

**Luiza Myrtaj**

**LIBËR PËR MËSUESIN**  
**GJUHA SHQIPE 8**  
Për klasën e 8-të të arsimit 9-vjeçar

**BOTIME**



## BOTIME



Redaktor letrar: Arlon Liko  
Paraqitja grafike: Lindita Prela  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, dhjetor 2017

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

---

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;  
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: [www.botimepegi.al](http://www.botimepegi.al)  
**Spektori i shpërndarjes:** cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;  
**e-mail:** [marketing@botimepegi.al](mailto:marketing@botimepegi.al)  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 40 075 01;  
**e-mail:** [shtypshkronjapegi@yahoo.com](mailto:shtypshkronjapegi@yahoo.com)

---

## Përmbajtja:

I.	Plani vjetor i lëndës.....	5
II.	Planifikimi i tremujorit të parë (shtator – dhjetor).....	7
III.	Planifikimi i tremujorit të dytë (janar – mars).....	15
IV.	Planifikimi i tremujorit të tretë (prill – qershor).....	24
V.	Planifikimi i orëve mësimore - Tremujori i parë.....	31
VI.	Planifikimi i orëve mësimore - Tremujori i dytë.....	147
VII.	Planifikimi i orëve mësimore - Tremujori i tretë.....	253



# GJUHA SHQIPE 8

## PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS

35 javë x 5 orë = 175 orë

	Kompetencat e fushës		Shkathësitë që do të realizohen në komunikim përmes:	Orë
1.	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshëm	8	Gjuhës së dëgjuar	8
2.	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	7	Gjuhës së folur	7
3.	Të lexuarit e teksteve: letrare dhe Teksteve joletrare	70 49  21	Teksteve në prozë (13-14 pjesë) Teksteve poetike (5-6 pjesë) Teksteve dramatike (2-3 pjesë) Teksteve joletrare	30 12 7 21
4.	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	25	Gjuhës së shkruar	25
5.	Përdorimi i drejtë i gjuhës	65	Njohurive gramatikore Sintaksë Morfologji Leksikologji Fjalëformim Drejtshkrim	 29 16 7 2 11
	Gjithsej			175 orë

*Shënim.* Orët për bisedat letrare, për projektet janë parashikuar nga orët e të lexuarit. Orët për testime, diktme, përsëritje janë parashikuar nga të shkruarit, njohuritë për gjuhën, të folurit e të dëgjuarit.

## PLANIFIKIMI VJETOR

KOMPETENCAT E FUS-HËS	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR – MARS	PRILL – QERSHOR
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	3 orë	3 orë	2 orë
Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	4 orë	1 orë	2 orë
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	24 orë	26 orë	20 orë
Të shkruarit për qëllime formale dhe funksionale	7 orë	7 orë	11 orë
Përdorimi i drejtë i gjuhës	22 orë	23 orë	20 orë

Brenda këtyre ka

1 orë test

3 orë projekt

2 orë bisedë letrare

2 diktime

1 orë test

3 orë projekt

2 orë bisedë letrare

1 orë test

3 orë projekt

1 orë bisedë letrare

# GJUHA SHQIPE 8

## PLANIFIKIMI I TREMUJORIT TË PARË (SHTATOR – DHJETOR)

### REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:

### KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrijedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (falëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

### KOMPETENCA E TË MENDUARIT

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

### KOMPETENCA E TË NXËNIT

Nxënësi/ja:

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitiyeje logjike.

### KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN

Nxënësi/ja:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

### KOMPETENCA QYTETARE

Nxënësi/ja:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

### KOMPETENCA DIGJITALE

Nxënësi/ja:

- përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS</b></p> <p><b>Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton tekstin dhe nëntekstin, si edhe gjykon për qëllimin, ndjenjat e folësit, vërtetësinë dhe besueshmërinë e tekstit;</li> <li>- diskuton, zgjeron dhe gjykon idetë e dëgjuara, si edhe merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon rreth temave të fushave të ndryshme.</li> </ul> <p><b>Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- flet qartë dhe kuptueshëm për tema të ndryshme në situata formale dhe joformale;</li> <li>- përfshihet në diskutime, parafrazon e përmbledh komentet e prezantuara me gojë, duke marrë parasysh edhe elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim;</li> <li>- krijon tekste mediatike për qëllime dhe audiencia të ndryshme duke përdorur format dhe teknikat e përshtatshme.</li> </ul> <p><b>Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kupton tekstin edhe kur mendimet dhe idetë nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shpjegon se si gjuha dhe stili i autorit ndikojnë për t'i dhënë idetë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar;</li> <li>- analizon dhe diskuton për interpretimet e të tjerëve rreth tekstit.</li> </ul> <p><b>Tekste letrare</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson gjuhën dhe idetë që përcjell autori në tekst, analizon sjelljen dhe qëndrimet e personazheve, zhvillimin e fabulës ose subjektit;</li> <li>- bën dallimin mes personazhit, autorit dhe tregimitarit;</li> <li>- krahason stilin, gjuhën dhe tematikën në tekste të ndryshme.</li> </ul> <p><b>Tekste joletrare</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh, krahason dhe përmbledh informacionin nga tekste të ndryshme;</li> <li>- dallon informacionin e rëndësishëm nga i parëndësishmi, faktin nga opinioni, shkakun nga pasoja;</li> <li>- veçon tiparet karakteristike të fjalëve, fjalive dhe tekstit në tekste të ndryshme.</li> </ul> <p><b>Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;</li> <li>- përdor forma të efektshme të të shkruarit për qëllime dhe audiencia të caktuara;</li> <li>- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idenë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.</li> </ul> <p><b>Përdorimi i drejtë i gjuhës</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore;</li> <li>- përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta;</li> <li>- përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;</li> <li>- analizon stilet dhe regjistrat e gjuhës;</li> <li>- vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.</li> </ul>	<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve</b></p> <p>Sugjerohet që gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: <i>stuhit mendimesh, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraparakë, diskutim për njohuritë paraparakë, hartat e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, diturët e të nxënës, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit, rrjeti i diskutimit, vija e vlerës, të mbajturit e strukturuar të shënimeve, DDM etj.</i></p> <p>Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.</p> <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, testeve, pjesëmarrja në biseda e diskutime e leximet jashtë klase, diktimet etj.</p>
---	--

Nr.	<sup>1</sup> Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	Dëgjimë D 1	Gjuha shqipe përmes vargjeve	Në një vend të huaj	<i>Subi mendimesh, Të nxënës në bashkëpunim, Vija e vlerës</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në aktivitet dhe debate	Teksti mësimor
2	Të folurit F 1	Flasim për vargjet kushtuar gjuhës	Thënie për gjuhën shqipe	<i>Ditari dypjesësh, Të nxënës në bashkëpunim, Ndërrimi i vendeve</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në aktivitet dhe debate	Teksti mësimor
3	L. Tekst letrar L 1	Kush e solli Doruntinën? (Ora 1)	Vargje nga Bajroni	<i>Subi mendimesh, Të nxënës në bashkëpunim – Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për lexim të rrjedhshëm	Teksti mësimor, Interneti
4	Nj. Gjuhësore Gj 1	Tipare të gjuhës së folur dhe të shkruar	Diskutim për fjalët “piktogram papirus, pergamenë, alfabet”	<i>DDM, Të nxënës në bashkëpunim – Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i>	Vlerësimi për dallimin e tipareve të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar	Teksti mësimor, fisha të ndryshme
5	Nj. Gjuhësore Gj 2	Përdorimi i saktë i dy pikave, thonjzave, pikëpresjes dhe kllapave	Shenjat e pikësimit të thonjzave, dy pikat në poezinë “Edukata” e Dritëro Agollit	<i>Subi mendimesh, INSERT, Punë në dyshe</i>	Vlerësimi për përcaktimin e dy pikave, kllapat dhe thonjzat në fjalitë e dhëna	Teksti mësimor (Pjesë të incizuara për përdorimin e shenjave të pikësimit.)
6	L. Tekst letrar L 2	Kush e solli Doruntinën? (Ora 2)	Fjalë të urta për besën	<i>Punë në dyshe, Pyetje-përgjigje, Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim për materialet e hulumtuara	Teksti mësimor, baladat shqiptare
7	Dëgjimë D 2	Sjellje dhe veprime të përshatshme gjatë të dëgjuarit	Loja “Telefoni i prishur”	<i>Subi mendimesh, Punë individuale, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për dëgjimin kritik	Teksti mësimor
8	L. Tekst letrar L 3	Përralla dhe mite (ora 1)	Në video-projektor shfaqet miti i Atlasit ose lexohet nga mësuesi/ja: Bartësi i qiejve.	<i>Subi mendimesh – Mbajtja e strukturuar e shënimeve</i>	Vlerësim për formulimin e saktë të mesazhit	Teksti mësimor
9	Nj. Gj. (Drejtshkrim) Gj 3	Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në trup të fjalës	Bisedë mes miqsh	<i>Subi mendimesh – Mbajtja e strukturuar e shënimeve</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti mësimor, fisha të ndryshme
10	Nj. Gj. (Drejtshkrim) Gj 4	Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç në fjalë	Vargje nga Fan Noli	<i>Subi mendimesh, Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i>	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë për bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç në fjalë	Teksti mësimor, incizime, fisha
11	L. Tekst letrar L 4	Përralla dhe mite (ora 2)	Përralla	<i>Punë në dyshe, ditari dypjesësh, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për dallimin e të dhënave kryesore	Teksti mësimor
12	L. Tekst letrar L 5	Narcisi	Diskutim mbi tablonë: “Narcis” të John William Waterhouse	<i>Imagjinatë e drejtuar, Pyetje-përgjigje, Diagramme Veni, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për dallimin e informacionit kryesor dhe atë dytësor	Teksti mësimor

Nr.	<sup>1</sup> Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
13	Flasim F 2	Sjellje dhe veprime të përshtatshme gjatë të folurit	Tryezë e rrumbullakët “Rreziku nga substancat e dëmshme”	<i>Subi mendimesh, Të nxënës në bashkëpunim, Punë me grupe, Lojë në role</i>	Vlerësim i përgjigjeve për sjelljet e përshtatshme gjatë të folurit	Teksti mësimor, “Metodika për estetikën e të folurit” Sonila Kapedani
14	Nj. Gj. (Drejtshkrim) Gj 5	Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret s-, z-	Lojë në dyshe	<i>DDM, Shkrim i lirë</i>	Vlerësimi i detyrave të klasës për përdorimin e drejtë të fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret nistore.	Teksti mësimor, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”
15	Nj. Gj. (Drejtshkrim) Gj 6	Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores -j-	Vargje nga poezia e Nënë Terezës “Jetoje jetën”	<i>punë në dyshe, Mbatjet e strukturuar e shënimeve, Të nxënës në bashkëpunim</i>	Vlerësimi i përgjigjeve për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -j	Teksti mësimor
16	L. Tekst letrar L 6	Tregimet e Eneas	Fragment nga filmi “Troja”	<i>VLMD (Veprimtari me lexim dhe mendim të drejtuar), Punë në dyshe, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për leximin shprehës	Teksti mësimor, “Eneida” e Virgjilit përshatje
17	L. Tekst letrar L 7	Martesa e Floçkës	Lexohen fragmente nga përralla “Gërzhetat”.	<i>Punë në dyshe, Pemë mendimi, Punë individuale “Lëre fjalën e fundit për mua”</i>	Vlerësim për leximin shprehës	Teksti mësimor
18	L. Tekst letrar L 8	Bota sipas miteve	Miti	<i>Punë në dyshe, Pemë mendimi, Punë individuale “Lëre fjalën e fundit për mua”</i>	Vlerësim për formulimin e saktë të temës, mesazhin dhe dallojnë simbolikën e mitit.	Teksti mësimor
19	Nj. Gj. (Drejtshkrim) Gj 7	Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores -h-	Lojë	<i>Shkrim i shpejtë, DDM, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -h	Teksti mësimor
20	Nj. Gj. (Fjalëformim) Gj 8	Përdorimi i drejtë i fjalëve që kanë bashkëtingëlloren -rr-	Lojë	<i>Lojë, INSERT, Punë individuale</i>	Vlerësim për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -h	Teksti mësimor
21	Flasim F 3	Mire dhe paragjykimet	Një thënie e Gëtes	<i>Bashkëbisedim, Punë me grupe në dyshe, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim	Teksti mësimor
22	L. Tekst joletrar L 9	Urtësia njerëzore	Histori njerëzore - cikël jetësor	<i>Parashikim me anë të titullit, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në grup	Teksti mësimor
23	Shkruajmë Sh 1	Parapërgatitja për shkrimin e një teme	Procesi i të shkruarit	<i>Subi mendimesh, Kërkim-bulumtim, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim dhe përfshirjen në grup	Teksti mësimor

Nr.	<sup>1</sup> Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
24	Nj. Gj. (Drejtshkrim) Gj 9	Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores -nj- në trup dhe në fund të fjalës	Lojë (gje) sa më shumë emra vendesh, njerëzish dhe kafshësh që fillojnë me bashkëtingëlloren -nj-)	<i>Punë në dyshe, Tabela INSERT, Punë individuale</i>	Vlerësim për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -nj-	Teksti mësimor “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”
25	Nj. Gj. (Drejtshkrim) GJ 10	Përdorimi i drejtë i grupeve të bashkëtingëlloreve -mb-, -nd-, -ng-, -ngj-	Lojë	<i>Subi mendimesh, Diskutim, Kllaster</i>	Vlerësim për lexim të rrjedhshëm	Teksti mësimor “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”
26	L. Tekst letrar L10	Ëndërr e vërtetë	“Malli për atdheun”, Faik Konica	<i>Diagrami i Venit, Hartë koncepti</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti mësimor
27	Shkruajmë Sh2	Shkruajmë një përvoja personale	Procesi i të shkruarit	<i>Subi mendimesh, Punë e drejtuar me fshë</i>	Vlerësim për dallimin e familjes së fjalëve.	Teksti mësimor
28	L. Tekst letrar L11	Tregtar flamujsh (ora 1)	“Himni i flamurit”	<i>Parashikim me anë të titullit, Pemë mendimi, Hartë personazhi, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për materialet e hulumtuara	Teksti mësimor
29	L. Tekst letrar L12	Tregtar flamujsh (ora 2)	Punë me tekstin	<i>Lojë me role, Shkrim i lirë, Pemë mendimi</i>	Vlerësim për formulimin e saktë të temës, mesazhit që përcjell pjesa	Teksti mësimor
30	Flasim F 4	Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën	Fjalët e huaja në median e shkruar	<i>Bashkëbisedim, Të nxënësit në bashkëpunim, Punë me grupe, Diskutim</i>	Vlerësim për përdorimin drejt të fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja	Teksti mësimor
31	Dëgjojmë D 3	Tekste që lidhen me traditat shqiptare	Vargje nga Udhëtimi i “Çajld Haroldit”	<i>Punë në dyshe, Të nxënësit në bashkëpunim, Veprimtari me lexim dhe mendim të drejtuar (VMD), Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim për tiparet e personazheve	Teksti mësimor
32	L. Tekst letrar L 13	Ngjarje pa lëvizje	Vargje nga Migjeni	<i>Parashikim me anë të titullit, Ditari dy pjesësh, Pemë mendimi</i>	Vlerësim për dallimin e përemrave	Teksti mësimor
33	Nj. Gj. (Drejtshkrim) GJ 11	Diktim	Diktim me të lexuar dhe plotësim	<i>Diktim me të lexuar dhe plotësim</i>	Vlerësim me notë	Tekste letrare ose jo letrare
34	Nj. Gj. (Fjalëformimi) GJ12	Fjala dhe pjesët e saj përbërëse	Lojë: “Dhe në gjuhë përdoren pluset”	<i>DDM, Subi mendimesh, Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për analizën e përbërësve të fjalës	Teksti mësimor

Nr.	<sup>1</sup> Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënësit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
35	Nj. Gj. (Fjalëformimi) Gj 13	Analiza e fjalëve sipas ndërtimit dhe formimit		<i>Subi mendimesh, Diskutim, Kllaster</i>	Vlerësim për dallimin e klasave	Teksti mësimor
36	L. Tekst letrar L 14	I forti (ora 1)	Kush është më i forti në klasë?	<i>Imagjinatë e drejtuar, Punë në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për të kuptuarit e tekstit, për analizimin me argumente të tij etj.	Teksti mësimor
37	L. Tekst letrar L 15	I forti (ora 2)	Stop bullizmit	<i>Shkrim i shpejtë, Punë individuale</i>	Vlerësim për materialet e hulumtuara	Teksti mësimor
38	Të shkruarit Sh 3	Krahasonjë personazhe	Berri dhe Piteri	<i>Diskutim, Diagrame Veni, Punë individuale</i>	Vlerësim për krahasimin e personazheve sipas skemës së caktuar	Teksti mësimor
39	L. Tekst letrar L 16	Udhëtimi i Parvanës	Sekuenca nga filmi “Hurtlocker”	<i>Pemë mendimi, Punë në dyshe, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim	Teksti mësimor
40	Të shkruarit Sh 4	Ritregojmë ndodhi	Punë me tekstin	<i>Diskutim, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për dallimin drejt të strukturës së tregimit	Teksti mësimor
41	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 14	Fjalët me ngjyrim emocional	Vargje nga Naimi	<i>Diskutim, Mbajtje e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për përdorimin drejt të fjalëve me ngjyrim emocional	Teksti mësimor, fisha
42	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 15	Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve	Kërkim në fjalor	<i>DDM, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim	Teksti mësimor, fisha
43	L. Tekst letrar L 17	Projekt “Traditat e vendit tim” ose “Veshjet tradicionale shqiptare”	Vendi im i shrenjtë	<i>Pyetje-përgjigje, Dëgjim i drejtuar, Bashkëbisedim, Diskutim etj.</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti mësimor
44	L. Tekst letrar L 18	Projekt “Traditat e vendit tim” ose “Veshjet tradicionale shqiptare”	Vizite në institucione të ndryshme	<i>Bisedë, Kllaster, Pyetësorë</i>	Vlerësim për formulimin e sakrë të mesazhit	Teksti mësimor, Materiale ose botime të ndryshme për Skënderbeun
45	L. Tekst L 19	Prezantimi i projektit (projekt) ora III	Prezantimi	<i>Pyetje-përgjigje, Dëgjim i drejtuar, Bashkëbisedim, Diskutim etj.</i>	Vlerësim në grup	Teksti mësimor, Materiale ose botime të ndryshme për Skënderbeun

Nr.	<sup>1</sup> Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
46	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 16	Regjistrat e gjuhës	Në autobus	<i>Sberim i lirë, DDM, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për dallimin e regjistrave të gjuhës	Teksti mësimor, fisha
47	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 17	Dallojmë regjistrat e gjuhës	Punë me tekstin	<i>Rikujtojmë në dyshe, Të nxënësit në bashkëpunim, Punë individuale</i>	Vlerësoj kontributet në etapat e ndryshme të orës së mësimi	Teksti mësimor
48	L. Tekst letrar L 20	Histori pa mbarim	Film “Never ending story”	<i>Diskutim, Pyetje-përgjigje, Pemë mendimi</i>	Vlerësoj kontributet në etapat e ndryshme të orës së mësimi	Teksti mësimor
49	Shkruajmë Sh 5	Shkruajmë me fantazi	Qyteti im i së ardhmes	<i>Imagjinatë e drejtuar, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për fantazinë e treguar gjatë shkrimit të tregimit	Teksti mësimor
50	L. Tekst letrar L 21	Bisedë letrare	Libri	<i>Suhi mendimesh, Kllaster, Bashkëbisedim</i>	Vlerësim për argumentimin e mendimeve gjatë bisedës letrare	Libër artistik
51	L. Tekst letrar L 22	Bisedë letrare	Libri	<i>Suhi mendimesh, Kllaster, Bashkëbisedim</i>	Vlerësim për argumentimin e mendimeve gjatë bisedës letrare	Libër artistik
52	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 18	Stilet e gjuhës	Një kërkesë për drejtorinë e shkollës	<i>Bashkëbisedim, Mbajja e strukturuar e shënimeve, Punë e pavarur</i>	Vlerësimi i nxënësit për dallimin e stileve të gjuhës në tekste të ndryshme	Teksti mësimor
53	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 19	Dialektet e gjuhës shqipe	Në klasë	<i>Punë e drejtuar me fisha, DDM</i>	Vlerësimi i nxënësve për dallimin e dialekteve	Teksti mësimor, tekste letrare në dy dialektet
54	Tekst letrar L 23	Pasqyra e dëshirave	Në pasqyrën e shtrigës së Botëbardhës	<i>Parashikim me terma paraparakë, VLMD, Sberim i lirë</i>	Vlerësimi i nxënësve që do të aktivizohen gjatë kësaj orë.	Teksti mësimor
55	Tekst letrar L 24	Makina e kohës	Film vizatimor në shqip “Makina e kohës”	<i>Parashikim me terma paraparakë, Ditari dyqjesësh, Shkrim i shpejtë, Punë në dyshe</i>	Vlerësimi i nxënësve që do të aktivizohen gjatë kësaj orë.	Teksti mësimor CD, libri
56	Shkruajmë Sh 6	Përshkrimi i personazhit të preferuar	Parvana, personazhi im i dashur	<i>Imagjinatë e drejtuar, Sberim i lirë</i>	Vlerësim për respektimin e strukturës së tregimit	Teksti mësimor, fisha

Nr.	<sup>1</sup> Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënësit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
57	Nj. Gj. (Leksikologji) Gj 20	Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj	Në hartë	<i>Pyetja sjell pyetjen, INSERT, Punë në dyshje</i>		Teksti mësimor, foto
58	Nj. Gj. Gj 21	Test për tremujorin e parë		<i>Punë e pavarur</i>	Vlerësim për arritjet e njohurive të këtij tremujori	
59	Njohuri gjuhësore Gj 22	Panair i portofolit		<i>Pyetje-përgjigje, Dëgjim i drejtuar</i>	Vlerësim i portofolit	
60	Të shkruarit Sh 7	Korrigjimi i punëve me shkrim	Punët me shkrim të nxënësve	<i>Vëzhgim i punëve me shkrim, Punë e drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim</i>	Vlerësim i punës me shkrim	Punimet e nxënësve, Interneti, Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe

# GJUHA SHQIPE 8

## PLANIFIKIMI I TREMUJORIT TË DYTË (JANAR – MARS)

### REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:

### KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

### KOMPETENCA E TË MENDUARIT

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

### KOMPETENCA E TË NXËNIT

Nxënësi/ja:

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit;
- ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhi të logjike.

### KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN

Nxënësi/ja:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/ shkolle apo jashtë saj).

### KOMPETENCA QYTETARE

Nxënësi/ja:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

### KOMPETENCA DIGJITALE

Nxënësi/ja:

- përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

## REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS

### Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi/ja:

- interpreton tekstin dhe nëntekstin, si edhe gjykon për qëllimin, ndjenjat e folësit, vërtetësinë dhe besueshmërinë e tekstit;
- diskuton, zgjeron dhe gjykon idetë e dëgjuara, si edhe merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon rreth temave të fushave të ndryshme.

### Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi/ja:

- flet qartë dhe kuptueshëm për tema të ndryshme në situata formale dhe joformale;
- përfshihet në diskutime, parafrazon e përmbledh komentet e prezantuar me gojë, duke marrë parasysh edhe elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim;
- krijon tekste mediatike për qëllime dhe audiencë të ndryshme, duke përdorur format dhe teknikat e përshatshme.

### Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi/ja:

- kupton tekstin edhe kur mendimet dhe idetë nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shpjegon se si gjuha dhe stili i autorit ndikojnë për t'i dhënë idetë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar;
- analizon dhe diskuton për interpretimet e të tjerëve rreth tekstit.

### Tekste letrare

Nxënësi/ja:

- vlerëson gjuhën dhe idetë që përcjell autori në tekst, analizon sjelljen dhe qëndrimet e personazheve, zhvillimin e fabulës ose subjektit;
- bën dallimin mes personazhit, autorit dhe tregimtarit;
- krahason stilin, gjuhën dhe tematikën në tekste të ndryshme.

### Tekste joletrare

Nxënësi/ja:

- përzgjedh, krahason dhe përmbledh informacionin nga tekste të ndryshme;
- dallon informacionin e rëndësishëm nga i parëndësishmi, faktin nga opinioni, shkakun nga pasojat;
- veçon tiparet karakteristike të fjalëve, fjalive dhe tekstit në tekste të ndryshme.

### Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi/ja:

- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;
- përdor forma të efektshme të të shkruarit për qëllime dhe audiencë të caktuara;
- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idenë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.

### Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi/ja:

- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore;
- përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta;
- përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- analizon stilet dhe regjistrat e gjuhës;
- vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.

### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Sugjerohet që gjatë orëve të mësimi do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *stuhi mendimesh, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, diskutim për njohuritë paraprake, hartat e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënës, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit, rrjeti i diskutimit, vija e vlerës, të mbajturit e strukturuar të shënimeve, DDM etj.*

Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.

### Vlerësimi

Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, testeve, pjesëmarrja në biseda e diskutime e leximet jashtë klase, diktimet etj. \

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
61	L. Tekst letrar L 25	“Rent, or Marathonomak”	Vargje nga F. Noli	<i>Stubi mendimesh, Vëzhgim i materialit me video-projektor</i>	Vlerësim për zbulimin e mesazhit	Teksti mësimor
62	L. Tekst letrar L 26	“Rent, or Marathonomak”	Vargje nga F. Noli	<i>Sheda e autorit, Punë individuale dhe në dyshe, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për punën individuale	Teksti mësimor
63	Të folurit F 5	Rrjedhshmëria, intonacioni dhe ritmi gjatë të folurit	Imitime të aktorëve të humorit	<i>Bashkëbisedim, Pyetja sjell pyetjen, Punë individuale</i>	Vlerësim për aftësimin e nxënësve në të folur	Teksti mësimor
64	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 23	Emrat që përdoren vetëm në njëjës dhe emrat që përdoren vetëm në shumës	Loja: “Më i sakti më i shpejti”	<i>Stubi mendimesh, Shënime mbi shënime, Punë individuale</i>	Vlerësim për saktësinë e zgjidhjes së ushtrimeve	Teksti mësimor, fisha me fragmente që kanë përëmbra të ndryshëm.
65	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 24	Emrat e farefisnisë 2 (i ati, i biri, e motra etj.)	Pema e familjes	<i>Diskutim, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimor	Teksti mësimor
66	L. Tekst letrar L 27	Serafina Topia	Punë me tekstin	<i>Diskutim, të nxënësve në bashkëpunim, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për përshkrimin e personazheve	Teksti mësimor
67	L. Tekst letrar L 28	Muza	Muza poetike	<b><i>Përvijim i të menduarit, Marrëdhëniet pyetje-përgjigje (MP-P), Shkrim i shpejtë</i></b>	Vlerësohet për: mënyrën sa më të qartë të analizimit të poezisë, argumentit të interpretimit të saj dhe gjuhës së përdorur.	Teksti mësimor
68	L. Tekst letrar L 29	Harta e përgjysmuar e atdheut, V. Zhiti	Shqipëria ime	<i>Punë individuale, Punë në grup</i>	Vlerësim për dallimin e mesazhit që zbulon poezia.	Teksti mësimor, fisha me situata që të kenë folje në mënyra të ndryshme.
69	Nj. Gj. (Morfologji)	Kategoritë gramatikore të mbiemrit	Portreti i shokut tim	<i>Punë individuale, Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim për punën e pavarur	Teksti mësimor, poezi të ndryshme
70	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 26	Përemri lidhor dhe përemri pronor	Punë me tekstin	<i>Punë individuale, Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti mësimor, Libër artistik

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
71	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 27	Përmiri lidhor dhe përmiri pronor USHT	Punë me tekstin	<i>Punë e drejtuar, Punë individuale</i>	Vlerësim për saktësinë e ushtrimeve	
72	L. Tekst letrar L 30	Buzëdrinas (ora 1)	Diskutim rreth poezisë së Agim Vinës “Poeti”	<i>Diskutim, Ditari dypjesësh, Shkrim i lirë, Turi i galerisë, Punë individuale</i>	Vlerësim për zbërthimin e poezisë	Teksti mësimor
73	L. Tekst letrar L 31	Buzëdrinas (ora 2)	Punë me tekstin	<i>Konkurs recitimi, Punë në dyshe, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për zbulimin e mesazhit të poezisë, për argumentet e përdorura gjatë diskutimit	Teksti mësimor
74	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 28	Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore	Punë me tekstin	<i>Imagjinatë e drejtuar, DDM, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për dallimin e kohëve të përbëra të formës joveprorë të mënyrës dëftore, lidhore, kushtore e habitore	Teksti mësimor, fisha me situata që ndodhin në kohë të ndryshme.
75	L. Tekst letrar L 32	“Vdekja nuk është fund (ora 1)	Death is not the end	<i>Bashkëbisedim, Lapsat në mes, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim nxënësit për analizën që i bëjnë poezisë, për zbulimin e motivit të këtyre vargjeve, për bashkëpunimin gjatë punës etj.	Teksti mësimor, foto
76	L. Tekst letrar L 33	“Vdekja nuk është fund” (ora 2)	Punë me tekstin	<i>Konkurs, Punë në dyshe, Karrigia e nxehtë</i>	Vlerësim për recitimin e poezisë	Teksti mësimor, foto
77	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 29	Ushtrime. Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore	Punë me tekstin	<i>Punë e drejtuar, Të nxënësit në bashkëpunim, Punë individuale</i>	Vlerësim nxënësit për pjesëmarrjen e tyre gjatë orës së mësimi	
78	L. Tekst letrar L 34	“Dremit liqeri”	Poezia dëgjohet në youtube ose recitohet nga mësuesi/ia.	<i>Bashkëbisedim, Të nxënësit në bashkëpunim, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi	Teksti mësimor + vëllimi poetik i L. Poradecit
79	Të shkruarit Sh 8	Poezia ora 1	Recito bukur një poezi	<i>Pyetja sjell pyetjen, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe</i>	Vlerësim nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi	Teksti mësimor, fisha

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
80	Të shkruarit Sh 9	“Shkruaj dhe unë poezi” (ora 2)	Poezi nga Ismail Kadare “Dhe unë vargëzoj”	<i>Stubi mendimi, Punë në dyshe, Shkrim i lirë, Diskutim</i>	Vlerësim për krijimin e poezive sipas udhëzimeve të dhëna	Teksti mësimor
81	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 30	Ndajfolja	Lojë në çift se kush gjen më shumë ndajfolje brenda 5 minutave.	<i>Rendit/Grupol/Emërto, DDM, Punë në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin, dallimin e ndajfoljeve nga pjesët e tjera të ligjëratës në fjalitë e dhëna	Teksti mësimor, Fisha
82	L. Tekst letrar L 35	Bisedë letrare	Libri	<i>Diskutim, Grupet e ekspertëve, Karrigia e nxehtë</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti që ka përzgjedhur mësuesi/ja për bisedë letrare ose lexim jashtë
83	L. Tekst letrar L 36	Karnavalet e Korçës (ora 1)	Pjesa teatrale në youtube	<i>Bashkëbisedim, Pemë mendimi, Të nxënësve në bashkëpunim, Diagram Veni, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti mësimor
84	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 31	Parafalët sipas strukturës morfologjike	Këmbësorët, makinat dhe polici	<i>Stubi mendimi, DDM</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të parafalëve në fjali duke e dalluar nga pjesët e tjera të ligjëratës	Teksti mësimor
85	L. Tekst letrar L 37	Karnavalet e Korçës (ora 2)	Fragment nga “Karnavalet e Korçës”	<i>Diagramme Veni, Grupet e ekspertëve, Rrjet diskutimi</i>	<i>Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi.</i>	Teksti mësimor
86	L. Tekst letrar L 38	Mbreti Lir (ora 1)	Shekspiri dhe tragjeditë e tij	<i>Pemë mendimi, Lexim me role, Harta e personazhit, Bashkëbisedim</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në orën mësimore	Teksti mësimor, Komedia “Karnavalet e Korçës”

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënës (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
87	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 32	Lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojeve të tyre	Lojë në dyshe-Lidhëzat	<i>Bashkëbisedim, Tabela e konceptit, Puno në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin e lidhëzave në fjali, për dallimin e tyre nëse lidhin pjesë fjalish që varen a jo nga njëra-tjera, apo lidhin gjymtyrë fjalie.	Teksti mësimor
88	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 33	Lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojeve të tyre USHTRIME	Punë me tekstin	<i>Punë në dyshe, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë, Turi i galerisë</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të lidhëzave dhe shprehjeve lidhëzore.	Teksti mësimor
89	L. Tekst letrar L 39	Mbreti Lir (ora 2)	Shekspiri dhe tragjeditë e tij	<i>Harta e personazhit, Lapsat në mes, Vija e vlerës</i>	Vlerësohen nxënësit për: leximin bukur e qartë të pjesës, dallimin e personazheve të vlershës, ndarjen e eksperiencave personale me shokët.	Teksti mësimor
90	L. Tekst letrar L 40	Projekt “Ndikimi i internetit e librit në zhvillimin e aftësive psikomotorore të nxënësve” (Ora 1)	Ndarja e punëve	<i>Mendolpuno në dyshe/shkëmbime mendime, Të nxënës në bashkëpunim</i>	Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin në ndarjen e punëve.	Teksti mësimor, foto
91	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 34	Pjesëza	Punë me tekstin	<i>Bashkëbisedim, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin e saktë të pjesëza në fjali, dallimin e llojeve të tyre sipas kuptimit dhe ndërtimit	Teksti mësimor
92	Nj. Gj. (Morfologji) Gj 35	Pasthirra	Lojë në çift Krijë një situatë dhe përdor pasthirra.	<i>Bashkëbisedim, Tabela e konceptit, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për identifikimin e pasthirmave në fjali	Teksti mësimor, fisha
93	Dëgjojmë D 4	Romeo dhe Zhuljeta	“Romeo dhe Zhuljeta” me aktorin Leonardo di Caprio	<i>Stubi mendimesh, Pyetja sjell pyetjen, Pauza treninutëshe</i>	Vlerësohen nxënësit për vëmendjen e kushtuar pjesës, gjatë dëgjimit të saj.	Teksti mësimor

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
94	L. Tekst letrar L 41	Projekt “Ndikimi i internetit e librit në zhvillimin e aftësive psikomotore të nxënësve” (Ora2)	Seleksionimi i materialeve	<i>Të nxënësve në bashkëpunim, Bashkëbisedim</i>	Vlerësim për materialet e hulumtuara	Burime të ndryshme hulumtimi
95	L. Tekst joletrar L 42	Kohë e pamjaftueshme (Ora 1)	Kadareja dhe Nobeli	<i>Parashikim me anë të titullit, Pyetja sjell pyetjen, Diskutim</i>	Vlerësohen nxënës për të kuptuarit e tekstit, për analizën e tij.	Teksti mësimor
96	L. Tekst joletrar L 43	Kohë e pamjaftueshme (Ora 2)	Kadareja dhe Nobeli	<i>Diagrame Veni, Ditari dypjesësh, Tabela M, Diskutim</i>		Teksti mësimor
97	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 36	Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali	Punë me tekstin	<i>Pyetje-përgjigje, INSERT, Punë në dyshe</i>	<i>Vlerësohen nxënës për dallimin e funksioneve të fjalëve në një fjali, për përfaqësimin e tyre gjatë orës së mësimet etj.</i>	Teksti mësimor
98	Dëgjojmë D 5	Tekste biografike dhe me kujtime	Biografi e D. Agollit	<i>Diskutim, Pyetja sjell pyetjen Reflekt/Reflekt/Reflekt</i>	Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna.	Teksti mësimor
99	L. Tekst letrar L 44	Projekt “Ndikimi i internetit e librit në zhvillimin e aftësive psikomotore të nxënësve” (Ora 3)	Prezantim projekti	<i>Të nxënësve në bashkëpunim, Bashkëbisedim</i>	Vlerësim për prezantimin e produkteve të krijuara	Interneti, materiale të shumta
100	L. Tekst letrar L 45	“Thuaji zemrës PO”	Lufta e brezave në familje	<i>Imagjinatë e drejtuar, Tabela INSERT, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësimin individual	Teksti mësimor
101	L. Tekst joletrar L 46	Të bëjmë përpara	Diskutim: Si të përballemi me vështirësitë	<i>Parashikim me anë të titullit, Të nxënësve në bashkëpunim, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për lexim të rrjedhshëm dhe angazhimin e tyre gjatë orës së mësimet	Teksti mësimor
102	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 37	Llojet e kallëzuesit: foljor dhe emëror	Fjali të ndryshme me kallëzuesin emëror dhe foljor	<i>Di, Dua të di, Mësova (DDM)</i>	Vlerësim për dallimin e kallëzuesit emëror dhe atij foljor	Teksti mësimor

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënës (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
103	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 38	Ushtrime. Llojet e kallëzuesit: foljor dhe emëror	Punë me tekstin	<i>Pyetja sjell pyetjen, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për punën individuale	Teksti mësimor
104	L. Tekst joletrar L 47	Homeri i Shqipërisë	Diskutojmë rreth thënies për Gjergj Fishtën	<b>Harta Semantike, Të nxënës me këmbime, Rrjet diskutimi</b>	<i>Vlerësohen nxënës për punën kërkuese për jetën e krijimtarisë e Fishtës, për argumentet që shprehin gjatë diskutimit etj.</i>	Teksti mësimor
105	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 39	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje	Një vizitë në Prizren	<b>DIIDUA TË DIIMËSOVA</b>	Vlerësim për përdorimin drejt të fjalëve me bashkërenditje dhe nënrenditje	Teksti mësimor
106	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 40	Ushtrime: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje	Punë me tekstin	<i>Diskutim, Rishiko në dyshje, Të nxënës me këmbime</i>	Vlerësim për përdorimin drejt të fjalëve me bashkërenditje dhe nënrenditje	Teksti mësimor
107	L. Tekst joletrar L 48	Një rrëfim mbi librat e zemrës	Unë i dua librat.	<i>Hartë koncepti, Të nxënës me këmbime, Karrigia e nxënë</i>	Vlerësim për punën në grup	Teksti mësimor
108	Të dëgjuarit D 6	Dëgjime dhe komente të intervistave	Diskutoni rreth jetës dhe krijimtarisë artistike të Inva Mulës	<i>Pemë mendimi, Pyetje-përgjigje, Shkrim i lirë</i>	Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna, diskutimit rreth personazhit të këngëtares Inva Mula, zbulimit të momenteve kyçe të jetës së saj gjatë procesit të të dëgjuarit kritik.	Teksti mësimor
109	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 41	Fjalitë e përbëra me nënrenditje	Fragmente ose tekste nga libri	<i>Bashkëbisedim, Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor lloje të ndryshme tekste, interneti
110	Të shkruarit Sh 10	Kronika	Kronika dhe gazetat	<i>Bashkëbisedim, DDM, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për dallimin e veçorive të kronikës	Teksti mësimor
111	Të shkruarit Sh 11	Shkruaj një kronikë	Kronika e jetës sime	<i>Pyetje-përgjigje, Punë e pavarur me shkrim, diskutim</i>	Vlerësim për dallimin e veçorive të kronikës	Teksti mësimor, foto

NR	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
112	L. Tekst joletrar L 49	Mbresa udhëtimi	Udhëtimet	<i>Stuhi mendimesh, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për dallimin e veçorive të kronikës	Teksti mësimor, foto
113	Nj. Gj. Gj 42	Diktum II		<i>Punë e drejtuar me shkrim, Diskutim</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor
114	L. Tekst letrar L 50	Një vend i rrallë në majat e Shqipërisë	“Kruja, historia dhe jeta” A. Pipa	<i>Stuhi mendimi, Pyetja sjell pyetjen, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për lexim të rrjedhshëm	Teksti mësimor, foto
115	Të shkruarit Sh 12	Shkrimi i një artikulli (Ora 1)	Një artikull gazete	<i>Bashkëbisedim, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Shkrimi i lirë</i>	Vlerësim nxënës për dallimin e karakteristikave të artikullit, për pjesëmarrjen në diskutim etj.	Teksti mësimor
116	Të shkruarit Sh 13	Shkrimi i një artikulli -Mbrotja e mjedisit	Artikuj për mbrojtjen e mjedisit	<i>Pyetje-përgjigje, Punë e pavarur me shkrim, Reflektore/Reflektore/Reflektore</i>	Vlerësim nxënës për analizën e gjuhës së një artikulli, si dhe në diskutimin e punës me shkrim.	Teksti mësimor
117	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 43	Fjalitë e varura rrethore	Peizazh vjeshte	<i>Pyetja sjell pyetjen, INSERT, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për identifikimin e fjalëve të varura rrethore	Teksti mësimor, fisha, foto
118	Nj. Gj. Gj 44	Test për tremujorin e dytë		<i>Punë e pavarur</i>	Vlerësim për materialet e hulumtuara	Testet
119	Nj. Gj. Gj 45	Panair i portofolit	Dosja	<i>Pyetje-përgjigje, Dëgjim i drejtuar</i>	Vlerësim i portofolit	Dosjet
120	Të shkruarit Sh 14	Qortime të punëve me shkrim	Qortime	<i>Vëzhgim i punëve me shkrim, Punë e drejtuar, Punë e pavarur</i>	Vlerësim i punës me shkrim	Fletoret e punës me shkrim

# GJUHA SHQIPE 8

## PLANIFIKIMI I TREMUJORIT TË TRETË (PRILL – QERSHOR)

### REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

Orrë mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:

### KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

### KOMPETENCA E TË MENDUARIT

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyrë (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

### KOMPETENCA E TË NXËNIT

Nxënësi/ja:

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohej;
- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

### KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN

Nxënësi/ja:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/ shkolle apo jashtë saj).

### KOMPETENCA QYTETARE

Nxënësi/ja:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

### KOMPETENCA DIGJITALE

Nxënësi/ja:

- përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS</b></p> <p><b>Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton tekstin dhe nëntekstin, si edhe gjykon për qëllimin, ndjenjat e folësit, vërtetësinë dhe besueshmërinë e tekstit;</li> <li>- diskuton, zgjedh dhe gjykon idetë e dëguara, si edhe merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon rreth temave të fushave të ndryshme.</li> </ul> <p><b>Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- flet qartë dhe kuptueshëm për tema të ndryshme në situata formale dhe joformale;</li> <li>- përfshihet në diskutime, parafrazon e përmbledh komentet e prezantuara me gojë, duke marrë parasysh edhe elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim;</li> <li>- krijon tekste mediale për qëllime dhe audienca të ndryshme duke përdorur format dhe teknikat e përshtatshme.</li> </ul> <p><b>Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kupton tekstin edhe kur mendimet dhe idetë nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shpjegon se si gjuha dhe stili i autorit ndikojnë për t'i dhënë idetë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar;</li> <li>- analizon dhe diskuton për interpretimet e të tjerëve rreth tekstit.</li> </ul> <p><b>Tekste letrare</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson gjuhën dhe idetë që përcjell autori në tekst, analizon sjelljen dhe qëndrimet e personazheve, zhvillimin e fabulës ose subjektit;</li> <li>- bën dallimin mes personazhit, autorit dhe tregimitarit;</li> <li>- krahason stilin, gjuhën dhe tematikën në tekste të ndryshme.</li> </ul> <p><b>Tekste joletrare</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh, krahason dhe përmbledh informacionin nga tekste të ndryshme;</li> <li>- dallon informacionin e rëndësishëm nga i parëndësishmi, faktin nga opinioni, shkakun nga pasoja;</li> <li>- veçon tiparet karakteristike të fjalëve, fjalive dhe tekstit në tekste të ndryshme.</li> </ul> <p><b>Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;</li> <li>- përdor forma të efektshme të të shkruarit për qëllime dhe audienca të caktuara;</li> <li>- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idenë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.</li> </ul> <p><b>Përdorimi i drejtë i gjuhës</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore;</li> <li>- përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta;</li> <li>- përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshme dhe të pandryshueshme;</li> <li>- analizon stilet dhe regjistrat e gjuhës;</li> <li>- vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.</li> </ul> <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b></p> <p>Sugjerohet që gjatë orëve të mësimi do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: <i>stubi mendimesh, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraparakë, diskutim për njohuritë paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit, rrjeti i diskutimit, vijat e vlerës, të mbajturit e strukturuar të shënimeve, DDM etj.</i></p> <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.</p> <p>Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, testeve, pjesëmarrja në biseda e diskutime e leximet jashtë klase, diktimet etj.</p>
--

NR	Kompetencat	Temat mësimore	Situata e të nxënimit (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
121	L. Tekst letrar L 51	Së shpejti kompjuterat emocionalë	Robotët dhe jeta jonë	<i>Parashikim me anë të titullit, Diskutim, Pyetje-përgjigje</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor, foto
122	L. Tekst letrar L 52	Së shpejti kompjuterat emocionalë	Robotët dhe jeta jonë	<i>Diskutim, Të nxënimit në bashkëpunim, Vije e vlerës</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor
123	Dëgjimë D 7	Mbajtja e shënimeve	Po ti si mban shënime?	<i>Pyetja sjell pyetjen, Punë individuale, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për saktësi të shënimeve	Teksti mësimor, fisha, foto
124	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 46	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur shkakore, qëllimore	Ana shkoi me vonesë në shkollë	<i>Bisedë, tabela Insert, shkrim i lirë</i>	Vlerësim për përcaktimin e fjalive me pjesë në n/r qëllimore e shkakore	Teksti mësimor, foto nga Durrësi
125	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 47	Ushtrime. Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur shkakore, qëllimore	Tekste të ndryshme	<i>Diskutim, Punë në dyshe, Diagram Veni</i>	Vlerësim për formulimin e fjalive të nënrenditura	Teksti mësimor
126	L. Tekst jolettrar L 53	Një program për shkëmbim nxënësish	Pse na pëlqen të studiojmë jashtë shtetit? Ose Në shkollën binjake	<i>Bashkëbisedim, Lexim zinxhir/diskutim, Pemë mendimi</i>	Vlerësim për analizën e tipareve të gjuhës dhe stilit të autorit	Teksti mësimor
127	L. Tekst jolettrar L 54	Një program për shkëmbim nxënësish	Në shkollën binjake	<i>Bisedë, Të nxënimit në bashkëpunim/punë me fisha, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor
128	Të flasim F 6	Mbledhja e informacionit	Punë me tekstin	<i>Pyetja sjell pyetjen, Punë në dyshe, Punë individuale</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor
129	Të shkruajmë Sh 15	Si të shkruajmë një raport	Punë me tekstin	<b><i>Diskutim, Tabela Insert, Shkrim i lirë</i></b>	Vlerësim individual	Teksti mësimor
130	Të shkruajmë Sh 16	Si të shkruajmë një raport	Punë me tekstin	<i>Punë e pavarur me shkrim – Diskutim</i>	Vlerësim për shkrimin e një raporti	Teksti mësimor, fisha
131	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 48	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur mënyrore,	Në supermarketin e ri	<i>Tabela e koncepteve, Bashkëbisedim, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për dallimin e fjalive me pjesë të n/r mënyrore e krahasore	Video projektor
132	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 49	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur rrjedhimore	Punë me tekstin	<i>Tabela e koncepteve, Bashkëbisedim, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për përcaktimin e pjesëve të fjalive me nënrenditje	Teksti mësimor, fisha
133	L. Tekst jolettrar L 55	Dhjetë rregulla për të ngrënë më mirë	Si të ushqehemi shëndetshëm	<i>Lexim i drejtuar, Kllaster</i>	Vlerësim për lexim të rrjedhshëm	Teksti mësimor

NR	Kompetencat	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
134	L. Tekst jolettrar L 56	Dhjetë rregulla për të ngrënë më mirë	Si të ushqehemi shëndetshëm	<i>Punë individuale, Punë në grup</i>	Vlerësim për zbulimin e mesazhit	Teksti mësimor
135	Të shkruajmë Sh 17	Shkruajmë një fletëpalosje	Punë me tekstin	<i>Bisedë, Pyetja sjell pyetjen, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për shkrimin e një fletëpalosjeje	Teksti mësimor, fisha
136	Të shkruajmë Sh 18	Shkruajmë një fletëpalosje	Punë me tekstin	<i>Bisedë, Punë e drejtuar me fisha</i>	Vlerësim për shkrimin e një fletëpalosjeje	Teksti mësimor
137	Nj. Gj. Gj 50	Ushtrime për fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje	Punë me tekstin	<i>Stuhi mendimesh, Parashikim me terma paraprakë, Pyetje-përgjigje</i>	Vlerësim për dallimin e fjalive me bashkërenditje dhe nënrenditje	Teksti mësimor
138	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 51	Konkurs për njohuritë gjuhësorë në klasën e tetë	Gara	<i>Diskutim, Analizë e tipareve semantike</i>	Vlerësim për njohuritë e marra	Teksti mësimor
139	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 52	Diktim 1		<i>Stuhi mendimesh, Kllaster, Bashkëbisedim</i>	Vlerësim për punën e pavarur	Teksti mësimor
140	L. Tekst letrar L 57	Projekt “Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj të moshuarve” (ora 1)	Ndarja e punëve	<i>Diskutim, bashkëbisedim, Të nxënës në bashkëpunim</i>	Vlerësim për punën në grup	Vizitë
141	L. Tekst letrar L 58	Projekt “Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj të moshuarve” (ora 2)	Vizita në terren	<i>Diskutim, Bashkëbisedim, Të nxënës në bashkëpunim</i>	Vlerësim për argumentet që sjell gjatë projektit.	Vizita në shtëpinë e të moshuarve
142	L. Tekst letrar L 59	Projekt “Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj të moshuarve” (ora 3)	Prezantim projekti	<i>Diskutim, Bashkëbisedim, Të nxënës në bashkëpunim</i>	Vlerësim për gjykimin e tij në lidhje me debatin	Kompjuteri
143	L. Tekst letrar L 60	Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut	Diskutojmë Sulltan Mehmeti II: “Kurrë s’ka për të dalë më mbi tokë një luan i tillë si Skënderbeu”.	<i>Bashkëbisedim, Lexim me kodim i tekstit, Diskutim</i>	Vlerësohen nxënësit për diskutimin që i bëjnë figurës së Skënderbeut, mesazhit që zbulon në fjalimin e tij.	Teksti mësimor
144	L. Tekst letrar L 61	Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut	Punë me tekstin	<i>Rruajtja e fundit për mua, Diskutim mbi njohuritë paraprake</i>	Vlerësim për analizën e figurave letrare	Teksti mësimor

NR	Kompetencat	Temat mësimore	Situata e të nxënës (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
145	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 53	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur kushtore, lejore	Ti ke një ëndërr në sirtar.	<i>Diskutim për njohuritë paraprake, Tabela Insert, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për punën e pavarur	Interneti, burime të ndryshme
146	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 54	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur kushtore, lejore	Ti ke një ëndërr në sirtar.	<i>Tabela e konceptit, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim për punën në grup	Teksti mësimor
147	Të folurit F 7	Prezantimi me gojë	Nxënësit prezantohen para klasës.	<i>Bisedë, punë e drejtuar, Diskutim-vlerësim</i>	Vlerësim për zbatimin e rregullave gjatë të folurit	Teksti mësimor, foto
148	L. Tekst letrar L 62	Gjiri i Meksikës	Ushqimet pikante të Meksikës	<i>Imagjinatë e drejtuar, Punë e orientuar, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për mesazhin dhe analizën e fragmentit	Teksti mësimor
149	L. Tekst letrar L 63	Gjiri i Meksikës	Plazhet e Meksikës-Kankun	<i>Diskutim, Tabela M, Të nxënës në bashkëpunim dhe punë me fsha</i>	Vlerësim për mesazhin dhe analizën e fragmentit	Teksti mësimor, Enciklopedi
150	L. Tekst letrar L 64	Letra e parë	Komento thëniet e Senekës	<i>Bisedë, Lexim zinxhir, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për shkrimin e një letre	Teksti mësimor, interneti
151	L. Tekst letrar L 65	Letra e parë	Punë me tekstin	<i>Bashkëbisedim, Bisedë, Punë në dyshe, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për krahasimin e mesazheve	Teksti mësimor, botime
152	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 55	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur krahasore, sasiore	Festat, krahasimi midis tyre	<i>Lojë në çift, Tabela e konceptit, Punë në dyshe</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor
153	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 56	Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur krahasore, sasiore USHTRIME	Punë me tekstin	<i>Diskutim, Tabela e konceptit, Punë e pavarur</i>	Vlerësim individual	Teksti mësimor, modele tekstesh
154	Të dëgjuarit D 8	Reklama	Reklama të ndryshme	<i>Bisedë, Punë në dyshe, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për shkrimin e një reklame	Teksti mësimor, fisha
155	Të shkruajmë Sh 19	Ese argumentuese (Ora 1)	A duhet mbajtur uniforma në shkollë.	<i>Imagjinatë e drejtuar, Lexim zinxhir, Punë individuale</i>	Vlerësim nxënësit për bashkëpunimin në dhënien e ideve, për argumentet e qarta qofshin pro a kundër etj.	Si të shkruajmë ese
156	Të shkruajmë Sh 20	Ese argumentuese (Ora 2)	Sot nuk dua të ha drekë!	<i>Diskutim, të nxënës në bashkëpunim, Reflektol/ Reflektol/ Reflektol.</i>	Vlerësim nxënësit për mënyrën e përdorimit të argumenteve në një ese argumentuese, bashkëpunimin e tyre etj.	Teksti mësimor

NR	Kompetencat	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
157	L. Tekst letrar L 66	Portreti i Lasgush Poradecit (Ora 1)	Përkrahja një prej pjesëtarëve të familjes.	<i>Bisedë, Lexim zinxhir e punë me fisha, Shkrim i shpejtë</i>	Vlerësim për përshkrimin e bërë shokut, shoqes, një nga pjesëtarëve të familjes etj.	Teksti mësimor Interneti
158	L. Tekst letrar L 67	Portreti i Lasgush Poradecit (Ora 2)	Vargje nga Poradeci	<i>Shkrimi i shpejtë, Pauza treminutëshe e të nxënësve në bashkëpunim, Shkrim i lirë, Punë individuale</i>	Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë orës së mësimi.	Teksti mësimor Interneti
159	L. Tekst letrar L 68	Mjeshtri i kukullave (ora 1)	“Kukullat Kokeshamister dhe bukuri”	<i>Parashikim me anë të titullit, VLMD, Punë në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për të dëgjuarit kritik, për të kuptuarit e tekstit etj.	Teksti mësimor, fisha
160	L. Tekst letrar L 69	Mjeshtri i kukullave (ora 2)	Punë me tekstin	<i>Hartë personazhi, Të nxënësve në bashkëpunim-Grupet e ekspertëve, Rrjet diskutimi</i>	Vlerësim për mesazhet që përcjell pjesa, për aktivizimin gjatë mësimi etj.	Teksti mësimor
161	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 57	Fjalitë e varura përcaktore	Punë me tekstin	<i>DDM, Punë në dyshe</i>	Vlerësim për dallimin e fjalive përcaktore	Teksti mësimor
162	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 58	Fjalitë e varura përcaktore (Ora 2) Ushtrime	Punë me tekstin	<i>Diskutim, Punë në dyshe, Pauza treminutëshe</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin saktë të mjeteve lidhëse në fjalitë me pjesë të n/r përcaktore etj.	Teksti mësimor
163	Të shkruajmë Sh 21	Ese përshkuese (Ora 1)	Përkrahja vendlindjen tënde.	<i>Imaginatë e drejtuar, mbajtja e strukturuar e shënimeve, Rishikim në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi.	Teksti mësimor, fisha
164	Të shkruajmë Sh 22	Ese përshkuese (Ora 2)	Përkrahja aromën e parfumit tënd të preferuar.	<i>Diskutim, Të nxënësve në bashkëpunim-Punë në grupe, Rishikim në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit në shkrimin e esesë.	Teksti mësimor
165	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 59	Ligjërata e drejtë	Figura të shquara të kinematografisë.	<i>Diskutim për njohuritë paraprake, Tabela e konceptit, Punë në dyshe</i>	Vlerësohen nxënësit për përdorimin e ligjëratës së drejtë në komunikim, për dallimin e pjesës lajmëuese dhe pjesës përmendëse etj.	
166	Nj. Gj. (sintaksë)	Ligjërata e zhdrejtë	Teknologjia në jetën time	<i>Diskutim i njohurive të mëparshme, Ditar dypjesësh, Praktikë e udhëhequr</i>	Vlerësim për angazhimin gjatë orës së mësimi	

NR	Kompetencat	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
167	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 60	Test për tremujorin e tretë	Punë me tekstin	<i>Punë individuale</i>		Teksti mësimor, fisha
168	Nj. Gj. (Sintaksë) Gj 61	Diktim	Kthe një ligjëratë të drejtë në të zhdrejtë.	<i>Punë individuale</i>	Vlerësohen nxënësit për kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas.	Internet
169	Tekst letrar L 70	Bisedë letrare	Libër	<i>Stubi mendimesh, bashkëbisedim</i>	Vlerësim për punën e kryer	Teksti mësimor
170	Të shkruajmë Sh 23	Shkruaj një ese argumentuese	Punë me një tekst argumentues	<i>Bashkëbisedim, Punë në dyshe, Reflektio/Reflektio/Reflektio</i>	Vlerësim për ndërtimin e esës argumentuese	Teksti mësimor, fisha
171	Të shkruajmë Sh 24	Vlerësime rreth një teme të shkruar	Teknologjia në jetën time. Punë me tekstin	<i>Bisedë, Lojë në çift, Pauza treminutëshe</i>	Vlerësohen nxënësit për respektimin e udhëzimeve për vlerësim dhe vetëvlerësim të një teme.	Teksti mësimor interneti
172	Nj. Gj. Gj 63	Ushtrime para testit		<i>Pyetje-përgjigje, Dëgjim i drejtuar</i>	Vlerësim për punën e pavarur	Teksti mësimor interneti
173	Nj. Gj. Gj 64	Panairi i portofolit			Vlerësim për arrijtet e njohurive të këtij tremujori	
174	Nj. Gj. Gj 65	Test përfundimtar vjetor		<i>Pyetje-përgjigje, Dëgjim i drejtuar</i>	Vlerësim i dosjes	
175	Të shkruajmë Sh 25	Korrigjimi i punëve me shkrim	Punët me shkrim të nxënësve	<i>Vëzhgim i punëve me shkrim, punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim</i>	Vlerësim i punës me shkrim	Punimet e nxënësve

# TREMUJORI I PARË


## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Të dëgjuarit <b>Tema mësimore:</b> Gjuha shqipe përmes vargjeve		<b>Situata e të nxënës:</b> Në një vend të huaj <i>Imagjinoni për një moment sikur jetoni në një vend të huaj.          Dikush nga shokët ju ndalon rreptësisht që të mos flisni sikur dhe një fjalë të vetme të gjuhës shqipe. Si do të vepronit në këtë moment?          Përshkruaj ndjesinë që përjetove.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- dëgjon për të nxjerrë informacionin kryesor nga ajo që dëgjon;</li> <li>- nxjerr informacionin kryesor nga materiali në DVD;</li> <li>- përgjigjet për pyetje rreth të kuptuarit të tekstit të dëgjuar.</li> </ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Gjuhë shqipe E dashur E ëmbël Simbol i kombit Themel diturie	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> gjuhë shqipe, histori, informatikë	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Stuhi mendimi, Të nxënës në bashkëpunim, Vija e vlerës

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënës:** Stuhi mendimi

Plotëso organizuesin grafik.



Nxënësit shtojnë dhe cilësi e karakteristika të tjera të gjuhës shqipe. Ata vlerësojnë njëri-tjetrin në përgjigjet e dhëna.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënës në bashkëpunim

Mësuesi/ja me ndihmën e videoprojektorit, u prezanton nxënësve poezitë, përmes zërit të shokut/shoqes suaj ose përmes regjistrimeve audio të tyre. Në rast se nuk ka në shkollë videoprojektor, poezitë do të lexohen nga mësuesi/ja.

Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e asaj që dëgjuan.

**Çfarë i bashkon titujt e këtyre poezive?**

- Gjuha shqipe

**Po autorët e tyre?**

- Dashuria për gjuhën shqipe

**Ç'emotion ju ngjall pasthirrma e përdorur nga Lasgush Poradeci te poezia “Gjuhë e zjarrtë”?** Emocion drithërues, pasi gjuha shqipe është e shenjtëruar, qiellore, hyjnore, jo e zakonshme.

Pasthirrat plotësojnë njëra-tjetrën për të dhënë idenë e zjarrit, djegies, ndriçimit, sakrificës, mundimit, pastrimit (purifikimit) si cilësi të gjuhës së zjarrtë. *Është vetëtim e qiellit dhe djellë i llaftarisur.*

**Gjuhë e zjarrtë Lasgush Poradeci**

O gjuhë – e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot

O vetëtim’ e qiellit që fërfëllon me flakë

**Si e jep Fishta bukurinë e gjuhës përmes krahasimit?**

Gj. Fishta e jep bukurinë e gjuhës shqipe të shkrirë me madhështinë e bukurinë e mëmës natyrë. Një gjuhë me një leksik të pasur, e mbushur plot fjalë të urta, urime e mallkime, duke bërë qasje me bukuritë e panumërta të natyrës shqiptare.

Gjuha shqype Gjergj Fishta

Porsi kanga e zogut t’verës,

Qi vallzon n’blerim të prillit

Porsi i ambli fllad i erës

Qi lmon gjit e drandofillit

Kjo gjuhë është e bukur dhe e ëmbël si *kanga e zogut t’verës*.

E lehtë si flladi i erës.

Ledhatuese si vala që ledhaton bregun.

Madhështore si gjama e rrfesë shqjetare

Gjuhës shqipe Mitrush Kuteli

Të falem ty, o gjuhë – hoj,

Ty, zëth i nënës – qetësi,

Ty, këngë e foshnjës – kaltërsi,


Ty, afshi zemrës – dashuri

Gjithmonë e ëmbël, mjaltë zgjoi

**Po Kuteli përmes metaforës?**

Ndjesitë e poetit për gjuhën e nënës jepen nëpërmjet harmonizimit të metaforave. Për të, gjuha shqipe është qetësuese si zëri i nënës, si kënga e foshnjës, e ëmbël si mjalti i zgjojeve dhe drithëruese si rrahjet e dashurisë.

**Ç'emotione burojnë nga ndjenja e  
madhështisë së gjuhës të Mjeda?**




Dashuria për gjuhën shqipe e mbush me krenari poetin. Ai e veçon atë nga gjuhët e tjera, pasi pushtimet e shumta nuk arritën t'i humbnin ëmbëlsinë dhe bukurinë kësaj gjuhe. Ajo tingëllon në veshët e poetit me ëmbëlsinë, muzikalitetin e këngës së bilbilit.

**Ç'kuptoni me përlujtje para gjuhës? Pse konsiderohet e shenjtë ajo?**


Nxënësit japin mendime të ndryshme për këtë pyetje.

**A kanë vlerë aktuale këshillat e Naimit për gjuhën?**



Naimi e sheh perëndinë kudo, panteizmi i tij duket qartë, ndaj ai identifikon gjuhën shqipe me perëndinë. Jo vetëm vargjet e Naimit, por të gjithë poetëve që dëgjuam janë aktuale për kohën që jetojmë, pasi largimi i shumë shqiptarëve në emigracion, jetesa larg vendit të dashur vë në pikëpyetje ekzistencën e gjuhës së mëmës. Nxënësit dhe mësuesi/ja diskutojnë më pas rreth kësaj çështjeje.

**Çfarë ju sjellin ndër mend vargjet e Kadaresë për gjuhën tonë?**



Sjellim ndërmend pushtimet e huaja (sidomos pushtimin shumëshekullor të otomanëve), që bashkë me zgjedhën u përpoqën “t’i hidhnin prangat gjuhës sonë, pra të asimilonin gjuhën shqipe dhe si rrjedhim të asimilonin popullin shqiptar”, ta bënin Shqipërinë memece, por nuk ia dolën dot. Kadare në mënyrë të vazhdueshme jep porosi për të ruajtur ta pastër gjuhën shqipe, si vlerë themeltare e shqiptarëve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Të nxënit në bashkëpunim

**Mësuesilja ndan klasën në grupe dhe secilit grup i lexon kërkesën:**

**Dëgjoni vlerësimet rreth vargjeve të shkruara për gjuhën dhe tregoni nëse jeni dakord. Pse?**

Vargjet kushtuar gjuhës janë me patos të veçantë, sidomos kur dëgjohen si një tërësi.

Tematika e tyre është gjithëpërfshirëse dhe krijon atmosferë gëzimi.

Mesazhi i tyre ndikon pozitivisht te dëgjuesit, duke zgjuar ndjenja, të tilla si: krenaria, patriotizmi, dashuria etj.

Vargjet për gjuhën tërheqin vëmendjen nëpërmjet figurave letrare, si: pasthirrmat, metaforat, enumeracionet, epitetet dhe krahasimet.

Nxënësit japin përgjigjet e tyre.

Mësuesi/ja mund të punojë dhe me teknikën “Vija e vlerës”.

Ngre nxënësit para klasës, i ndan në dy grupe.

Një nga vlerësimet e dhëna rreth gjuhës shqipe ngre një pyetje binare:

**A mendoni se** vargjet për gjuhën tërheqin vëmendjen nëpërmjet figurave letrare,

si: pasthirrmat, metaforat, enumeracionet, epitetet dhe krahasimet?

Po

Argumento dhe ilustro mbi shembujt e dhënë.

JO

**Nxënësit mësojnë, duke u argëtuar dhe argumentuar.**

**Në fund të orës pyeten nga mësuesilja: A u pëlqeu ora e mësimit?**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përgjigjet e pyetjeve rreth të kuptuarit të tekstit të dëgjuar, për nxjerrjen e informacionit gjatë të dëgjuarit kritik, për argumentet e dhëna për thëniet që janë shkruar për gjuhën shqipe etj.

**Detyrë shtëpie:** Mësoni përmendësh një poezi të një prej autorëve të dhënë dhe recitoheni bukur në klasë.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të folurit</b> <b>Tema mësimore: Flasim për vargjet kushtuar gjuhës shqipe</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Shumë kanë folur dhe kanë shkruar vargje për gjuhën shqipe. Dëgjoni thëniet e mëposhtme dhe thoni si i kuptoni ato. “Themelin e diturisë dhe të atdhetarisë e përbën gjuha shqipe” - Mit’hat Frasheri “Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij” - Eqerem Çabej “Gjuha shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe i përparimit” - Holger Pedersen “Gjuha ruhet, atje ku shkruhet” - Populli	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- liston poetët, të cilët kanë shkruar vargje për gjuhën shqipe;</li><li>- argumenton mendimet e tij për forcën e vargjeve dhe thëniet të shkruara për gjuhën;</li><li>- interpreton poezi për gjuhën shqipe.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Gjuhë shqipe E dashur E ëmbël Simbol i kombit Themel diturie	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Ditari dypjesësh, Të nxënësve në bashkëpunim, Ndërrimi i vendeve. <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Nxënësve u është dhënë për detyrë shtëpie të mësojnë përmendësh një nga poezitë e shkruara për gjuhën shqipe. U tërhiqet vëmendja që të kenë kujdes për intonacionin,qartësinë dhe rrjedhshmërinë e vargjeve të poezisë. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Ditari dypjesësh Nxënësit udhëzohen të punojnë me ditarin dypjesësh, duke plotësuar tabelën.			

Fragmenti	Reflektim
<p>Geg' e tosk', mGeg' e tosk', malsi, jallia jan' një komb, m'u da, s'duron; fund e maj' një a Shqipnia e një gjuh' t'gjith' na bashkon. N. Mjeda</p> <p>Se njerëzit të gjithë vdesin Po jeta s' mbetet e shkretë Gjuha, mëmëdheu mbesin Të patundurë përjetë N. Frashëri</p> <p>Pra, shqypetarë çdo fës qi t'jini, gegë e toskë, malci e qyteta, gjuhën t'uej kurr mos ta lini, mos ta lini sa t'jetë jeta, por për të gjithmonë punoni; Gj. Fishta</p>	

**Gjej në poezitë e dhëna për reflektim vargjet që shprehin të njëjtin mesazh.**

Vargjet e Mjedës dhe Fishtës përcjellin të njëjtin mesazh.

**Të nxënit në bashkëpunim:** Ndërrimi i vendeve

Mësuesi/ja përdor metodën "Ndërrimi i vendeve" dhe ndan klasën grupe, shpërndan fisha për diskutim të çështjeve:

**Grupi 1:** Poezitë kushtuar vlerave kombëtare kanë një ndikim të madh të lexuesit e çdo kohe. Si kanë ndikuar këto poezi dikur dhe si ndikojnë sot ato?

**Grupi 2:** Pse shkrimtarët shqiptarë i kanë kënduar kaq shumë gjuhës shqipe?

**Grupi 3:** Si ndikojnë figurat e dukshme letrare në përcjelljen e mesazheve që transmetojnë këto poezi?

**Grupi 4:** Listo autorët që kanë shkruar vargje për gjuhën shqipe në dialekt.

Argumento mendimin tënd pse është përdorur gjuha dialektore.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** E vërtetële gabuar

**Kur diskutoni për poezi të kësaj natyre sillni ndërmend:**

- a) kuptimet e drejtpërdrejta të vargjeve; V/G
- b) atmosferën që shoqëron diskutimin; V/G
- c) autorin dhe vargje e poezi të tjera nga ai; V/G
- d) që duhet të shprehni pëlqimin tuaj, përjetimin tuaj, mbresën tuaj. V/G

Mendimi, që të jetë i vërtetë, duhet të argumentohet.

**Pyeten nga mësuesi/ja në fund të orës:**

**A u pëlqeu ora e mësimit? A i realizoi ajo pritshmëritë tuaja në drejtim të rezultateve të të nxënit?**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përgjigjet e pyetjeve rreth diskutimeve dhe argumenteve të sjella nga ata, për vjetërsinë e gjuhës shqipe dhe bukurinë e saj.

**Detyrë shtëpie:** Diskuto me prindërit dhe gjyshërit për rëndësinë e gjuhës shqipe, vargjet dhe thëniet e shkruara për të. A mësove më shumë se ato që dije? Pse?

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Kush e solli Doruntinën (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Besa e shqiptarëve në vargjet e Bajronit Të rreptë bijt' e Shqipes! Po vetitë Nuk u mungojnë; veç t'ishin më t'arrira; Armiku ua pa kurrizin ndonjë herë? Kush e duron si ata mundimn' e luftës? Shkëmbinjt' e tyre s'janë më të patundur Nga ata në çast rreziku dhe nevojë: Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë! Kur besa a nderi i thrrer të derdhin gjakun, Si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre	

<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare	
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- lexon për të identifikuar llojin e baladës në letërsinë gojore;</li> <li>- shpreh ndjenjat dhe përjetimet e tij rreth baladës;</li> <li>- analizon tiparet dalluese të personazheve që veprojnë në të;</li> <li>- gjen figuracionin e përdorur në baladë dhe tregon funksionin e tyre.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Baladë Gjëmë Besë Ringjallje
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, “Balada popullore shqiptare” etj.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, Të nxënës në bashkëpunim, Punë në dyshe, Shkrim i lirë	
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Stuhi mendimi Keni mësuar rreth krijimeve folklorike të popullit tonë. Gjithashtu keni mësuar dhe për veçoritë dhe karakteristikat e baladave. Nxënësit ngrihen në tabelë dhe plotësojnë organizuesin grafik.	
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënës në bashkëpunim Prezantohen nxënësit me temën e re të mësimit: “Kënga e Dhoqinës”. Në sfond vendoset balada e recituar ose orientohen nxënësit për leximin e pjesës, duke pasur parasysh intonacionin me të cilin do të lexohet, respektimin e shenjave të pikësimi dhe pauzat. Pas leximit apo dëgjimit të baladës, këto veprimtari janë të kushtëzuara nga sasia e mjeteve teknologjike që ka shkolla, mësuesi/ja punon me fjalët e reja që janë shpjeguar dhe në tekst. Shpjegimi i fjalëve është i rëndësishëm dhe për të treguar karakterin arkaik të tyre. Mësuesi/ja shkruan në tabelë sinonimet e këtyre fjalëve dhe nxënësit ndërtojnë fjali me to. <b>“Kuptojmë tekstin”</b> rubrika që do të diskutohet me nxënësit. Ata u japin përgjigje pyetjeve: <b>1) Cila është dita e shënuar dhe çfarë ndodh në këtë ditë? - Kur?</b> Dita e Pashkës, <b>në drekë</b> , pas tre vjetësh. <b>Çfarë ndodhi?</b> Një stuhi, pra një qenie mitologjike në formën e gjarprit që helmon kusinë me mish, e cila ishte vendosur për të festuar në këtë ditë feste. Mishi helmon pjesëtarët e familjes.	

2) **Ku duken shenjat e gjëmës?** Shenjat e gjëmës- 9 djem, 9 nuse, të nënta me djepe në duar.

3) **Jepni detajet që tregojnë se nëna nuk arrin ta besojë ardhjen e Doruntinës.** Detajet -\*pyetjet e njëpasnjëshme që i bën Dhoqinës:

*Me cin erdhe moj Dhoqinë?*

*Ç' Kostandini moj të ardhët gjëma?*

4) **Çfarë tregojnë pyetjet që bën nëna kur dëgjon trokitjen në derë?**

Nëna nuk mund ta besojë që Konstandini është ngritur nga varri për të mbajtur fjalën që i ka dhënë asaj, megjithëse e di që besa për shqiptarët është e shenjtë, por dhimbja ia mbyty arsyetimin.

5) **Çfarë tregon nxitimi i vëllait?** Padurimin për dërgimin sa më parë të Doruntinës te nëna dhe mbajtja e fjalës së dhënë.

6) **Nga buron gëzimi i Doruntinës?** Gëzimi i saj buron nga dashuria për të takuar familjarët e saj dhe rikthimit në gjirin e familjes.

**Të nxënit në bashkëpunim:** Punë në dyshe

7) Në tabelën e mëposhtme shkruani nga një tipar të personazheve të baladës sonë.

Personazhi	Nëna	Dhoqina	Kostandini
Tipari më dallues për secilin prej tyre.	<i>E fortë dhe pas humbjes së djemve, nuseve, nipërve të saj</i>	<i>Sakrifikuese – nuk nguron që të lerë festën dhe të udhëtojë tri male kaptuar, në mes të natës për të takuar familjarët e saj.</i>	<i>Besëmbajtës – thyen rregullat njerëzore, rrasa iu bë kalë.</i>

8) **Ç' lloj marrëdhëniesh familjare shtjellon kënga?** Marrëdhënie që ngrihen mbi bazën e respektit dhe vlerave morale të familjes. Kostandini respekton nënën, motrën dhe fjalën që u ka dhënë atyre.

9) **Për cilin virtut të lashtë të popullit shqiptar bën fjalë balada?** Virtyti i besës që shkonte deri në kufijtë e hyjnore. Besa si institucion.

10) **Gjeni disa krahasime në këngë dhe thoni rolin e tyre.**

*Të vishem si gjeraqinë.*

*Të vishem si kallogre.*

*Plasën si qelqe me verë.*

11) Plotësoni tabelën:

Momentet kryesore të subjektit të baladës	<i>Gjëma e shuarjes së gati një familjeje</i>	<i>Ringjallja e Kostandinit</i>	<i>Takimi tragjik i nënës me Dhoqinën</i>
---	---	---------------------------------	---


**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

**Shkrim i lirë:** Ç' përshtypje ju lë fundi i baladës? Mund të ketë një fund tjetër balada? Provoni ta shkruani ju. Nxënësit punojnë individualisht për të gjetur një fund tjetër për baladën. Punët e tyre i prezantojnë duke i shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe duke i vlerësuar ato.

**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për: përgjigjet e dhëna, për pyetjet e bëra rreth pjesës, diskutimit rreth personazheve kryesore, mbylljes tjetër për baladën etj.

**Detyrë shtëpie:** Bëj një vizatim për mbylljen e baladës kur nëna dhe Dhoqina vdesin në krahët e njëra-tjetrës.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> <b>Tipare të gjuhës së folur dhe të shkruar</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>    Çfarë ju sjellin ndër mend fjalët: piktogram papyrus, pergamenë, alfabet? Shikoni figurat dhe diskutoni.	

	<p><i>Piktografi:</i> Lloji më i vjetër i shkrimit që bëhej me vizatime të ndryshme.</p> <p><i>Pergamenë:</i> Lëkurë kafshësh (dhie, qengji, keci) që përpunohej dhe përdorej për të shkruar në të, kjo para se të shpikëj letra.</p> <p><i>Papirus:</i> Lloj kallami që rritet në vendet e nxehta, me gjethe të holla që dalin pranë rrënjës dhe me kërcell të gjatë trekëndësh, prej të cilit në lashtësi bënin letër dhe sende të tjera.</p> <p><b>2/fletë</b> e hollë e prerë nga kërcëjtë e kësaj bime dhe e përpunuar që përdorej nga egjiptianët dhe popujt e tjerë të lashtë si letër për të shkruar.</p> <p><i>Alfabet:</i> Tërësia e shkronjave të një gjuhe, të radhitura sipas një rendi të caktuar.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</li><li>- Kompetenca e të menduarit</li><li>- Kompetenca personale</li><li>- Kompetenca personale</li></ul>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon dokumentet e para të gjuhës së shkruar;</li><li>- përcakton llojin e gjuhës së përdorur në situata të ndryshme komunikimi;</li><li>- identifikon lehtësisht situatat në të cilat duhet të përdoret gjuha e shkruar;</li><li>- analizon dallimet midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar;</li><li>- argumenton avantazhet dhe disavantazhet e rrëfimit me gojë dhe me të shkruar.</li></ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Komunikim</p> <p>Gjuhë e folur</p> <p>Gjuhë e shkruar</p> <p>Papirus, piktograme, pergamenë, alfabet</p> <p>Situatë komunikimi</p> <p>Fushë veprimi</p> <p>Kanal komunikimi</p>	
<p><b>Burimet:</b> Teksti mësimor, tekste të ndryshme poetike dhe tregimtare etj.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p>histori</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> DDM, Të nxënit në bashkëpunim, Punë në dyshe, Shkrim i lirë.</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Di, dua të di, mësova.</p> <p>Nxënësit do të udhëzohen të punojnë me metodën <i>Di, Dua të di, Mësova</i> (DDM)</p>		
<p><b>DI</b></p> <p>Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë dy mënyra që përdoren për të komunikuar.</p> <p>Te gjuha e folur dhënësi dhe marrësi janë njëkohësisht pranë njeri-tjetrit, ndërsa te gjuha e shkruar dhënësi dhe marrësi kanë distancë mes tyre.</p> <p>Te gjuha e folur përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja, ndërsa te gjuha e shkruar përdoren shenjat e pikësimit.</p> <p>Te gjuha e folur përdoret gjuha standarde dhe dialektet, ndërsa te gjuha e shkruar përdoret vetëm gjuha standarde.</p>	<p><b>DUA TË DI</b></p>	<p><b>MËSOVA</b></p>
<p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> DDM, Të nxënit në bashkëpunim-punë në dyshe, Shkrim i lirë</p> <p>Udhëzohen nxënësit që të bëjnë pyetje rreth njohurive që duan të dinë për dallimin midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar.</p>		

<i>DI</i>	<i>DUA TË DI</i>	<i>MËSOVA</i>
Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë dy mënyra që përdoren për të komunikuar.	Cilat janë dallimet midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar?	
Te gjuha e folur dhënësi dhe marrësi janë njëkohësisht pranë njëri-tjetrit, ndërsa te gjuha e shkruar dhënësi dhe marrësi kanë distancë mes tyre.	A përdorin ato shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi?	
Te gjuha e folur përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja, ndërsa te gjuha e shkruar përdoren shenjat e pikësimit.	A ka fusha të ndryshme veprimi gjuha e folur në dallim me gjuhën e shkruar?	
Te gjuha e folur përdoret gjuha standarde dhe dialektet, ndërsa te gjuha e shkruar përdoret vetëm gjuha standarde.	A përdoren në situata të ndryshme komunikimi?	

***Të nxënit në bashkëpunim – punë në dyshe***

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë në dyshe për t'u dhënë përgjigje, pyetjeve të ngritura pre tyre. U lihet nxënësve 7 minuta në dispozicion dhe më pas ngrihen në tabelë për të plotësuar tabelën DDM, rubrikën mësova.

<i>DI</i>	<i>DUA TË DI</i>	<i>MËSOVA</i>
Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë dy mënyra që përdoren për të komunikuar.	Cilat janë dallimet midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar?	<i>Dallimet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar janë këto:</i> 1) Përdorin shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi. 2) Kanë fusha të ndryshme veprimi. 3) Kanë dallime në nivelin shprehës. 4) Përdorin shenja të ndryshme.
Te gjuha e folur, dhënësi dhe marrësi janë njëkohësisht pranë njëri-tjetrit, ndërsa te gjuha e shkruar dhënësi dhe marrësi kanë distancë mes tyre.	A përdorin ato shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi?	Po përdorin shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi. Gjuha e folur përdor shenja verbale të zëshme dhe në të përdoret kanali dëgjimor, ndërsa gjuha e shkruar përdor shenja verbale pamore dhe si mbështetje përdor kanalin e të parit. Jepen dallime të tjera.
Te gjuha e folur përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja, ndërsa te gjuha e shkruar përdoren shenjat e pikësimit.	A ka fusha të ndryshme veprimi gjuha e folur në dallim me gjuhën e shkruar?	Gjuha e folur përdoret në të gjitha raportet komunikuese dhe në të gjitha mjediset: familje, shkollë, institucione, rrugë etj. Ajo shpreh të gjitha nevojat jetësore dhe emocionale, ndërsa gjuha e shkruar përmban mesazhe të ndryshme instruksione, rregulla, ligje, ndjenja etj.
Te gjuha e folur përdoret gjuha standarde dhe dialektet, ndërsa te gjuha e shkruar përdoret vetëm gjuha standarde.	A përdoren në situata të ndryshme komunikimi?	Te gjuha e folur dhënësi e korrigjon apo e përmirëson deklaratën e tij në kohë reale, ndërsa gjatë përdorimit të gjuhës së shkruar, dhënësi thotë gjithçka që mendon për çështjen. As nuk heq, as nuk shton gjë.

Këto pyetje të përdoruara janë vetëm sugjeruese, pasi nxënësit mund të bëjnë pyetje rreth asaj që duan të mësojnë për temën në fjalë.

***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Të nxënit në bashkëpunim – Punë në dyshe.***

Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe për ushtrimet e dhëna në tekst.

**Ushtrimi 1 fq. 163.** Përcaktoni llojin e gjuhës që përdoret në situatat e komunikimit të përshkruara më poshtë.

Situata	F	SH
Gjatë një marshimi në mal, thërrisni për ndihmë dikë që është shumë larg jush.	+	
Gjatë një marshimi në mal, thërrisni për ndihmë një shok që është disa hapa para jush.	+	
Doni të takoni në Romë një shokun tuaj që banon prej 22 vitesh atje, por nuk arrimi të lidheni në celular, sepse celulari juaj nuk hyn në linjë.		+
Justifikoni mungesat në shkollë.		+
Bëni kërkesë për t'u abonuar në një revistë.		+
Lë një takim me shopen ose shokun tënd.(mund të lësh takimin me mesazh ose me bisedë telefonike).	+	+
Pyesni se cilën rrugë duhet të ndiqni për të shkuar në destinacion.	+	

**Ushtrimi 2.**

Shënoni me + te F, ato karakteristika që i përkasin gjuhës së folur dhe te Sh, ato karakteristika që i përkasin gjuhës së shkruar.	F	Sh
Përdor shenja verbale të zëshme.	+	
Dhënësi mund ta rishikojë dhe ta korrigjojë mesazhin.	+	
Marrësi mund të jetë larg në kohë dhe në hapësirë.		+
Përdoret një leksik i pasur dhe i përshtatshëm për llojin e tekstit të shkruar.		+
Përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja.	+	
Përdoren grafikët, diagramet, figurat dhe fotografitë për ilustrim.		+

**Shkrim i lirë: Ushtrimi 3 fq. 163.** Përcaktoni pesë situata, në të cilat duhet të përdoret gjuha e shkruar. Nxënësit punojnë të qetë dhe më pas përgjigjen për punët e tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësi për dallimin e karakteristikave të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar, për identifikimin lehtësisht të përdorimit të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar në situata të ndryshme etj.

**Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 fq. 163.** Vëreni figurat dhe ndërtoni tregimin. Tregojeni atë një herë me gojë dhe një herë me shkrim. Dalloni avantazhet dhe disavantazhet e çdo mënyre të treguar.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore-drejtshkrim <b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave		<b>Situata e të nxënit</b> Diskutoni rreth shenjave të pikësimit të thonjëzave, dy pikave e shenjave të tjera të pikësimit që dalloni në poezi. <b>Edukata</b> Dy macka qimebardha porsi shkumës, në pjatë hanin tok përshesh me qumësht. Dy qentë shikonin vëngër të mërzitur, dhe kuvendonin, veshët duke ngritur. Këto nuk paskan fare edukatë, e sheh si futin hundët në një pjatë? Ndërkohë u ra një kockë mu në këmbë, për kockën qentë u shqyen keq me dhëmbë. U ngrit një zhurmë e madhe e shamatë, dhe macet thanë: “Kjo është edukatë!”	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon shenjat e pikësimit në fund të fjalisë, brenda fjalisë, thonjëzat dhe vizat;</li> <li>- shpjegon përdorimin e dy pikësimit, pikëpresjes, kllapave dhe thonjëzave në tekstet e dhëna;</li> <li>- argumenton përdorimin e thonjëzave dhe shenjave të tjera të pikësimit në fjalitë e dhëna.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Shenja pikësimit Thonjëza Dy pikat Kllapat Pikëpresja</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti mësimor, fisha me tekste të ndryshme poetike dhe tregimtare, materiale të tjera nga burime të ndryshme</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stubi mendimi, INSERT, Punë në dyshe</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Stubi mendimi</p> <p>Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Diskutohen 3-4 minuta për ndonjë paqartësi që mund të ketë ndonjë nxënës. Paqartësitë mund të sqarohen nga nxënësit ose nga mësuesi/ja.</p> <p><b>Cilat janë shenjat e pikësimit që ju njihni?</b></p> <p>Ndërto një organizues grafik me njohuritë që ke marrë nga klasat e mëparshme.</p> <div data-bbox="159 873 1404 1411" data-label="Diagram"> <pre> graph TD     Pika[Pika (.)] --&gt; Center[Shenjat e pikësimit]     Presja[Presja (,)] --&gt; Center     Kllapat[Kllapat ()] --&gt; Center     Thonjezet[Thonjëzat (" ")] --&gt; Center     DyPikat[Dy pikat (:)] --&gt; Center     Pikëpresja[Pikëpresja (;)] --&gt; Center     </pre> </div> <p>Sqarohen nxënësit se tema e sotme e mësimit do të trajtojë përdorimin e drejtë të dy pikave, thonjëzave, kllapave dhe pikëpresjes në tekste të ndryshme.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> INSERT</p> <p>Udhëzohen nxënësit të punojnë me teknikën INSERT.</p> <p>Udhëzohen të hapin tekstet e të plotësojnë tabelën INSERT.</p>	

<i>Njoburitë që ka mësuar më parë</i>	<i>Njoburitë e reja që do të marri këtë mësim</i>	<i>Njoburitë që di, por që janë ndryshe nga ato të saktat</i>	<i>Njoburitë të cilat kanë nevojë për sqarimin e mësuesit</i>
<b>V</b> <b>Dy pikat</b> shënojnë grafikisht një pushim, që zgjat më pak se pika dhe më shumë se presja. <b>Thonjëzat</b> tregojnë që fjalët e përfshira në to nuk janë të një natyre me pjesën tjetër të tekstit, ose që fjalët brenda tyre nuk janë përdorur me kuptimin e tyre të zakonshëm. <b>Pikëpresja</b> shënon grafikisht një pushim më të gjatë se presja, por më të shkurtër se pika. <b>Kllapat</b> shënojnë një pushim të shkurtër, si presja dhe shërbejnë për të dalluar, për të shquar dhe për të veçuar fjalë apo fjali që shprehin një sqarim ose një mendim të ndërkallur.	<b>+</b> Përdoren para onomatopeve, kur vijnë pas fjalësh që i paralajmërojnë: Përdoren para një vargu gjymtyrësh homogjene.		

Plotësohet tabela, duke punuar individualisht nxënësit dhe më pas plotësohet nga të gjithë nxënësit në klasë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

\*Në këtë fazë të orës mësimore punohet me ushtrimet e dhëna në tekst:

**Ushtrimi 1, 2, 3 dhe 4 në faqen 166.**

Përgjigjet e ushtrimeve shoqërohen me argumente.

Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të shenjave të pikësimit në tekstet e dhëna.

**Detyrë shtëpie:** Formoni nga dy fjali për secilin rast, në të cilat të përdorni: dy pikat; pikëpresjen; thonjëzat; kllapat.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore:</b> <b>Kush e solli Doruntinën (ora II)</b>		<b>Situata e të nxënit</b> Fjalë të urta për besën. <i>Besa e shqiptarit si purtekë e arit.</i> <i>Besa më e fortë se vdekja.</i> <i>Besa e burrit,pesha e gurit.</i> <i>Shqiptari kur jep fjalën, ther djalën.</i> <i>Shqiptari kryet e then dhe besën s`e pren.</i> <i>Besa asht më e fortë se vdekja.</i> <i>Amanetin s`e tret dheu.</i> Diskutoni rreth tyre. Me njërën prej këtyre fjalëve të urta krijo një tregim të shkurtër.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - diskuton konceptin e besës si institucion;		<b>Fjalët kyçe:</b> Baladë Gjëmë	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- argumenton funksionin e figurave letrare;</li> <li>- gjen mesazhin që përcjellin vargjet e baladës;</li> <li>- kthen baladën në prozë, duke ruajtur karakteristikat e saj.</li> </ul>	Besë Ringjallje
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, “Balada popullore shqiptare”, burime të ndryshme	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukatë qytetare

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Diskutim, Pyetje-përgjigje, Rrjeti i diskutimit

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Diskutim

Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Mësuesi/ja aktivizon sa më shumë nxënës për të demonstruar punën e tyre dhe të argumentojnë arsyet që kanë çuar në realizimin e vizatimit në përputhje me mesazhin e pjesës.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Pyetje-përgjigje

Mësuesi/ja udhëzon nxënës të hapin tekstet te rubrika “Analizojmë tekstin”. Nxënësit diskutojnë në dyshe për t`u dhënë përgjigje pyetjeve.


**Pse nëna e lidh humbjen e djemve të saj me djepet?**

E lidh me djepet, se ato tregojnë vazhdimësinë e familjes, fisit. Gjëma është kaq e madhe sa çon në shuarjen e fisit si rrjedhim dhe të mbiemrit.

**Si jepet përmasa e tragjedisë së humbjes përmes numrit 9?**

Tragjedia jepet me përmasa shumë të mëdha. Numri 9 në folklorin tonë ka vlerë simbolike. Në baladë kemi 9 djem, 9 nuse, 9 fëmijë që humbin jetën, pra shumë lidhet me sasi.

**Shpjegoni kuptimet që vijnë nga fjalët: djem, pajë, dyfekë. Në cilin realitet ju shpien ato?**



**Përmes shembujve, shtjelloni disa karakteristika të baladës.**

Disa karakteristika të baladës	Përshkrimi i ngjarjes	Përshkrimi i ndjenjave	Detajet fantastike	Pika kulmore e ngjarjes
Shembull nga balada	Ditën e Pashkës në drekë seç u ther një ka në fshat/vajta mora një ok mish...	Kostandin të ardhhtë gjëma Martove Dhoqinën larg Larg e larg	Ngritja e Kostandinit nga varri, udhëtimi dhe biseda e të vdekurit me të gjallin, zogjtë që	Ngritja e Kostandinit nga varri për të mbajtur fjalën e dhënë.

		mërguar	flasin.	
		Tri male kaptuar		
<b>Shpjegimi i tij</b>				

U kërkohet nxënësve të diskutojmë rreth rubrikës “Interpretojmë tekstin”.

Gjatë këngës ndeshim vargje dyshe që tingëllojnë si refren i kënduar nga një kor. Gjejini ato dhe shpjegoni rolin që luajnë në ngjarje. Ç’mesazh përcjellin?

*Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit japin mendimin e tyre.*

**Gjeni në baladë dy momentet kur nëna mallkon. Kujt i drejtohet mallkimi i parë? Po i dyti? Pse ato e tensionojnë atmosferën e ngjarjes?**

1- Vargu 15: *Kostandin, të ardhhtë gjëma, martove Dhoqinën larg...* Mallkimi i drejtohet Kostandinit që martoi larg motrën e vetme dhe nëna nuk mund ta kishte pranë atëherë kur i duhej;

2- Vargu 51: *Ç’ Kostandin moj të ardhhtë gjëma!* I drejtohet Dhoqinës, e cila pretendon se ka udhëtuar me vëllain e vdekur.

Të dyja situatat janë të tensionuara, për shkak se kanë brenda trishtimin e një nënë të plagosur nga dhimbja për humbjen e djalit të saj, frikën e mosmbajtjes së besës nga ana e tij, udhëtimit të vajzës së saj në mesnatë me një të vdekur dhe pabesueshmërisë se Kostandini ishte ngritur nga varri për të mbajtur fjalën e dhënë.

**Ç’përfytyrim ju ngjall onomatopeja: “Cili-viu, viu-viu,/kush ia bën, ia bën vetiu?”**

Kjo onomatope krijon para lexuesit tablonë e një mesnate në të cilën dhe zogjtë habiten nga ajo që po ndodh dhe nuk kishte ndodhur ndonjëherë.

*Shkon një zogëz bishtëbardhëli vdekuri me të gjallë.*

**Gjuha e tekstit**

**Nga se karakterizohet dialogu vëlla-motër?**

Dialogu është i **tensionuar, plot ankth dhe frikë**. Dhoqina nuk e di që vëllezërit kishin vdekur dhe Kostandini bashkë me ta, ajo gjithashtu nuk ka dijeni as për arsyen e ardhjes së beftë të Kostandinit. **Ankthi dhe tensioni** rriten varg pas vargu edhe në momentet kur përshkruhet udhëtimi natën dhe largimi i Kostandinit sapo arrin te dera e kishës, duke e përshkruar këtë të fundit si shtëpinë e tij:

*...Ik tani, o moj Doruntinë,  
se kam punë në ajodhimë,  
se aty e kam shtëpinë*

Frika e Doruntinës shfaqet në formën e hamendësimeve nga ana e saj:

*...në ke ardhur për keq,  
të vishem si kallogre*

**Shpjegoni rolin e kontrastit në shembujt: i gjallë/i vdekur dhe jeta/vdekja.**

Roli i kontrastit është për të vënë ballë për ballë tablotë plot gjallëri, harmoni të jetës me momente më të dhimbshme, madje më fatale të vdekjes.

**I gjallë/i vdekur** Kontrasti mban gjithë peshën emocionale të rrëfimit.

**Gjeni fjalë sinonime nga gjuha standarde për dy fjalët dialektore:**

Dyfek-pushkë çin-me kë/me cilin?

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

Nxënësit në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me ndihmën e mësuesit/es reflektojnë rreth tekstit duke punuar me teknikën “Rrjeti i diskutimit”.

JO

A mund të ndodhë në jetën reale ngritja e të vdekurit nga varri,  
bashkëbisedimi dhe udhëtimi me të gjallët?

PO

Argumentoni mendimin tuaj.

**Vlerësimi:** Vlerësohet nxënësi për mënyrën sa më të qartë të analizimit të ngjarjeve, argumentimin dhe interpretimin të tekstit dhe gjuhës së tekstit.

**Detyrë shtëpie:** Kthejeni baladën në prozë, duke ruajtur karakteristikat e saj. Ndaluni te lidhja mes besës dhe ringjalljes.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të dëgjuarit Tema mësimore: Sjellje dhe veprime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit		Situata e të nxënët: a) Me 10 nxënës luajmë lojën “Telefoni i prishur”. Jepet mesazhi dhe do të shohim transformimin e tij për shkak të dëgjimit jo të vëmendshëm. b) Mësuesi/ja lexon një tekst. Nuk ka rëndësi çfarë lloji teksti është. Ai/ajo udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm gjatë të dëgjuarit.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon qëllimet e të dëgjuarit; - dëgjon me vëmendje për të kuptuar sa më shpejt llojin e tekstit; - analizon sjellje dhe veprime që duhet të bëjë para dhe pas procesit të të dëgjuarit; - zbulon strategji për përmirësimin e të dëgjuarit.		Fjalët kyçe: Të dëgjuarit Vëmendje Veprime Sjellje Informacion	
Burimet: Teksti mësimor, Lindsay Miller 2003. <i>Developing Listening Skills with Authentic Materials. ELC</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stubi mendimi, Punë individuale, Punë në dyshe Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stubi mendimi Të dëgjuarit përdoret më së shpeshti në jetën e përditshme. Duke iu referuar një studimi nga Burely-Allen, është konstatuar se “më shumë se 40% e komunikimit tonë të përditshëm kalohet në të dëgjuar, 35% në të folur, 16% në të lexuar dhe vetëm 9% në të shkruar (Lindsay Miller. 2003. Developing Listening Skills with Authentic Materials. ELC)”. _			
<div><div><p>për të dalluar sa më shpejt llojin e tekstit;</p></div><div><p>Qëllimi i të dëgjuarit:</p></div><div><p>për të riprodhuar fjalë, citate, vargje;</p></div><div><p>për të kuptuar plotësisht tekstin që dëgjohej.</p></div><div><p>për të dalluar fushën konkrete të veprimit: për informacion, për të mësuar, për të marrë udhëzime, për kënaqësi etj.;</p></div></div>			
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale Mësuesi/ja u liston nxënësve se çfarë sjelljesh dhe veprimesh duhet të kenë parasysh para, gjatë dhe pas procesit të të dëgjuarit.			

Sjellje dhe veprime para dhe gjatë të dëgjuarit	Sjellje dhe veprime pas të dëgjuarit
Përgatitja e terrenit për një dëgjim sa më të mirë	Mbajtja mend e informacionit
Përzgjedhja e informacionit të dëgjuar (konceptet, faktet, të dhënat)	Reflektimi rreth materialit të dëgjuar, duke verifikuar çështjet kryesore të përmbajtjes.
Dallimi i argumenteve	Vlerësimi i materialit të dëgjuar
Ndërhyrja me pyetje në momentin e përshtatshëm	Riorganizimi i informacionit të dëgjuar në bazë të shënimeve
Mbajtja e shënimeve	

Fillohet dhe punohet me ushtrimet. Punë individuale Ushtrimi 1

**Ushtrimi 1. Plotëso tabelën, pasi të dëgjosh tekstin.**

Veprimi	Kur?	Ku?

**Ushtrimi 2. Plotëso tabelën, duke përcaktuar fushën e veprimit të tekstit që dëgjohet.**

Teksti që dëgjohet	Fusha
Një leksion historie	Për të mësuar
Një romancë	Për t' u argëtuar
Një tregim	Për kënaqësi
Lajmet e orës 7:30	Për informacion
Një anekdotë	Për kënaqësi
Një debat rreth globalizmit	Për informacion
Një kronikë sportive	Për informacion
Horoskopi i ditës	Për të marrë udhëzime, për t' u argëtuar
Konferencë për ngrohjen globale	Për të mësuar

**Ushtrimi 3. Dëgjoni tekstin dhe më pas plotësoni fjalët që mungojnë.**

Nxënësit dëgjojnë dhe plotësojnë vendet bosh.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Organizoni tekstet poetike, pasi të dëgjoni variantet e rregullta të tyre. Para çdo vargu, shënoni numrin e tij.

**Lexohen poezitë e Gjergj Fishtës dhe Ismail Kadaresë dhe nxënësit gjatë dëgjimit plotësojnë me një numër vargun që duhet.**

Para dëgjimit I. Kadare	Pas dëgjimit I. Kadare
<p>Të shkoj dua mbrëmjes në rrugët e Tiranës,  Ku kam bërë dikur ndonjë marrëzi,  Kokën do ma tundin,  Por unë s'do ta marr për keq,  Se malli më ka marrë  Dhe në rrugët ku s'kam bërë asnjë marrëzi.  Dhe t'eci rrugicave plot gjethe të thara,  Gjethe të thara, gjethe vjeshte,  Më njohin ato porta të vjetra të drunjt,  Inatin akoma do ma mbajnë,  Për të cilat krahasimet gjenden aq lehtë.</p> <p>I. Kadare "Malli i Shqipërisë"</p>	<p>1) Të shikoj dua mbrëmjes në rrugët e Tiranës,  2) Ku kam bërë dikur ndonjë marrëzi,  3) Dhe në rrugët ku s'kam bërë marrëzi,  4) Me njohin ato porta të vjetra të drunjt,  5) Inatin akoma do ta mbajnë,  6) Kokën do ta tundin,  7) Po unë s'do ta marr për keq,  8) Se malli më ka marrë.  9) Dhe t'eci rrugicave plot gjethe të thara  10) Gjethe të thara gjethe vjeshte,  11) Për të cilat krahasimet gjenden aq lehtë.</p> <p>I. Kadare "Malli i Shqipërisë"</p>
Para dëgjimit Gj. Fishta	Pas dëgjimit Gj. Fishta
<p>T'falem, Shqypni, ti i shpirtit tem dishiri!  Tue gzue t'pamt tand, tue t'hjekë atë ajr t'kullue,  I lum njimend jam un' n'gj tan tue rrnue,  Ku Shqypnija e Burrit s'dron se i qaset niri.  Ktu trima lejn gjithmonë, pse ti je nana,  E armvet n'za, qi shndrisin duert e t'lumit,  Si Leka i Madhi e Skandërbegu i biri,</p>	<p>1) T' falem, Shqypni, ti i shpirtit t'em dishiri!  2) I lum njimend jam un' n' gji t' and tue rrnue,  3) Tue gzue t' pamt t' and, tue t' hjekë atë ajr t' kullue  4) Si Leka i Madhi e Skandërbegu i biri.  5) Kjë i Lumi vetë, qi mue m' dergoi ksi hiri  6) Për nën qiellë t' ande t' kthiellte un me u përfutue,  7) Malet e hjedhta e t' blerta me shikjue,</p>

<p><i>Kje i Lumi vetë, qi mue m'dërgo ksi biri</i>  <i>Kah des për ty i rrebtë e trim si zana</i>  <i>Eden n'Balkan ti je; ti prej t'Amshumit.</i>  <i>Për nën qiellë tande t'kthiellte un me u përftue.</i>  <i>Malet e hjedhta e t'blerta me shikjue</i>  <i>Gj.Fishta "Shqypnis"</i></p>	<p>8) Ku Shqypja e Burrit s' dron se i qaset niri.            9) Ktu trima léjn gjithmonë, pse ti jé nana            10) E armvet n' zâ, qi shndrisin duerët e t' lumit,            11) Kah des për ty i rrebtë e trim si Zana.            12) Eden n' Balkan ti jé; ti prej t' Amshu'mit  <i>Gj.Fishta "Shqypnis"</i></p>
---	--

Në fund, disa nga nxënësit lexojnë punimet e tyre. Disa nga punimet e nxënësve vendosen në muret e klasës dhe shokët e klasës i shikojnë, për të vendosur në fund se cilat nga punimet janë të sakta. Falënderohen nxënësit për pjesëmarrjen.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për punimet e bëra.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Përralla dhe mite (Ora I)</b>		<b>Situata e të nxënët:</b> Në videoprojektor shfaqet miti i Atlasit ose lexohet nga mësuesi/ja: <b>Bartësi i qiejve</b> Biri i Titanit Iapetus dhe një nimfe të detit, Klimenës, Atlasi sundonte mbi një ishull-mbretëri të lashtë, me emrin Atlantidë. Kishte shumë njerëz nën sundimin e tij, por për arsye shumë të forta, perënditë vendosën që të shkatërrojnë të gjithë racën e tyre. Ata dërguan një përmbytje të madhe, që vrau të gjithë njerëzit dhe e fundosi ishullin, në fund të detit. I zemëruar me perënditë për humbjen e mbretërisë së tij, Atlasi udhëhoqi Titanët në luftën kozmike. Kur perënditë fituan luftën, ata e ndëshkuan Atlasin për pjesën që kishte luajtur në këtë luftë, duke e bërë që të mbajë përgjithmonë qiejt mbi supet e tij.	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon veçoritë kryesore të përrallës, mitit dhe legjendës; - dallon strukturën e ndërtimit të tyre; - plotëson hartën e personazheve.		<b>Fjalët kyçe:</b> Miti Përralla Legjenda	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, M. Xhaxhiu “Letërsia antike greke”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, qytetari	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësave:</b> “Parashikim me anë të titullit”, Punë në dyshe, Harta e personazheve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Tema e mësimit të sotëm është “Përralla dhe mite”. <b>Çfarë mendoni se do të lexoni? Thoni mitin, përrallën dhe legjendën që do të donit të ishte në tekst?</b> Nxënësit diskutojnë dhe japin mendimet e tyre. <b>Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe</b> <b>Nxënësit hapin tekstin mësimor. Kuptojmë tekstin</b> <b>1) Plotësoni tabelën rreth tematikës së krijimeve më lart.</b>			
<b>Krijimi</b>	<b>Përralla</b>	<b>Miti</b>	<b>Legjenda</b>
<b>Tematika</b>			

1) Plotësoni tabelën rreth tematikës së krijimeve më lart.

<i>Krijimi</i>	<i>Përralla</i>	<i>Miti</i>	<i>Legjenda</i>
<i>Tematika</i>			

2) Të gjitha krijimet më lart kanë pak a shumë të njëjtën strukturë. Dalloni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen në secilin prej tyre. Nxënësit punojnë në dyshe.

<i>Gozhda</i>	<i>Hyrje</i>	<i>Zhvillim</i>	<i>Mbyllje</i>

<i>Rrëfenja peshkatarësh dhe gjuetarësh</i>			

<i>Kutia e Pandorës</i>			

3) Si zhvillohet subjekti i tyre? Përshkruani atmosferën dhe përcaktoni pikën kulmore të secilit krijim.

Pika kulmore e përrallës “Gozhda” është kur kali ra përdhe dhe tregtarit iu desh të shkonte në këmbë në shtëpi, ndërsa te “Rrëfenja peshkatarësh dhe gjuetarësh” është kur gjuetari gënjen hapur për lepujt që zë dhe te “Kutia e Pandorës” është hapja e kutisë dhe dalja e të gjitha të këqijave.

4) Ngjarjet e krijimeve kanë edhe intrigë. Në secilin rast, identifikojeni atë dhe shpjegoni rolin që ka në zgjidhjen e problemit që ngrihet.

5) Plotësoni figurën e mëposhtme me veçoritë kryesore të këtyre krijimeve.

<i>Miti</i>	<i>Përralla</i>	<i>Legjenda</i>
Formë e thjeshtë tregimtare	Fillon zakonisht me: Na ishte njëherë..., Na ishte seç na ishte...	Tekst rrëfimtar nga rrëfimtari popull për një ngjarje, dukuri ose person.
Ka të bëjë me shpjegimin naiv të dukurive të natyrës.	Ka fund të lumtur.	Koha dhe vendi të papërcaktuara.
Krijime plot fantazi	Vendi ku zhvillohet ngjarja është imagjinar.	Kanë elemente fantastike.
	Ka objekte magjike si p.sh.: molla e helmuar, pasqyra magjike, shkopi magjik.	

**Analizojmë tekstin**

6) Zakonisht në krijime të kësaj natyre ka personazhe që qëndrojnë përballë njëri-tjetrit.

Identifikoni nga dy personazhe për secilin krijim dhe shpjegoni arsyen përse janë të ndryshme

Gozhda: T regtari-Seizi; Rrëfenja peshkatarësh dhe gjuetarësh: Peshkatari-gjuetari


Kutia e Pandorës: Pandora – Zeusi. Nxënësit më pas do të japin mendimet e tyre për pyetjet e mëposhtme.

Në ç'mënyrë përballen me njëri-tjetrin? Çfarë përfaqëson secili prej tyre?

7) A ndryshojnë këto personazhe? A zhvillohen ato? Shpjegoni veprimet e tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

Plotësoni hartën e personazheve, duke dhënë nga një tipar thelbësor për secilin.



**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për mitin, përrallën dhe legjendën.

**Detyrë shtëpie:** Ritrego një prej krijimeve.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të folurit</b> <b>Tema mësimore: Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në trup të fjalës</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Bisedë mes miqsh. Bëni është vëllai i vogël i Mirit. Ai mëson në klasën e dytë. Një mëngjes kur po bisedonte më vëllanë ai u habit kur shqiptoi fjalët mëngjez, barkaz, baraz, mëngjezore. <i>A i shqiptoi Beni drejt fjalët?</i> <i>Argumento përgjigjen.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor drejt bashkëtingëlloret e zëshme <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> në fund dhe në trup të fjalës;</li> <li>- përdor drejt bashkëtingëlloret e zëshme të mbiemrave të prejardhur;</li> <li>- argumenton shqiptimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fjalët e dhëna.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllore të zëshme Shqiptim Shkrim
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Diskutim, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Punë individuale</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim</p> <p>Çfarë quajmë bashkëtingëllore?          Cilat janë bashkëtingëlloret e zëshme?          Pse quhen të tilla?</p> <p><b>Listoju ato:</b> <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i></p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Mbajtja e strukturuar e shënimeve</p> <p>Udhëzohen nxënësit të hapin tekste dhe të shohin rastet kur përdoren drejt bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës. Gjithashtu, këshillohet që nxënësit të mbajnë shënim çështjet kryesore në to, duke i paraqitur në skemë.</p> <p>Bashkëtingëlloret e zëshme <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> shkruhen ashtu siç shqiptohen në rastet e mëposhtme:</p> <div data-bbox="175 952 1428 1400" style="text-align: center;"> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #f0f0f0;">             Kur janë përpara një zanoreje:               lab (labi), rob (robi),              bredh (bredhi), dredh (drodha) zog (zogu)           </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #f0f0f0;">             Bashkëtingëlloret e zëshme <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #f0f0f0;">             Kur gjenden në fund të fjalës ose në trup të saj, përpara një bashkëtingëllores n:           </div> </div> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center; margin-top: 10px;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #f0f0f0;">             digj (digje), ligj (ligji),              hov (hovi), xhuxh (xhuxhi), brez (brezi)           </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #f0f0f0;">             mund, kënd, livadh, lagsha, i hovshëm           </div> </div> </div> <p>Me bashkëtingëllore të zëshme shkruhen e shqiptohen edhe mbiemrat e prejardhur, të formuar me prapashtesën -shëm: <i>i përjavshëm, i përbuzshëm, i ndërgjegjshëm</i>.</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Punë individuale</p> <p>Udhëzohen nxënësit të punojnë dhe të përgjigjen në mënyrë individuale për ushtrimet 1-6/faqe 168.</p> <p><b>Ushtrimi 1. Gjeni në fjalor kuptimet e fjalëve lidhëz dhe lidhës.</b></p> <p><b>Lidhëz:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Shih lidhëse; Lidhësat e rrushit</li> <li>2) Pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që lidh dy gjymtyrë fjalie ose dy fjali edhe shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre lidhëz bashkërenditëse dhe nënrenditëse etj.</li> </ol> <p><b>Lidhës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ai që lidh diçka me rrip ose me një lidhëse tjetër; Lidhësi i dengjeve të duhanit.</li> <li>2) Punëtor i hekurudhës që lidh varg vagonët e trenit.</li> </ol> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejtë të bashkëtingëlloreve të zëshme në trup e në fund të fjalës.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Shikoni figurën dhe shkruani një tekst të shkurtër. Nënvizoni bashkëtingëlloret e zëshme dhe shpjegoni rastin e përdorimit të tyre.</p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të folurit</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> <b>VARIANTI 1:</b> Konkurs: Gjej nga 10 fjalë që kanë parashtesat nistore <i>sh/zh/ç</i> . Koha në përdorim është 3 minuta. <b>VARIANTI 2:</b> Gjej bashkëtingëlloret nistore <i>sh/zh</i> dhe në vargjet e F. Nolit. <i>Çirem, digjem i vrerosur,</i> <i>Sakatosur, çarmatosur...</i> <i>...Se të deshte dhe s'të deshnin,</i> <i>Se të qante kur të qeshnin,</i> <i>Se të veshte kur të çveshnin,</i> <i>Nëno moj, të ra dëshmor.</i> <i>...Rent, or rent, rent e u thuaj</i> <i>Se u çthur ordi e huaj,</i> <i>Se betejën e fituam</i> Argumento përgjigjen.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloret nistore <i>sh/zh/ç</i> në fjalët e dhëna;</li><li>- shkruan saktë fjalët që kanë bashkëtingëlloret nistore;</li><li>- krijon çifte antonimike me ndihmën e këtyre bashkëtingëlloreve nistore;</li><li>- përdor si duhet bashkëtingëlloret nistore në tekstet që krijohen prej tij;</li><li>- dallon fjalët që bëjnë përjashtim nga rregullat e përdorimit të këtyre bashkëtingëlloreve.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllore <i>sh/zh/ç</i> Parashtesa nistore	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, materiale të ndryshme letrare (poezi)		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Stuhi mendimi, Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> <i>Stuhi mendimi</i> Nxënësit dhe në klasat e mëparshme kanë mësuar përdorimin e bashkëtingëlloreve <i>sh/zh/ç</i> në fjalë të ndryshme dhe se para cilës bashkëtingëllore apo zanore përdoren ato. Por gjithashtu kanë mësuar se këto bashkëtingëllore përdoren dhe si parashtesa për krijimin e fjalëve me kuptim të kundërt.			

Nxiten nxënësit të plotësojnë organizuesin grafik.

Shkruhen me *sh*- nistore fjalët që pas *sh*-së vijojnë me një prej bashkëtingëlloreve.  
të shurdhëta: *f, k, p, q, t, th*.

**Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret sh-, zh-, -ç**

Shkruhen me *zh*- nistore fjalët që pas *zh*-së vijojnë me një prej bashkëtingëlloreve.  
të zëshme: *b, d, g, gj, v*.

Shkruhen me *ç*- nistore fjalët që pas *ç*-së vijojnë me një zanore; me një prej bashkëtingëlloreve të tingullta: *l, j*; me një prej bashkëtingëlloreve hundore: *m, n, nj*; me një prej bashkëtingëlloreve dridhëse: *r, rr*.

Nxënësit japin shembuj ilustrues me fjalë që fillojnë me këto bashkëtingëllore.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe të shohin rregullat për përdorimin e bashkëtingëlloreve *sh/zh/ç*. Por kujdes, nxënësit dhe mësuesi/ja duhet të përqendrohen në disa raste kur përdorimi i këtyre bashkëtingëlloreve del nga rregullat.

Kujdes! Përemri çdo te të gjitha fjalët e formuara me pjesëmarrjen e tij, shkruhet kështu, pavarësisht nga bashkëtingëlloret që e pason: *çdokush, çdonjëri, çdollojtë* etj.

Kujdes! Shkruhen me *-sh* fjalët: *shmang, shlyej, shndërroj, shndrit* dhe ato që formohen prej tyre.

Nxënësit udhëzohen të punojnë ushtrimet e dhëna në tekst.

**Ushtrimi 1 fq. 169. Gruponi fjalët e mëposhtme sipas pjesës së ligjëratës në të cilën bëjnë pjesë:** *çdonjëri, çfarë, çfarëdo, i çfarëdoshëm, çka, diçka, gjithçka, çorientim, (i, e) çrregullt, çngjyros, çjerr, (i, e) çjerrë, zhvoshk, shquaj, zhgërryej, zhdoganoj, shkarkoj, shkëlqej, shkoq, shpyllëzim*.

Emër	Mbiemër	Folje	Përemër
Çorientim	I çrregullt	Çngjyros	Çdonjëri
Shpyllëzim	(i, e) çjerrë	Çjerrë	Çfarë
	I çfarëdoshëm	Zhvoshk	Çfarëdo
		Shquaj	Gjithçka
		Shkoq	Çka
		Shkëlqej	Diçka
		Shkarkoj	
		Zhdoganoj	
		Zhgërryej	

**Ushtrimi 2 fq. 169.** Gjeni dhe shkruani fjalën antonime për çdo fjalë të sjellë si shembull në këtë mësim, që fillon me një nga bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç- nistore. P.sh.: shfajësoj-fajësoj. Cili është roli i bashkëtingëlloreve nistore në këtë rast?

Shfryj-fryj; shpërdorim-përdorim; shqep-qep; shthur -thur; shthurje-thurje

Zhbëj-bëj; zhbllokoj-bllokoj; zhdaravit-daravit; zhdëmtoj-dëmtoj; zhdredh-dredh; i, e zhdrejtë-i, e drejtë; zhgënjej-gënjej; zhgërrij-gërrij; zhgjakësohem-gjakësohem; zhvendos-vendos; zhvesh-vesh; zhvleftësim-vleftësim

Çarmatos-armatos; Çarmatim-armatim; Çorganizoj-organizoj; Çorganizim –organizim; Çorientoj-orientoj;

Çorientim-orientim; Çliroj-liroj; Çlirim-lirim; Çlodhem-lodhem; Çmësohem-mësohem; Çnderoj-nderoj; Çnderim-

nderim; Çngjyros-ngjyros; Çnjerëzor-njerëzor; Çregjistroj-regjistroj; Çregjistrim-regjistrim; Çrregulloj-rregulloj;

Çrregullim-rregullim; i, e Çrregullt-i, e rregullt; Çrrenjosje-rrënjosje; **Roli i bashkëtingëlloreve sh/zh/ç është krijimi i antonimive.**

**Ushtrimi 3/fq.169.** Formoni fjalë të tjera prej fjalëve shmang, shlyej, shndërroj, shndrit. Cilës klase fjalësh i përket secila prej fjalëve të reja? P.sh.: shmang (folje) – shmangie (emër) – (i, e) shmangur (mbiemër).

Folje	Emër	Mbiemër
Shmang	Shmangie	i, e shmangur
Shlyej	Shlyerje	i, e shlyer
Shndërroj	Shndërrim	i, e shndërruar
Shndrit	Shndritje	i, e shndritur

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i lirë

Udhëzohen nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë me ushtrimin 4 fq. 169:

**Hartoni një tekst (me mbi 100 fjalë), ku të përdorni edhe fjalë që fillojnë me bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç-.**

**Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.**

Në fund të punës, nxënësit do të lexojnë punët e tyre duke evidentuar fjalët që fillojnë me bashkëtingëllore sh/zh/ç.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e bashkëtingëlloreve nistore sh/zh/ç në fjalë të ndryshme të krijuara prej tyre dhe që u përkasin klasave të ndryshme të ligjëratës, për hartimin e teksteve që kanë në to fjalë që fillojnë me sh/zh/ç.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Përralla dhe mite (Ora II)		Situata e të nxënët: Diskutohet për mitet që nxënësit i kanë lexuar, dëgjuar, apo i kanë parë të ekranizuara.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- ritregon bukur mitin, përrallën dhe legjendën;</li><li>- analizon shprehjet frazeologjike dhe fjalët e urta në pjesët e dhëna;</li><li>- diskuton rreth ndryshimeve që kanë mitet, përrallat e legjendat;</li><li>- zbulon mesazhet që përcjellin pjesët.</li></ul>		Fjalët kyçe: Miti përralla legjenda rrëfim	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, qytetari	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në dyshe, Ditari dypjesësh, Shkrim i lirë</i>			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Detyrë shtëpie u është dhënë nxënësve që të ritregojnë një prej krijimeve të dhëna. Ngrihen disa nxënës. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin, madje dhe vetëvlerësohen.</i> <i>Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim</i>			
<b>Si mendoni, pse të tilla krijime e marrin titullin nga personazhi kryesor apo nga ngjarja kryesore?</b> Mësuesit/et udhëzojnë nxënësit ku duhet të përqendrohen për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje. Nxënësit duhet të kenë parasysh edhe mite të tjera krahas mitit të orës përkatëse. P.sh: Nga e ka marrë titullin miti “Prometeu i mbërthyer”? <i>*Mitet e marrin titullin nga ngjarja kryesore.</i>			
<b>Ç’ju bën përshtypje në mitin e Pandorës?</b> Në këtë pyetje nxënësit mund të japin përgjigjet e tyre duke u përqendruar në mënyrën e krijimit të Pandorës, në figurën despotike (sunduese) e hakmarrëse të Zeusit apo në kureshtjen e Pandorës.			
<b>Në ditët e sotme përdoret shumë shprehja: Gjeti kutinë e Pandorës. Me çfarë ngjyrimi përdoret ajo: negativ apo pozitiv?</b> Fillimisht nxënësit nisen nga miti “Kutia e Pandorës”. Çfarë ndodhi pasi Pandora hapi kutinë? (Nxënësit listojnë pasojat që solli hapja e kutisë). Më pas ata orientohen të përgjigjen në vija të përgjithshme: Çfarë ngjyrimi merr në ditët e sotme shprehja “gjeti kutinë e Pandorës”.			
Shembuj me ngjyrim pozitiv		Shembuj me ngjyrim negativ	
Gjeti shpresën		Gjeti gjithë të këqijat	

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të japin mendimin e tyre për fragmentet e dhëna:

Fragmenti	Komenti im
Brenda në kuti babai i perëndive kishte mbyllur shumë halle, mjerime, shqetësime, sëmundje, lot e dhimbje... dhe të gjitha këto,  sapo u hap kutia, dolën jashtë, u derdhën dhe shkuan të bashkëjetojnë me njerëzit. Kështu, që nga ajo ditë, njerëzit do të jetonin bashkë me hallet, shqetësimet, sëmundjet e dhimbjet. Në këtë mënyrë Zeusi u hakmor ndaj njerëzve.	
Por brenda në kuti kish mbyllur dhe diçka të mirë: shpresën. Dhe njerëzit, sado që të vuajnë, shpresojnë gjithmonë se ditë më të mira do të vinë. Shpresa zbukuron jetën dhe jep guxim për të kapërcyer të gjitha vështirësitë.	

Gjeni nota humorit në këto krijime dhe shpjegoni se mbi ç'rrethana krijohet.

Në këtë mit notat e humorit krijohen në dialogun midis Pandorës dhe mbretit të njerëzve, Epimeteut. *“Atëherë...mos e hap”*

**Gjuha e tekstit**

**Si zhvillohet dialogu dhe si ndihmon ai në zbulimin e personazheve?**

DIALOGU	KOMENTI
...Këtë kuti ma dhuroi Zeusi, - u përgjigj ajo, - por më porositi... - Atëherë...mos e hap, - e këshilloi Epimeteu.	Duke u nisur nga dialogu që zhvillohet mes Epimeteut dhe Pandorës vëmë re kureshtjen që shfaq kjo e fundit në lidhje me dhuratën e dasmës. Nga ana tjetër, figura e Epimeteut dallon nga figura e të vëllait Prometeut, i cili ishte më syçelë.

**Gjeni shprehjet frazeologjike dhe fjalët e urta, duke shpjeguar më pas rëndësinë e tyre në krijime të tilla. Bjeri larg se del më afër; Një vrap pele etj.**

*\*Edhe për këtë ushtrim ndiqet teknika e ditarit dypjesësh, në këtë mënyrë nxënësit e kanë më të lehtë të listojnë shprehjet frazeologjike dhe përballë tyre të japin kuptimin e zgjeruar të tyre.*

**Pse themi që gjuha e përrallave, miteve dhe legjendave është e thjeshtë dhe e qartë?**

Gjuha e këtyre krijimeve është e thjeshtë, sepse kemi të bëjmë me forma tregimtare të cilat më së shumti janë transmetuar gojarisht ndër vite.

**Bie në sy kjo më lart? Ilustrojeni me shembuj.**

*Fjalitë në këtë mit janë të thjeshta, e përgjithësisht të shkurtra për të krijuar një rrëfim rrjedhës. P.sh.:*

*- Dhe tani tha Zeusi, - shko të jetosh me njerëzit. Merre me vete këtë kuti. Por kujdes, mos e hap kurrë.*

**Reflektojmë rreth tekstit**

**Pse themi që këto krijime kanë zgjidhje optimiste?**

E themi këtë, pasi janë krijime popullore dhe në luftën midis të mirës dhe të keqes, dëshira për të triumfuar vetëm e mira, ka qenë shumë e madhe.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**


Në orën e parë të kësaj teme, u diskutua për karakteristikat e mitit, përrallës dhe legjendës. Gjatë kësaj ore bëhet një rimarrje e njohurive të prezantuara në këto dy orë. Klasa mund të ndahet në tri grupe dhe secili grup të bëjë një përmbledhje të shkurtër për karakteristikat e përrallës, mitit dhe fabulës.

**Shkrim i lirë Bëj një ese me temë:** “Shpresa zbukuron jetën dhe jep guxim për të kapërcyer të gjitha vështirësitë.”

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për ritregimin e pjesëve, analizën e frazeologjive dhe fjalëve të urta, për zbulimin e mesazheve etj.

**Detyrë shtëpie:** Bëni një ese me temë: “Shpresa zbukuron jetën dhe jep guxim për të kapërcyer të gjitha vështirësitë.”

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Narcisi		Situata e të nxënit: Shfaqet piktura përpara klasës dhe diskutohet rreth saj.	
			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<ul style="list-style-type: none"><li>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</li><li>- Kompetenca e të menduarit</li><li>- Kompetenca personale</li><li>- Kompetenca qytetare</li></ul>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- ritregon shkurt pjesën duke u mbështetur në fjalët kyçe;</li><li>- analizon tiparet dalluese të personazheve që veprojnë në të;</li><li>- krahason personazhin e Drrerit te fabula e Ezopit me atë të Narcisit.</li></ul>		Fjalët kyçe: Narcis Dashuri për veten Bukuri Liqen Alkimisti	
Burimet: Teksti mësimor piktura e John William Waterhouse, videoprojektor etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Imagjinatë e drejtuar, Pyetje-përgjigje, Diagram Veni, Rrjet diskutimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Imagjinatë e drejtuar			
Nxënësit diskutojnë së bashku me mësuesin/en për mitin e Narcisit.			
Çfarë rrëfen legjenda e vjetër e Narcisit? Narcizi, na mëson mitologjia, është biri i nimfës Liriope dhe lumit Cefis. E ëma në interesimin për jetëgjatësinë e të birit, kërkoi ndihmën e një orakulli, i cili i tha se ai do të ketë një jetë “Po kaq të gjatë sa nuk do ta njohë vetveten”. Narcisi, djaloshi me bukuri të rrallë, rrëmbeu adhurimin e shumë djemve dhe vajzave, por ai gjithnjë kishte një arsye t’i largonte me një përbuzje të paepur, duke përfshirë këtu edhe nimfën e bukur Eko, e cila ishte e dashuruar marrëzisht pas tij. Njëra nga viktimat e Narcisit, sqaron mitologjia, u kërkoi perëndive të bëjnë gjithçka që edhe ai të jetë i lënduar, të provojë dhimbjen e përbuzjes dhe përçmimit, çka i bën të vuajnë adhurueset e tij dhe të gjithë ata që e kanë të pamundur të zotërojnë objektin e dëshirimit. Afërdita, perëndesha e dashurisë e ndëshkoi rëndë Narcisin. Narcisi duke kaluar një ditë pranë një burimi të kulluar, u përkul të shuante etjen, por kaloi në ekstazë duke parë fytyrën e vet të mahnitshme. Por askush nuk mund të hidhet në krahët e dashurisë për vetveten. Kështu që, sapo Narcisi i afrohej pasqyrimit të tij, ai zhdukej duke e shuar ëndjen për t’u ndjerë i marrosur pas bukurisë së vet. Narcisi tashmë i dëshpëruar që nuk mund të kishte një tjetër në krahët e tij, i sëmbuar nga vetmia dhe braktisja, qëndroi pareshtur buzë ujit dhe përpiqej papushim të shihej me pasqyrimin e tij. Fati i tij tragjik është tashmë i parathënë. Ai mohon çdo gjë që e rrethon dhe shuhet duke lënguar. Me gjithë të keqen që ka bërë, motrat e tij, nimfat e burimeve dhe të drurëve, Najadat dhe Driadat, e qajnë me lot. Perënditë e përjetësojnë emrin e tij te një nga lulet e para të pranverës që është Narcisi.			

### Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetje-përgjigje

Prezantohen nxënësit me temën e re të mësimit:

Narcisi, fragment i shkëputur nga romani “Alkimisti” i **Paulo Coelho** (24 gusht, 1947), romancierit të njohur brazilian.

Është një ndër autorët më të lexuar në të gjithë botën. Ai është një ndër fituesit e çmimeve të mëdha, ku një ndër këto është “Kristal Awards” i dhënë nga forumi “World Economic”. Paulo Coelho hyri në Librin Guinness të Rekordeve si autori që firmosi më shumë libra në 9 tetor 2003, në Panairin e Librit në Frankfurt. Librat e tij, janë përkthyer në më shumë se 56 gjuhë të botës.

*\*Orientohen nxënësit për leximin e pjesës, duke patur parasysht intonacionin me të cilin do të lexohet, respektimin e shenjave të pikësimit dhe pauzat.*

*Pas leximit, mësuesilja punon me fjalët e reja që janë shpjeguar dhe në tekst.*

*Kuptojmë tekstin rubrika që do të diskutohet më nxënësit. Ata u japin përgjigje pyetjeve:*

#### 1- Çfarë rrëfen pjesa e Oskar Uajlldit?

Rrëfimi i Uajlldit fillon aty ku mbaron legjenda e Narcisit.

#### Tregoni shkurt ngjarjen sipas variantit të tij.

Legjenda e tij vjen në kohët tona në forma të ndryshme: e përshtatur, e përpunuar ose e gërshtuar me forma më të reja të tij. Pjesa e Oskar Uajlldit tregon se “virusi Narcis” u përhap dhe kishte viktimën e tij të parë, liqenin.

#### Nxënësit fillojnë dhe e ritregojnë shkurt variantin e Oskar Uajlldit?


Një variant i ritregimit mund të ishte ky:

Narcisi ishte një djalë shumë i bukur që shkonte për të parë bukurinë e tij në ujërat e liqenit çdo ditë. Një ditë ra në liqen dhe u mbyt. Aty mbiu një lule që u quajt me emrin e tij. Liqeni u shndërrua në një poçe me ujë të kripur. Këtë gjë e vunë re Oreadat, perëndeshat e pyllit, të cilat e pyetën se cila ishte arsyeja që liqeni qante, pasi ai kishte pasur fatin ta shihte çdo ditë atë. Liqeni nuk e kishte vënë re bukurinë e tij, pasi në sytë e Narcisit, kur përkulej në breg ai shihte bukurinë e vet.

**Hapi i dytë:** Kllaster personazhesh

#### 2. Përshkruani personazhet e pjesës më lart, duke plotësuar figurat e mëposhtme. (Narcisi Oreadat Liqeni Alkimisti Autori).

Në këtë fazë nxënësit mund të përdorin klasterin, për të ndërtuar portretin fizik dhe moral të personazheve.



**Hapi i tretë:** Praktikë e drejtuar

#### 3. Figura e Narcisit është e lidhur me pasqyrimin e bukurisë së tij në liqen. Pse është e rëndësishme përzgjedhja e këtij detaji të natyrës?

Marrja e detajit nga natyra është e rëndësishme, pasi bukuritë natyrore nuk krahasohen me asgjë.

#### 4. Mendoni që Narcisi është një personazh për t'u admiruar apo për t'u kritikuar? Pse?

5. Pse liqeni ishte një tjetër Narcis? Fakti që nuk kishte arritur të shihte bukurinë e Narcisit, sepse ishte i dashuruar me veten.

**Interpretojmë tekstin**

**6. Ku qëndron bukuria e tregimit të Uajlldit?** Uajllidi e zhvillon më shumë rrëfimin, nuk e lë te miti subjektin, duke e përhapur virusin e marrosjes pas vetes dhe te të tjerët.

**Pse e pëlqen Alkimisti atë? Po ju, a e pëlqeni tregimin e tij? Më shumë se vetë legjendën?** Si në legjendë dhe variantin i Uajlldit trajtohet e njëjta tematikë. Dashuria për veten dhe mospranimi i askujt tjetër.

**7. Interpretoni kuptimin që ka sot emri Narcis?** Njeriu i dashuruar me veten. **A ka ngjyrim negativ?** Po ka kuptim negativ, një njeri i cili nuk mund t'i kushtojë rëndësi askujt tjetër përveç vetes quhet narcist dhe i kushton rëndësi vetëm pamjes së jashtme.

**8. Si ndërthuren rrëfimet në këtë pjesë të shkurtër?** Rrëfimi ndërthuret nga e shkuara në të tashmen, nga përdorimi i kohës së shkuar në të tashmen. **A e bën të larmishme përmbajtjen kjo ndërthurje?** Po e bën të larmishme.

**9. Vini re humorin e hollë që përshkon tregimin e Uajlldit. Shpjegoni rolin e tij në dhënien e mesazhit.** Fjala e urtë shkodrane “Të hyftë vetja në qejf” i përshtatet shumë mirë subjektit dhe personazheve të përzgjedhur nga autori dhe përbën mesazhin i cili tregohet qartë në fatin tragjik të Narcisit.

**10. Si ju duket fakti që liqeni flet? Çfarë ngjyre i jep ky element artistik dhe fantastik rrëfimit?** Liqeni flet, ka marrë tiparet e njerëzores.

Nëse do të bëjmë një përjasje me kohët moderne, “virusi Narcis” po merr jetë me vetë fotografimin, pra me *selfi*.

Vetëfotografimi, më shumë se një nevojë për të pasqyruar vetveten para të tjerëve, mbetet një përpjekje për të mbushur boshllëkun e së përditshmes që shqetësonte Narcisin.

**Reflektojmë rreth tekstit: Diagram Veni 11** Më poshtë vijon një nga fabulat e Ezopit. Lexojeni dhe gjeni të përbashkëtat midis saj dhe pjesës sonë. Diskutoni rreth mesazheve që përcjellin ato. Një dre i etur shkoi te një burim. Ndërsa ishte duke pirë ujë, vuri re në ujë hijen e vet dhe filloi të mburrej për brirët e tij, duke parë madhësinë e bukurinë e tyre. Kurse për këmbët e veta u hidhërua që i kish aq të holla e të hajthme. Kur ishte ende duke menduar për këtë gjë, ia behu luani e filloi ta ndjekë. Dreri iu dha këmbëve dhe u largua mjaft prej luanit. Për sa kohë vrapoi në fushën pa gjerë, dreri i shpëtoi rrezikut. Kur mbërriti në pyll, në një vend me drurë të dendur, brirët iu ngatërruan nëpër degët e drurëve. Ai nuk mundi të vrapojë më, ndaj luani e kapi. Para se të përfundonte në gojën e luanit, dreri tha me vete: “I shkreti unë! Këmbët më shpëtuan, megjithëse mendova se ato do të më linin në baltë dhe e gjeta belanë prej brirëve, që më mbushnin gjithë besim.”

Nxënësit fillojnë dhe gjejnë të përbashkëtat midis fabulës së Ezopit dhe fragmentit të dhënë.



*Pas mbarimit të punës e diskutojnë atë në klasë.*

**Hapi i katërt:** Rrjet diskutimi

**Mendoni që Narcisi është një personazh për t'u admiruar apo për t'u kritikuar?**

PO

JO

Nxënësit japin argumentet e tyre gjatë diskutimit.

**Vlerësimi:**

Bëhet vlerësimi për: përgjigjet e dhëna, për pyetjet e bëra rreth pjesës, diskutimit rreth personazheve të pjesës etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të folurit</b> <b>Tema mësimore: Sjellje dhe veprime të përshtatshme gjatë të folurit</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Tryezë e rrumbullakët “Rreziku nga substancat e dëmshme” Diskutojmë së bashku	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- analizon sjelljet dhe veprimet e përshtatshme gjatë të folurit;</li><li>- argumenton situatat që kanë nevojë për strukturim dhe përmirësim;</li><li>- diskuton rrjedhshëm për tema të ndryshme.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Të folur Situatë komunikimi Mesazhi Intonacion Rrjedhshmëri	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, “Metodika për estetikën e të folurit” Sonila Kapedani; “Arti i të folurit dhe mençuria në komunikim”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> teatër, të folurit publik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stubi mendimi, Të nxënësve në bashkëpunim, Punë me grupe, Lojë në role <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Stubi mendimi “Vjelim” mendimet e nxënësve për të folurit.			
<div><div><div>Flisni rrjedhshëm!</div><div>Kujdes ritmin!</div><div>Kujdes intonacionin!</div><div>Zgjidhni tema për të cilat keni shumë informacion</div><div>Kujdes kohën!</div><div>Mos përsërit veten!</div><div>Mos u tregoni nervoz!</div><div>Kujdes gjuhën e trupit!</div><div>Kujdes kontaktin me sy dhe buzëqeshjen</div><div>Të folurit</div></div></div>			
<b>Kujdes!</b> Fusha për të cilën do të flisni. Situata në të cilën do të flisni. Përmbajtja e mesazhit.			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënësve në bashkëpunim Nxënësit hapin tekstin mësimor. Mësuesi/ja i udhëzon të punojnë ushtrimin 1 sipas kërkesës. Klasa ndërkohë është e ndarë në grupe dhe secili nga grupet do të prezantohet me një përfaqësues. Shprehuni në lidhje me situatat e mëposhtme. Vlerësoni të folurin e njëri-tjetrit duke gjetur fjalë, fjali apo grupe fjalësh që e dëmtojnë të folurin.			

**Grupi 1** Duhet t'i kërkoshe falje një shoku, sepse ke harruar t'i ktheshe librin.

**Grupi 2** Duhet t'ju shpjegosh prindërve mbresat nga vizita në muze.

**Grupi 3** Duhet të informosh trajnerin se për dy javë nuk do të shkosh në stërvitje.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin pas të folurit, duke evidentuar fjalët, fjalitë apo grupet e fjalëve që e dëmtojnë të folurin.

Për të punuar ushtrimin 2 ruhen përsëri grupet duke shtuar një grup.

Shprehuni në lidhje me situatat e mëposhtme. Sugjeroni ndryshime fjalësh, fjalish apo grupesh fjalësh që do ta përmirësonin të folurin.

**Grupi 1** Duhet t'i them mësuesit se nuk mund të shkoj në ekskursion, për një arsye të caktuar.

**Grupi 2** Duhet të fitoj besimin e nënës.

**Grupi 3** Duhet t'i shpjegoj parukieres tipin e prerjes së flokëve të mia.

**Grupi 4** Duhet të bind vëllanë që të më lejojë ta përdor biçikletën e tij të re.

**Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Lojë në role

Në dyshe luajmë lojë me role disa situata: Intervistuesi dhe i intervistuari.

a) Sapo u ktheve nga pushimet në Spanjë Ana. Të lutem, të flasim pak rreth vizitës sate atje.

b) Të shtunën u zhvillua olimpiada e matematikës në shkollën tonë. Diskutoni për arsyet e mospjesëmarrjes në të.

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për sjelljet dhe veprimet që respektojnë gjatë të folurit dhe që janë të përshtatshme etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore; Drejtshkrim <b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret s/z-		<b>Situata e të nxënës:</b> Lojë në dyshe Dy nxënës ngrihen para klasës dhe gjejnë emra që fillojnë me s/z nistore. Loja do të zgjasë 5 minuta. Kush nuk mund të gjejë më fjalë s’kualifikohet nga loja. Nxirret fituesi.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloret nistore s/z në fjalët e dhëna;</li> <li>- shkruan saktë fjalët që kanë bashkëtingëlloret z/s;</li> <li>- krijon çifte antonimike me ndihmën e këtyre bashkëtingëlloreve.</li> </ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllore nistore s/z	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit; “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, DDM, Shkrim i lirë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim sfungjer, sfurk etj., skalit, skërfjell, snob, stoik, zbath, zbavit, thoni përdorimin e fjalëve që fillojnë me s/z zgalem, zgavër, zvogëloj Para cilës bashkëtingëllore janë përdorur këto? Nxënësit diskutojnë dhe argumentojnë përgjigjet e tyre.			

<b>Ndërtimi i njohurive të reja: DDM</b>		
<b>Di</b>	<b>Dua të di</b>	<b>Mësova</b>
Bashkëtingëllorja -s përdoret para bashkëtingëlloreve të shurdhëta dhe të tingullta.	A ka raste kur shkrimi i këtyre bashkëtingëlloreve nuk u përgjigjet rregullave drejtshkrimore?	Po. Ka raste kur shkrimi dhe shqiptimi i bashkëtingëlloreve s/z në fjalë të ndryshme ka përjashtim nga rregulli. Kujdes! Në përputhje me shqiptimin më të përhapur, me z- shkruhen edhe foljet: zmadhoj, zmbrops, si edhe fjalët e formuara prej tyre.
Bashkëtingëllorja -z përdoret para bashkëtingëlloreve zëshme.	A ka raste ku bëhet përjashtim?	
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë</b>		
<b>Ushtrimi 1 fq. 170</b>		
<b>Gjeni fjalë të formuara prej foljeve zbavit, zvarrit, zgjat, skalit, zmadhoj, zmbrops. Cilës pjese të ligjëratës i përket secila prej fjalëve të reja?</b>		
Zbavitje, zvarritje, zgjatje, zmadhim, skalitje, zmbropsje. Fjalët e reja të krijuara janë emra të cilët krijohen nga foljet.		
<b>Ushtrimi 2</b>		
<b>Hartoni një tekst për një garë sportive (mbi 100 fjalë) ku të përdorni edhe fjalë që fillojnë me bashkëtingëlloret s dhe z.</b>		
Nxënësit punojnë në krijimet e tyre, duke iu përmbajtur kërkesës që teksti të ketë mbi 100 fjalë dhe 40 prej tyre të fillojnë me këto dy bashkëtingëllore s/z.		
Pas përfundimit të punës, nxënësit shkëmbejnë punimet me njëri-tjetrin dhe bëjnë vlerësimin e tyre.		
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëlloreve nistore s/z dhe për krijimin e çiftëve antonimike gjatë përdorimit të tyre.		
<b>Detyrë shtëpie:</b> Shkruani një tekst të shkurtër me temë “Ëndrrat e mia” ku të përdorni fjalë që kanë bashkëtingëllore nistor -s dhe -z.		

## PLANIFIKIM I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore: Drejtshkrim Tema mësimore. Përdorimi drejt i bashkëtingëllores –j		Situata e të nxënës: Dallo bashkëtingëlloren –j në vargjet e poezisë së Nënë Terezës. JETOJE JETEN... Jeta është një mundësi, kape. Jeta është bukuri, admiroje. Jeta është bekim, shijoj. Jeta është një ëndërr, realizoj. Jeta është një sfidë, përballoje. Jeta është një detyrë përmbushje. Jeta është një lojë, luaje. Jeta është një diamant, kujdesu. Jeta është një pasuri, ruaje. Jeta është një dashuri, gëzoje. Jeta është një mister, zbuloje. Jeta është një premtim, mbaje. Jeta është një trishtim, kaloje. Jeta është himn, këndoje. Jeta është një luftë, fitoj. Jeta është një aventurë, kaloje. Jeta është lumturi, meritoje. Jeta është jetë, mbroje.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloren –j në fjalët e dhëna;</li> <li>- shkruan dhe shqipton saktë fjalët që kanë bashkëtingëlloren –j;</li> <li>- analizon rastet kur fjalët që kanë bashkëtingëlloren –j dalin nga rregulli gjuhësor.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllorja –j
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësi, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Punë në dyshe, Mbajtje e strukturuar e shënimeve, Të nxënës në bashkëpunim

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Punë në dyshe

- Ktheni në trajtën e shquar fjalët: Kala, para, dado, depo, tablo, lagje, paqe.

- Vendos në numrin shumës foljet: laj, blej, fryj, paguaj, lyej. Çfarë ndodh me bashkëtingëlloren –j. Argumento përgjigjen.

- Shkruani trajtën e shquar të emrave të përveçëm: Koço-Koçoja; Pirro-Pirroja; Safo-Safoja; Misto-Mistoja.

- Zgjedhoni foljet laj dhe ndjej në kohën e tashme, mënyra dëftore.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Mbajtje e strukturuar e shënimeve

Nxënësit hapin librat dhe mbajnë shënime të strukturuar, pas shqyrtimit të temës.

Kujdes!!! Jo –j po –I Trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës së tretë (i), kur bashkohet me një trajtë tjetër të shkurtër përemërore ose me pjesëzën *u* përpara foljes: ia hapi zemrën, iu mbush mendja.

Trajtat e gjinore, të dhanores e të rrjedhore njëjës të pashquar, si edhe të emërores njëjës të shquar të emrave që mbarojnë me –o të patheksuar: kallo=kalloja.

Emrat femërore që mbarojnë me zanore të theksuar, përvec –i-se, në të gjitha trajtat, kur zanorja e theksuar ndiqet nga një zanore tjetër: kala-kalaja.

Bashkëtingëllorja –j

Shkrimi dhe shqiptimi i saj

Rregulla

Emrat ku *j*-ja ndërzanore i përket temës, si edhe fjalët e formuara prej tyre  
lloj-lloji, vaj-vajin.

Kujdes!!! Jo –j po –I Trajatat rasore të njëjësit të shquar (me përjashtim të kallëzores), si edhe trajtat e gjinore, të dhanores e të rrjedhore së njëjësit të pashquar të emrave mashkullore, që mbarojnë me –ua ose me –a të theksuar  
Dragua-dragoi; ftua-ftoi

Emrat e përveçëm të tipit: Balo-Baloja; Pirro-Pirroja

\*Shënimet që nxënësit kanë strukturuar diskutohen në klasë me të tjerët dhe ndërtohet një pemë mendimi me to. Pema e mendimit ka një organizues më të plotësuar se ky më sipër, pasi jo të gjitha rregullat janë shënuar në të.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Të nxënës në bashkëpunim

Udhëzohen nxënësit të punojnë ushtrimet e dhëna në tekst. Ndahet klasa në grup heterogjene dhe punojnë ushtrimet.

### Ushtrimin 1 fq. 173

Gjeni fjalë të formuara prej fjalëve *dije, fije, hije, vije, paje*. Cilës klase fjalësh i përket secila prej fjalëve të reja?

<p>Shembull:</p> <p>Dije - dijetar (emër)</p> <p>Fije - fijëzoj (folje) - fijëzim (emër)</p> <p><b>Grupi 1 ushtrimin 2.</b> Gjenerali folje të tjera që në vetën e parë njëjës të së tashmes dëftore mbarojnë me: <i>-aj, -ej, -ej, -ij, -oj, -uj, -yj, -iej, -uaj, -yej</i>.</p> <p><b>Grupi 2 ushtrimin 3.</b> Foljet që gjetët në ushtrimin 2, vendosini në dëftore, lidhore dhe kushtore, sipas shembujve në pikën 7.</p> <p><b>Grupi 3 ushtrimin 4.</b> Qarkoni rastet kur foljet janë shkruar saktë: <i>fryj – fryej; lyj – lyej; paguaj – paguj; shlyj – shlyej; shkruaj – shkruj.</i></p> <p><b>Grupi 4 ushtrimin 5.</b> Qarkoni rastet kur emrat janë shkruar saktë: <i>përroi – përroit – përroit; baba – (nje) babai – (i, e) babait – babain; vëlla – (nje) vëllai – (i, e) vëllait – vëllain.</i></p> <p><b>Grupi 5 ushtrimin 6.</b> Foljet <i>nxë, vë, zë</i>, vendosini në vetën e parë e të tretë shumës të së tashmes dëftore e lidhore dhe në vetën e parë e të dytë njëjës të së tashmes lidhore dhe urdhërore.</p> <p>Pasi nxënësit punojnë me ushtrimet fillojnë dhe bëhen gati në prezantimin e punëve të tyre.</p> <p><b>Diskutim mes grupesh:</b></p> <p><b>*Bëhet dallimi për vetën dhe mënyrën se si janë përdorur foljet e mëposhtme.</b></p> <p>Argumentoni përdorimet e mëposhtme të fjalëve me të zeza.</p> <p>a) Dritani <b>harroi</b> të kalonte nga shtëpia e gjyshes. Mami i tha: “<b>Harroji</b> daljet darkave!”.</p> <p>b) Klasa <b>punoi</b> pasdite vonë për zbukurimin e mjedisit. Miri i punoi me kujdes kurotat e pemëve në kopsht. Kështu <b>punoji</b> edhe ti, Arta.</p> <p>c) Mami <b>zgjoi</b> vetëm Mirën, edhe pse i gjyshja i kishte thënë: “<b>Zgjoji</b> të gjithë”.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -j.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Shkruani një dialog të shkurtër me temë “Unë dhe lajmëtari” në të cilin të përdorni bashkëtingëlloren -h.</p>
---

## PLANIFIKIM I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Tregimet e Eneas</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Fragment nga filmi “Troja”	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për personazhet e Iliadës së Homerit;</li><li>- liston veprimet që ndodhin në fragment sipas renditjes kronologjike;</li><li>- dallon figurat letrare në fragment;</li><li>- analizon personazhet e fragmentit;</li><li>- analizon dhe interpreton gjuhën e tekstit.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Lufta greko-trojane Luftëtarë Çirçe Kamp Sakrifica	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit, “Eneida” e Virgjilit përshtatje		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, qytetari	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëse:</b> VLMD (Veprimtari me lexim dhe mendim të drejtuar), Punë në dyshe, Shkrim i shpejtë			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Rikujtojmë *Nxënësit sjellin ndërmend dhe tregojnë subjektin e “Iliadës”. Iliada, një ndër veprat më të njohura Homerike ngërthen në vete këngët mbi luftën legjendare të Trojës. Sipas legjendës, lufta i ka rrënjët e saj në një gosti perëndish ku nuk ftohet perëndesha e grindjes. Nga zemërimi ajo merr një mollë gdhend mbi të fjalët “Më të bukurës” dhe e hedh atë në mesin e perëndeshave të tjera, Afërditës, Herës, Athinës, të cilat janë të paafta për ta zgjidhur këtë mosmarrëveshje dhe i drejtohen princit të Trojës, Paridit.			

Ai u magjeps nga premtimi i Afërditës për t' i dhënë atij gruan më të bukur, Helenën. Pas kësaj Paridi rrëmben Helenën dhe shënon fillimin e Luftës më gjakatare të Antikës, e cila fillon me rrethimin e Trojës nga grekët. Të udhëhequr nga Agamenoni, Mbreti i Mikenës dhe vëllai i Menelaut (burrit të Helenës), mbreti i Spartës e me prezencën e komandantëve më të shquar grek Akilit, Odiseut, Diomedit, Ajaksit dhe Telamonit bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të rrëzuar Trojën. Mirëpo të gjitha sulmet sprapsen nga Hektori, prijësi i trojanëve. Ndonëse kjo vepër përshkruan vetëm 51 ditët e fundit, shihet qartë dhe shumë lehtë mund të paramendohen viktimat e shumta të kësaj lufte.



Pas pushtimit dhe rrënimit të **Trojës** nga grekët, **Enea**, i mbijetoi masakrave. U largua nga qyteti në flakë duke mbajtur në kurriz *Ankizën* të atin dhe duke marrë me vete gruan, të birin *Askanin* dhe një grup të të mbijetuarve të tjerë trojanë, siç e shikoni në pikturë.

Sipas *Homerit* mbeti atje dhe rithemeloj e mbretëroi një Trojë të re afër *Troadës* në malin *Ida* ku kishte lindur. Sipas një versioni tjetër (shek. VI p.e.s), Enea u largua drejt perëndimit dhe u vendos në Maqedoni duke krijuar qytetin *Aineia*. Versioni më i pranueshëm që hyri pastaj dhe në tradicionin dhe mitologjinë, është ai që u shfrytëzua dhe nga *Virgjili* tek *Eneida*. Sipas këtij version, Enea iku nga Troja për t'u mos u kthyer kurrë më. Udhëtoi drejt perëndimit, në kërkim të një atdheu të ri, duke kaluar nëpër *Thrakë* dhe Butrint. Peripecitë e tij nëpër Mesdhe zgjatën për disa vjet deri sa arriti pastaj në *Lacium*. Gjatë peripecive gruaja dhe babai i tij vdiqën, kurse i biri, Askani, themeloi qytetin *Alba Longa* që më vonë u bë atdheu i *Romulit* dhe *Remit*, themeluesve të Romës.

Poema e Virgjilit, "Eneida", ndjek gjurmët e heroit trojan gjatë rrugës që ai bën për të plotësuar misionin e tij historik, për themelimin e Romës. Përgjatë rrugës, ai dhe shoqëruesit e tij patën shumë aventura, iu desh t'u bënte ballë shumë tundimeve që i viheshin qëllimisht përpara për ta shpërqendruar nga misioni i tij i vërtetë.

#### **Ndërtimi i njohurive të reja:**

#### **Mësuesilja udhëzon nxënësit të punojnë me teknikën VLMD. Mësuesilja lexon pjesën.**

Lexoni pjesën duke u ndalur paraprakisht në pyetjet referuese.

**A.** Jemi në fillim të rrëfimit. Duke kujtuar historitë rreth luftës së Trojës, parashikoni se për çfarë do të na flasë kjo ngjarje? Si mendoni se nis rrëfimi?

Nxënësit do të parashikojnë se nga fundi i luftës greko-trojane. Enea, një luftëtar Trojan së bashku me luftëtarë të tjerë arrin të largohet, kalon një sërë aventurash dhe shumë vështirësi derisa krijon Romën.

**B.** A do të gënjejehet Enea nga kënga e Circes? A përsëritet historia si në rastin e Odisesë?

*Vazhdoni leximin. Vërtetoni parashikimin tuaj, duke parë se çfarë ndodh në të vërtetë.*

Enea nuk u gënjeu nga zëri i ëmbël i Circes. Historia nuk u përsërit. Ata u larguan për në veri, ku dhe ndaluan për të ngrënë e qetësuar.

**C.** Cili do të jetë reagimi i Eneas pas fjalëve plot humor të Julit? Ku e mbështet ai këtë veprim të tijin? Enea u bën me dije trojanëve se tashmë ata janë në atdheun e tyre të ri, Lacioja. Udhëtimi i tyre i gjatë kishte marrë fund tashmë.

**D.** Jemi në fund. Çfarë prisni të sugjerojë Enea? Kujtoni qëllimin e udhëtimit të tij për të parashikuar sa më pranë të vërtetës artistike

*Enea sugjeroi ngritjen e një çadre e cila do të jetë më pas bërthama e një qyteti të ardhshëm.*

Çfarë dini për historinë e Trojës dhe luftën greko-trojane?

Ç'ju kujton personazhi i Circes? Si shfaqet ajo këtu?

Kujt i këndon Circe?

Çfarë synon të arrijë ajo përmes këngës së saj?

Gjeni shprehje dhe veprime që nxjerrin në pah aftësinë e Circes, për të detyruar të tjerët të bëjnë siç dëshiron ajo.

Në qoftë se do të bënim një renditje kronologjike të veprimeve që ndodhin në këtë fragment, cila do të ishte ajo?

**Veprimi 1:** Udhëtimi i anijeve drejt veriut dhe dëgjimi i këngës së Circes.

**Veprimi 2:** Ndalesa e anijeve trojane pranë brigjeve të lumit Tevere dhe drekimi në të.

**Veprimi 3:** Shenja nga Jovi se udhëtimi i tyre i gjatë kishte mbaruar dhe ky vend ishte atdheu i tyre i ri.

**Veprimi 4:** Sistemimi në atdheun e ri dhe dërgimi i mesazheve të paqes nga lajmëtarët e Eneas, fqinjëve të tyre.

**Çfarë nënkupton shprehja atdheun tonë të ri?** Nuk kishte më Trojë, por një vend tjetër ku do të ndërtohej një jetë e re, ashtu si do ta kishin paracaktuar perënditë.

**4. Shkruani disa emra vendesh dhe personazhesh që dalin në këtë pjesë, si dhe detajet që ju lanë gjurmë gjatë leximit të pjesës.**

Emra vendesh	Emra personazhesh	Detaje
Goeta, Kepi i Circes	Odiseja, Circe, Enea	
Ishujt Strofordi, qyteti Laurento, Lacioja		

#### Analizojmë tekstin

**5. Pse trojanët u besuan shenjave paralajmëruese për t'u ndalur në atë vend? Analizoni shenjat që dalin këtu dhe mënyrën se si i interpretojnë personazhet dhe ju si lexues.**

Si t'i interpretoni ju shenjat.	Pak e vështirë që të besojmë dhe të japim gjykimet mbi shenjat e dërguara nga perënditë, pasi besojmë në gjykimet e veprime të vërtetuara shkencërisht...
Si i interpretojnë personazhet.	Sa për hyrje mund të themi se Enea ishte biri i perëndeshës Afërditë. Fati që përcaktoi rënien e Trojës, ka vendosur dhe për shpëtimin e Eneas. Dëshira e tij do të kishte qenë të rindërtonte Trojën, po Zeusi nuk e donte një gjë të tillë, ndaj endi Enean shtatë vjet nëpër detet Egje, Jon etj., dhe e vendosi para shumë peripecive derisa themeloi Romën. Pra, të kthehemi te pyetja si i interpretojnë personazhet shenjat themi se personazhet e dinin se fati i tyre ishte i paracaktuar nga perënditë ndaj tri herë gjëmimi që shkundi qiellin pa re nga Jovi, ishte paralajmërimi se nuk mund të ndodhte ndryshe.

**6. Gjeni pasthirmën e Eneas dhe shpjegoni rolin e saj në rrëfim. Të përshëndes, o tokë, që fati ma ka caktuar!**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe, Shkrim i shpejtë

*Nxënësit punojnë në grupe dyshe.*

**7. Në paragrafin e parë, magjia e ishullit shkëmbor jepet përmes një përshkrimi fantastik.**

Kur kaluan pranë Circeos shkëmbor, ishte natë me hënë të shndritshme. Në qetësinë e detit të argjenditë u dëgjuan të vinin nga toka ulërima luanësh dhe arinjsh, ulërima kërcënuese ujqërish, hungërima derrash të egër që dikur kishin qenë njerëz dhe që magjistarja Circe i kishte kthyer në kafshë.

**8. Gjeni disa epitete që përdoren këtu dhe shpjegoni rolin e tyre për plotësimin e magjepsjes që sjell pamja:** me hënë të shndritshme, qetësinë e detit të argjenditë, ulërima kërcënuese.

#### Interpretojmë tekstin

**9. Dalloni përjetimet e personazheve kur mbërrijnë pranë lumit Tevere. Si shfaqet magjia e lumit dhe e natyrës?**

Dita tjetër filloi së bashku me diellin, qielli i kaltër dhe bregu i gjelbër shtrihej në të djathtë të anijeve trojane, i ndarë më dysh si nga një brazdë e shndritshme: ishte lumi Tevere që derdhej në det. Në brigjet e tij, drurët shekullorë varnin degët e dendura derisa preknin ujin; mes degëve dhe mbi lumë vinin rrotull zogj, thirrjet e të cilëve dukeshin sikur të ftonin...

**10. Pse fjalët e djaloshit Jul ndërpresin në njëfarë mënyre këtë magji?**

**11. Ndaluni dhe analizoni optimizmin që shoqëron paragrafin e fundit.**

**12. Diskutoni rreth mesazhit universal që përcillet në fjalinë e fundit.**

Enea i dërgoi atij njëqind lajmëtarë, të prirë nga një prej njerëzve të tij më besnikë, Ilioni, për t'i çuar një mesazh paqeje dhe aleance.

Enea e dinte fare mirë që mbreti Latini i Laurentos dhe gjithë sa ishin atje nuk do të ishin të kënaqur që dikush po ndërtonte një qytet rreth tokave të tyre, por Enea donte të përcillte mesazhin e një fqinjësie paqësore, besnike dhe aleate për ta.

**Sqarim!!! Ekzistojnë dy variante.**

Sipas një versioni, Latini e pranoi Enean me mirësi dhe ia lejoi që ta ndërtojë qytetin.

Sipas një versioni tjetër u është kundërvënë, por në luftë u mund dhe me të lidhi paqen dhe marrëveshjen për miqësinë.

Të dy versionet pajtohen në faktin se Latini në fund Eneas ia dha grua bijën e vet, Lavininë. Për nder të saj, Enea, qytetin e porsathemeluar e pagëzoi me emrin Lavini. Toka bëhet atdhe vetëm atëherë kur u spërkat me gjak, duke e mbrojtur nga armiku. Enea u bind për këtë së shpejti. Latinët e shikonin me sy të keq se si të huajt po e ndërtojnë qytetin në tokën e tyre. Kjo kaloi edhe në mosmarrëveshje dhe kjo madje në përleshje me armë në dorë. Mbreti i latinëve përpigje që t'i qetësojë njerëzit e vet, por në këtë ndërhyri Rutul Turni, mbret i tokës fqinje, i cili ka pasur arsye për ta urreyer Enenë. Në të vërtetë, ai ishte dhëndri i Lavinisë dhe e konsideronte veten si trashëgimtar të mbretërisë së Latinës. U vendos në krye të latinëve të pakënaqur dhe vendësve të tjerë dhe me ushtri të madhe e sulmoi qytetin e Eneas. Eneas i erdhën në ndihmë etrurët, armiqtë e hershëm të Turnit, ndërsa mbreti i tyre Euandari e solli me vete përveç këmbësorisë të stërvitur mirë edhe njësinë e fortë të kalorësisë. Shpërtheu luftë e ashpër ku ranë shumë latinë. Kur farefisi i tyre e luti Enenë për armëpushim, iu përgjigj se nuk do të luftojë me latinët, po që se kjo duhet kështu të jetë, por do të luftojë me Turnin. Kështu e detyroi Turnin të pranojë dyluftimin në të cilin edhe e vrau. Pas ngadhënjimit mbi Turnin, Enea e zgjeroi qytetin e vet dhe e përzjeu popullin e vet me latinët. Prej tyre doli populli romak, i cili emrin e vet e ka marrë sipas qytetit të cilin më vonë e themeluan pasardhësit e Eneas, Romuli dhe Remi. Sa ka zgjatur sundimi i Eneas në atdheun e ri nuk dihet, ndërsa për vdekjen e Eneas ka shumë versione. Sipas njërit, ai është vrarë në betejën me Rutulin ose me etrurët, ndërsa sipas tjetrit është ngjitur në qiell me armatimin e plotë. Versionet e tjera janë të përhapura më pak mirëpo pajtohen në një gjë: që më në fund ai u bë zot.

**Gjuha e tekstit****13. Shkruani nga një fjalë përmbledhëse për secilin paragraf.**

Fjalitë përmbledhëse janë të shkruara te veprimet sipas rendit kronologjik.

**14. Shpjegoni me fjalët tuaja kuptimin e shprehjes “po hamë edhe pjatat”.**

Kur je shumë i uritur nuk vë re se çfarë cilësie ka ushqimi, por vetëm sasinë e tij. Në këtë rast është pak ndryshe, pasi pjatat u sajuan me material të ngrënëshëm.

**15. Cili është kuptimi i numërorit 100 (lajmëtarë)?**

Kuptimi i parë është ai i sasisë, kuptimi i figurshëm është ai i simbolit.

Gjeni shprehjet frazeologjike në paragrafin e tretë dhe shpjegoni rolin e përdorimit të tyre. Zëvendësojini këto shprehje me një fjalë të vetme.

Nxënësit do të reflektojnë rreth fragmentit të dhënë me një shkrim të shpejtë me temë: *Çfarë mësuat rreth Eneas dhe historisë së aventurës së tij.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për: të kuptuarit e tekstit, analizën e personazheve të fragmentit, interpretimin e përjetimeve të personazheve dhe analizës së gjuhës së tekstit etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një ngjarje personale në të cilën jeni protagonist i një udhëtimi të bukur.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: GJUHE SHQIPE	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Të lexuarit		Situata e të nxënës: Lexohen fragmente nga përralla “Gërzhetat”	
Tema mësimore: Martesa e Floçkës			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
- Kompetenca e të menduarit			
- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Floçka	
- dallon karakteristikat e personazhit kryesor të përrallës, Floçkës;		Mbreti	
- përshkruan personazhin e Floçkës;		Bukuri e rrallë	
- krahason personazhin e Floçkës me atë të Prometeut.		Shpirt i ndjeshëm	
		Kërkesa	
		Martesë	
		Prometeu	

Burimet:	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Parashikim me terma paraprakë, Tabela M, Diskutim, Punë në dyshe</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Parashikim me terma paraprakë</p> <p><b>Vajzë e bukur, mbret, shpirt i ndjeshëm, martesë, kërkesë.</b></p> <p>Nxënësit me fjalët e dhëna do të ndërtojnë një përrallë. Pas leximit të saj do të shohim nëse ata kanë parashikuar saktë ato çfarë ndodhin në përrallë. Vlerësohet parashikimi më i mirë, pasi lexohen disa nga punët e nxënësve.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Tabela M, Diskutim</p> <p><b>Punojmë me nxënësit rubrikën “Të kuptojmë tekstin”</b></p> <p><b>Kush është floçka?</b></p> <p>Floçka Nersana është figurë e besimeve popullore që përfytyrohej si një vajzë e bukur që jetonte në lumenj e liqene.</p> <p><b>A mund të gjeni një emër tjetër për të?</b> Gërsheta ose çdo emër tjetër që nxënësit do të mendojnë që lidhet kryesisht me këtë personazh.</p> <p><b>Cilat ishin disa nga vetitë e Floçkës dhe cilën prej tyre do të veçonit?</b></p> <p>Si veçanti fizike të Floçkës do të veçonim bukurinë e saj. Si tipar moral, Floçka është një personazh me shpirt të ndjeshëm.</p>	
Tri kërkesat e Floçkës	Mendimi i Të Urtëve për secilën kërkesë
1) Nuk mund të martohem, pa gjetur mënyrën si t'ua lehtësoj dhembjet qenieve të gjalla.	Ëndërr sa e bukur, aq dhe e pamundur.
2) Njerëzit të mos ndiejnë dhimbje ditën tonë të dasmës.	Kjo është një marrëzi.
3) Të martohemi në mesditë nga ora 12:00-13:00 dhe në këtë kohë të mos ketë vend të njerëzit dhimbja dhe pikëllimi, po vetëm lumturia dhe gëzimi.	Kërkesa u realizua.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë rubrikën “Analizojmë tekstin”.


**Shpjego disa nga karakteristikat e përrallës që i ndeshim këtu.**

- Kalimi nga e pamundura tek e mundur. Pas dy kërkesave të pamundura për t'u realizuar nga Të urtët e Oborrit, në kërkesën e tretë ata e realizuan. Gjithashtu numri tre është një element numerik që ndeshet shpesh në përralla.
- Vendi ku zhvillohet pjesa është imagjinar. Floçka jetonte në Përroin e Virgjërshave.
- Fundi i lumtur; dëshira që realizohet.

**Më poshtë janë renditur disa veprime të personazhit kryesor. Shkruani në krah shembullin nga teksti që lidhet me atë veprim.**

- 1- Personazhi ecën duke shëtitur në pyll.
- 2- Personazhi mahnitet me bukurinë e Floçkës dhe i kërkon menjëherë asaj të martohen.
- 3- Personazhi përqendrohet në dëshirën e saj për t'i parë njerëzit e lumtur.
- 4- Personazhi vepron duke mbledhur të Urtët e Oborrit.
- 5- Personazhi kalon hap pas hapi duke paraqitur kërkesa të njëpasnjëshme dhe të përshtatshme.
- 6- Personazhi vë kushte: Unë nuk mund të martohem pa gjetur mënyrën si t'ua lehtësoj dhembjet qenieve të gjalla. Po ma plotësove këtë dëshirë unë do të bëhem gruaja jote.
- 7- Personazhi fiton. Vë kurorë në mesditë në orën 12:00-13:00 dhe në këtë kohë në zemrat e njerëzve kishte vetëm gëzim e lumturi. Dëshira e saj u realizua.

Si kombinohen te ky personazh bukuria fizike me atë shpirtërore? Po zgjuarsia? Në ç'raporte qëndrojnë ato te Nersana?



Të tria qëndrojnë në një vijë horizontale. Është po aq e bukur në fizik, në shpirt, sa dhe e zgjuar.

*Gjuha e tekstit*

Gjeni fjalët që tregojnë bukurinë e jashtëzakonshme të Nersanës.

*Ishte më e bukura e floçkave.*

*Mbreti i ri u habit aq shumë kur e pa...*

**Si mund ta titullonit ndryshe këtë përrallë?**

*Për këtë pyetje do të ketë përgjigje nga më të ndryshme. Mësuesilja udhëzon nxënësit që të risjellin ndërmend ngjarjet para se të riformulojnë një titull.*

*Disa tituj mund të jenë: “Floçka zemërmirë”, “Kërkesat e një floçke” etj.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Punë në dyshe*

*Mësuesilja udhëzon nxënësit të punojnë në dyshe për të krahasuar figurën e Floçkës me atë të Prometeut.*

Floçka u bën një dhuratë të vyer njerëzve. Vetëm në këtë gjë ajo ngjan me një hero mitologjik, të cilin ju e keni ndeshur edhe më parë në rrëfime apo filma. Ky është Prometeu, heroi i mitologjisë greke. Plotësoni tabelën:

	Dhurata që u bëri njerëzve.	Çfarë ndodhi me secilin prej tyre.	Si e përjetoni ju historinë e secilit prej tyre.
Floçka	Gëzim dhe lumturi	U ndje e plotësuar për atë çka bëri për njerëzit dhe mbajti premtimin duke u martuar me Mbretin e ri.	Plot emocione pozitive duke mësuar se duhet të jemi të pakursyer për të falur sa më shumë dashuri te të tjerët.
Prometeu	Zjarri	U ndëshkua nga Zeusi me vuajtje të mundimshme e të përsëritshme.	Plot dhimbje për fatin e heroit

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për analizën dhe krahasimin që e personazheve, krahasimit të floçkës me Prometeun etj. Vlerësohen nxënësit për punimet e bëra.

**Detyrë shtëpie:** Përrallat zakonisht kanë funde të lumtura dhe zgjidhin gjithmonë konfliktet mbi të cilat ndërtohen. Si paraqitet fundi dhe zgjidhja në përrallën tonë? Shkruani një mbyllje tjetër për përrallën.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Bota sipas miteve</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Miti (Diskutim me nxënësit)	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- ritregon mitin bazuar në frazat kyçe;</li><li>- dallon ndërtimin e subjektit të pjesës;</li><li>- analizon elementet reale dhe fantastike të pjesës;</li><li>- dallon në fragment paragrafët rrëfimtari të shpjegimit dhe paragrafët e përshkrimit.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Mit Elemente reale Elemente fantastike Paragrafë rrëfimi, shpjegimi dhe përshkrimi	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, literaturë e përshtatur për mitologjinë greke e romake, libri “Bota e Sofies”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> filozofi, histori	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Punë në dyshe, Pemë mendimi, Punë individuale, Diskutim, Lëre fjalën e fundit për mua</i>			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Punë në dyshe ose Pemë mendimi</i>			
<b>1. Kemi folur dhe më parë për mitin. Listo karakteristikat e miteve. Nxënësit punojnë në dyshe.</b> 1) Forma më e thjeshtë tregimtare. 2) Origjina e fjalës vjen nga greqishtja që do të thotë rrëfim. 3) Lidhen me traditat. 4) Lloj i letërsisë gojore 5) Ka të bëjë me shpjegimin naiv të botës.			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> <i>Punë individuale</i> Udhëzohen nxënësit të punojnë me rubrikën “Kuptojmë tekstin”.			
<b>2. Pasi të lexoni pjesën, ritregoni mitin bazuar në frazat kyçe:</b>			
<b>3. Si e shpjegon filozofi mitin?</b> Një interpretim i mundshëm do të ishte ky: 1) Kur ishte thatësirë, njerëzit kërkonin një shpjegim se përse nuk binte shi. Kjo mund të ndodhte, sepse gjigantët kishin vjedhur çekanin e Torit. 2) Mund të mendohet se miti provon të shpjegojë se pse ndryshojnë stinët. Në dimër natyra vdes, sepse çekani i Torit është në Jotunheim. Por në pranverë ai arrin që ta marrë përsëri. Kështu, miti kërkon që t’u japë njerëzve përgjigje për diçka që ata nuk e kuptojnë.			
<b>4. Si reflektoi Sofia pas shpjegimeve të filozofit?</b> <b>Për të kuptuar qëndrimin e Sofies marrim parasysh fragmentin e mëposhtëm. Vëmë re që Sofia fillimisht është konfuze për natyrën e miteve, më pas ajo fillon reflekton.</b> <i>Sofia qëndroi gjatë duke shëtitur nëpër kopshtin e madh. A ishte ajo në gjendje të gjente ndonjë lloj shpjegimi se pse një ditë mund të binte papritur shi? A mund të punonte me fantazi për të shpjeguar se ku shkoi dëbora dhe pse dielli qëndron në qiell?</i> <i>Ajo e kuptonte se njerëzit gjithmonë kishin pasur nevojë për të gjetur shpjegime lidhur me fenomenet natyrore. Ndoshta ata nuk mund të jetonin pa këto shpjegime. Kështu që kishin bërë mitet në atë kohë që nuk njiheshin shkenca.</i>			
<b>Analizojmë tekstin</b>			
<b>5. Cila është e veçanta e ndërtimit të subjektit të kësaj pjesë?</b> Nuk është një subjekt i zakonshëm si pjesët e tjera narrative. Autori, përmes bashkëbisedimit të Sofisë me narratorin e romanit filozofik na paraqet mitin më të njohur në Norvegji, i cili ka të bëjë me marrjen e çekanit të Torit nga gjigantët. Pra miti na shfaqet në këtë pjesë si një rrëfim, brenda një rrëfimi tjetër.			

**6. Në këtë pjesë gjejmë elemente reale dhe fantastike. Cilat janë ato?***Vendet reale: Norvegji**Vendet fantastike: Jotunheim**Personazhet mitologjike: Tori, Froja, Loke**Personazhet reale: Sofija, filozofi**Objektet fantastike: Krahët e Frojas, çekani**Veprimet fantastike: fluturimi me krahët***Gjuha e tekstit**

Gjatë realizimit të kësaj rubrike mund të zhvillohet një diskutim i organizuar në klasë, ku secili nxënës të shprehë dhe të mbrojë mendimin e tij.

**7. Në këtë pjesë vendin më të madh e zë:**

rrëfimi?

shpjegimi?

përshkrimi?

Për nxënësit mësuesi/ja sqaron veçoritë e çdo lloj paragrafi.

**Paragrafi tregues/rrëfimi PRR** - Tregohet një histori apo ngjarje nga jeta e shkruarit.**Paragrafi shpjegues PSH** - jepen shpjegime për një send, ngjarje etj.; ose jepen informacione për to. Në të përfshihen fakte që i nevojiten lexuesit për ta kuptuar subjektin.**Paragrafi përshkrimi PP** - Përshkruan një person, vend, ngjarje ose send. Për të shkruar një paragraf të tillë, përdoren fjalë që e ndihmojnë lexuesin të shikojë, dëgjojë, ndjej a shijojë objektin e përshkrimit.**8. Ilustroni me paragrafët përkatës secilën prej këtyre mënyrave tregimtare.**

**PRR:** Perënditë e mira ndodhen në një situatë shumë të vështirë. Gjigantët kanë tani në zotërim armën e tyre më të fuqishme dhe kjo është një situatë e papranueshme. Për sa kohë gjigantët kanë në dorë çekanin e Torit, ata kanë fuqi mbi perënditë dhe njerëzit në tokë. Në këmbim të çekanit, ata kërkojnë Frojan.

**PSH:** Por një këmbim i tillë është i pamundur. Nëse perënditë do ta dorëzonin perëndeshën e pjellorisë, e cila mbron gjithë jetën, bimët do të zhdukeshin nga toka dhe perënditë e njerëzit do të vdisnin. Situata është pa rrugëdalje.

**PP:** Po të lidhte flokët dhe të vinte dy gurë në gjoks, ai do të ngjante si grua.

Gjatë festës nusja (Tori) hëngri një ka të tërë dhe tetë salmonë. Ai piu gjithashtu tri fuçi me

birrë. Kjo e futi në dyshime Trymin dhe “komandot” për pak sa nuk u zbuluan.

Këtu ndërhyr Loke dhe thotë se nusja, ngaqë mezi priste të martohet, nuk kishte ngrënë tetë ditë, prandaj ishte e uritur.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

*Reflektojmë rreth tekstit “Lerë fjalën e fundit për mua”.*

**9. Tregoni një mit që njihni dhe shpjegojeni sipas mendimit tuaj. Në rast se nxënësi nuk mban mend asnjë mit, mësuesi/ja shpërndan fisha ku ka të shkruara mite dhe nxënësit do të nxiten ta ritregojnë atë pas leximit dhe mbi të gjitha do të shpjegojnë atë sipas mënyrës së tyre.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të kuptuarit e tekstit, analizës së personazheve, dallimin e paragrafëve etj.

**Detyrë shtëpie:** Ç’informacion keni për besimin e hershëm të popujve të mitet? Sillni shembuj konkretë nga mitologjia shqiptare ose ajo botërore. Më pas bëni krahasimet me shpjegimin që jep shkenca lidhur me dukurinë. Nxirrni konkluzionet tuaja rreth evoluimit të besimeve në kohë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Drejtshkrim</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores -h</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Me nxënësit zhvillohet një lojë. Për 5 minuta të ndarë në dy grupe do të shkruani sa më shumë fjalë që kanë bashkëtingëlloren –h në fillim, në mes dhe në fund të fjalëve. Shtet, Qytet, Fshat, Kafshë Emër vajze, Emër Djali, Kujdes shkrimin dhe shqiptimin e bashkëtingëllores !!!	

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe		
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare		
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloren –h, në pozicionet ku ajo ndeshet në fjalët e dhëna;</li> <li>- shkruan saktë fjalët që kanë bashkëtingëlloren –h në fillim, në mes dhe në fund të saj.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllorja -h	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Shkrim i shpejtë, DDM, Punë në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Shkrim i shpejtë Ndërto një tregim të shkurtër jo më shumë se 10 fjali ku të përdorni bashkëtingëlloren -h në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Pas përfundimit të kohës disa nga nxënësit lexojnë dhe shqiptojnë drejt bashkëtingëlloren -h në fjalët që e përmbajnë atë. Mësuesi/ja tërheq vëmendjen në rastet kur nxënësit gabojnë. Varianti 2: Ktheni në formën joveprore foljet e mëposhtme: Bëj-bëhem-bëhesha Laj-lahem-lahesha Kthej-kthehem-kthehesha Shtyj-shtyhem-shtyhesha Formo fjalë të prejardhura sipas modelit: Hap-i hapur-hapje Njoh-i njohur-njohje Ftoh-i ftohur-ftohje Ngroh-i ngrohur-ngrohje Ndërtimi i njohurive të reja: DDM		
DI	DUA TË DI	MËSOVA
Bashkëtingëllorja –h ndodhet në fillim të fjalës, në fund të saj dhe në mes.	A ka rregulla të ngurta që nuk lejojnë që kjo bashkëtingëllore të mos përdoret në këto pozicione?	1) Shkruhen me <i>h</i> - në fillim të fjalës, fjalët: <i>ha, habit, hale, hap, harabel, hardhi.</i> Në këtë ndarje hyjnë edhe fjalë të burimit turk, si: <i>haber, hayat, hajdut.</i> 2) Shkruhen me <i>-h</i> në fund të fjalës: foljet e tipit: <i>fshëh, ftoh, mpërëh, ndih, ngreh, njoh, rrah, shkreh, shoh</i> etj., në të gjitha trajtat e zgjedhimit të tyre: <i>fshëh, fshëhim, fshihni</i> emrat, si: <i>ah, gjah dhe trajtat e lakimit të tyre.</i> Shkruhen me <i>-h</i> në mes të fjalës: trajtat pësore-vetvetore të foljeve me temë që mbaron me zanore: <i>lahem,</i> <i>lahesh...; lahesha</i> foljet, si: <i>dihas, gërhas</i> emrat dhe mbiemrat, si: <i>grahme, krehër.</i>
	Kam dëgjuar që disa fjalë si harushë, vehtja, heci, shkruhen dhe shqiptohen me <i>-h</i> . A është i saktë ky përdorim?	Kujdes! Përdorimi në shkrim e shqiptim i bashkëtingëllores <i>-h</i> në këto raste është i gabuar. Kujdes rregullin !!! Nuk shkruhen me <i>h</i> - fjalët: <i>arushe, avaz, avlli, eci, iki, yll, vete, vetja, vete</i> dhe formimet prej tyre: <i>përvetësor,</i> <i>vetvete, vetvetor.</i>

**Tabela plotësohet nga nxënësit dhe mësuesit/ja në rastet kur ka nevojë për sqarimin e saj.**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Ushtrimi 1** punohet nga të gjithë nxënësit.

**Ushtrimi 2** punohet me ndihmën e mësuesit/es dhe të Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe.

Gjeni në fjalor shpjegimin e foljes *harr* dhe të emrave *hikërr, haliç, harxh, hase, hasëll, moh, pah, i lehtë, nahije*.

Diskutoni rreth përdorimit të tyre në ditët e sotme.

Shembull:

Harr – shkul, heq, pastroj barërat e këqija nga të lashtat; harr arën, kopshtin

Hikërr – qumësht i prerë, hirrë

Haliç – gur i vogël, copë e vogël guri, gjëra të hedhura, mbeturina; Humbi si meli në haliç.

Harxh – ushqimet që blihen për t'u përdorur për një kohë të caktuar, për një festë; shpenzime.

Hase – kambrik, çarçaf haseje.

Hasëll – tërshërë a elb a thekër që mbillet në fund të verës, në fund të vjeshtës ose në pranverë dhe përdoret si ushqim i njomë për bagëtinë, mbjellë me hasëll.

Moh – mohim, i ra moh – mohoi diçka që ka thënë.

Pah – pjesa shumë e imët e miellit që ngrihet si pluhur gjatë bluarjes; zbokth; pamje e jashtme; paraqitje

I lehtë – që ka peshë të vogël e rëndon pak. Kjo fjalë ka 17 kuptime në fjalorin e gjuhës shqipe.

Nahije – krahinë, anë, nënndarje administrative që përfshinte disa fshatra në kohën e pushtimit osman në Shqipëri; komunë.

**Ushtrimi 3. Formoni fjalë me çiftet e fjalëve të mëposhtme:**

*Herë – erë; ndiej – ndihej; arkë – bark; ata – bata; hënë – e hënë.*

**Punohet ushtrimi nr 4 fq. 174. Hartoni një tekst (me mbi 100 fjalë), ku të përdorni dhe fjalët:** *hov, hije, habit, humbas, hoje, ftoh, ftohje, hënë, krah, hardhi, fsheh, gjah, gjahtar, ngrihej, shoh, rrah, shkreh, i zbehte, ndihesha, hutoj, hyj, harroj, hingëllimë.*

*Udhëzohen nxënësit se nëse nuk mund ta mbarojnë në klasë ushtrimin, ta përfundojnë në shtëpi për ta diskutuar orën tjetër.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëllores –h në fillim të fjalës në fund të fjalës dhe në mes të saj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një dialog të shkurtër me temë “Djali dhe Hëna” në të cilin të përdorni bashkëtingëlloren –h.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Drejtshkrim</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Përdorimi i drejtë i fjalëve që kanë bashkëtingëlloren –rr</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Gjej emra njerëzish, vendesh dhe kafshësh që fillojnë me –rr. Nxënësit diskutojnë duke u argëtuar.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloren –rr në fjalët e dhëna;</li><li>- shkruan saktë fjalët që kanë bashkëtingëlloren –rr.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllorja -rr	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Punë në dyshe, Tabela INSERT, Punë individuale</i> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Punë në dyshe</i> Lojë: Udhëzohen nxënësit që për 5 minuta në dyshe të shkruajnë sa më shumë fjalë që kanë bashkëtingëlloren -rr në to. Dvshia që ka shkruar më shumë fjalë del fituese.			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Tabela INSERT

Udhëzohen nxënësit që do të punohet me tekstin për të plotësuar tabelën INSERT.

<i>Njohuritë që i ka marrë më parë</i>	<i>Njohuritë e reja që shtohen këtë orë</i>	<i>Njohuritë që i di, por jo të sakta</i>	<i>Njohuritë e reja që merr dhe nuk i kupton</i>
<b>V</b>	+	-----	?
Në rastet më të shumta bashkëtingëllorja –rr kur ndodhet në trup dhe në fund të fjalës	<i>-rr në fillim të fjalës:</i> emrat: rradake, rrap mbiemrat: I rrallë foljet: rrëfej ndajfoljet: rrotull <i>-rr në mes të fjalës:</i> emrat: bërryl, burrë mbiemrat: I pjerrët foljet: gërryej, turrem ndajfoljet: kurrë pasthirrma: urra! <i>-rr në fund të fjalës:</i> emrat: derr, zjarr foljet: marr, korr		

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

Nxënësit punojnë dhe përgjigjen në mënyrë të pavarur për ushtrimet 1, 2 dhe 3.

*\*Është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të përgjigjen në mënyrë që realizojnë shqiptimin e bashkëtingëllores –rr në mënyrë të drejtë.*

*rregull, rrebesh, i rrallë, rrëshqas, rri, rrëshirë, arrë, bërryl, curril, korr, korrik, kërrabë, urrej, dërrasë, dërrmoj, kurrë, ngatërroj, urra!, zjarr, oborr, rrotë, rrokje, mëshqerrë, rrëfej, rrëfim, sharrë, thërrime, shkurre, tmerr, ëndërr, zhavorr, i rrezikshëm, mburrem, rrethim, marrëveshje, korrje, thirrore, rreze, rrugë, rrush, rrethoj, sharroj, rremb, turravrap, tjerres, thirrje, ndërresë, manaferrë, shndërroj.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -rr.

**Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 4. Formoni fjali me çiftet e fjalëve të mëposhtme:

*rase – rrase; deri – derri; birë – birrë; arrë – arë; urë – urra!; kor – korr; korije – korrje; resht – rresht*

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Mite dhe paragjykime		Situata e të nxënit: “Besëtytnia është pjesë e natyrës humane, kur mendohet se e kemi dëbuar plotësisht, ajo në të vërtetë fshihet në qoshet dhe skajet më të paimagjinueshme, nga të cilat edhe del”. Diskutoni rreth thënies së Gëtes e cila, megjithëse e shkruar në shekullin XVII, ajo është aktuale dhe në ditët e sotme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca digjitale</div>			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon mite që ka dëgjuar ose lexuar;</li> <li>- diskuton rreth miteve dhe paragjytimeve;</li> <li>- argumenton mendimet e tij/saj rreth të vërtetave të miteve dhe paragjytimeve.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Paragjykim Mit Besëtytni
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bashkëbisedim, Punë me grupe dyshe, Rrjet diskutimi</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim</p> <p>Tregoni mite të tjera të lexuara apo të dëgjuara që lidhen me: kafshët, veshjet, ngjyrat, ditët, paratë, numrat, ushqimin, objektet.</p> <p>Konotacionet negative, të cilat i lidhim me numrin 13 kanë shpjegim nga disa teori. Njëra ndër to i ka rrënjët te tradita e krishterë. Apostull Juda, i cili e tradhtoi Krishtin, ishte i trembëdhjeti në Darkën e fundit.</p> <p>Frika nga numri 13 lidhet edhe me një mit norvegjez. Në fakt, në vendin Valhala, 12 perëndi ishin mbledhur për t'u argëtuar, ku u paraqit mysafiri i 13-të, i paftuar, Loki shpirtkeq, i cili shkaktoi kaos në mesin e perëndive. Për këto dhe shkaqe të tjera, numri 13 shkakton njëfarë frike në tërë botën. Disa shkencëtarë thonë sesi 80% e rrokaqiejve në botë nuk e kanë katin e 13-të, hotelet dhe spitalet nuk e kanë dhomën nr. 13, shumica e aeroporteve nuk ka dalje 13 në pistë etj.</p> <p>Në Kinë, numri 7 konsiderohet si me fat, pasi ngjan me fjalët kineze “ngrihem” dhe “jetë”. Ajo është simbol i bashkimit dhe si rrjedhojë, është parë si një shenjë e mirë në marrëdhënie. Numri 6 paraqet njerëzimin, rrjedhimisht, 7-a shihet si qendra e njerëzimit dhe si lidhja e njeriut me krijuesin. Po ashtu, ai është numri i universit dhe kombinon qiellin, i cili në mënyrë tipike simbolizohet nga numri 3, me tokën, e cila lidhet me 4-ën. Po ashtu, numri 7 shfaqet shpesh në kulturë dhe histori. Për shembull, janë shtatë mrekulli të botës, shtatë ditë të javës, shtatë rrathë të universit, shtatë mëkate dhe shtatë nota bazë muzikore. Në fenë budiste, shtata është numri i ngritjes dhe thuhet se Buda ka bërë shtatë hapa pas lindjes. Ndërsa për krishterimin, Zoti përfaqësohet nga rrethi i shtatë, i cili ndodhet në qendër të shtatë rrathëve të krijimit. Sipas traditës hebraike, shtata është numri i inteligjencës, ndaj ka shtatë Ditë të Shenjta në vitin hebraik.</p> <p><b>Mite për ngjyrat</b></p> <p>Ekzistojnë edhe disa mite rreth ngjyrave të fustaneve gjatë ceremonisë martesore, mendohet se fustani i bardhë tregon se nusja ka bërë zgjedhjen e duhur, i ziu tregon se dëshiron të kthehet prapa, për paradoks te disa kultura ekziston miti se fustani i kuq tregon se nusja e dëshiron veten të vdekur.</p> <p><b>Për kafshët</b></p> <p>Mit: Macet kanë nevojë për qumësht.</p> <p>Miti që ka ekzistuar për një kohë më të gjatë është nevoja e maces për qumësht dhe është një mit i gabuar. Duke i dhënë maces suaj qumësht lope mund t'i shkaktoni asaj diarë. Kotelet pinë qumështin e nënave të tyre deri sa rriten, dhe ndoshta kur vjetërsohen mund të pëlqejnë shijen e qumështit të lopës. Por macet e rritura nuk kanë shumë laktozë, një enzimë e nevojshme e nevojshme për to.</p> <p>Bashkëbisedohet me nxënësit duke ndarë mitet nga faktet.</p> <p><b>Bëni komentet tuaja rreth paragjytimeve (besëtytnive) të mëposhtme.</b></p> <p><b>Shumë njerëz thyerjen e pasqyrës e lidhin me një fatkeqësi.</b></p> <p>Në Greqinë e Lashtë e ardhmja e një personi ‘parashikohej’, duke analizuar reflektimin e tij në pasqyrë dhe një pasqyrim i shpërfytyruar nuk ishte shenjë e mirë, ndërsa romakët i shtuan edhe shtatë vite telashe, një periudhë nëpër të cilën personi që ka thyer pasqyrën do të kalonte nëpër cikle të alternuara sëmundjesh.</p> <p>Ekziston një besim i përhapur sesi pasqyra e thyer sjell shtatë vjet të fatit të keq. Ka disa shpjegime për këtë, ku njëri ndër ta thotë se pjesëzat e pasqyrës së thyer mund ta robërojnë shpirtin. Mendohet se, me thyerjen e pasqyrës, thyhet edhe shpirti. Në disa kultura, kur të vdesë dikush, mbulohen të gjitha pasqyrat në shtëpi, në mënyrë që shpirti i të vdekurit të mund të largohet pa probleme.</p> <p>Shumë njerëz nuk udhëtojnë të premtën.</p> <p>Sa i përket së premtës, ajo konsiderohet një ditë ters të paktën që prej shekullit XIV. Gjithashtu e premtë ishte edhe dita e kryqëzimit të Jezu Krishtit. Megjithatë, ka autorë që thonë se të gjitha referencat për “tersin” e së premtës nuk ekzistojnë para vitit 1907.</p> <p><b>Shumë njerëz mendojnë se është ters të ta presë rrugën një mace e zezë.</b></p> <p>Është e lidhur me periudhën e Mesjetës. Macet vriteshin, pasi konsideroheshin si kafshë të shtrigave.</p> <p>Shumë njerëz mendojnë se qyqja që këndon në dritare, sjell fatkeqësi.</p>	

Gjetja e një patkoi në rrugë sjell fat.

Mbajtja e një kali/peshku në shtëpi sjell fat.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë me grupe dyshe

**Lexoni pohimet, jepni mendimin tuaj dhe shënoni + në tabelë.**

<b>Pohimet</b>	<b>PO</b>	<b>JO</b>
Ka shumë njerëz që besojnë te parandjenjat.	+	
Parandjenjat janë të rrezikshme, sepse ato i ndalojnë njerëzit të njohin shkencën.		+
Parandjenjat janë një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore. Për të zgjidhur një problem.		+
Për të zgjidhur një problem, duhet t'u drejtoheni zakoneve popullore.		+
Mosrespektimi i parandjenjave sjell fatkeqësi.		+

**Nxënësit japin argumentet e tyre. Ata vlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna.**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Rrjet diskutimi

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe. Shpërndan fishat me çështjet që do të diskutohen.

**Grupi 1)** Keni veshje që i konsideroni fatsjellëse?

Mendoni se një nga ditët e javës është pa fat?

**Grupi 2)** Keni ndonjë numër që nuk e pëlqeni?

Mendoni se disa ngjyra sjellin fat?

**Grupi 3)** Mendoni se disa ngjyra sjellin fat?

Në rast se ju vjedhin diçka, e quani veten pa fat?

**Grupi 4)** Në rast se ju vjedhin diçka, e quani veten pa fat?

Keni ndonjë kafshë që nuk ju sjell fat?

Nxënësit japin argumentet për çështjet në fjalë.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për mënyrën sesi tregojnë mite, për logjikën e diskutimit dhe argumentet e dhëna rreth çështjeve të shtruara.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruaj një objekt që e ruan në shtëpi si fatsjellës.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Urtësia njerëzore</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Histori njerëzore = Cikël jetësor	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon idenë kryesore që përshkruan pjesën;</li><li>- analizon thelbin e ciklit jetësor;</li><li>- argumenton veprimet e personazheve duke u nisur nga këndvështrimi i tij.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Urtësi njerëzor Cikël jetësor Akademikë Mbret i Persisë Dijetar	
<b>Burimet:</b> Teksti i nxënësit, vepra të A. Francit si Nobelist i vitit 1921		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Parashikim me anë të titullit, Të nxënët në bashkëpunim, Shkrim i lirë

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Parashikim me anë të titullit

Kur dëgjoni titullin e pjesës “Urtësia njerëzore” çfarë mendoni se do të lexoni? Nxënësit japin parashikimet e tyre duke argumentuar përgjigjet.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënët në bashkëpunim

**Nxënësit punojnë me të kuptuarit e tekstit.**

Cila është kërkesa e princit Zemir ndaj akademikëve të Persisë?	Ju urdhëroj të hartoni historinë botërore, pa lënë kurrgjë pas dore, me qëllim që të jetë sa më e plotë.
Pse mbreti ua ktheu mbrapsht punën akademikëve herën e parë?	Pas 20 vjetësh ata dorëzuan te mbreti 6000 mijë vëllime ku kishin përmbledhur historinë njerëzore.
Sa vite punuan ata herën e dytë?	Punuan 20 vite të tjera dhe dorëzuan 1500 vëllime.
Sa vëllime dorëzuan ata herën e tretë?	Punuan dhe 10 vite dhe dorëzuan 500 vëllime.
Çfarë u kërkonte vazhdimisht mbreti i pakënaqur?	Të përmbledhnin sa më shkurt historinë njerëzore.
Cila ishte forma përfundimtare e punës së kryer?	Thënia me tri fjalë e historisë njerëzore  <i>Njerëzit lindin, vuajnë dhe vdesin në fund.</i>

**Klasa ndahet në grupe të cilave u shpërndahen fisha rreth çështjeve:**

**Analizojmë tekstin**

**Grupi 1** Gjeneri në tekst fjalitë në të cilat veprimet përsëriten. Si i shërben autorit kjo përsëritje lidhur me idenë kryesore të pjesës?

Ju urdhëroj të hartoni historinë botërore, pa lënë kurrgjë pas dore, me qëllim që të jetë sa më e plotë.

Njëzet vjet më pas u paraqitën tek ai, pasuar nga një karvan me dymbëdhjetë deve, secila ngarkuar me pesëqind vëllime.

Ju lutem, hartoni për mua një përmbledhje të tërë kësaj pune për shoqërinë njerëzore.

E përmbledhni edhe më, zotërinj, edhe më, e sa më shpejt. Edhe nuk u vonuan shumë, vetëm dhjetë vjet të mira, sa më në fund u paraqitën sërish te mbreti me një almet elefanti ngarkuar me pesëqind vëllime.

Shkurtojeni, shkurtojeni sërish.

Sekretari i përgjithshëm u shfaq rishtas në pallatin mbretëror pas pesë vjetësh me një libër goxha të trashë.

Me tri fjalë po jua përmbledh unë tërë historinë e njerëzve:

Ata lindin, vuajnë, vdesin!

**Grupi 2** Rendit fushat e njohurive që përmbledheshin në veprën e akademikëve: gjeografi, histori, diplomaci.

Gjeni një sinonim dhe një antonim për fjalën me të zeza në fjalinë: “...as që mund të

shpresoj të kem kohë të lëcis një histori të tillë kaq të tjerë.”

**Grupi 3** Si i kuptoni shprehjet e mëposhtme?

*Tërë akademikët e mbretërisë:* \_\_\_\_\_

*përbëjnë ngarkesën e një gamileje:* \_\_\_\_\_

*ja fryti i punës sonë të re:* \_\_\_\_\_

*tërhiqte për kapistalli një hajvan:* \_\_\_\_\_

*mbreti kish zënë shtratin e vdekjes*

**Grupi 4** Historia njerëzore e përmbledhur në një frazë, është edhe rezultati përfundimtar i hulumtimeve të akademikëve, pas një jete të tërë. Kjo frazë e urtë bart në vetvete idenë:

Thelbi i ciklit jetësor është dija, kultura, historia e një kombi.

**Shtjellojeni më tej, duke zgjeruar me shembuj frazën që zgjodhët.**

\*Grupet dëgjojnë njëri-tjetrin në diskutim, replikojnë me njëri-tjetrin në rast se nuk janë dakord me argumentet e dhëna nga grupi që diskuton.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë**

Përzgjidhni një fjalë të urtë dhe krijoni një rrëfim të shkurtër (me rreth 50 fjalë), i cili mbështet vlerën e thënies.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikim	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Parapërgatitja për shkrimin e një teme</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Diskutojmë me nxënësit rreth procesit të të shkruarit si një shprehje komunikative që ka lindur që në lashtësi, si një nevojë e njerëzimit për të komunikuar dhe për të përcjellë mesazhe me njëri-tjetrin. Të shkruarit realizon komunikimin në kohë dhe hapësirë. Të shkruarit si proces vetjak që fillon që në moshat e vogla dhe e shoqëron individin gjatë gjithë jetës.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon hapat bazë që duhet të bëjë në parapërgatitjen e shkrimit të një teme;</li><li>- analizon idetë e ndryshme rreth temës, për t'i vënë në shërbim të shkrimit;</li><li>- hulumton në burime të ndryshme për të gjetur sa më shumë material rreth temës;</li><li>- organizon mirë detajet, derisa të arrijë tek e tëra;</li><li>- krijon tekstin sipas strukturës hyrje-zhvillim-mbyllje.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Parapërgatitje Temë Kërkim-hulumtim Detaje Hyrje-zhvillim-mbyllje	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësvë:</b> Stuhi mendimi, Kërkim-hulumtim, Shkrim i shpejtë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Stuhi mendimi Para se të shkruani, duhet të bëni një parapërgatitje për temën që do të trajtoni. Kjo fazë kalon përmes disa hapash. Në rast se titulli ju është dhënë, duhet që të kuptoni mirë se çfarë kërkohet nga teksti që do të shkruani. Nëse tema është e lirë, ju duhet ta zgjidhni atë. Për zgjedhjen e temës: shkruani disa ide rreth problemit për të cilin do të shkruani; zgjidhni njërin nga idetë dhe përqendrohuni tek ajo, duke menduar se çfarë dini rreth saj dhe se çfarë do të donit të mësonit. Qarkoni një ide, p.sh., pushimet verore. <b>Kjo do të jetë tema juaj. “Pushimet verore po afrojnë.” Organizo një stuhi mendimi.</b> Shkruani menjëherë fjalë dhe ide që ju vijnë në mendje për temën që zgjedhët:			
<div><div>Det/liqen</div><div>Vijnë pas një viti punë të lodhshëm</div><div>Mal/fshat/qytet</div><div>Ndjesi pozitive në spektrin emocional</div><div>Pushimet verore</div><div>Argëtuese</div><div>Interesante</div></div>			

**Ndërtimi i njohurive të reja: Kërkim-hulumtim**

Shikoni, dëgjoni/vëzhgoni dhe hulumtoni.

Jini vigjilent, duke menduar se kështu do të mblidhni më shumë informacion nga i cili do të merrni ide.

Përqendrohuni për t'iu përgjigjur pyetjeve konkrete.

*Pse pushimet e verës janë interesante dhe argëtuese?*

*Ku do të donit t' i kaloni pushimet verore?*

*Do të donit më shumë pushime pasive, duke qëndruar të gjitha ditët në një vend, apo duke eksploruar vende të cilat nuk i keni vizituar më parë?*

**Lexoni sa më shumë rreth temës dhe mbani shënime.**

Kur lexoni apo shikoni diçka më shumë rreth temës që keni zgjedhur, mbani shënime dhe renditni detajet për të treguar më pas:

për faktet interesante ose jo;

për fjalët dhe frazat që tingëllojnë bukur;

për tematikat që ju interesojnë.

*Bëni një listë me pyetje ose me çështje interesante rreth temës:*

*- A jeni të emocionuar para se të niseni me pushime dhe pse?*

*- Ku mendoni se do të kaloni më mirë jashtë Shqipërisë apo brenda saj?*

*- Parapëlqeni pushime të gjata apo të shkurtra?*

*- Ku do të donit t' i kaloni pushimet verore dhe më kë?*

Ka ardhur momenti të skiconi një plan të shkrimit, duke pasur parasysh strukturën e shkrimit.

Hyrje - zhvillim - mbyllje

Vendosini fjalët kyçe të çdo ideje në kuti. Secilën prej këtyre ideve mund ta shprehni me një ose disa fjali, duke krijuar paragrafët.

Argëtuese	Miqësi të reja
Interesante	Largim nga e përditshmja
Ndjesi pozitive në spektrin emocional	Eksplorim vendesh të panjohura
Kosto e lartë	Det/liqen/mal

**\*ORGANIZIMI I DETAJEVE**

Gjatë organizimit të detajeve kini parasysh që këto të fundit të kenë rrjedhshmëri logjike.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrimi shpejtë**

Tashmë ka ardhur moment që të shkruani ju rreth temës në fjalë, duke qenë se faza e parapërgatitjes së shkrimit është gati. Nxënësit lihen të qetë të punojnë për shkrimin e një eseje me këtë temë.

Në fund të orës lexohen punët e tyre. Ata vlerësojnë shokun dhe njëri-tjetrin.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për punën krijuese dhe hapat e organizimit të parapërgatitjes së shkrimit të një teme.

**Detyrë shtëpie:** Bëni parapërgatitjen për shkrimin e një teme të cilën do ta zgjidhni vetë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Drejtshkrim</b> <b>Tema mësimore:</b> <b>Përdorimi i drejtë i fjalëve që kanë bashkëtingëlloren -nj</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Gjej emra njerëzish, vendesh dhe kafshësh që fillojnë me -nj. Nxënësit diskutojnë duke u argëtuar.	

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca qytetare</div>			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <div><div>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloren -nj në fjalët e dhëna;</div><div>- shkruan saktë fjalët që kanë bashkëtingëlloren -nj;</div><div>- argumenton rastet kur fjalët nuk shkruhen me bashkëtingëlloren -nj, por me -j.</div></div>		<b>Fjalët kyçe:</b> Bashkëtingëllorja -nj	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Punë në dyshe, Tabela INSERT, Punë individuale <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Punë në dyshe Lojë: Udhëzohen nxënësit që për 5 minuta në dyshe të shkruajnë sa më shumë fjalë që kanë bashkëtingëlloren –nj në to. Dyshja që ka shkruar më shumë fjalë del fituese në lojë. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Tabela INSERT <b>Udhëzohen nxënësit që do të punohet me tekstin, për të plotësuar tabelën INSERT.</b>			
<b>Njohuritë që i ka marrë më parë</b>	<b>Njohuritë e reja që shtohen këtë orë</b>	<b>Njohuritë që i di, por jo të sakta</b>	<b>Njohuritë e reja që merr dhe nuk i kupton</b>
V	+	-----	?
Në rastet më të shumta bashkëtingëllorja –nj kur ndodhet në trup dhe në fund të fjalës shkruhet si –nj dhe jo –j. Brinjë, shushunjë, arinj, gjarpërinj	1) Emrat femërore me nj në trup të fjalës: Rrëfenjë, zonjë, thinjë etj. 2) Mbiemrat e formuar nga një temë që mbaron me -nj: I florinjte 3) Trajtat e shumësit të emrave mashkullore që mbarojnë me zanore të theksuar ose me –ua bari-barinj thonj-thua 4) trajtat e shumësit të emrave mashkullore, si: gjarpërinj, lumenj KUJDES! Shkruhen me –j, shumësat: kufij (kufi), të këqij, të këqija (i keq, e keqe).		
<b>Për kolonat plotësohen gjatë përgjigjeve që japin ose jo nxënësit.</b> <b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Punë individuale <b>Punohet me ushtrimet 1-5 duke aktivizuar të gjithë nxënësit, në mënyrë që të vihet theksi edhe në drejtshqiptimin e bashkëtingëllores -nj.</b>			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëllores -nj.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim Tema mësimore: Përdorimi i drejtë i grupeve të bashkëtingëlloreve -mb, -nd, -ng, -ngj.		Situata e të nxënësve: Lojë. Nxënësve u ngjiten në shpinë etiketa me fjalë që kanë bashkëtingëlloret mb, -nd, -ng, -ngj. Ata do të gjej fjalët. Do të mësojnë duke u argëtuar.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon lehtësisht bashkëtingëlloret mb, -nd, -ng, -ngj në fjalët e dhëna;</li><li>- shkruan drejt fjalët që kanë bashkëtingëlloret mb, -nd, -ng, -ngj.</li></ul>		Fjalët kyçe: Bashkëtingëlloret -mb, -nd, -ng, -ngj	
Burimet: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim, Mbajtje e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim			
Varianti 1: Gjej bashkëtingëlloret -mb, -nd, -ng, -ngj në fragmentin e dhënë: Në sheshin e qytetit, era përplaste andej-këndej copa dokumentesh e gazetash të grisura. Në pedestalin e monumentit të qytetit ishin ngjitur njëra mbi tjetrën afishet me urdhrat e komandantit italian dhe të komandantit grek të qytetit. Këto afishe të grisura nga shiu dhe nga era ishin e vetmja gjë që mbetën nga shqetësimi i ditëve të fundit.			
Sipas Ismail Kadaresë			
Varianti 2: Qarko fjalët e shkruara gabim dhe rishkruajini ato si duhen. Këmbë, pëllum, pengje, gacmoj, përmensh, këngë, kumull, vend, këndoj, ngjitem, qenq pëllumb, ngacmoj, përmendësh, kumbull, qengj.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Mbajtje e strukturuar e shënimeve Në fragmentin e punuar në fazën e parë të mësimi ju vutë re se grupet e bashkëtingëlloreve -mb-, -nd, -ng, -ngj shkruhen të plota si në fillim, ashtu edhe në trup e në fund të fjalës.			
Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë të mbajnë shënime në mënyrë të strukturuar.			
mb dhëmbët, i ëmbël, këmbë, kumbulla		nd përmendsh, ndërtoj, këndoj, mend, mund	
Bashkëtingëlloret -mb-, -nd-, -ng-, -ngj			
ng ngacmoj, ngul, brengë, kungull		ngj ngjyrë, ngjalë, qengj, thëngjill	

<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe</b>			
<b>Punohen ushtrimet</b>			
<b>Ushtrimi 1.</b> Në secilin çift fjalësh, qarkoni fjalën që mendoni se është shkruar saktë.			
ngjit – njit	kurrkund – kërrkund	njalë – ngjalë	mbjell – mjell
mange – mëngë	kumull – kumbull	tungjatjeta – tugjatjeta	dhëmbë – dhëmë
<b>Ushtrimi 2.</b> Shkruani tetë emra që kanë në fillim, në trup dhe në fund të tyre bashkëtingëlloret <i>mb, nd, ng, ngj.</i>			
<i>Vend, mend, mbesë, ngjalë, ngarkesë, ngjyrë, shkëmb, trung</i>			
<b>Ushtrimi 3.</b> Shkruani tetë folje që kanë në fillim, në trup dhe në fund të tyre bashkëtingëlloret <i>mb, nd, ng, ngj.</i>			
<i>ngjey, mbërthej, ndez, këndoj, mbaroj, ngacmoj, mbaj, ndërtoj</i>			
<b>Ushtrimi 4.</b> Formoni fjalë të prejardhura nga fjalët <i>ngjall, i ngjashëm, ngjesh, ngjit, ngjey, ngjyrë, ndaj, nder, ndesh, ndjek, këndoj, mundoj</i> . Sa fjalë të prejardhura gjetët për çdo rast?			
<i>Ngjall-ngjallje-ngjalloj (vrapi, turrem)-i/e ngjallur</i>			
<i>Ngjyrë-ngjyrim-ngjyroi-ngjyros-ngjyrosje-i/e ngjyrosur-i ngjyrshëm-ngjyruet</i>			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëlloreve nistore s/z dhe për krijimin e çiftëve antonimike gjatë përdorimit të tyre.			
<b>Detyrë shtëpie, ushtrimi 5.</b> Formoni fjali me fjalët <i>i ngjashëm, ngjey, ndesh, ndjek, mundoj</i> dhe me një nga fjalët e prejardhura nga secila prej fjalëve të dhëna.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b>  <b>Tema mësimore: “Ëndërr e vërtetë” Asdreni</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> <b>Diskutim i prozës poetike të Faik Konicës “Malli i atdheut”.</b> Kur vete njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut - viset e reja ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo të harrosh Shqipërinë, po të mos të vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S`di c`të mungon, s`di se ç`të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën; e, pikësëpari herë-herë, mbastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm, ku u quajtëm foshnja e ku lozëm djelm, kujtimi i atyre maleve larg të cilëve nuk rron dot mirë një shqiptar, kujtimi i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë, e me tepër kujtimi e dëshira e etja e gjuhës sonë ta shtrëngojnë e ta dërrmojnë me të vërtetë zemrën. Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s`e ka pasur në dhe të huaj! Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç`forcë e ç`bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri! Ajo më e zbrazura letër, ajo fjala më e vogël, na sjell, kur vjen nga Shqipëria, një gaz të parrëfyeshëm, se na sjell si një copë të atdheut...	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- rrëfen përvoja personale të tij dhe të të tjerëve për ndjesitë që ka provuar larg atdheut;</li> <li>- analizon thëniet e njerëzve të shquar për atdheun;</li> <li>- zbulon figurat letrare të pjesës dhe funksionin e tyre;</li> <li>- argumenton mesazhin që përcolli pjesa tek ai.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Atdhe Dashuri Mall Vendlindje
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, poezi nga Asdreni	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:** Bashkëbisedim, Lexim zinxhir, Të nxënës në bashkëpunim, Rrjet diskutimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim

Rrëfime personale

Paraprakisht mësuesi/ja ka udhëzuar nxënësit që të bisedojnë me prindërit dhe të afërmit e tyre që kanë qenë larg atdheut apo që dhe jetojnë jashtë tij t'i pyesin për ndjesitë e tyre larg tokës mëmë.

Nxënësit rrëfejnë përvojat e tyre jashtë Shqipërisë.

Nxënësit rrëfejnë përvojat e prindërve të tyre dhe njerëzve të familjes që kanë qenë ose janë jashtë atdheut.

Nxënësit kanë mësuar gjithashtu dhe vargje për atdheun nga autorë të ndryshëm dhe i recitojnë ato në klasë.

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka  
 Më je nënë, më je motër, më je vlla.  
 Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,  
 Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhë

Naim Frashëri

Mëmëdhe quhet toka

Ku më ka rënë koka  
 Ku kam dashur mëmë e atë,  
 Ku më njeh dhe guri i thatë

Çajupi

Me vite jam larguar,  
 i dashur Atdhe,  
 por nuk të kam harruar,  
 se shumë i ëmbël je.  
 Kjo zemra më këndon  
 për ty, o Shqipëri,  
 por prapë më lëngon,  
 se je në varfëri.  
 Asdreni

N'ty mendoj kur agon drita,  
 Kur bylbyli mallshem kndon,  
 N'ty mendoj kur soset dita,  
 Terri botën kur e mblon  
 Vec se ty të shoh un n'andërr,  
 Vec se ty, culet, t'kam n'mendim;  
 Nder t'vështira ti m'je qandërr,  
 Per ty i lehtë m'vjen cdo ndëshkim  
 Gj. Fishta

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Lexim zinxhir

Lexohet teksti zinxhir duku u përqendruar te leximi shprehës. Më pas fillojmë të punojmë rubrikat e tekstit: *Duke nxënë në bashkëpunim*

### Kuptojmë tekstin

#### Grupi 1

##### 1. Gjeni në tekst fjalitë në të cilat autori:

**shpreh dëshirën dhe mallin për atdheun;** Natyra ishte më e para gjë që më dëfrente zemrën, që më kënaqte sytë dhe shpirtin, prandaj ndjeva një trishtim të madh kur e lashë.

Po me tërë këto, një dëshirë e brendshme e zemrës më shtynte, më shponte që t'i shihja edhe njëherë ato vise, të shihja vendin e prindërve të mi që e kisha lënë me aq mallëngjim, me aq lot, të shihja baltën e Shqipërisë nga e cila jam krijuar.

Thosha me vete: të kapërcej male, fusha e dete, të vete atje, t'i shoh të gjitha: gurët, drurët, barërat, brigjet, kodrat, t'i ngjit e t'i zbres malet, të pi ujin e kulluar të burimeve, të shikoj fshatrat përreth, bagëtitë, lulet, pemët, t'i zë me dorën time, t'i ndiej, t'i përgëzoj, t'i përqafoj, të ngopem, të nxjerr mallin e zemrës.

**shpreh dilemën e vet, e cila i trazon mendimet;** Po herë-herë mendja më kthehej, zemra më trishtohej. Jo, këto janë ëndrra të miturisë, të vegjëlisë, të foshnjërisë, janë ëndrra të shkuara. Tani jam i madh, ato shkuan e vanë, fluturuan, u shuan. Tani duhet të përpiqem, të mundohem, të mbledh për rrojtje, për ushqim, për bukën e përditshme... jam burrë... tani jam burrë, ka ardhur tjetër kohë, tjetër zakon, tjetër jetë. Ato ishin ëndrra foshnjeje, kur njeriu s'di ç'është bota, ç'është mendimi për rrojtje. **Isha në një dilemë: a të qëndroja atje ku isha, apo të plotësoja dëshirën që më donte shpirti edhe zemra?**

**rrëfen ëndrrën, e cila i mbush shpirtin;**

**rrëfen çudinë për sa i ka ndodhur.**

### Grupi 2

#### Analizojmë tekstin

2. Në ç'vetë rrëfen autori? Në vetën e parë. **Cili është efekti që krijon kjo mënyrë të rrëfyeri?** Përcaktimin e autorit për të rrëfyer ngjarjet e përjetuara si të vërteta e fat kolektiviteti, e jo për të shfaqur vetëm vetën e tij.
3. **Autori rrëfen në dy kohë: reale dhe joreale. Si e realizon ai këtë?** Një herë tregon realitetin ku ndodhet – koha reale dhe herën tjetër koha joreale – ëndrra është realiteti ku dëshiron të ndodhet.
- 4.

### Grupi 3

5. Në këtë pjesë rrëfimi ndërthuret me vjershërimin. **Si mendoni, pse e bën këtë zgjedhje autori?**

Kjo prozë ka muzikalitet si një vjershë sepse i gjithë teksti ka ndjeshmëri të lartë që synon ta përcjellë te lexuesi.

*\*Ky grup do të punojë edhe ushtrimet 4-7 për të zbuluar veçoritë gjuhësore dhe stilistikore të Asdrenit.*

*Mësuesi/ja do t'i orientojë nxënësit të punojnë me kujdes duke analizuar imtësisht çdo njësi gjuhësore që është përdorur në funksion të figurave letrare.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Rrjet diskutimi

PO

Ç'është atdheu për ju? A e mendoni të ardhmen tuaj larg tij

JO

Nxënësit diskutojnë së bashku për këto thënie. A janë aktuale këto thënie? Pse? Argumento përgjigjet.

*"Përgjegjësia jonë ndaj vendit është e pamohueshme: do vuajmë me vuajtjet e Shqipërisë, do gëzojmë me gëzimet e saj"*

F. Konica

*"Është kënaqësi të vdesësh për atdhe! Edhe më kënaqësi është të jetosh për të".*

Horaci

Udhëzohen nxënësit që debatin e tyre ta ngrenë mbi argumente.

**Detyrë shtëpie:** Gjeni poezi të rilindësve kushtuar mallit për atdheun. Dy prej tyre kthejini në prozë.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b> <b>Tema mësimore: Shkruajmë përvoja personale</b>			
		<b>Situata e të nxënit:</b> Koha atë mëngjes, aty qante, aty qeshte. Karvani dy qerresh i të zbuarve, posa kishte lënë pas mullirin e beut, Kodrën e Shkozës dhe kishte hyrë në Fier. Qerret ndaluan... dhe po pritshin të kalonte përtej, vargu i gjatë i grave. Me kanistrat bosh në duar, po me gojën plot llafe, ato ktheheshin nga kisha e Shën-Gjergjit për në shtëpi. Shiu sa kishte pushuar, megjithatë, nga ijet e tepruara të buajve, nga halat e gjata të qepallave të tyre, nga lelet e shkurtra, nga veshët llapushë të qenit që kishte zënë vend atje poshtë qerres, rrëshqisnin rrëke të holla uji që vinin e binin mbi llucën e rrugës. Rrogozet prej kashte frytje, që mbulonin qerret dhe ruanin robt e plaçkat nga kullimi i reve, si kishin pirë e ishin fryrë të rrugës me shi, të ngopur, po villnin tani ujë e tepërt. Lart, në qiell, nga një dritare e madhe hapur përmes reve, dielli po vërviste mbi qytet tufën e rrezeve të tija, që ngjanin me vandakë zhukash të thata, të arta, që një dorë e fshehtë i flakë poshtë në fushë. J. Xoxa "Lumi i vdekur"	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe	
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit	
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kujton elementet e tekstit përshkrues;</li> <li>- dallon hapat që duhet të ndjekë për të shkruar një histori personale;</li> <li>- dallon strukturën e shkrimit të një përvoje personale hyrje, zhvillim, mbyllje.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Tekst përshkrues përvojë personale
<b>Burimet:</b> teksti mësimor	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukatë qytetare
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stuhi mendimi, Punë individuale, Punë në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Stuhi mendimi	
<pre> graph TD     TP[Teksti përshkrues] --&gt; O[Objektiv]     TP --&gt; S[Subjektiv]     TP --&gt; PR([Paraqesin realitete])     PR --&gt; TB[Të brendshme]     PR --&gt; RN[Rreth nesh]     TB --&gt; ND([Ndjenja])     TB --&gt; EM([Emocione])     TB --&gt; ME([Mendime])     RN --&gt; NK([Njerëz/kafshë])     RN --&gt; OJ([Objekt])     RN --&gt; V([Vend])       </pre>	
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë individuale Për të shkruar një histori personale duhen ndjekur disa hapa: <ol style="list-style-type: none"> <li>1 - Përgatituni emocionalisht. Truri juaj duhet të nxitet të kujtojë ngjarjet që ka përjetuar.</li> <li>2 - Bëni një listë me disa histori që ju vijnë në mendje. Hyrja në klasën e parë, ekskursioni në Berat, takim me një shkrimtar, pjesëmarrja në Olimpiadën e Matematikës etj.</li> <li>3 - Zgjidhni historinë për të cilën do të shkruani. "Shohitni" mendimet që keni listuar te stuhia e mendimit, zgjidhni atë temë për të cilën keni më shumë kujtime dhe mbresa, detaje për të shkruar.</li> <li>4 - Kujtoni dhe shënoni detaje poshtë saj.</li> </ol> Pjesëmarrësit janë pjesë e rëndësishme e tregimit të një përvoje personale. Ata duhet të përshkruhen edhe me tiparet dhe karakteristikat që kanë. <ol style="list-style-type: none"> <li>5 - Kujtoni dhe shkruani emocionet që keni kaluar.</li> <li>6 - Përcaktoni titullin që do t'i vendosni historisë suaj personale.</li> </ol> Proveni ta tregoni përvojën tuaj personale si një histori të plotë me <b>hyrje, zhvillim dhe mbyllje</b> . Kujdes strukturën e historisë!	
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Punë në dyshe Lexoni një tregim me përvojën personale të një bashkëmoshatarit tuaj dhe gjeni në të paragrafët e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes. Nënvizoni fjalitë që tërheqin vëmendjen dhe pikën kulmore.	


<p><b>TË LUASH ME ZËRA</b>  <i>E kujtoj mirë atë ditë...</i>  <i>Tri ditë pasi kisha mbërritur në qytet, Maksi më ftoi:</i>  - E ngjisim atë kodrën aty lart? - Aty është një zë që të përgjigjet.  Unë kisha dëgjuar për të tillë zëra, por nuk i kisha besuar ndonjëherë. Isha gati.  U nisëm...  Pasi kishim ecur rreth një orë, arritëm në majë të kodrës. U ulëm pranë një shkëmbi.  Maksi më tha:  - Bërtit tani me sa fuqi të kesh.  Sikur u tremba pak dhe iu ktheva Maksit:  - Po bërit ti i pari!  - Sa frikacak që je! - më tha.  - Si? Si? - iu përgjigja.  - Je frikacak, frikacak, frikacak, - përsëriti tri herë këtë fjalë.  Ai nisi t'i përsëritë këto fjalë më shpesh dhe me zë gjithnjë e më të lartë.  Zërat nisën të vijnë nga thellësia duke ushtuar si sirena alarmi.  Maksi nisi të ulërinte me sa kishte në kohë. Sa më shumë bërtiste ai, aq më të thellë vinin zërat. Ai nisi të bëjë një lojë të padëgjuar ndonjëherë me zëra. Pa mbaruar një fjalë, niste tjetrën. Dukej sikur kishim pranë një orkestër gjigante.  Pasi më doli frika, nisa të luaj edhe unë me zëra. Atë ditë zërat tanë kumbuan gjatë në mes të pyllit.  Ishte bukur të luaje me zëra. Një lojë që nuk e kisha bërë ndonjëherë.  ... Kanë kaluar shumë kohë. Sot unë kam nisur të bëj muzikë.  Shpesh kujtoj Maksin dhe them me vete: "Ai më mësoi të luaj me zëra."</p>		<p>HYRJA }</p> <p>MBYLLJA }</p>
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për punët e bëra.  <b>Detyrë shtëpie:</b> Shkruaj edhe ti përvojën tënde personale, duke u mbështetur në udhëzimet që mësove në këtë mësim.</p>		

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha e komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: “Tregtar flamujsh” (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënësve</b> Këndohet “Himni i flamurit” në klasë	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- zbulon motivet e shtjelluara në fragment;</li><li>- dallon figurat letrare në të;</li><li>- analizon cilësitë e personazheve;</li><li>- interpreton këshillat dhe shprehjet më mbresëlënëse të fragmentit duke argumentuar dhe ilustruar përgjigjen.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Flamur Tregtar Poet Atdhedashuri	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, “Tregtar flamujsh” E. Koliqi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, qytetari	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Parashikim me anë të titullit, Pemë mendimi, Hartë personazhi, Punë në dyshe			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Parashikim me anë të titullit Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Diskutohen 3-4 minuta për ndonjë paqartësi që mund të ketë. “Parashikim me anë të titullit”, kjo është teknika me të cilën do të çelej ora e mësimi. Çfarë mund të parashikoni e do të ndodh te fragmenti kur dëgjoni titullin “Tregtar flamujsh?” Çfarë është flamuri për ju? A është mall e me të mund të bëhet tregti? Pse? Nxënësit dëgjohen në përgjigjet e tyre.			

**Ndërtimi i njohurive të reja: Pemë mendimi**

Bëhet leximi shprehës i fragmentit, duke u përqendruar tek informacioni që jepet për Ernest Koliqin si themelues i prozës moderne shqiptare. U sqarohet nxënësve që proza e Koliqit ngjason me prozën poetike, pasi ka karakteristikat e saj si: a) muzikalitet të frazës; b) ka figura dhe imazhe të gjalla c) pasuri mjetesh figurative etj.



Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet, pasi të mbarojnë leximin zinxhir do të punojnë me rubrikën “Kuptojmë tekstin”.

**1. Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.**

**Plotësoni tabelën:**

**Motivet e shtjelluara në fragment**

- 1) Motivi i atdhedashurisë
- 2) Motivi i jetës urbane

Personazhet kryesore të këtij tregimi vijnë nga:

dy breza të ndryshëm; po  
 dy familje të ndryshme; po  
 dy vende të ndryshme; jo  
 botëkuptime të ndryshme; po

Kanë qëndrime të ndryshme të papajtuësme me njëri-tjetrin që lidhen me probleme të çështjes kombëtare.

Me pyetjet në vijim krijohet mendimi për portretin fizik e moral të dy personazheve. Për ta bërë sa më të qartë kontrastin midis dy personazheve mund të përdoret *harta e personazheve*.


**2. Hilushi dhe Gaspëri mendojnë njëloj apo kundërshtojnë njëri-tjetrin?**

Nuk mendojnë njësoj dhe nuk ka sesi kur thamë se i përkasin dy mentaliteteve të ndryshme e si rrjedhim dhe koncepti që ndajnë për atdheun është i ndryshëm.

**3. Ku duket shpërfillja e Gaspërit për artin?** Shpërfillja e Gaspërit për artin duket: “Po, zati ti s’din veç me qitë bejta. Jeto në pralla, bieru mbas Andrra... Bejtat e Shqipnia kanë me të qitë në dritë...”

**4. Ku duket patriotizmi i Hilushit?** E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindrue.

**5. Analizoni portretin e secilit personazh. Shkruani karakteristikat e të dyve në figurat e dhëna:**



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe  
Nxënësit punojnë në **grupe dyshe** duke plotësuar njëri tjetrin për pyetjet e mëposhtme.

**6. Ç'figurë letrare përftohet nga shprehja: e kish ngri çudija në vend?**

Metonimi

Metaforë

Krahasim

Hiperbolë

**7. Cila është këshilla që jep Hilushi?** Por edhe një fjalë due me t'a thane e të lutem vire në vesh si at këshill qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrehesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallëve qysh se je ndry në këtë dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri i yt. E sa për

Shqipni, po të siguroj un se ka me qindruë. Prandej mos ban marak se edhe flamujt kanë me t'u shitë krejt. Por rueje shpirtin t'and mos t'ia shitish dreqit.

**8. A është ajo një e vërtetë e madhe?** Po është një e vërtetë e madhe. Tregtari ishte një njeri pa parime si rrjedhim një genie që vendos materien mbi gjithçka.

**9. A është ajo një vlerë e lartë morale?** Po, pasi nuk mund të shiten parimet për interesa materiale, të vogla. Pra, një këshillë që të shpie të kuptosh të vërtetën sa nuk është vonë.

këshillë ironike

këshillë që të shpie të kuptosh

Ndonjëherë Koliqi, personazhin e tij e quan edhe tregtar.

Koliqi personazhin e tij e quan edhe tregtar, pasi ai flamurin, simbolin e shenjtë dhe të shtrenjtë të kombit e ka kthyer në mall që shitet dhe blihet dhe shitjen e flamujve e shikon si rrugën e vetme për t'u pasuruar.

**10. Pse nuk ia përmend emrin në këtë rast?** Autori nuk ia përmend emrin, pasi për të, atdheu nuk është asgjë, kur në të vërtetë atdheu është i shenjtë, është identiteti. E tregtari nuk ka atdhe, nuk pyet për flamur e si rrjedhim nuk ka identitet: *U shitne e s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesh.* Çfarë tregon kjo? Autori ndjen neveri dhe nuk i jep rëndësi personazhit.

**Nxënësit në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me ndihmën e mësuesit** reflektojnë rreth rubrikës interpretojmë tekstin. Nxënësit punojnë në dyshe për të zbuluar mesazhin që buron prej shprehjes *"E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindruë."*

**11. Ku mbështetet bindja e personazhit tonë? Nxirrni mesazhin që buron prej saj.** Bindja e personazhit mbështetet te besimi dhe atdhedashuria e tij dhe shpresa për të ardhmen e vendit. Kjo e fundit përben dhe mesazhin e shprehjes. Mesazhet që nxjerrin nxënësit ngjiten në muret e klasës.

**Vlerësimi:** Vlerësohet për zbulimin e motiveve që trajton fragmenti, analizën e personazheve, dallimin e figurave letrare dhe interpretimin e këshillave dhe thënieve mbresëlënëse.

**Detyrë shtëpie:** Interpreto pjesën në role.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE




Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: “Tregtar flamujsh” (ora 2)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
- Kompetenca personal			
- Kompetenca digjitale			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton pjesën në role;</li> <li>- dallon karakteristikat e dialogut në fragment;</li> <li>- analizon antonimet dhe funksionin e tyre gjuhësor dhe artistik;</li> <li>- analizon notat e ironisë në fjalët e Hilushit.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Flamur Tregtar Poet Atdhedashuri
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukatë qytetare
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Lojë me role, Stuhi mendimi, Ditar dypjesësh, Shkrim i lirë</i></p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Lojë me role</i></p> <p>Nxënësve u është lënë si detyrë shtëpie të ndanin rolet dhe të interpretonin fragmentin në klasë. Për rreth 15 minuta ata interpretojnë e më pas vlerësojnë njëri-tjetrit dhe vetëvlerësohen.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Shpjegoni detajet që e bëjnë këtë një prozë të drejtpërdrejtë me nota realizmi.</p> <div data-bbox="177 689 1426 1043" style="text-align: center;"> <pre> graph TD     A([Realizmi]) --- B[Pasqyrimi me vërtetësi i realitetit]     A --- C[Shkatërrimi i personalitetit të njeriut]     A --- D[Psikologjia e thellë e personazheve]     A --- E[Trajtimi i temave me problemet e kohës]     A --- F[Pasqyrimi me vërtetësi i realitetit]           </pre> </div>	
Evidentimi i vlerave gjuhësore e stilistikore të kësaj proze bëhet me anë të ditarit dypjesësh:	
Si është dialogu?	<i>I vazhdueshëm, dinamik, ka vijueshmëri logjike</i>
Jepni shembuj të ironisë.	
Jepni shembuj të sinonimeve, antonimeve, njësive frazeologjike dhe shprehjeve dialektore.	
Dalloni shkallët e mbiemrit në tekst.	
<p><b>Jrezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> <i>Shkrim i lirë</i></p> <p>Shkruani një ese argumentuese me temë: “Çdo profesion merr vlerë kur e ushtron me ndershmëri”.</p> <p>Nxënësit punojnë për esenë individualisht. Nisin fillimisht me një stuhi mendimi për të nxjerrë argumentet ku do të mbështeten, bëjnë zgjedhjen e argumenteve dhe kundër argumentit dhe më pas bëjnë strukturimin e esesë në skeletin fillestar të saj.</p> <p>Nëse nxënësit e mbarojnë punën në klasë diskutojnë rreth saj dhe vlerësojnë punët e njëri-tjetrit, në rast të kundërt jepet si detyrë shtëpie.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për dallimin e detajeve të realizmit, karakteristikat e dialogut, dallimin e ironisë etj.</p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Flasim Tema mësimore: Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën.		Situata e të nxënës: Hulumtim nëpër median e shkruar për të gjetur format dhe strukturat gjuhësore që kanë pushtuar gjuhën shqipe.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- gjen gjegjëset e shqipes për fjalët e huaja;</li><li>- analizon thëniet dhe vlerësimet njerëzve të shquar për gjuhën shqipe;</li><li>- diskuton rreth formave dhe strukturave të huaja që po pushtojnë gjuhën shqipe.</li></ul>		Fjalët kyçe: Fjalë e huaj Gjegjëse shqipe Huazime	
Burimet: Libri i nxënësit, gazeta të ndryshme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Bashkëbisedim, Të nxënës në bashkëpunim, Punë me grupe, Diskutim</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim</p> <p>Kohët e fundit kanë filluar të përdoren fjalët turist, xhins, emigrim, supermarket, eko, transistor, hamburger, suflaqe. Me cilat fusha leksikore lidhen këto fjalë?</p> <p><b>Diskutojmë së bashku</b></p> <p>Gjatë shekujve, të parët tanë kanë mbajtur fustanella, shallvare, xhubleta, rubë, rizë. Cili është ndryshimi i këtyre fjalëve me fjalët pantallona, fustan dhe shami koke?</p> <p>Për të diskutuar më mirë kuptimin e fjalëve përdorni “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënës në bashkëpunim - Punë me grupe</p> <p>Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të lexojnë thëniet dhe vlerësimet e njerëzve të shquar për gjuhën shqipe.</p> <p><b>Ndabet klasa në grupe dhe secili grup do të japë gjykime dhe vlerësime rreth thënies.</b></p> <p><b>Grupi 1</b> “Fjala e huaj në gjuhë, është si dhia nder dhen” - Naim Frasheri</p> <p><b>Grupi 2</b> “Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet” - Filip Shiroka</p> <p><b>Grupi 3</b> “Gjuha është pasqyra me e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij” - Eqrem Çabej</p> <p><b>Grupi 4</b> “Gjuha shqipe është një pasuri fjalësh dhe është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen me të klasikët e çdo kombi, e çdo kohe” - Gjergj Fishta</p> <p><b>Grupi 5</b> “Gjuha ruhet, atje ku shkrubet” - Populli</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Diskutim</p> <p>Nxënësit punojnë në formë diskutimi ushtrimet 4 dhe 5.</p>			
<p><b>Vlerësimi:</b> vlerësohen nxënësit për analizën dhe vlerësimin e thënieve të njerëzve të shquar për gjuhën shqipe, për përdorimit drejt të fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja etj.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Teknologjitë e reja kanë sjellë përdorimin gjithnjë e më të madh të fjalëve dhe të shprehjeve të shkurtuara ose të huazuara. Diskutoni rreth këtij realiteti gjuhësor, duke sjellë shembuj dhe raste të ndryshme.</p>			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të dëgjuarit</b> <b>Tema mësimore: Tekste që lidhen me traditat shqiptare</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Sill ndër mend vargjet e Bajronit dhe reflekto. Shih t'egrin shqipëtar me fustanellë E rrobat të qëndisura me ar. Armët të lara me flori, sa bukur! Haroldi i pa në kullë t'Ali Pashës Tek niseshin në luftë e në fitore; Pastaj i pa kur vetë u ra në dorë, Viktimë e dallgës s'egër n'udhë e sipër, Kur rasti i bën të liqtë më të liq; E pritën në shtëpi me gjith të mirat... Pa lajka. Ndezën zjarr, u thanë rrobat; Pa nasqirisën llambën, mbushën plloskën, dhe shtruan sufrën, me atë që patën: Kësaj i thonë dashuri njerzore.	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b> Nxënësi/ja: - diskuton rreth traditave të popullit tonë; - përshkruan veshjet tradicionale dhe vendet arkeologjike të krahinës së tij; - rindërton tekstin e shkëputur nga “Bardha e Temalit”, pas dëgjimit të fragmentit; - argumenton përgjigjet e pyetjeve që lidhen me fragmentin.		<b>Fjalët kyçe:</b> Tradita shqiptare Veshje tradicionale Vendet arkeologjike Zakone dhe doke Trashëgimi Mikpritja	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, edukim muzikor dhe edukim figurativ, gjeografi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Punë në dyshe, Të nxënësve në bashkëpunim, Veprimtari me lexim dhe mendim të drejtuar (VLMD), Rrjeti i diskutimit <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Diskutim Mësuesi/ja ka udhëzuar nxënësit orën e kaluar që të hulumtojnë rreth traditave shqiptare, veshjeve, vendeve arkeologjike, zakonit të besës dhe mikpritjes, kulinarisë etj. Në videoprojektor, mësuesi/ja shfaq një veshje tradicionale shqiptare. Nxënësit do të gjejnë se cilës krahine i përket dhe cilat janë veçoritë e saj.			
		 	
<a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Veshjet_tradicionale_shqiptare">https://sq.wikipedia.org/wiki/Veshjet_tradicionale_shqiptare</a>			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** *Puno në dyshe*

Nxënësit dëgjojnë fragmentet e teksteve që lidhen me fotografitë. Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrit, ata lidhin fragmentet me fotografitë përkatëse.

*Të nxënit në bashkëpunim:*

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe katërshe dhe punojnë pikën 2 të ushtrimit 2. Përshkruani veshjet tradicionale dhe vendet arkeologjike të krahinave tuaja (në grupe katërshe). Bëjini pyetje njëri-tjetrit për detaje që lidhen me to.

*Veprimtari me lexim dhe dëgjim të drejtuar (VLMD).*

Fragmenti i shkëputur nga vepra “Bardha e Temalit” nuk është vendosur në radhë kronologjike. Mësuesi/ja lexon pjesët dhe nxënësit rindërtojnë tekstin si shembulli i mëposhtëm.

Ime zonjë kishte një vajzë, një zanë të vërtetë mali, aq e bukur edhe aq e hijshme ishte. Një trim i ri e kishte parë tinëz dhe kishte rënë në dashuri me të. Ai s’la dinakëri e marifet pa përdorur që ta shihte edhe një herë tjetër. Po të gjitha përpjekjet i shkuan kot, sepse engjëllushja e mjerë nuk dille kurrë jashtë oborrit të shtëpisë dhe fshihej, sipas zakoneve tona, me të arritur ndonjë i huaj. Po një ditë prej ditësh ajo nuk u tregua mjaft e kujdesshme si gjithnjë dhe u gënjye e erdhi vetëm gjer në këtë koriqe këtu, për të mbledhur lule.

Kur e pa se ishte vetëm, trimi doli nga kaçubja dhe pati guxim të afrohej e t’i fliste për dashuri. Vajza e shkretë u tmerrua. Ajo mbeti aty si e hutuar, duke dëgjuar fjalët e djaloshit... Mjerisht, Mhilli i Vlashajve, i ati, gjendej në kopsht.

**Kur mendoni se zhvillohet kjo ngjarje? Në cilën kohë? Ku e kuptoni këtë?**

Ngjarjet zhvillohen në vitin 1842, në Shkodër. Ku e kuptojmë këtë? Nuk dille kurrë jashtë oborrit të shtëpisë dhe fshihej, sipas zakoneve tona. Kjo fjalë të bën të mendosh kohën kur zhvillohet ngjarja.

**Çfarë ka ndodhur në familjen e Mhillit?** Në familjen e Mhillit kishte ndodhur gjëma.

**Cili është episodi që ka prishur qetësinë e kësaj familjeje?** Vajza e tij e kishte çnderuar familjen, për shkak se kishte guxuar ta takonte djalin që dashuronte, të bisedonte me të, madje duke përfutur nga hutimi i saj dhe e kishte puthur në faqe.

**Si reagoi babai i vajzës?** Babai reagon egër për të ashtu siç e donte zakoni. Nderi i shtëpisë vlente më shumë se jeta e pjesëtarëve të saj.

**Me cilin zakon shqiptar ka lidhje ky episod?** Nderi i familjes

**Çfarë do të ndodhë më pas? Si mendoni? Pse mendoni kështu? Cilat janë ato fjalë që e tregojnë...** Vajza e shkretë u tmerrua. U tmerrua se i njihnte mirë zakonet dhe se e dinte çfarë e priste, pavarësisht se ishte e pafajshme.

**Mjerisht,** Mhilli i Vlashajve, i ati, gjendej në kopsht.

*Ime zonjë mbeti si e dërrmuar një copë herë, pastaj zuri të qante. Dënsat e saj më binin si pika në zemër. Më në fund, ime zonjë u ngrit nga divani duke thirrur si e prishur mendsh:*

*– Duhet bërë pa derman! Taksirat! Taksirat!*

*Si një njeri që ka marrë një vendim të befasishëm, ajo hapi derën dhe i thirri me zë të fortë së bijës, e cila erdhi pa vonuar.*

*Që në fjalët e para, ajo ia tregoi të gjitha.*

*– Po unë s’kam ndonjë faj, – përsëriste me një zë të përvajshëm e ankues, – unë s’kam ndonjë faj!*

*Nuk e dija se ishte atje ai djalosh. Kjo ishte një befasi, një pritë, një fatalitet!*

*Dhe qante e mjera vajzë sa të këpuste shpirtin.*

*– E çfarë!*

*Meqë ti vetë po e pranon se je takuar me të në kopsht, asnjëri nuk do të besojë pafajësinë tënde.*

**Çfarë do të ndodhë më pas?**

Familja nuk mund të pranojë “turpin” e bërë nga bija e tyre. Ata do të mundohen të respektojnë zakonet.

**Pse mendoni kështu?**

Vendndodhja e ngjarjes në Shqipërinë e Veriut ku kanuni, zakonet e traditat janë të forta, na e krijojnë bindjen se kështu do të ndodhë.

**Cilat janë ato fjalë që tregojnë arsyen e këtij veprimi?** *Asnjëri nuk do të besojë pafajësinë tënde.*

**Cilat janë fjalët që ju bëjnë më shumë përshtypje? Pse?**

*Po unë s’kam ndonjë faj, – përsëriste me një zë të përvajshëm e ankues, – unë s’kam ndonjë faj!*

*Nuk e dija se ishte atje ai djalosh. Kjo ishte një befasi, një pritë, një fatalitet!*

*Dhe qante e mjera vajzë sa të këpuste shpirtin.*

*E çfarë! Kjo e çfarë është ulëritëse që nuk pyet as për lotët e pafajësisë së vajzës së re.*

*Por, o perëndi, – thirri e shkreta nënë, – ajo ndoshta s’ka ndonjë faj. Shiko njëherë mere vesh mirë si ka qenë puna. Ime bijë s’mund ta ketë lëshuar veten, s’mund të ketë arritur gjer atje. Ajo nuk duhet të vdesë. Të lutem, mendohu...*

*– Unë jam menduar mirë dhe e kam peshuar punën hollë. Mos harro se jam baba. Zoti e di se sa i kushton kjo zemrës sime, por që të dy duhet të vdesin. Pas këtij turpi, jeta për të do të ishte e padurueshme; do të ishte për të një mynxyrë e vërtetë.*

– Mëshirë, – klithi me zë të përvajshëm nëna e mjerë duke rënë në gjunjë. – Ki mëshirë për fëmijën tonë, për mua, për veten tënde!...

#### **Si reagoi nëna e vajzës?**

E lebetitur, pasi e dinte se çfarë e priste bijën e saj.

#### **Me çfarë nuk ishte dakord ajo?**

Ajo nuk ishte dakord me vendimin e bashkëshortit të saj.

#### **Çfarë thotë babai i vajzës?**

Të dy duhet të vdesin.

#### **Babai është i egër apo i dhembshur?**

Babai është i dhembshur, por zakonet e detyronin të bëhej mizor e të mos dëgjonte zërin e arsyës.

#### **Ku duket kjo? Cilat janë ato fjalë që e tregojnë gjendjen e tij shpirtërore?**

Mos harro se jam baba. Zoti e di se sa i kushton kjo zemrës sime, por që të dy duhet të vdesin. Pas këtij turpi, jeta për të do të ishte e padurueshme; do të ishte për të një mynxyrë e vërtetë.

#### **A dëgjohej fjala e femrave në atë kohë?**

Gruaja nuk dëgjohej e shihej vetëm si një mjet për të shtuar familjen e të mos shuhej kjo e fundit.

#### **Çfarë do të ndodhë më pas në këtë fragment? Cilat janë fjalët që e tregojnë këtë parashikim?**

Pas këtij turpi, jeta për të do të ishte e padurueshme; do të ishte për të një mynxyrë e vërtetë. Kjo fjali tregon për fatin e hidhur të personazhit.

Pasi doli e ëma, vajza mbeti për disa çaste e dërrmuar e si e ngrirë në vend. Pastaj u vërsul drejt shishes, e rrëmbu ...

#### **Çfarë ndodhi në këtë fragment? Gjykimi i një personi, i cili është "fajtor" për një veprimi i cili nuk varej prej tij.**

**Vendimi që mori babai është shenjë dashurie, urrejtjeje apo paragjykimi?** Vendimi i babait është paragjykim.

**Pse e mori ai këtë vendim?** Ai e mori këtë veprim për hir të zakoneve, të nderit të familjes apo të nderit të së bijës.

**A duhej të merrej një vendim i tillë për hir të zakoneve?** Para babait ishin dy rrugë: 1) Të vriste të bijën dhe "të dashurin" e saj 2) Dera e Vlashajve do të ishte e koritur.

Pra, nuk kishte rrugëzgjidhje.

#### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: rrjeti i diskutimit**

#### **A ka në fragmentin e mësipërm detaje që mungojnë krahasuar me ato që dëgjuat?**

Po mungojnë shumë detaje. Nxënësit i listojnë ato pas dëgjimit të plotë të fragmentit.

Mësuesi/ja ndan klasën në tri grupe dhe u jep nga një çështje për të diskutuar. Nxënësit japin argumentet e tyre për përgjigjet PO/JO.

Dëgjoni komentet e njëri-tjetrit në lidhje me çështjet e mëposhtme. *Po Jo Pse*

Jepni mendimin tuaj për secilën çështje dhe argumentojeni atë.

*A është e domosdoshme të vishesh dhe të jetosh sipas traditës për të treguar ndjenjën e vlerësimit që ke ndaj saj?*

*Mendoni se kultura tradicionale shqiptare është më shumë apo më pak e vlerësuar se ajo e vendeve të tjera?*

Njohja e traditave të së kaluarës është: mungesë qytetërimi, kulturë e një shoqërie, nevojë për brezat?

*Pyeten nxënësit nga mësuesi/ja: A u pëlqeu ora e mësimit? Çfarë mësuar prej saj dhe çfarë do të donit të mësonit. Ishte tema në pritshmërinë tuaj?*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përgjigjet e pyetjeve rreth të kuptuarit të tekstit të dëgjuar, për nxjerrjen e informacionit gjatë të dëgjuarit kritik, për argumentet e dhëna çështjet e ngritura gjatë diskutimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Ngjarje pa lëvizje		Situata e të nxënës: Vargje nga Migjeni O si nuk kam një grusht të fortë t'i bij malit që s'bëzanë... Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla mjerimi Kafshatë që të mbetë në fyt e të zë trishtimi Kur shef ftyra të zbehta dhe sy të jeshilta Që të shikojnë si hije she shrijnë duert e mpita...	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca e të menduarit			

<b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbulon motivin kryesor të pjesës;</li> <li>- gjen detajet më mbresëlënëse;</li> <li>- zbulon mesazhin që përcjell proza e Migjenit.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Kali Mjerim Sy lotues Kamxhik Barbarizëm												
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, vargje dhe proza nga Migjeni	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukatë qytetare												
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Parashikim me anë të titullit, Ditari dypjesësh, Pemë mendimi</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Parashikim me anë të titullit</p> <p>Pjesa që do të studiojmë për sot quhet “Ngjarje pa lëvizje”, çfarë mendoni se do të lexoni në këtë pjesë? Si parashikoni se do të rrjedhin ngjarjet?</p> <p>Nxënësit bëjnë disa parashikime edhe pasi lexohet tregimi pjesë pas pjesë, dallohet nxënësi që bëri parashikimin më të saktë.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Ditari dypjesësh</p> <p>Nxënësit lexojnë zinxhir pjesën. Shpjegohen fjalët e reja dhe fjalë të tjera që nuk kuptohen nga nxënësit meqë pjesa është në dialektin e veriut. Më pas, në mënyrë të pavarur udhëzohen të punojnë rubrikën “Kuptojmë tekstin”. Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.</p> <p><b>1. Përgjigjuni pyetjeve në tabelë:</b></p>													
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Pyetjet</th><th>Komenti im</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="228 996 794 1108">Cili është motivi kryesor i pjesës më lart? Ku mbështetet autori për të ndërtuar fabulën e kësaj proze?</td><td data-bbox="794 996 1361 1108">Motivi i mjerimit. Për të ndërtuar fabulën e kësaj proze mbështetet te përditshmëria e mjerueshme e jetës së qytetit.</td></tr> <tr> <td data-bbox="228 1108 794 1176">A del këtu një pamje që shihej rëndom në rrugët e qytetit?</td><td data-bbox="794 1108 1361 1176">Po.</td></tr> <tr> <td data-bbox="228 1176 794 1489">Proza e mësipërme ka nota: trishtimi; revolte; gëzimi; kënaqësie.</td><td data-bbox="794 1176 1361 1489">Notat e <i>revoltës</i> janë të gërshetuara dhe me ato të <i>trishtimit</i>. Revolta ngrihet ndaj mjerimit dhe barbarizmit që i bëhet njeriut.</td></tr> <tr> <td data-bbox="228 1489 794 1736">Shënoni disa detaje që ju bëjnë përshtypje gjatë leximit.</td><td data-bbox="794 1489 1361 1736">Fshikullimi i kamxhikut Kali kufomë Sytë pa lëndë, pa lëvizje Barbarizmi i njeriut Fëmijët që presin të hanë</td></tr> <tr> <td data-bbox="228 1736 794 2087">Cila është pika kulmore e përshkrimit migjenian?</td><td data-bbox="794 1736 1361 2087">Përshkrimi i trishtimit në sytë e kalit, si të ishte njeri. “N’ata dy sy, që aq u ngjajnë syve të njeriut, ishte i shkruem fundi i jetës së tij. Nga ata dy sy pikoishin (në mënyrë si ke njeriu!) dy pika të njëj lingu ndërpamës... Si t’ishin lotë. Ata dy sy, të një lande pa ngjyrë, pa lëvizje, pa jetë, flitshin për një barrë që then kurrizin, flitshin për mjerimin e krijesave të kësaj bote, flitshin për një kufomë”</td></tr> </tbody> </table>	Pyetjet	Komenti im	Cili është motivi kryesor i pjesës më lart? Ku mbështetet autori për të ndërtuar fabulën e kësaj proze?	Motivi i mjerimit. Për të ndërtuar fabulën e kësaj proze mbështetet te përditshmëria e mjerueshme e jetës së qytetit.	A del këtu një pamje që shihej rëndom në rrugët e qytetit?	Po.	Proza e mësipërme ka nota: trishtimi; revolte; gëzimi; kënaqësie.	Notat e <i>revoltës</i> janë të gërshetuara dhe me ato të <i>trishtimit</i> . Revolta ngrihet ndaj mjerimit dhe barbarizmit që i bëhet njeriut.	Shënoni disa detaje që ju bëjnë përshtypje gjatë leximit.	Fshikullimi i kamxhikut Kali kufomë Sytë pa lëndë, pa lëvizje Barbarizmi i njeriut Fëmijët që presin të hanë	Cila është pika kulmore e përshkrimit migjenian?	Përshkrimi i trishtimit në sytë e kalit, si të ishte njeri. “N’ata dy sy, që aq u ngjajnë syve të njeriut, ishte i shkruem fundi i jetës së tij. Nga ata dy sy pikoishin (në mënyrë si ke njeriu!) dy pika të njëj lingu ndërpamës... Si t’ishin lotë. Ata dy sy, të një lande pa ngjyrë, pa lëvizje, pa jetë, flitshin për një barrë që then kurrizin, flitshin për mjerimin e krijesave të kësaj bote, flitshin për një kufomë”	
Pyetjet	Komenti im												
Cili është motivi kryesor i pjesës më lart? Ku mbështetet autori për të ndërtuar fabulën e kësaj proze?	Motivi i mjerimit. Për të ndërtuar fabulën e kësaj proze mbështetet te përditshmëria e mjerueshme e jetës së qytetit.												
A del këtu një pamje që shihej rëndom në rrugët e qytetit?	Po.												
Proza e mësipërme ka nota: trishtimi; revolte; gëzimi; kënaqësie.	Notat e <i>revoltës</i> janë të gërshetuara dhe me ato të <i>trishtimit</i> . Revolta ngrihet ndaj mjerimit dhe barbarizmit që i bëhet njeriut.												
Shënoni disa detaje që ju bëjnë përshtypje gjatë leximit.	Fshikullimi i kamxhikut Kali kufomë Sytë pa lëndë, pa lëvizje Barbarizmi i njeriut Fëmijët që presin të hanë												
Cila është pika kulmore e përshkrimit migjenian?	Përshkrimi i trishtimit në sytë e kalit, si të ishte njeri. “N’ata dy sy, që aq u ngjajnë syve të njeriut, ishte i shkruem fundi i jetës së tij. Nga ata dy sy pikoishin (në mënyrë si ke njeriu!) dy pika të njëj lingu ndërpamës... Si t’ishin lotë. Ata dy sy, të një lande pa ngjyrë, pa lëvizje, pa jetë, flitshin për një barrë që then kurrizin, flitshin për mjerimin e krijesave të kësaj bote, flitshin për një kufomë”												

**Analizojmë tekstin**

Në këtë rubrikë mësuesi/ja mund të përdorë, aktivizojë nxënësit nëpërmjet metodës së pyetjeve zinxhir ose kubizmit.

**2. Kali ka një emër, ndërsa njeriu jo. Si e shpjegoni këtë zgjedhje të autorit?**

Njeriu qenie ekzistencialiste (orientohen nxënësit rreth domethënies që ka fjala “ekzistencialist”)

**3. Zbërtheni figurën:**

Kali, bota e mjerueme - e fundit: kufomë - elipsë, epitët.

**4. Si përshkruhen sytë e kalit në paragrafin e katërt? Jepni dy karakteristika të tyre. Në ç'konkluzion mbërrin autori duke përshkruar ata?**

Nëpërmjet krahasimeve të shumta, Migjeni i përshkruan sytë e kalit të afërt me sytë e njeriut.

**5. Njeriu herë e mallkon dhe herë e merr me të mirë kalin. Gjejini këto dy momente dhe tregoni si e nxjerr kjo gjë atë përballë kalit.**

Hyjo, Hyjo! Të marroftë zoti! Hyjo! të hangërt dreqi! Hyjo! Hyjo të pasha hajrin, – Dhimbjen që ka brenda vetes njeriu ia nxjerr kalit. Barra shumë e rëndë, kali nuk e mban dot se është bërë kufomë, fëmijët që presin bukë në shtëpi një kallkofoni ndjenjash të përziera në shfryrjen e mallkimeve dhe “përkëdhelive” ndaj kalit.

**6. Ndaj kalit, mban qëndrim i zoti, vetë autori por edhe lexuesi. Si e sheh secili prej tyre kalin?**

Si e sheh i zoti kalin?	Si e sheh autori kalin?	Si e shihni ju?
Si kafshë pune	Si qenie me shpirt, i dhimbset në vuajtjen e tij.	Njeriun, kalin, të gjithë të kryqëzuar në një gjendje mundimi e dhimbjeje të jashtëzakonshme dhe nuk dimë kush ka të drejtë: kali apo njeriu?!

**Interpretoni tekstin****7. Mesazhi që përcjell shkrimtari këtu, është i lidhur me:**

- Në këtë pyetje mësuesi/ja kërkon që nxënësit të argumentojnë përgjigjet e tyre.

**8. Përdorimi i gjerë i klasës së foljeve këtu është i lidhur:**


me gjendjen e njeriut dhe kalit;

me rimën.

Kohët e foljeve në skicë janë përgjithësisht në të pakryerën (fshikullonte, binte, njihte, ngante, dridheshin, mbylleshin, pikojsin, flitshin) pra veprimi nuk është përfunduar dhe jo vetëm kaq ngjarja nuk dihet se kur ka filluar, një situatë të ngjashme të rrëfimit të një ngjarjeje pa lëvizje, personazhesh të kapur në një grackë kohore dhe është i lidhur me gjendjen e njeriut dhe të kalit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Pemë mendimi

**Reflektoni rreth tekstit**

**9. Nga teksti del mesazhi, që vuajtja dhe dëshpërimi janë përhapur dhe ndikojnë kudo dhe si rrjedhim që të gjithë mund të kenë të drejtë.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për zbulimin e motiveve të pjesës, për dallimin e mesazhit që përcjell pjesa etj.


**Detyrë shtëpie:** Gjeni një pjesë tjetër të Migjenit dhe konstatoni ngjashmëritë ose dallimet me këtë pjesë.

## PLANIFIKIMI I TEMËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Diktim për temat e drejtshkrimit		Situata e të nxënit: Diktim me të lexuar dhe plotësim	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: Diktim Normë drejtshkrimore Standard	
Burimet: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të bashkëtingëlloreve nistore s/z dhe për krijimin e çiftëve antonimike gjatë përdorimit të tyre.			

## PLANIFIKIMI I TEMËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore; Fjalëformim <b>Tema mësimore:</b> <b>Fjala dhe pjesët përbërëse të saj</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë: “Dhe në gjuhë përdoren pluset” Nxënësit zbërthejnë fjalët e dhëna Zbukurojmë Fluturoj Përmirësoj Shkollar etj. Z+bukur+0+jmë Kështu veprojmë dhe për fjalët e tjera.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon përbërësit e fjalës rrënjë, temë, mbaresë, parashtesë dhe prapashtesë;</li><li>- identifikon lehtësisht pjesët përbërëse të secilës fjalë të paragrafit të parë të pjesës me titull: “I forti”, por jo vetëm.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Përbërësit e fjalës Rrënjë Temë Mbaresë Prapashtesë Parashtesë	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi, DDM, Punë në dyshe, Shkrim i lirë</i> <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimi</i>			

**Ndërtimi i njohurive të reja: DDM**

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet, për të plotësuar përgjigjet e pyetjeve të bëra prej tyre.

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Fjalët e prejardhura dhe të përbëra ndahen në pjesë.	Çfarë tregojnë morfemat fjalëformuese? Po ato trajtëformuese?	Mbaresa quhen ato morfema trajtëformuese, që qëndrojnë në fund të fjalës.  Ato tregojnë kuptimet gramatikore të fjalës: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën.  tek emri; gjininë dhe numrin te mbiemri; kohën, mënyrën dhe veten te folja.
Njësia më e vogël kuptimore është morfema.	Nëse do të hiqni morfemat trajtëformuese të fjalës <i>alpinistet</i> , cila është pjesa që mbetet?	Tema e fjalës është pjesa e fjalës që mbetet, pasi asaj i hiqen të gjitha morfemat trajtëformuese. Kështu tema e fjalës <i>malin</i> është <i>mal</i> (pa –in që është morfemë trajtëformuese e rasës kallëzore në trajtë të shquar).
Parashtesat dhe prapashtesat janë morfema fjalëformuese, ndërsa mbaresat janë morfema trajtëformuese.	A mund të ndahet fjala gur? Po gurore? Pse?	<i>Rrënja e fjalës</i>  Rrënja është pjesa e fjalës që mbetet, pasi i hiqen të gjitha morfemat ndajshesore (parashtesa, prapashtesa, mbaresa, nyje). Rrënja është bartësja e kuptimit themelor leksikor të fjalës.

Tabela plotësohet nga nxënësi të ndryshëm. Mësuesi/ja ndërhyr vetëm në rastet kur ka paqartësi.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe****1. Nënvizoni mbaresat e fjalëve të mëposhtme. Për secilën fjalë, gjeni temën dhe rrënjën e saj.**

*shkoj, duroj, lotët, përkulte, degët, përkëdheli, flokët, vështrimi, vajzat, luanin, vrapoi, shkeli, gishtat, endacakët, lulishtare, brohoritje, shkop, bashkëmoshatarët, mbishkruani.*

Fjala	Rrënja	Tema	Mbaresa
Vrapoi	Vrap	vrapo	I
Shkeli	Shkel	Shkel	i
Vajzat	Vajz(ë)	Vajz(ë)	at

2. Identifikoni pjesët përbërëse të secilës fjale të paragrafit të parë të pjesës me titull “I forti”.

3. Gjeneroni në fjalët me shkronja të zeza mbaresat, temën, parashtesat, prapashtesat dhe rrënjën.

Aeroplani merr **lartësinë** me shpejtësi. Zemra me rreh me forcë. Përpara meje një mori **instrumentesh**.

Disa lëvizin si të gjalla disa **vështrojnë** të palëvizshme numrat, **shigjetat** dhe akrepat e tyre. Ja, me këto instrumente piloti bën **vazhdimisht** një dialog të gjatë, këtu, lart në qiell. **Gjuha** e tyre është e saktë, e përpiktë. Mos u beso **syve**, thonë **ata**, kur përreth është errësirë. Na beso neve, tani je në këtë lartësi. Po mua më duket se jam më ulët? Jo, të gënjejnë **dritat** e tokës. Më duket sikur motori po pakëson xhirot. S’është e vërtetë. Të **gënjejnë** veshët. **Motori** punon në rregull. Instrumentet luftojnë vazhdimisht me **iluzionet** që mund t’i **lindin** pilotit në fluturim, sidomos në **fluturimet** e natës. Piloti duhet t’u besojë gjithmonë instrumenteve. Kur humbet **besimin** në to, atëherë rrezikun e ke mbi kokë, ai fluturon bashkë me ty.

Fjala	Tema	Parashtesa	Prapashtesat	Rrënja	Mbaresa
Lartësinë	Lartësi	-----	Si	i/e lartë	Në
Instrumentesh	Instrument	-----	-----	instrument	Esh
Vështrojnë	Vështro	-----	O		Jnë
Gjuha	Gjuha	-----	-----	Gjuh(ë)	a
Syve	Sy	-----	-----	sy	ve
Ata	Ata	-----	-----	Ata	-----
Beso	Bes(ë)	-----	O	Bes(ë)	-----
Shigjetat	Shigjet(ë)	-----	-----	Shigjet(ë)	At
Vazhdimisht	Vazhdim		Im /isht	Vazhd(o)	
Dritat	Drit (ë)			Drit(ë)	at
Motori	Motor	-----	-----	Motor	i
Besimin	Besim		im	Bes(ë)	in
Fluturimet	Fluturim	-----	Im	Flutur	et

Gjeni parashtesat në fjalët e grupit të parë dhe prapashtesat në ato të grupit të dytë.

Fjala	Parashtesa
Përmbledh	Për
Nënkryetar	Nën
Zbardh	Z
Skuq	S
i paplotë	Pa
Rindërtoj	Ri
Mbingarkoj	Mbi

Fjala	Prapashtesa
Urdhëroj	O
Tregtar	Tar
Vendos	Os
Traktorist	Ist
Lumturi	I
Hyrje	Je
shtëpizë	zë

### Shkrim i lirë

Formo fjalë të reja me temat e dhëna, përdori ato në një tekst dhe më pas bëj analizën e tyre:

Dorë, gjumë, udhë, zemër, besë, vend, luftë Nxënësit punojnë dhe më pas lexojnë punët e tyre duke i vlerësuar.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin saktë të përbërësve të fjalës rrënjës, temës, mbaresës etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: NJOHURI GJUHËSORE</b> <b>Tema mësimore: Analiza e fjalëve sipas ndërtimit dhe formimit</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë në çift	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			

<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton rreth mënyrave të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;</li> <li>- analizon fjalët sipas mënyrës së ndërtimit;</li> <li>- analizon fjalët sipas mënyrës së formimit;</li> <li>- klasifikon fjalët sipas mënyrës së fjalëformimit të tyre.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Fjalë të parme Të prejardhura Të përngjitura Të përbëra
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Letërsi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** DDM

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Di

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Tema e fjalës mund të jetë e parme dhe jo e parme. Tema është e parme kur nuk ka asnjë morfemë trajtëformuese. Pra, ajo është edhe rrënjë e fjalës, si: <i>dal, sjell, gur, afër, mirë</i> etj. Tema është jo e parme kur ka edhe morfema fjalëformuese, si: <i>puno</i> (ka edhe morfemën fjalëformuese -o), <i>zhvendos, çorganizo</i> etj.		
<b>fjalëformimi me prejardhje formim parashtesor, prapashtesor dhe të dyja së bashku përbërje nga bashkimi i dy temave</b>		

**Plotësojmë tabelën me njohuritë që nxënësit dinë për fjalëformimin.**

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Dua të di


DI	DUA TË DI	MËSOVA
Tema e fjalës mund të jetë e parme dhe jo e parme. Tema është e parme kur nuk ka asnjë morfemë trajtëformuese. Pra, ajo është edhe rrënjë e fjalës, si: <i>dal, sjell, gur, afër, mirë</i> etj. Tema është jo e parme kur ka edhe morfema fjalëformuese, si: <i>puno</i> (ka edhe morfemën fjalëformuese -o), <i>zhvendos, çorganizo</i> etj.	<b>A ka mënyra të tjera të ndërtimit të fjalëve?</b> <b>Si duhet analizuar fjala sipas ndërtimit?</b> <b>Po sipas formimit?</b>	Nyjëzimi mbiemra të nyjshëm, emra prejfoljore asnjans dhe femërore Përngjitja me ngurosjë togfjalëshash <i>emra, mbiemra, ndajfolje, lidhëza, përemra, numërore farefis, gjëgjëzë, njëmbëdhjetë, njëzet</i> Konversioni me ndryshimin e pjesës së ligjëratës <i>afër, anës, brenda, drejt, gjatë, jashtë ku, kur</i> .
<b>fjalëformimi me prejardhje formim parashtesor, prapashtesor dhe të dyja së bashku përbërje nga bashkimi i dy temave</b>		Mënyrat e përziera me parashtesim, prapashtesim dhe përbërje njëkohësisht emra, mbiemra, numërore, ndajfolje <i>pesëmbëdhjetëditëshi, shumëkëndësia zakonshëm, i përgjithshëm, i pashkollë</i>

		Pra, kur e analizojmë fjalën sipas ndërtimit, identifikojmë rrënjën, mbaresën dhe, kur është e prejdardhur, parashtesën dhe prapashtesën. Analizë fjalëformuese është analiza e mënyrës së formimit të fjalës. Sipas kësaj analize, identifikohen morfemat e fjalës dhe mënyra se si janë bashkuar ato me njëra-tjetrën.
<p><i>*Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet, të shohin informacionin e dhënë në tekst dhe më pas plotësojnë tabelën.</i></p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mësova</b></p> <p><b>Punohen ushtrimet e dhëna në tekst</b></p> <p><b>1) Bëni analizën e përbërësve të fjalëve: rindërtoj, vendos, urdhëroj, zbardh, skuq, argjendar, peshkatar.</b></p> <p>ri -parashtesë      vend- rrënjë dhe os-prapashtesë          rindërtoj -tema      urdhëroj -urdhër(rrënjë)- o(prapashtesë) -j(mbaresë)          o-prapashtesë          j-mbaresë</p> <p><b>2) Gruponi fjalët e mëposhtme, sipas mënyrës së fjalëformimit të tyre.</b></p> <p><i>drejtësi, katërmbëdhjetë, i akullt, veshmbathje, treditëshi, rishfaq, përkthej, i dobishëm, shlyej, përdhe, domethënie, përputh, skuq, mendoj, vulos, lumturi, gjëgjëze, blerës, i hapur, futbollist, vendqëndrim, gjykatës, kopshtar, nëndrejtor, i përjavshëm, thashetheme, nga, përmirësoj, dituri, shqep, anembanë, veshje, argjendar, mbikalim, drejt, zhvesh, askush.</i></p> <p>fjalë të parme drejt          fjalë të prejdardhura me parashtesa: shqep, zhvesh, skuq, shlyej, përdhe, rishfaq, përkthej, përputh, nëndrejtor;          fjalë të prejdardhura me prapashtesa: veshje, vulos, mendoj, lumturi, drejtësi, futbollist, argjendar, blerës, dituri, gjykatës, kopshtar;          fjalë të prejdardhura me parashtesa dhe me prapashtesa njëkohësisht: përmirësoj, i përjavshëm          fjalë të formuara me nyjëzim: i hapur, i akullt;          fjalë të përbëra: vendqëndrim;          fjalë të përngjitura: gjëgjëzë, katërmbëdhjetë, askush, domethënie, anembanë;          fjalë që mund të formohen me konversion          fjalë të formuara me mënyra të përziera: i dobishëm.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b>          Analizoni fjalët e mëposhtme:          - sipas ndërtimit të tyre;          - sipas formimit të tyre.  <i>pemishten, përfundojmë, dorëzimin, gjumash, çorganizimi, i panjohur, përmirësimi, këmbësorët, fletorja, padrejtësia, zhvendosje, këngëtar, ditëlindje, shumëgjyreshë</i></p>		

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: I forti (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Kush është më i fortë në klasë. A ka ndonjë nxënës të fortë në klasën tuaj? Pse ju e quani të tillë? A përballen lehtësisht bashkëmoshatarët me të? Po më të rriturit apo më të vegjlit? Jepni mendimin tuaj.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b>  - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca digjitale			

<p><b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon temën dhe mesazhin që përcjell pjesa;</li> <li>- përshkruan personazhet duke u nisur nga mbresat që lë ai te lexuesi;</li> <li>- krahason cilësitë e personazheve.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Djalë i fortë Sjellje agresive dhe të dhunshme Poshtërim Frikë Ndjesë</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti mësimor</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Imagjinatë e drejtuar, Punë në dyshe, Hartë personazhi</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Imagjinatë e drejtuar</p> <p>Kujtoni pak Hakëlbërr Finin tek “Aventurat e Tom Sojerit”, çfarë cilësish kishte ai. Nxënësit diskutojnë dhe japin mendimet e tyre.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë në dyshe</p> <p>Në grupe dyshe, nxënësit punojnë rubrikën “të kuptojmë tekstin”.</p> <p><b>Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.</b></p> <p><b>Cila është tema e kësaj pjese?</b></p> <p>Tema e “luftës” kundër dhunës dhe sjelljeve agresive në shkollë e jashtë saj ose lufta kundër bullizmit. Nxënësit mund të japin mendime të ndryshme.</p> <p><b>Si e përshkruan autori Berri Temërlejinin?</b></p> <p>Ishte i hijshëm, e i rrumbullakosur në pamje, edhe pse jo i shëndoshë; mbante syze dhe në fytyrën e butë e ngjyrë rozë i fekste aparati dentar.</p> <p><b>Cili është shpjegimi që Piteri i jep “suksesit” të Berrit?</b></p> <p>Shpjegimi që Piteri i jep “suksesit” të Berrit: Jemi ne. Jemi ne që e kemi parë si të fortin e shkollës. S’është më i fortë se asnjëri prej nesh. Tërë forca dhe hija e tij e rëndë është thjesht pjellë e mendjes sonë, një përfytyrim i yni.</p> <p><b>Si ndihet Piteri dhe si reagon ai?</b></p> <p><b>Cilat janë fjalët e Piterit që e shfuqizojnë Berrin?</b></p> <p>Fjalët e Piterit që e shfuqizojnë Berrin janë: palluqe surratrozë... me dhëmbë hekuri.</p> <p><b>Cili është qëndrimi i nxënësve që ndodhen e vështrojnë situatën?</b></p> <p>Nxitës, indiferent... disa mbajnë anën e Berrit e të tjerët anën e Piterit.</p> <p><b>Cila është sjellja e Berrit pas konfliktit me Piterin?</b></p> <p>Berri ishte bërë flakë i kuq dhe përvëlonte i tëri.</p> <p><b>Çfarë ndodh mes Piterit dhe Berrit në vijim?</b> Ata bëhen shokë dhe shkojnë mirë me njëri-tjetrin.</p> <p><i>Nxënësit e shohin tekstin në një këndvështrim tjetër duke e analizuar atë.</i></p> <p><b>Gjeni në tekst ato fjali që tregojnë:</b></p> <p><b>qëndrimin problematik të Berrit;</b> Berri foli sërish: “Është mundësia e fundit. Ma jep atë mollë ose bëhu gati të hash një grusht që do të të çojë në stratosferë”. Madje edhe Berri rrudhi vetullat dhe nuk po luhatej më sa para-mbrapa. “Si the, ore?” Berri ishte bërë flakë i kuq dhe përvëlonte i tëri.</p> <p><b>triumfin e Piterit;</b></p> <p>Të gjithë i kishin dalë kundër. Askush nuk e besonte më.</p> <p><b>ndryshimin e sjelljes së Berrit;</b></p> <p>Më vonë, në klasë, Berri nuk pipëtiu, atë mëngjes. U kërrus mbi fletore, pa i ngritur sytë nga frika se mos ndeshte vështrimet e të tjerëve. Dukej sikur donte të bëhej i vogël fare, të zhdukej fare nga faqja e dheut.</p> <p><b>qëndrimin dinjitoz të Piterit;</b></p> <p>Teksa dilnin për pushimin e drekës, Piteri i la një pusullë Berrit mbi bankë. Shkruhej: “Ke dëshirë të luajmë me top? Piteri.”</p> <p><b>Cila mendoni se është pika kulmore e kësaj pjese?</b></p> <p>Pika kulmore fillon nga kundërshtimi i Piterit, poshtërimi në sytë e të gjithëve duke i thënë: “S’je tjetër veçse një palluqe surratrozë... me dhëmbë hekuri.” Tashmë Berri po ngashërente aq fort sa nuk kishte fuqi as të largohej.</p> <p><b>Krahasoni cilësitë e dy personazheve. Argumentoni mendimin tuaj.</b></p> <p>Për këtë nxënësit do të ndërtojnë hartën e personazheve.</p>	



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

Në fund pasqyrohen punimet e nxënësve para klasës, ku përzgjidhen dhe disa nga punimet më të mira.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për: të kuptuarit e tekstit, për analizimin me argumente të tij dhe krahasimin e cilësive të dy personazheve të pjesës.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruani një ngjarje, e cila trajton një temë të ngjashme me këtë të rrëfimit të mësipërm.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: I forti</b> <b>(Ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Viktimë e bullizmit quhet një fëmijë që nuk ndjehet i sigurt në shkollë, për shkak të kërcënimeve ose të dëmtimeve fizike nga një ose disa nxënës që ndodhen në shkollën e tij/saj (Sanders & Phye, 2004). A ka raste bullizmi në klasën tuaj? Çfarë lloj bullizmi keni ndjerë më shumë atë virtual ose kibernetik, racial, seksual, emocional-psikologjik apo fizik. Diskutoni me shembuj.	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth formave të gjithave formave të sjelljes agresive si: 1. Bullizmi fizik. 2. Bullizmi emocional/psikologjik. 3. Bullizmi seksual. 4. Bullizmi racial. 5. Bullizmi virtual ose bullizmi kibernetik;</li><li>- ritregon ngjarjen duke e kthyer në vetën e parë për të parë ndryshimet gjuhësore që ndodhin;</li><li>- flet për ngjarje të ngjashme që mund të ketë kaluar dhe ai/ajo;</li><li>- zbulon mesazhin që përcjell pjesa.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Djalë i fortë Sjellje agresive dhe të dhunshme Poshtërim Ndjesë Frikë	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Shkrim i shpejtë, Punë individuale <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Kontrolli i detyrave të shtëpisë Kontrollohen detyrat e shtëpisë dhe lexohen disa nga punimet e nxënësve. Mësuesi/ja dhe nxënësit diskutojnë për punimet që nxënësit kanë realizuar. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Diskutim Hapet teksti dhe nxënësit udhëzohen të punojnë me rubrikën “Gjuha e tekstit”. Në ç’vetë e rrëfen autori ngjarjen? Provoni ta tregoni ngjarjen sikur ju jeni Piteri për paragrafin, i cili fillon me fjalinë: .. Piteri, pa ia bërë syri tërr, e afroi mollën në gojë deri te: <i>Kafshoi një tjetër copë molle...</i> <b>Cilat janë ndryshimet gjuhësore që kryet gjatë rrëfimit tuaj.</b> <i>Nuk ma bën syri tërr, e afroj mollën në gojë ..dhe kafshoj një alamet cope. “E di çfarë?” i them ngadalë, pa e ndërprerë për typjen “Mua nuk ma mbush syrin.”</i> Turma mban frymën pezull, dikush kukuris me zë të ulët. Madje edhe Berri rruadh vetullat dhe nuk luhetet më sa para-mbrapa. “Si thua, ore?”			

Mua m'u zhduk frika si me dorë.

Kafshoj një tjetër copë molle...

*Ndryshimet gjuhësore që ndodhin janë në përdorimin e kohëve të foljes nga veta e tretë në vetën e parë.*

**Pasi të gjeni kuptimin e parë të fjalëve me shkronja të zeza, zëvendësojini ato me të tjera sinonime, duke ruajtur kuptimin e fjalisë.**

*Kishte bërë **sus** atë tipin...Sus – pa folur dhe pa lëvizur nga nderimi ose nga frika, e detyron të rrijë urtë.*

*Kurse Piteri **gufonte** i tëri...**gufonte** – Del jashtë me forcë, shpërthen.*

*Piterit iu zhduk frika **si me dorë**. – menjëherë*

*Piteri ndjeu zërat që **morën dhenë** në gjithë oborrin – u përhapën*

**Reflektojmë rreth tekstit:** Shkrim i shpejtë

**Sipas jush, si veproi Piteri? Po ju si do të kishit vepruar në një situatë të tillë?**

Nxënësit shkruajnë përshtypjet e tyre rreth veprimit të Piterit dhe mendimit se si do të vepronin ata nëse ndodheshin në një situatë të tillë. Në fund të punës lexohen dhe diskutohen disa punë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve për të zbuluar mesazhet që përcjell pjesa. Njëri nga mesazhet që përcjell ky tregim është:

*Frika ekziston vetëm në mendjet tona.*

Shkruani edhe të tjera formulime, që përcjell te ju kjo ngjarje.

Nxënësit, pasi shkruajnë formulimet e mesazheve, i lexojnë ato para klasës.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për leximin bukur e qartë të pjesës, për dallimin e cilësive të personazheve të pjesës, për ndarjen e eksperiencave personale me shokët.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një ese argumentuese me temë: “Bullizmi vret”.


## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Shkruajmë</b> <b>Tema mësimore: Krahasojmë personazhe</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Rikujtojmë personazhet te tregimi “I forti” Berri dhe Piteri	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon lehtësisht ndryshimet dhe të përbashkëtat te personazhet;</li><li>- krahason personazhet nga tekste të ndryshme letrare;</li><li>- përdor mënyra dhe skema të ndryshme për të krahasuar personazhet.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Krahasim Personazh Bota e brendshme Pamja e jashtme	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, tekste letrare të ndryshme		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<i><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bashkëbisedim, Diagrami i Venit, Punë individuale</i> <i><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim</i> Në librat që lexojmë mund të kemi më shumë se një personazh të preferuar, por mund të kemi edhe personazhe që janë me karaktere shumë të ndryshme nga njëri-tjetri. Këto personazhe mund t'i gjejmë në të njëjtin libër, por edhe në libra të ndryshëm. Shpesh na duhet t'i krahasojmë personazhet për të nxjerrë në pah ndryshimet midis tyre dhe të përbashkëtat që mund të kenë. Ka mënyra të ndryshme për të përshkruar dhe krahasuar personazhet. <i><b>Rikujtojmë personazhet e Piterit dhe të Berrit, të Tom Sojerit dhe Hakëlbërr Finit.</b></i> Çfarë dallimesh dhe të përbashkëdash kanë ato? Plotësojmë tabelën:			

Personazhi	Paraqitja	Bota e brendshme	Çfarë bën?	Çfarë thotë?	Ku duket kjo cilësi?
<b>Berri</b>	Ishte i hijshëm, i rumbullakosur në pamje, jo i shëndoshë; mbante syze dhe në fytyrën e butë e ngjyrë rozë i fekste aparati dentar	Hijerëndë Ngatërrestar Sherrxhi I frikshëm	Ngatërrohet në të gjithë, moshatarë dhe jo moshatarë. Hiqej si i forti i shkollës.	“Mos e zgjat, sille këtu!” “Ma jep atë mollën, ndryshe ta bëra surratin përshesh.” Ta zëmë se i pëlqente një lodër që e kishte një fëmijë në oborr; pa e bërë të gjatë, ia zhvaste nga duart. Apo kur i duhej një laps në klasë, kthehej dhe “ia merrte hua” shokut pa e bërë të gjatë.	Të gjitha këto cilësi duken në veprimet e fjalëve të tij.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Diagram Veni

Plotëso të përbashkëtat dhe dallimet midis personazheve të tregimit “I forti” në diagramin e Venit.



Nxënësit diskutojnë për saktësinë e kryerjes së detyrës.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

Krahasoni personazhet tuaja në skemën e mëposhtme. Shkruani cilësi dhe vendosni yje ( ), nga 1-5 .

Personazhet	Personazhi 1	Personazhi 2
Emri mbiemri		
Titulli i librit		
Autori		
Pamja e jashtme		
Bota e brendshme		
Interesat		
Me se merret		
Miqtë që ka		
Shtëpia ku banon		

Përkthyeri personazhet tuaja, duke u mbështetur në skemën e mësipërme.

Nxënësit punojnë për përshkrimin e personazheve. Në qoftë se punën nuk e mbarojnë dot në klasë jepet për detyrë shtëpie.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për krahasimin e personazheve sipas skemës së caktuar.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Udhëtimi i Parvanës</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Shikohen sekuenca nga filmi “Hurt locker” që ka fituar 4 çmime “OSCAR” ose “American sniper”.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth jetës dhe veprës letrare të Deborah Ellis;</li><li>- diskuton rreth përballjes së fëmijëve afganë, sirianë dhe irakenë me luftën dhe konfliktet;</li><li>- ndërton hartën e personazhit të Parvanës;</li><li>- gjen në tekst fjalë të përbëra, të prejardhura, të përveçme, pjesëzat.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Luftë Dhimbje Gërmadhë Afganistan Rrënoja	


**Burimet:** Teksti mësimor, CD me filma, videoprojektor.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** letërsi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Pemë mendimi, Punë në dyshe, Rrjet diskutimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Pemë mendimi

Nxënësit së bashku me mësuesen ndërtojnë pemën e mendimit për jetën dhe veprën e autores Deborah Ellis.



**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

Nxënësit fillojnë lexojnë zinxhir pjesë. Më pas shpjegohen fjalët e reja.

**Punojmë rubrikën** "Kuptojmë tekstin".

**1. Lexoni pjesën dhe shënoni me V nëse pohimi është i vërtetë dhe me G nëse është i gabuar.**

Parvana është personazhi kryesor i këtij rrëfimi.	V	G
Parvana është personazh dytësor i rrëfimit.	V	G
Cilësia kryesore e Parvanës është trimëria.	V	G
Parvana është një vajzë guximtare dhe e dashur.	V	G
Prej më shumë se njëzet vjetësh, Afganistani rrënohet nga lufta.	V	G
Në rrënojat e shtëpive të braktisura nga bombardimet, Parvana gjen një foshnje të braktisur.	V	G

**Analizojmë tekstin - është rubrika tjetër që do të punohet.**

## 2. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Cila është tema e kësaj pjese?	Moshumbja e vlerave njerëzore me gjithë vuajtjet e kaluara nga lufta.
Situata në rrëfim është dramatike. Renditni elementet që e bëjnë atë të tillë.	Bombardimet Fshati i kthyer në gërmadha. Shtëpitë e braktisura nga njerëzit Fëmija i braktisur
Si komunikon Parvana me foshnjën? Çfarë zbulon ky komunikim lidhur me karakterin e saj?	Parvana komunikon ngrohtësisht me foshnjën dhe kjo tregon natyrën njerëzore paqësore dhe miqësore të saj.

## Gjuha e tekstit

### 3. Zëvendësoni fjalët me shkronja të zeza me sinonimet e tyre, duke ruajtur kuptimin e fjalisë.

E **këqyri** fshatin për një kohë të gjatë, po nuk **shqoi** asnjë lëvizje.

E vështroi fshatin për një kohë të gjatë dhe nuk dalloj asnjë lëvizje.

### 4. Plotësoni tabelën e mëposhtme, duke gjetur në tekstin e mësipërm fjalët e kërkuara.

5 pjesëza	<i>Nuk, më...</i>
5 fjalë të përbëra	<i>Mbasdite, vendbanim, frymëmarrje, njëdhomëshe, ulje-ngritjet</i>
5 fjalë të prejardhura	<i>Rindërtuar, kujdesur, i zhveshur, i frikshëm, e palara</i>
3 emra të përveçëm	<i>Afganistan, Kabul, Parvana</i>
5 folje në kohën e pakryer	<i>Jetonin, bombardonte, rrëmbente, vraponte, qante</i>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Rrjet diskutimi

## Reflektojmë rreth tekstit

Sipas një studimi, rreth 14 milionë fëmijë dhe adoleshentë në Siri, Irak dhe Afganistan përballen me luftën, konfliktet dhe padrejtësitë çdo ditë. Ndërkaq ky është dhe shkaku i ndezjes së krizave të refugjatëve dhe emigrantëve kudo në Evropë.

Diskutoni rreth të dhënave të këtij studimi.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të kuptuarit e tekstit, për analizën dhe reflektimin e tekstit.

**Detyrë shtëpie:** Zgjidhni mes dy temave:

a) Ndërtoni hartën e personazhit të Parvanës.

b) Zhvilloni një diskutim me temë: “Lufta kundër varfërisë”. Kërkoni në internet dhe sillni sa më shumë fakte dhe argumente që mbështesin dhe zbërthejnë temën.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të shkruajmë Tema mësimore: Ritregojmë ndodhi		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>-Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- kujton rregullat për të realizuar ritregimin e një ndodhie apo tregimi;</div><div>- dallon paragrafët e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes në një tregim;</div><div>- rishkruan tregimin duke ndryshuar hyrjen dhe mbylljen.</div></div>		Fjalët kyçe: Ritregim Paragrafë Hyrje, zhvillim, mbyllje Ndodhi	

**Burimet:** Libri i nxënësit, tekste letrare të ndryshme, përvoja të nxënësve

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Letërsi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Stuhi mendimi, Shkrim i lirë, Punë në dyshe

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Stuhi mendimi

Për çdo paragraf përcaktohen fjalët kyç dhe informacioni kryesor që përcjell paragrafi.

**Ritregimi**

Ndahet pjesa në paragrafë

Hyrje, zhvillim, mbyllje

Pjesa nuk ndryshohet nga ana kuptimore.

Kujdes shenjat e pikësimit!

Gjenden fjalët kyçe për çdo paragraf.

Nxënësit rikujtojnë njohuritë e marra për ritregimin e një ndodhie apo të një tregimi.

Në tabelë plotësohet organizuesi grafik me përgjigjet e nxënësve.


**Ndërtimi i njohurive të reja:** Shkrim i lirë

Ndërtoni tregimin duke u mbështetur në figurat e mëposhtme. Gjeni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit.

Vendosni numrat 1-6 pranë figurave. (Për çdo figurë shkruani nga 2-3 fjali, jo më pak se një paragraf.) Vendosini një titull tregimit tuaj.

Shkruani të plotë tregimin, duke dalluar paragrafët që i përkasin hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes.

2



3



1



5



4



6



Ditëlindja e Sonjës ishte të nesërmen. Ana, Drini dhe Bora po mendonin t'i bënin një festë surprizë. Filluan të lajmëronin gjithë shoqërinë e tyre për orën dhe vendin ku do të mbledheshin. Sarës i erdhi në viber mesazhi dhe filloi të mendohej, nëse do të behej pjesë e festës apo jo. Dëshira e madhe për të qenë mes miqsh bëri që ajo të shkonte në festë, megjithëse të nesërmen kishte provimin e matematikës në minimaturë.

Në orën 18:00 festa filloi. Gjithçka ishte përgatitur me kujdes nga organizatorët. Sonja ishte e surprizuar. Të gjithë po kënaqeshin, por Sara rrinte si mbi gjemba për provimin e së nesërmen.

Sara u përshëndet me shokët e shoqet, i uroi dhe një herë ditëlindjen Sonjës dhe u nis për në shtëpi. Aty po e priste nëna e saj e shqetësuar. Ajo i rikujtoi së bijës se provimi i së nesërmen ishte i vështirë dhe i rëndësishëm. Sara u fut në dhomë të studionte, megjithëse ishte vonë. Qepallat filluan t'i rëndoheshin dhe koka u var mbi libra. E zuri gjumi

*Të nesërmen në mëngjes ajo u ngrit herët për në provim, me shpresën e madhe që të dilte sa më mirë...*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

\*Nxënësit në dyshe do të punojnë për ushtrimin 3 në faqen 61.

Lexoni tregimin në vijim. Përcaktoni paragrafët që i takojnë hyrjes dhe mbylljes. Rishkruani tregimin duke ndryshuar hyrjen dhe mbylljen. Shtoni ndonjë episod të ri.

\*Më pas krijohet një tjetër tregim me hyrjen e mbylljen e ndryshuar.

*Olsi së bashku me nënën e tij po shkonin në shtëpi të zënë dorë për dorë. Olsi pa një lypës i cili ishte skrupullosur në një cep të rrugës dhe sytë e tij lotonin. Nënës së Olsit i erdhi keq për të dhe vendosi t'i jepte ca të holla që të blinte diçka për të ngrënë.*

*Olsi nuk ishte dakord me këtë veprim të saj, ndaj e tërhoqi me forcë atë.*

- Mos nënë, mos i jep asnjë lekë!

- Olsi, përse ke këtë urrejtje ndaj tij? Kaq pak lekë nuk na varfërojnë, por atij i shërbejnë të hajë një vakt të ngrohtë.

*Lypësi zgjati dorën dhe mbi të ranë monedhat. Ai uroi zonjën për shëndet e mbarësi në familje.*

*Nënë e bir u ulën te një stol përballë sallës së operacionit. Drithërima. Nga dritaret e gjera derdhej një dritë blu. Kirurgu punonte mbi zemrën e babait të Olsit. Nënë e bir prisnin. Nga dera doli një infermiere veshur me jeshile. Ajo hoqi maskën nga hunda dhe i thirri nënës së Olsit:*

- Mblidhuni si fis a si miq dhe ejani, se të sëmurit i duhet ende gjak... Shpejt! Nuk pret puna!

*Nëna u tjetërsua. Ata qenë vetëm. Ajo filloi t'i lutej kujdo që shihte:*

- Gjak për tim shoq. Ju lutem!

- Gjak për babanë!...

*Kalimtarët mbanin këmbët si me mëdyshje.*

- Eja e jep, ti e para, - tha infermierja.

*Nëna u zhduk. Olsi mbeti vetëm. Tani ai qante dhe lutej, lutej si fëmijë...*

- Gjak për babin, jepni gjak për babin!

*Ai u soll rrotull si i marrë. Më në fund u fut në të ndarën ku disa po dhuronin gjak. Gjak për të atin e tij. Olsi iu tha gjuha. Mbeti si një dordolec i mjerë tek pa ata dy-tre dhurues.*

*I pari qe lypësi. Olsi u përmend.*

*Nga sytë e lypësit vetëtinte një dritë qiellore, e mrekullueshme, dritë jete... Sa qe zbukuruar! Infermierja hoqi shiringën nga krahu i lypësit dhe, pa e pyetur kush, tha:*

- Ka gjak të pastër. Ja një lypës i pasur...

*Olsi deshi t'i puthte dorën, por lypësi e fshehu pas shpine.*

- Të ruajt Zoti!

*Olsi i dukej se ishte në ëndërr. Lypësi, që ai kishte përbuzur, ishte bërë shpëtimtari i babait të tij. Në ato momente ai i bëri vetes një premtim se nuk do të përbuzte askënd dhe asnjëherë. Lypësi me shpirtin si bora i kishte dhënë një mësim të mirë, të cilin ai nuk do ta harronte kurrë.*

Nxënësit lexojnë punët e tyre dhe i vlerësojnë ato.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin saktë të paragrafëve të një tregimi, shkrimin saktë të tyre, saktësinë e frazës, respektimin e shenjave të pikësimit etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore leksikologji <b>Tema mësimore:</b> Fjalët me ngjyrim emocional		<b>Situata e të nxënit:</b> Gjeni fjalët me ngjyrim emocional në vargjet e Naimit: <i>Vashë bukuroshe e bariut, që vjen me llërë përveshur</i> <i>Me zemër të dëfryer e me buzëze të qeshur</i> <i>Me dy shqerrazë ndër duar, të bukura dhe vetë</i> <i>Në sythin tënd e shoh gazin</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon në fjali ose në një tekst fjalët që përdoren me kuptim të drejtpërdrejtë dhe ato me ngjyrim emocional;</li> <li>- përdor drejt në fjali fjalët, duke u dhënë ngjyrim emocional pozitiv dhe negativ.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Ngjyrim emocional Gjuhë shprehëse – emocionale Ngjyrim emocional pozitiv dhe negativ</p>
<p><b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, fisha, tekste të ndryshme letrare</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p>Letërsi</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Mbajtje e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe.</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim</p> <p>Lexoni fragmentin e dhënë dhe gjej kuptimin e fjalëve me të zeza:</p> <p><i>Pikërisht në këtë kohë ajo dëgjoi për ilaçin e ri, “Shërimtari”. Porositi menjëherë një arkë të madhe. E provoi vetë dhe iu kënaq zemra. Ishte një lëng që të ndizte flakë, një zjarr i gjallë. Banjat dhe kurat e tjera u ndaluan në çast. Që tani e tutje ajo e lidhi fatin me “Shkrimtarin”. I dha Tomit një lugë kafeje dhe priti në anë të efektin. Dhe ja ku më në fund morën fund meraqet e saj, ja ku i ra shpirti në paqe, ja ku u thye indiferenca e djalit. Edhe flakën t’i kishte vënë atij nën vete, nuk do të gjallërohej e nuk do të shkundej më tepër. sipas Mark Twain, “Aventurat e Tom Sojerit”</i></p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja: mbajtje e strukturuar e shënimeve.</b></p> <p>Ngjyrimi emocional i fjalëve është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj që ai komunikon. Ngjyrimi emocional e gjallëron gjuhën, e bën më shprehëse, më të fuqishme.</p> <div data-bbox="159 981 1417 1585"> <div data-bbox="662 981 1058 1104"> <p>Njësitë frazeologjike: e solli kokën</p> </div> <div data-bbox="159 1104 699 1350"> <p>Fjalët me ngjyrim emocional shprehin gëzim dhe hidhërim, lavdërim ose qesëndisje, përgëzim ose përbuzje, dashuri ose urrejtje, përkëdhelje ose shpërfillje.</p> </div> <div data-bbox="699 1104 1114 1227"> <p><b>Fjalët me ngjyrim emocional</b></p> </div> <div data-bbox="1114 1070 1417 1238"> <p>Fjalët e huazuara nga turqishtja: <u>kalama</u>, <u>surat</u></p> </div> <div data-bbox="746 1249 1034 1384"> <p>Fjalët që tregojnë cilësi: hutaq.</p> </div> <div data-bbox="1050 1249 1417 1440"> <p>Emrat e sendeve që kanë cilësi të dallueshme: fyell, hënë.</p> </div> <div data-bbox="231 1373 627 1541"> <p>Fjalët që emërtojnë shpendë dhe kafshë: buallicë, derr</p> </div> <div data-bbox="699 1417 1018 1585"> <p>Fjalët që emërtojnë lule, drurë dhe bimë: karafil, kastravec.</p> </div> </div> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Punë në grupe dyshe</p> <p>Punohen në grupe ushtrimet 1-4</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalëve dhe me kuptim të drejtpërdrejtë dhe me ngjyrim emocional.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Ndërto fjali me fjalët <i>lis, trëndafil, karafil, sorkadhe, flutur</i> duke i përdorur me ngjyrim emocional.</p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore leksikologji Tema mësimore: Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalës		Situata e të nxënit: Kërkim në fjalor Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe gjej kuptimet e fjalës <i>nënë</i> dhe <i>vend</i> . Kujdes! Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon kuptimet e drejtpërdrejta të fjalëve nga kuptimet e figurshme;</li><li>- analizon mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve;</li><li>- argumenton kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshme nëpërmjet përbërësve të kuptimeve dhe shembujve.</li></ul>		Fjalët kyçe: Kuptim i drejtpërdrejtë Kuptim i figurshëm Përbërësit e kuptimit Shembulli Metaforë gjuhësore Parashtesa me nuançë përkëdhelëse	
Burimet: Libri i nxënësit, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: DDM, Punë në dyshe			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: DDM			
Di	Dua të di	Mësova	
Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë: të drejtpërdrejta; të figurshme.	Cilat janë mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve?		
Ndërtimi i njohurive të reja: DDM			
Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë në plotësimin e rubrikës “Mësova”.			
Di	Dua të di	Mësova	
Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë: të drejtpërdrejta; të figurshme.	Cilat janë mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve?	Kuptimet e figurshme të fjalëve mund të krijohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme:  1) nëpërmjet metaforës gjuhësore;  2) nëpërmjet përdorimit të prapashitesave me nuanca përkëdhelëse dhe keqësuese.	

Lexoni tabelën e mëposhtme dhe plotësoni kolonat e fundit.

<b>Prapashtesa</b>	<b>Shembull</b>	<b>Prapashtesa të tjera</b>	<b>Shembull në çdo rast</b>
Zë	zogëze	cak	burracak
Th	birth	aç	gungaç
Aq	ngordhalaq	anik	Thatanik
Ash	balash	ak	Hollak
Ac	përtac	osh	Gjatosh
Ec	grindavec	ush	gjatush

Nëpërmjet përdorimit të intonacionit të veçantë me nuanca: përbuzjeje, talljeje, shakaje, ironie: *Vërtet! Ashtu?! Posi?! Me gjithë mend?!*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Punë në dyshe*

Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë (kuptimi 1) dhe kuptimin e figurshëm (kuptimi 2)

të fjalëve në tabelat e mëposhtme. Argumentoni nëpërmjet shembujve se pse kuptimi 2 është kuptimi i figurshëm i kësaj fjale.

<b>Fjala bir</b>	
Kuptimi 1  Djali kundrejt prindërve	Kuptimi 2  Djalë ose burrë në lidhje me vendlindjen ose shtresën e tij shoqërore
Përbërësit e kuptimit 1  a) Njeri i seksit mashkull b) Njeri me moshë të re c) Lidhje gjaku me prindërit	Përbërësit e kuptimit 2  a) Njeri i seksit mashkull b) Njeri me moshë të thyer a të re pa lidhje gjaku
Shembull  Eja biri i nënës!	Shembull  Bir i fshatit tonë.

### Ushtrimi 3

Lexoni poezinë “*Rent or Marathonomak*” të Fan Nolit dhe gjeni rastet e krijimit të kuptimeve të fi gurshme të fj alëve.

### Ushtrimi 4

Formoni fj ali me tri nga fj alët që Noli i ka përdorur në kuptim të fi gurshëm. Lexojini ato, duke përdorur një intonacion të veçantë, në përputhje me kontekstin e fjalisë.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fj alëve me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të fi gurshëm.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: III
<b>Tema mësimore: Projekt</b> <b>Tradita, zakone, rite, trashëgimi kulturore, (Lojëra popullore, monumente të kulturës dhe të natyrës (ora 1))</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë jam nga Shqipëria	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>  - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetë,sipërmarrje dhe mjedis - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth traditave themelore të trevave të Veriut të vendit, lidhur me ushqimet tradicionale të zonës, veshjet popullore, zakonet dhe doket e krahinës, dhe ritet kryesore të lindjeve, vdekjeve, dasmave si dhe tradita e kultivimit të rriteve fetare të vendit;</li><li>- merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;</li><li>- përzgjedh materialet e duhura për produktet finale;</li><li>- bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim;</li><li>- drejton punën në grup;</li><li>- prezanton produktet e projektit.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Traditë Zakone Doke Lojëra popullore Monumente kulture	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, materiale të ndryshme të hulumtuara në internet a bibliotekë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bashkëbisedim, të nxënit në bashkëpunim			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim			
<b>Ndahet klasa në grupe</b>			
<b>U bëhet me dije nxënësve se gjatë projektit faza e parë e tij është:</b>			
Gjate kësaj dite nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"><li>- njihet me temën dhe objektivat e projektit;</li><li>- organizohen në grupe me tema specifike;</li><li>- përcakton veprimtaritë që do të zhvillojnë gjatë projektit.</li></ul>			
<b>Faza 1 Aktivitetet parapërgatitore të projektit</b>			
Njohja me temën e projektit. Pavarësisht se është ora e parë, nxënësve për projektin u është folur që në fillim të vitit që ata të marrin masa për hulumtim dhe mos ta lënë punën vetëm në ditët që kanë projektin.			
Formimi i grupeve të nxënësve dhe ndarja e detyrave brenda grupit.			
Grupet brenda klasës formohen heterogjene me nxënës me përparim të mirë, mesatar apo të dobët. Nxënësit duhet të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, pasi gjatë orës së projekteve nxënësit duhet të mësojnë duke u argëtuar.			

**Ndërtimi i njohurive të reja:**

**Po japim më poshtë një model të planifikimit të projektit.**

<b>Titulli</b>	<b>Një emër/Titull tërheqës projekti.</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	Data e fillimit dhe mbarimit të projektit
<b>Qëllimi</b>	Çfarë do të nxënë nxënësit? Tregohet se si klasat pjesëmarrëse do të përfitojnë nga përvojat e tyre me ju.
<b>Lëndët</b>	Lista e fushave të kurrikulës, të cilave do t'iu adresohet ky projekt.
<b>Pjesëmarrësit</b>	Mësues, Nxënësit sipas nivelit.
<b>Përshkrimi</b>	Paragrafë të shkurtër, të cilët përshkruajnë projektin që të tërheqë interesin e lexuesit.
<b>Veprimtaritë sipas linjave kohore</b>	<p>Përshkrim i asaj që nxënësit do të kryejnë sipas afateve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjidhje problemesh.</li> <li>- Grumbullim informacioni.</li> <li>- Shkëmbime ndërpersonale.</li> <li>- Vëzhgime.</li> <li>- Diskutime.</li> <li>- Vlerësime.</li> </ul>
<b>Burime të kërkuara</b>	Lista e burimeve.
<b>Rezultatet</b>	Produkte përfundimtare.
<b>Përfitimet</b>	
<b>Vlerësimi</b>	

**Pra nxënësit duhet të jenë të aftësuar për atë që do të bëjnë.**

**Qëllimi i projektit**

**Projekti ka si detyrë t'i pajisë nxënësit me kompetencat e mësipërme dhe të përforcojë disa rezultate të të nxënësit sipas kompetencave të fushave.**

**Në fund të projektit nxënësi/ja duhet të arrijë:**

të prezantojë produktet finale të projektit që kanë ardhur si rezultat i punës në grup apo individuale;

të argumentojë atë që ka sjellë në produkt;

të interpretojë çdo qasje të tij.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Të nxënësit në bashkëpunim**

Nxënësit pasi kanë ndarë grupet dhe kanë caktuar nëntemat bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të caktuar mënyrën e përgatitjes së produktet që do të prezantojnë në orën e fundit.

**Ai mund të jetë:**

**Prezantim në powerpoint, fletëpalosje, postera, revistë apo gazetë, faqe web-i etj.**

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin në grup, për marrjen e përgjegjësisë personale etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Projekt Tradita, zakone, rite, trashëgimi kulturore, (Lojëra popullore, monumente të kulturës dhe të natyrës (ora 2))		Situata e të nxënësve: Unë jam nga Shqipëria	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis</div> <div>- Kompetenca qytetare</div> <div>- Kompetenca digjitale</div>			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- hulumton rreth traditave themelore të trevave të Veriut të vendit, lidhur me ushqimet tradicionale të zonës, veshjet popullore, zakonet dhe doket e krahinës dhe ritet kryesore të lindjeve, vdekjeve, dasmave, si dhe tradita e kultivimit të riteve fetare të vendit;</div><div>- merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;</div><div>- përzgjedh materialet e duhura për produktet finale;</div><div>- bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim;</div><div>- drejton punën në grup;</div><div>- prezanton produktet e projektit.</div></div>		Fjalët kyçe: Traditë Zakone Doke Lojëra popullore Monumente kulture	
Burimet: Libri i nxënësit, vizitë në Muzeun Kombëtar, në Institutin Albanologjik		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënësve në bashkëpunim			
Faza 2: Përpunimi i materialeve; Krijimi i posterave; Krijimi i punimit në powerpoint-it; Krijimi i videos me mendime të nxënësve.			
Në fazën e dytë të projektit do të kemi parasysh aktivitetet që do të zhvillojnë: <div><div><div>• Vizitë në muzeun historik</div><div>• Ndërtimi i një albumi me foto për traditën kulturore dhe të veshjeve</div><div>• Përgatitet një informacion i printuar mbi traditën zakonore, besën si një virtyt i shqiptarit, i spikatur më së shumti në Shqipërinë e veriut.</div><div>• Përgatitet tabela e riteve në rastet e dasmave, vdekjeve etj.</div><div>• Ndërtohet një poster që përfshin gjërat më të rëndësishme të këtij studimi.</div><div>• Listohen dhe paraqiten fotot e ndërtesave kryesore të trashëgimisë kulturore të krahinës.</div><div>• Jepen karakteristikat e dialektit të Gegërisë.</div><div>• Ndërtohet tabela e karakteristikave kryesore të zonës në këngë, vegla muzikore dhe veshje popullore.</div><div>• Përgatitet për t'u luajtur një lojë popullore e zonës.</div><div>• Ndërtohet albumi i monumenteve të kulturës dhe të natyrës.</div></div><div>Nxënësit punojnë sipas punës së caktuar.</div><div>Koordinatori i grupit është i vëmendshëm për punën që kryen secili nga anëtarët e grupit dhe bën vlerësimin e anëtarëve.</div></div>			

<p>Vini re!</p> <p>Në këtë fazë nxënësit duhet të mbledhin materialin në “burim”, pranë institucioneve të ndryshme për të kryer intervista dhe pyetësorë minimalistë.</p> <p><b><i>Puna për projektin fillon që në fillim të vitit dhe nuk i libet ditëve të projektit!</i></b></p>
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara.</p>

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Projekt (Tradita, zakone, rite, trashëgimi kulturore, lojëra popullore, monumente të kulturës dhe të natyrës (ora 3))		Situata e të nxënit: Unë jam nga Shqipëria	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis</div> <div>- Kompetenca qytetare</div> <div>- Kompetenca digjitale</div>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- hulumton rreth traditave themelore të trevave të Veriut të vendit, lidhur me ushqimet tradicionale të zonës, veshjet popullore, zakonet dhe doket e krahinës dhe ritet kryesore të lindjeve, vdekjeve, dasmave si dhe tradita e kultivimit të riteve fetare të vendit;</div><div>- merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;</div><div>- përzgjedh materialet e duhura për produktet finale;</div><div>- bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim;</div><div>- drejton punën në grup;</div><div>- prezanton produktet e projektit.</div></div>		Fjalët kyçe: Traditë Zakone Doke Lojëra popullore Monumente kulture	
Burimet: Libri i nxënësit, vizitë në Muzeun Kombëtar, në Institutin Albanologjik		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënit në bashkëpunim, Prezantim			
Faza 3:			
Aktivitete në të cilin nxënësit prezantojnë rezultatet e punës së tyre si prezantime, tabela dhe albume.			
Gjatë kësaj faze, nxënësit do të prezantojnë produktet që kanë ardhur si rezultat i punës në grup.			
<div><div><div>• Prezantimi i traditave themelore të trevave të Veriut të vendit lidhur me ushqimet tradicionale të zonës, veshjet popullore, zakonet dhe doket e krahinës dhe ritet kryesore të lindjeve, vdekjeve, dasmave, si dhe tradita e kultivimit të riteve fetare të vendit.</div><div>• Prezantimi i një materiali që përshkruan dhe përmban ndërtesat kryesore të trashëgimisë kulturore të zonës, gjuhën dhe dialektin e gegërishtes, veshjet karakteristike popullore, veglat muzikore të zonës, këngët popullore dhe zhvillimin e saj në shekuj e vite.</div><div>• Prezantimi i një liste me lojërat popullore më të spikatura të zonës, të luajnë vetë nxënësit njërin prej lojërave popullore, të ndërtojnë albumin e monumenteve të kulturës në krahinën e veriut dhe albumin e monumenteve të natyrës në zonë.</div></div></div>			

Në këtë fazë do të vlerësohen nxënësit. Mësuesi/ja duhet të jetë transparente në vlerësim, po kështu dhe pjesëtarët e grupit me njëri-tjetrin.

Më poshtë do t'ju sugjerojmë mbajtjen e disa evidencave në secilën prej orëve të projektit, evidenca që do t'ju lehtësojnë vlerësimin e nxënësve dhe ata do të jenë më të qartë me veten. Tabelat përmbajnë kriteret për vlerësim, të cilat u bëhen me dije nxënësve me fillimin e projektit.

#### Plotësimi i kriterëve për vlerësim

Monitorimi i zbatimit të detyrave

Grupi I

Vini re! Kjo tabelë plotësohet për secilin grup pjesëmarrës në projekt!

	Detyrat	Personat përgjegjës	Afati	Komente
Planifikuar	Diskutimi i ideve dhe mendimeve për përgatitjen e prezantimit, traditat, zakonet e ritet		24.11.2014	Nxënësit dhanë ide interesante dhe bashkëpunuan për realizimin e tyre.
Realizuar	+		24.11.2014	
Planifikuar	Vizitë në muzeun Historik Kombëtar		25.11.2014	Paraqitja e albumit me fotografi nga Muzeu Historik Kombëtar. Seleksionimi i tyre sipas temave të grupeve.
Realizuar	+		25.11.2014	
Planifikuar	Vizitë në komitetin e veteranëve të rrethit Tiranë		25.11.2014	Vizita u realizua në formën e intervistës, materialet e së cilës u përdorën në hartimin e posterave.
Realizuar	+		25.11.2014	
Planifikuar	Përgatitja dhe hedhja e të dhënave në një tabelë dhe ndërtimi i posterave dhe albumeve apo dosjeve të punës		26.11.2014	U hartuan postera, fletë palosje dhe një hartë e Shqipërisë së Veriut me veshjet popullore të zonës.
Realizuar	+		26.11.2014	
Planifikuar	Prezantimi i produktit		27.11.2014	Prezantim i suksesshëm i punimeve duke shfaqur në mënyrë të qartë e koncize të gjitha llojet e përgatitjeve të bëra.
Realizuar	+		27.11.2014	

	Tiranë			cilës u përdorën në hartimin e posterave.
	Kriteret Nxënësit	Anëtarët e grupit e ndihmojnë njëri tjetrin	Të gjithë marin pjesë në mënyrë të barabartë në realizimin e projektit	Vlerësimi ditor
Realizuar	+		25.11.2014	cilës u përdorën në hartimin e posterave.
Planifikuar	Përgatitja dhe hedhja e të dhënave në një tabelë dhe ndërtimi i posterave dhe albumeve apo dosjeve të punës		26.11.2014	U hartuan postera, fletë palosje dhe një hartë e Shqipërisë së Veriut me veshjet popullore të zonës.
Realizuar	+		26.11.2014	
Planifikuar	Prezantimi i produktit		27.11.2014	Prezantim i suksesshëm i punimeve duke shfaqur në mënyrë të qartë e koncize të gjitha llojet e përgatitjeve të bëra.
Realizuar	+		27.11.2014	

Fletëvlerësimi për menaxhimin individual të kohës (Vlerësimi në pikë)

Dita 1

Vini re! Fletëvlerësimi plotësohet për secilën ditë të projektit!

	Kriteret Nxënësit	Kohën e shfrytëzon në mënyrë racionale	Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të grupit	Kryen detyrat në kohë	Vlerësimi ditor
1	Luiza M	10	10	10	10
2	X Y	10	10	10	10
3	Ervin Z	10	10	10	10
4	Ervisa B	9	8	9	9
5	Esilda M	9	9	8	9
6	Drin C	9	9	8	9

Fletëvlerësimi për bashkëpunimin brenda grupit (Vlerësimi në pikë)

	Kriteret Nxënësit	Anëtarët e grupit e ndihmojnë njëri tjetrin	Të gjithë marin pjesë në mënyrë të barabartë në realizimin e projektit	Vlerësimi ditor
25	Frenki Gj	10	10	10
26	Gabriel L	9	10	10

***U komunikohet dhe argumentohet vlerësimi nxënësve, pas prezantimit.***

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Leksikologji</b> <b>Tema mësimore:</b> Regjistrat e gjuhës		<b>Situata e të nxënës:</b> Në autobus Miri: (po flet në telefon) - Po iki me kombinatin, po plasëm vape. Fatorino: - Ej ti mos fol me zë të lartë! Miri: - Posi, posi ëëë.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>identifikon regjistrat e gjuhës gjatë komunikimit;</li><li>dallon në tekstet e dhëna karakteristikat e regjistrave të gjuhës.;</li><li>argumenton se cilit regjistër gjuhe i përketin shprehjet dhe paragrafët e dhënë.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Regjistër gjuhe Regjistër i zakonshëm Regjistër i thjeshtë Regjistër i ngritur	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Shkrim i lirë, DDM, Punë në dyshe, Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Shkrim i lirë Secili prej nesh fl et në mënyra të ndryshme, në varësi të situatës, pra vendit në të cilin ndodhet, dhe në varësi të bashkëbiseduesit. Për shembull, në shtëpi nuk fl asim njësoj si në shkollë dhe në shkollë nuk fl asim njësoj si me një shok apo shoqe. Krijo një situatë me përshtypjet për një ndeshje futbolli. a) Flet me shokun/shoqen. b) Flet me babanë. c) Flet me mësuesin e edukimit fizik.			

Ndërtimi i njohurive të reja: DDM		
Di	Dua të di	Mësova
Nga situatat në të cilat ndodhemi gjatë komunikimit, varen edhe mënyrat e ndryshme të folurit. Këto situata komunikimi (të folurit apo të shkruarit) ndryshe quhen edhe regjistra gjuhësorë.	Ku përdoren këta regjistra gjuhësorë?	<b>Regjistri i thjeshtë</b> është ai regjistër gjuhësor që përdoret në familje ose në shoqëri, në situata të lira komunikimi. <b>Regjistri i zakonshëm</b> i komunikimit ka të bëjë me situata formale mësues/nxënës, gazetar/institucion, drejtor/vartës <b>Regjistri i ngritur</b> përdoret në situata komunikimi të veçanta. Bashkëbiseduesit që përdorin këtë lloj regjistri kanë marrëdhënie të mirëpërcaktuara me njëri-tjetrin: drejtor/president: politikan/shkencëtar.
Regjistri gjuhësor që përdorim mund të jetë i thjeshtë, i zakonshëm dhe i ngritur.	Cilat janë karakteristikat e tre regjistrave gjuhësorë?	Karakteristikat e regjistrit të thjeshtë: Shpesh mungon kryefjala: <i>Mjaft, mos fol më!</i> Ka raste që mungon edhe folja: <i>Këtu! Poshtë! Lart!</i> <i>Karakteristikat e regjistrit të zakonshëm:</i> Përdoret në biseda mes njerëzve që nuk kanë lidhje familjare. Përdoret në artikujt e gazetave, në emisionet e radios dhe të televizionit, në reklama; në libra artistike etj. Karakteristikat e regjistrit të ngritur: Përdoret në konferenca dhe takime ceremoniale, në festime, në përshëndetje zyrtare. Përdoren terma të veçantë nga fusha për të cilën bëhet fjalë: shkencë, politikë etj.
<b>Plotësohet tabela nga nxënësit.</b>		
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë në dyshe</b>		
Udhëzohen nxënësit të punojnë me shokun/shoqen e bankës, ushtrimet 1-3 në faqen 189.		
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për evidentimin e veçorive që kanë regjistrat gjuhësorë.		

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Leksikologji</b> <b>Tema mësimore:</b> Ushtrime për regjistrat e gjuhës		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, vizitë në Muzeun Kombëtar, në Institutin Albanologjik		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon regjistrin e komunikimit në tekstet e dhëna;</li><li>- analizon karakteristikat leksikore dhe gramatikore të regjistrave gjuhësorë;</li><li>- argumenton ndryshimet që pëson teksti kur kalon nga një regjistër gjuhe në regjistrin tjetër.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Regjistër gjuhe Karakteristika leksikore dhe gramatikore	

Burimet: Libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Rikujtojmë në dyshe, Të nxënit në bashkëpunim, Punë individuale</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Rikujtojmë së bashku</p> <p>Rikujtojmë së bashku</p> <p>A flasim njësoj me shokët/shoqet dhe prindërit?</p> <p>Po me mësuesit? Pse?</p> <p>Cilët janë regjistrat e gjuhës?</p> <p>Cilët janë karakteristikat e secilit prej regjistrave?</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënit në bashkëpunim-punë me grupe</p> <p>Ndaj klasën me grupe dhe udhëzoj nxënësit të punojnë me tekstet e dhëna.</p> <p><b>Grupi 1</b> Lexoni tekstet e mëposhtme dhe dalloni regjistrin e komunikimit në secilin prej tyre.</p> <p>Argumentoni përgjigjet tuaja, duke gjetur karakteristikat e çdonjërit prej tyre.</p> <p>Tekst 1</p> <p>– Me buzëqeshje?! – dhe kur pa që në, fjalët e saj po i dëgjonim me çudi e mosbesim, vogëlushja natyrshëm vazhdoi: – Ja, këto janë buzëqeshjet, – dhe na tregoi disa kartonë të vegjël ku kishin vizatuar fytyrat gazmore.</p> <p>– Në mbarim të shkollës, me këto bëjmë blerje te dyqani i shkollës. Blejmë ç’të duam. Unë bleva një komplet zhytjeje, pesë çokollata, një kuti me lapsa, një libër jashtëshkollor me përralla dhe tri tullumbace. Eri bleu pak se nuk kishte shumë buzëqeshje.</p> <p><b>Grupi 2</b></p> <p>Tekst 2</p> <p>Besoj se ju, fëmijë, e njihni Moxartin, kompozitorin e madh austriak. Por ky kompozitor i madh ka qenë edhe i vogël. Imagjinojeni të shtrirë në djepin e drunjtë apo në duart e së ëmës, ku sytë e tij blu në të kaltër vështronin vazhdimisht, zhytur në ëndërrime, siç i dukej së ëmës, tej dritares në qiellin e kaltër e të tejdukshëm. E ëma e kuptoi shpejt që djali kishte një natyrë gazmore, sepse u buzëqeshte me gëzim të gjithëve. Volfangu qante shumë rrallë. Kur filloi të ecte, i ndodhte të rrëzohej e të vritej.</p> <p><b>Grupi 3</b> Lexoni fragmentin dhe diskutoni pse ky regjistër mund të jetë i thjeshtë.</p> <p>Një mbrëmje qershori, të mbledhur te cepi i pallatit, po flisnim për notat përfundimtare, kur ajo u afrua dhe na tha:</p> <p>– Unë i mora notat: 69 buzëqeshje.</p> <p>– Çfarë ?</p> <p>– Si, si the?! – u habitëm ne.</p> <p>– 69 buzëqeshje. Mësuesja jonë nuk na vlerëson me dhjeta, as me shumë mirë, por me buzëqeshje.</p> <p><b>Grupi 4</b> Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe përpikuni ta ktheni aty për aty në një tekst të regjistrat të lartë.</p> <p>Argumentoni ndryshimin e çdo fjalie, duke sjellë ndër mend karakteristikat e regjistrat të lartë.</p> <p>Ndryshimet që kishte vënë re, sidomos të ngjyrës së lëkurës, i mbetën për shumë kohë në mendje. Si kishte ngjarë ky ndryshim dhe pse ne e kishim lëkurën të bardhë dhe ata të zezë? Një mbrëmje vendosi të pyeste babanë. Ai ia shpjegoi ashtu si e dinte: “Në Afrikë s’ka dimër e verë. Atje dielli djeg gjithmonë si në korrik dhe ata, duke bërë gjithmonë banjo dielli, janë nxirë.</p> <p>Po ta kishin lëkurën ndryshe, do t’u bëhej gjithë plagë. E ke vënë re, edhe në plazh digjen më shumë ata që e kanë lëkurën të bardhë.</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Punë individuale</p> <p>U është lënë si detyrë një orë më parë të sillni në klasë njoftime, reklama dhe informacione të marra nga gazeta të ndryshme.</p> <p><b>Tregoni se cilit regjistër gjuhësor i përkasin. Vëreni karakteristikat e këtij regjistri.</b></p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për dallimin e regjistrave gjuhësorë në tekstet e dhëna.</p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Histori pa mbarim</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Mësuesi/ja në videoprojektor ose në një lap-top vendos CD e filmit “Neverending story” shiko këtu! <a href="https://www.youtube.com/watch?v=xsVLb5ibKfM">https://www.youtube.com/watch?v=xsVLb5ibKfM</a>	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth jetës dhe veprës letrare të Michael Ende-së;</li><li>- u përgjigjet pyetjeve për brendinë e pjesës;</li><li>- përshkruan personazhet e pjesës;</li><li>- analizon elementet fantastike të fragmentit;</li><li>- shkruan një paragraf mbyllës, duke u mbështetur në imagjinatën e vet.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fantastik Sëmundje vdekjeprurëse Krijesë fantastike Sende magjike Mjekë Medalion magjibërës	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, “Histori pa mbarim”, CD, videoprojektor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> anglisht, edukim muzikor	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Pemë mendimi, Pyetje-përgjigje, Diskutim <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Pemë mendimi U kërkohet nxënësve për të ndërtuar pemën e mendimit të autorit të romanit.			
<div><div>12 nëntor 1929-28 gusht 1995</div><div>Shkrimtar gjerman i shekulli XX</div><div>Vepra e tij e përkthyer në më shumë se 40 gjuhë të botës.</div><div>Historia pa mbarim</div><div>Michael Andreas Helmuth Ende</div></div>			
<b>Dy fjalë për subjektin e romanit</b> Libri rrëfen për një djalë të quajtur Bastian Balthazar, një fëmijë i vogël dhe i çuditshëm, i cili është lënë pas dore nga babai, pas vdekjes së nënës së tij. Ai gjen interesin e tij në një dyqan antik ku ishte një libër i quajtur “Historia pa mbarim”. Në pamundësi për të rezistuar, ai vjedh librin dhe fshihet në papafingon e shkollës së tij, ku fillon leximin. Historia që Bastiani lexon është vendosur në tokën magjike të Fantastikës një vend jorealit të çuditshëm të sunduar nga Perandoresha-Fëmijë dashamirëse dhe misterioze. Një delegacion i madh ka ardhur te Perandoresha-Fëmijë për të kërkuar ndihmën e saj kundër një entiteti të çrregullt quajtur “Asgjë”. Delegatët janë tronditur kur mjeku i perandoreshës, një centaur i quajtur Cairon, informon ata se Perandoresha është duke vdekur, dhe ka thirrur një djalë të quajtur Atreyu, për të gjetur një kurë. Për Atreyu, Perandoresha jep AURYN: një medaljon të fuqishëm që mbron atë nga çdo e keqe. Në këshillën e breshkave gjigante, Morla, Atreyu vendoset në kërkim të një orakulli të padukshëm të njohur si Uyulala, i cili mund të dinte shërimin e Perandoreshës. Për të arritur këtë, ai është ndihmuar nga një luck dragon quajtur Falkor, të cilin e shpëton nga përbindëshi “Ygramul”. Orakulli tha se e vetmja gjë që mund të shpëtojë Perandoreshën është një emër i ri, i cili mund të gjendet vetëm përtej kufijve të Fantastikës. Falkor dhe Atreyu shkojnë te Perëndesha-Fëmijë dhe e sigurojnë se kanë sjellë shpëtimtarin e saj; Bastian refuzon të flasë nën një emër të ri, për të nxjerrë atë në përmbushjen e rolin e tij si Shpëtimtar. Perandoresha-Fëmijë takon plakun endacak të malit, i cili posedon një libër të titulluar “Histori pa mbarim”, të cilin Perandoresha-fëmijë kërkon ta lexojë me zë të lartë. Historia përfshin takimin e Bastian me Coreander, vjedhjen e librit nga ai dhe të gjitha veprimet e tij në papafingo. Kuptohet se historia do të përsëritet përgjithmonë pa ndërhyrjen e tij, emrat Bastian, Perandoresha-Fëmijë, “Hëna Child” dhe duket me të në Fantastike, ku ai rikthen ekzistencën e saj me anë të imagjinatës së tij. Perandoresha i ka dhënë edhe atij një AURYN, në anën e pasme të së cilës ai e gjen mbishkrimin “bëni atë që ju dëshironi”.			

Për çdo dëshirë, Bastian humb një kujtim të jetës së tij si njeri dhe disa nga aftësitë e tij. I Pavetëdijshëm për këtë në fillim, ai shkon përmes Fantastikes, duke pasur aventura dhe treguar histori, dhe humbjen e kujtimeve të tij. Përkundër paralajmërimeve të Atreyu dhe miqve të tjerë, Bastian përdor AURYN për të krijuar krijesat që shkaktojnë disa efekte negative anësore te Fantastika. Pas ndeshi të ligjtë magjistare Xayide, Bastiani vendos për të marrë përsipër Fantastikën për vete, por është ndaluar nga Atreyu, të cilin Bastiani plagos rëndë në betejë. Në fund të fundit, një Bastian i penduar është reduktuar në dy kujtime: ato të nënës dhe babait të tij, dhe të emrit të tij. Pas shumë aventurave, Bastian duhet të heqë dorë nga kujtimi i prindërve të tij, për të zbuluar se dëshira e tij më e fortë është që të jetë i aftë të japi dashuri për të tjerët (domethënë babanë e vet).

Pas shumë kërkimin, dhe në prag të humbjes së kujtesës e tij të fundit, Bastian nuk është në gjendje për të gjetur ujin e jetës me të cilin do të largohet nga Fantastika me kujtimet e tij. Atreyu dhe Falkor hyjnë ku uji i kërkesave të jetës di për emrin e Bastianit. Vetëm pasi Atreyu jep emrin e Bastianit dhe premtimet për të përfunduar të gjitha tregimet për ujin e jetës e lejon Bastianin për t'u kthyer në botën njerëzore, së bashku me disa nga ujërat mistike. Ai kthehet te babai tij, ku ai tregon historinë e plotë të aventurave të tij, dhe kështu pajtohet me të. Më pas, Bastian rrëfen për Coreander për vjedhje librin e tij, humbjen e librit Coreander zbulon se ai ka qenë në Fantastikë dhe se libri ka të ngjarë lëvizur në duart e dikujt tjetër.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** *Kuptojmë tekstin pyetje-përgjigje*

**1. Pasi të lexoni pjesën, përgjigjuni pyetjeve:**

**Çfarë po ndodh në Kullën e Fildishtë?**

Janë mbledhur 500 mjekë, të cilët duan të gjejnë shkakun e sëmundjes së Perandoreshës-Fëmijë.

**Cilat janë personazhet e këtij rrëfimi? Perandoresha-fëmijë, mjekët (personazhe që nuk veprojnë në fragment për ta vetëm rrëfëhet).**

Kaironi ...

**Pse autori shprehet se Perandoresha-Fëmijë është epiqendra e gjithë jetës në Fantastikë?**

Autori thotë kështu për ta theksuar akoma më shumë pjesën e fantastikes. Një Perandori e tërë që udhëhiqej nga një fëmijë, duke përforcuar idenë që shprehin tregimet fanta-shkencë që personazhet, ngjarjet, mjedisi, koha nuk janë reale.

**Çfarë u thotë Kaironi banorëve të Fantastikës?** Kaironi u thotë sekretin se kush mund të shpëtojë Perandoreshën si rrjedhim dhe botën e Fantastikës dhe ky është Atreju.

**Analizojmë tekstin**

**2. Përshkruani:**

**mjekët e mbledhur në Perandorinë e Fantastikës:** Kishte mjekë xhuxhë me mjekër të

bardhë e gungë në kurriz, kishte mjekezana, të veshura me fustane të argjendta e më yje xixëlluese ndër flokë.

**Perandoreshën-Fëmijë:** S'kish përdorur kurrë dhunë dhe kurrë s'e kish vënë në veprim pushtetin e saj; s'jepte asnjë urdhër dhe as gjykonte ndokënd; s'ndërhynte asnjëherë dhe asnjëherë s'kish qenë e detyruar të mbrohej nga ndonjë sulmues, sepse askujt s'do t'i kish shkuar ndër mend që të ngrihej kundër saj apo t'i bënte ndonjë të keqe. Në sytë e saj të gjithë ishin të barabartë.

Ajo vetëm se ndodhej atje. Por edhe prania e saj ishte e një lloji të veçantë: ajo ishte epiqendra e gjithë jetës në Fantastikë. Dhe çdo krijesë, në ishte e mirë apo e ligë, e bukur apo e mençur, e shëmtuar, gazmore apo serioze, mendjelehtë apo e mençur, të gjithë pra, ekzistonin vetëm falë pranisë saj. Pa atë s'mund të jetonte asgjë, ashtu siç nuk mund të jetojë trupi i njeriut pa zemër.

**Kaironin:** Kaironi, i famshmi dhe legjendari mjeshtër i artit të mjekësisë. Ai ishte një nga ata të cilët në kohërat e lashta i patën quajtur centaurë. Deri në brez kishte trup njeriu, kurse pjesa tjetër ishte trup kali. Majë kokës mbante një kapelë të çuditshme prej kashte. Në qafë kishte varur me zinxhir një medaljon të madh prej floriri, ku dalloheshin dy gjarpërinj: një i çelët dhe një i errët, të cilët kafshonin bishtin e njëri-tjetrit dhe formonin kështu një figurë vezake. *Një pëshpërimë habie kaloi nëpër gjithë sallën dhe u dëgjuan disa klithma habie. Kaironi përplasi disa herë thundrat, derisa u vendos qetësia dhe pastaj foli me një zë të thellë.*

**3. Cilat janë elementet fantastike të kësaj pjese?**

**Sendet magjike:** Auryni, medalioni që i fal atij që e mban fuqi të mbinatyrshme.

**Veprimet fantastike:** Kërkimi i madh, shërimi i sëmundjes me një medaljon.

**Personazhet fantastike:** Kishte mjekë xhuxhë me mjekër të bardhë e gungë në kurriz, kishte mjekezana, të veshura me fustane të argjendta e më yje xixëlluese ndër flokë, kishte ujqorë barkmëdhenj e me cipë lëkure mes gishtërinjve të duarve e të këmbëve për të notuar, por kishte edhe gjarpërinj të bardhë, të cilët ishin mbledhur kutullaç sipër tryezës gjatoshë në mes të sallës grerëza, madje edhe shtriganë, vampirë kukudhë, që në përgjithësi s'para gëzonin namin e bamirësve ose të atyre.

**Krahasojini elementet fantastike të kësaj pjese me ato të një rrëfimi tjetër që keni lexuar.**

Harry Poteri dhe guri filozofik është vepra me të cilën mund të bëjmë analogji dhe ka pak a shumë veprime fantastike si këtu.

**Gjuha e tekstit**

4. Ndërtoni një tabelë ku të dalloni fjalitë e përbëra me bashkërenditje nga fjalitë e përbëra me nënrenditje, të cilat janë përdorur në paragrafin e fundit të pjesës.

Fjali e përbërë me bashkërenditje	Fjali e përbërë me nënrenditje
Atij do t'ia dorëzoj AURYNNIN dhe do ta nis për Kërkimin e Madh...	Madje, s'jemi as të sigurtë nëse është arti i mjekësisë ai që do të mund ta shpëtojë Perandoreshën.
	Madje, po ju them se e fundmja dhe e vetmja shpresë që kam, është se në këtë perandori pa fund e pa anë mund të ketë ndonjë krijesë, që është më e ditur se ne dhe e zonja të na japë këshilla e ndihmë.

Nxënësit gjejnë fjalitë e më pas bëjnë analizën e ndërtimit të tyre. Ata vlerësojnë saktësinë e përgjigjeve të shokëve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Diskutim

Pse ishte e rëndësishme ekzistenca e Perandoreshës-Fëmijë për jetën e Fantastikës?

**Komentoni frazën: “Pa atë s'mund të jetonte asgjë, ashtu siç nuk mund të jetojë trupi i njeriut pa zemrën.**

Nxënësit fillojnë e diskutojnë duke mbrojtur mendimin e tyre me argumente.


**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për evidentimin e motiveve që trajton fragmenti, analizën e personazheve, dallimin e figurave letrare dhe interpretimin e këshillave dhe thëniesve mbresëlënëse.

**Detyrë shtëpie:** Vijoni zhvillimin e rrëfimit të mësipërm mbështetur në imagjinatën tuaj. Ndërtoni një paragraf (rreth 10 fjali), duke u orientuar nga fjalët kyçe:

AURYNNI, Atreju, Kërkimi i Madh, Malet e Argjendta.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b> <b>Tema mësimore: Shkruajmë me fantazi</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Qyteti im i së ardhmes Diskutoni si e imagjinoni qytetin ose fshatin ku jetoni, pas 10- 20 vjetësh.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth librave fanta-shkencë;</li><li>- diskuton për personazhet e kësaj letërsie;</li><li>- shkruan tregime fantastiko-shkencore duke respektuar strukturën e tyre: hyrje, zhvillim, mbyllje.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fantazi Botë fantastike Letërsi fantastiko-shkencore Skena dramatike Protagonistë	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, libra fanta-shkencë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Imagjinatë e drejtuar, Të nxënit në bashkëpunim, Shkrim i lirë, Punë me grupe			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Imagjinatë e drejtuar**

Diskutojmë për letërsinë fantastike shkencore dhe për filmat me subjekt fanta-shkencë.

Pas diskutimit listojmë karakteristikat e teksteve me fantazi:

- Një histori e shkruar me fantazi përmban në vetvete ngjarje nga bota joreale.
- Ato nuk ndodhin në të vërtetë, por ekzistojnë në fantazinë e atij që e shkruan atë.
- Historitë me fantazi lindin në mendjen e atij që i shkruan, ndaj duken sikur janë të vërteta.
- Tregimet me fantazi krijojnë një botë tjetër, gati magjike, në të cilën kryhen veprime të panjohura më parë që nuk ndodhin realisht.
- Dukuritë natyrore mund të jenë krejt ndryshe nga planeti tokë.
- Në një historike me fantazi rregullat mund të jenë të pafundme, ashtu siç i vendos fantazia.
- Lexuesit i jepen më shumë pamje sesa rrëfim.
- Fantazia mbështet në lexime dhe pasurohet me detaje të panjohura më parë.
- Rregullat e botës fantastike janë të ndryshme nga ato të botës reale në të cilën jetojmë.
- Historitë me fantazi shpesh mbështeten në histori shumë të vjetra, në mite apo në legjenda.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënësit në bashkëpunim**

Dëgjoni këshillat si duhet shkruar një histori me fantazi e më pas filloni e shkruani dhe ju.

Filloni me krijimin e botës suaj imagjinare: një planet, një vend, një mrekulli që nuk është parë dhe dëgjuar më parë.

Caktoni rregullat e botës fantastike të historisë suaj, që është një botë tjetër imagjinare me rregulla dhe ligje ndryshe nga bota që jetoni.

Përcaktoni temën, pasi historia juaj do të lëvizë rreth një teme.

Zgjidhni karakteret, përshkruani rolet që do të luajnë në historinë tuaj.

Zgjidhni protagonistët dhe përshkruajini me tiparet që i bëjnë të veçantë dhe të ndryshëm nga qeniet njerëzore (p.sh., fluturojnë, kërcejnë nga një ndërtesë në tjetrën).

Hiperbolizoni skenat dhe personazhet.

Krijoni skena dramatike ku protagonistët të jenë në veprim.

Shkruani dialogë brenda strukturës së tregimit.

Tregojuani punën tuaj të tjerëve, merrni vlerësime.

Rishikojeni dhe ripunojeni historinë tuaj derisa të shkruani variantin përfundimtar.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë, punë në grupe**

Shkruani historinë tuaj me fantazi.

**Grupi 1** “Planeti i endrrave të mia”

**Grupi 2** “Si e ëndërroj qytetin tim”

**Grupi 3** “Edhe unë e kam një ëndërr”

(Si të gjitha historitë e tjera edhe ajo ka hyrje, zhvillim dhe mbyllje.) Plotësoni skemën shikoni në tekst.

Nxënësit punojnë të qetë. Në fund të orës ata lexojnë punët e njeri-tjetrit dhe japin vlerësimin e tyre, nëse janë zbatuar këshillat e dhëna në fillim të orës a jo.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për respektimin e strukturës së tregimit fanta-shkencë, për bashkëpunimin e tyre brenda grupit etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Bisedë letrare (ora 1)		Situata e të nxënësve: Punë me tekstin e bisedës letrare	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: <div><div>- diskuton rreth jetës dhe veprës letrare të autorit të veprës së zgjedhur;</div><div>- zbulon temën dhe idenë kryesore të veprës letrare;</div><div>- diskuton rreth subjektit të veprës dhe personazheve që veprojnë në të;</div><div>- argumenton përshtypjet e tij për librin;</div><div>- zbulon mesazhin kryesor që përcjell vepra.</div></div>		Autor Tema Ideja Subjekti Personazhet Mesazhi	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stubi mendimi, Grupet e ekspertëve, Rishikim në dyshe			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stubi mendimi			
Nxënësit janë udhëzuar tri ose katër javë më parë për veprën letrare që do të diskutohet në klasë.			
<div><div><div>Skeda e librit</div><div>a)Titulli i librit b)Gjinia c)Autori d)Shtëpia botuese e)Viti i botimit</div></div><div><div>Çfarë kanë shkruar kritikët rreth kësaj vepre?</div></div><div><div>Përshtypjet e nxënësve për veprën letrare</div></div><div><div>Vepra letrare</div><div>Dy fjalë për autorin</div><div>Biografia e tij</div><div>Analiza e veprës letrare</div><div>a)Tema b)Ideja c)Subjekti d)Personazhet</div><div>Pjesa që ju pëlqen më shumë</div></div></div>			
Ndërtimi i njohurive të reja: Grupet e ekspertëve			
Pasi ndërtuam organizuesin grafik me përgjigjet e nxënësve nxënësit bisedojnë më me hollësi për:			
Grupi 1: Skedën e librit, biografinë e autorit			
Grupi 2: Materialin e hulumtuar rreth mendimit të kritikëve për veprën në fjalë			
Grupi 3: Analiza e veprës letrare (tema, ideja, dhe duke bërë analogji me vepra të tjera të autorëve të ndryshëm që kanë trajtuar të njëjtën temë dhe mënyrën se si e kanë trajtuar)			
Grupi 4: Në cilën vetë rrëfëhet ngjarja dhe dallo figurat letrare më të spikatura në kapitullin e parë			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rishikim në dyshe			
Nxënësit në dyshe do të ndalen në momentet kryesore të subjektit të veprës:			
Ku zhvillohet/n ngjarja/et?			
Si përshkruhet mjedisi ku veprojnë personazhet?			
Nxënësit japin mendimet e tyre, diskutojnë duke dhënë argumente dhe vlerësuar më pas përgjigjet e tyre dhe të shokëve të tyre.			
Vlerësimi:			
Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen e tyre në diskutim dhe argumentet e dhëna.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Bisedë letrare (ora II)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b>	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton rreth jetës dhe veprës letrare të autorit të veprës së zgjedhur;</li> <li>- zbulon temën dhe idenë kryesore të veprës letrare;</li> <li>- diskuton rreth subjektit të veprës dhe personazheve që veprojnë në të;</li> <li>- argumenton përshtypjet e tyre për librin;</li> <li>- zbulon mesazhin kryesor që përcjellë vepra.</li> </ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Autor Tema Ideja Subjekti Personazhet Mesazhi	
<b>Burimet:</b>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stuhi mendimi, Punë në grupe, Diagram Veni, Karrigia e nxehtë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënës:</b> Stuhi mendimi <b>Nxënësit në këtë orë bisede do të diskutojnë rreth personazheve, do t'i analizojnë ato.</b>			
<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 20%;">Çfarë mendon?</div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 50%; padding: 10px; width: 20%; text-align: center;">Skeda e personazhit</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 20%;">Si i përjeton ngjarjet, veprimet?</div> </div> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center; margin-top: 10px;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 20%;">Si vepron?</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 20%;">Anët e forta të tij/Pika e dobët e tij</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 20%;">Çfarë thotë?</div> </div>			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë në grupe <b>Nxënësit diskutojnë se cilët prej personazheve i ka bërë më shumë përshtypje?</b> Argumento me cilin prej personazheve ngjan më shumë. Veço dy personazhe dhe gjej të përbashkëtat dhe të vecantat midis tyre. tPloëso diagramin e Venit.			
Jep gjykimin tënd rreth personazhit.			
<b>Veprimet e personazhit</b>		<b>Vlerësimi im</b>	
<b>Plotëso:</b>			
<b>Personazhi</b>	<b>Karakteristikat fizike</b>	<b>Bota e brendshme</b>	

<p>Gjej personazhin që i ngjan më shumë dhe thuaj pse.</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> <i>Karrigia e nxehtë</i></p> <p>Zgjidh njërën prej personazheve që të pëlqen më shumë. Përpiku të vihesh plotësisht në vendin e tij; të mendosh si ai, të veprësh si ai. Ulu në një karrige para klasës (karrigia e nxehtë) dhe kërkoju shokëve të klasës të drejtojnë pyetje njëllor sikur ia drejtojnë personazhit që ti po aktron. P.sh.: Unë jam X, Y.</p> <p>Çfarë doni të dini prej meje?</p> <p>Përgjigju pyetjeve njëllor sikur të ishit personi në fjalë. Pyetjet e bëra nga shokët mund të kërkojnë informacion për çdo gjë që lidhet me këtë personazh. Ata mund të bëjnë pyetje delikate, prandaj tregoni kujdes se “mos digjeni”!</p> <p>Nxënësit japin mendimet e tyre, diskutojnë duke dhënë argumente dhe vlerësuar më pas përgjigjet e tyre dhe të shokëve të tyre.</p> <p>Më pas gjejnë pjesën që u pëlqen më shumë dhe argumentojnë pse u ka pëlqyer ajo.</p> <p><b>Vlerësimi:</b></p> <p>Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen e tyre në diskutim dhe argumentet e dhëna gjatë orës së mësimit.</p>
---

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p><b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore</p> <p><b>Leksikologji</b></p> <p><b>Tema mësimore:</b> Stilet e gjuhës</p>	<p><b>Situata e të nxënës:</b></p> <p>Një kërkesë për drejtorinë e shkollës</p> <p>Hartoni një kërkesë për vazhdimin e studimeve në një shkollë të mesme drejtuar drejtorisë së shkollës.</p>	<p><b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</li> <li>- Kompetenca e të menduarit</li> <li>- Kompetenca qytetare</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton stilin e gjuhës që u përkasin tekstet e dhëna;</li> <li>- analizon karakteristikat e stileve të gjuhës;</li> <li>- krahason stilet e gjuhës me njëri-tjetrin.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe</b></p> <p>Stilet e gjuhës</p> <p>Stili shkencor-teknik</p> <p>Stili i letërsisë artistike</p> <p>Stili administrative-juridik</p> <p>Stili politiko-shoqëror</p>	<p><b>Burimet:</b> Libri i nxënësit tekste të ndryshme letrare dhe joletrare</p>	
<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p>letërsi</p>		<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Bashkëbisedim, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Punë e pavarur</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim</p> <p>Gjuha standarde përdoret në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore. Secila fushë i zgjedh, i përdor dhe i përpunon mjetet gjuhësore sipas nevojave të veta. Sistemi i mjeteve gjuhësore, i përpunuar e i përdorur sipas kërkesave të një fushe të caktuar të veprimtarisë shoqërore, përbën stilet e gjuhës.</p> <p>1) <i>Dimër acar. Dielli ndrit shumë e ngroh pak. Era e marrë tund rrapin e moçëm të Jutbinës. Maleve ka rënë borë e madhe. Ahet janë të rënduara sa mend thyhen.</i></p> <p><i>Pishave u kanë mbetur jashtë vetëm kreshtat. Vajzat e Jutbinës kanë dalë bregut të lumit. Ato kërkojnë ujë për gjënë e gjallë, por tërë lumi ka ngrirë akull.</i></p> <p><i>Sa të hapesh e të mbyllësh sytë, moti ndryshon. Dynden retë e zënë diellin. Nga lart endet një pëlthurë shumë e gjerë e shumë e gjatë që fshin përnjëmend gjithë majat rreth e rrotull. Shtrohet dëborë e re mbi të vjetrën...</i></p> <p><i>Cilit stil i përket ky tekst? Diskutoni.</i></p>	

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Mbajtja e strukturuar e shënimeve



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë e pavarur

\*Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 1-3.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e stileve të gjuhës në tekste të ndryshme.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Leksikologji</b> <b>Tema mësimore:</b> Dialektet e gjuhës shqipe		<b>Situata e të nxënit:</b> Në klasë Klasat tona janë heterogjene me popullsi të ardhura nga krahina të ndryshme. Improvizoni një dialog një nxënës nga pjesa e Shqipërisë Veriore me një nga pjesa e Shqipërisë së Mesme.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon tekstet e shkruara në dialektin e Jugut nga ato të dialektit të Veriut;</li><li>- krahason të folmet dialektore dhe dialektet;</li><li>- analizon dallimet fonetike dhe leksikore midis dy dialekteve.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Dialekt Fjalë krahinore Ndryshim fonetik Ndryshim leksikor	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Punë e drejtuar me fisha, DDM

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Punë e drejtuar me fisha

Mësuesi/ja u shpërndan fisha me poezi a me thënie të ndryshme në dialektin e Veriut dhe dialektin e Jugut. Nxënësit do të bëjnë identifikimin e dialekteve.

**Shembull**

Gjuha Shqipe – Gj.Fishta

Porsi kanga e zogut t'verës,

qi vallzon n'blerim të prillit;

porsi i ambli fladi i erës,

qi lmon gjit e drandofillit;

porsi vala e bregut t'detit,

porsi gjâma e rrfës zhgjetare,

porsi ushtima e një tërmetit,

ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare.

Ah! po; â' e ambël fjala e sajë,

Në cilin dialekt janë shkruar vargjet?

**Ndërtimi i njohurive të reja:** DDM

<b>Di</b>	<b>Dua të di</b>	<b>Mësova</b>
Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: <i>gegërishten</i> në Veri dhe <i>toskërishten</i> në Jug.	Cilat janë dallimet midis dialekteve?	Dallimet midis tyre janë fonetike dhe leksikore.
Kufiri ndarës i tyre është lumi Shkumbin.	Po të përbashkëtat midis tyre?	E përbashkëta kryesore midis tyre është veprimi pasurues i barabartë në leksik.
Edhe brendapërbrenda një dialekti ka dallime gjuhësore ndërmjet krahinave të ndryshme. Këto dallime përbëjnë krahinorizmat ose të folmet krahinore.		Dhe në fushën e fjalëformimit gjuha standarde merr shumë nga dialektet.

Tabela plotësohet dhe me pyetje të tjera të bëra nga nxënësit. Ju kujtojmë se këto janë thjesht orientime për ta bërë më të lehtë planifikimin ditor të mësuesit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë me fisha

Mësuesi/ja ushtrimet i përgatit me fisha dhe shpërndan nga një fletë formati për ta plotësuar punën dyshet.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të dialekteve në raport me gjuhën standard.

**Detyrë shtëpie:** Fjalët Kojshi, cucë dhe bonjak kanë ekuivalentet e tyre në dialektin e Jugut. Gjejini ato duke përdorur Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuha Shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Pasqyra e dëshirave</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Mësuesi/ja vendos në videoprojektor sekuenca nga filmi me të njëjtin titull <a href="https://www.youtube.com/watch?v=Ck4Bk6SKO7o">https://www.youtube.com/watch?v=Ck4Bk6SKO7o</a>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- flet për jetën e shkrimtares Xhoanë Kethlin Rouling dhe vëllimit të parë të saj ‘Harry Potter dhe guri filozofik’;</li><li>- rindërton ngjarjen sipas strukturës: hyrje; zhvillim; mbyllje;</li><li>- analizon personazhet e fragmentit;</li><li>- zbulon mesazhin që përcjell fragmenti.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Pasqyra e dëshirave Plotësim dëshirash Prindërit e Harry-t Profesor Urtimori	
<b>Burimet:</b> teksti i gjuhës shqipe, vëllimi “Harry Potter dhe guri filozofik”, CD me fragmentin me të njëjtin titull		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi, Punë në dyshe, Bashkëbisedim</i> <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stuhi mendimi</i>			
<div><div><div>I pari nga shtatë romanet e Harry Potërit</div><div>Harry zbulon se ka fuqi magjike brenda vetes</div><div>Lindi në 31 korrik 1965 në një familje angleze</div><div>Në 1995 doli dorëshkrim dhe 1997 doli në treg</div><div>Harry Potter dhe dhuratat e vdekjes</div><div>Harry Potter dhe guri filozofal</div><div>Harry Potter dhe I burgosuri i Azkabanit (1999)</div><div>Harry Potter and the Chamber of Secrets (1998)</div><div>Harry Potter dhe kupa e zjarrit (2000)</div><div>Fitoi një sërë Çmimesh ndër të tjerash dhe ‘Çmimi Britanik i Librit për Librin për Fëmijë të Vitit ‘</div><div>Xhoanë Kethlin Rouling@ Harry Potteri dhe guri filozofik</div><div>Harry Potter dhe fëmija i mallkuar</div></div></div>			

Harri Potter është një djalosh jetim dhe pa miq, që nuk e duan dhe e tallin në familjen që e ka adoptuar. Megjithatë, jeta e tij merr një kthesë krejtësisht të re kur ai zbulon që është magjistar dhe fillon studimet në shkollën e magjistarëve për të mësuar magji. Ai zbulon gjithashtu se prindërit e tij nuk e kanë humbur jetën në një aksident me makinë, por ishin vrarë nga magjistari të cilit i druhen të gjithë, Fluronvdekja. Sipas një profecie të mistershme, Fluronvdekja është përpjekur të mallkojë Harrin, por nuk ia ka dalë dot dhe ka humbur fuqinë e veta. Meqenëse vetëm Harri i ka mbijetuar mallkimit, ai është i famshëm mes magjistarëve, por jo të gjithë e duan, sidomos mbështetësit e Voldemortit. Në veprën që ne kemi përzgjedhur, ndërtohen të dhënat bazë për historinë, prezantohet Harri dhe personazhet e tjerë, përshkruhen rregullat kryesore të botës së magjistarëve, lëndët që zhvillohen në shkollë, rregullat e lojërave sportive, etj. Harri dhe miqtë e tij, Roni dhe Hermiona, mësojnë rreth magjive dhe përfshihen në rreze kur përpiqen të zgjidhin misterin e gurit filozofal. Mendojmë se Shtatë romanet fillojnë me Harry Potter and the Philosopher's Stone

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

**Kuptojmë tekstin**

**1. Plotësoni tabelën e mëposhtme, në mënyrë që të ndërtoni ngjarjen e rrëfyer më sipër:**

**Hyrje:** Natën e tretë rrugën e gjeti shumë më shpejt se herët e tjera. Po ecte aq shpejt sa po bënte më shumë zhurmë se çdo të bënte një njeri i matur, por nuk hasi në njeri ... As edhe një gjë. Përveç se.....

**Zhvillim:** Epo... përsëri ke ardhur, Harri? Harri ngriu në vend. Pa mbas vetes. Ulur në njërin nga bankat e rreshtuara rrëzë murit, ishte vetë Albus Urtimori... deri Kushedi pse mua më dhurojnë vetëm libra.

**Mbyllje:** Vetëm kur u fut përsëri në shtrat, Harri mendoi se mbase Urtimori nuk i kishte thënë të vërtetën. Por tek ishte duke përzënë nga nënkresa miun Kore, mendoi që, në fund të fundit, pyetja e tij mbase kishte qenë një pyetje shumë personale.

**Analizojmë tekstin**

**2. Si do ta përcaktonit ngjarjen e rrëfyer?**

a) Reale b) Fantastike c) Fantastiko-shkencore d) Me aventura e) Historike

**3. Bazuar në dialogun e zhvilluar midis personazheve, si mendoni, çfarë marrëdhënieje kanë?**

**Në fillim mendojmë se marrëdhënia midis Urtimorit dhe Harrit është shumë formale dhe jo miqësore dhe kjo duket në këtë fragment "Harri ngriu në vend. Pa mbas vetes. Ulur në njërin nga bankat e rreshtuara rrëzë murit, ishte vetë Albus Urtimori. Harri do t'i kishte kaluar pranë pa e parë aspak, aq e madhe kishte qenë dëshira që të kthehej para pasqyrës.**

– Unë... unë nuk ju pashë zotni.

– Çudi: të qenit i padukshëm të bëka dritëshkurtër! – vërejti Urtimori dhe Harrit **iu shkri gjaku** kur pa se po buzëqeshte"

Më pas marrëdhënia e tyre i shkrin akujt.

Unë s'kam nevojë për mantel për t'u bërë i padukshëm, – tha Urtimori **me zë të ëmbël.**

Po edhe jo, – tha **Urtimori i qetë.**

**Këshillues:** Mos harro: nuk ka kuptim që njeriu të zhytet mes ëndrrave dhe të harrojë të jetojë.

**I paqtë:** A mund t'ju bëj një pyetje?

– S'do mend! Tashti sapo ma bëre! – **Urtimori buzëqeshi.**

**4. Cili është sekreti i Pasqyrës së Dëshirave, sipas Urtimorit?**

Ne shohim atë që dëshirojmë... gjërat që duam... Ky është sekreti i pasqyrës së dëshirave sipas Urtimorit.

**Gjuha e tekstit**

**5. Gjuha e përdorur nga autori në këtë fragment, karakterizohet nga përdorimi:**

- i figurave letrare;

- i termave të fushave të ndryshme;

- i emrave të përveçëm;

- **i ironisë;** Kushedi pse mua më dhurojnë vetëm libra.

- **i humorit.** Zotni... profesor Urtimor... A mund t'ju bëj një pyetje?

– S'do mend! Tashti sapo ma bëre! – Urtimori buzëqeshi. – Sidoqoftë mund të më bësh edhe një tjetër.

– Çfarë shihni ju, kur shikoheni në atë pasqyrë?

– Unë? Shoh veten me një palë çorape të trasha leshi në dorë. Harri vështroi pa i besuar.

– Çorapet nuk janë kurrë mjaft, – tha Urtimori. – Kaloi edhe një Krishtlindje tjetër dhe nuk më ka dhuruar askush goftë dhe një palë çorape.

**Ilustroni zgjedhjen tuaj me shembuj nga teksti.**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Bashkëbisedim

Si mendoni, cili është mesazhi që përcjell këshilla e Urtimorit? Zgjeroheni atë duke e konkretizuar me shembuj nga jeta juaj.

*Harri, dhe unë kërkoj prej teje të mos përpiqesh më kurrë ta gesh. Nëse ka për të të qëlluar ta hasësh përsëri, do të jesh i përgatitur. Mos harro: nuk ka kuptim që njeriu të zhytet mes ëndrrave dhe të harrojë të jetojë.*

Nxënësit fillojnë e konkretizojnë këshillën e Urtimorit me shembuj nga jeta e tyre ose e prindërve të tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të kuptuarit e tekstit, për analizën e tij dhe mesazhet që transmeton ai te lexuesi.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një rrëfim të shkurtër me temë: “Pasqyra e dëshirave”. Prezantoni variantin e parë dhe variantin përfundimtar të punës suaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimin	Lënda: Gjuha shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Makina e kohës</b>	<p><b>Situata e të nxënës:</b> Vendoset në videoprojektor një fragment nga filmi vizatimor në shqip Makina e kohës  <a href="https://sss.youtube.com/watch?v=cZKxUgb6sRs">https://sss.youtube.com/watch?v=cZKxUgb6sRs</a></p> <p><b>Subjekti i filmit</b>  <i>Një grup njerëzish, duke përfshirë edhe tregimtarin, po dëgjojnë Udhëtarin e Kohës që diskuton teorinë e tij se koha është dimension i katërt. Udhëtarin e kohës prodhon një makinë miniaturë dhe e bën atë të zbulohet në ajër të hollë. Javën e ardhshme, të ftuarit kthehen, Ata ulen e pas darkës, Udhëtarin kohor nis historinë e tij.</i>  <i>Udhëtarin kohor më në fund kishte përfunduar punën në makinën e tij kohore, dhe ai e shtyu atë në të ardhmen. Kur makina ndalet, në vitin 802, 701 pas Krishtit, ai e gjen veten në një botë parajsore të krijesave të vogla humanoidë të quajtur Eloi.</i>  <i>Ata janë të dobët dhe të qetë dhe i japin frytë për të ngrënë. Ai e shqyrton zonën, por kur kthehet ai gjen se makina e tij e kohës është zhdukur. Ai vendos se është vendosur brenda pedestalit aty pranë. Ai përpqet ta hapë atë hapur, por nuk mundet. Në natën, ai fl lon të kapë krijesa e panjohura që i quajnë Morlocks. Morlockët jetojnë nën tokë, poshtë puseve . Ndërkohë, ai shpëton një nga Eloi nga mbytja, dhe ajo miqësohet me të. Emri i saj është Weena. Udhëtarin kohor më në fund punon me guxim të mjaftueshëm për të hyrë në botën e Morlocks për t'u përpjekur të rifitojë makinën e tij kohore. Ai gjen se ndeshjet janë një mbrojtje e mirë kundër Morlocks, por në fund ata e ndjekin atë . I frikësuar nga Morlocks, ai merr Weenën dhe përpqet të gjejë një vend ku ata do të jenë të sigurt nga gjuetia e natës së Morlocks. Ai shkon në atë që ai e quan Pallatin e Porcelanit të Gjellbër, i cili rezulton të jetë një muze. Atje, ai gjen më shumë ndeshje, disa kamfare dhe një levë që mund të përdorë si armë. Atë natë ai u tërhoq nga Morlockët. Duke u tërhoqur nga Morlockët nëpër një dru gjigant, aksidentalisht fillon një zjarr. Shumë Morlocks vdesin në zjarr dhe në betejën që vjen pas, dhe Weena është vrarë. Udhëtarin e rraskapitur i kohës kthehet në pedestal për të gjetur se është tashmë i hapur. Ai përparon me besim, dhe vetëm kur Morlocks mendojnë se ata e kanë zënë atë, Ai kthehet në makinë në të ardhmen. Udhëtarin kohor bën disa ndalesa të tjera. Në një kohë të largët ai ndalon në një plazh ku ai është sulmuar nga gaforret gjigante. Dielli i kuq i fryrë qëndron i palëvizshëm në qiell. Ai pastaj udhëton tridhjetë milionë vjet në të ardhmen. Ajri është shumë i hollë, dhe e vetmja shenjë e jetës është një blob i zi me tentakula. Ai sheh një planet që eklipson diellin. Ai pastaj kthehet, i lodhur, deri në kohën e tashme. Ditën tjetër, ai largohet dhe nuk kthehet kurrë më.</i></p>		

<p align="center"><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</li> <li>- Kompetenca e të menduarit</li> <li>- Kompetenca personale</li> <li>- Kompetenca digjitale</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton rreth kuptimit të përmbajtjes;</li> <li>- analizon personazhet e fragmentit;</li> <li>- analizon mesazhet për përcjell pjesa;</li> <li>- argumenton mënyrën e rrëfimit dhe efektin që krijon kjo mënyrë të rrëfyeri.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Makina e kohës Fantastiko-shkencor E ardhmja Njerëz të çuditshëm Përsosmëri</p>
<p><b>Burimet:</b> teksti mësimor, videoprojektor, CD me filmin</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, kinematografi</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Parashikim me terma paraprak, Ditari dypjesësh, Shkrim i shpejtë, Punë në dyshe</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Parashikim me terma paraprakë</p> <p>Makina e kohës, fantastiko-shkencor, e ardhmja, njerëz të çuditshëm, përsosmëri. Shkruhen në tabelë këto fjalë kyçe dhe mbi bazën e tyre nxënësit udhëzohen të shkruajnë një tregim. U lihen 7 minuta në dispozicion dhe më pas lexohen punë të tyre. U kërkohet nxënësve të jenë të vëmendshëm në dëgjim, pasi pas leximit të fragmentit të dhënë do të bëhet krahasimi me të dhe do të caktohet se cili nga nxënësit ka bërë parashikimin më të saktë.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Lexim zinxhir, Punë në dyshe</p> <p>Udhëzohen nxënësit të lexojnë zinxhir pjesën, duke mos anashkaluar shenjat e pikësimit, respektimin e pauzave, theksin logjik të fjalisë etj.</p> <p>Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur për rubrikën <b>“Kuptojmë tekstin”</b>.</p> <p>Renditni frazat e dhëna sipas rrjedhës së ngjarjeve në tekst.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>U nisa të bëja një shëtitje.</li> <li>Këta njerëz nuk e njihnin domethënien e frikës.</li> <li>Makina u përmbys.</li> <li>Për herë të parë i hodha një shikim të plotë botës së të ardhmes.</li> <li>Hipa sërish mbi Makinën e Kohës dhe u ula.</li> <li>Tërhoqa fort levën e ndalimit.</li> <li>Askush nuk u përpoq të zbulonte se kush isha.</li> <li>Mbeta i shtangur, këta njerëz mendonin se unë kisha rënë prej qielli, njësoj si breshri.</li> <li>Njerëzit kishin humbur ndjenjën e punës për ta bërë jetën më të mirë.</li> <li>Një valë tmerri më kaploi.</li> <li>Pashë se Makina e Kohës ishte zhdukur!</li> </ol> <p><b>Varianti i saktë</b></p> <p>Tërhoqa fort levën e ndalimit.</p> <p>Makina u përmbys.</p> <p>Për herë të parë i hodha një shikim të plotë botës së të ardhmes.</p> <p>Hipa sërish mbi Makinën e Kohës dhe u ula.</p> <p>Këta njerëz nuk e njihnin domethënien e frikës.</p> <p>Askush nuk u përpoq të zbulonte se kush isha.</p> <p>Mbeta i shtangur, këta njerëz mendonin se unë kisha rënë prej qielli, njësoj si Breshri.</p> <p>U nisa të bëja një shëtitje.</p> <p>Njerëzit kishin humbur ndjenjën e punës për ta bërë jetën më të mirë.</p> <p>Një valë tmerri më kaploi.</p> <p>Pashë se Makina e Kohës ishte zhdukur.</p> <p><b>Analizojmë tekstin.</b></p> <p>Në këtë rrëfim, autori: është vetë pjesëmarrës në ngjarje; vëzhgon ngjarjet; rrëfen ngjarjet në vetën e tretë. Cili është efekti që krijon kjo mënyrë rrëfimi?</p>	

**Gjuha e tekstit**

- **Nënvizoni frazat që shprehin gjendjen e autorit:**

P.sh.: *U kaplova nga paniku.*

I trullosur, pashë se rrija mbi një shtresë të butë e të gjelbër bari.

Mbeta i shtangur, këta njerëz mendonin se unë kisha rënë prej qielli, njësoj si breshri.

Psherëtiva i dëshpëruar.

Një valë tmerri më kaploi.

- **Përcaktoni në ç'klasë fjalësh bën pjesë secila prej fjalëve të këtyre fjalive.**

U pjesëz e formës joveprore (në kohën e kryer të thjeshtë).

Kaplova – kallëzues foljor i thjeshtë mënyra dëftore, koha e kryer e thjeshtë, veta e parë, numri njëjës.

Nga – parafjalë e rasës emërore

Paniku – emër, gjinia mashkullore, lakimi i dytë, trajta e shquar, rasa emërore

- **Dalloni krahasimet e përdorura në këtë pjesë. Zëvendësojini ato me shprehje të tjera sinonime, duke ruajtur kuptimin e figurshëm.**

Gjithçka e tij ishte e bukur, por shumë delikate, **si një lule e përsosur**, që do të thahej nën erën e ftohtë.

Zërat e tyre të ëmbël e melodikë tingëllonin **si zogj që gugatnin**, teksa flisnin. Mbeta i shtangur, këta njerëz mendonin se unë kisha rënë prej qielli, **njësoj si breshri**.

Një valë tmerri më kaploi, njësoj **si bubullima** që më përshëndeti kur mbërrita.

**Reflektojmë rreth tekstit**

**Plotësoni tabelën e mëposhtme dhe reflektoni rreth tekstit. Ditari dypjesësh**

Fragmenti	Komenti im
Ç'është lumturia sipas jush? Çfarë u nevojitet njerëzve për të qenë të lumtur?	
Nëse do të kishit mundësi të udhëtonit në kohë, në cilën kohë do të donit të ndalonit me Makinën e Kohës?	

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrimi i shpejtë**

Ndërsa përshkruan botën e së ardhmes, autori shprehet: “...*Nuk tregonin asnjë shenjë sëmundjeje, asnjë shenjë plage, as moshe, gëzonin shëndet të përkryer, lumturi të përkryer, në një botë të përkryer*”.

Si e mendoni ju një botë të përkryer?


Mendimet tuaja i hidhni në letër dhe më pas diskutoni me shokët.

**Vlerësimi:** Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi.

**Detyrë shtëpie:** Çfarë mendoni se ndodh pasi autori shprehet se Makina e Kohës është zhdukur? Vazhdojini ngjarjet sipas imagjinatës suaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të shkruajmë Tema mësimore: Përshkrimi i personazhit të preferuar		Situata e të nxënit: Pse Parvana është personazhi im i dashur? Diskutojmë së bashku	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për personazhet e preferuara të librave ose të filmave;</li><li>- analizon karakteristikat e pamjes së jashtme dhe të botës së brendshme;</li><li>- ndërton hartën e personazhit të preferuar;</li><li>- përshkruan objektivisht dhe subjektivisht personazhin e preferuar;</li></ul>		Fjalët kyçe: Personazh Heronj Pamja e jashtme Bota e brendshme Përshkrim objektiv Përshkrim subjektiv	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, Hartë personazhi, Shkrim i lirë			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim			
Të gjithë kemi personazhe të preferuara që na kanë mbushur me emocione gjatë leximit të librave të ndryshëm. Ata janë heronjtë e librave tanë. Këta heronj shpesh na kanë lënë me gojë hapur nga pamja e tyre e jashtme, por edhe nga bota e tyre e brendshme. Kur përshkruajmë një personazh dhe vëmë re vetëm pamjen e jashtme themi se përshkrimi është objektiv, kurse kur përshkrimi përqendrohet te karakteristikat e botës së brendshme themi se përshkrimi është subjektiv.			
Diskutoj me nxënësit			
Listo tipare të botës së brendshme të personazheve që ke lexuar:			
i bukur/simpatik/i shëmtuar			
i rregullt/i shkujdesur/i çrregullt			
i shkathët/i ngathët etj.			
Listo karakteristikat të botës së brendshme shpirtërore të personazheve që ke lexuar:			
guximtar/frikacak			
sakrifikues/indiferent			
përkushtuar/individualist			
i dashur/i ftohtë etj.			
Diskutojmë së bashku			
Nxënësit listojnë karakteristikat e personazheve të tyre të dashur.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hartë personazhi, Punë në dyshe			
A na duhet një hero (personazh në tregimet që lexojmë apo shkruajmë)?			
Shiko me kujdes! Nxënësit punojnë në dyshe dhe diskutojnë këshillat e dhëna.			
Kur lexojmë, ne sigurisht që kërkojmë për heroin tonë të tregimit apo të librit.			
Heroi i librit na ushqen dhe na frymëzon për vepra të mira.			
Heroi na ndihmon të gjejmë cilësitë që na mungojnë.			
Heroi na ngre moralin.			
Heroi na jep shpresa.			
Te hero i preferuar ne gjejmë moralin që kërkojmë.			
Heroi na ndihmon për të zgjidhur problemin.			
Fillojmë e lexojmë tregimin e dhënë në tekst “Biblioteka e Sardit”.			
Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve që gjatë leximit të përqendrohen te personazhi dhe karakteristikat e tij dhe këto do t'i mbajnë shënim në bllokun e shënimeve dhe do të ndërtojnë hartën e personazhit, pas leximit të pjesës “diskutoj me nxënësit” për personazhin e Sardit.			



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i shpejtë

Pasi të lexoni tregimin, përcaktoni personazhin tuaj të preferuar. Përshkruani pamjen e jashtme, por edhe botën e brendshme të tij. Mbështetuni te harta e personazhit që ndërtuat, kur të bëni përshkrimin.

Mësuesi/ja, gjatë gjithë kohës që nxënësit punojnë, shkon bankë më bankë për të parë nëse dikush ka nevojë për ndihmë dhe për të parë ecurinë e punës së nxënësve.

Kujdes! Në përshkrimin tuaj mos harroni strukturën e tekstit narrative hyrje, zhvillim, mbyllje!

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimt.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruaj personazhin tënd të dashur të një libri a të një filmi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Leksikologji</b> <b>Tema mësimore:</b> Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimt të saj		<b>Situata e të nxënit:</b> Në hartë Përcaktoni në hartë trevat që përdorin gjuhën standarde shqipe.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon kufirin fizik ndarës të dy dialekteve;</li><li>- dallon gjuhën standarde nga dialektet;</li><li>- argumenton punën e tij për ruajtjen të pastër të shqipes standarde;</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b>  Gjuhë standarde Shkolla Median e shkruar dhe të folur Trevat ku flitet	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</i> Pyetja sjell pyetjen, INSERT, Punë në dyshe <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</i> Pyetja sjell pyetjen Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Mësuesi/ja sqaron nxënësit rreth problemeve të paqarta për ta, më pas fillon me temen e re.			

**Pyetja sjell pyetjen**

Çfarë kuptoni me gjuhë standarde?

Ku flitet gjuha standarde?

Nga dallon gjuha standarde nga dialektet?

Cili është dokumenti që përfaqëson kodin e përdorimit të gjuhës standarde?

Nxënësit u japin pyetjeve përgjigjet që dinë.

**Ndërtimi i njohuriave të reja:** INSERT

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë me vëmendje informacionin e dhënë në tekst dhe më pas të plotësojnë tabelën INSERT.

Njohuritë që i ka marrë më parë	Njohuritë e reja që shtohen këtë orë	Njohuritë që i di, por jo të sakta	Njohuritë e reja që merr dhe nuk i kupton
V	+	-----	?

*Në qoftë se nxënësit kanë informacione të paqarta, mësuesilja i udhëzon ata.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Punohen ushtrimet e tekstit**

**Ushtrimi 1.** Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes gjuhës standarde dhe dialekteve.



**Ushtrimi 2.** Në tekstin me titull “Ngjarje pa lëvizje”, gjeni fjalët e gegërishtes. Përbri secilës fjalë shkruani formën që ka në gjuhën standarde.

**Ushtrimi 3.** Shkruani në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme.

*Bani-bëri me lexu-duke lexuar, kam zgjidh-kam zgjidhur, shqypitar-shqiptar, syni-syri, lark-larg me shkue pa kendue tash, ish foshnjisht i math*

**Ushtrimi 4.** Ndahuni në grupe dhe bëni një projekt me temë “Pasurimi dhe pastrimi i gjuhës standarde shqipe”.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të gjuhës standarde në raport me dialektet.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Panairi i dosjes/portofolit		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
- Kompetenca e të menduarit			
- Kompetenca personale			


<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton me shokët për punët e arkivuara në dosje;</li> <li>- vlerëson dhe vetëvlerëson punët në portofol/ dosje.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Portofol Vlerësim Vetëvlerësim
<b>Burimet:</b> Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në AMU, janar 2017	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Të nxënësve në bashkëpunim

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:** Stubi mendimi

**Si bëhet vlerësimi i nxënësve në fund të viti shkollor?**

**Nxënësit japin mendimet e tyre në një organizues grafik.**



**VLERËSIMI I NXËNËSIT** (Sqarimi jepet nga mësuesi/ja)

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve. Mësuesi/ja, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

Vlerësimi për të nxënë i nxënësve kryhet nëpërmjet:

- vlerësimit të vazhduar;
- vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse;
- vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësve.

**Ndërtimi i njohurive të reja:**

**Të flasim pak rreth portofolit.** Nxënësve u është bërë me dije që në fillim të vitit rëndësia e portofolit të tij.

**Rikujtojmë njohuritë.**

**Vlerësimi me portofol lëndor**

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve krijuese dhe hulumtuese të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohuri, shkathtësi, qëndrime).

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.

Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor. Sugjerohet që përgjatë një periudhe, të përfshihen në portofol, të paktën 3 detyra të nxënësve, përfshirë projektin ose një nga fazat e tij.

Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë (nëse është një) edhe përgjatë gjithë vitit.

Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.

Për vlerësimin e portofolit, mësuesi/ja përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili mësues i vendos secilës detyrë. Rubrikat e portofolit mund të grupohen në: • - punë dhe detyra të kryera në klasë.

Rubrikat e portofolit mund të grupohen në: - punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj, si punë praktike, punë laboratorie, ese, detyrë me shkrim etj.; - projekte individuale ose në grup; - detyra dhe kontribute të pavarura të

nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.). Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet në planin e periudhave si orë e veçantë (në fund ose përgjatë periudhës). Që nxënësi të mos jetë i paqartë për vlerësimin që i bëhet portofolit të tij, mësuesi/ja i shpjegon mënyrën e vlerësimit.

#### **Shembull i vlerësimit të portofolit në lëndën e gjuhës shqipe**

Në lëndën e gjuhës, mësuesi/ja mund të planifikojë të paktën 3 (tri) detyra për portofolin lëndor (përfshirë edhe projektin kurrikular).

Në shembullin më poshtë, mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar e detyra për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 50 pikë.

Për vlerësimin e portofolit, mësuesi/ja përcakton vetë pikët/peshat për secilën detyrë.

Më poshtë është dhënë thjesht një shembull, pikët/peshat e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi/ja).

a) Përshkruani ngjashmëritë dhe dallimet mes jush dhe një personazhi të pëlqyer nga ju. (10 pikë)

b) Projekti “Përgatitja e një reviste për fëmijë” ose çdo temë tjetër që mund të ketë projekti. (20 pikë)

c) Gjetja e rasteve të përdorimit të gabuar të shkronjës së madhe në jetën e përditshme, si p.sh., në meny, në tabela të ndryshme, në televizion, në libra etj.

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	8 pikë	14 pikë	14 pikë	36 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si në rastin e vlerësimit të testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 8 (tetë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	14	14-20	21-26	27-32	33-38	39-44	50

#### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

Mësuesi/ja fillon e vlerëson nxënësit sipas udhëzimeve të dhëna. Nxënësit bëhen pjesëmarrës në vlerësim.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për mënyrën e organizimit të punëve në dosje/portofol.

#### **Testim për tremujorin e parë**

##### *Djali me dy sy*

Larg, shumë larg, në hapësirë ndodhet një planet tamam si Toka. Njerëzit që jetojnë në planet janë tamam si ne, me ndryshimin se ata kanë vetëm një sy. Ata mund të shikojnë larg, shumë larg dhe mund të shikojnë dhe nëpërmjet mureve. Gratë në këtë planet kanë fëmijë ashtu si dhe në Tokë. Një ditë u lind një fëmijë i çuditshëm. Ai kishte dy sy. Babai dhe nëna e tij u mërzitën shumë. Djali ishte një fëmijë i gëzuar. Prindërit e donin dhe u pëlqente të kujdeseshin për të. Por ata ishin të shqetësuar se ai ishte jo i zakonshëm. Ata e çuan atë në shumë doktorë. Doktorët tundnin kokën dhe thonin se ata nuk mund të bënin asgjë.

Ndërsa fëmija rritej, ai krijonte gjithmonë e më shumë probleme. Për arsye se ai nuk mund të shikonte natën, i duhej të mbante një dritë. Kur shkoi në shkollë, ai nuk mund të lexonte aq mirë sa shokët e tij. Mësuesve të tij iu desh që ta ndihmonin dhe më shumë. Ai nuk mund të shikonte në distanca të gjata, kështu që duhet të kishte një teleskop të posaçëm. Me këtë ai mund të shikonte planetet e tjera, si çdokush tjetër. Ngandonjëherë, kur kthehej nga shkolla, ndihej shumë i vetmuar. “Fëmijët e tjerë i shikojnë gjërat, unë nuk mundem”, mendonte ai. “Unë duhet të jem në gjendje të shikoj gjëra, që ata nuk janë në gjendje t’i shikojnë.” Dhe, një ditë të mrekullueshme, ai zbuloi se mund të shikonte gjëra që të tjerët nuk i shikonin. Ai nuk shikonte në bardhë e zi, si shikonin të tjerët. Ai u tregoi prindërve se si i shikonte gjërat. Ai i nxori prindërit jashtë në oborr dhe u tregoi për zbulimin e tij të mrekullueshëm. Ata u habitën shumë. Gjithashtu dhe shokët e tij u habitën shumë. Ai u tregonte atyre përralla fantastike, përdorte fjalë, që ata kurrë nuk i kishin dëgjuar më parë si: e kuqe, e verdhë... dhe portokalli. Ai fliste për pemë të gjelbra dhe për lule rozë. Ndonjëri donte të dinte si i shikonte gjërat. Ai tregonte tregime të mrekullueshme për dete të thella blu dhe valë, që krijonin shkumë të bardhë. Fëmijëve u pëlqente të dëgjonin përrallat e tij tërheqëse me dragoj. Ata mbeteshin gojëhapur, kur ai përshkruante lëkurën e tyre, sytë dhe frymëmarrjen e tyre të nxehtë.

Një ditë takoi një vajzë. Ata ranë në dashuri. Asaj nuk i bënte përshtypje që ai kishte dy sy. Dhe, më vonë, ai pa se dhe atij nuk i bënte përshtypje. Ai ishte bërë shumë i famshëm. Njerëzit vinin nga gjithë planeti ta dëgjonin të fliste. Ata patën një djalë. Djali ishte si të gjithë fëmijët e tjerë të planetit. Ai kishte një sy.

**1) Cili ishte dallimi i djalit nga fëmijët e tjerë? (1 pikë)**

- a) Ishte më një dorë
- b) Kishte vetëm një këmbë
- c) Kishte dy sy
- d) Kishte dymbëdhjetë gishtërinj

**2) Njerëzit e këtij planeti kishin një dhunti: (1 pikë)**

- a) Shikonin dhe nëpërmjet mureve.
- b) Parashikonin të ardhmen.
- c) Kuptonin gjuhën e kafshëve.
- d) Çfarë preknin e kthenin në ar.

**3) Çfarë vështirësish kishte djali me dy sy? (1 pikë)**

- a) Nuk dëgjonte.
- b) Nuk shikonte në distance të largëta.
- c) Nuk fliste.
- d) Nuk fliste dhe nuk dëgjonte.

**4) Pse prindërit ishin të shqetësuar për të? Listo tre shembuj nga teksti. (4 pikë)**


---



---



---



---

**5) Cila ishte mrekullia që i ndodhi djalit? (1 pikë)**


---

**6) Pse djali u bë i famshëm? Argumentoni përgjigjen tuaj. (2 pikë)**


---



---

**7) Shkruani një ese me temë: “Të ndryshëm, por të barabartë” (4 pikë)**


---



---



---



---



---



---



---



---

*Përdorimi i gjuhës***1) Argumentoni përdorimin e dy pikave në fjalinë e dhënë. (1 pikë)**

*Ai u tregonte atyre përralla fantastike, përdorte fjalë, që ata kurrë nuk i kishin dëgjuar më parë si: e kuqe, e verdhë... dhe portokalli.*

**2) Argumentoni përdorimin e thonjëzave në fjalinë e dhënë. (1 pikë)**

*“Fëmijët e tjerë i shikojnë gjërat, unë nuk mundem”, mendonte ai.*

**3) Në pjesën e dhënë “Djali me dy sy” gjeni 2 fjalë që ta kenë bashkëtingëlloren e zëshme në fillim të fjalës dhe 2 që ta kenë në trup të saj. (4 pikë)****4) Qarkoni rastet kur foljet janë shkruar saktë: (2 pikë)**

*fryj – fryej; lyj – lyej; paguaj – paguj; shlyj – shlyej.*

**5) Cila fjalë është shkruar saktë: (3 pikë)**

*sfurg – sfurk – cfurk; sbardh – zbardh – zbarth; cmirë – smirë; cbokth – zbokth; cfilit – sfilit*

- 6) Formoni fjalë të tjera prej fjalëve *shmang, shlyej, shndërroj, shndrit*. Cilës klase fjalësh i përket secila prej fjalëve të reja? (4 pikë)

---

- 7) Krijoni një situatë ku komunikimi të realizohet me regjistrë të thjeshtë. Listoni 3 karakteristika të këtij regjistri. (4 pikë)

---



---



---

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

- 8) Bëni analizën fjalëformuese të fjalëve *përshkruante* dhe *ndihmonin*.

Plotësoni në tabelë (5 pikë)

Fjala	Rrënja	Tema	Parashtesa	Prapashtesa	Mbaresa
<i>Përshkruante</i>					
<i>Ndihmonin</i>					

- 9) Fjalën “Fëmijë” përdore në fjali një herë me kuptim të mirëfilltë dhe një herë me ngjyrim emocional. (2 pikë)

a) Kuptim të mirëfilltë \_\_\_\_\_

b) Ngjyrim emocional \_\_\_\_\_

- 10) Cilët stil i përket teksti “Djali me dy sy”. Thoni karakteristikat e këtij stili. (4 pikë)

---



---




---

- 11) Cilët dialekt i përkasin vargjet e mëposhtme. Kthejini poezinë në normë letrare. Listo ndryshimet midis fjalëve në dialekt dhe atyre në standard. (5 pikë)

Ishin dhëtë vjet m a ma ndoshta, qi s`e shifte at mur. Nji mur i vjetër jo fort i naltë, i nximë prej kohët, me këllqere gjithkund të rame. Ngjyra e atij muri e bante Lecin me andrrue. S`kishte nji ngjyrë të përçansueme; në të gjitha ngjyrat ishin të përmladhuna. Shiu e dielli tue rrah me vjet e vjet e kishin veshun me nji lemashk të bruzët ashtu si hijet e gjalla të kopshtit.

- 12) Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes gjuhës standarde dhe dialekteve. (2 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	13	14-20	21-26	27-32	33-38	39-44	45-50

Çelësi i zgjidhjes

1) C

2) A

3) B

4) Prindërit ishin të shqetësuar se djali i tyre ishte i ndryshëm nga të tjerët.

Shembuj nga teksti

1) Ai nuk mund të shikonte në distanca të gjata.

2) Ai kishte dy sy.

3) Nuk shikonte natën dhe duhej të mbante një dritë.

4) Nuk lexonte aq mirë sa shokët.

5) Ai kishte filluar të shihte gjëra që të tjerët nuk i shikonin

Ose nuk shihte më bardhë e zi si shikonin të tjerët.

6) U bë i famshëm për shkak se, ai u tregonte atyre përralla fantastike, përdorte fjalë, që ata kurrë nuk i kishin dëgjuar më parë si: e kuqe, e verdhë... dhe portokalli.

Ai tregonte tregime të mrekullueshme për dete të thella blu dhe valë, që krijonin shkumë të bardhë.

Ai fliste për pemë të gjelbra dhe për lule rozë.

### **Përdorimi i gjuhës**

1) Përdoren dy pikat për numërimin e një vargu shembujsh.

2) Përdorën thonjëzat për të dalluar fjalët që riprodhohen nga fjalët e autorit.

3) bardhë b në fillim të fjalësh; dh në trup të saj

Ditë – d në fillim të fjalës

Gojëhapur – g në fillim të fjalës

Gjendje – d në trup të saj

4) fryj – fryej; lyj – lyej; paguaj – paguj; shlyj – shlyej

5) sfurg – sfurk – sfurk; sbardh – zbardh – zbarth; cmire – smire; cbokth – zbokth; cfilat – sfilat

6) shmang - folje shlyej - folje

Shmangie - emër shlyerje - emër

I shmangur - mbiemër I shlyer - mbiemër

7) Situata:

A - Hapi dritaret se plasëm vape.

B - Dale ti dale, të paska hipur vapa.

C - Ej, nuk ka ardhur ende vera.

A - Të foli kush ty?

B - Do ta qepësh gojën ti? Mos i fol atij ashtu!

A - Kush të foli?

Regjistri i thjeshtë është ai regjistër gjuhësor që përdoret në familje ose në shoqëri, në situata të lira komunikimi. Disa nga karakteristikat e tij janë renditur në vijim.

Shpesh mungon kryefjala: *Mjaft, mos fol më!*

Ka raste që mungon edhe folja: *Këtu! Poshtë! Lart!*

Përdoren fjalë parazite, si: *po jo, po... po, eee, atëherë.*

Bashkëbiseduesit i drejtoheni me *ti*.

Përdoren shpesh fjalë dhe shprehje dialektore.

Shkurtohen emërtimet: *Do udhetoj me "Al Italia", me "Adriatik" etj. Kemi seminar te "Sheratoni".*

8) përshkruante ndihmonin

Për – parashtesa o – prapashtesë

Nte – mbaresa nin – mbaresa

Përshkrua (j) – tema ndihmo

Shkrua (j) – rrënja ndihm(ë)

9) mos u bëj fëmijë – ngjyrim emocional

Fëmija qante me të madhe për lodrën e tij të preferuar. Kuptim i mirëfilltë

**10)** I përket stilit të letërsisë artistike.

*Karakteristikat e tij:*

Përdoren shumë fjalë me kuptim të figurshëm (*dimër acar, dielli ndrit shumë e ngroh pak; dynden retë etj.*).

Përdoren shumë fjalë që tregojnë cilësi (*e marrë, i moçëm, të renduara etj.*).

Përdoren shprehje frazeologjike (*sa të hapesh e të mbyllesh sytë*).

Përdoren lloje të ndryshme fjalish.

**11)** Ishin dhjetë vjet më shumë ndoshta, që s' e shihte atë mur. Një mur i vjetër jo shumë i lartë, i nxirë prej kohësh, me gëlqere gjithkund të rënë. Ngjyra e atij muri e bënte Lecin të ëndërronte. S' kishte një ngjyrë të veçantë; në të gjitha ngjyrat ishin të përmbledhura. Shiu e dielli duke e rrahur me vite e vite e kishin veshun me një lemashk të bruzët ashtu si hijet e gjalla të kopshtit.

“Kumbulla përtej murit” E. Koliqi

Ndryshime fonetike

Ndryshime leksikore

Të pëçansueme – të veçantë

përmbledhuna – përmbledhura

tue rrah – duke e rrahur - morfologjike

lemashk – myshk

dhetë – dhjetë

shifte – shihte

gëlqere – gëlqere

bruzët – ngjyrë e kaltër

**12)** Gjuha standarde shqipe është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit

Shqiptar. Ajo përfshin gjuhën që përdoret në shkollë, në dokumente zyrtare, në

botime, si dhe në komunikimin zyrtar.

Gjuha standarde pasurohet duke marrë vazhdimisht fjalë prej tyre, me të cilat zëvendëson fjalët e huaja ose sjell nuanca e ngjyrimet emocionuese a larmi të shprehjes.

Edhe në fushën e fjalëformimit, gjuha standarde merr shumë prej dialekteve.

Gjuha standarde shqipe dallohet për praninë e rregullave dhe normave, që duhen

zbatuar gjatë përdorimit të gjuhës.

Dialektet. Dialektet përbejnë edhe pasurinë leksikore të gjuhës. Tipar i përbashkët i të dy dialekteve, është veprimi pasurues i barabartë në leksikun e saj.

# TREMUJORI I DYTË

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Rent or Maratonomak (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënët:</b> Historia e maratonës dhe maratonomakut Historia e maratonës fillon që në antikitet kur një ushtar grek përshkoi një distancë prej 48 km nga Maratona deri në Athinë për të lajmëruar që grekët fituan luftën ndaj Persisë. Ky ushtar quhej Filipides dhe për fat të keq nuk e përballoi dot sforcimin. Për nder të tij u krijua disiplina e maratonës në olimpiadën e parë moderne, duke iu vënë emri i qytetit ku filloi gjithçka. Në maratonën e parë të bërë në Greqi në vitin 1896 për rastësi të fatit fitoi përsëri një grek. Akademia e gjuhës e përcakton termin marathon: atletikë, rezistencë përgjatë rrugës prej një distance 42 km e 195 m. Në ditët e sotme nuk ka ndonjë kompeticion tjetër më me shumë rezistencë se maratona. Disiplinë sportive që është konsideruar olimpike që prej 1896. Në fillim ka qenë e praktikuar vetëm prej meshkujve dhe pas viteve '70 iu lejua dhe femrave për të marr pjesë. Aktualisht janë sportistët afrikanë që dominojnë këtë sport, për shkak të terrenit që kanë vendet e origjinës së tyre dhe fizionomisë trupore. <a href="https://sportfanal.ordpress.com/2014/09/22/%D2%ABfare-eshte-maratona/#more-330">https://sportfanal.ordpress.com/2014/09/22/%D2%ABfare-eshte-maratona/#more-330</a>	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth jetës dhe veprës letrare të Fan Nolit;</li><li>- diskuton rreth rolit të lajmëtarit në lashtësi;</li><li>- analizon rolin e figurave letrare në poezi;</li><li>- zbulon mesazhet që përcjell poezia;</li><li>- analizon veçoritë gjuhësore të poezisë;</li><li>- reciton bukur e me ndjenjë poezinë.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Maratonomak Rent, vrapo Lajm i fitores Pushtues Njerëzia Athina Vdiq	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit <a href="https://sportfanal.wordpress.com/2014/09/22/%D2%ABfare-eshte-maratona/#more-330">https://sportfanal.wordpress.com/2014/09/22/%D2%ABfare-eshte-maratona/#more-330</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Skeda e autorit, Punë individuale dhe në dyshe, Rrjet diskutimi  
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Skeda e autorit

Kryeministër i Shqipërisë  
 16 qershor 1924-23 dhjetor 1924  
 Lindi më 6 janar 1882 Ibriktepe, Perandoria  
Osmane, sot Turqia  
 Vdiq 13 mars 1965, në Boston

\* Recitohen vargje nga Fan Noli. Për këtë, nxënësit janë udhëzuar disa orë më parë që të hulumtojnë rreth jetës dhe veprës së Fan Nolit.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë individuale dhe në dyshe

**Nxënësit fillojnë e bëjnë leximin shprehës të poezisë duke u përqendruar tek artikulimi i saktë i fjalëve ritmi, intonacioni i zërit etj.**

**Më pas fillojnë e punojnë në dyshe.**

Pasi të lexoni poezinë, përgjigjuni pyetjeve:

**Çfarë i kërkon poeti Marathonmakut në fillim të poezisë?**

Poeti i kërkon Maratonmakut të shkojë nga Maratona në Athinë e të shpërndajë lajmin e fitores.

*Rent, or rent, rent e u thuaj*

*Se u çthur ordi e huaj,*

*Se betejën e fituam*

*Dhe qytetin e shpëtua*

**Cili është lajmi që duhet të shpërndahet dhe detyra e tij?**

Lajmi i fitores dhe dërgimi në Athinë i lajmit të fitores nga Persët.

**Gjeni fjalët kyçe të strofës së parë që ndërtojnë lajmin.**

*Rent, u thuaj, beteja u fitua, qyteti u shpëtua,*

**Cila nga fjalët e mëposhtme tregojnë qëndrimin e Marathonmakut përballë turmës së njerëzve?**

*Brohorite. Vërtitesh. E shpëtua. Çkallmon.*

**Si e shtyn autori Marathonmakun drejt qëllimit final? Gjeni vargjet që e tregojnë këtë.**

*Hajde, ja Akropolia,*

*Ja qyteti e njerëzia*

*Që të pan' e që të çquan*

*Dhe fuqinë t'a rishtuan*

*Ha dhe pak,*

*Hajde, or Marathonmak!*

**Çfarë tregon strofa e parafundit? Ç'ndodh paralelisht me dhënien e lajmit të fitores?**

*Ja, arrive, ua the:*

*Ç'gas e ç'helm qe kjo myzhde!*

*"E fituam!", brohorite*

*Dhe për tok' u-përpëlitë;*

*Vdiq, or vdiq!*

*Vdiqe, or Marathonmak!*

Paralelisht me dhënien e lajmit të fitores ndodh dhe vdekja e Maratonmakut. Misioni u përfundua me sukses!

**Analizoni poezinë. Plotësoni tabelën:**

**Figura letrare**

Figura letrare	Shembulli dhe shpjegimi i rolit të secilës figurë në dhënien e kuptimit
Metafora	<i>Afshi gjoksin përvëlon/syrin avulli verbon</i>
Antiteza	<i>Ç'gas e helm qe kjo myzhde</i>
Krahasimi	<i>Gryka si gjyryk të shfry</i>
Pasthirrma	<i>E fituam brohorite</i>
Aliteracioni	<i>Se mileti po të pret/ankthi zemrat ua vret/ Vrer e tmerr</i>
Enumeracioni	<i>Nëna ,motra ,nusja dalin ...</i>

**Shembulli dhe shpjegimi i rolit të secilës figurë në dhënien e kuptimit**

Metafora

*Afshi gjoksin përvëlon/syrin avulli verbon*

Antiteza

*Ç'gas e helm qe kjo myzhde*

Krahasimi

*Gryka si gjyryk të shfryn*

Pasthirrma

*E fituam brohorite*

Aliteracioni

*Se mileti po të pret/ankthi zemrat ua vret/ Vrer e tmerr*

Enumeracioni

*Nëna ,motra ,nusja dalin ...*

**Nëpërmjet cilës figurë jepet përshkallëzimi i gjendjes emocionale të Maratonomakut?** Shkallëzimi, i cili i shton gjallërinë dhe dramacitetin ngjarjes, përjetimeve shpirtërore, dendëson mendimet dhe përsiatjet e tij. Është rritës dhe zbritës. Shkallëzimi si figurë gjithashtu e rrit shkallën e intensitetit të paraqitjes së idesë.

**Cili është mesazhi i strofës së parafundit?**

Mesazhi që përcjell strofa e fundit është “Devotshmëria për idenë paguhet me jetë dhe fiton përjetësi ”

**Si lidhen mes tyre: rendja e Maratonomakut, lajmi që ai do të sjellë, vdekja e heroit dhe mesazhi që del në strofën e fundit?**

Vrapimi 48 km në këmbë -Lajmi i fitores-vdekja e bukur e maratonomakut-mesazhi i përjetësisë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Rrjet diskutimi*

Diskutoni rreth rolit të lajmëtarit në Lashtësi dhe rreth detajeve që sjell poezia nga ai realitet.

PO	A do të bënit ju të njëjtin veprim që bëri Maratonomaku?	JO
----	--	----

Jepni argumentet për secilin qëndrim që do të mbani.

Nxënësit diskutojnë duke mbajtur parasysh rregullat gjatë diskutimit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për punën kërkuese për jetën e krijimtarinë e Nolit, për argumentet që shprehin gjatë diskutimit etj.

**Detyrë shtëpie:** Mësoni 20-30 vargje përmendësh.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Rent or Maratonomak (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxëniet:</b> Vargje nga Fan Noli <i>Arratisur, syrgjynosur,</i> <i>Raskapitur dhe katosur</i> <i>Po vajtonj pa funt, pa shpresë,</i> <i>Anës Elbës, anës Spree-së.</i> <i>Ku e lam' e ku na mbeti</i> <i>Vaj-vatani e mjer-mileti</i> <i>Anës detit i palarë,</i> <i>Anës dritës i paparë,</i> <i>Pranë sofrës i pangrënë,</i> <i>Pranë dijes i panxënë,</i> <i>Lakuriq dhe i dregosur,</i> <i>Trup e shpirt i sakatosur?</i> <i>*Diskutojmë dhe për vargje të tjera të Fan Nolit duke shpërndarë te nxënësit fisha me vargje.</i>	

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe	
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale	
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- hulumton rreth jetës dhe veprës letrare të Fan Nolit;</li> <li>- diskuton rreth rolit të lajmëtarit në lashtësi;</li> <li>- analizon rolin e figurave letrare në poezi;</li> <li>- zbulon mesazhet që përcjell poezia;</li> <li>- analizon veçoritë gjuhësore të poezisë;</li> <li>- reciton bukur e me ndjenjë poezinë.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Maratonomak Rent, vrapo Lajm i fitores Pushtues Njerëzia Athina Vdiq
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, poezi të Fan Nolit	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Konkurs, Të nxënës në bashkëpunim (punë në grupe)</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Konkurs</p> <p><i>*Recitojmë vargje përmendësh nga poezia. Mësuesi/ja përpiqet që të aktivizojë sa më shumë nxënë.</i></p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënës në bashkëpunim</p> <p><i>Ndaj klasën në grupe dhe shpërndaj në fisha pyetjet që do të punojnë:</i></p> <p><b>Grupi 1:</b> Kjo është një poezi e shkruar në vetën e dytë njëjës. Si mendoni, pse autori ka zgjedhur këtë vetë për ndërtimin e poezisë? Si i vjen në ndihmë kjo për të bërë dallimin midis tij dhe heroit?</p> <p><b>Grupi 2:</b> Shpjegoni rëndësinë kuptimore dhe muzikalitetin që ka përdorimi i shpeshtë i foljes “rent”. Përsëritja e foljes <i>rent</i> nga ana kuptimore tregon ngulmimin dhe dëshirën për ta çuar sa më shpejt lajmin e fitores. Përsëritja tregon mundimin e maratonomakut, përpëlitjen për jetë a vdekje të tij. Kjo lloj përsëritjeje krijon muzikalitet, ritëm, harmoni, ritmikë dhe orkestrim tingullor të thënieve.</p> <p><b>Grupi 3:</b> Gjeni fjalët sinonime dhe antonime në këtë poezi. Çfarë vlere i japin ato poezisë?</p> <p><b>Grupi 4:</b> Plotësoni vendet bosh me foljet që tregojnë veprimet e njëpasnjëshme të heroit tonë.</p> <div style="text-align: center;"> <pre> graph TD     A[Rent] --&gt; B[Thuaj]     B --&gt; C[Hip-zbrit]     C --&gt; D[Rent]     D --&gt; E[Turru shpejt]     E --&gt; F[Tutje]     F --&gt; G[Mbahu]     G --&gt; H[Hajt dhe pak]           </pre> </div>	
<p><b>Grupi 5:</b> Shkruani llojit e rimës, ritmit, vargut, strofës të kësaj poezie. Diskutoni mbi muzikalitetin e vargjeve.</p> <p>Vargjet janë 8 rrokëshe trokaike, theksi bie te rrokjet 3, 5, 7. Ky lloj vargu i jep tekstit kumbimin e duhur, muzikalitet dhe tonalitetin e lartë. Rimë është e përputhur.</p> <p>Pas përfundimit të punës, grupet përgjigjen për detyrën e dhënë.</p> <p><i>*Bëhet kujdes që asnjë nxënë dhe asnjë grup të mos jetë i përjashtuar nga diskutimi.</i></p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Prezantim</p> <p>Në këtë fazë të orës së mësimi shpallen tri vendet e para të recituesve. Nxënësit vlerësojnë njeri-tjetrin dhe veten e tyre.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për recitimin e poezisë, për punën e bërë në grup dhe përgjigjet e sakta që kanë dhënë.</p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të flasim Tema mësimore: Rrjedhshmëria, intonacioni dhe ritmi gjatë të folurit		Situata e të nxënët: Imitoni një aktor të humorit. Zgjedhja është e lirë	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për të folurin publik;</li><li>- diskuton për rrjedhshmërinë në të folur;</li><li>- dallon ritmin e të folurit dhe ritmin poetik;</li><li>- analizon intonacionin ngjithës apo zbritës në fjali;</li><li>- imiton aktorë e humoristë të njohur.</li></ul>		Fjalët kyçe: Rrjedhshmëri fjale Intonacion Ritëm Zëri	
Burimet: Libri i nxënësit, “Metodika për estetikën e të folurit Sonila Kapidani”, “Hyrje në shkencën e letërsisë” Gjergj Zheji		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, edukim muzikor	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, Pyetja sjell pyetjen, Punë individuale			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim			
Diskutoni rreth kuriozitetëve të mëposhtme në lidhje me rrjedhshmërinë në të folur.			
Rrjedhshmëria në të folur përmirësohet duke gjetur ekuilibrin emocional me anë të aktiviteteve të ndryshme dhe meditimit.			
Rrjedhshmëria në të folur është e lidhur me rrjedhshmërinë e mendimeve dhe me artikulimin e saktë të tyre. Mirëpo çdokush mund të ketë probleme me rrjedhshmërinë. Në shumicën e rasteve këto probleme shfaqen me fjalë ose fraza që përsëriten ose shtohen pa vend. Në raste të tjera, problemet me rrjedhshmërinë shfaqen në formën e belbëzimit. Pra, duke përsëritur zanore e rrokje të ndryshme ose duke i hequr ato. Belbëzimi shoqërohet shpesh nga tensioni dhe ankthi. Nxënësit japin mendimet e tyre.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetja sjell pyetjen			
Çfarë kuptoni me intonacion?			
Kur flasim ose lexojmë, nuk i shqiptojmë të gjitha fjalitë në të njëjtën mënyrë, pra me të njëjtin intonacion. Me intonacion kuptojmë ngritjen ose uljen e forcës së zërit, si dhe mënyrën e shqiptimit a të theksimit të fjalëve, kur synojmë që të shprehim sa më mirë ndjenjat e qëndrimin tonë dhe të ndikojmë te dëgjuesi. Sipas llojit të fjalisë (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse etj.), intonacioni është ngjithës ose zbritës.			
Çfarë kuptoni me ritmin?			
Njeriu e ka përdorur ritmin për të lehtësuar punën e tij, p.sh. farkëtarët kur rrahin hekurin në kudhër, druvarët kur godasin drurin me sëpatë, varkëtarët që vozitin me rrema, nëna kur vë foshnjën në gjumë me lëvizjet ritmike të djepit të tij:			
Ni-na-na-dja-lë-në			
Qan-e –zgjon-më-ha-llë-në			
“Se nga vjen ky ritëm-gjëmim bazë, nuk dihet. Për mua kjo është një përsëritje që ndodh tek unë, i një tingulli, i një zhurme, i një lëkundjeje ose, përgjithësisht, përsëritjes së çdo dukurie që unë hetoj prej tingullit”			
V. Majakovski			
Studiuesi Gjergj Zheji, në libri “Hyrje në shkencën e letërsisë”, për ritmikën shprehet: “Ritmi është diçka e lidhur me vetë natyrën”. Çdo gjë rreth nesh ka një ritëm të dhënë që shpreh lëvizje, ku pjesët e saj kanë-lidhje të caktuar midis tyre. Ndjenjën e ritmit njeriu e ka hetuar së pari në vetë trupin e tij: zemra e njeriut rreh me një ritëm të caktuar, që mund të shprehet muzikalisht me kohën muzikore tre të katërtat. Nga natyra, ritmi kaloi në art, si një pasqyrim i veçantë dhe i figurshëm i natyrës.”			

**Ritëm poetik** do të quhet muzikaliteti i brendshëm i vargjeve të një poezie, që është një lëvizje e organizuar e elementeve të saj përbërëse.

Ritmi është kombinimi i fjalëve të theksuara dhe të patheksuara brenda një fjalie ose vargu.

Ritmi poetik është përsëritja e rregullt e rrokjeve të theksuara e të patheksuara ose e rrokjeve të gjata e të shkurtra në një varg.

**Ritmi i të folurit** është lëvizja e rregullt dhe zgjatja e tingujve, që bëhet në përputhje me njësitë e caktuara të kohës.

Ritmi diktohet nga ngjarje dhe situata të caktuara. Shprehje të tilla si: “ooooo-op !” shërbejnë për të qetësuar ritmikisht zërin dhe muskujt, pas tensionit. Një marsh i kënduar ka efekt stimulues te një grup i lodhur njerëzish.

Ritmi i lëvizjes dhe tingullit është qetësues te nina-nana dhe kur e dëgjojmë ndiejmë efektet qetësuese dhe forcat rinovohen. Ka momente që është lëvizja ajo që dikton ritmin si p.sh., një fëmijë që luan me lisharse dhe shton ritmin e lëvizjes dhe në të njëjtën kohë këndon. Ritmi mund të jetë i ngadaltë, mesatar, pak i shpejtë, shumë i shpejtë, gjithmonë në varësi të karakterit dhe situatës që ndodhet. Për zhvillimin e ndjenjës së ritmit luan një rol të madh e të rëndësishëm edukimi muzikor.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

Punohen ushtrimet në tekst, por jo vetëm.

Plotëso tabelën. Kujdes!

\*Ngritjet dhe uljet e zërit gjatë të folurit quhen intonacione. • Intonacioni mund të pësojë modifikime edhe në varësi nga shprehja e emocioneve dhe e ndjenjave të gëzimit, zemërimit, admirimit, shpresës, dyshimit etj.

FJALITË	INTONACIONI
A u kujtuat për të blerë qumësht?	<u>Ngjitës</u>
Ku e keni blerë atë?	<u>Ngjitës</u>
Është mirë ta bëni këtë gjë.	<u>Zbritës</u>
Pse erdhe kaq vonë?	<u>Ngjitës</u>
A mendon se mund ta kalosh kaq lehtë?	<u>Ngjitës</u>
Djalosh, do ta shohim më vonë punën tënde.	<u>Zbritës</u>
Kur u nise?	<u>Ngjitës</u>
Sa orë t`u deshën të vije deri këtu?	<u>Ngjitës</u>
E pabesueshme!	<u>Ngjitës</u>
Kush të kërkoi në telefon?	<u>Ngjitës</u>

Shembulli më klasik i përdorimit të ritmit në letërsinë shqipe është Fan Noli, i cili i edukuar me sensin muzikal ka përdorur në poezi disa lloje ritmesh:

*Fryn e shfryn veriu,  
ngrin, mërdhin i ziu  
dhe mangallit i afrohet  
që të ngrohet.*

*Krishtin brenda e gjykojnë  
dhe pas ligjës e dënojnë,  
e goditin dhe e shtyjnë,  
e pështyjnë.  
S'del askush që ta shpëtojë,  
Roma do ta kryqësonjë,  
triumfon legaliteti dhe lanëti.*

(“Shën Pjetri mbi mangall” F.Noli)

Shembull tjetër nga letërsia botërore sjellim poetin francez Zhak Prevert:

*Kjo dashuri*

*Kaq e rrëmbyer*

*kaq e brishtë,*

*kaq e butë,*

*kaq e pashpresë.*

*Kjo dashuri,*

*e mire si koha*

*kur koha është e mirë,*

*e keqe si koha,*

*kur koha është e keqe.*

*Kjo dashuri kaq e vërtetë.*

*kjo dashuri kaq e bukur,*

*kaq e singertë, kaq e lumtur,*

*kaq e lehtë, që dridhet nga frika,*

*si një fëmijë natën .*

*Dhe kaq e sigurt ne vetvete*

*Kjo dashuri e përgjuar,*

*se e përgjonin*

*e plagosur, e varrosur*

*e mohuar, e harruar,*

*se e plagosnim, e varrosnim,*

*e mohonim, e harronim*

*e gjallë si dëshira*

*mizore si kujtesa*

*marroqe si pendimet,*

*e ëmbël si kujtimi,*

*e ftohtë si mermeri*

*(Kjo dashuri)*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për aktivizimin e tyre gjatë orës së mësimi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore - morfologji <b>Tema mësimore:</b> Emrat që përdoren vetëm në njëjës dhe emrat që përdoren vetëm në shumës		<b>Situata e të nxënit:</b> Loja “Më i sakti më i shpejti” Udhëzohen nxënësit të thonë emra nga numri njëjës në numrin shumës.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon emrat në numrin shumës dhe mënyrën e formimit të tyre;</li><li>- dallon emrat që përdoren vetëm në njëjës dhe ato që përdoren vetëm në shumës;</li><li>- përdor në tekstet që krijojnë emra që përdoren vetëm në njëjës dhe vetëm në shumës.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Shumësi i emrave Emra vetëm në shumës Emra vetëm në njëjës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Stuhi mendimi, Shënime mbi shënime, Punë individuale  
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Stuhi mendimi

Me mbaresë fshat  
fshatra, mal-male

Numri shumës i emrave

Me ndërrim fonetik mik-  
miq, zog-zogj

Njësoj si njëjësi rrugë-  
rrugë, mësues-mësues

Me ndërrim fonetik  
dhe mbaresë breg-  
brigje

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Shënime mbi shënime

Pasi pamë që emrat përdoren në numrin shumës dhe shumësi krijohet nëpërmjet këtyre rrugëve themi se kemi emra që përdoren vetëm në njëjës dhe emra që përdoren vetëm në shumës.

**Cilët emra përdoren vetëm në njëjës?**

Emrat e përveçëm të njerëzve, të kafshëve, të vendeve etj., si: *Artan, Etleva*.

Disa emra përmbledhës, si: *djalëri, pleqëri*

Disa emra abstraktë, si: *arsim, dashuri*

Disa emra konkretë që tregojnë lëndë, si: *bakër, hekur, kripë*

Disa emra të tjerë, si: *jug, veri, breshër*

**Cilët emra përdoren vetëm në shumës?**

Disa emra që tregojnë sende të përbëra prej dy a me shumë pjesësh, si: *pantallona-t, syze-t*

Disa emra që tregojnë shumësi qeniesh, si: *dhen-të*

Disa emra sëmundjesh, si: *grykë-t, ethe-t, shyta-t*

Disa emra vendesh, si: *Alpe-t, vise-t, Rrëza-t etj.*

Emra të tjerë që emërtojnë veprime a gjendje: *të korra-t, të mbjella-t*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

*\*Udhëzohen nxënësit të punojnë ushtrimet 1-3, faqja 196.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejtë emrave që përdoren vetëm në njëjës dhe ato që përdoren vetëm në shumës.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Emrat e farefisnisë (i ati, i biri, e motra etj.)		<b>Situata e të nxënit:</b> Pema e familjes Ndërto në 5 minuta pemën e familjes.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon emrat e farefisnisë në fjali;</li><li>- analizon përdorimin e nyjës së përparme, para tyre.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Lojë: Improvizo një situatë midis pjesëtarëve të familjes. <i>*Kujdes përdorimin e emrave të farefisnisë!</i>	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit , “Gramatika e gjuhës shqipe” Akademia e Shkencave 2002		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, INSERT, Punë në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim			

**Lexojeni këtë fabul dhe emrat me *bold* i vini në rasën e duhur.** Ishte një ditë e mirë vjeshte. Lepurushi e kishte nxjerrë në shëtitje **të biri**. Duke kërcyer nëpër fushë, **lepur** i vogël hetoi diçka, me gëzim iu afrua **babai** dhe i tha: - Babi, shih, shih sa brirë të bukur janë mbi bar! A e di të kujt janë? - Këta brirë, biri im, janë **të dreri**. Këta e zbukurojnë **mali**. - Pra, pasi i paska humbur po i marr unë. Atëherë të gjitha kafshë dhe drurë do të dridhen prej meje. Kështu tha **lepur** i vogël, i mori **brirë** dhe i vendosi në kokë. **Baba** e shikoi **të biri** dhe i tha duke qeshur: - Këta brirë mund t'i mbajë vetëm ai, i cili i ka hequr **prej kokë** së vet. Këta u takojnë vetëm atyre që janë trima dhe guximtarë. E për ne që jemi frikacakë, janë të tepërt edhe këta veshë që i kemi.

**Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT**

*\*Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të plotësojnë tabelën INSERT.*

+	V	---	?

Emrat *vëlla, motër, atë, ëmë, ungi* (xhaxha, dajë), *nip, mbesë, kunat, kunat, etj.*, janë emra farefisnie. Këta lloj emrash përdoren edhe me nyje të përparme: *i biri, e bija, i ati, e ëma, i vëllai, e motra, i shoqi, e shoqja, i nipi, e mbesa, i kunati, e kunata, e veja etj.*

**Mbani mend!** Me nyje të përparme përdoren dhe emrat *zot, zonjë* (i zoti, e zonja). Në këto raste, nyja e përparme shpreh kuptimin e një përemri pronor të vetës së tretë njëjës (*i tij, i saj*): *Atë e priti e motra e saj/e tij.*

Lexo! Profesor Sh. Demiraj ka mendimin se zanafilla e kësaj nyje me vlerë pronori sot për sot është historikisht e paqartë. Kurse Bokshi, burimin e kësaj nyje e kërkon te sintagmat amë i ti(j) bir, e sa(j), të cilat pas krijimit të pronorëve im bir, yt bir “paralajmëronte”, kur duhej përdorur me kuptimin e pronësisë. Prandaj im bir, yt bir, sintagmat i tij bir, e saj amë, mbeten në strukturën e vjetër (i), (e) si nyja të gjinore, (i tij), (e saj). Por njësia e re leksikore (i bir) nuk jepte kuptimin e pronësisë, prandaj në vetën e tretë u shoqërua dhe me nyjën shquese i bir-i.

**Gjeni emrat që janë përdorur me nyje të përparme.**

*Djemtë u harruan pas lojës. Mirit i thirri i ati. Në këtë kohë, Vojsava u kujtua se duhet të shkonte të merrte të vëllanë në kopsht. Kur ajo arriti te kopshti, edukatorja i tha se të vëllanë e kishte marrë fqinja e tyre.*

*E shoqja e Gazmendit kishte vite pa shkuar në qytetin e lindjes. Dy kunatat e saj ishin bërë me fëmijë. I vëllai nuk erdhi për ta marrë, pasi nuk mundi. I kunati martonte djalin e vetëm dhe ishte angazhuar me punët e dasmës.*

*Dasma kishte dite që kishte filluar. I zoti i dasmës kujdesej që të mos mbetej njeri pa u respektuar.*

*Të nipërit dhe të mbesat e shikonin ne sy të zonjën e shtëpisë dhe bënë çdo punë që u ngarkonte ajo.*

**Nëvizioni emrat që nuk mund të përdoren në numrin shumës.**

*i biri, e bija, i ati, e ëma, i vëllai, e motra, i shoqi, e shoqja, i nipi, e mbesa, i kunati, e kunata, i zoti, e zonja, i riu, e reja, e dashura, i pasuri, i varfëri, i pandehuri.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe**

**Lakoni emrat i nipi, e shoqja, e ëma. A lakohen në trajtën e pashquar? Po në numrin shumës? Argumentoni përgjigjen tuaj.**

Emërore:	I nipi	e shoqja	e ëma
Gjinore:	I e të nipit	I,e së shoqes	I,e së ëmës
Dhanore:	të nipit	së shoqes	së ëmës
Kallëzore:	të nipin	të shoqen	të ëmën
Rrjedhore :	prej të nipit	prej së shoqes	prej së ëmës

**Argumenti:**

Në faqen 124 të “Gramatikës së gjuhës shqipe” 2002, thuhet:

“Me një numër të caktuar emrash që tregojnë lidhje gjaku ose familjare, nyja i – i. e të që u paravendosen këtyre emrave, përdoren paralelisht e me një kuptim të ngjashëm me pronorët e paravendosur për dy vetat e para dhe **kërkojnë që emri i paraprirë prej tyre të vihet patjetër në trajtën e shquar**: p.sh. i biri, e mbesa, të vëllezërit, të motrat etj (krahaso me jot mbesë, im bir) në këto raste ata kanë kuptimin e pronorit për vetën e tretë (biri i tij, mbesa e tij, vëllezërit e tij, motrat e saj,) i cili siç u tha më sipër e kërkon gjithashtu emrin në trajtën e shquar.

**Ndërtimi 4 fjali me secilin nga emrat që lakuat, duke i përdorur në rasta të ndryshme.**

- Të nipin e tij e kishin caktuar drejtor në një shkollë.
- Prej së shoqes ishte në atë vend pune.
- Të ëmën e kishte shumë punëtore, ndërsa ajo nuk zinte punë me dorë.
- E ëma i kishte lënë pasuri të madhe.

*\*Diskutoj së bashku me nxënësit. Vlerësoj përgjigjet e tyre.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të emrave të farefisnisë, për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi etj.


## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Serafina Topia</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon tiparet fizike dhe cilësitë e personazheve;</li><li>- analizon rrjedhën e ngjarjeve;</li><li>- reflekton mbi zgjedhjet që bëjnë personazhet.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Serafina E zgjuar Personazh ideal Dashuri Bozdari Natyre	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, studimin “Mitologjia dhe njeriu” Skënder Karriqi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim, Të nxënësve në bashkëpunim, Grupet e ekspertëve, Shkrim i shpejtë</i> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Diskutim</i> Serafina Topia një poemë epiko-lirike u ripunua dhe u botua më 1843 me titullin “Një pasqyrë e jetës njerëzore”. Një poemë me motive autobiografike Serafina, është një personazh i realizuar me shumë kujdes nga De Rada. E bukur, e ditur, e moralshme, karakteristika që e bëjnë një personazh ideal. Ngjarjet e poemës janë të imagjinuara dhe të çojnë në shekullin XV. Studiuesit, poemën Serafina Topia e kanë cilësuar si variantin femëror të Milosaos, ndryshimi qëndron përtej dallimeve thjesht gjinore të protagonistëve. Serafina është heroina e ndriçuar. Edhe kur ajo nuk flet, (madje sidomos në këto raste), rrezaton një dritë të brendshme që e shënjon si heroinë të sakrificës vetëflijuese. Një aspekt i tragjedisë së saj është se kupton, di dhe ka lexuar shumë libra. Shfaqet kështu profili i heroit të ditur, që e shohim të zhvillohet përgjatë gjithë periudhës së Rilindjes Kombëtare. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> <i>Të nxënësve në bashkëpunim, Grupet e ekspertëve</i> <i>Pasi lexohet pjesa në role, ndahet klasa në grupe të cilave u shpërndahen fshat me të cilat do të punojnë.</i> <b>Grupi 1.</b> Kujt i këndon poeti në këtë fragment? Cilat personazhe ndeshim këtu? Cila është atmosfera mbizotëruese e këtij fragmenti? Jepni disa detaje të saj. Që në këngën hyrëse ne njihemi me Serafinën dhe Bozdarin. Fillimin e bukur të njohjes së tyre dhe bulëzat e para të dashurisë që sapo ka filluar. Foljet e së shkuarës rritesha, ...u rrita... të ndieja ... më gëzohej zemra... Ndërsa hapësira në këtë fazë të parë të rritjes së heroinës, përkon me vatrën prindërore, mjediset bukolike të të korrave, imazhin e morisë së kandileve përmbi maja lisash lart, imazhin e botës së largët etj., (...te vatra e prindërve... përkundëjt të korrave... përmbi maja lisash lart... në një botë aq të largë) <b>Grupi 2.</b> Gjeneri dhe shpjegoni elementet nga poezia popullore në këtë fragment. Ashtu si në poezinë popullore ku takimi dhe njohja e të rinjve ndodhte në natyrë, po këtu kështu ndodh. <b>Në strofën e fundit lumturia e Serafinës është në kulmin e vet. Shpjegoni arsyen e këtij ngazëllimi?</b> Ngazëllimi i Serafinës e ka emrin Bozdar. Dashuria vjen me imazhin simbolik të kalit të bardhë dhe djalit shtegtar. <b>Grupi 3.</b> Përshkruani natyrën e kujdesshme dhe plot jetë të Bozdarit. Si i drejtohet ai Serafinës? Ilustrojeni me shembuj. Mund të ndërtoni hartën e personazhit ose mund të bëni përshkrim objektiv dhe subjektiv.			
<div><div>I sjellshëm</div><div>Bozdari</div><div>Provokues</div><div>Hijeshisë së vetes sate Lerma këtë si puhi vere.</div><div>Zonja vashë, kush nga ju Shaminë që më ra mua Ndejtë?</div><div>Mos u bëj Vashë, koprace; e kam thesar T’jetës sime!</div></div>			

**Grupi 4.** Shpjegoni kuptimin e togfjalëshit: *vashë e hareshme*. A ndihmon ai në përfytyrimin tuaj për Serafinën?

*\*Gjeni antitezën e ndërtuar me folje në strofën e fundit dhe shpjegoni funksionin e saj artistik.*

**Grupi 5.** Ndërto hartën e personazhit të Serafinës.



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i shpejtë**

Diskutoni rreth konceptit të lirisë që përcjell fundi i poezisë. Shkruani një ese argumentuese me njërin nga temat e mëposhtme.

“Liria është jetë”.

“Liria është lumturi”.

Nxënësit punojnë me esenë. Në rast se nuk e mbarojnë do të klasë u lihet detyrë shtëpie.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për analizën e personazheve etj.


## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Muza</b>		<b>Situata e të nxënit</b> <b>Diskuto rreth vargjeve për muzën poetike</b> Muza e poetit është burim i pashtershëm Di të këndoj dhe për dimrin e vjeshtën Dhe një mijë vite dritë përpara Andaj kurrë për jetë e mot nuk i humb fara...	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth konceptit të muzës në antikitet;</li><li>- shpjegon ngarkesën emocionale që përcjellin vargjet e poezisë;</li><li>- argumenton funksionin e figurave letrare;</li><li>- gjen mesazhin që përcjellin vargjet e poezisë;</li><li>- kthen poezinë në prozë, duke ruajtur karakteristikat e saj.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe</b> Poet Poezi Muzë poetike Frymëzim	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, burime të ndryshme Petraq Kolevica “Kam njohur sy o, ata sy!” Poezi Ruse fq. 145-165		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Përvijim i të menduarit, Marrëdhëniet pyetje-përgjigje (MP-P), Shkrim i shpejtë

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Përvijim i të menduarit

Në qendër të dërrasës mësuesi/ja shkruan fjalën Muzë. Më pas i fton nxënësit të shkruajnë në fletorët e tyre të gjitha fjalët që sipas tyre i lidh me fjalën e dhënë.



*Përkufizimi sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*

1) Secila nga nëntë hyjneshat, bijat e Zeusit që përkrahnin degë të ndryshme të artit dhe të shkencës (sipas mitologjisë).

2) Burim i frymëzimit poetik, frymëzimi për të krijuar.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Marrëdhëniet pyetje-përgjigje (MP-P)

*U sqarohet nxënësve teknika që do të përdoret duke u sqaruar se ka dy lloje MP-P, në libër dhe një MP-P në kokën time.*

Për rastin e parë, gjatë kohës që nxënësit japin përgjigjen, u kërkoni atyre ta lokalizojnë përgjigjen në tekst.

MP-P në libër vendos së bashku pyetjet i kanë të gjitha pjesët e nevojshme në tekst, por lexuesi duhet të lokalizojë secilën prej tyre dhe t'i mbledhë për të formuluar përgjigjen.

**MP-P në kokën time ka të bëjë me:**

**autori dhe unë ku përgjigjet ndërtohen pjesërisht nga fakte të dhëna në tekst dhe pjesërisht nga njohuritë bazë të lexuesit dhe sipas meje përgjigjet bazohen në njohuritë personale të lexuesit.** Pas diskutimit për fjalën muzë, nxënësve u jepet detyrë leximi i poezisë. Klasa ndahet në 4 grupe 2 grupe marrin të njëjtën strofë.

**Pikërisht aty:**

Kujt i kushtohet poezia? Poezia i kushtohet muzës poetike.

Poezia fillon me një çast pritjeje. Për cilin moment është fjala?

Ardhjen e frymëzimit

Cila është ndjesia që shoqëron këtë moment? Ankthi i pritjes

**Vendosni së bashku:**

Shpjegoni kuptimin dhe ngarkesën emocionale që përcjell vargun:  
Në fill të flokut jeta ngjan e varur.

Pritja është kaq e padurueshme saqë jeta duket sikur do të shuhet  
nga moment në moment nga mosardhja e muzes poetike.

Në strofën e parë, poetja shtron një pyetje retorike. Cili është  
funksioni i saj?

Ndaj kësaj mikeje të shtrenjtë me flaut?

Funksioni i saj për të tërhequr vëmendjen e lexuesit për ardhjen e  
muzës Euterpa, muzës së poezisë lirike e cila paraqitet me flaut  
dhe për të shtuar ngarkesën emocionale të padurimit të pritjes.

Ne strofën e dytë, poetja pyet muzën dhe pret përgjigje prej saj.  
Cili është funksioni i këtij dialogu?

**Autori dhe unë**

Vlerësoni dhe komentoni mënyrat dhe zgjedhjet stilistike të autorit.

Zgjedhjet stilistike të autorit	Komenti	Vlerësimi im
Mikeje të shtrenjtë -epiteti metaforik	Prania e saj sfidon gjithçka dhe çon më shumë oksigjen në trurin e poetes për frymëzim poetik	Muza i shërben poetes si far ndriçimi për të gjetur rrugën e duhur  Muza nuk ka orare, ajo është llastuar.
Në fill të flokut jeta ngjan e varur –Metaforë	Metafora e dhembjes poetike.	Jeta e vështirë e plot dhembje e poetes, nuk mund të gjente ngushëllim vetëm në krijimtari e pa muzën ajo do ta kishte të vështirë të hidhte dhimbjen e saj në vargje

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrimi i shpejtë**

Portretizimi i muzës krijon idenë e një pikturë. Kthejeni në prozë këtë poezi, duke përshkruar me detaje portretin e muzës së poetes.

*Varianti i mëposhtëm është orientues!*

Natë ... Të pres të vish ty, muza ime. Jeta pa ty s'ka frymëzim, s'ka kuptim, mikja ime e shtrenjtë, mikja e ditëve të mia të vetmuara. Papritur ti shfaqesh duke më mbushur me jetë, duke më mbushur plot shpresë. Ti frymëzuesja e Dantes dhe e shumë poetëve të tjerë...

Më pas nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe në fund punën e depozitojnë në dosje.

**Vlerësimi:** Vlerësohet për mënyrën sa më të qartë të analizimit të poezisë, argumentit të interpretimit të saj dhe gjuhës së përdorur.

**Detyrë shtëpie:** Mëso poezinë përmendësh.

**Shtojcë informacioni për poeten Ana Ahmatova**

Ana u lind më 23 qershor 1889 pranë Odesës (Balshoi Fontan). Kur mbushi 1 vjeç, familja e saj do të zhvendosej në Veri në Carskoe Sjello. Aty do të jetonte derisa u bë 16 vjeç. Kujtimet e para gjithnjë e çonin në Carskoe Sjello, në parqet e gjelbra dhe madhështore, hipodromi ku vraponin kuajt e vegjël. Çdo verë e kalonte pranë Sevastropolit, në breg të kënetës, ku do të miqësohej me detin. Përshtypja më e fuqishme e atyre viteve do të ishte Hersoni i lashtë, afër të cilit banonte. Poezinë e parë do ta shkruante kur ishte 11 vjeçe. Në vitin 1905, prindërit e saj do të divorcoheshin dhe ajo do të jetonte me nënën. Një vit do të jetonin në Evpatproa, ku do të bënte dhe gjimnazin dhe do të niste të shkruante më shumë vjersha. Studimet e larta do t'i niste në Fakultetin Juridik. Më 25 prill 1910, ajo u martua me N.S. Gumiljovin dhe do të kalonin një muaj në Paris.

Në vitin 1912 do të udhëtonte në Italinë veriore. Në po këtë vit do të dilte vëllimi i saj i parë me poezi “Mbrëmje” dhe një vit më vonë libri i dytë “Kthjellime”. Lufta e vitit 1941 do ta gjente në Leningrad. Deri në maj të vitit 1944 jetoi në Tashken. Në maj të vitit 1944 do të kthehej me avion në Moskë e më pas në Leningrad dhe do të fillonte të shkruante në prozë e më pas do ta tërhiqte përkthimi artistik.

Burimi: Revista Saras më, 29.02.2016 shkrimi me titull “Ana Ahmatova një ruse në Paris”.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Harta e përgjysmuar e Atdheut</b>		<b>Situata e të nxënët:</b> Diskutojmë rreth vargjeve të Pashko Vasës “O moj Shqipni” dhe vargjeve të tjera për atdheun <i>Kujt i ban zemra me e lan me dek</i> <i>Kët farë trimneshe qi sot asht mek</i> <i>Kët nanë të dashtun a do e lam</i> <i>Që njeri i huej ta shklas me kambë</i>	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - hulumton rreth jetës dhe krijimtarisë letrare të Visar Zhitit; - diskuton për veçoritë e poezisë së tij; - analizon metaforat e përdorura në poezi.		Fjalët kyçe Atdhe Mall Dashuri Ikje larg atdheut Harte e përgjysmuar Atdhe i copëtuar	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, poezi për atdheun		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Parashikim me anë të titullit, Lexim dhe pyetje në dyshe, Shkrim i lirë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Parashikim me anë të titullit			
Dëgjoni titullin e poezisë “Harta e përgjysmuar e Atdheut” çfarë mesazhi mendoni se do të përcjellin vargjet e poezisë së Zhitit.			
Nxënësit japin mendimin e tyre. Në fund të orës diskutoni se cili nga nxënësit ka dhënë një parashikim të saktë të asaj që keni hasur në poezi.			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Lexim dhe pyetje në dyshe			
Nxënësit lexojnë poezinë dhe anash vendosin çështjet për të cilat duan të diskutojnë. Pasi nxënësi lexon poezinë, i dyti i bën pyetje, të cilat i ka shkruar në një skedë. Nëse nxënësi që pret përgjigjen është dakord me të e shkruan prapa skedës. Më pas ndërrojnë rolet.			
<b>Nxënësi 1: Cili është motivi i kësaj poezie?</b>			
Nxënësi 2: Motivi i kësaj poezie është ai i atdhedashurisë.			
<b>Nxënësi 1: Shkruani pesë ide kyçe të autorit që shfaqen përmes vargjeve.</b>			
Nxënësi 2: Lashtësia e këtij vendi			
Prindër që digjen nga malli për bijtë e tyre në emigrim.			
Largimi nga atdheu shoqërohet me brengën e mallin për të.			
Ata që falsin të njëjtën gjuhë duhet të jenë bashkë, por padrejtësitë historike i kanë ndarë.			
Vendlindja të ndjek pas kudo që të shkosh.			
<b>Nxënësi 1: Shkruani detajet përshkruese të përdorura në poezi.</b>			
Nxënësi 2: Male, male si varre të mëdhenj			
Dielli dhe hëna përsipër			
Prindër pleq që digjen prej dhimbjes			
Pyll i madh i errët është mençuria jonë...			
<b>Nxënësit ndërrojnë rolet</b>			
<b>Nxënësi 2: Gjej dhe shpjego përdorimin e këtyre figurave letrare.</b>			
<b>Dielli dhe hëna përsipër-prindër pleq që digjen prej dhimbjes</b>			
<b>Kudo që të jem (dhe në dete) larg, gjurmët i lë në formën e hartës së atdheut</b>			
<b>Nxënësi 1: Pleq që digjen prej dhimbjes... Me anë të kësaj metafore autori do të theksojë vetminë e këtyre njerëzve që gdhihen dhe ngrysen (Dielli dhe hëna përsipër) me mallin për bijtë e tyre që nuk i kanë pranë.</b>			
<b>Kudo që të jem (dhe në dete) larg, gjurmët i lë në formën e hartës së atdheut. E thamë dhe më lart se atdheu, vendlindja të ndjek pas kudo.</b>			

**Nxënësi 2: Në varësi të ndërtimit të tyre gjuhësor, metaforat mund të jenë: emërore, foljore, mbiemërore.**

**Verifikoni praninë e tyre në vargjet e mësipërme.**

**Nxënësi 1:** Prindër pleq që digjen prej dhimbjes – metaforë foljore

Fushat e jetës i kam në një copëz buke – metaforë emër

Pylli i madh, i errët është mençuria jonë, me kafshë dhe vetëtimë – metaforë emërore

Pi dritën e syve të lirë – metaforë foljore; syve të lirë – metaforë mbiemër

Një ishull vetmie – metaforë emërore

Lumenj që ikin – metaforë foljore

Një shpellë pret shpirtin tim – metaforë foljore

#### Nxënësit ndërrojnë rolet

**Nxënësi 1: Cili është funksioni i përdorimit të: pasthirmës në hyrje të poezisë; përsëritjes artistike; përfshirjes së vetvetes?**

**Nxënësi 2:** Ah male, male, male si varre të mëdhenj pasthirmë përdoret për të tërhequr vëmendjen e lexuesit për lashtësinë e këtij vendi; jepet rrugëtimi dhe qëndresa ndaj sulmeve dhe prapështive të fuqive të mëdha, betejat shekullore, fitorja etj.

Lumenj që ikin/dhe unë që iki me erërat e tërbuara të fatit

Iki përsëri/ pa ty s' iki dot përsëritje artistike e cila shërben për të përcjellë gjendjen emocionale dhe psikologjike të largimit nga atdheu.

Autori nuk e largon veten nga kjo gjë, por e përfshin veten është pjesë e kësaj krenarie, e kësaj ikjeje malli e brengje larg atdheut të copëtuar.

#### Pak histori

Historia ka vërtetuar se kombet që mbijetojnë janë ata që dinë të mbrohen.

Po ne si komb a ditëm të mbrohemi e të tregojmë identitet kombëtar?

Shqiptarët u përpoqën shumë për njohjen e kombit shqiptar si shtet autonom dhe për t'i bashkuar kufijtë natyral të tij, edhe pse nuk pati rezultate të menjëhershme i dhanë të kuptojnë fuqive të mëdha dhe shteteve fqinje se “çështja shqiptare” nuk është më problem i tyre, por është problem i shqiptarëve.

rëndësishme për historinë e kombit tonë është data e 28 Nëntorit 1912, që simbolizon ditën e Pavarësisë Kombëtare, por me një territor dhe popullsi të përgjysmuar, siç rezultoi mbas vendimit të Konferencës së Londrës të vitit 1913.

...Vendet fqinje kishin rrëmbyer gjysmën e territorit dhe ëndërronin ta gllabëronin të tërë.

Enciklopedisti i njohur shqiptar i viteve tridhjetë, Vasfi Samimi, në librin e tij “Nëna Kosovë”, ndër të tjera shkruan:

*Ne nuk duam një Shqipëri të vogël,  
as edhe një Shqipëri të madhe,  
por ne duam një Shqipëri të vërtetë”.*

*...Qysh prej Tivarit deri n'Prevezë,  
Asht tok' e jona, prind na e kanë lanë  
Kush mos na e preki, se desim t'tanë  
Të desim si burrat që vdiqnë motit  
Edhe mos marrohnë përpara zotit.*

Vaso Pasha

Italia, që nga ana tjetër e Adriatikut ëndërronte për “bregun e 5-të”, siç e quante ajo Shqipërinë, pati tentuar disa herë të rrëmbente pjesë të saj derisa e realizoi në vitin 1939 me pushtimin e plotë.

Burimi: <http://lutfiguri.org/publicazioni/14-shqiperia-dhe-identiteti-kombetar>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i lirë

Nxënësit udhëzohen të punojnë me ushtrimin 8 fq. 86.

**Ç'mesazh përcillet përmes këtyre vargjeve:** Iki përsëri. Pa ty s'iki dot. Jam përgjysmë. Kujt i referohet poeti? Lidhini këto tri fjali në një frazë të plotë, e cila mbart idenë universale të autorit.

Brenda saj është dhe thirrja që t'i kthehemi Shqipërisë, më me përdëllim e punë e më me mençuri, të denjë e seriozë e më me dashuri e përunjësi. Ja si lutej shenjtorja jonë Nënë Tereza, fjalët e saj kumbojnë në altar si poezi:

*Dua të kthehem në Shqipëri.../Ta dimë, secili nga ne është krijuar/për të bërë vepra të mëdha... /Gjithmonë e kam në zemër/popullin tim shqiptar./Shumë luti Zotin që paqja e Tij/të vijë në zemrat tona...*

**Fjalët e tij të mëposhtme përbëjnë idenë universale të poetit:**

*Në fund të fundit Atdheu është Altari më i madh, i pakohë ose i gjithkohshëm dhe ne jemi brenda tij edhe ai është i tërë brenda nesh.*

Ose Vendlindja të ndjek pas kudo që të shkosh.

**Përgjigjet e dhëna janë orientuese dhe jo detyruese!**

Pranohen çdo përgjigje e argumentuar e nxënësve.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin hulumtimin për jetën dhe veprën letrare të Visar Zhitit, për analizën e poezisë së tij etj.

**Detyrë shtëpie:** Ktheni poezinë në prozë. Jepini asaj formën e një teksti përshkrues.

*Shtojcë informacioni:*

Visar Zhiti, lindur më 2 dhjetor 1952 në Durrës. Ai u rrit në Lushnjë, ku ai përfundoi shkollën e mesme në vitin 1970. Pas përfundimit të studimeve në Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër (sot Universiteti Luigj Gurakuqi), ai filloi karrierën e tij të mësimit në qytetin malor verior të Kukësit, duke demonstruar një interes në fillim në vjersha, disa nga të cilat u botuan në revistat letrare. Në 1973, ai përgatiti për botim një përmbledhje, “Rapsodia e jetës së trëndafilave” i cili u konsiderua si një krijim me gabime të rënda ideologjike dhe që nxinte realitetin socialist. Ai u arrestua më datë 8 nëntor, 1979 në Kukës. Mbasi u dënua në një gjyq qesharak në prill të vitit 1980 me trembëdhjetë vjet burg, ai u dërgua në burgun e Tiranës dhe më vonë transferohet në burgun famëkeq të Spaçit. Pasi u lirua nga burgun në fillim të vitit 1987 u “lejua” nga pushteti komunist për të punuar në një fabrikë të prodhimit të tullave në Lushnjë. Mbas rënies së diktaturës komuniste në vitin 1991, ai arriti të shkojë në Itali ku punoi në Milano deri në 1992. Përmes një burse studimi nga Fondacioni Heinrich Boll, Zhiti shkoi në Gjermani në vitin 1993 dhe vitin e ardhshëm shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Libra me poezi:

Kujtesa e ajrit (Tiranë: Lidhja e shkrimtarëve, 1993)

Koha e krisur (1993)

Hedh një kafkë te këmbët tuaja (Tiranë: Shtëpia Botuese Naim Frashëri, 1994)

Mbjellja e vetëtimave (Shkup: Flaka e vëllazërimit, 1994)

Koha e krisur (1993)

Dyert e gjalla (Tiranë: Eurorilindja, 1995)

Kohë e vvarë në sy (Prishtinë: Rilindja, 1997)

Si shkohet në Kosovë (Tiranë: Toena, 2000)

Rrugët e ferrit: burgologji (2001)

Ka shkruajtur edhe Pazari i Këpucarit. Përkthyer në Gjuhën Angleze:

Condemned Apple (Molla e dënuar): Poezi të zgjedhura, përkthyer nga Robert Elsie (Los Angeles: Green Integer, 2005).

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Kategoritë gramatikore të mbiemrit		<b>Situata e të nxënit:</b> Portreti i shokut tim Dy nxënës ngrihen në tabelë dhe përshkruajnë njeri-tjetrin. Kujdes! Përdorni sa më shumë mbiemra.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon mbiemrin si pjesë ligjëruese në fjalitë e dhëna;</li><li>- analizon kategoritë gramatikore të mbiemrit;</li><li>- analizon shkallët e mbiemrit;</li><li>- argumenton kthimin në numrin shumës të grupeve emërore.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Gjini Numër Rasë shkallë	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, TABELA INSERT, Punë në dyshe  
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim

Me ka marrë malli për Shqipërinë tonë;  
 Për atë qiell të madh, të gjerë e të thellë,  
 Për vrapin e kaltër të dallgëve adriatike,  
 Për retë që në muzg si kështjella digjen,  
 Për alpet flokëbardha e mjekërgjelbra,  
 Për netet e neilonta, që nga fladët fërgëllojnë,  
 Për mjegullat që si indianë të kuq  
 muzgjeve shtegtojnë

Malli i Shqipërisë – Kadare

Këtu s' do jem – Agolli

Këtu s' do jem do jem larguar  
 Në tokë i tretur si të tjerët  
 Në kafenenë e preferuar  
 Nuk do më shohin kamarierët

Dhe nëpër udhët ku kam ecur  
 S' do ndihet kolla ime e thatë  
 Mbi varrin tim do të rrijë i heshtur  
 Nje qipariz si murg i ngratë

\*Udhëzohen nxënësit të gjejnë mbiemrat në dy poezitë e mësipërme. Pas kësaj kërkohet prej tyre të tregojnë si i dallojnë mbiemrat nga pjesët e tjera të ligjëratës.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** TABELA INSERT

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të diskutojnë për informacionin e dhënë, për ta sistemuar në tabelë.

+ informacione që shtohen	V informacione që i ke ditur më parë	----informacione që i ke ditur gabim	? informacion që kërkon ndihmën e mësuesit/es
Mbiemrat e gjinisë femërore e formojnë numrin shumës:	Kategoria e gjinisë numrit dhe rasës  Përshtatet me mbiemrin ne gjini, numër dhe rasë		
Duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme.  Duke ndryshuar nyjen e përparme + mbaresë.	Shkallët e mbiemrit  Pohore  Krahasore  Sipërore		
Duke pësuar ndryshime në temë.  Duke ruajtur të njëjtën formë në të dy numrat.	Pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që emërton cilësi		

\*Tabela plotësohet nga nxënësit dhe nëse duhet ndihma e mësuesit/es, ndërhyjnë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Nxënësit punojnë ushtrimet 1-3, faqe 200.

Nxënësit diskutojnë dhe argumentojnë mbi përgjigjet që ata japin.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin në orën e mësimit.

**Detyrë shtëpie:** Grupi 1: Ushtrimi 4 faqe 200

Grupi 2: Krijoni një tregim në të cilin të përdorni mbiemra në shkallë të ndryshme.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII												
Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Përemri lidhor dhe përemri pronor		Situata e të nxënit: Në treg Krijo një tregim të shkurtër ku të përdorësh 5 përemra lidhorë dhe 5 pronorë.													
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe															
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca qytetare</div>															
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- dallon përemrat lidhorë e pronorë në fjali;</div><div>- përdor drejt në një tekst përemrat lidhorë dhe pronorë;</div><div>- analizon dallimin midis përmrave pyetës dhe përmrave lidhorë të pacaktuar;</div><div>- argumenton rastet ku përemri pronor krijon paqartësi kuptimore.</div></div>		Fjalët kyçe: Përemër lidhor Përemër pronor Pronar Pronë I caktuar I pacaktuar													
Burimet: Libri i nxënësit, tekste letrare dhe jolettrare		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi													
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi, DDM, Punë individuale															
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stuhi mendimi															
Nxënësit krijojnë një tregim të shkurtër, për një situatë të caktuar. Në këtë tregim ata analizojnë përemrat e përdorur, duke veçuar dhe theksuar përdorimin e përmrave lidhorë e pronorë.															
Bëjmë së bashku një stuhi mendimi për përemrat lidhorë dhe pronorë.															
<div><div><div><div>Që dhe i cili/e cila</div><div>I cili – e cila lakohen dhe mund të shoqërohen dhe me parafjalë</div><div>Shërben për të lidhur dy fjali të thjeshta në një fjali të përbërë</div></div><div><div>Përemri lidhor</div><div>Përemri pronor</div></div><div><div>Shërben për të treguar pronën dhe pronarin</div><div>Im, ime, ynë, jonë, yt, jote</div><div>Ka kategorinë e gjinisë,rasës,numër</div></div></div></div> <div>Ndërtimi i njohurive të reja: DDM</div> <table><tr><th>Di</th><th>Dua të di</th><th>Mësova</th></tr><tr><td>Shërben për të lidhur dy fjali të thjeshta në një fjali të përbërë.</td><td>Cilët janë përemrat lidhorë të pacaktuar?</td><td>Përemrat lidhorë të caktuar dhe të pacaktuar Kush, cili, Çfarë, Ç` janë të pacaktuar. Nga ana kuptimore, këta përemra janë të zbërthyesëm në dy përemra të tjerë: <i>Ai që punon, fiton. Nisu me atë që erdhi.</i></td></tr><tr><td>I cili – e cila lakohen dhe mund të shoqërohen dhe me parafjalë. Që dhe i cili/e cila Që nuk ka kategori gramatikore.</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Përemri pronor ka kategorinë e gjinisë, numrit dhe rasës.</td><td>A ka klasifikime të tjera dhe për përmrin pronor?</td><td>Përemrat pronorë vetorë: im, yt, i tij etj., si dhe përemra pronorë vetvetorë: i vet/e vet.</td></tr></table>				Di	Dua të di	Mësova	Shërben për të lidhur dy fjali të thjeshta në një fjali të përbërë.	Cilët janë përemrat lidhorë të pacaktuar?	Përemrat lidhorë të caktuar dhe të pacaktuar Kush, cili, Çfarë, Ç` janë të pacaktuar. Nga ana kuptimore, këta përemra janë të zbërthyesëm në dy përemra të tjerë: <i>Ai që punon, fiton. Nisu me atë që erdhi.</i>	I cili – e cila lakohen dhe mund të shoqërohen dhe me parafjalë. Që dhe i cili/e cila Që nuk ka kategori gramatikore.			Përemri pronor ka kategorinë e gjinisë, numrit dhe rasës.	A ka klasifikime të tjera dhe për përmrin pronor?	Përemrat pronorë vetorë: im, yt, i tij etj., si dhe përemra pronorë vetvetorë: i vet/e vet.
Di	Dua të di	Mësova													
Shërben për të lidhur dy fjali të thjeshta në një fjali të përbërë.	Cilët janë përemrat lidhorë të pacaktuar?	Përemrat lidhorë të caktuar dhe të pacaktuar Kush, cili, Çfarë, Ç` janë të pacaktuar. Nga ana kuptimore, këta përemra janë të zbërthyesëm në dy përemra të tjerë: <i>Ai që punon, fiton. Nisu me atë që erdhi.</i>													
I cili – e cila lakohen dhe mund të shoqërohen dhe me parafjalë. Që dhe i cili/e cila Që nuk ka kategori gramatikore.															
Përemri pronor ka kategorinë e gjinisë, numrit dhe rasës.	A ka klasifikime të tjera dhe për përmrin pronor?	Përemrat pronorë vetorë: im, yt, i tij etj., si dhe përemra pronorë vetvetorë: i vet/e vet.													

**Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 1-4 faqe 203. Mësuesi/ja kërkon prej nxënësve të argumentojnë çdo përgjigje që ata japin.

**Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 4, faqe 200.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të përemrave lidhorë dhe pronorë në fjali.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Ushtrime përemri lidhor dhe pronor		<b>Situata e të nxënit:</b> Kujdes me fjalën! A janë përdorur drejt përemrat pronorë? Atdheu jonë i dashur Vëllai yt më tha Kunata e time motre më solli një dhuratë.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon në fjali përemrin pronor dhe lidhor;</li><li>- analizon përdorimin e përemrave pronorë në fjali;</li><li>- analizon kategoritë gramatikore të përemrave pronorë;</li><li>- argumenton emërzimin e përemrave pronorë.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Përemër lidhor Përemër pronor Pronar Pronë I caktuar I pacaktuar	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<i><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, Punë në dyshe, Lojë në dyshe</i> <i><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim për njohuritë paraprake</i> <i>*Diskutohet detyra e shtëpisë e dhënë një orë më parë. Kjo fazë i shërben mësuesit/ës edhe për të kontrolluar njohuritë që ka marrë nxënësi gjatë orës së kaluar.</i> <i><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë në dyshe</i> <b>1. Përdor më vete përemrat e mëposhtëm dhe ndërto fjali me to.</b> Imi - të mitë Yti - të tutë; imja - të miam I tyre - të tyre; e saj - të sajat I veti - të vetët <b>2. Lako i cili dhe të cilat dhe ndërto fjali me të gjitha rasat.</b> Ky ishte një qytet i vogël në të cilin kisha kaluar fëmijërinë. <b>3. Ndërto fjali me përemrin lidhor çka.</b> Gjatë bisedës përmende 3 herë fjalën “idiot” dhe 4 herë fjalën “hajvan” çka tregon se komunikimi yt i përket regjistrit të thjeshtë. <b>4. Në fjalitë e mëposhtme dalloni përemrin lidhor QË nga lidhëza që.</b> Gjëja e parë që (përemër lidhor) do të vini re në ishullin tonë, mendoj se është era. Ajo fryn pothuajse çdo ditë, herë nga veriperëndimi, herë nga lindja, orientime gjeografike që (përemër lidhor) e përjashtojnë jugun për nga forca dhe intensiteti i erës. Po nxitonte, që (lidhëz) të mos humbiste orën e parë të mësimt. Aldo kishte shkuar në Gjermani që (lidhëz) të studionte për inxhinieri.			

**5. Ndërto katër fjali në të cilat përemrat pyetës *Kush?*, *Cili?*, *Ç?*, *Çfarë?*, të përdoren si përemra lidhorë.**

*Kujdes: Përemrat pyetës Kush?, Cili?, Ç?, Çfarë? Janë përemra lidhorë kur zbërthehen në ai që*

*Kush (ai që) përpigjet të ngatërrojë të tjerët, do të marrë një ditë atë që meriton.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Lojë në dyshe

**6. Me temën “Në kamping” ndërto një tekst të shkurtër ku të përdorni përemra pronorë dhe lidhorë!**

- Nxënësit përforcojnë duke u argëtuar, njohuritë për përmrin lidhor e pronor.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin e përmrave.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Buzëdrinas (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutojmë rreth poezisë së Agim Vincës. POETI Mjellmë e pikëlluar në ujërat kristalore të liqenit A rosak i shëmtuar i Hans Kristian Andersenit? Trumcak i gjerë shkurresh a shqiponjë majë mali Zgalem mes stuhish a bretkosë moçali? Brenda një çasti vjen e shkon e shkon e vjen sërish Në ferr e parajsë; në Parnas e Paris; Në Tomorr e Korab; në Drin e në Bunë “Veshunë me diell, mbathunë me hënë”. Sa çel e mëshel sytë hyn e del në burg e në bordel Zbret në horizontin e nëntë a ngjitesh në Kullën Eifel! Bilbil parëverak me këngë e vaj në buzë Qjellin ke jatak e liqenin - muzë. Përherë i dashuruar marrëzisht gjer në pleqëri Ishnje a s’ishnje, vallë, grua a shajni? Azilkerkues plak në kantonin e shpresëkotës A Arlekin i përbotur në cirkun e fundbotës? Është i marrë poeti e i urtë në marrëzinë e vet Nuk i bën ballë lotit, pret me dorë rrufetë!	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për jetën dhe krijimtarinë letrare të autorit të poezisë;</li><li>- dallon inversionin dhe anaforat në poezi;</li><li>- analizon funksionin e tyre në poezi;</li><li>- zbulon mesazhet që përcjell poezia.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Buzëdrinas Kujtime Pemë Zog Druvar, poet Peshkatar Trung Gur	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, poezi nga Agim Vinca		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> teatër	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Ditari dypjesësh, Shkrim i lirë, Turi i galerisë, Punë individuale <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim <i>*Në këtë fazë nxënësit, të cilët janë njoftuar një orë më parë, mund të lexojnë materialet që ata kanë sjellë.</i>			

**Dy fjalë për autorin**

Agim Vinca lindi më 22 maj 1947 në Veleshtë të Strugës (Maqedoni). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Strugë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në vitin 1970, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku edhe kreu masterin dhe doktoraturën. Është profesor në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku ligjeron Letërsinë e sotme shqipe. Agim Vinca është njëri nga poetët e njohur bashkëkohorë shqiptarë dhe njëri ndër studiuesit e dalluar të letërsisë shqipe. Ai merret edhe me përkthime letrare. Jeton dhe punon në Prishtinë. E kanë vlerësuar si “poet i idealit kombëtar”, “mjeshtër i thjeshtësisë (madhështisë) poetike” dhe se “zëri poetik i tij e ka pasuruar poezinë shqiptare”. E kanë cilësuar si “mik dhe krijues i shquar”, “mjeshtër bindës i shkrimit”, “dijetar dhe profesor i Kosovës”. Ai është poet, historian i letërsisë, kritik letrar, eseist, pedagog e edukator shembullor, përkthyes, publicist, polemist, drejtues mësimor e shkencor, veprimtar i palodhur politiko-shoqëror.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Pyetje-përgjigje, Ditari dypjesësh

**Kuptojmë tekstin****Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve:****1. Kuja ia kushton poeti këtë poezi?**

Këtë poezi autori ia kushton vetes dhe gjithë bashkëvendësve të tij të lindur buzë Drinit.

**2. Në ç'mënyrë jepet lidhja midis poetit dhe buzëdrinasit?**

Një lidhje e fortë, fizike dhe shpirtërore.

...Guri rëndon në vend të vet.

Mos u tund,

Prite shiun që larg nga retë...

Buzëdrinas

O trungu im!

**Po midis njeriut dhe lumit?** Po një lidhje e fortë shpirtërore e cila del në vargjet:

Qëndro

Qëndro,

Pyete lumin ç'sjell me vete

A gurë të bardhë,

A ujë të zi. Zgjohu

**3. Gjithë poezia duket sikur është ndërtuar midis këshillave: Bëj dhe mos bëj. Çfarë këshillon autori të bëjë Buzëdrinasi?**

Pyete lumin ç'sjell me vete

Qëndron në këto brigje,

Zgjohu! Dhe thua diçka

Dil në shëtit Dhe kthehu prap

Prite shiun që larg nga retë,

**4. Çfarë këshillon autori të mos bëjë Buzëdrinasi?**

Mos u tremb,

Mos u belbëzo,

Mos thuaj lamtumirë,

Mos klith,

Mos u tund,

Mos e shuaj etjen,

Mos iu lut Zotit

**5. Komentoni vargjet e mëposhtme, duke e zgjeruar kuptimin e tyre me fjalët tuaja.**

Nxënësit punojnë me teknikën ditari dy pjesësh.

Vargu	Komenti im
Ku e le ditën të të shkojë pa gëzim?	Një ditë pa buzëqeshje është një ditë e humbur, -thotë një shprehje. Njeriu dhe midis dhembjesh duhet të shoh një rreze drite në tunelin e errët.
Për një copë qiell e fal tërë botën.	

Komentet që japin nxënësit janë të ndryshme.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Analizojmë tekstin**

**6. Gjeni përsëritjet në fillim të vargjeve. Cili është roli i përdorimit të tyre?**

**Vini re!** Anafora është përsëritja e një fjale a një togu fjalësh në fillim të dy a më shumë vargjeve ose frazave.

Mos u tremb, Mos u belbëzo, Mos thuaj lamtumirë.

Mos e shuaj etjen, Mos iu lut Zotit

I ngjan pëllumbit që vdes në fluturim,

I ngjan pemës që lulëzon për frytin,

I ngjan degës që kërkon trungun e vet

Edhe kur je,

Edhe kur s'je,

Edhe sot,

Edhe dje,

Edhe nesër

Roli i përdorimit të përsëritjeve, pra anaforave është për t' i dhënë muzikalitet vargut dhe të duket sikur në sfond kemi një melodi.

*Shkrim i lirë, Turi i galerisë*

“Guri i rëndë në vend të vet” është një nga mesazhet që zbulon poezia. Nxënësit mund të zbulojnë dhe mesazhe të tjera. Më pas ata punojnë me temën e dhënë në mënyrë individuale me zbërthimin e këtij mesazhi.

Pasi mbarojnë punën, ata shkëmbejnë krijimet me njëri-tjetrin dhe bëjnë vlerësimin e tyre.

Më pas, punët ngjiten në muret e klasës dhe vizitohen nga të gjithë nxënësit si pikturat në një galeri.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për të kuptuarit e tekstit, për dallimin e anaforës dhe inversionit në poezi, për zbulimin e mesazheve që përcjell poezia. Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi.

**Detyrë shtëpie:** Mësoni poezinë përmendësh dhe recitoheni bukur në klasë.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore: Buzëdrinas (ora 2)</b>		Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
- Kompetenca e të menduarit			
- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			

<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon figurat letrare në poezi;</li> <li>- identifikon tiparet e gjuhës së kësaj poezie;</li> <li>- argumenton ndikimin e vendlindjes në ardhmërinë e njeriut.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Buzëdrinas Kujtime Pemë, Zog Druvar Poet Peshkatar Trung Gur
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, poezi nga Agim Vinca	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> teatër

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Konkurs recitimi, Punë në dyshe, Rrjet diskutimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Konkurs recitimi

Recitohet poezia nga nxënës të ndryshëm. U tërhiqet vëmendja nxënësve për të recituar bukur duke respektuar rregullat e recitimit.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Figura letrare	Shembuj nga poezia për secilën figurë
Epitet	A ujë të zi
Metaforë	Brigje ku të lagin shirat ku të rrahin Dallgët.  Pyete lumin ç'sjell me vete
Krahasim	Dhe thuaj diçka  Si përshëndetje.
Antitezë	A gurë të bardhë,  A ujë të zi.  Edhe sot,  Edhe dje,
Pasthirmë	O trungu im!

**Vargjet e mëposhtme sjellin paralelizmin midis njeriut dhe natyrës. Kjo krijon një atmosferë të veçantë përfytyruese. Shpjegoni atmosferën e secilit varg, duke thënë pse heroi lirik i ngjan:** zogut, pëllumbit, pemës dhe degës.

I ngjan zogut që jeton në fluturim \_\_\_\_\_

I ngjan pëllumbit që vdes në fluturim \_\_\_\_\_

I ngjan pemës që lulëzon për frytin \_\_\_\_\_

I ngjan degës që kërkon trungun e vet \_\_\_\_\_

Përshkruani ndjesinë e poetit, duke plotësuar tabelën e mëposhtme.

Si ndihet poeti	I çlirët	I tensionuar	Indiferent
Pse mendoni kështu			

**Gjuha e tekstit**

**Identifikoni tiparet e gjuhës së kësaj poezie, duke iu përgjigjur kërkesave të mëposhtme.**

**Në cilën vetë është shkruar poezia?**

Poezia është shkruar në vetën e dytë, heroi lirik merr porosi nga autori.

**Shkruani disa nga foljet që tregojnë këtë:** emrin e **ke**; Ku e **le** dritën...; **dil** shëtitje; I ngjan pëllumbit

**Pse përdoret shpesh mënyra urdhërore? Ilustrojeni me shembuj.**

Zgjohu! Dil shëtitje! Prite shiun! Qëndro! *Duket në njëfarë mënyre se autori e urdhëron heroin lirik në atë që duhet të bëjë apo nuk duhet të bëjë.*

**Si është formuar fjala Buzëdrinas:** Buzë+Drinas fjalë e përbërë

**Ndaluni te fjala kujtim.** Shpjegoni dykuptimësinë që mbart ajo. A është e qëllimshme

zgjedhja e autorit?

Fjala	Kuptimi i parë	Kuptimi i dytë
Kujtim		

**Nxirrni mesazhin e poezisë përmes vargut të fundit:** *Buzëdrinas, o trungu im.* Shpjegoni

nëse ky varg arrin qëllimin final të autorit dhe nëse mban peshën kuptimore të gjithë poezisë. A është figura e përdorur në këtë rast e mjaftueshme?

Renditni karakteristikat e kësaj poezie portretizuese.

Poezia portretizuese	Karakteristikat e saj
Buzëdrinas	

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Rrjet diskutimi*

**Lexoni me vëmendje zanatet që autori u vesh buzëdrinasve, si: rremtarë, druvarë, peshkatarë, poetë. Në ç'përfundim arrini?**

A ndikon vendi i lindjes dhe mundësitë që ai fal në punët që zgjedh të bëjë njeriu?

Po

Jo

Nxënësit japin mendimin e tyre duke e mbështetur në argumente. Ata vlerësojnë, diskutojnë rreth argumenteve të shprehura, debatojnë për të arritur në përfundime të sakta të mbështetura dhe në përvoja personale.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për recitimin e poezisë, për gjetjen saktë të figurave letrare në tekst; për argumentet e përdorura gjatë diskutimit etj.

*Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi.*

**Detyrë shtëpie:** Portretizoni bashkëvendësin tuaj dhe lulen më të dashur për ju.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore. Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshimore dhe urdhërore		Situata e të nxënës: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: -Diskuton për zgjedhimin jovepror në të gjitha mënyrat -Dallon foljet e zgjedhimit jovepror në fjali -Analizon foljen jam kur përdoret me kuptim të plotë dhe si folje ndihmëse -Bën dallimin midis pjesës u të formës joveprore dhe trajtës së shkurtër -Shkruan një tekst të shkurtër duke përdorur të tria mënyrat e formimit të zgjedhimit jovepror të foljeve		Fjalët kyçe: Zgjedhim Forma jovepror Mënyra Jam Pjesëz u	
Burimet: libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve :Imagjinatë e drejtuar,DDM,Shkrim i lirë Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:imagjinatë e drejtuar Përshtetja vendlindjen tënde.Përdor folje të formës vepore dhe joveprore Dallo foljet e zgjedhimit vepor dhe jovepror Mëmëdhe quhet toka ku më ka rënë koka, ku kam dashur mëm'e atë, ku më njeh dhe gur' i thatë ku kam pasur shtëpinë, ku kam njohur perëndinë, stërgjyshët ku kanë qënë dhe varret q'i kanë vënë, ku jam rritur me thërrime ku kam folur gjuhën time, ku kam fis e ku kam farë, ku kam qeshur, ku kam qarë, ku rroj me gas e me shpres, ku kam dëshirë të vdes.			
Ndërtimi i njohurive të reja: DDM			
DI	DUA TË DI	MËSOVA	
Zgjedhimi jovepror ndertohet me tri mjete gjuhesore te ndryshme: me ane mbaresash; me ane te pjesezes u; me ane te foljes ndihmese jam	Si mund të dalloj pjesën u të formës joveprore nga trajta e shkurtër e përemrit vetor?	Për të gjetur nëse është trajtë e shkurtër bëjmë pyetjen e rasës dhanore kujt ?atyre u	
	Si mund të dallojmë forljen jam si folje ndihmëse dhe me kuptimin e plotë të saj?	Format foljore te pashtjelluara mohore dhe percjellore e formojne kohen e kryer te formes joveprore me ane te foljes ndihmese jam.	

**Nxënësit hapin tekstet dhe plotësojnë tabelat pas pyetjeve të bera në qoftë se nxënësit kanë paqartësi e sqarojnë me mësuesen/in!**

**PUNOJMË USHTRIMIN 1** Plotësoni tabelën e mëposhtme me format joveprorë të foljeve: *mendoj, mat, zë*

	<i>E tashme</i>	<i>E pakryer</i>	<i>E ardhme</i>
<i>Mënyra dëftore</i>	<i>Mendohem ,matem ,zihem</i>	<i>Mendohesha, matesha ,zihesha</i>	<i>Do të mendohem</i>
<i>Mënyra lidhore</i>	<i>Të mendohem, të matem ,të zihem</i>	<i>të mendohesha ;të matesha .të zihesha</i>	-----
<i>Mënyra kushtore</i>	<i>Do të mendohesha;do të matesha ,do të zihesha</i>	-----	-----

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *shkrim i lirë*

Shkruani një tekst të shkurtër, ku të përdorni të tria mënyrat e formimit të zgjedhimit joveprorë të foljeve.

Nxënësit punojnë të qetë dhe pas mbarimit të punës shkëmbejnë punët me njeri-tjetrin dhe diskutojnë rreth tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të foljeve në zgjedhimin joveprorë, për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit etj

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuha shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Vdekja nuk është fund (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Vendoset në videoprojektor kënga e tij “Death is not the end”. Pra, Vdekja nuk është fund <u><a href="https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=YKMËuIy8qu4">https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=YKMËuIy8qu4</a></u> Diskutohet me nxënësit Ose Diskutojmë për jetën dhe vështirësitë që njeriu has gjatë të jetuarit	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale.			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Diskuton për jetën dhe veprën e Bob Dilanit</b> <b>Zbulon motivin e këtyre vargjeve</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Diskuton rreth kuptimit të jetës dhe vdekjes.</li><li>Analizon mesazhet që përcjell poezia.</li><li>Diskuton rreth funksionit të figurave letrare në poezi.</li><li>Argumenton këndvështrime të ndryshme për jetën dhe vdekjen.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Shpirt njerëzor Jetë Vdekje Fund Shpresë	
<b>Burimet:</b> teksti mësimor, videoprojektor, CD me këngë nga Bob Dylan		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Anglisht, Edukim muzikor	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.</b> Bashkëbisedim , Lapsat në mes ,shkrim i shpejtë, <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënës:</b> Bashkëbisedim Çfarë dini për Bob Dilan? U është dhënë detyrë një orë më parë të kërkojnë rreth jetës dhe veprës artistike të Bob Dilanit. Mësuesja shpjegon për jetën dhe krijimtarinë artistike të tij duke shtuar informacione. Bob Dilan (pseudonim i Robert Alen Cimmerman) Fryt i martesës së lumtur të dy prindërve hebrej të amerikanizuar, Abramit dhe Beatrices, Bobi ishte fëmija i parë dhe njëkohësisht edhe brezi i tretë emigrantësh me origjinë nga Evropa			

Lindore. I rritur në qytezën fqinje të Hibingut, në një kohë kur Amerika e pasluftës po ndryshonte pa e kuptuar edhe vetë, pavarësisht se ende nuk ishte gati shpirtërisht për ndryshim, Roberti i vogël i mori mësimet e para për jetën jashtë kornizave të provincës, për aktrimin dhe mrekullitë e artit duke parë me ëndje dhe admirim filmat që shfaqeshin në kinemanë e vogël të qytetit, e cila ishte pronë e familjes së tij nga e ëma. Aty u dalldis pas personazheve të portretizuara nga Gregori Pek, Marlon Brando, por sidomos nga Xhejms Dini, jetën dhe fatin tragjik të të cilit u mundua ta imitonte me të gjitha mënyrat duke filluar që nga pasioni për motoçikletat, për xhinset dhe xhaketat e zeza prej lëkure e deri tek të jetuarit me shpejtësi marramendëse e pa ndonjë konsideratë të veçantë për anën sipërfaqësore e materialiste të jetës. Në njërin prej këngëve të tij të mëvonshme në 1965 ai e përcaktoi qartë filozofinë e vet: “*Ai që s’e vret shumë mendjen kur lind, është tepër i zënë duke menduar për vdekjen*”.

Poezinë e parë Bobi e qëndisi në fillim të viteve ’50-të duke ia kushtuar së ëmës, Betit, si dhuratë për Ditën e Nënës, ndërsa eksperimentet e para muzikore i provoi me pianon *Gulbransen* që i ati e kishte sjellë në shtëpi, por katërmbëdhjetëvjeçari nuk ishte nga ata që shtroheshin dhe merrnin mësimet profesionale muzike. Bobi kishte idetë e tij për muzikën dhe pianos donte t’i binte vetëm sipas kokës së vet. Bob Dilani gjatë gjithë jetës së vet artistike mundi të luajë e t’i bjerë mjeshtërisht kitarës, pianos dhe sazes, që e varte me një tel në qafë dhe prej së cilës hoqi dorë vetëm në vitin 1997, pas një sëmundjeje të rëndë në mushkëri, që për pak i mori jetën. Pasi ndërroi emrin duke e bërë edhe ligjërisht *Bob Dylan*, si dhe pasi u njoh më nga afër me poetët modernë francezë, me dramaturgët Brehtit, me *folkun* anglez, skocez dhe irlandez, ai regjistroi dhe nxori në treg më 19 mars 1962 albumin e tij të parë, të cilin e titulloi me shumë modesti *Bob Dylan*.

Dilani ka këngë me kritika shoqërore, me tema historike, biblike, këngë proteste, balada. Në fillim të viteve ’60, protesta e Dilan ka qenë shumë e fortë. Përkthyesi i tij Edvin Shvarc duke shpjeguar karakterin protestues të Dilan thotë se ai është “akuzuar sikur tradhtoi muzikën folk dhe kaloi nga kitara elektrike në kitarën akustike, madje e quajën edhe Judë tradhtar. “Ishte në një koncert në Albert Hall në Londër. Dilanin e akuzuan sikur tradhtoi edhe rrymën ose vijën e vet të protestave sepse shumë njerëz në vitet ’60 e kishin si profet, si shprehës të zërit të brendshëm. Preku tema duke filluar që nga lufta për të drejtat civile, protestat kundër Luftës në Vietnam, ndryshimin që ndodhi në Amerikë se Amerika ndoshta vetë nuk ishte gati për ndryshimin dhe luajti rolin e tij duke ndikuar te shumë artistë”. Bobi ishte një artisti që krijoi me qindra këngë, regjistroi rreth 45 albume, fitoi çmime si *Grammy Aëards*, *Golden Globe*, *Academy Aëards*, *Kennedy Center Honor* në vitin 1997, “*Pulitzer*” në vitin 2008, kur katër vite më parë ishte kandidat për Çmimin Nobel, dhe arrin ta fitojë atë duke u vlerësuar nga Akademia suedeze për estetikën e ekspresivitetit në poezi.

Bob Dilan ishte zëdhënësi i një brezi që ishte kundër çdo gjëje”, madje edhe si artisti që “ka bërë marrëveshje me djallin”. Dylan-i lirisht mund të konsiderohet Homer i kohës moderne, postmoderne, dhe pas dy mijë vjetëve, vargu i tij do të jetë ende më i fuqishëm. Është revolucionar ndonëse si Homer sepse arkeologjikisht kundër fantazisë poetike, pasqyron të vërtetat historike që kanë ndodhur, ndodhin dhe vazhdojnë në tërë SHBA-të dhe globin. Kohërat ndryshojnë edhe pas 5000 vjetëve do të kënaqemi sikur tash me Homerin, po ashtu edhe me Dylan-in. Homer dhe Dilan janë të pavdekshëm, aktual dhe ky i fundit dëshmon me këto vargje: *Por ti e di se atje thjesht të kanë shfrytëzuar/Kurrë askush s’të ka mësuar në rrugë se si duhet jetuar/ E tash e ke diktuar se me jetë të tillë patjetër duhet mësuar/*

**Burimi :Gazeta “Mapo “ 15 Tetor 2016**

**Nobel 2016, Edvin Shvarc: Kur përktheja Bob Dilan**

*Gazeta “Koha jonë “ 06.01.2017 A duhet kritikuar Bob Dylan?*

Më poshtë keni këngën në origjinal në anglisht. Nëse keni mundësi mund ta këndonit në klasë

**“Death is Not The End”**

Ëhen you’re sad and Ëhen you’re lonely  
And you haven’t got a friend  
Just remember that death is not the end  
And all that you held sacred  
Falls doë n and doë s not bend  
Just remember that death is not the end.  
Not the end, not the end  
Just remember that death is not the end.  
Ëhen you’re standing on the cross-roads  
That you cannot comprehend  
Just remember that death is not the end  
And you don’t knoë Ë hat’s up the bend  
Just remember that death is not the end.  
Not the end, not the end  
Just remember that death is not the end.

Ëhen the storm clouds gather round you  
And heavy rains descend  
Just remember that death is not the end  
And there's no here there to comfort you  
Ë ith helping hand to lend  
Just remember that death is not the end.  
Not the end, not the end  
Just remember that death is not the end.  
Oh the tree of life is growing  
Ëhere the spirit never dies  
And the bright light of salvation  
Shines in dark and empty skies  
Ëhen the cities are on fire  
Ëhen the burning flesh of men  
Just remember that death is not the end  
And you search in vain to find  
Just one lasting abiding citizen  
Just remember that death is not the end.  
Not the end, not the end  
Just remember that death is not the end

Bëni një krahasim të tekstit në origjinal me përkthimin që i është bërë. Nxënësit diskutojnë së bashku dhe japin mendimet e tyre.

#### Skeda e autorit -Dy fjalë për Bob Dylan

Ka lindur më në 24 maj 1941.

Emri i vërtetë Robert Allen Zimmerman

Muzikant dhe autor vargësh amerikan

Një nga muzikantët më të famshëm në botë në vitet 60.

Ai këndon, luan kitarë, piano dhe harmonikë

Ka fituar 11 Grammy Awards dhe është futur në Grammy Hall of Fame dhe Rock and Roll Hall of Fame.

*Bob Dylan është poeti që fitoi çmimin Nobel në letërsi, për vitin 2016.*

#### ***Ndërtimi i njohurive të reja:***Lapsat në mes

*Do të punohet me këtë strategji të të nxënësve në bashkëpunim që i ndihmon nxënësit ta ndajnë kohën në mënyrë të barabartë. Kur nxënësit fllojnë thonë mendimin e tyre në një grup secili prej tyre lë lapsin në mes të tavolinës. Nxënësi që dha mendimin e tij nuk mund të flasi përsëri, derisa të gjithë anëtarët të kenë vënë lapsat në tavolinë. Ai që nuk ka çfarë të thotë "pas" dhe vendos lapsin në tavolinë. Mësuesja mund të shkojë në çdo grup të tërheq një laps dhe të kërkojë nga nxënësi që ka lapsin*

*Lexohet poezia me intonacionin e duhur. Më pas fllojmë analizën e saj, duke kuptuar brendinë e vargjeve të Bob Dylan.*  
*Grupi 1*

#### **1 Cili është motivi i kësaj poezie?**

**Vdekja nuk është fund /Njeriu është kaq i fortë sa dhe vdekja nuk e mposht atë. A kthehet ai në një lajtmotiv të saj?** Po

<p>Grupi 2</p> <p><b>2 Numëroni arsyet që jep poeti për faktin se asgjë nuk merr fund me vdekjen.</b></p> <p>1) Kur je i trishtuar dhe nuk ke asnjë mik afër.</p> <p>2) Kur gjërat e shtrenjta nuk i ke më.</p> <p>3) Kur je në udhëkryq e nuk ke rrugëdalje.</p> <p>4) Kur nuk ke ëndrra dhe të ardhme.</p> <p>5) Ku nuk ke një mik të të ndihmojë</p> <p>6) Kur shpirti është bosh.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre</p> <p>Grupi 3</p> <p><b>3 Komentoni titullin e poezisë duke pasur parasysh:</b></p> <p>- fjalët sinonime <i>vdekje</i> dhe <i>fund</i> në strukturën e tij;</p> <p>- përsëritjen e tij gjatë poezisë.</p> <p>Vdekje - ikje fizike nga jeta</p> <p>Fund - ikje shpirtërore nga jeta</p> <p>Për poetin të dyja fjalët kanë të njëjtin kuptim.</p> <p>Gjatë gjithë poezisë autori përsërit idenë e fuqisë së qenies njerëzore.</p> <p>Por... kur ke gjithë këto problem vdekja nuk është zgjidhje. Mund të largohesh nga jeta, por asgjë nuk zgjidh asnjë problem.</p>	
<p>Grupi 4</p> <p><b>Autori e ndërton ligjërimin poetik edhe përmes dialogut. Për këtë arsye, ai ka krijuar një personazh. Kush është ai dhe si është ndërtuar raporti midis tij, autorit dhe lexuesit?</b></p> <p>Diskutoni së bashku.</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: shkrim i shpejtë</b></p> <p><i>Cili është mendimi juaj për jetën dhe gjërat që ofron ajo?</i></p> <p>Nxënësit punojnë për të ndërtuar një ese argumentuese. Mësuesi/ja orienton nxënësit rreth strukturës së esesë, argumenteve dhe kundërgjendjeve, të cilat do t'i nxjerrin që në fillim të stuhisë e mendimit që do të bëjnë.</p> <p>Pas mbarimit të esesë disa nga esetë lexohen në klasë për të parë gjykimet e nxënësve rreth temave të dhëna. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin dhe veten për punën e bërë. Në fund puna depozitohet në dosje.</p> <p>Detre shtëpie: Mëso 20 vargje përmendësh ose mësoje ta këndosh këngën në origjinal Vlerësimi :Vlerësohen nxënësit për analizën që i bëjnë poezisë, për zbulimin e motivit të këtyre vargjeve ,për bashkëpunimin gjatë punës etj</p>	

## Plannifikimi i orës mësimore

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuha shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Vdekja nuk është fund (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale. - Kompetenca digjitale.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Diskuton rreth kuptimit të jetës dhe vdekjes.</li><li>• Analizon mesazhet që përcjell poezia.</li><li>• Diskuton rreth funksionit të figurave letrare në poezi.</li><li>• Argumenton këndvështrime të ndryshme për jetën dhe vdekjen.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Shpirt njerëzor Jetë Vdekje Fund Shpresë	
<b>Burimet:</b> teksti mësimor, videoprojektor, CD me këngë nga Bob Dylan		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Anglisht, Edukim muzikor	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.**Konkurs , punë në dyshe.Karrigia e nxehtë

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Konkurs

**Nxënësve u është dhënë detyrë shtëpie që do të mësojnë vargje përmendësh ose do të mësojnë të këndojnë këngën në origjinal.Nxënësit vlerësojnë njeri-tjetrin për interpretimin më të bukur e zgjedhin fituesit e tri vendeve të para.**

**Ndërtimi i njohurive të reja:**Punë në dyshe

**Gjeni figurat letrare në vargjet me shkronja të pjerrëta dhe shpjegoni funksionin e tyre.**

Figurat letrare	Lloji i tyre	Funksioni
Ëndrrat të janë zbehur	Metaforë	Ëndrrat e mbajnë gjallë njeriun, kur ato zhduken bashkë me to zhduket dhe shpresa për të jetuar.
E ardhmja s' duket kurrkund	Metaforë	
Re stuhie të rrethojnë	Metaforë	
Dora ndihmëtare nuk shihet	Metaforë	
Në qiejt e errët dhe të zbrazur	Epitet metaforik	
Pema e jetës rritët	Metaforë	
Shpirti kurrë nuk tretet	Metaforë	

**Interpretojmë poezinë**

**Me cilin nga pohimet e mëposhtme do të ishit dakord, nisur nga mesazhi që përcjell kjo poezi.**

Gjërat më të dhimbshme në jetë janë të këqijat prej njeriut dhe natyrës.

Jeta është vetëm e bukur, pa trazime dhe pengesa.

**Vdekja nuk është harresë.** Ky është pohimi që i shkon më përshtat mesazhit të kësaj poezie. Njeriu dhe pas vdekjes jeton në kujtimet e njerëzve me punën dhe veprën e lënë pas.

Njeriu është gjithmonë humbës.

**Gjuha e poezisë**

**Përgjatë gjithë poezisë ka disa fjalë që krijojnë rimë. Plotësoni figurën me fjalët e tjera, pasi të rilexoni me kujdes poezinë.**

Kund

Fund

Kurrkund

Fund

Pafund

Fund

Askund

Fund

Shkrumb

Fund

Tund

Fund

**Fjalët udhëkryqe dhe shtegdalje janë:**

të parme;

të prejardhura;

të përbëra; udhë + kryqe, shteg + dalje

të përngjitura.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Karrigia e nxehtë**

**Improvizohet një bisedë me Bob Dylan**

Cili është mendimi juaj Bob Dylanit për jetën?

Një nxënës vihet në rolin e Bobit dhe nxënësit e tjerë të klasës i bëjnë pyetje.

Vlerësohen nxënësit për zbulimin e mesazheve që përcjell poezia, për recitimin bukur të poezisë etj

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore.</b> Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore-Ushtrime		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi:</b> -Diskuton për zgjedhimin jovepror në të gjitha mënyrat -Dallon foljet e zgjedhimit jovepror në fjali -Analizon foljen jam kur përdoret me kuptim të plotë dhe si folje ndihmëse -Bën dallimin midis pjesëzës u të formës joveprore dhe trajtës së shkurtër -Shkruan një tekst të shkurtër duke përdorur të tria mënyrat e formimit të zgjedhimit jovepror të foljeve		<b>Fjalët kyçe:</b>  Zgjedhim Forma jovepror Mënyra Jam Pjesëza u	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Letërsi	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e drejtuar ,Të nxënë në bashkëpunim.Punë individuale</i> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <b>Udhëzoj nxënësit të punojnë me shndërrimin pësor të fjalive të dhëna! Kujdes ndryshimet që ndodhin në fjali gjatë shndërrimit pësor të saj .</b> <b>Bëj shndërrimin pësor të fjalive</b> <i>Rrezet e diellit ndiçonin dhomën e Arditit.</i> <i>Arkeologët nxjerrin në dritë një qytetërim të ri.</i> <i>Nëna natyrë ofron mundësi të pafundme zgjedhjesh.</i> <i>Era e fortë rrëzonte gjethet e zvedhura të vjeshës.</i> <b>*Kujdes !Kur të bëni shndërrimin pësor të fjalive</b> <b>A) Forma veprore kthehet në formën joveprore.</b> <b>B) Kryefjala kthehet në kundrinor të zhdrejtë me parafjalë.</b> <b>C) Kundrinori i drejtë kthehet në kryefjalë.</b> <b>D) Folja duhet të jetë në të njëjtën kohë në të dyja format!</b>			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënësit në bashkëpunim

**\*Nxënësit do të ndahet në grupe për të punuar ushtrime e dhëna në tekst.**

**Grupi 1**

**Bëni dallimin mes përdorimit të foljes jam si folje me kuptim të plotë dhe si folje ndihmëse.**

Ku je?

Jam duke ardhur.

Ku keni qene kaq kohe?

Qenke veshur e stolisur si rralle here.

Qofsha gabim, por zor se kthehet me.

Mund te ishim nisur qe dje.

Qe te gjithë duhej te ishim atje.

**Grupi 2 Bëni dallimin mes pjesëzës u të formës joveprore dhe të trajtës së shkurtër përemërore.**

U bëfsh njëqind vjec!

U thashë te prisnin pak.

Merruni edhe me sport.

Mos u anko kot!

Kush u foli atyre?

Jepuani te drejtën e fjalës!

U shqetësova me shumë se c'duhet.

**Grupi 3 Rishkruani fjalitë, duke i kthyer foljet nga mënyra dëftore në atë lidhore.**

Ti zgjohesh shumë herët në mëngjes. Ti të zgjohesh herët në mëngjes

Të mendohej gjatë më parë se të merrte një vendim

Më parë mendohej gjatë para se te merrte nje vendim.

Do të takohemi me shokët pas dreke.

Të takohemi pas drake me shokët

Nuk e di se nga fshihet kohët e fundit.

Kohët e fundit se nga të fshihet nuk e di!

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale.**

**Si e bëjnë formën joveprore foljet? Ndërto një fjali me to.**

Laj –mënyra dëshirore koha e tashme (u lafsha)

Gëzova –mënyra dëftore koha e kryer e thjeshtë (u gëzova)

Laj –koha e tashme mënyra lidhore

Këndova –mënyra dëftore koha e ardhme

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Më pas diskutojnë rreth zgjidhjes së ushtrimit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore.</b> <i>Dremi liqeri</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> <b>Dëgjohet në</b> youtube poezia e recituar <b><u><a href="https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=P5eKdmPjeP0">https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=P5eKdmPjeP0</a></u></b> <b>ose recitohet nga mësuesi</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale.			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi:</b> -Hulumton rreth jetës dhe veprës letrare të Lasgush Poradecit -Gjen neologjizmat dhe shprehjet popullore në poezi. -Analizon figurat letrare në poezi argumenton për rfishirjen e shumë ndjenjave në këtë poezi pejzazhi. -Kthen vargjet në prozë.	<b>Fjalët kyçe:</b> Liqen Pyll vjeshtarak Krua Qytet Perë ndim i diellit Mall
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit <a href="http://www.newsbomb.al/kulture-art/item/41604-interpretimi-fantastik-i-elsa-liles-sjell-dremit-liqeri-n-e-lasgushit-me-notat-e-mozartit-video">www.newsbomb.al/kulture-art/item/41604-interpretimi-fantastik-i-elsa-liles-sjell-dremit-liqeri-n-e-lasgushit-me-notat-e-mozartit-video</a>	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> TIK

*Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve: Bashkëbisedim, Të nxënë në bashkëpunim, Shkrim i shpejtë.*

*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim.*

*E kush nuk ka dëgjuar të paktën një herë në jetën e tij ndonjë varg nga Lasgushi. Po rikujtojmë disa prej tyre.*

E MORA SHOQEZËN PERKRAH	PORADECI	Vdekja e Nositit
<b>E mora shoqezë n për rrah, E matme rrugë n ca-nga-ca, Sikur na ndillte larg dicka.</b>  <b>Pa zu dita përë ndoj, Pa zu nata na mbuloj, Pa zura shopen ta pushtoj</b>	Perëndim i vagëlluar mi Liqerin pa kufir Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije. Njëpër Mal e nër Lëndina shkumb' i natës që po bije, Duke sbritur që nga qjelli përmi fshat po bëhet fir...  E kudó krahin' e gjërë më s'po qit as pipëlim: Në katund kërcet një portë...në Liqer heshtë një lopatë... Një shqiponjë-e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë... Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im	Me zjarr ju flas... me zjarr Në gjirin tim kam hapur varr... Që t'i jap shpresë- edhe t'ja marr...  Un' ik liqerit zemërak Fatlum dh' i pastër si zëmbak, Po zemra ime kullon gjak

**Cili ishte Lasgush Poradeci?**

**Poeti që i këndoi me aq bukuri dashurisë, natyrës dhe shpirtit njerëzor. Ai ishte dhe një përkthyes i shkëlqyer. Vargu i tij ishte i ndjeshëm dhe i ëmbël.**

Lasgush Poradeci është poeti i parë modern shqiptar dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptarë të shek. XX. Pjesë e dallueshme në poezinë e Lasgushit Poradecit është edhe poetika e natyrës së peizazhit që poeti ia kushton vendlindjes dhe atdheut të vet. Këtë, ai e bërë në mënyrë mjeshtërore, sepse ia mundësoi studimi në Akademinë e Arteve të Bukura në Austri si dhe marrja kohë pas kohe më pikturë.

*-Cilët janë vëllimet poetike të tij më të dëgjura ?*

*-Vëllimet e tij më të dëgjura janë "Vallja e yjeve" dhe "Ylli i zemrës"*

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënësit në bashkëpunim

Nxënësit fillojnë e bëjnë leximin shprehës të poezisë duke u përqëndruar te artikulimi i saktë i fjalëve ritmi,,intonacioni i zërit etj

Më pas fillojmë dhe punojmë me rubrikat për zbërthimin e poezisë

Kuptojmë poezinë

**1) Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve:**

**Kujt i kushtohet poezia?**

I kushtohet liqenit të Pogradecit i cili ka qenë gjithmonë një objekt frymëzimi për poetin

**2)Kjo është një lirikë peizazhi. Jepni detaje mbështetëse për këtë pohim.**

Mi zall të pyllit vjeshtarak

Posi me flakë-u ndez e kroj

Ai ndaj fundesh u përflak

Tashti po shuhet nënë mal

Qytet'i ngrysur në të zi,

Po ndizen yjtë dal-nga-dal

**3)Duket sikur poeti nuk ia fal kujt këtë moment dremitjeje të liqenit. Ku duket kjo?**

Në këtë ças perëndimor,

Ndaj po më dehen sytë - e mi,

**4)Përveç liqenit, cilat janë elementet e tjera që bëjnë pjesë në këtë peizazh? Qyteti,kroi janë elementet e tjera që plotësojnë peizazhin. Si mbyllet poezia?**

Poezia mbyllet me lidhjen shpirtërore të poetit me liqenin.Liqeni i sjell frymëzim poetit, i sjell ndërmend motnë e shkuar të djalërisë e të dashurisë rinore të tij.

**Analizoni poezinë**

**Plotësoni tabelën :**

<b>Figura letrare</b>	Shembulli dhe shpjegimi i rolit të secilës figurë në dhënien e kuptimit
<b>Metafora</b>	Dremit liqeri pa kufi
<b>Epitet</b>	Qytet i ngrysur ,shpirtin vjershë tor
<b>Krahasimi</b>	Porsi me flak u ndez dhe kroi/Porsi me zjarr e me flori

**Interpretojmë poezinë**

**3)A ka ndonjë lidhje të veçantë midis poetit dhe liqenit? Si realizohet shpirtëzimi i liqenit?**

Po midis poetit dhe liqenit është një lidhje që duket si lidhje simbiotike,shpirtërore, frymëzuese dhe motivuese..

Dremit,përflaket,etj

**4)Poeti ndjenjën e tij e pasqyron që nga zanafilla deri në përmbushje. Gjeni dhe analizoni**

**fjalët dhe shprehjet që japin zhvillimin e kësaj ndjenje poetike**

<b>Ndjenja</b>	<b>Shembulli</b>
<i>Si goditje</i>	
<i>Si vetëtimë</i>	<i>E vetëtiti plot magji</i>
<i>Si pushtim</i>	
<i>Si frymëzues</i>	<i>Kuptoj si shpirtin vjershëtor Ma frymëzon një mall i ri.</i>
<i>Si përmbushje</i>	

5) Poeti herë duket sikur nuk dëshiron që t'ia falë kujt këtë moment, herë i fton të gjithë të jenë pjesë e tij. Shpjegoni si ndodh kjo. Si e përfshin poeti lexuesin?

6) Ndonëse e shkurtër dhe me temë të përcaktuar, poezia pasqyron disa lloje ndjenjash.

Cilat janë ato dhe si harmonizohen me njëra-tjetrën?

Siç e thamë dhe në fillim poezia në fjalë është një himn i qartë kushtuar dashurisë së poetit për liqenin e vendlindjes. Dashuria për të është frymëzim, tharm, por përpos kësaj ndjenje në poezi ashtu si në të gjitha poezitë e peizazhit të Lasgushit që nuk janë të mirëfillta peizazhi, por të gërshëtuar me trazimet e shpirtit të poetit. Dhe në këtë poezi motivi i natyrës është i bashkëdyzuar me motivin e dashurisë dhe nuk ndahet nga ai. Këtu përkujtohet imazhi i kujtimeve dhe përmallimet e poetit për vashën e zemrës, e cila paraqitet në kopshtin e shenjtëruar që mbëltohet nga hapi i saj që e bleron edhe më shumë atë. Kështu zemra e poetit ndizet dalëngadalë kur dalin yjet dhe ai dehet sepse:

*Kuptoj si shpirtin vjershëtor Ma frymëzon një mall i ri.*

### Gjuha e poezisë

7) Lasgushi dallohet për gjuhë të qartë, të pasur me fjalë të reja, si dhe për mbështetjen në shprehjet popullore. Gjeni shembuj të tillë në këtë poezi.

*Pylli vjeshtarak*

*Çast perëndimor*

*Shpirt vjershëtor*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** shkrim i shpejtë

Ktheni në prozë vargjet e mësipërme

*Është vjeshtë. Liqeni dremet në heshtjen e vjeshtës. Ai u përflak nga perëndimi i diellit. Po kë shtu dhe kroi. Qyteti i heshtur është ndricuar nga dalja e yjeve. I debur nga gjithë kjo bukuri, një mall i ri frymëzoi shpirtin tim.*

**A mund të më thoni se ku vjen peizazhi më bukur në prozë a në poezi. Diskutojmë së bashku.**

**Nxënësit punojnë të qetë dhe në fund të orës diskutojnë dhe vlerësojnë punët e njerit-tjetrit.**

**Detyrë shtëpie:** Poeti i ka kushtuar edhe poezi të tjera liqenit. Gjeni disa prej tyre dhe tregoni gjendjen e liqenit që paraqitet në secilën prej tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b> <b>Tema mësimore.</b> <i>Poezia</i>		<b>Situata e të nxënës:</b> Recito bukur një poezi	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale.			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi:</b> -Diskuton për poezinë dhe ndërtimin strukturor të saj -Analizon teknikat që gjenerojnë frymëzim për të shkruar poezi. -Analizon poezi nga poetë të njohur. -Krijon poezi duke u nisur nga udhëzimet e dhëna.		<b>Fjalët kyçe:</b> Poezi Vargje Strofa Rima	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit, CDE “Si të shkruajmë – procesi dhe shkrimet funksionale” ,vëllime poetike		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Letërsi	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Pyetja sjell pyetjen, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe  
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Pyetja sjell pyetjen.

-Çfarë është poezia?Një nevojë e shprehjes të së bukurës.

-A duhet të përzgjedhim fjalët kur krijojmë poezi?

Po ,patjetër.Përzgjedhja e fjalës është mjete i saj

-A ka teknika të cilat na frymëzojnë për të shkruar një poezi?

Po ka teknika të caktuara që na frymëzojnë dhe drejtojnë për të shkruar një poezi.

-A mund të krijojë gjithkush poezi ?

Po, nëse të gjithë mund të hedhin ndjenjat e tyre të humorit, gëzimit, trishtimit, dhimbjes ,në letër. Fillimisht ashtu të pagdhëndura siç ju vinë e më pas rregullojini ato .

A është e nevojshme të përdorim figura letrare të ndërtojmë poezi

Po,poezia i do figurat letrare.

**Diskutojmë me nxënësit**

Ndërtimi i njohurive të reja:**Mbajtja e strukturuar e shënimeve**

**Hapi 1 Japim disa udhëzime për të shkruar një poezi.**

Diskutoni për titujt e poezive që ju pëlqejnë dhe për vargjet e tyre.


Përcaktoni llojet e strofave, por edhe figurat letrare që gjeni në vargjet e poezive që lexoni.

Lexoni vargje, rishkruajini, zgjidhni ato që ju duken të përshtatshme për poezinë tuaj.

Provoni të krijoni dy vargje.

Provoni t'i organizoni vargjet në strofa dhe strofat në vjershë

Çfarë duhet të bëjmë para se të shkruajmë një poezi?



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe:** Lexoni poezitë e mëposhtme dhe nënvizoni fjalët dhe grupet e fjalëve që formojnë figura letrare, të tilla si metafora, krahasime, hiperbola, personifikime, epitete. Vëreni fjalët me shkronja të pjerrëta. Thoni çfarë figurash letrare formojnë ato.

#### Kujdes me fjalën

Kujdes me fjalën, zonjës me çantë,  
 Kujdes me fjalën dhe ti zotëri;  
 Pushteti i fjalës është i veçantë,  
 Gatuan male dhe papastërti.  
 Me fjalën rrjedhin përrenj me mjaltë,  
 Pikojnë çizma me helm të zi.  
 Kujdes me fjalën zonjës me çantë,  
 Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!  
 Nga fjala humbën Jude e Pilate  
 Strategë e mbretër me mbretëri;  
 Kujdes me fjalën zonjës me çantë,  
 Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!

D.Agolli

#### Mama dhe bijtë

Gjithmonë e më rrallë të shoh,  
 Gjithmonë e më tepër çuditëm.  
 Si dola nga barku yt,  
 dhe ti je ime bijë.  
 Sepse je e vogël,  
 mama, e pafajshme  
 dhe lotët i ke të brishtë e të rinj.  
 Ti që u plake dhe qan si foshnjë,  
 kur duhet të gëzohesh,  
 e që pikëllimi të ndjek si urith,  
 pikërisht kur liria hap një shteg.  
 Po ti je e vogël,  
 mama, e pafajshme...

Mimoza Ahmeti

*E para ishte fjala*, -thuhet në bibël.

Autori do të përcjellë idënë se “fjala vret më shumë se plumbi”, ndaj duhet të jemi të kujdesshëm kur ta nxjerrim atë .

Për fjalën ka dhe shumë proverba:

-E vrau me pambuk!

-Po doli nga dhëmballët, mori mëhallët!

-Fjala e mirë në ditë të vështirë .

-Burri kur jep fjalën, therr djalën !

-Fjala dhe plumbi kur dalin s`kthehen më .

-Fjala e drejtë është e shkurtër, fjala e shtrembër është e gjatë.

-Fjalë pak e punë shumë

-Fjala pa punë, si peshku pa lumë

Fjalë e ëmbël thyhen të fortin.

Në poezi jepet në mënyrë të pakundërshtuese pushteti i fjalës ,fuqia ndërtuese,por dhe rrënuese e saj.Poezia është e shkruar në strofa katërshe, që rimojnë sipas skemës ABAB ku vargu u parë rimon me të tretin dhe i dyti me të katërtin.Vargje me muzikalitet, në planin e idesë ,përmbajtjes dhe formës.

**Figurat letrare** :Metafora “*gatuan male dhe papastërti*”, “*Me fjalën rrjedhin përrenj me mjalte*, pikojnë (metafora) *çezma me helm të zi* (epitete.etj)

Nxënësit dikutojnë së bashku për dy poezitë dhe vlerësojnë mendimet e njeri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:**Shkruaj një poezi në vargje të lira ose me strofa.Respektoni udhëzimet e dhëna gjatë orës së mësimi!

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b> <b>Tema mësimore.</b> <i>Shkruaj dhe unë poezi</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> Dhe unë vargëzoj -Poezi nga Ismail Kadare Do te zgjidhet një poezi nga Kadareja .Do t`u kërkohet nxënësve që pas një vargu të krijojnë një varg tjetër që të rimoje me vargun që thuhet.Do të zhvillohet në formën e lojës	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>  - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca personale.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi:</b> -Diskuton për poezinë dhe ndërtimin strukturor të saj -Analizon teknikat që gjenerojnë frymëzim për të shkruar poezi. -Analizon poezi nga poetë të njohur. -Krijon poezi duke u nisur nga udhëzimet e dhëna.		<b>Fjalët kyçe:</b>  Poezi Vargje Strofa Rima	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit, CDE”Si të shkruajmë – procesi dhe shkrimet funksionale”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Edukatë shoqërore</b>	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve :** Stuhi mendimi, Punë në dyshe, Shkrim i lirë

**Diskutim**

*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stuhi mendimi*

Cilat janë veçoritë e poezisë ?

Diskutojmë së bashku :

Veçoritë e poezisë janë ( CDE”Si të shkruajmë –procesi dhe shkrimet funksionale”)

1)Poezia shkruhet ndryshe!

*\*Kujdes nuk kemi rreshta,por vargje!*

2)Poezia i thotë gjërat ndryshe!

Kujdes gjuha e poezisë është e mbushur me figura letrare, më e zgjedhur, më e gjallë !

Poezia tingëllon bukur!

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe.

-Përpykjet për të krijuar fillimisht duhet të nisen duke përshkruar një send të thjeshtë , të njohur dhe të dashur.

-Në qoftë se duam të shkruajmë një poezi për detin gjëja e parë që duhet të bëjmë është mbledhja e fjalëve përshkruese dhe hedhja në letër e tyre.

DET

I kaltër, i pafund ,hapësirë  
,dallgë ,peshq etj etj

I kaltër si ngjyra e qiellit

Hapësirë e pafund ,infiniti

Dashuria për ty e thellë

Si thellë sia jote pa limit ...

**Fillojmë e organizojmë fjalët në mënyrë të tillë që të kemi dhe vende për rishikime dhe riparime.Pasi shkruan kopjen e parë ,rishikoje ,zgjidh fjalë të tjera nëse të duhen ,bëj ndryshimet në rimat dhe gjatësinë e vargjeve.**

I kaltër si bluja e qiellit

Hapësirë e frikshme, e pafund

Ku dallgët përplasen me bregun

Perëndimit të përflakur dorën i tund...

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë**

**Diskutim**

*Për të bërë ndryshime në poezi duhet të kemi parasysh disa pyetje vetes.*

A më pëlqen poezia e krijuar?

Nese nuk më duket e ndërtuar saktë bëj ndryshimet në të .

A më pëlqen mënyra se si e kam shkruar atë ?Nëse jo, bëj ndryshime!

A të pëlqen muzikaliteti dhe tingëllimi i poezisë ?Nëse jo, kujdes rimat!

Kontrollo drejtshkrimin dhe pas ndryshimeve të bëra ,hidhe në të pastër!

Puna ka përfunduar!

Shkruaj një poezi me temë “Miqësia”

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për krijimin e poezive sipas udhëzimeve të dhëna,për aktivizimin gjatë orës së mësimit etj

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Ndajfolja		Situata e të nxënës: Lojë në çift se kush gjen më shumë ndajfolje brenda 5 minutave.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: dallon ndajfoljet nga pjesët e tjera të ligjëratës; dallon ndajfoljen në fjali nga pjesët e tjera të ligjëratës; klasifikon ndajfoljes sipas funksionit që kryejnë në fjali; analizon shkallët e ndajfoljes.		Fjalët kyçe: Ndajfolje Përcaktore dhe rrethore Mënyre, Sasie Kohe, Vendi Shkaku, Qëllimi Shkallë Pohore Krahësore, sipërore	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve : Rendit/Grup/Emërto, DDM, Punë në dyshe Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Rendit/Grup/Emërto			
Kristal - Kadare Ka kohë që s'shihemi dhe ndjej si të harroj unë <i>dalëngadal</i> si vdes tek unë kujtimi yt si vdesin flokët dhe gjithçka.  tani kërkoj <i>poshtë e lartë</i> një vend ku ty të të lëshoj një strofë a notë, a një brilant ku të të lë, të puth, të shkoj. Të huaj jemi - Kadare Po kur mëngjesi zë afrohet, Nis shqetësohesh <i>befas</i> ti, Dhe <i>heshturazi</i> del <i>përrjashta</i> Nga shtegu, që del veç ti Kërcënimi -Kadare ... Erdh'pas tij i nënti, i dhjeti <i>radhaz</i> . Sa <i>ngadalë</i> në epos mllëfi del... Shtat'qind vjet kam për t`i djegur kullat, Do të t'i vras qentë shtat'qind vjet. Gjeni ndajfoljet në poezitë e Kadaresë Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për ndajfoljet dhe mënyrën se si i klasifikojmë ato. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM Sistemojmë informacionin e fazës së parë në tabelë			

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Ndajfolja pjesë e pandryshueshme e ligjëratës	Çfarë tregojnë shkallët e ndajfoljes?	Shkalla e ndajfoljes tregon masën e tiparit të veprimit të foljes ose masën e rrethanave në të cilat kryhet veprimi.
Emërton një tipar të veprimit a gjendjes	Mënyra e ndërtimit të shkallëve të ndryshme të ndajfoljeve a është e njëjtë me ato të mbiemrave?	PO! Mënyrat e ndërtimit të shkallëve të ndryshme të ndajfoljeve janë të njëjta me ato të mbiemrave.
Mënyre, sasi, vendi, kohe, shkaku, qëllimi	A mundet që e njëjta fjalë të dalë njëherë si ndajfolje, si lidhës apo si parafjalë.	Po mundet, ndaj duhet të shohim kontekstin ku ato përdoren.
Shkalla pohore mirë  Shkalla krahasore më mirë  Shkalla sipërore shumë mirë		

*Kujdes! Pyetjet që do të shënohen në kolonën “Dua të di” duhet të bëhen nga nxënësit dhe plotësimi i kolonës “Mësova” do të bëhet, pasi nxënësit do të hapin librat dhe do të gjejnë në libër përgjigjet e pyetjeve. Në rast se bëhen pyetje, përgjigjet e të cilave nuk gjenden në tekst, mësuesilja bën sqarimin e tyre.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Punojmë ushtrimet e dhëna në tekst.

### 1. Nënvizoni ndajfoljet në tekstin e mëposhtëm. Përcaktoni llojin e tyre.

Nëpunësit e të gjithë sektorëve pa përjashtuar asnjë, por sidomos ata të Seleksionimit, dridheshin nga fjala “verifikim”. I kishin treguar se qëllonte shpesh që ëndërrparësi, me të dëgjuar ndonjë ngjarje reale, dërgonte letër në Tabir Saraj, duke pretenduar profetizimin e ngjarjes me anë të ëndërrës së tij. Atëherë kërkoheshin ëndrra, gjendej me anë të numrit të regjistrimit të saj në recepsion. Një t'u nxjerrë nga arkivi, në qoftë se ajo ishte vërtet ashtu, kërkoheshin fajtorët që ajo s'qe marrë parasysht. Fajtorë mund të ishin interpretuesit, që nuk e kishin zbërthyer drejt kuptimin e sinjalit, po mund të ishin seleksionuesit, që e kishin nxjerrë ëndërrën të pavlefshme dhe në këtë rast faji i tyre quhej edhe më i rëndë, sepse gabimi i interpretuesit, që nuk arriti ta shpjegonte drejt sinjalin, ishte më i falshtëm në krahasim me gabimin e seleksionuesit, që nuk gjeti në ëndërr asnjë sinjal.

*Shpesh - ndajfolje mënyre*

*Atëherë - ndajfolje kohe*

*Drejt - ndajfolje mënyre*

### 2. Gjeni ndajfoljet dhe i zëvendësoni me ndajfolje të tjera të të njëjtit lloj, pa prishur kuptimin e fjalive.

- Nuk bën ashtu (KËSHITU)! - e qortoi gjyshja vogëlushin. - Mos e thyej lodrën, mbaje mirë (ME KUJDES)!

Vogëlushi gjuante topin majtas e djathtas (ANDEJ-KËNDEJ), hidhte përpara (TUTJE) dorezën e tenisit, shpërndante gjithandej (NGADO) lodrat e ndihej tepër i kënaqur. Vështroi rreth e rrotull (KUDO) dhe papritur (MENJËHERË) dëgjoi një zhurmë tepër të veçantë.

### 3. Fjalët *gjatë, afër, pranë, drejt, mes për mes, ballë për ballë*, përdorini në fjali edhe si ndajfolje, edhe si parafralë.

- a. I ra shkurt dhe i doli **gjatë**. – ndajfolje **Gjatë** rrugës ai hasi shumë pengesa. – parafralë  
 b. Mos më rri **afër!** – ndajfolje **Afër** shtëpisë ndodhej supermarketi. – parafralë  
 c. Mbaje trupin **drejt!** – ndajfolje **Drejt** nesh po vinte Agroni. – parafralë  
 d. I ra **mes për mes**. – ndajfolje **Mes për mes** fushës mund të kalohej më shpejt. – P  
 e. Ata u gjendën **ballë për ballë**. – ndajfolje **Ballë për ballë** meje gjendej personi të cilit nuk doja t'i flisja. –

### 4. Fjalët *nga dhe tek* përdorini në fjali si ndajfolje, si lidhëza dhe si parafralë.

- Nga - lidhëz Shkon nga të fryjë era.  
 Nga - parafralë Uji i kristaltë buron nga mali.  
 Nga - ndajfolje Nga u nisët?  
 Tek - lidhëz Tek ishte në fshat, merrej me bujqësi.  
 Tek - ndajfolje Erdhën tek e tek në mbrëmje.  
 Tek - parafralë E takova tek autobusi.

### 5. Shkruani fjali në të cilat të përdorni pesë ndajfolje të ndryshme në shkallën pohore, në shkallën krahasore dhe në atë sipërore.

- Kaloi rrugë *ngadalë* e *qetësisht*. – pohore  
 Afrohu *më afër* \*Krahasore, mos rri *shumë larg* – sipërore

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin dallimin e ndajfoljeve nga pjesët e tjera të ligjëratës në fjalitë e dhëna, për përdorimin e ndajfoljeve në shkallë të ndryshme etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Karnavalet e Korçës (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënët:</b> Vendoset në videoprojektor një fragment nga komedia “Karnavalet e Korçës” me aktorët Violeta Manushi dhe Ilia Shyti ose nga komedia e parë muzikore me të njëjtin titull me aktor kryesor Mirush Kabashin. <u><a href="https://www.youtube.com/watch?v=TZO0Cpu9-FI">https://www.youtube.com/watch?v=TZO0Cpu9-FI</a></u> <i>Në rast se nuk mundeni të keni internet shkëputen fragmente nga vepra dhe luhet në klasë.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth gjinisë së komedisë dhe Karnavaleve të Korçës;</li><li>- analizon personazhet e fragmentit;</li><li>- gjen shprehjet dialektore dhe gjejëset e tyre në gjuhën standarde;</li><li>- analizon mesazhet për përcjell komedia;</li><li>- argumenton aktualitetin e mesazheve të komedisë me kohën që jetojmë;</li><li>- luan në role pjesë nga vepra.</li></ul>			<b>Fjalët kyçe:</b> Tregtar Karnavale Pasuri Mendjelehtësi Mendjemprehtësi Naive Interes
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor, CD me filmin dhe teatrin			<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> teatër


**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, Pemë mendimi, Diagram Veni, Rrjet diskutimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim, Pemë mendimi

Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit rreth subjektit të komedisë dhe jetës dhe veprës letrare të Spiro Çomorës.

Karnavalet e Korçës. Një komedi e ndërtuar me tri akte, ku rrëfehej mjedisi i një qyteti shqiptar në vitin 1936.

Me skena komike ngjarjet vendosen në qytetin e Korçës, në shtëpinë e tregtarit të pasur me emrin Nikollaq dhe bashkëshortes së tij Olimbi, që përfaqësojnë me veprimet dhe mosveprimet e tyre shtresën e ashtuquajtur të pasur shqiptare, që nuk hezitojnë të “shesin” edhe të ardhmen e vajzës së tyre për ca para më shumë.



**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënit në bashkëpunim

\*Klasa ndahet në grupe dhe diskutohet më pas.

### Grupi 1

#### Kuptojmë tekstin

##### 1. Në këtë komedi vihet në lojë:

###### a) materializmi;

...po i biri ka edhe një hall tjetër: napolonat e mia!

Më ke plasur shpirtin me këto napolonat e tua!

Po njëqind napolona janë, të flamosurat!... Përse, mor Nikollaq, bëhesh kështu?!

Se më kërkon një mijë rumbullak, më shet edhe pallavra.

###### b) paragjykimet;

Nga pianoja? Meazalla! Pupupu! Unë s’e nxjerr çupën pa piano, sikur të bëhet tellua! Më poshtë se Thomaidha e

Tirkës, që i dha së bijës piano, Olimbia s’bie! Përse kërkon të na e lësh turpin në derë?

###### c) naiviteti;

###### d) fanatizmi;

###### e) të gjitha së bashku.

Për çdo alternativë, kërkohet nga nxënësit ta ilustrojnë me shembuj konkret nga teksti. Mësuesi/ja ndërhyr kur ka paqartësi nga nxënësit.

### Grupi 2

#### Analizojmë tekstin

##### 2. Cilat janë personazhet? Si i përfytyroni ato nga fjalët që thonë?

Nikollaqi, Olimbia dhe Afroviti dhe Loni, Nasta janë personazhet që veprojnë në fragment.

Nxënësit do të përshkruajnë se si i përfytyrojnë personazhet në fjalë.

##### 3. Në dialogun e Nikollaqit me Olimbinë zbulohen edhe tipare të karakterit të tyre. Gjeni dhe lexoni fjalitë ku zbulohen këto tipare.

**Nikollaqi:**

Nisu tani dhe pritja shkurt! Mos **llomotit**, sepse kjo kockë e di se si fitohen! - **arrogant**

M'i dhanë se isha i biri i Peçi Jorganxhiut! Me qeskë e me mall!

Prej soji e zengjin denbabaden, prandaj më ka zili e më nderon gjithë Korça! - **mburravec**

Se më kërkon një mijë rrumbullak, më shet edhe pallavra! Po unë nuk ia jap sikur ta bëjë dhëmbin kaq! - **kurnac**  
**Olimbia:**

Unë s'e nxjerr çupën pa piano, sikur të bëhet tellua! - **fanatike në mendimet e saj**

Më poshtë se Thomaïdha e Tirkës, që i dha së bijës piano, Olimbia s'bie! Përse kërkon të na e lësh turpin në derë? - **paragjyquese**

**4. Shënoni me + cilësitë e personazheve. Argumentoni zgjedhjet tuaja.**

Cilësitë e personazheve	i/e llaturar	Koprrac/e	Naiv/e	Mendjemprehtë	Mendjelehtë	Materialist/e
Nikollaqi		+		+		+
Olimbia			+		+	
Afroviti	+		+		+	
Loni				+		

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i lirë

Cila mendoni se ka qenë arsyeja që autori e ka titulluar këtë komedi: “Karnavalet e Korçës”? Si mendoni se lidhet ky titull me përmbajtjen e saj? Vendosini një titull tjetër komedisë dhe argumentoni pse bëtë këtë zgjedhje.

**Përgjigje e sugjeruar:** Veprimet e Nikollaqit e bëjnë atë qesharak e karnavale para syve të lexuesit.

“Kopraci” do të ishte titulli tjetër që mund t’i vendosnim komedisë në fjalë, duke bërë analogji me koprracin e romanit “Evgjeni Grande” të Balzakut, plakun Grande. Dhe ai sakrifikoï vajzën e tij, pasi gjithë kandidatët për dhëndurë i dukeshin shfrytëzues dhe gllabërues të pasurisë së tij.

Nxënësit punojnë të qetë. Pas mbarimit të punës së tyre ata diskutojnë së bashku e më pas punën e depozitojnë në dosje.

**Vlerësimi:** Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi.

**Detyrë shtëpie:** Shihni të plotë komedinë “Karnavalet e Korçës” në *youtube*. Ndahuni në grupe, zgjidhni një pjesë dhe luajeni në role.

## PLANIFIKIMI I ORËS MISIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Parafjalët sipas strukturës morfologjike		<b>Situata e të nxënësve:</b> Këmbësorët, makinat dhe polici Në klasë krijohet një situatë trafiku, Semaforët nuk punojnë, sepse sistemi ka dalë jashtë kontrollit, makinat nuk dinë nga të shkojnë, këmbësorët po kështu. Polici mban rregullin. Drejt nisjes, nga e majta, nga e djathta, nën mbikalim etj. Nxënësit do ta interpretojnë këtë situatë.	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			

<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon parafralët në fjali nga pjesët e tjera të ligjëratës;</li><li>- analizon parafralët nga mënyra e ndërtimit të tyre.</li></ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Parafralë Emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore Të parme	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stuhi mendimi, DDM <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Stuhi mendimi <b>Cfarë dini për parafralët?</b>		
<div><div>I ndajmë sipas rasave:  Emërore, dhanore, gjinore, kallëzore, rrjedhore.</div><div>Parafralët</div><div>Shpreh marrëdhënie varësie mes fjalëve që lidhen me anë të saj.</div><div>Pjesët e pandryshueshme të ligjratës.</div></div>		
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> DDM <i>*Udhëzohen nxënësit të bëjnë pyetje rreth njohurive të reja që duan të dinë për parafralët.</i>		
<b>DI</b>	<b>DUA TË DI</b>	<b>MËSOVA</b>
Pjesë e pandryshueshme e ligjratës	Si i klasifikojmë parafralët duke u nisur nga mënyra se si janë ndërtuar?	Parafralë t të parme  Nga, te, tek, prej, pa, për, nën
I ndajmë sipas rasave:  Emërore, gjinore, kallëzore, rrjedhore		Parafralë të përngjitura  Për+mbi,  në +për+mjet  me konversion nga ndajfoljet e përngjitura: për+ballë; për+krah
Shpreh marrëdhënie varësie mes fjalëve që lidhen me anë të saj.		Shprehje parafralore  Rreth e qark  Në lidhje me, për shkak të, në kundërshtim me... etj.

**Nxënësit lexojnë mirë njohuritë gjuhësore të dhëna në tekst për të mos mbajtur asnjë pikëpyetje rreth paraafjalëve. Tabela plotësohet në dërrasë nga një numër sa më i madh nxënësish të angazhuar gjatë orës mësimore.**

**Punohet ushtrimi 1.** Gjeni paraafjalët në tekstin e mëposhtëm dhe përcaktoni se cilës rasë i përket secila prej tyre.

*Unë isha ulur këmbëkryq përballë tij, ndërsa ai në një karrige matanë tryezës. I thashë se mund të merrte një qen tjetër, por ai m'u përgjigj tërë urtësi se ishte mësuar me atë qen. I mbante duart mbi gjunjë dhe kapelën e vjetër prej plisi mbi kokë. Ai i përtypte në gojën e tij pa dhëmbë copëzat e fjalive që i lëshonte nën mustaqet e zverdhura. Për të mos mbetur gojëkyçur e pyeta për qenin e tij. Me tha se e kishte marrë pas vdekjes të së shoqes.*

kallëzore

Gjinore

Rrjedhore

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

**Punohen ushtrimet e dhëna në tekst**

**Ushtrimi 2.** Formoni nga një fjali, duke përdorur paraafjalë të rasës:

**Emërore:** Nga librat mësojmë shumë gjëra të reja dhe të vlefshme.

**Kallëzore:** Në shtëpinë e Albës ka shumë harmoni.

**Gjinore:** Në sajë të përpjekjeve je ky që je sot!

**Rrjedhore:** Prej babait i ke gjithë këto të mira.

**Ushtrimi 3.** Dalloni përdorimin e fjalëve si ndajfolje (N) dhe paraafjalë. (P)

Të gjithë hynë brenda në shtëpi. N

Të gjithë hynë brenda shtëpisë. P

Eja më afër. N

Afër meje ishte ulur një i panjohur. P

Përballë nesh kishim një skuadër shumë të fortë. P

Mos me rri përballë se më zë diellin. N

Vazhdo para, pavarësisht vështirësive. N

Ata mbërritën para jush. P

**Ushtrimi 4.** Formoni paraafjalë të përngjitura me anë të fjalëve: *bri, ballë, në, mbi, krah, për, mjet, rreth, anë, mes* dhe ndërtoni nga një fjali me to.

Për+mbi,

për+mes,

në+për+mjet,

për+(r)reth,

për+ballë,

për+bri,

në+për,

për+krah

Kaluan përmes shkurreve për të mos u diktuar.

Përreth shtëpise kishte gazetarë.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të paraafjalëve në fjali, duke e dalluar nga pjesët e tjera të ligjëratës etj.

**Detyre shtëpie:** Shkruani një tekst të shkurtër, ku të përdorni të gjitha llojet e paraafjalëve sipas rasave dhe ndërtimit të tyre: të thjeshta, të përngjitura dhe shprehje paraafjalore.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Karnavalet e Korçës (ora 2)		Situata e të nxënësve: Vendoset në videoprojektor një fragment nga komedia “Karnavalet e Korçës” me aktorët Violeta Manushi dhe Ilia Shyti ose nga komedia e parë muzikore me të njëjtin titull me aktor kryesor Mirush Kabashin. <a href="https://www.youtube.com/watch?v=wAbCZV7W7Kk">https://www.youtube.com/watch?v=wAbCZV7W7Kk</a> Në rast se nuk mundeni të keni internet shkëputen fragmente nga vepra dhe luhet në klasë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth gjinisë së komedisë dhe Karnavaleve të Korçës;</li><li>- analizon personazhet e fragmentit;</li><li>- gjen shprehjet dialektore dhe gjuhëset e tyre në gjuhën standarde;</li><li>- analizon mesazhet për përcjell komedi;</li><li>- argumenton aktualitetin e mesazheve të komedisë me kohën që jetojmë;</li><li>- luan në role pjesë nga vepra.</li></ul>			Fjalët kyçe: Tregtar Karnavale Pasuri Mendjelehtësi Mendjemprehtësi Naive Interes
Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, CD me filmin dhe teatrin			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Teatër
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, Pemë mendimi, Diagram Veni, Rrjet diskutimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diagramë Veni, Grupet e ekspertëve, Rrjet diskutimi Krahasonini personazhet e mësipërme, shkruani cilësitë e tyre të përbashkëta dhe të veçanta.			
<div><div><div>Olimbia</div><div>Nikollaqi</div></div><div><div>Afroviti</div><div>Olimbia</div></div><div><div>Nasta</div><div>Loni</div></div></div>			
Nxënësit plotësojnë Diagramin e Venit dhe më pas diskutojnë rreth personazheve. Ndërtimi i njohurive të reja: Grupet e ekspertëve Ndaj klasën në grupe në këtë fazë Grupi 1 Në dialogun e Nikollaqit me Olimbinë zbulohen edhe tipare të karakterit të tyre. Gjeni dhe lexoni fjalitë ku zbulohen këto tipare. *Në këtë grup mësuesi/ja mund të përfshijë ata nxënës që ajo mendon se kanë nevojë të përsërisin njohuritë e marra në orën e parë të kësaj teme.			

**Nikollaqi:**

Nisu tani dhe pritja shkurt! Mos **llomotit**, sepse kjo kockë e di se si fitohen! - **arrogant**

M'i dhanë se isha i biri i Peçi Jorganxhiut! Me qeskë e me mall!

Prej soji e zengjin denbabaden, prandaj më ka zili e më nderon gjithë Korça! - **mburravec**

Se më kërkon një mijë rrumbullak, më shet edhe pallavra! Po unë nuk ia jap sikur ta bëjë dhëmbin kaq! - **kurnac**

**Olimbia:**

Unë s'e nxjerr çupën pa piano, sikur të bëhet tellua! - **fanatike në mendimet e saj**

Më poshtë se Thomaidha e Tirkës, që i dha së bijës piano, Olimbia s'bie! Përse kërkon të na e lësh turpin në derë? -

**paragjykuese****Grupi 2**

**Nënvizoni në tekst të gjitha shprehjet dhe fjalët që përdoren në gjuhën e folur, si dhe ato dialektore. Përbri tyre shkruani se si mund të shprehen ndryshe ato.**

*P.sh.: S'ngjyen ai në këtë derë. - Nuk bëhet ai pjesë e kësaj familjeje.*

*Shyqyr që s'e këpute perin - nuk e prishe muhabetin, nuk i shkëpute lidhjet*

*Më ke plasur shpirtin - më ke mërzhitur*

*Prej soji zengjin denbabaden - i pasur brez pas brezi*

*Më shet pallavra - më flet budallallëqe*

*Kërkon të na e lësh turpin në derë - kërkon të na turpërosh përgjithmonë*

*Mblidh mendjen - mendohu mirë*

*Do t'i plagoset zemra - do trishtohet*

*E ëma që noksane - e ëma që e keqe, e metë, e hidhur*

*Nuk që prej soji i sërës sonë - nuk ishte i të njëjtës shtresë shoqërore*

*Ato tani shkuan e vanë - ikën e nuk kthehen më kohët e vjetra ose iku vapa me gushtin*

*Kërkoni në tekst për të gjetur shembuj të tjerë.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjet diskutimi**

**Në këtë fazë nxënësit do të diskutojnë rreth temës:**

Prindërit, personazhet e komedisë së mësipërme, mendojnë se po bëjnë më të mirën për jetën e vajzës së tyre. Po juve, si ju duket mënyra se si ata mendojnë dhe veprojnë?

Nxënësit japin mendimet e tyre të argumentuara. Mësuesi/ja udhëheq diskutimin.


**Vlerësimi:** Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gatë kësaj ore mësimi.

**Detyrë shtëpie:** Shihni të plotë komedinë "Karnavalet e Korçës" në *youtube*. Ndahuni në grupe, zgjidhni një pjesë dhe luajeni në role.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Mbreti Lir (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Tragjedi nga Shekspiri	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca e të menduarit			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth jetës dhe krijimtarisë letrare të U. Shekspirit;</li><li>- u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit;</li><li>- ndërton hartën e personazheve.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Tragjedi Mbreti Lir Vajzat e tij	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> teatër	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Pemë mendimi, Lexim me role, Harta e personazhit, Bashkëbisedim  
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Pemë mendimi



**Ndërtimi i njohurive të reja:** Leximi me role

Mësuesi/ja udhëzon nxitësit të lexojnë me role dhe më pas t'u përgjigjen pyetjeve rreth brendisë së pjesës:

**Përgjigjuni pyetjeve rreth brendisë së pjesës:**

**Cilët personazhe përfshihen në fragmentin e mësipërm?** Mbreti Lir dhe Kordelja

**Ku zhvillohen dialogët e personazheve?** Në pallatin e Mbretit Lir

**Si e argumenton Kordelja shprehjen e dashurisë ndaj të atit?**

*Madhëri, ju dua*

*Ashtu si e ka detyrë çdo fëmijë*

*Ndaj t'et, dhe as më shumë, as më pak.*

**Çfarë mendon ajo për deklaratat e të motrave?**

Mendon se dashuria e tyre për babanë nuk është ajo që ato prezantojnë. Në fjalët e tyre nuk ka sinjeritet, por vetëm falsitet.

**A ndryshon mendim mbreti Lir nga arsyetimi i së bijës?** Jo "Sa e re dhe sa e vrazhdë!" - i thotë Kordeljas.

**Cili është dënimi i mbretit Lir për Kordelian?** Dënimi i mbretit Lir ishte heqja e Kordelias nga ndarja e pasurisë, madje dhe nga të qenurit bijë e tij.


*Dhe midis meje e zemrës sime qofsh*

*Që sot e tutje përgjithmonë e huaj... Po mirë, pra, të drejtën marsh për priqë,*

**Analizojmë tekstin**

Gjeni në tekst frazat ku pasqyrohen këto momente.

Mosbesimi i Lirit	Si the? Kordelja! Ndreqe pakëz gjuhën. Se mos i biesh fatit tënd me shqelm. Sa e re dhe sa e vrazhdë!
Dashuria e vajzës për babanë, e shprehur thjeshtësisht	Madhëri, ju dua Ashtu si e ka detyrë çdo fëmijë Ndaj t'et, dhe as më shumë, as më pak.
Dënimi i Lirit	Po mirë, pra, të drejtën marsh për prikë, Prej lidhjes shpirtërore dhe të gjakut; Dhe midis meje e zemrës sime qofsh Që sot e tutje përgjithmonë e huaj Mëshirë e dhembshuri dhe përdëllim, sa edhe ti ish-bija jonë.



**Portretizoni figurën e mbretit Lir, nëpërmjet kllasterit të mëposhtëm.**

*\*Në këtë ushtrim përdoret metoda e hartës së personazhit, ku nxënësit evidentojnë cilësitë e personazheve.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për leximin bukur e qartë të pjesës, dallimin e personazheve të vjershës, ndarjen e eksperiencave personale me shokët.

**Detyrë shtëpie:** Luani në role skenën e mësipërme.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojit të tyre		<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë në dyshe Lidhëzat E groposi në dhe Moza dhe Mira janë shoqe të ngushta. Ndërtoni dhe ju fjali ku e njëjta fjalë të përdoret si lidhëz apo një pjesë tjetër ligjërate	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojit të tyre; - analizon përdorimin kur lidhin gjymtyrë apo pjesë fjalisht; - ndërton tekste ku përdor gjithë llojet e lidhëzave dhe shprehjeve lidhëzore.	<b>Fjalët kyçe:</b> Lidhëza Gjymtyrë fjalisht Pjesë fjalisht Të thjeshta Të përngjitura Shprehje lidhëzore
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, tekste artistike	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, Tabela e konceptit, Puno në dyshe

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim

**Dalloni lidhëzat në fragmentin e dhënë:**

**Kur** mbaroi këtë vepër të madhe inxhinieri mesa duket deshi ta vizitonte. E vizitoi birucë për birucë, bodrum për bodrum. Kushedi se si ndërgjegjja e tij prej italian, prej arkitekti iu nxi, sytë iu verbuan **dhe** ia hoqi vetes. **Sapo** e pa me sy që të burgosurit e kidhur këtu jo vetëm nuk do ta lëkundnin dot këtë kullë, **por** përkundrazi ata do të treteshin dhe do të vdisnin (Petro Marko).

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Tabela e konceptit

Nxënësit lexojnë me kujdes temën e dhënë dhe plotësojnë më pas tabelën e konceptit.

Lidhëzat	Lidhin gjymtyrë fjalisht	Lidhin pjesë fjalisht	Llojet e lidhëzave
Lidhëza është pjesë e pandryshueshme e ligjaratës që lidh dy gjymtyrë fjalisht ose dy fjali.	Kallëzues + kallëzues  Kryefjalë + kryefjalë  Kundrinorë + kundrinorë  Rrethnorë + rrethnorë  Përcaktorë + përcaktorë	Lidhin dy fjali që nuk varen dhe dy fjali që varen prej njëra-tjetrës.	Të thjeshta  Të përngjitura  Shprehje lidhëzore

\*Tabela plotësohet së bashku me mësuesen, pasi nxënësit e kanë plotësuar individualisht në blloqet e shënimeve të tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Puno në dyshe

**Punohet ushtrimi 1 në tekst në fq 212.**

Gjeni lidhëzat në tekstin e mëposhtëm dhe thoni në lidhin gjymtyrë apo pjesë fjalisht.

Pas vdekjes së Skënderbeut **dhe** pas ngadhënjimit të Shqipërisë prej turqve, ushtritë e tij që mbeten si fëmijë pa atë, shkuan në mërgim **dhe** luftuan jo pa lavdi. Sa për shqiptarët që qëndruan në vend, këta nuk u çfiseruan, **as** u shtypnë, **as** u bënë robër këmbëlëpirës të turqve. Shqiptarët s'e kanë njohur qeverinë e turqve, as u janë përlulur ndonjëherë, **por** luftuan kundër syresh për të drejtat e tyre deri në fundin e hidhur.

Lidhëzat dhe rrethnorë + rrethnorë dhe kallëzues + kallëzues

+ as, as lidhin gjymtyrë fjalisht kallëzues + kallëzues

Lidhëza **por** lidh pjesë fjalisht që nuk varen nga njëra-tjetra.

Diskutohet ushtrimi me nxënësit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin e lidhëzave në fjali, për dallimin e tyre nëse lidhin pjesë fjalisht që varen a jo nga njëra-tjetra, apo lidhin gjymtyrë fjalisht.

**Detyrë shtëpie:** Ndërto 6 fjali me lidhëza të thjeshta, të përbëra dhe të prejardhura.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Ushtrime - Lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojit të tyre		Situata e të nxënës Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojit të tyre;</li><li>- analizon përdorimin kur lidhin gjymtyrë apo pjesë fjalie;</li><li>- ndërton tekste ku përdor gjithë llojet e lidhëzave dhe shprehjeve lidhëzore.</li></ul>		Fjalët kyçe: Lidhëza Gjymtyrë fjalie Pjesë fjalie Të thjeshta Të përngjitura Shprehje lidhëzore	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi, histori	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Punë në dyshe, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë, Turi i galerisë</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Punë në dyshe</p> <p>Në thëniet e Nënë Terezës gjeni lidhëzat:</p> <p><i>Nëse lutemi, do besojmë! Nëse besojmë, do dashurojmë!</i></p> <p><i>Nëse dashurojmë, do shërbejmë!</i></p> <p><i>Folu butësisht njerëzve! Tregoje mirësinë në fytyrë, në sy, në buzëqeshjen tënde, në ngrohtësinë e buzëqeshjes tënde, gjithnjë të kesh buzëqeshje gazmore! Jep jo vetëm kujdesin, por edhe zemrën! Lidhin pjesë fjalie që nuk varen nga njëra-tjetra.</i></p> <p><i>Nëse vërtet duam të dashurojmë, duhet të mësojmë si të falim!</i></p> <p>Lidhëza <b>nëse</b> e përdorur në fjalitë e dhëna lidh pjesë fjalie që varen nga njëra-tjetra.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënës në bashkëpunim-Punë në dyshe</p> <p><b>Bashkoni fjalitë e dhëna në një fjali të përbërë. Analizoni mjetet e lidhjes.</b></p> <p><i>Mua më pëlqen teatri. Ai parapëlqen kinemanë.(kurse)</i></p> <p><i>Gjethet binin. Frynte ere e fortë. (për shkak se)</i></p> <p><i>Nxënësit dolën. Ra zilja. (Sapo)</i></p> <p><i>Vazhdon të binte shi. Ne qëndronim jashtë.(ndërsa )</i></p> <p><i>Nuk kam shumë kohë. Do të të telefonoj. (sepse )</i></p> <p><b>Ndërtoni pesë fjali ku gjymtyrët e renditura më poshtë të lidhen me anë të lidhëzave në kllapa.</b></p> <p>Kallëzues (dhe) Këndonte dhe vallëzonte me një energji të paparë.</p> <p>Kryefjalë (ose) Nëna ose djali do të shkonin të ftuar në dasmë.</p> <p>Kundrinore (apo) Shqipërinë apo Gjermaninë do të zgjidhje për të jetuar?</p> <p>Rrethanore (as.....as) Nuk donte të shkonte as në shtëpi, as te gjyshja.</p> <p>Përcaktore (edhe.....edhe) Shtëpitë e larta edhe madhështore dukeshin sikur që së ndizeshin me heshtjen e qytetit.</p> <p><b>Ushtrimi 4 fq. 212.</b></p> <p><b>Përdori në fjali:</b></p> <p>Kur - ndajfolje Kur e merr lejen?</p> <p>Kur - lidhëz Do të pushojmë, kur të arrijmë në hotel.</p> <p>Që - përemër lidhor Librat që më dhe i lexova.</p> <p>Që - lidhëz E di që thua të vërtetën.</p> <p>Edhe - pjesëz Nuk ka ardhur edhe.</p> <p>Edhe - lidhëz Sipas vendit edhe kuvendi.</p>			

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i lirë + Turi i galerisë

Shkruani një tekst të shkurtër, ku të përdorni të gjitha llojet e lidhëzave: të thjeshta, të përngjitura dhe shprehje. Bëni dallimin mes rasteve kur shërbejnë për të lidhur gjymtyrë fjalish ose pjesë fjalish.

Nxënësit punojnë e më pas punët e tyre i ngjisin nëpër klasë dhe i vizitojnë ato duke i vlerësuar për saktësinë e tyre.


**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të lidhëzave dhe shprehjeve lidhëzore, vlerësohen për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha:</b> Gjuha dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Shkalla:</b> IV	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Rubrika:</b> Të lexuarit <b>Tema mësimore:</b> Mbreti lir (ora 2)		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca personale - Kompetenca e të menduarit			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- ndërton hartën e personazhit të Kordelias;</li><li>- argumenton aktualitetin e dramës lidhur me problemet e ditëve të sotme;</li><li>- interpreton bukur fragmentin e dhënë.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Tragjedi Mbreti Lir Vajzat e tij	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> teatër	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Harta e personazhit, Lapsat në mes, Vija e vlerës

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Harta e personazhit



**Ndërtimi i njohurive të reja:** Lapsat në mes

Ndahet klasa në 3 grupe ekspertësh dhe punohet me teknikën “Lapsat në mes”.

### Grupi 1

Plotësoni tabelën e mëposhtme, duke zbërthyer kuptimin.

Kush e thotë	Fraza	Kuptimi
Mbreti Lir	Nga asgjëja del asgjë	Mbreti i sheh gjërat shumë ngushtë, të prera, racionale pa shpirt tamam si veprimet në matematikë.
Kordelja	...s'jam e zonja të ngroh zemrën	E kuptonte mirë se nuk ishte e aftë të bënte si motrat e saj.
Mbreti	Se mos i biesh fatit tënd me shqelm	Në rast se Kordelja nuk do të thurte lavde si motrat e saj nuk do të fitonte gjë.
Mbreti	Dhe midis meje e zemrës sime qofsh Që sot e tutje përgjithmonë e huaj	Mungesa e falsitetit i kushtoi Kordeljas shumë, me mohimin e saj prej babait.

**Grupi 2**

**Përcaktoni mënyrën dhe kohën e foljeve në ligjëratën e mbretit Lir në mbyllje të kësaj skene.**

Po mirë, pra, të drejtën marsh për prikë/Dhe midis meje e zemrës sime qofsh: Mënyra dëshirore, koha e tashme  
Përmes të cilëve jetojmë e vdesim,/Heq dorë prej kujdesit prindëror,/Barbari skit, që ha fëmijë' e vet-Mënyra dëftore  
koha e tashme

**Grupi 3**

**Ku mendoni se qëndron aktualiteti i kësaj drame, lidhur me problemet e sotme?**

- a) Kontrasti midis pamjes së jashtme dhe botës së tyre të brendshme (sjelljeve hipokrite të njerëzve)
- b) Dashuria e ngritur mbi interesa
- c) Ndëshkimi nga e vërteta

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Vija e vlerës*

Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit që këta të fundit të japin argumentet për pyetjen:

**A matet me fjalë dashuria?**

Mbroni qëndrimin tuaj me argumente.

PO

JO

PSE?

Nxënësit japin mendimet e tyre, replikojnë për mendimet të cilat nuk ju duken te drejta.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për: leximin bukur e qartë të pjesës, dallimin e personazheve të vjershës, ndarjen e eksperiencave personale me shokët.

**Detyrë shtëpie:** Luani në role skenën e mësipërme.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Projekt. Ndikimi i internetit dhe librit ne zhvillimin e aftësive psikomotorë të nxënësve (ora 1)		Situata e të nxënësve: Ndarja e punëve	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis</div> <div>- Kompetenca qytetare</div> <div>- Kompetenca digjitale</div>			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- diskuton për rëndësinë e librit të shkruar;</div><div>- analizon lidhjen midis internetit dhe librit të shkruar;</div><div>- diskuton për shfrytëzimin e kohës së lirë nga fëmijët;</div><div>- merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;</div><div>- përzgjedh materialet e duhura për produktet finale;</div><div>- bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim;</div><div>- drejton punën në grup;</div><div>- prezanton produktet e projektit.</div></div>		Fjalët kyçe:  Internet Web Facebook Rrjete sociale Libër Subjekt Mesazh	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Mendo/puno në dyshe/shkëmbe mendime, Të nxënësve në bashkëpunim			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Mendo/puno në dyshe/shkëmbe mendime			
Faza 1 Aktivitetet parapërgatitore të projektit			
Njohja me temën e projektit. Pavarësisht se është ora e parë nxënësve për projektin u është folur që në fillim të vitit që ata të marrin masë për hulumtim dhe mos ta lënë punën vetëm në ditët që kanë projektin.			
Formimi i grupeve të nxënësve dhe ndarja e detyrave brenda grupit.			
Grupet brenda klasës formohen heterogjene me nxënës me përparim të mirë, mesatar apo të dobët. Nxënësit duhet të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, pasi gjatë orës së projekteve, duhet të mësojnë duke u argëtuar.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënësve në bashkëpunim			
Po japim më poshtë një model të planifikimit të projektitTitulli			
Një emër/Titull tërheqës projekti.			

<b>Titulli</b>	Një emër/Titull tërheqës projekti.
<b>Kohëzgjatja</b>	Data e fillimit dhe mbarimit të projektit
<b>Qëllimi</b>	Çfarë do të nxënë nxënësit? Tregohet se si klasat pjesëmarrëse do të përfitojnë nga përvojat e tyre me ju.
<b>Lëndët</b>	Lista e fushave të kurrikulës, të cilave do t'ju adresohet ky projekt.
<b>Pjesëmarrësit</b>	Mësues, Nxënësit sipas nivelit.
<b>Përshkrimi</b>	Paragrafë të shkurtër, të cilët përshkruajnë projektin që të tërheqë interesin e lexuesit.
<b>Veprimtaritë sipas linjave kohore</b>	Përshkrim i asaj që nxënësit do të kryejnë sipas afateve: <ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjidhje problemesh;</li> <li>- grumbullim informacioni;</li> <li>- shkëmbime ndërpersonale;</li> <li>- vëzhgime;</li> <li>- diskutime;</li> <li>- vlerësime.</li> </ul>
<b>Burime të kërkuara</b>	Lista e burimeve
<b>Rezultatet</b>	Produkte përfundimtare
<b>Përfitimet</b>	
<b>Vlerësimi</b>	

*Pra nxënësit duhet të jenë të aftësuar për atë që do të bëjnë.*

### **Qëllimi i projektit**

Projekti ka si detyrë t'i pajisë nxënësit me kompetencat e mësipërme dhe të përforcojë disa rezultate të të nxëni sipas kompetencave të fushave.

Në fund të projektit nxënësi duhet të arrijë:

- të prezantojë produktet finale të projektit që kanë ardhur si rezultat i punës në grup apo individuale;
- të argumentojë atë që ka sjellë në produkt;
- të interpretojë çdo qasje të tij.

**Grupi 1:** Problemet e fëmijëve autik.

**Grupi 2:** Si ndikon libri te fëmijët.

**Grupi 3:** Interneti ndikon pozitivisht apo negativisht te fëmijët?

**Grupi 4:** Interneti apo Libri? Cili ka zhvillim më të gjerë?

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Të nxënësit në bashkëpunim

Nxënësit pasi kanë ndarë grupet dhe kanë caktuar nëntemat, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të caktuar mënyrën e përgatitjes së produktet që do të prezantojnë në orën e fundit.

Ai mund të jetë:

- prezantim në powerpoint;
- fletëpalosje;
- poster;
- revistë apo gazetë;
- faqe web-i.

**Vlerësimi:** Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gatë kësaj ore mësimi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Pjesëza		Situata e të nxënës: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- dallon pjesëzat në fjali nga pjesët e tjera të ligjëratës;</div><div>- përcakton llojin e pjesëzave;</div><div>- analizon pjesëzat sipas mënyrë së ndërtimit të tyre;</div><div>- ndërton histori duke përdorur pjesëza të llojeve të ndryshme.</div></div>		Fjalët kyçe: <div>Pjesëz</div> <div>Dëftuese</div> <div>Përforcuese, përcaktuese-saktësuese</div> <div>Modale</div>	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bashkëbisedim, Mbajtje e strukturuar e shënimeve, Punë në dyshe.</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim</p> <p>Emërtoni fjalët me shkronja të zeza dhe thoni se ç'pjesë ligjërate janë.</p> <p><b>Ja dhe Jehona, shoqja ime më e mirë. E kam njohur <i>qysh</i> në fëmijëri, kur ishim në të njëjtin kopsht. Ajo <b>nuk</b> rrinte një sekondë pa lëvizur. Luante <b>pothuajse</b> gjithë ditën dhe <b>nuk</b> ia dilte dot kush. Edhe sot dallohet. Është në qendër të vëmendjes <b>pikërisht</b> si dikur.</b></p> <p><i>Të gjitha janë pjesëza</i></p> <p><i>Ja - dëftuese</i></p> <p><i>Nuk - mohuese</i></p> <p><i>Qysh - saktësuese</i></p> <p><i>Pikërisht - saktësuese</i></p> <p><i>Pothuajse - përafruese</i></p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Mbajtje e strukturuar e shënimeve</p> <p><b>Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstet dhe të mbajnë shënime në mënyrë të strukturuar dhe të diskutojnë më pas me mësuesin/en.</b></p>			
<div>Pjesëza është pjesë e pandryshueshme e ligjeratës dhe shërben për të shprehur ngjyime kuptimore ose emocionale plotësuese të një fjale, të një togfjalëshi apo të një fjalie.</div>		<div>Sipas kuptimit i klasifikojmë:</div> <div>Pjesëza që shprehin Ngjyime kuptimore të Përgjithshme, Modale dhe Pjesëza emocionuese shprehese.</div>	
<div>Pjesëza</div>			
<div><div>Pjesëza të thjeshta: <i>bile, ja, jo, nuk, po etj.</i></div><div>Pjesëza të përngjitura: <i>pale, posi, pothuajse etj.</i></div><div>Pjesëza shprehje: <i>as që, ja që, jo që jo etj.</i></div></div>			

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Punohen ushtrimet në tekst, fq. 214.**

### 1. Gjeni pjesëzat dhe përcaktoni llojin e tyre.

Ju u plakët, - i tha ai rrënjës së trëndafil. - Tani mjaft më! Ju i dhatë botës gjithë ç'mundet, se sa me vlere qe kjo, është një çështje me të cilën **nuk** kam kohë të merrem. Por ama është e qartë se ju nuk keni bërë asgjë për zhvillimin tuaj të brendshëm. Së shpejti do të katandiseni në një shkurre të thatë! **A** e kuptoni se ç'dua të them?

Ju po më trembni! - tha rrënja e trëndafil. - **Nuk** i kisha menduar kurrë këto gjëra!

**Po, po** merret vesh që ju **nuk** e lodhni shumë mendjen. Po **a** e keni vrarë mendjen ndonjëherë të merrni vesh përse ju lulëzoni dhe si ndodh kjo? Përse kështu dhe **jo** ndryshe?

### 2. Në tekstin e mëposhtëm shtoni pjesëza pa prishur kuptimin e fjalive.

Djaloshi kërkoi t'i zgjidhnin duart. Pastaj ai nxori një letër nga xhepi dhe seç shkroi në të me një pendë, të cilën e këputi nga bishti i zogut.

(Pikërisht ) të nesërmen kur po afronte dreka ndodhi e papritura më e madhe: u hap dera e bujtinës dhe hyri . . . po, po, hyri Ardita. ( \_\_\_\_\_ Bile \_\_\_\_\_ ) ajo dukej e gëzuar, ishte e freskët e plot shëndet, ( \_\_\_\_\_ Thuajse ) sikur sapo të ishte zgjuar nga një gjumë i gjatë e plot ëndrra të bukura.

( \_ Bash \_ ) Shtojzovallet e kishin shndërruar në një zog që të shëtiste e të lodronte ( \_\_\_\_\_ madje \_\_\_\_\_ ) ngado që të donte. ( \_\_\_\_\_ Pikërisht \_ ) Në një zog të vogël pendëkuq.

( \_ Tamam \_ ) Atëherë e kuptuan Miroshi dhe Qerosi, pse ai zogu i vogël pendëkuq i ndiqte gjithnjë nga pas.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin e saktë të pjesëza në fjali, dallimin e llojeve të tyre sipas kuptimit dhe ndërtimit.

**Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 4 fq. 214. Vëreni fotografitë dhe ndërtoni një histori. Shkruajeni atë, duke përdorur sa më shumë pjesëza.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Njohuri Gjuhësore</b> <b>Tema mësimore:</b> Pasthirrma		<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë në çift Krijë një situatë dhe përdor pasthirrma në të.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon pasthirrmat nga pjesët e tjera të ligjëratës;</li><li>- dallon pasthirrmat emocionale nga ato nxitëse;</li><li>- dallon pasthirrmat sipas formimit të tyre;</li><li>- ndërton tekste në të cilat përdor pasthirrma dhe tingullimitimet.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Pasthirrma Tingullimitimet Nxitëse Emocionale Të thjeshta, të përngjitura, shprehje	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Arte	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</i> Bashkëbisedim, Tabela e konceptit, Punë në dyshe <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</i> Bashkëbisedim <i>Ua sa qenke rritur moj çupë?!</i> <i>Ej, Ela ti je?</i> <i>Se mjaft në robëri</i> <i>Moj e mjera Shqipëri</i> <i>O burra kokni armët</i> <i>Ja vdekje ,ja liri</i>			

Evidento pasthirrat në fjalitë e dhëna. Si i dallon ato? A kanë kategori gramatikore?

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Tabela e konceptit

<b>Pasthirrat</b>	<b>Emocionuese</b>	<b>Nxitëse</b>	<b>I. Pasthirrma të thjeshta</b>
	Shprehin gëzim, admirim, kënaqësi	Shprehin nxitje, urdhër ose lutje	Mund të jenë tinguj të veçantë ose grupe tingujsh
	Shprehin mosbesim, mospërfillje, përbuzje	Shprehin thirrje.	<b>II. Pasthirrma të përngjitura</b>
	Shprehin frikë, dëshpërim, hidhërim.	Shprehin përshëndetje, mirënjohje, mallkime, sharje, ngushëllime.	Formohen prej përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm si formula urimi a përshëndetjeje
	Shprehin pakënaqësi, keqardhje, mërzi, dhimbje.	Faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjesi, mirupafshim, mirë se erdhe, natën e mirë, tungjatjeta, udha e mbarë	<b>Pasthirrma Shprehjeje</b>  Disa shprehje frazeologjike kur përdoren si njësi të gatshme për të shprehur ndjenja të ndryshme, marrin rolin e pasthirrmës.

Të ngjashme me pasthirrat, janë edhe tingulllimitimet (onomatopetë). Ato nuk shprehin ndjenja, as nuk nxitin për të vepruar, vetëm imitojnë tingujt e natyrës: *Mjau-mjau, – dëgjohej macja.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**1. Nënvizoni pasthirrat dhe thoni se çfarë lloji janë ato.**

**Oh!** Sa të bukura janë lulet në pranverë! **Ah**, ku jeni **o** ditët të lumtura e gjithë diell! **Ua**, paska filluar shiu! Dreq **o** punë, m'u prish humori. **Ahu**, s'guxon njeriu të bëjë një plan! **Uf**, u mbyllëm brenda! **Eh**, iku edhe një ditë.

Oh - pasth/emoc që tregon kënaqësi

Ah /eh - pasthirrmë emocionale që tregon dhimbje e mërzi

Ua - pasth/emoc shpreh habi

Ahu - pasth/emoc shpreh mosbesim

**2. Vendosni në tabelë pasthirrat e mëposhtme, duke i ndarë sipas llojit.**


bobo, aha, bubu, korba, obobo, ehe, qyqja, o, oh, oho, ububu, e zeza, au, eu, oj, ou, bah, ehe, ahu, i, ohu, të lumtë, urra, u, ua, uh, ptu, y.

**3. Shkruani pesë fjali në të cilat të përdorni tingulllimitime të ndryshme.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e pasthirrmave në fjali, për bashkëveprimin me shokët në punën në grup etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një përshkrim të shkurtër në të cilin të përdorni pasthirrma të llojeve të ndryshme. Bëni një tabelë, në të cilën t'i ndani pasthirrat e përdorura sipas kuptimit dhe sipas ndërtimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të dëgjuarit Tema mësimore: Romeo dhe Zhuljeta		Situata e të nxënësve: Në videoprojektor shikohet një fragment nga filmi “Romeo dhe Zhuljeta” me aktorin Leonardo di Caprio Diskutojmë së bashku.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dëgjon për të nxjerrë informacionin kryesor nga ajo që dëgjon;</li><li>- nxjerr informacionin kryesor nga materiali në DVD;</li><li>- përgjigjet për pyetje rreth të kuptuarit të tekstit të dëgjuar.</li></ul>		Fjalët kyçe: Dashuri pasionante Hasmëri Fat i keq Tragjedi	
Burimet: Teksti mësimor, videoprojektor, fragment nga filmi “Romeo dhe Zhuljeta” me aktorin Leonardo di Caprio		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: teatri	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh, Pyetja sjell pyetjen, Pauza treminutëshe Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh Para një ore ne kemi diskutuar rreth jetës dhe veprës së Shekspirit. Kemi përmendur gjithashtu se një nga kryeveprat e këtij shkrimtari është “Romeo dhe Zhuljeta”. Para se të dëgjojmë fragmentin e përzgjedhur nga tragjedia do të zhvillojmë një stuhi mendimi për të.			
Tragjedi me 5 akte/2 të parat me situata komike		Personazhet kryesore: Romeo dhe Zhuljeta	Personazhe të tjera Merkuti, Vaja, Frati Laurën, s Benvolio
Montagët (Romeo) dhe Kapuletët (Zhuljeta) në hasmëri me njëri-tjetrin.		I përket periudhës së parë të krijimtarisë së tij.	
<div><div></div><div><p>Është burim frymëzimi për:</p><p>Opera “Kapuletët dhe Montagët” Rossini 1830</p><p>Sinfoninë “Romeo dhe Zhuljeta“ të Hektor Berliozit 1839</p><p>Opera “Romeo dhe Zhuljeta” “Guinoi 1867</p><p>Baletin po me të njëjtin titull të Prokofievit (1936-1938)</p><p>Tabloja “Lamtumira e Romeos dhe Zhuljetës”</p><p>Delakrua 1846 etj.</p></div></div>			
*Mësuesilja sqaron gjithashtu se çfarë është prologu në një tragjedi.			

Një nga pjesët kryesore të tragjedisë prologu (gr. prólogos – fjalë, të folur në fillim, parathënie),

**Ndërtimi i njohurive të reja:** *Pyetja sjell pyetjen*

Vendoset fragmenti për t' u dëgjuar nga nxënësit. Mësuesi/ja i udhëzon ata që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime për përgjigjet e pyetjeve.

**Përpikuni të mbani shënim përgjigjet e pyetjeve:**

**Për cilën ndeshje flitet? Cilat janë dy familjet që ndeshen me njëra-tjetrën?**

Autori e ka fjalën për takimin e dy të rinjve që u përkisnin dy familjeve më në zë në Veronë, Kapuletët dhe Montagët. Ata ushqenin një urrejtje të fortë për njëri-tjetrin.

**Si lindi dashuria midis dy të rinjve?**

Në fragment nuk na jepet vendi ku lind dashuria, por nga leximi i veprës mësojmë se dashuria lindi në një ballo me maska të organizuar nga Kapuletët.

**Pse rrezikohet ajo nga hasmëria?**

Dashuria rrezikohet nga hasmëria, sepse asnjë nga familjet nuk mund ta pranonte që kjo lidhje të ngrihej mbi këtë urrejtje të madhe.

**Çfarë paralajmëron vargu:** *“Kjo udhë e dashurisë ogursterre”*

Hasmëria e dy familjeve ishte kaq e madhe sa kish tronditur gjithë qytetin, jo vetëm familjet, ndaj dhe fundi i saj tragjik ishte i paralajmëruar.

*Pas dëgjimit*

**Përgjigjuni pyetjeve:**

**Cilët aktorë ju vijnë ndër mend kur dëgjoni këtë prolog?**

Ashtu si në tragjedinë antike greke një vend të rëndësishëm zinte kori i cili qortonte, këshillonte, rrëfen ngjarjen etj., dhe në këtë prolog këtë aktor na kujton.

**Renditni disa nga personazhet e kësaj tragjedie.**

Personazhe të tjerë:

Merkuti

Vaja

Fрати Laurens

Benvolio

**Si ju duket kërkesa për durim që kori i bën spektatorit? Po kërkesa për faljen e të metave që mund të ketë vepra?**

Kori te Sofokliu përfaqëson grupin e qytetarëve, të cilët shprehin mendimin e opinionit publik lidhur me atë që po ndodh. Ai në përgjithësi është mbartës i moralit dhe i botëkuptimit të kohës.

**Pse ju prekin detajet tragjike? Cilat janë disa prej tyre?**

Detajet tragjike na prekin pasi përballë tyre është vënë dashuria e madhe e dy të rinjve, dashuri e cila ngrihet mbi paragjykimet dhe urrejtjen e dy familjeve.

**Ç'elemente skenike bien në sy në këtë fragment? A e ndihmojnë ato dëgjuesin?**

Diskutojmë së bashku duke u këshilluar dhe me njohuritë e marra në lëndën e teatrit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Pauza treminutëshe*

**Për disa minuta nxënësit në dyshe do të diskutojnë së bashku.**

Diskutoni rreth normave shoqërore që pengojnë dashurinë e dy të rinjve.

Mësuesi/ja udhëzon të fokusohen të normat morale, fetare dhe shoqërore (nuk mund të kurorëzohet dashuria e të rinjve kur familjet urrejnë njëri-tjetrin).

Nxënësit shprehin sa më lirshëm mendimet e tyre. Listojnë normat shoqërore që pengojnë dashuritë dhe argumentojnë mendimet e tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për vëmendjen e kushtuar pjesës gjatë dëgjimit të saj.

**Detyrë shtëpie:** Luani në role pjesë nga vepra.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Ndikimi i internetit dhe librit ne zhvillimin e aftësive psikomotorë të nxënësve (ora 2)		Situata e të nxënësve: Seleksionimi i materialeve	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis</div> <div>- Kompetenca qytetare</div> <div>- Kompetenca digjitale</div>			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- diskuton për rëndësinë e librit të shkruar;</div><div>- analizon lidhjen midis internetit dhe librit të shkruar;</div><div>- diskuton për shfrytëzimin e kohës së lirë nga fëmijët;</div><div>- merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;</div><div>- përzgjedh materialet e duhura për produktet finale;</div><div>- bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim;</div><div>- drejton punën në grup;</div><div>- prezanton produktet e projektit.</div></div>		Fjalët kyçe: Internet Web Facebook Rrjete sociale Libër subjekt Mesazh	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënësve në bashkëpunim, bashkëbisedim			
Faza 2: <div><div><div><div></div><div>Përpunimi i materialeve</div></div><div><div></div><div>Krijimi i posterave</div></div><div><div></div><div>Krijimi i punimit në powerpoint</div></div><div><div></div><div>Krijimi i videos me mendime të nxënësve</div></div><div><div></div><div>Kërkimi në internet i shfrytëzimit të internetit në jetën e përditshme.</div></div><div><div></div><div>Krijimi i fletëpalosjeve dhe posterave ku shprehin mendimin e tyre për librin e shkruar dhe zhvillim psikomotor të nxënësve.</div></div><div><div></div><div>Krijimi i një videoje me mendimet e nxënësve në lidhje me internetin dhe librin.</div></div></div><div>Nxënësit punojnë sipas punës së caktuar.</div><div>Koordinatori i grupit është i vëmendshëm për punën që kryen secili nga anëtarët e grupit dhe bën vlerësimin e anëtarëve.</div><div>Vini re! Në këtë fazë nxënësit duhet të mbledhin materialin në “burim”, pranë institucioneve të ndryshme për të kryer intervista dhe pyetësorë minimaliste.</div></div>			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara.			



Puna për krijimin e kësaj vepre sipas Helena Kadaresë ka filluar pesëmbëdhjetë më parë nga ditarët e mbajtur prej saj në mënyrë josistematike, por me periudha. Që në fillim të veprës jepet lidhja e më pas njohja krejt rastësore me Ismail Kadarenë asoherë student në Moskë. Përmes kujtimeve para lexuesit vjen jeta e çiftit të shquar dhe vajzave të tyre para dhe pas rënies së komunizmin dhe largimin e tyre në Francë.

Kadareja ashtu siç rrëfen gruaja e tij (faqe 292), nuk e ka konsideruar veten kurrë as si një shkrimtar zyrtar e as si një shkrimtar disident, por thjesht, një shkrimtar. Kjo nuk është një piruetë e thjeshtë apo një formulë e shkathët. Kadare nuk e përdor kurrë këtë shprehje pa u thelluar. Ai ka një ide tepër të lartë për rolin e shkrimtarit në shoqëri. Ai e vendos shumë lart përgjegjësinë e këtij të fundit, dhe akoma më lart pushtetin e letërsisë.

Duke mos pasur kurrfarë dyshimi për vendin e tij personal në linjën e shkrimtarëve më të mëdhenj, Homer, Dante, Shekspir, Dostojevski, Ismail Kadare shfaq dukshëm njëkohësisht modestinë më të madhe dhe jomodestinë më të madhe, duke refuzuar, për shembull, pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri, që të merrte postin e Presidentit të Republikës. Atyre që ia propozuan këtë post, Kadare iu përgjigj, se ndihej i paafte për ushtrimin e këtij posti, sepse duke qenë shkrimtar, “është mësuar të punojë vetëm, pa dëgjuar e pa u këshilluar me askënd”. Shkurt, përfundon ai me një humor acid, që për të është i zakonshëm, “shkrimtari është detyrimisht i një natyre intolerante, pra, pak i pajtueshëm me demokracinë!”.

Rrëfyer nga Helena (faqe 205), kjo vërejtje thotë shumë për kompleksitetin e njeriut të jetës së saj.



**Personazhet që gjenden në libër nuk janë fiktivë, pra të krijuar nga shkrimtarja, por realë.**

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Pyetja sjell pyetjen

Të shkruarit e kujtimeve biografiqe ka gjithmonë dy gjendje: të atij që i shkruan dhe të atij për të cilin shkruhen ato. Pra, ka gjithmonë një emër dhe një ngjarje të vërtetë. Si qëndron raporti me të vërtetën në këtë fragment?

Po në rrëfim kemi ngjarje të vërtetë dhe jo trill, duke filluar nga emri i të madhit Kadare.

**Kujt personazhi dhe cilës ngjarjeje të vërtetë i kushtohet ky rrëfim?** Ismail Kadaresë dhe i kushtohet momentit kur Kadare i tregon së shoqes dorëshkrimin e tij të parë në prozë dhe frikën e saj nga përballja e mundshme me regjimin e kohës.

**Cilat mendoni se janë detaje të vërteta?** Cilat mendoni se janë trillime apo elemente subjektive të autorit?

**Ç'dëshmi të kohës kur ka ndodhur ngjarja sjell autorja këtu?** Përballja me regjimin e kohës, përballje e cila të humbiste ardhmërinë dhe jetën ndoshta.

**Kur kishte shkruar për herë të parë autori?** Shumë herët 11-12 vjeç

**Si i quan shkrimtari provat e para të të shkruarit?** Lodrat e fëmijërisë

**Nga e kuptoi ajo që ishte roman dhe që kishte të bënte me një vepër të vërtetë? Ç'detaje na sjell paragrafi i mëposhtëm?** E shfletova një copë herë dorëshkrimin, si për ta besuar se kisha vërtet në dorë një roman. Kapitulli i parë, kapitulli i shtatë, kapitulli i dhjetë. Faqja 131 e fundit dhe poshtë saj fjalët: “23 nëntor 1959. Moskë”.

Kompozicioni i jashtëm i veprës i ndarë në kapituj na bën me dije se kemi të bëjmë me një roman.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Diskutim

**Përshtetja e gjendjen emocionale të autores kur shihet për herë të parë dorëshkrimin. Pse trembet ajo? Çfarë e shtyn atë të mendojë negativisht për situatën, por pozitivisht për autorin?**

*Përgjigje e sugjeruar:*

Kur shihet për herë të parë dorëshkrimin ajo habitet, pasi ishte hera e parë që po e shihte atë. Ajo nuk dinte çfarë të mendonte. Pse Ismaili e kishte mbajtur të fshehur kaq vite këtë dorëshkrim? Pas bisedës me të që romanin nuk duhej ta shihte dhe ta dinte kush, ajo u turbullua akoma më shumë. Para saj qëndronte një dorëshkrim i rrezikshëm. Pra, situata ishte kritike, por Ismaili kishte pasur kurajën që e kishte shkruar dhe që nuk e kishte grisur po e ruante si për t'i kujtuar kohën e frikshme në të cilën po jetonte...

Nxënësit diskutojnë dhe japin mendimet e tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të kuptuarit e tekstit, për analizën e tij etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Kohë e pamjaftueshme (Ora 2)		Situata e të nxënit: <u>Koha e pamjaftueshme</u> S’kam kohë të harroj shumë gjëra Që nga mendja t’i nxjerr përjetë. Për tragjikët e vjetër e shkreptëtimat Do t’më duhen së paku dy vjet. Dhe ndoshta po aq për Danten, Për frëngjishten tok me plazhet po aq, Ndoshta gratë do të jem duke fshirë Kur muzgu do të afrohet ndërkaq. Si udhëtari me peshë të tepërt Para avionit që niset pas pak I ngarkuar rëndshëm ende Do t’afrohem tek varri humbak. Nga supet si ta heq këtë barrë? Ku ta hedh këtë peshë, si? Me të s’mund të zbres atje poshtë Por as lart dot s’e lë kurrësi. I menduar gjer në çast të fundit Nga mosthënia, nga pengu tragjik, Një shenjë ndoshta të pakuptueshme Do t’ju bëj të gjithëve e do ik.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për jetën dhe krijimtarinë letrare të Helena Kadaresë;</li><li>- rrëfen ngjarjen duke u mbështetur në detaje;</li><li>- përshkruan gjendjen emocionale të Helenës kur merr vesh “sekretin” e Kadaresë;</li><li>- zbulon tiparet e gjuhës me të cilën rrëfëhet.</li></ul>		Fjalët kyçe: Rrëfim Elemente realiste Gjendje shpirtërore Realitet i hidhur	
Burimet: Libri i nxënësit, romani “Kohë e pamjaftueshme”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diagram Veni, Ditari dypjesësh, Tabela M, Diskutim Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diagram Veni Nga dallojnë dy familjet, ajo e autores dhe ajo e Kadaresë? Plotësoni skemën e mëposhtme.			
<div><div><div>Familja e autores</div><div>E kujdesshme</div><div>E mbyllur</div></div><div><div>Familja e Kadaresë</div><div>E vjetër</div><div>Donkishoteske – e larguar nga realiteti</div><div>E çuditshme</div></div></div>			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Ditari dypjesësh

**Përgjigjuni pyetjeve**

<i>Si shfaqet Kadareja në sytë e autores?</i>	Misterioz, nuk e kishte treguar “të fshehtë” e tij, i zoti për të shkruar një roman, megjithëse në moshë të vogël etj.
<i>Si shfaqet Kadareja në sytë e lexuesit?</i>	Shfaqet një njeri i qetë, me autokontroll, aspak i trishtuar që romani i tij i parë nuk e kishte parë dritën e botimit etj.
<i>Si shfaqet autorja në sytë e lexuesit?</i>	E frikësuar nga përballja e mundshme me regjimin e kohës etj.

**Përcaktoni tiparet e gjuhës së këtij fragmenti, pasi t’u përgjigjeni kërkesave të mëposhtme. Ndaluni në shprehjet: shtëpi donkishoteske; familje e çuditshme dhe shpjegoni rolin përcaktues të fjalëve të dyta. Donkishoteske.**

E çuditshme përcaktorët e shprehur me mbiemra karakterizojnë familjen e Kadaresë, një familje e cila ishte jashtë normalitetit siç thotë dhe Ismaili në një intervistë, sepse derisa çdo shtëpi kishte doket e saj, prirja për të respektuar një traditë, gërshetohej me prirjen për ta thyer atë.

Një familje ku bashkëshortët ishin të çuditshëm. Babai që nuk tregonte asgjë, megjithëse punonte në gjyqe dhe nëna e cila ishte shumë kurioze të mësonte se çfarë bëhej në to.

**Ç’nënkupton autorja me shprehjen frazeologjike: Unë i shqeva sytë nga habia?**

Nënkupton frikën nga regjimi. Për çdo fjalë të thënë kundër regjimit dihej mirë fati i atij që e kishte thënë e jo më të shkruaje një roman të rrezikshëm, nga ata të ndaluarit. Dihej se çfarë të priste.

**Cilat janë fjalët që e tronditin atë? “se mos e tregoni këtë gjë?” “se mos e flisni me njeri këtë që dëgjuar”?**

**Gjeni një sinonim për fjalën *apartment-hyrje-shtëpi*.**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Tabela M - Diskutim

**Plotësoni tabelën dhe diskutoni.**

Çfarë dinit më parë për Ismail Kadarenë?	Çfarë mësuat nga ky fragment për të?	Çfarë doni të dini më tepër për autorin?
Shkrimtar	Mësuam për dorëshkrimin e rrezikshëm.	Jeta e tij si student në Moskë.
Shkroi që 12 vjeç vjershën e parë.	Familjen e tij paksa të çuditshme	Për Çmimin Nobel që ende nuk po i akordohet, megjithëse është nominuar disa herë.
		Kishte lidhje me diktatorin Hoxha? Sa herë e kishte takuar atë gjatë jetës së tij?

**Diskutojmë së bashku me nxënësit.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të kuptuarit e tekstit, për analizën e tij etj.

**Detyrë:** Kërkoni në librari ose bibliotekë librin “Kohë e pamjaftueshme” dhe lexoni e diskutoni momente të tjera të përshkruara nga autorja.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali		Situata e të nxënit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca qytetare</div>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- dallon funksionet sintaksore të fjalëve në një fjali;</div><div>- shpjegon gabimet drejtshkrimore dhe sintaksore në një fjali;</div><div>- argumenton gjymtyrët drejtuese e të varura në një fjali;</div><div>- ndërton fjali ku e njëjta fjalë del në funksione të ndryshme.</div></div>		Fjalët kyçe: Fjali Funksion gramatikor Gjymtyrë drejtuese Gjymtyrë e varur	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje-përgjigje, INSERT, Punë në dyshe			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit			
Ç`kuptoni me fjali?			
Njësi tërësore e ligjëritimit,e cila përbëhet nga një varg fjalësh ose nga një fjalë e vetme të formësuar e të lidhura gramatikisht sipas ligjeve të një gjuhe të caktuar.			
Fjalja është mjeti kryesor për formimin, shprehjen e kumtimin e mendimit.			
Cila prej fjalive është e saktë? Pse?			
Krahasoni variantet e gabuara: ç'i dallon ato prej njëri-tjetrit?			
Argumentoni përgjigjet tuaja.			
a) Të hënë, nxënësit e takuan shkrimtarin në studion e tij.			
b) E hëna, nxënësit e takuam shkrimtari në studios të tij.			
c) Te henen, nxenësit e takuan shkrimëtarin në studion e tijë.			
d) Shkrimtarin, nxënësit e takuan të hënë në studion e tij.			
Fjala në vetvete nuk mbart ndonjë funksion sintaksor, por e fiton atë, falë lidhjes që realizon me fjalën drejtuese.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela INSERT			
Nxënësit do të punojnë me tabelën INSERT.			
Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të plotësojnë tabelën.			

<i>V</i>	+	-----	?
Lidhja e fjalëve në fjali bëhet në bazë të rregullave të caktuara gramatikore.	Fjalët mund të luajnë rol drejtues, ose të jenë të varura. Fjalët luajnë rol drejtues, kur u caktojnë fjalëve të tjera formën e shprehjes dhe rolin e tyre në fjali.  Fjala në vetvete nuk mbart ndonjë funksion sintaksor, por e fiton atë, falë lidhjes që realizon me fjalën drejtuese		

Nxënësit punojnë për të plotësuar tabelën e më pas ato diskutojnë së bashku me mësuesin/en për çdo paqartësi që mund të kenë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Analizoni shembujt e mëposhtëm. Shpjegoni gabimet dhe klasifikojini ato sipas tabelës së dhënë.**

Ndarja e mbetjeve ndihmojnë mrojtjen e mjedisit.

Ndaria e mbetjeve ndihmonë mrojtien e miedisit.

Ndarja ndihmon e mbetjeve mbrojtjen e mjedisit.

E ndihmon mbrojtjen e mjedisit, ndarja e mbetjeve.

<i>Fjalë me gabime drejtshkrimore</i>	<i>Grup fjalësh pa lidhje sintaksore</i>
<i>Ndaria e mbetjeve ndihmonë mrojtien e miedisit</i>	<i>Ndarja ndihmon e mbetjeve mbrojtjen e mjedisit</i>
	<i>Ndarja e mbetjeve ndihmojnë mrojtjen e mjedisit.</i>

**Cilat fjalë dalin si gjymtyrë të varura dhe drejtuese. Argumentoni përgjigjen tuaj.**

Prerja e pemëve dëmton rëndë mjedisin tonë

**Ndërtoni pesë fjali, ku fjala “rrugë” të dalë si:**

Kryefjalë: Rruga jote qoftë e bardhë more djalë!

Kundrinor i drejtë: Kujdes kur kalon rrugën! I lau rrugët me lot!

Kundrinor i zhdrejtë: Rrugës së lagjes sime u vu emri i një këngëtarit të njohur.

Rrethanor: E prisja çdo ditë në rrugën ku ajo kalonte.

Përcaktor: Kanë vesh dhe gurët e rrugës. E morën vesh dhe gurët e rrugës.

**Diskutohen ushtrimet në dyshe**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e funksioneve të fjalëve në një fjali, për përfaqësimin e tyre gjatë orës së mësimi etj.

**Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 4 fq. 219 jepet detyrë shtëpie.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të dëgjuarit</b> <b>Tema mësimore: Tekstet biografike dhe me kujtime</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=RSFESIS9RrM">https://www.youtube.com/watch?v=RSFESIS9RrM</a> Në videoprojektor shikohen sekuenca nga filmi dokumentar për Ismail Kadarenë <i>Ose</i> Mësuesi/ja ua jep detyrë nxënësve një orë më parë të hulumtojnë rreth shkrimtarit të madh e më pas diskutohet për jetën dhe veprën e Kadaresë.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- dëgjon në mënyrë kritike informacionin që i paraqitet;</li><li>- jep gjykime rreth veprave biografike dhe atyre me kujtime;</li><li>- diskuton rreth jetës së Kadaresë, duke u mbështetur në librin me kujtime të Helena Kadaresë</li><li>- Diskuton rreth detajeve në rrëfimin e Helena Kadaresë</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Tekst biografik Libër me kujtime Mbresa Emocione	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, <a href="https://www.youtube.com/watch?v=RSFESIS9RrM">https://www.youtube.com/watch?v=RSFESIS9RrM</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte, tik	
<b>etodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Pyetja sjell pyetjen, Reflekt/Reflekt/Reflekt			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Diskutim Të shkruarit e kujtimeve biografike ka gjithmonë dy gjendje: Të atij që i shkruan dhe të atij për të cilin shkruhen ato. Pra, ka gjithmonë një emër dhe një ngjarje të vërtetë. Të shkruash një biografi duhet ta njohësh mirë personin të cilit i referohesh, të kesh të dhëna të sakta për veprimtarinë e tij. Mësuesi/ja në këtë fazë nxit nxënësit të japin mendimet e tyre për tekstet biografike. Pyetje sugjeruese: Çfarë është sipas jush një tekst autobiografik? Çfarë karakteristikash ka? Thoni një vepër që do ta klasifikonit si tekst me kujtime. Çfarë karakteristikash ka teksti i kujtimeve nga ai autobiografik? <i>*Nxënësit diskutojnë rreth kësaj tematike.</i>			

(Informacion ndihmës)



“Jetë me kujtime” titullohet libri më i fundit i historianit Arben Puto, në të cilin ai rrëfen fëmijërinë, rininë dhe mandej karrierën. Në të kanë zënë vend edhe miqtë e tij në kohë të ndryshme, studimet në Gjirokastrë, Korçë, e më pas në Itali dhe Bashkimin Sovjetik.

*\*Shikoni fotografitë që janë marrë nga libri me kujtime i Helena Kadaresë, i cili i kushtohet shkrimtarit Ismail Kadare.*

*\*Diskutoni rreth tyre duke imagjinuar rrjedhën e jetës së autorit.*

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Pyetja sjell pyetjen

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

**Shprehni mendimin tuaj për kontributet që jep familja me praninë e saj në ecurinë e një shkrimtari apo në krijimin e një vepre artistike.**

- Familja e mbështet shkrimtarin emocionalisht.
- Financiarisht
- Është burim frymëzimi, pasi çdo element i jetës është motiv për një vepër të madhe.

**Mendoni se jeta e shkrimtarit është një jetë që ndërthuret me vështirësitë që të vënë para zgjedhjeve të ndryshme, por edhe të japin kënaqësi? Argumentoni përgjigjen tuaj.**

*N.q.s do të japi kënaqësi:*

- Të jep famë.
- Të jep të holla (nga shitja e librave).

*Para zgjedhjeve të vështira*

- Të shprehurit shumë nga vetja
- Përballja me mendimin e turmës
- Është gjithmonë i paragjykuar

*Bëjini një pyetje shokut ose shoqes suaj rreth veprës së Kadaresë.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Reflekto/Reflekto/Reflekto*

Dëgjoni pjesët e zgjedhura nga libri me kujtime i Helena Kadaresë dhe diskutoni rreth pyetjeve të mëposhtme.

Çfarë emocioneesh ju shkaktojnë pjesët e përzgjedhura dhe tematikat për autorin dhe veprën e tij?

Si vjen përmasa e Kadaresë përmes tyre? Po profili i autores?

Ç’lloj ligjërimi ka përdorur autorja?

Sa të rëndësishme janë detajet në rrëfimin e saj? Po emrat, datat dhe vendet?

Çfarë ju tërheq më tepër te Kadare? Sa ndikoheni nga qëndrimi i autores së këtij teksti?

Do dëshironit që të kishit të njëjtën histori jetësore.

**Diskutojmë së bashku:** Nxënësit japin vlerësimin e tyre pas të dëgjuarit e vëmendshëm të pjesëve të zgjedhura nga libri i Helena Kadaresë. Ata vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore: Ndikimi i internetit dhe librit në zhvillimin e aftësive psikomotore të nxënësve (ora 3)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Prezantimi i materialit	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për rëndësinë e librit të shkruar;</li><li>- analizon lidhjen midis internetit dhe librit të shkruar;</li><li>- diskuton për shfrytëzimin e kohës së lirë nga fëmijët;</li><li>- merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;</li><li>- përzgjedh materialet e duhura për produktet finale;</li><li>- bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim;</li><li>- drejton punën në grup;</li><li>- prezanton produktet e projektit.</li></ul>		Fjalët kyçe: Internet Web Facebook Rrjete sociale Libër Subjekt Mesazh	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> tik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Të nxënësve në bashkëpunim, Bashkëbisedim Faza 3: Aktivitetet në të cilin nxënësit prezantojnë rezultatet e punës së tyre si prezantime, tabela dhe albume. <b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Në këtë fazë do të vlerësohen nxënësit. Mësuesi/ja duhet të jetë transparente në vlerësim, po kështu dhe pjesëtarët e grupit me njëri-tjetrin. Më poshtë do t`ju sugjerojmë mbajtjen e disa evidencave në secilën prej orëve të projektit, evidenca që do t`jua lehtësojnë vlerësimin e nxënësve dhe ata do të jenë më të qartë me veten. Tabelat përmbajnë kriteret për vlerësim, të cilat u bëhen me dije nxënësve me fillimin e vitit shkollor.			

Plotësimi i kriterëve për vlerësim  
Monitorimi i zbatimit të detyrave

### Grupi 1

	Detyrat	Personat përgjegjës	Afati	Komente
<b>Planifikuar</b>	Diskutimi i ideve dhe mendimeve për përgatitjen e prezantimit teknologjisë si koncept.		05.12.2016	Nxënësit dhanë ide interesante dhe bashkëpunuan për realizimin e tyre.
<b>Realizuar</b>	+		05.12.2016	
<b>Planifikuar</b>	Punë në klasë		06.12.2016	Punë me fletëpalosje, vizatime
<b>Realizuar</b>	+		05.12.2016	
<b>Planifikuar</b>	Përgatitja dhe hedhja e të dhënave në një tabelë dhe ndërtimi i posterave dhe albumeve apo dosjeve të punës.		06.12.2016	Krijimi i posterave për teknologjinë në shërbim të njerëzimit
<b>Realizuar</b>	+			
<b>Planifikuar</b>	Prezantimi i produktit		09.12.2016	Prezantim i suksesshëm i punimeve duke shfaqur në mënyrë të qartë e koncize të gjitha llojet e përgatitjeve të bëra.
<b>Realizuar</b>	+		09.12.2016	

Fletë vlerësimi për menaxhimin individual të kohës (Vlerësimi në pikë)

### Dita 1

Vini re ! Fletë vlerësim plotësohet për secilën ditë të projektit!

	Kriteret Nxënësit	Kohën e shfrytëzon në mënyrë racionale	Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të grupit	Kryen detyrat në kohë	Vlerësimi ditor
1	Luiza Myrtaj	10	10	10	10
2	X Y	10	10	10	10
3	Ervin Z	10	10	10	10
4	Ervisa B	9	8	9	9
5	Esilda M	9	9	8	9
6	Drin C	9	9	8	9

Fletë vlerësimi për bashkëpunimin brenda grupit (Vlerësimi në pikë)

### Dita 1

	Kriteret Nxënësit	Anëtarët e grupit e ndihmojnë njëri-tjetrin	Të gjithë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në realizimin e projektit	Vlerësimi
25	Frenki Gj	10	10	10
26	Gabriel L	9	10	10

***U komunikohet dhe argumentohet vlerësimi nxënësve, pas prezantimit.***

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha:	Lënda:	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Të lexuarit “Thuaj zemrës PO”		Situata e të nxënësve: Diskutim; ‘Lufta’ mes brezave në një familje Familja e Tomit është një familje e madhe. Ata jetojnë së bashku, dy prindërit e Tomit, motra dhe vëllai i tij, gjyshja dhe gjyshi nga babai dhe xhaxhai i tij që sapo është martuar. Mes brezash lindin debate nga më të ndryshme të cilat acarohen nga këndvështrimi i ndryshëm i problemeve. Megjithatë pjesëtarët e kësaj familjeje të madhe e duan fort njëri-tjetrin.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton për luftën e mendimeve midis brezave;</li><li>- portretizon bukur figurën e gjyshes;</li><li>- zbulon mesazhet që përcjell pjesa;</li><li>- analizon veçoritë gjuhësore të tekstit;</li><li>- argumenton strukturën e ditarit në fragmentin e dhënë.</li></ul>		Fjalët kyçe: Ditar Gjyshe Konflikt brezash Kujtime Këshilla të mençura	
Burimet: Teksti shkollor i gjuhës, romani “Thuaj zemrës PO”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikular: edukatë shoqërore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Imagjinatë e drejtuar, Tabela INSERT, Rrjet diskutimi Dy fjalë për autoren			
Susanna Tamaro ka lindur në Trieste në 1957-ën, ka studiuar në Qendrën Eksperimentale të Kinematografisë, në regjisorë. Për dhjetë vjet ka punuar për televizionin, dhe ka realizuar dokumentarë shkencorë. Është njëra nga shkrimtaret italiane më të njohura dhe të dashura në mbarë botën. Ka botuar romane për të rritur me një sukses të jashtëzakonshëm publik: “Koka në re” (1989), “Vetëm me zë” (1991), “Thuaj zemrës po” (1994), “Shpirti i botës” (1997), “E dashur Matildë” (2001), “Përgjigjmu” (2001), “Më shumë zjarr, më shumë erë” (2002), “Jashtë!” (2003), “Dëgjoje zërin tim” (2006), “Luisitoja” (2008). Romani i saj më i famshëm, “Thuaj zemrës po”, përveçse ka shitur 15 milionë kopje në mbarë botën. Gjatë kësaj faze, nxënësit reflektojnë për titullin dhe imagjinojnë ngjarjen mbi të cilën është ndërtuar ky libër.			
<div><div>Skeda e librit</div><div>Titulli: Thuaj zemrës po Origjinali: Vá dove ti porta il cuore Gjinia: Roman Autori: Susanna Tamaro Shqipëroi: Dritan Çela Shtëpia botuese: Çabej Viti: 2005 Fq. 136 Pesha: 0.15 kg ISBN: 978-99927-33-47-0</div></div>			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Tabela INSERT			
+ (Informacioni që shtohet)	V (Informacioni që dihet/njihet nga nx)	--- (Inf që njihet, por gabim)	? (Informacioni i panjohur)

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

*Nxënësit punojnë në dyshe rubrikat*

**Kuptojmë tekstin**

**Pasi të lexoni pjesën e shkëputur nga ditari, përgjigjuni pyetjeve:**

**Ku ndodhet mbesa, ndërsa gjyshja i drejtohet nëpërmjet ditarit të saj?**

Mbesa kur gjyshja mban ditarin e saj ndodhet në vendet e largëta të Afrikës.

**A shpreson gjyshja se një ditë e mbesa do ta kuptojë atë?**

Megjithëse mund të ketë kaluar shumë kohë kur mbesa do ta kuptojë gjyshen, por në fund do ta kuptojë.

**Kur do të ndodhë kjo?**

*“Ndoshta do të më kuptosh vetëm në tjetër moshë, do të më kuptosh po ta kesh bërë atë udhën e misterhme që, nga papajtueshmëria, të çon te mëshira”*

**Si ka qenë marrëdhënia e tyre në të shkuarën?** Jo shumë e mirë.

*“Nuk ma merr mendja, ndoshta vetëm të kanë acaruar, kanë vërtetuar mendimin shumë të keq që kishe për mua para se të niseshe.”*

**Cilat janë këshillat e gjyshes?**

Të luftosh për një ide, pa pasur një ide për veten, është një prej gjërave më të rrezikshme që mund të bëhen.

Çdo herë që do të ndihesh e përhumbur, e pështjelluar, mendo për pemët, sill në mend mënyrën se si rriten ato.

E ku, mandej, para teje të hapen sa e sa rrugë dhe ti nuk do të dish cilën të marrësh, mos iu fut njëres kuturu, por ulu dhe prit etj.

**Analizojmë tekstin** *Nxënësit do të punojnë me teknikën “Shkrimi i lirë”*

**Portretizoni me fjalët tuaja figurën e gjyshes.**

**Gjeni në tekst fjalitë në të cilat përdoret humori. Çfarë zbulon kjo mënyrë rrëfimi lidhur me personazhin?**

**Ç’veçori ka hyrja dhe mbyllja e këtij teksti?**

**Shëno me + idenë që del nga fjalja:** *“Te mëshira, dëgjon, jo te brenga”.*

+ Keqardhja e bën njeriun të ndjeshëm dhe të arsyeshëm.

Një njeri i brengosur arsyeton drejt.

Brenga dhe mëshira janë ndjesi të ndryshme.

Ai që mëshiron, ndihet i brengosur.

***Gjuha e tekstit***

**Analizoni këto veçori gjuhësore të këtij teksti:**

a. Llojet e fjalive më të përdorura;

b. kohën më të përdorur të foljeve.

**Nënvizoni ato fraza në të cilat gjuha e autorit bëhet e figurshme.**

Nëse do të ndiesh brengë, do të zbres posi ata xhindët e ligj e do të të punoj një mijë rrengje. Të njëjtën gjë do të bëj nëse, në vend që të jesh e përlulur dhe modeste, do të mburresh me gjepura boshe, në vend që të heshtësh. Do të plasim llambushkat, pjatat do të fluturojnë nga sergjenet, nga agimi deri natën vonë nuk do të lë as edhe për një çast të qetë.

Rrënjët dhe gjethnaja duhet të rriten barabar, duhet t’u hysh gjërave nga brenda e të jesh sipër tyre, vetëm kështu mund të ofrosh hije dhe strehë, vetëm kështu në stinën e duhur mund të mbuloresh me lule e fryte.

**Përcaktoni tri figura letrare të përdorura në tekst (të ndryshme nga njëra-tjetra).**

Krahasim: Nëse do të ndiesh brengë, do të zbres posi ata xhindët e ligj e do të të punoj një mijë rrengje.

Metaforë: Rri pa lëvizur, hesht, dhe dëgjo zemrën tënde.

Te mëshira, dëgjon, jo te brenga.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Rrjet diskutimi*

***Reflektojmë rreth tekstit***

**Si i kuptoni fjalët e gjyshes në paragrafin e fundit? Zgjeroni me fjalët tuaja.**

E ku, mandej, para teje të hapen sa e sa rrugë dhe ti nuk do të dish cilën të marrësh, mos iu fut njëres kuturu, por ulu dhe prit. Merr frymë thellë e plot besim, ashtu si ke marrë frymë ditën kur ke ardhur në këtë botë, pa u hutuar nga asgjë, prit e prit akoma. Rri pa lëvizur, hesht, dhe dëgjo zemrën tënde. Mandej, kur të të flasë, ngrihu dhe shko ku të shpie ajo.

Këshilla shumë të vyera nga gjyshja për mbesën e saj .Nëse do të bëjmë analogji krahasojmë këto këshilla ne poezinë “Lum, lumi” të Ali Podrimës:

*Ti mëso të duash vogëlush.*

*Ti mëso të ecësh me këmbët e tua*

*mbi të kegen mbi të mirën, mendo me kokën tënde*

*kurrë mos pështyj në dashuri, as në pleh;*

*Mallkim i fisit.*

*Shkolla jote antike; të dish të çelësh derën e shtëpisë*

*Në çdo kohë,*

*Të dish të thuash fjalën kur duhet thënë.*

*Urrejtja është më e rëndë se vrasja.*

**Shkruani tri ide të cilat ju mbeten në mendje pas leximit të këtij ditari. Diskutoni në grup rreth tyre dhe vlerësoni arsyetimet e njëri-tjetrit.**

*Mendohu para se të marrësh vendime!*

*Beso te vetja dhe mos u tërhiq para vështirësive!*

*Revolucioni i parë që duhet bërë është ai brenda vetes!*

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe diskutojnë rreth tyre.

**Vlerësimi:** Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një fletë ditari drejtuar gjyshes apo një njeriu të dashur të familjes suaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Të bëjmë përpara</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> <b>Diskutim: Si të përballemi me vështirësitë</b> Genti duhej të konkurronte në një konkurs pikturë që do të zhvillohej midis shkollave 9-vjeçare të qytetit të tij. Për të bërë pikturën i duheshin telajo, bojëra, penelë, këmbalec dhe shumë mjete të tjera, të cilat nuk mund t'i siguronte për shkak se familja e tij ndodhej në vështirësi ekonomike. Dëshira ishte e madhe, po mundësitë shumë të pakta. Ai mendonte të punonte te një komshi i tij për të siguruar të hollat që i duheshin, por ishte i vogël për punë. E diskutoi këtë problem me mësuesin/en e klasës. Ajo i përforcoi atij faktin se nuk duhej të tërhiqej nga konkurrimi. Ajo do të bënte të pamundurën së bashku me prindërit e klasës që dëshira e Gentit të bëhej realitet.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon elementet e një shkrimi biografik;</li><li>- diskuton rreth jetës dhe aktivitetit të Sheryl Sandberg-ut;</li><li>- analizon karakteristikat gjuhësore të këtij lloj teksti;</li><li>- zëvendëson fjalët e huaja me gjegjëset shqipe.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Autobiografi Karrierë Profesion Vështirësi Besimi në vetvete	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, libri, internet		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> tik	

<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Parashikim me anë të titullit, Të nxënët në bashkëpunim, Rrjet diskutimi</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Parashikim me anë të titullit, lexim zinxhir.</p> <p>U kërkohet nxënësve të bëjnë parashikim të asaj që do të lexojnë duke u nisur nga titulli “Të bëjmë përpara”.</p> <p><b>Pas leximit të pjesës, do të ballafaqojmë parashikimin e tyre me atë që lexuan.</b></p> <p><i>*Nxënësit fillojnë e lexojnë zinxhir pjesën. U tërhiqet vëmendja që gjatë leximit të respektojnë shenjat e pikësimit dhe të kujdesen për artikullim të qartë e të saktë të fjalëve.</i></p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënët në bashkëpunim</p> <p>Fillojmë dhe punojmë rubrikat në tekst duke ndarë klasën në grupe.</p> <p>Pasi të lexoni pjesën, përgjigjuni pyetjeve:</p> <p><b>Cila është rruga që ka ndjekur autorja për të ndërtuar karrierën e saj?</b></p> <p>Një rrugë e gjatë, e mundimshme duke qenë e megjullt për drejtimin që do të merrte e ardhmja e saj.</p> <p><b>Si kanë rezultuar përpjekjet e para të autores?</b></p> <p>Përpjekjet e para kanë rezultuar të pasuksesshme.</p> <p><b>Çfarë ka ndikuar te prindërit e saj për të vendosur drejtimin që kanë ndjekur në karrierat e tyre?</b></p> <p>Dëshira për të ndihmuar sadopak njerëzit në vështirësi dhe dhimbje.</p> <p><b>Si ka ndikuar modeli i prindërve në formimin e autores?</b></p> <p>Gjatë gjithë kohës, prindërit i thoshin të bënte një jetë kuptimplote duke u përqendruar te ndihma që duhej t’u jepte të tjerëve, ajo këtë gjë bëri.</p> <p><b>Cila ka qenë ëndrra e saj e hershme lidhur me profesionin?</b></p> <p>Të punonte në ndonjë organizatë jofitimprurëse ose në qeveri.</p> <p><b>Cili është këndvështrimi i autores lidhur me planifikimin e karrierës?</b></p> <p>Autorja nuk beson në planifikimin e karrierës, por beson në ëndrrat dhe qëllimet afatgjata dhe specifike të njeriut.</p> <p>Ndaj klasën në grupe dhe shpërndaj temat që do të diskutojnë më pas.</p> <p><b>Grupi 1.</b> Pse autorja e përcakton karrierën e saj me thënien: “kërcimi degë më degë”?</p> <p><b>Grupi 2.</b> Gjeni në tekst:</p> <p><i>Një fakt:</i> Gjithashtu, në atë kohë nuk isha shumë e dhënë pas teknologjisë. E përdora sistemin kompjuterik të Harvardit vetëm një herë. Kur u përpoqa të kryeja përlllogaritjet e mia të fundit, dogja gjithë sistemin.</p> <p><i>Një opinion:</i> E, ndërsa vërtet nuk besoj në planifikimin e detajuar të karrierës, besoj thellësisht në një ëndërr apo në një qëllim afatgjatë. Një ëndërr afatgjatë nuk ka pse të jetë realiste apo edhe specifike. Mund të jetë pasqyrim i dëshirës për të punuar në një fushë të caktuar apo për të udhëhequr nëpër botë</p> <p>një citim: Një nga shprehjet e mia më të preferuara është ajo e autores Alis Uoker, e cila thotë: “Arsyeja më e zakonshme për të cilën njerëzit heqin dorë nga pushteti i tyre, është mendimi se janë të pafuqishëm”.</p> <p><i>Një shembull:</i> Edhe po të doja, do të ishte e pamundur ta vizatoja kurbën e ecurisë së karrierës sime. Si fillim, Mark Zukerbergu ishte vetëm 7 vjeç kur unë u diplomova në universitet.</p> <p><b>Grupi 3.</b></p> <p>Ç’karakteristika gjuhësore ka paragrafi i fundit?</p> <p>Plotësoni: kohët foljore të përdorura:</p> <p>mënyra foljore e përdorur:</p> <p>lloji i fjalive të përdorura:</p> <p>figuralshmëria e përdorur:</p> <p><b>Grupi 4.</b> Zëvendësoni fjalën me shkronja të zeza me një fjalë tjetër, duke ruajtur kuptimin e fjalisë. “Njësoj si ajo kurora, mund të mos <b>materializohet</b> kurrë. E, për më tepër, ç’e do kurorën kur je duke u ngjitur nëpër degë?”</p> <p><b>Grupi 5.</b> Cilat janë qëllimet tuaja kryesore në jetë? Renditini ato, sipas vlerës që kanë për ju, duke argumentuar zgjedhjen tuaj në secilin rast.</p>
--

**Grupi 6.** Cilat mendoni se janë gabimet që kryejnë njerëzit në përpjekjet e tyre drejt suksesit personal? Sillni shembuj të ndryshëm dhe komentojini ata.

tërheqja përpara vështirësive;

humbja e besimit në vetvete etj.

**Grupi 7.** Gjej në tekst fjalët e huaja, zëvendësojini ato me gjeqjësset shqipe dhe formo fjali me to

inkurajuese - nxitëse, motivuese

Sfidoj - konkurroj pa frikë dikë më të fortë

U diagnostikua - përcaktoi sëmundjen ose shkakun

fleksibilitet - zhdërvjelltësi, shkathtësi

kurbë - ecuri

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjet diskutimi**

Komentoni dhe jepni vlerësimin tuaj për këtë këshillë të dhënë nga Henri Ford, themeluesi i motorëve Ford:

“Dështimi është thjesht një mundësi për të filluar përsëri, këtë herë me më shumë zgjuars.”

A jeni dakord me këtë thënie?

Dakordësinë apo jodakordësinë, nxënësit do ta shprehin duke u ardhur në ndihmë teknika “Rrjeti i diskutimit. Klasa do të ndahet në grupe që janë pro thënies dhe kundër asaj.

**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna.

**Detyrë shtëpie:**

Megjithëse suksesi mund të arrihet, nuk është diçka që vjen lehtë. Ka shumë këshilla dhe strategji rreth asaj se si të bëhemi të suksesshëm në jetë, mirëpo mënyra më e mirë për të pasur sukses është të ndjekim hapat e atyre që janë të tillë. Gjeni dhe shkruani 10 këshilla për suksesin, nga disa prej njerëzve më të suksesshëm dhe të njohur në botë.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Llojet e kallëzuesit emëror dhe foljor		<b>Situata e të nxënit</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon kallëzuesin emëror nga ai foljor;</li><li>- dallon kallëzuesin foljor të thjeshtë e të përbërë;</li><li>- ndërton fjali me kallëzues emëror dhe foljor.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Kallëzues Gjymtyrë kryesore e fjalisë Kallëzues emëror Kallëzues foljor i thjeshtë Kallëzues foljor i përbërë Folja jam	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** DI, DUA TË DI, MËSOVA -DDM

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Di

\*Mësuesilja udhëzon nxënësit të plotësojnë tabelën, fillimisht me ato që ata dinë për kallëzuesin.

Di	Dua të di	Mësova
Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon një veprim apo një gjendje të kryefjalës.  Pyetjet për të gjetur kallëzuesin janë: ç`bën? ç`do bëjë? ç`ka bërë? ç`është?		
Kallëzuesi është emëror dhe foljor.		

**Ndërtimi i njohurive të reja:** DDM

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë në dyshe rreth njohurive të dhëna në tekst

Më pas, në fazën e tretë të plotësojnë rubrikën “Mësova”.

Di	Dua të di	Mësova
Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon një veprim apo një gjendje të kryefjalës.  Kallëzuesi shërben si qendër organizuese e fjalisë.  Rreth tij bashkohen të gjitha gjymtyrët e tjera, pavarësisht pozicionit të tyre në fjali.	Si formohet kallëzuesi emëror?	
Kallëzuesi është emëror dhe foljor	Sa lloj e kemi kallëzuesin foljor?	

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: DDM, Punë e pavarur**

Di	Dua të di	Mësova
Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon një veprim apo një gjendje të kryefjalës.	Si formohet kallëzuesi emëror?	Kallëzuesi emëror formohet nga këpuja “jam” + një mbiemër, emër, përemër, numëror, grup fjalësh etj.  Nata ishte e qetë Kallëzues emëror folja jam + mbiemër. Nata ishte pus. Nata ishte pa hënë Kallëzues emëror jam + emër
Kallëzuesi është emëror dhe foljor	Sa lloj e kemi kallëzuesin foljor?	Kallëzues foljor:  I thjeshtë - Shprehet me forma foljore të ndryshme  I përbërë - Formohet nga dy folje ku e para tregon mënyrën e veprimit dhe e dyta vetë veprimin.  Fillim veprimi: Filloi të flasë. Vazhdim veprimi: Vazhdonte të fliste. Mbarim veprimi: Pushoi së foluri.  Formohet nga dy folje ku e para tregon mënyrën e kryerjes së veprimit dhe e dyta vetë veprimin.  Domosdoshmëri: Duhet të flasim.  Mundësi: Mund të flasim.

Pasi plotësohet tabela, punohet ushtrimi 1-2 në mënyrë të pavarur.

**Dalloni kallëzuesit dhe nënvizoni fjalët që varen prej tij. Ktheni kallëzuesit e mësipërm në kallëzues të përbërë dhe formoni fjali me ta.**

Ardhja e pranverës *i gëzon* të gjithë.

Ardhja e pranverës *nisi t`i gëzonte* të gjithë.

Karakteret e forta nuk *i përkul* asgjë.

Karakteret e forta nuk *mund t`i përkul* asgjë.

Nxënësit diskutojnë për ushtrimet.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e kallëzuesit emëror dhe foljor në fjalitë e dhëna, për kthimin e kallëzuesit foljor të thjeshtë në kallëzues foljor të përbërë etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Llojet e kallëzuesit foljor dhe emëror – Ushtrime		Situata e të nxënës Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon kallëzuesin emëror nga ai foljor; - dallon kallëzuesin foljor të thjeshtë e të përbërë; - ndërton fjali me kallëzues emëror dhe foljor;		Fjalët kyçe: Kallëzues Gjymtyrë kryesore e fjalisë Kallëzues emëror Kallëzues foljor i thjeshtë Kallëzues foljor i përbërë Folja jam	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhësi	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Pyetja sjell pyetjen, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i shpejtë.</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Pyetja sjell pyetjen</p> <p>Ç'është kallëzuesi e çfarë tregon ai? Me cilën pyetje gjendet?</p> <p>Sa lloje kallëzuesish kemi?</p> <p>Si formohet kallëzuesi emëror?</p> <p>Po ai foljor? Nga formohen kallëzuesi foljor i thjeshtë dhe ai i përbërë?</p> <p><b>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve duke ilustruar me shembuj.</b></p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënës në bashkëpunim-Punë me grupe</p> <p><b>Grupi 1.</b> Analizoni funksionet e formave foljore të pashtjelluara. Nënvizoni fjalët që lidhen me to. <i>S'ka për t'u nisur njeri, pa përënduar (rreth. kohe) dielli. Shkova në bibliotekë për të marrë (rreth. qëllimi) një libër. Një të rënë (rreth. kohe) zilha, të gjithë vërshuan në oborr. Ecte duke fshkëllyer. (rreth. mënyrë)</i></p> <p><b>Grupi 2.</b> Dalloni funksionet e foljes jam.</p> <p>kallëzues apo këpujë</p> <p>Kush është (kallëzues) në shtëpi? Unë nuk jam ti, (Këpujë) Duhet të jesh më i kuptueshëm. - këpujë Ç'është kjo? - Këpujë Na ishte (kallëzues) njëherë.</p> <p><b>Kujdes!</b> Folja jam mund të shërbejë si kallëzues kur del me kuptimin e saj të plotë: <i>Sa është ora?</i></p> <p>Folja jam mund të shërbejë edhe si pjesë e kallëzuesit emëror. Në këtë rast, ajo quhet këpujë: <i>Ora është e prishur.</i></p> <p><b>Grupi 3.</b> Sillni nga një shembull ose kundërshtim argumentues për secilin nga pohimet e mëposhtme:</p> <p><b>a) Të gjitha fjalët kanë rend të lirë në fjali.</b></p> <p>Jo çdo fjalë ka rend të lirë në fjali.</p> <p>Erdhi me mamin në festë.</p> <p>P.sh., para fjalës nuk ndahen nga emrat me të cilët lidhen.</p> <p><b>b) Kallëzuesi mund të jetë emëror dhe foljor</b></p> <p>Ora ishte dymbëdhjetë - kallëzues emëror.</p> <p>Ai u nis për në shkollë - kallëzues foljor i thjeshtë</p> <p>Filloi të binte shi - kallëzues foljor i përbërë</p> <p>Po e vërtetë</p> <p><b>Grupi 4. Gjenerali kallëzuesit dhe thoni llojin e tyre:</b></p> <p>E kishte prituri (kallëzues foljor i thjeshtë) me padurim pragun e Vitit të Ri për të bërë këtë telefonatë, pa e ditur se kjo do ta brengoste (kallëzues foljor i thjeshtë) më shumë nga ç'ishte i brengosur (kallëzues foljor i thjeshtë) deri më tash.</p> <p>Zëri i nënës iu duk (kallëzues foljor i thjeshtë) i huaj, i panatyrshëm.</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Shkrim i shpejtë</p> <p>Ndërto një tekst argumentues ku të përdorni kallëzues foljor të thjeshtë dhe të përbërë si dhe kallëzues emërorë.</p> <p>Nxënësit punojnë, më pas lexojnë punët dhe vlerësojnë njëri-tjetrin. Në fund, puna depozitohet në dosje.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për dallimin e kallëzuesit emëror dhe foljor në fjalitë e dhëna, për kthimin e kallëzuesit foljor të thjeshtë në kallëzues foljor të përbërë etj.</p>			



Recitohen vargje nga Gjergj Fishta. Për këtë nxënësit janë udhëzuar disa orë më parë që të hulumtojnë rreth jetës dhe veprës së tij.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënit me këmbime

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe çështjet që do të diskutohen i shkruan në fletë të veçanta dhe iu shpërndahen secilit grup.

**Grupi 1:** Fleta e parë e ditarit

- a) Për çfarë takimi bën fjalë?
- b) Si e cilëson deputeti francez At Gjergj Fishtën?
- c) Cila është tema e bisedës së tyre?
- d) Çfarë mendon Fishta në lidhje me të?

**Grupi 2:** Fleta e dytë e ditarit

- a) Për çfarë takimi bën fjalë?
- b) Cili është qëllimi i vizitës që Fishta i bën Godartit në Paris?
- c) Për çfarë debatojnë ata gjatë këtij takimi?
- d) Cila është pyetja që ngre Fishta? Çfarë e shtyn atë të bëjë këtë pyetje?

**Grupi 3:** Gjenerali në pjesët e shkëputura nga ditarit ato fjali ku:

- a) jepen detaje udhëtimi;
- b) përshkruhet Fishta dhe veprimtaria e tij;
- c) jepet informacion për tematikën e poezive të tij;
- d) parashikohet se ç'do të ndodhë pas dy brezash;
- e) përshkruhet atdhetarizmi i Fishtës.

Përgjigjet e fletës së parë të ditarit:

- a) Takimin e Fishtës me deputetin francez Zhystin Godart, në Shkodër
- b) Deputeti francez e quan Gj.Fishtën "Homerin e Shqipërisë", madhështor dhe inteligjent.
- c) Dasitë fetare ose do ta bashkojnë Shqipërinë, ose do ta përçajnë atë.
- d) Ndryshimi mes krahinave nuk u detyrohet besimeve fetare, por kulturës së ndryshme që u kanë dhënë fetë.

Përgjigjet e fletës së dytë të ditarit:

- a) Takimi i Fishtës me deputetin francez Zhystin Godart, në Paris.
- b) Qëllimi i vizitës ishte për të diskutuar për marrëdhëniet që duheshin vendosur midis Shqipërisë dhe Francës dhe hapjen e një shkolle të mesme franceze, në Shkodër
- c) Gjatë takimit u debatua për prestigjin e Shqipërisë i cili ishte nëpërkëmbur në artikujt e shtypit francez.
- d) Kur do të na trajtojnë me drejtësi?

Ai e bën këtë pyetje, pasi dëgjoji se çfarë të pavërtetash shkruheshin në artikujt e gazetave dhe gazetarëve francezë, për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Përgjigjet e fletës së tretë të ditarit:

- a) Lamë Tiranën në orën 9 dhe morëm rrugën për në Shkodër.
- b) Fishta është poet dhe burrë veprimi.
- c) Me poezitë e tij fisnike dhe të forta... ai ka folur për mizoritë, vuajtjet dhe shpresat e Shqipërisë dhe ka ngritur lart shpirtin për pavarësi të bashkëkombësve të tij.
- d) Ndryshimi mes krahinave do të zhduket pas dy brezave.
- e) I indinjuar dhe i fyer tha: Gjithnjë do të shpifin për vendin tonë aq burrëror dhe aq fatkeq. Dhe kë neve që duam paqen...

**Grupi 4**

a) Godarti e cilëson Fishtën “Homeri i Shqipërisë”. Sipas jush, pse?

b) Shkruani tri ide, të cilat ju mbeten në mendje pas leximit të këtij ditari. Diskutoni në grup rreth tyre dhe vlerësoni arsyetimet e njëri-tjetrit.

**Përgjigjet e fletës së katërt të ditarit:**

a) Tonet e madhërishme heroike  
Njohës i thellë i botës shqiptare  
Shqiptarësia në dhënien e mjediseve, heronjve, rrethanave  
Burimësia e papërsëritshme e përfytyrimeve  
b) Përpjektjet e Fishtës për ta rritur nderin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.  
Shqetësimet e poetit, politikanit, për t’u trajtuar me drejtësi për atë çka jemi në sytë e botës.  
Shqipëria kurdoherë ka nxjerrë burra të zotë të cilët janë përpjekur për të.

Prof. Dr. Maximilian Lambertz "Shqipëria që ideali i tij, për te punoi, për te vërtetë e me emnin e saj në gojë dha frymën e fundit."

c) Fjalitë më të përdorura fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje.

Koha më e përdorur është e shkuara

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Rrjet diskutimi*

Për At Fishtën, ndryshimi mes krahinave të ndryshme nuk u detyrohet besimeve fetare, por kulturës së ndryshme që u kanë dhënë atyre fetë...

PO

A lidhet ajo me realitetin e sotëm?

JO

Nxënësit japin mendimet e tyre rreth thënies së Fishtës.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për punën kërkuese për jetën e krijimtarinë e Fishtës, për argumentet që shprehin gjatë diskutimit etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një fletë ditari në të cilin të përshkruani një takim që keni pasur me drejtorin e shkollës suaj, ose me një përfaqësues të pushtetit vendor në lidhje me një çështje që ju shqetëson.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII					
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje		Situata e të nxënit: Një vizitë në Prizren Ndërtoni një tekst të shkurtër me këtë temë ku të përdorni fjali të përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje.						
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe								
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare								
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon fjalitë e thjeshta nga fjalitë e përbëra;</li><li>- analizon fjalitë me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje;</li></ul>		Fjalët kyçe: Fjali Fjali e thjeshtë Fjali e përbërë						
<ul style="list-style-type: none"><li>- krahason fjalitë me b/r e n/r;</li><li>- gjykon rreth fjalive të dhëna në tekst duke argumentuar përgjigjen e tij.</li><li>- argumenton zgjerimin dhe ngushtimin e fjalive.</li></ul>		Bashkërenditje Nënrenditje						
Burimet: Teksti mësimor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi						
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Di, Dua të di, Mësova								
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Di								
Lexoni me kujdes fjalitë e mëposhtme.								
1) Me nisjen e shirave dhe nën kërcënimin e daljes së lumenjve nga shtrati me pasojë përmytjen e mundshme të të gjitha zonave të ulëta të atij qarku, u mbledh, si çdo vit, këshilli i emergjencës, për të diskutuar rreth masave parandaluese si dhe evakuimin e banorëve në rast rreziku.								
2) Vendosën të largoheshin.								
Cila prej fjalive është e thjeshtë dhe cila e përbërë? Argumentoni përgjigjen tuaj.								
Kujtojmë								
<table><tr><td>DI</td></tr><tr><td>Fjalitë e thjeshtë ka vetëm një kallëzues.</td></tr><tr><td>Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse.</td></tr><tr><td>Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.</td></tr><tr><td>Lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve.</td></tr></table>				DI	Fjalitë e thjeshtë ka vetëm një kallëzues.	Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse.	Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.	Lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve.
DI								
Fjalitë e thjeshtë ka vetëm një kallëzues.								
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse.								
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.								
Lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve.								
Lidhni fjalitë e mëposhtme në një fjali të vetme.								
Asaj i pëlqen teatri. Atij i pëlqen kinemaja.								
Si e gjykoni fjalinë e mëposhtme? Ç'ndodh nëse fjalën “teatri” e zëvendësojmë me fjalën “shumë”? A ka të bëjë kjo me kuptimin e fjalës apo rolin që kryen ajo në fjali?								
Asaj i pëlqen shumë, kurse atij i pëlqen kinemaja. Nuk mund ta zëvendësojmë fjalën teatri, pasi heqja e plotësisht kryesor në fjali e prish kuptimin e saj.								

**Ndërtimi i njohurive të reja: Di, Dua të di, Mësova**

DI	Dua të di	Mësova
Fjalitë e thjeshtë ka vetëm një kallëzues.	Ç'loj marrëdhënies vendosen midis pjesëve bashkërenditëse?	Ato shprehin lidhje barazie. Lidhja e barazisë realizohet në ato raste, kur asnjëra nga pjesët e një fjalisë të përbërë nuk varet prej tjetrës. Pra, secila mund të qëndrojë si fjali më vete.
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse.	Po midis pjesëve nënrenditëse?	Kur mes pjesëve të një fjalisë të përbërë vendosen lidhje varësie, kemi të bëjmë me fjali nënrenditëse. Lidhja e varësisë, nënkupton se njëra pjesë fjalisë varet prej pjesës tjetër, e cila e drejton të parën.
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.	Si realizohen këto lloj marrëdhënies?	Te fjalitë, foljet e tyre janë të plotësuar me gjymtyrët e domosdoshme, ndaj ato mund të qëndrojnë si fjali të thjeshta më vete.
Lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve.		

Zvogëloni fjalinë: 1) e dhënë në fazën e parë të mësimin aq sa është e mundur dhe zgjeroni sa më shumë fjalinë 2), duke ruajtur të njëjtin numër kallëzuesish. Diskutoni së bashku shembujt e krijuar

1) *Me nisjen e shirave dhe kërcënimit në daljen së lumenjve u mbledh këshilli i emergjencës.*

2) *Ata vendosën papritur të largoheshin drejt Gjermanisë për një jetë më të mirë.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe**

**Punohet ushtrimi 1 fq. 224.**

Dalloni fjalitë e thjeshta (TH) nga ato të përbëra (P). Nënazoni kallëzuesit.

Gjeja më e mirë është t'i shënosh ngjarjet çdo ditë. TH

Të mbash ditar për të parë më qarte. TH

Kështu nuk të shpëtojnë hollësitë, edhe pse duken të parëndësishme.

P

Duhet të hedh në letër si e shoh këtë tryezë, rrugën, njerëzit, sepse janë pikërisht këto që kanë ndryshuar. P

Duhet përcaktuar pikë për pikë zgjatja dhe natyra e këtij ndryshimi. TH

Ushtrimi 2 fq. 224 Dalloni fjalitë me bashkërenditje **b/r** nga ato me nënrenditje **n/r** Argumentoni përgjigjen tuaj.

Frynte erë dhe gjethet binin. b/r

Gjethet binin, sepse frynte erë. n/r

Nuk mund ta kuptosh mësimin nëse je i pavëmendshëm. n/r

Nuk e kuptonte se kishte gabuar. n/r

Isha aty, por nuk dëgjova gjë. b/r

Nuk dëgjova, ç'u tha aty. n/r

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje janë ndërtuar me ndihmën e lidhëzave bashkërenditëse *dhe, por* etj., ndërsa fjalitë e përbëra me nënrenditje janë ndërtuar me ndihmën e lidhëzave *n/r* nëse, sepse, se, apo pa ndihmën e lidhëzave.

Nxënësit punojnë në dyshe. Më pas diskutojnë së bashku saktësinë e zgjidhjes së tyre.

**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për saktësinë e dallimit të fjalive të thjeshta nga ato të përbëra, për krahasimin e fjalive të përbëra me b/r e nr. Etj.


## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Ushtrime për fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca qytetare</div>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- dallon në tekstin e dhënë fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra me b/r e n/r;</div><div>- ndërton fjali të përbëra brenditë se të llojeve të ndryshme, nr të llojeve të ndryshme.</div></div>		Fjalët kyçe: Fjali Fjali e thjeshtë Fjali e përbërë Bashkërenditje Nënrenditje	
Burimet: Teksti mësimor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
<p><i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe dyshe, Rishiko në dyshe, Të nxënit me këmbime.</i></p> <p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Punë në grupe dyshe.</i></p> <p><i>Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet e librit në faqen 224.</i></p> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: Rishiko në dyshe</i></p> <p>Dallo fjalitë e thjeshta e të përbëra në tekstin e dhënë: “Për kë punon koha” intervistë nga Ismail Kadare dhënë në gazetën “Sheshi” të Kosovës,18 korrik 1998.</p> <p><i>Uniteti, thuhet apo nuk thuhet, është i pranishëm në çdo komb të gjallë sot. Ai s`është as luks, as virtyt. Ai është domosdoshmëri. Ndryshe këta popuj e shtete, që ne na duken të fuqishëm e modernë ,në të vërtetë janë të gjallë e janë në këmbë për hir të unitetit... Uniteti i popullit shqiptar ka qenë përherë i vështirë, ndaj e rëndë dhe tragjike ka qenë historia e tij. Ajo nuk mund të jetë veç e tillë edhe në të ardhmen në qoftë se kjo sëmundje nuk do të zbutet.</i></p> <p><i>Uniteti i çdo populli, ashtu si pullazi i çdo tempulli mbështetet mbi disa shtylla. Kur shtyllat nisin e bien njëra pas tjetrës pullazi do të bjerë e pas tij do të bjerë vetë kombi. Gjergj Kastrioti, që ju përmendni, është programuesi kryesor i orientimit shqiptar. Programi i tij vazhdon të jetë ende i saktë, ndaj goditja ndaj figurës së tij, është goditje tradhtare kundër jetës së Shqipërisë. Uniteti është i vështirë, por formula e tij është e thjeshtë. Uniteti për t`u një mendësuar kërkon nga gjithkush të heqë dorë nga diçka nga vetja...</i></p> <p><i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Të nxënit me këmbime</i></p> <p><i>Ndërtoni një tekst duke përdorur fjali të thjeshta e të përbëra b/r e n/r.</i></p> <p><i>Grupi 1: Projektet e mia për të ardhmen</i></p> <p><i>Grupi 2: Miku njihet që është mik, në nevojë e në rrezik.</i></p> <p><i>Grupi 3: Lufta midis brezave</i></p> <p><i>Grupi 4: Nënë Tereza na frymëzon me veprën e saj.</i></p> <p>Nxënësit punojnë të qetë e më pas përgjigjen për punët e bëra. Ata vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna.</p>			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Një rrëfim mbi librat e zemrës</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë i dua librat. Dashuria për librin është dashuria më e madhe për mua. Në raftet e bibliotekës sime ka shumë tituj librash, të cilat i ruaj me fanatizëm... <b>VAZHDONI TEKSTIN!</b>	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe	
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare	
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- hulumton mbi jetën dhe krijimtarinë artistike të autorit;</li> <li>- jep gjykimin e tij rreth autorit;</li> <li>- analizon veçoritë gjuhësore të intervistës;</li> <li>- komenton rreth përgjigjeve të autorit;</li> <li>- krahason përgjigjet e autorit me përgjigjet e tij apo të shokut/shoqes.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Intervistë I intervistuari Letërsi artistike Personazh
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor videoprojektor, librat e Adrian Vehbiut	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> gjuhësi, letërsi
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Hartë koncepti, Të nxënit me këmbime, Karrigia e nxehtë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Hartë koncepti	



**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënit me këmbime

Nxënës të ndarë në grupe punojnë me rubrikat e tekstit.

**Lexoni pohimet e mëposhtme dhe shënoni me + nëse pohimi është i vërtetë dhe - nëse është i gabuar.**

Sipas të intervistuarit, një ndër romanet më të mirë me vlerë gjithëkohore është “Xha Gorioi”. + Po

Tregimet e pëlqyera të Ardian Vehbiut janë ato të Kalvinos. – Jo

Letërsia antike greke mbetet frymëzuese për të intervistuarin. + Po

Ndër pëlqimet e Ardian Vehbiut mbeten librat nga historia e shahut, gjeometrisë, mjekësisë. + Po

Ardian Vehbiu u referohet viteve ‘80 në të shkruarën. + Po

Kritika letrare bën një punë të mirë lidhur me vlerësimin e librave.

“Sende që nxirrte deti” është libri më i realizuar që Ardian Vehbiu

mendon se ka shkruar. – Jo

Eksplorimi në lexim mbetet një nga detyrat e pëlqyera të të intervistuarit. + Po

**Analizojmë tekstin**

**Gjeni në përgjigjet e të intervistuarit ato fjali ku ai:**

**jep informacione për kohën e fëmijërisë së tij;**

*Lexoja shumë, sidomos letërsi franceze të përkthyer: Hygo, Balzak, Stendal, Zhyl Vern. Sidomos Zhyl Vernin. “Udhëtimet e Guliverit” të Suiftit e kam lexuar tepër herët për ta kuptuar mirë. Tani që e mendoj, edhe letërsi ruse: Turgenjevin, Tolstoin, Çehovin dhe nga fantashkenca, “Mjegullnajën e Andromedës,” nga Efremovi. Nga autorët shqiptarë, veçoj Mitrush Kutelin e “Tregimeve të moçme shqiptare” dhe “Xinxifilos”; Petro Markon e “Shpellës së piratëve”; më pas Kadarenë e “Kronikës në gur” dhe “Kështjellës.”*

**Përmend vizitën e teknologjisë:**

*Si letërsi artistike mbaj vetëm ato vepra që më kanë pëlqyer veçanërisht, të tjerat i dhuroj pasi i kam lexuar – edhe pse tani po përpiqem që të kursej letrën dhe letërsinë e zhanrit ta lexoj në Kindle.*

**Jep informacion për situatën e leximit në të shkruarën;**

*Në vitet 1980 qarkullonim dorazi letërsi përndryshe të ndaluar – besoj se kjo vinte me njëfarë rreziku, sado teorik. Mbaj mend që ashtu kemi lexuar Dostoevskin, Kamynë, Sartrin, Frojdin, Kunderën. Libri “më i rrezikshëm” që kam lexuar atëherë ndoshta ka qenë monografia e Arshi Pipës, për standardizimin e shqipes, që ma kanë dhënë të fotokopjuar*

**Tregon pëlqimet e veta në zhanrin e letërsisë;**

*Prozë: më pëlqen qasja narrative post-moderne. Më mahnit letërsia greke antike, që nga Homeri te tragjedianët e mëdhenj. Nga zhanret, më tërheq fantashkenca. Si rregull, nuk lexoj romane me temë historike.*

**Vetëvlerëson krijimtarinë e tij;**

*“Kulla e Sahatit” ka qenë i pari në shqip, dhe më i rrëmbyeri si përrua. Më personalisht është “Sende që nxirrte deti”, ndërsa më i latuari, nga pikëpamja e artit letrar – gjithnjë për mua – “Bolero”.*

**Bën parashikime për të ardhmërinë e leximeve të tij.**

*Ka autorë latino-amerikanë që dua, që duhet t’i eksploroj më mirë.*

**Gjuha e tekstit**

**Vendosni në pohimin e saktë lidhur me veçoritë gjuhësore të kësaj interviste.**

Ardian Vehbiu jep përgjigje të shkurtra në hyrje dhe në mbyllje të intervistës. PO

Në intervistë përdoren terma nga fusha të ndryshme të shkencës. PO

Fjalitë e përdorura janë kryesisht të përbëra, me nënrenditje. PO

Ardian Vehbiu përdor figura letrare gjatë të folurit. JO

Emrat e përveçëm janë përdorur për të emërtuar vende. JO

Emrat e përveçëm emërtojnë tituj librash dhe autorët e tyre. PO

**Reflektojmë rreth tekstit**

**Komentoni përgjigjen e Ardian Vehbiut ndaj pyetjes:**

*“Kë do të donit të shkruante historinë e jetës suaj?”*


## DËSHIRA PËR PAVDEKËSI TË VEPRËS SË TIJ DHE PAS VDEKJES FIZIKE

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Karrigia e nxehtë*

Një nxënës ngrihet para klasës, ulet në një karrige dhe të tjerët i bëjnë pyetje sikur të ishte vetë autori. Me anë të kësaj teknike të nxënësi ngulitet një nga shprehjet themelore të të menduarit siç është ajo e eupatisë, pra të futjes “në lëkurën e tjetrit”.

Disa nxënës vendosen në karrige.

**Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e shokëve duke plotësuar:** *Diagramin e Venit*



**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna.

**Detyrë shtëpie:** Përcaktoni temën e intervistës suaj dhe zgjidhni një personazh të përshtatshëm.

Mblidhni sa më shumë informacione, të cilat do t'ju ndihmojnë për të shkruar një intervistë të suksesshme.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të dëgjuarit</b> <b>Tema mësimore: Dëgjojmë dhe komentojmë intervista</b>		<b>Situata e të nxënët:</b> 1) Diskutoni rreth jetën dhe krijimtarisë artistike të Inva Mulës. 2) Intervisto shokun/shoqen e bankes për hobet dhe fobitë e tij.	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon elementet kryesore në një intervistë;</li><li>- hulumton për gjetjen e mënyrave e këshillave për një intervistë të suksesshme;</li><li>- harton pyetje të suksesshme për një intervistë të suksesshme;</li><li>- zbulon gjatë të dëgjuarit të intervistës sekretet e jetës së Inva Mulës;</li><li>- reflekton për moment më pikante të intervistës.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Intervistë I intervistuar Intervistuesi Pyetje Shtyp i shkruar/elektronik Television Të dëgjuarit	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor video-projektor, video në youtube me intervistën e Inva Mulës etj.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukim muzikor	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pemë mendimi, Pyetje-përgjigje, Shkrim i lirë**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Pemë mendimi*

Dialog mes një gazetari  
(intervistuesi)  
dhe një të intervistuari

**Intervista**

Realizohet përmes pyetjeve dhe  
përgjigjeve

I intervistuari është një njeri i  
shquar, një politikan, një përfaqësues  
i shoqërisë civile, një  
artist, një zyrtar etj.

Intervista botohet në shtypin e  
shkruar a  
elektronik ose transmetohet në radio  
a në televizion

Këshilla për të dhënë një intervistë të suksesshme.

Informohu rreth personit që do të të marrë në intervistë.

Jepi rëndësi pamjes dhe vishu në mënyrë të përshtatshme.

Mos kopjo thëniet e të tjerëve.

Mbaj kontakt me sy, buzëqesh dhe kujdesu për gjuhën e trupit kur  
bashkëbisedon.

Shprehu qartë dhe mos përsërit të njëjtat fjalë.

Përdor sa më shumë fjalë të zgjedhura.

**Këshilla**

Këshilla për të hartuar pyetjet e një interviste të suksesshme.

Fillo me pyetje të hapura.

Përgatit pyetje të cilat të lidhen mirë me njëra-tjetrën.  
Shkruaj pyetje të qarta.

Shkruaj pyetje që e mobilizojnë të intervistuarin.

Përgatit pyetje që mbështeten në përvoja reale.

Eliminoni këshillat që nuk i fiksuat gjatë dëgjimit etj

**Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetje-përgjigje**

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje intervistën në *youtube* të Inva Mulës.

U tërhiqet vëmendja për të dëgjuar në mënyrë kritike duke mbajtur stilolaps e letër dhe të shënojnë në të momentet më mbresëlënëse të intervistës.

Pas dëgjimit të saj komentojmë së bashku me nxënësit intervistën.

**Cilat janë momentet më të rëndësishme të intervistës që dëgjuat?****Cila ishte pjesa më e bukur e saj, sipas jush?**

Pjesët më interesante janë ato kur ajo tregon për familjen e saj, fëmijët me hobet e tyre, pasi për famën, angazhimet dhe profesionin e saj është folur gjithmonë.

**Me ç'rast e ka dhënë sopranoja e famshme këtë intervistë?**

Gjatë kohës kur ishte thirrur në Tiranë nga Zana Çela për të drejtuar Festivalin Operistik “Marije Kraja”

**Çfarë mendon ajo për profesionin e saj?**

Megjithëse ka shumë pasione brenda saj për pikturën a dizajnin ajo nuk do ta ndërronte pasionin e saj për muzikën me asgjë. Dhe sikur të riniste një jetë nga fillimi përsëri do të zgjidhte të ishte këngëtare e muzikës klasike.

**Si e përshkruan sopranoja marrëdhënien me fëmijët e saj?**

Një marrëdhënie e ngrohtë, një nënë e përkushtuar ndaj djalit të saj adoleshent duke e shoqëruar atë në koncertet e yjeve të mëdhenj të muzikës si Dua Lipës apo Sting dhe përkushtimi i madh për vajzën e saj të vogël, Ninën që darkave i lexon përralla dhe i tregon histori duke kaluar moment të paharruara me fëmijët e saj.

<p><b>Çfarë dëshiron ajo për ta?</b> Dëshiron më të mirën sidomos për Antonin, muzikën e të cilit e adhuron dhe dëshiron të jetë një fansja e tij më e madhe kur ai të ketë koncertet.</p> <p><b>Si është një ditë e zakonshme e Inva Mulës?</b> Si gjithë njerëzit e zakonshëm, madje ajo ka zbuluar dhe një sekret që në ditët kur nuk ka koncert, pas orës 7 të mbrëmjes nuk dëshiron të dalë nga shtëpia, por ta kalojë kohën me vajzën e saj të vogël</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë</b></p> <p><b>Reflekto:</b> Nxënësit do të reflektojnë rreth temës: “Çfarë ju bëri më shumë përshtypje te kjo intervistë?” Do të japin mendimet e tyre të cilat do t'i ndajnë me njëri-tjetrin pas mbarimit të punës. Mendimet e tyre duhet t'i mbrojnë patjetër me argument.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna, diskutimit rreth personazhit të këngëtares Inva Mula, zbulimit të momenteve kyçe të jetës së saj gjatë procesit të të dëgjuarit kritik etj.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Zhvillo një intervistë imagjinare me një këngëtar a sportist, idhullin tënd. Zhvillo një intervistë me një nga prindërit e tu për vitet e fëmijërisë së tij/saj.</p>
--

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje		Situata e të nxënës: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca qytetare</div>			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- dallon fjalitë me pjesë të nënrenditur nisur nga lloji i lidhjes dhe marrëdhënies që vendoset midis pjesëve;</div><div>- dallon fjalitë me pjesë të varur fthilluese kryefjalore nga ato kundrinore.</div></div>		Fjalët kyçe: Fjali e përbërë me nënrenditje: Fthilluese, Kryefjalore & Kundrinore Rrethanore Përcaktore	
Burimet: Libri mësimor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: DDM			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Di			
DI	DUA TË DI	MËSOVA	
Fjali e përbërë më pjesë të nënrenditur			
Pjesët në këto fjali kanë marrëdhënie varësie midis tyre.			
Fjali e përbërë fthilluese, rrethanore			

**Plotësohet tabela DI me njohuritë që nxënësit kanë marrë në vitet e mëparshme.**

**Ndërtimi i njohurive të reja: Dua të di**

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Fjali e përbërë më pjesë të nënrenditur	Si realizohet lidhja midis pjesës kryesore dhe pjesës së varur në fjalitë ftilluese?	Pjesa e varur është e domosdoshme dhe plotëson kallëzuesin e pjesës kryesore.
Pjesët në këto fjali kanë marrëdhënie varësie midis tyre.	Nga ndryshon pjesa e varur ftilluese kryefjalore nga ajo kundrinore?	Te fjalitë e varura ftilluese në ndryshim nga fjalitë e thjeshta, funksionin e kryefjalës apo të kundrinorit, nuk e përmbush një gjymtyrë, por një pjesë fjalie.  Rolin e kryefjalës e luan pjesa e varur ftilluese kryefjalore.  Rolin e kundrinorit e luan pjesa e varur ftilluese kundrinore.
Fjali e përbërë ftilluese, rrethanore		

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të bëra në këtë fazë. Më pas përgjigjet e pyetjeve hidhen në tabelë e plotësohet kolona "Mësova".

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Të nxënësit në bashkëpunim

**Në këtë fazë të mësimi klasa ndahet në grupe dhe punohen ushtrimet e dhëna në tekst në fq. 227.**

**Grupi 1. Punojnë ushtrimin 1-2 në tekst.**

**Grupi 2. Lidh me shigjetë. Ç' lloj fjalish formohen:**

1. *Porositi* - shumë vargje.  
- një kafe.  
- për të lënë një dëshmi të pakundërshtueshme.
2. *Na tha* - fjalën e fundit të parën.  
- këtë.  
- të gjithë të afërmit e tij.
3. *nuk e imagjinoja* - ç' i erdhi në mendje.  
- që puna mund të shkonte deri aty.  
- më shumë se ç' konsumoi.

Punohet dhe ushtrimi 3 fq. 227 sipas kërkesës së dhënë.

Ata nuk e dinin (PK) ç' e ardhme i priste PVF Kundrinore

**Grupi 3.** Nxënësit e këtij grupi punojnë me ushtrimet 4-5 fq. 227.

**Ktheni fjalitë pyetëse në pjesë të varura ftilluese të një fjalie të përbërë.**

Kur fillon mësimi? - *Pyeti se kur fillonte mësimi.*

Ku do të takohemi? - *Pyeti nënën se ku do të takoheshin për shopping.*

**Shpjegoni se janë të papranueshme fjalitë e mëposhtme. Rishkruajini si duhet.**

Gjithçka e dija se kush kishte ardhur - *E dija se kush kishte ardhur.*

Nëse kallëzuesit të pjesës së parë i shtojmë një kryefjalë, atëherë nuk ka vend për pjesën e varur kryefjalore, sepse ky rol përmbushet nga gjymtyra e fjalisë.

*Ai mendonte ai të nisej nesër - Mendonte të nisej nesër.*

*Punën e filluan të ndërtojnë teatrin* \_\_\_\_\_

*Diçka dukje se do të binte shi* \_\_\_\_\_

*Nxënësit diskutojnë së bashku për ushtrimet e dhëna.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e fjalive të varura ftilluese kryefjalore dhe kundrinore.

**Detyra e shtëpisë:** Detyrë shtëpie jepet usht 5. fq. 227.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruarit</b> <b>Tema mësimore: Kronika</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Gazetat dhe kronikat	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon kronikën si një lloj shkrimi që u kushtohet lajmeve të përditshme.</li><li>- dallon datën, faktin, situatën, rrjedhojën, pasojën, në një kronikë.</li><li>- analizon hapat që ndiqen gjatë shkrimit të një kronike.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Kronikë Kur? Kush? Si? Çfarë? Si? Pse?	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, gazeta të ndryshme, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> gazetari	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bashkëbisedim, DDM, Shkrim i lirë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim A keni dëgjuar ndonjëherë për fjalën “kronikë”? Le të shohim përkufizimin e kësaj fjale sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe. Kronikë: 1) vepër ku janë shënuar vit për vit ngjarjet historike, përmbledhje faktesh historike dhe ngjarjesh kryesore të jetës, të renditura njëra pas tjetres sipas kohës kur kanë ndodhur. 2) vepër letrare me temë historike në të cilën autori gjatë shtjellimit të ngjarjeve ndjek me përpikëmeri rendin kohor. 3) rubrikë në një gazetë a në një revistë që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve. 4) film dokumentar që jep ngjarje të renditura njëra pas tjetres, sipas kohës kur kanë ndodhur. <b>Ndërtimi i njohurive të reja: DDM</b>			
<b>Di</b>	<b>Dua të di</b>	<b>Mësova</b>	
Rubrikë në një gazetë a në një revistë që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve.	Cilat janë pyetjet me anë të të cilave marrim informacionin? A janë të gjata kronikat dhe të strukturuar?	Kronika është një lloj shkrimi që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve. Në të rrëfohen fakte që kanë ndodhur vërtet. Informacioni që ajo jep u përgjigjet pyetjeve: Kush? Çfarë? Ku? Kur? Kush? Si? Në përgjithësi, kronikat janë shkrime të shkurtra, por të strukturuar mirë, ku dallohen mirë data, fakti, situata, rrjedhojat, pasojat.	
	Çfarë hapash duhet të ndjekim për të shkruar një kronikë?	Zgjedhim temën. Përshkruajmë vendin ku zhvillohet ngjarja. Japim sa më shumë elemente që përcaktojnë kohën dhe vendin. Japim fakte dhe shifra. Tregohemi objektivë dhe të paanshëm kur bëjmë vlerësimin e ngjarjes, duke dalluar qartë faktet nga opinionet.	

Rubrikë në një gazetë a në një revistë që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve.

Cilat janë pyetjet me anë të të cilave marrim informacionin?

A janë të gjata kronikat dhe të strukturuar?

Kronika është një lloj shkrimi që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve. Në të rrëfohen fakte që kanë ndodhur vërtet.

Informacioni që ajo jep u përgjigjet pyetjeve: Kush? Çfarë? Ku? Kur? Kush? Si?

Në përgjithësi, kronikat janë shkrime të shkurtra, por të strukturuar mirë, ku dallohen mirë data, fakti, situata, rrjedhojat, pasojat.

Çfarë hapash duhet të ndjekim për të shkruar një kronikë?

Zgjedhim temën.

Përshkruajmë vendin ku zhvillohet ngjarja.

Japim sa më shumë elemente që përcaktojnë kohën dhe vendin.

Japim fakte dhe shifra.

Tregohemi objektivë dhe të paanshëm kur bëjmë vlerësimin e ngjarjes, duke dalluar qartë faktet nga opinionet.

Përdoret në këtë fazë modeli i tekstit.

Tema: **Dy ditë pas shpalljes së kampionëve**

*Jemi në stadium.*

*Ku?*

*Është ora 16:30.*

*Sa?*

*Në rrugë ka shumë tifozë.*

*Ku?*

*Kemi ardhur për arsye se luan skuadra jonë e zemrës.*

*Pse?*

*Me ne ndodhen dhe miqtë tanë.*

*Kush?*

*Flitet se Mesi do të jetë pjesë e ndeshjes.*

*Çfarë?*

*Por ja të shohim nëse fjalët janë të vërteta.*

*Çfarë?*

*Para nesh po kalon Ronaldo ylli i futbollit portugez.*

*Kush?*

*Mijëra tifozë nxituan ta takonin.*

*Sa?*

*Njerëzit u shpërndanë në pushim të ndeshjes për t'u rikthyer përsëri pas 15 minutash. Kur?*

Lexoni kronikën e mëposhtme dhe gjeni në tekst fjali që u përgjigjen pyetjeve: *Kur? Kush? Si? Sa? Pse?*

### **Në ditën e karnavaleve**

20 shkurt. Është mëngjes dimri. Qyteti u zgjua i shtuar nga një shtresë e bardhë dëbore. Njerëzit nisën të dalin nga shtëpitë me një ndjenjë dhe shprehje gëzimi në fytyrë. Fëmijët ishin ata që me zërat e tyre gazmorë e shprehnin më shumë këtë emocion gëzimi. Sot të gjithë janë nisur drejt sheshit të qytetit. Do të organizohet festivali i karnavaleve.

Qindra të rinj nisën të mbledhen në qendër të qytetit të veshur me kostume shumëngjyrëshe. Pasi të gjithë u mbledhën në shesh, ata u ndanë në dhjetëra grupe shumëngjyrëshe

për të realizuar lojërat e tyre të karnavaleve. Për orë të tëra ata shfaqën në shesh një spektakël madhështor. Pasdite vonë, kur nisi të errësohej, sheshi filloi të zbrazej pas një dite të bukur për të gjithë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i lirë

**Shkruaj një kronikë për një nga temat e mëposhtme:**

*Rekordi më i ri në botë*

*Yjet e futbollit*

*Ndotja mjedisore*

Nxënësit punojnë të qetë. Në qoftë se puna nuk mbaron në klasë u jepet detyrë shtëpie. **Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për shkrimin e një kronike.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<b>Rubrika: Të shkruarit</b> <b>Tema mësimore: Mbrojtja e mjedisit</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Diskutojmë së bashku për pastërtinë e mjedisit ku jetojmë (lagje, shkollë, klasë etj)	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- shkruan një kronikë sipas karakteristikave të saj;</li><li>- diskuton me shokët për kronikat e krijuara prej tyre;</li><li>- vlerëson punët e shokëve dhe vetëvlerëson punën e tij.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Artikull Titull Hulumtim Audienca	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> gazetari	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Pyetje-përgjigje, Punë e pavarur me shkrim, Diskutim <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Pyetje-përgjigje Mësuesi/ja nxit nxënësit të rikujtojnë dhe një herë informacionet e marra në orën e parë. Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetjet: <i>Çfarë dini për shkrimin e një kronike?</i> <i>Cilat janë hapat që duhen ndjekur për të shkruar një kronikë?</i> <i>Cilat janë karakteristikat e gjuhës së përdorur në të?</i> <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë e pavarur me shkrim Mësuesi/ja jep si detyrë në klasë nxënësit të bëjnë një artikull me temë: “Rreziku i përdorimit të celularit nga fëmijët” ose “Ushqimi dhe adoleshenca”. Tërhiqet vëmendja që nxënësit të respektojnë karakteristikat e shkrimit të një kronike. Lihen nxënësit të punojnë të qetë. Mësuesi/ja ndjek punët e tyre dhe i ndihmon kur ata i kërkojnë ndihmë apo kanë paqartësi. <b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Diskutim Pasi nxënësit mbarojnë punimin e tyre përzgjidhen nga mësuesi/ja ose me dëshirën e tyre dy-tre nxënës për ta lexuar punimin. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje dhe diskutojnë për punët e shokëve dhe japin vlerësimin për njëri-tjetrin. Puna depozitohet në portofol. <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për analizën e gjuhës së një kronike, si dhe në diskutimin e punës me shkrim.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Mbresa udhëtimi		Situata e të nxënit: Përshkruaj udhëtimin më mbresëlënës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
- Kompetenca e të menduarit			
- Kompetenca personale			
- Kompetenca qytetare			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- hulumton rreth jetës së Mit'hat Frashërit;</li> <li>- analizon detajet që jepen gjatë përshkrimit të vendit, natyrës e përshkrimeve;</li> <li>- diskuton rreth kuptimit të secilit paragraf;</li> <li>- zbulon mesazhet që përcjell pjesa;</li> <li>- analizon figurat letrare në pjesë;</li> <li>- vlerëson figurën e Mit'hat Frashërit nisur nga këndvështrimi i tij.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Udhëtim Meditim Vend i huaj Pension Të huaj Arsimim i mirë Mbresa udhëtimi
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, <a href="http://www.tiranaobserver.al/jeta-e-gjeniut-te-kombit-mithat-frasheri/">http://www.tiranaobserver.al/jeta-e-gjeniut-te-kombit-mithat-frasheri/</a>	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, arte

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Stuhi mendimi, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:** Stuhi mendimi

Filloi të aktivizohet në politikën shqiptare që në fund të shekullit XIX dhe u bë një nga figurat më të spikatura në politikën shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XX.

**Mithat Frashëri/  
Lumo Skëndo**

Në vitin 1908, filloi të botojë gazetën “Liria”, në Selanik.

U lind më 25 mars 1879, në Janinë. Ishte i biri i patriotit të madh, rilindasit Abdyl bej Frashëri, nipi i enciklopedistit Sami Frashëri dhe poetit të mallit për vendlindjen, Naim Frashëri.

Vdiq në SHBA në moshën 69 vjeçare.

Në shkrimet publicistike ai përdori pseudonimet Lumo Skëndo dhe Mali Kokojka, ndërsa në botimet e ndryshme përdori pseudonimin Ismail Malosmani.

Në vitin 1912, në Qeverinë e Pavarësisë, të krijuar nga Ismail Qemali, ai zgjidhet ministër i

Ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit, i njohur ndryshe edhe me emrin Kongresi i Alfabetit, më 14 nëntor-22 nëntor 1908. Mit'hat Bej Frashëri u zgjodh Kryetar i Kongresit dhe nënkryetar i komisionit të hartimit të alfabetit (kryetar i komisionit ishte At

Në shpalljen e pavarësisë ka qenë i zgjedhur delegat i Elbasanit, Ipekut,

Në vitin 1926 hapi në Tiranë librarinë e tij personale “Lumo Skëndo”. Një vit më pas, më 1927, filloi të botojë në Tiranë, revistën “Diturija”.

Më 1919 ka qenë kryetar i delegacionit shqiptar në Paris “në mbrojtje të të drejtave të Shqipërisë”.

Kundërshtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë, u detyrua në nëntor 1944, të largohet nga Shqipëria dhe të vendoset në Itali.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Lexim zinxhir dhe të nxëniet në bashkëpunim

**Pas leximit të tekstit zinxhir nga nxënës të ndryshëm klase diskuton për të kuptuarit e tekstit**

**Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.**

Cilat janë dy qëllimet e udhëtimit? *Dy qëllimet e udhëtimit janë: Shikimi dhe meditacioni*

Ku ndodhet autori? *Në Lozanë*

Me kë e krahason ai liqenin Leman? *Me liqenin e Ohrit*

Kush ndodhet te salla e bukës? *Shumë njerëz të ardhur nga vende të ndryshme*

Nga vijnë njerëzit që jetojnë në atë pension? *Nga shumë vende, ka polakë, francezë, bullgarë, grekë, italianë, turq dhe shqiptarë.*

Cila është shprehja që tregon se Lozana është një vend me më shumë të huaj? *Ata duken si të huaj, sepse të huajt bëjnë shumicën/Shitore e përbotsme*

**Jepni detaje për informacionin rreth:**

• **natyrës** (përshkrimi fizik të vendit); Volteri thotë se liqeni i Lemanit është më i bukuri liqen i dheut. Lozana është mbi një brinjë bregu, afër këtij liqeni. Përkundrejt janë Alpet e Savojës, male mjaft të larta, të kreshpëruara.

• **bashkëjetesës;** Salla e bukës na mbledh të gjithëve dhe ahëre shoh: një fëmijë polak, dy fëmijë francezë, një zonjë ruse që studion mjekësinë, dy bullgarë prej të cilëve njëri vete në shkollë të drejtësisë, tjetri në të mjekësisë, tre grekë, njëri prej të cilëve del këtë mot inxhinier dhe dy të tjerë që bëjnë mësim në lice, një italiankë, një turk dhe një shqiptar që kanë ardhur të shkojnë pak kohë këtu ose të mërziten. Në mes të kaq të huajve, vendasit mbeten të pakë: vetëm pesë; dhe ata duken si të huaj, sepse të huajt bëjnë shumicën.

• **shkollimit, arsimit;** Kemi dhe do të kemi gjithnjë nevojë për mjekë, për inxhinierë për njerëz të drejtësisë. Lozana për këto tri degë, si edhe për degën e literaturës vjen në shkallë të parë.

• **përshkrimeve;** Këtë e shoh në këta djem; rreth luleve është bar i gjelbërt që e rrethon një gardh, një pëllumb i lartë dhe e ndan atë nga rruga; po askush nuk e kapërcen këtë gardh, nuk zgjat dorën; kurrkujt s'i vjen ndër mend të këputë jo lule, po as fletë. Të tilla kopshte, shëtitore, janë disa këtu në secilindo ka nga një të shkruar ku thuhet se kopshti është në mbrojtje dhe ruajtje të njerëzve, pra gjithë bashkë duhet ta ruajnë e të kujdesen...

• **emrave dhe datave:** qytetin Lozanë., Jemi buzë liqenit Leman, Volteri s'do kish folur ashtu, sikur të kish qenë në Ohër a në Starovë etj.

**Grupi 1.** Çfarë e çudit autorin kur shih një grup djemsh duke luajtur? Në ç'mënyrë kalon autori nga përshkrimi fizik i vendit në detaje të karakterit kulturor?

**Grupi 2.** Përmbledhni dhe diskutoni rreth kuptimit të secilit paragraf.

Përse studentët duhet të studiojnë në Lozanë-Sepse shkollat për mjekë, drejtësi dhe degën e literaturës mbanin vendin e parë?

**Grupi 3.** Në mbresat e udhëtimit mjaft të rëndësishme janë edhe referimet që kanë dhënë më parë njerëz të tjerë apo informacioni që është nxjerrë nga leximet mbi këto vende. A demonstrohen këto në këtë fragment? Ilustrojeni përgjigjen me shembuj në formën e shprehjeve të autorëve të njohur.

**Grupi 4.** Gjatë përshkrimit të mbresave, autori jep edhe këshilla të ndryshme. Lexoni dhe interpretoni mesazhet që përcjellin dy këshillat e mëposhtme:

*Pra gjithë bashkë duhet ta ruajnë e të kujdesen...Pronën joprivate, shtetërore duhet ta ruajmë të gjithë.* Si egoistë të paparë që jemi tregojmë çdo ditë të jetës sonë, që ajo që nuk është e jona private nuk na intereson. Shkatërrojmë bankat dhe mjetet në shkollë duke mos patur konceptin se duhet t'i ruajmë, këpusim lulet në oborr se nuk është oborri i shtëpisë sonë e kështu me radhë. Pra, duhet të mësohemi me rregull!

*Qysh do t'i mësojmë shqiptarët që s'ka të drejtë njeriu që të vrasë një njeri tjetër?*

Megjithëse jemi në mijëvjeçarin e ri, lajmet e kronikës së zezë në media të ndryshme nuk reshtin asnjë minutë. Lajme të cilat tregojnë që bashkëshorti i merr jetën pa të keq fare, bashkëshortes, ku biri i merr jetën prindërve, ku vëllai i merr jetën motrës, ku xhaxhai i merr jetën nipit... e kështu kalvari vazhdon. E gjithë kjo ndodh si pa të keq fare. Është bërë e udhës, askush nuk tronditet për asgjë e askënd. Ende ne shqiptarët nuk po mësojmë se jeta është e shenjtë dhe nuk mund t'ia marrësh dikujt si pa të keq. Duhet të sensibilizohemi dhe të qytetërohemi se jeta është e shenjtë dhe ajo nuk mund të cenohet!

**Grupi 5.** Identifikoni veçoritë gjuhësore të tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme.

Vetë autori thotë: “Nuk dua të mjaftohem me një përshkrim të thatë.” Në fakt, përshkrimi i tij sipas jush është: *dhënë në detaje dhe është mbresëlënës.*

Nga dallojnë: *të vërejmë dhe të bëjmë vërejtje?*

Të vërejmë - të shikojmë me imtësi, pra na tërheq vëmendjen.

Të bëjmë vërejtje - u tërheqim vëmendjen të tjerëve për diçka,

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Shkrim i lirë*

*\*Udhëzohet nxënësit të shkruajnë dhe japin mendimin e tyre rreth temës.*

Mbresat e udhëtimit zgjojnë mjaft fantazinë e njeriut dhe kërshërinë për të parë vende të ndryshme. Çfarë kërshërie ngjall autori te ju përmes mbresave të tij?

- Dëshira për të parë e vizituar vende turistike e historike.
- Dashuria për vendin tonë.
- Dëshira për t'u arsimuar sa më mirë.
- Dëshira për rregull e ligje e për të pasur shtet që funksion. Etj.

**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna, aktivizimin gjatë orës së mësimit, bashkëpunimit në grup etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani mbresat e një udhëtimi që keni kryer së fundmi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Një vend i rrallë në majat e Shqipërisë		Situata e të nxënës: Reportazh nga Arshi Pipa “Kruja, historia dhe jeta” <a href="http://www.shqiptarja.com/kulture/2730/reportazh-kruja-historia-dhe-jeta-283727.html">http://www.shqiptarja.com/kulture/2730/reportazh-kruja-historia-dhe-jeta-283727.html</a>	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth zonës së Kelmendit dhe fshatit Lepushë;</li><li>- dallon karakteristikat e reportazhit;</li><li>- analizon problemin kyç që ngrihet në reportazh;</li><li>- vlerëson qëndrimin e autorit në reportazh.</li></ul>		Fjalët kyçe: Vend turistik Turistë Bukuri e rrallë Vend malor Investime Shtëpi pritjeje	
Burimet: Libri i nxënësit <a href="http://www.shqiptarja.com/kulture/2730/reportazh-kruja-historia-dhe-jeta-283727.html">http://www.shqiptarja.com/kulture/2730/reportazh-kruja-historia-dhe-jeta-283727.html</a>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gazetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi, Pyetja sjell pyetjen, Punë në dyshe Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Stuhi mendimi			
<div><div>Mbështetet në fakte të vërtetuara.</div><div>Ai botohet në gazetë, në radio, në televizion ose në mediat elektronike.</div><div>Prania e autorit në vendin e ngjarjes</div><div>Reportazhi</div><div>Faktet paraqiten nga këndvështrimi i reporterit.</div><div>Reportazhi është një përshkrim artistik që u bëhet ngjarjeve dhe njerëzve të vërtetë.</div></div>			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Pyetja sjell pyetjen

**Dy fjalë për fshatin Lëpushë**

Fshati Lëpushë

Fshati Lëpushë ndodhet 21 km larg Tamares dhe 10 km më në juglindje të fshatit Vermosh. Ky fshat gjendet 1200 m mbi nivelin e detit dhe vlerësohet si kryevepra e natyrës së Kelmendit. Ai shtrihet në një luginë të butë të veshur me gjelbërim, ku pranë saj ngrihen Bjeshkët e Namuna, vendi ku lindën legjendat dhe eposi i Kreshnikëve. Të pasionuarit pas speleologjisë këtu mund të gjejnë mjaft shpella interesante. Shtigjet e shënuara do ju shpëjnë në itinerare shumë të bukura. Në Lëpushë do të provoni reçelin e boronicës dhe të luleshtrydheve të pyllit, rakinë e sanzës etj. Do të argëtoheni në festën e “Logut të Bjeshkëve”, ku do të njiheni me veshjet tradicionale, këngët e vallet e Kelmendit.

Emri i fshatit mendohet se rrjedh nga një bimë barishtore me gjethe të mëdha dhe lule të verdha që quhet Lëpushtra (*Caltha palustris*) e cila gjendet me shumicë në këtë fshat. Ky është fshati me reshjet më të mëdha të dëborës, trashësia e saj në male ka arritur deri 425 cm. Në majat e Bjeshkëve të Namuna, dëbora qëndron gjatë gjithë vitit. Lugina e Lëpushës është si një pistë natyrore për ski dhe ditët e shumta me dëborë e favorizojnë zhvillimin e këtij sporti. Ky fshat dallohet për kontraste të mëdha të relievit, të cilat i japin asaj bukuri panoramike. Në këtë fshat mbizotëron gjelbërimi. Pyjet përbëhen nga dru ahu dhe halor. Në livadhe e kullota rriten shumë lloje bimësh e lulesh. Për vlerat floristike të këtij fshati studiuesi dhe paleontologu hungarez Franc Nopça shkruante: “Njeriu mund të besonte që gjendej në pyllin e Vjenës, sikur të mos gjendej aty maja kërcënuese e Trojanit”. Ky fshat është shumë i pasur me bimë mjekësore si: boronica, balsami, sanza, bar shpatorja, cermerdelli, dëllinja e kuqe dhe e zezë etj. Përveç florës edhe fauna është e pasur. Vlen të përmenden Shqiponja e malit (*Aquila crysaetus*) dhe Shkaba (*Gyps fulvus*), të cilat i ndërtojnë foletë në shkëmbinj të Bjeshkëve të Namuna dhe që i kanë dhënë emrin vendit tonë “vendi i shqiponjave”.

*Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe më pas punohet me të kuptuarit e tekstit.*

**Kuptojmë tekstin**

**Pasi të lexoni reportazhin, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.**

- Për ku udhëton grupi i xhirimit të reportazhit? Në Lëpushë

- Në cilën zonë të Shqipërisë ndodhet Kelmendi?

*Komuna Kelmend është një komunë në Rrethin e Malësisë së Madhe në Shqipëri.*

- Cilat janë vlerat kulturore të zonës?

*Duke u bazuar në dokumente të shkruara dhe gjetje arkeologjike, mendohet se banorët e Kelmendit janë vendosur në Kelmend që në kohët e lashta dhe kanë vazhduar të jetojnë në këtë vend deri në ditët tona. Në fshatin Selcë, është gjetur prej kohësh, një thesar monedhash ilire dhe mendohet se njerëzit kanë banuar në shpella që në kohë shumë të lashta. Kohët e fundit janë gjetur fragmente qeramike të bronzit të hershëm, enë bakri e hekuri, fosile kafshësh dhe vizatime me thëngjill në shpellën e Lule Ndreut, në Grishaj të Vuklit.*

- Ç’vlera të tjera ka zona?

*Shtëpitë e fshatit janë ndërtuar në formë kullash. Burime të shumta ujore, si Gurra e Pepushajve janë shpallur monumente të natyrës. Shpella e Prek Calit, shpella e shkëmbinjve të Gurrës së Gegëve dhe shpella e Vushës janë pikat më interesante për t’u vizituar. Në zonë rriten bimët mjekësore dhe aromatike si: boronica, mjedra, blini, salepi.*

- Cili mendoni se është problemi i ngritur në këtë reportazh?

*Një vend me bukuri të rralla natyrore, por që ne shqiptarët nuk ia dimë vlerën. Një vend i ngjellur në harresë, mungesa e projekteve, financimeve, mbështetjes, tregut etj., janë vetëm disa ndër elementet, që i kanë mbajtur ngërthyer ekonomitë e vogla të familjeve të fshatit.*

Çfarë kërkon të thotë autori me fjalinë mbyllëse të reportazhit?

*Një thirrje si ato migjenianet për t’ia ditur vlerat këtij vendi të vogël, por me kaq vlera.*

**Analizojmë tekstin**

**Gjeni paragrafin në të cilin autori:**

**ngre problemin kyç;** Kamera e një televizioni ka shkuar rreth 88 kilometra nga qyteti i Shkodrës, drejt një destinacioni me bukuri të rralla e me mundësi të jashtëzakonshme turistike. Një vendi që, nëse do të ishte pjesë e Francës, Austrisë, Zvicrës e kudo tjetër, do të gjendej në të gjitha kartolinat, që do të shpërndareshin në të gjithë Evropën. Ndërsa në Shqipëri, ai nuk është reklamuar kurrë aq sa duhet.

**përshkruan vendin;**

Veç turizmit ka edhe shumë mundësi të tjera. Zona ka bimë medicinale, është e pasur në kërpudha, boronica, luleshtrydhe të egra, mjedra, salep etj. Ka mundësi të mëdha për bujqësi dhe blegtori.

**paraqet episode të jetës;** në fshat banorët kanë bërë jo pak investime nga ana e tyre. Mjafton të përmendësh faktin se, në fshat ka mbi 6 shtëpi pritjeje.

**pasqyron qëndrimin e tij;** në Lëpushë do të mund të rrije gjatë, duke larguar zhurmën e bezdisjen e qyteteve të mëdha, duke hedhur tej ndotjen dhe kaosin e kudondodhur. Sa shumë mundësi ka ky vend, e sa pak ne i shfrytëzojmë këto mundësi.

**tregon për rrudhjen e jetesës në vend;** deri në vitin 1990, fshati ka pasur rreth 320 banorë; sot ka rreth 150.

**Gjeni fjalët kyçe të paragrafit të fundit.**

Nxënësit punojnë për të gjetur fjalët kyçe në të.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Puno në dyshe

**Gjuha e tekstit**

**Gjuha e reportazhit përmban terma dhe fjalë të fushës së turizmit. Gjeni pesë të tilla dhe**

**përcaktoni klasën e fjalëve ku ato bëjnë pjesë.** Destinacion-emër, reklamimi-emër, turist-emër shtëpi pritjeje-GE (emër+emër)

**Dalloni emrat e përveçëm në këtë reportazh. Çfarë emërtojnë ata?**

**Zbërtheni kuptimin dhe ndërtimin gjuhësor të titullit të reportazhit:** “Një vend i rrallë në majat e Shqipërisë.”

**Diskutim: Nxënësit reflektojnë rreth tekstit.**

**Reflektojmë rreth tekstit**

**Vlerësoni:**

- qëndrimin e autorit të reportazhit;
- rëndësinë kulturore të zonës;
- stilin e përshkrimit.

Nxënësit japin mendimet e tyre me argumente.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një reportazh rreth një problemi mjedisor.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të shkruajmë Tema mësimore: Shkrimi i një artikulli		Situata e të nxënës: Artikuj nga gazeta të ndryshme	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon artikullin nga shkrimet e tjera si: reportazhi, njoftimi, udhë përshkrimi etj.;</li><li>- analizon hapat që ndiqen në shkrimin e një artikulli;</li><li>- shkruan një artikull duke respektuar karakteristikat e tij;</li><li>- vlerëson artikujt që lexon në gazeta, media online dhe rrjete sociale.</li></ul>		Fjalët kyçe: Artikull Titull Hulumtim Audiencë	
Burimet: Libri i nxënësit, artikuj nga gazeta të ndryshme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve: Bashkëbisedim, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Shkrim i lirë			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim			
A e dini se çfarë është artikulli?			
Si shkruhet ai?			
A ka një strukturë të mirëcaktuar?			
A ka kritere për vlerësimin e tij?			
Artikujt janë shkrime që botohen në gazeta apo në mediat online, në të cilët trajtohen tema të ndryshme të realitetit dhe jetës. Ata shprehin probleme, japin shembuj dhe ofrojnë këndvështrime të ndryshme për zgjidhjen e tyre.			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Udhëzohen nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë e të mbajnë shënime të strukturuar.

Për të shkruar një artikull duhen ndjekur hapat e mëposhtëm.

**Së pari** zgjidhni një temë

Tema e artikullit përbën edhe titullin e tij.

Artikulli

Shkruesi i artikullit duhet ta ketë të qartë se kujt i drejtohet artikulli.

Mendoni se për kë po e shkruani artikullin. Çdo artikull ka një grup njerëzish që i drejtohet.

Në fund, vendosni fotografi të ndryshme.

Kërkoni më shumë për temën.

Vendosni sa i gjatë do të jetë artikulli. Ai mund të jetë një, dy ose maksimumi tri faqe.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë zinxhir artikullin e dhënë në tekst i shkruar nga një bashkëmoshatar. Punohet me modelin e librit në këtë etapë.

Pas leximi të pjesës diskutoni për karakteristikat e artikullit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Bashkëbisedim, Shkrim i lirë

Cilat është tema e artikullit të shkruar nga moshatari juaj? Marrëdhënia mësues-nxënës

A ka ai shembuj dhe informacion të saktë?

A përputhet përmbajtja e tij me realitetin shkollor?

Cilat janë disa nga karakteristikat e gjuhës së përdorur në të?

Pas diskutimit filloni të mendoni për strukturimin e artikullit për gazetën e shkollës me temë: **“Lojërat online dëmtojnë rëndë shëndetin e fëmijëve dhe ulin përqendrimin në të mësuar”**

Koha për të shkruar artikullin është e pamjaftueshme, ndaj merret detyrë për ta përfunduar në shtëpi.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e karakteristikave të artikullit, për pjesëmarrjen në diskutim etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një artikull për gazetën e shkollës me temë:

*“Lojërat online dëmtojnë rëndë shëndetin e fëmijëve dhe ulin përqendrimin në të Mësuar”.*

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruarit</b>		<b>Situata e të nxënës:</b>	
<b>Tema mësimore: Mbrojtja e mjedisit</b>		Artikuj për mbrojtjen e mjedisit	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</div> <div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			

<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>shkruan një artikull sipas karakteristikave të tij;</li> <li>diskuton me shokët për artikujt e krijuar prej tyre;</li> <li>vlerëson punët e shokëve dhe vetëvlerëson punën e tij.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Artikull Titull Hulumtim Audiencë
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Pyetje-përgjigje, Punë e pavarur me shkrim, Reflekto/Reflekto/Reflekto <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Pyetje-përgjigje Mësuesi/ja nxit nxënësit të rikujtojnë dhe një herë informacionet e marra në orën e parë. <b>Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetjet:</b> Çfarë dini për shkrimin e një artikulli? Cilat janë hapat që duhen ndjekur për të shkruar një artikull? Cilat janë karakteristikat e gjuhës së përdorur në të? <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë e pavarur me shkrim Mësuesi/ja jep si detyrë në klasë të bëjnë një artikull me temë: “Mbrotja e mjedisit”. Tërhiqet vëmendja që nxënësit të respektojnë karakteristikat e shkrimit të një artikulli. Lihen nxënësit të punojnë të qetë. Mësuesi/ja ndjek punët e tyre dhe i ndihmon kur ata i kërkojnë ndihmë apo kanë paqartësi. <b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Reflekto/Reflekto/Reflekto Pasi nxënësit mbarojnë punimin e tyre përzgjidhen nga mësuesi/ja ose me dëshirën e tyre dy-tre nxënës për ta lexuar punimin. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje dhe diskutojnë për punët e shokëve dhe japin vlerësimin për njëri-tjetrin. Puna depozitohet në portofol. <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për analizën e gjuhës së një artikulli, si dhe në diskutimin e punës me shkrim.	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuhë dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur rrethore Kohore dhe vendore		Situata e të nxënës: Peizazh vjeshte Ndërto një tekst ku të përdorni fjali me pjesë të nënrenditur kohore dhe vendore.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
<div>- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</div> <div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>- dallon fjalitë me pjesë të nënrenditur kohore nga ato vendore;</div><div>- argumenton rendin e pjesë së nënrenditur në raport me pjesën kryesore;</div><div>- krahason rrethorët e vendit e kohës me fjalitë e varura kohore dhe vendore.</div></div>		Fjalët kyçe: Rrethor kohe Rrethor vendi Fjali e varur kohore Fjali e varur vendore Pjesë kryesore Pjesë e nënrenditur	
Burimet: Teksti mësimor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Pyetja sjell pyetjen, INSERT, Punë në dyshe

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Pyetja sjell pyetjen

**Sa lloje rrethanorësh njihni? Listojini ata.**

Rrethanorë kohe, vendi, shkaku, qëllimi, mënyre dhe sasi.

**Çfarë tregon rrethanori në një fjali të thjeshtë?**

Rrethanori tregon rrethanën e kryerjes së veprimit.

**Kthe rrethanorët e kohës në pjesë të varura rrethanore.**

Treni u boshatis një të mbërritur në stacion.

Treni u boshatis, sapo mbërriti në stacion.

Me fillimin e shirave, trafiku rëndohej më keq.

Kur fillonin shirat, trafiku rëndohej dhe më keq.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Tabela INSERT

\*Udhëzoi nxënësit se këtë fazë të mësimi do të punohet me tabelën INSERT.

V	+	----	?
Fjali me pjesë të nënrenditur kohore	Pjesa e nënrenditur kohore mund të qëndrojë në tri pozicione në raport me pjesë kryesore:  para, pas dhe në mes të pjesës kryesore.		Si lidhet pjesa kryesore me pjesën e nënrenditur?
Fjali me pjesë të nënrenditur vendore	Pjesa e nënrenditur vendore mund të qëndrojë në tri pozicione në raport me pjesën kryesore.		

**Punohet ushtrimi 1 fq. 229 bëhet dallimi midis rrethanorëve të kohës dhe fjalive të varura kohore**

Me të marrë lajmin, doli vrik nga shtëpia.

Sa herë që binte shi, banorët i kthenin sytë nga sipërfaqja e lumit.

Mbrëmjeve, kur ndizeshin dritat e qytetit, burri me kitarë i drejtohej urës së vjetër.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Punohen ushtrimet 1-4 në faqen 229.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e fjalive me pjesë të varura rrethanore kohore dhe vendore nga rrethanorët e kohës dhe vendit.

Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gatë kësaj ore mësimi.

# TEST

## Tremujori i dytë

Tregtarë flamujsh (fragment)

Ernest Koliqi

Në raftat deri në tavan që rrethojshin katër zdatkat e odës, tue lanë lirshëm vetëm katrorin e dritores kah oborri mbas dugajës, rrijshin pilue qinda paketash të trasha mbështjellë në letër zverdhurke. Letra e shkyeme vende vende lëshonte pre do paketash skjepin e ndonji kindi të kuq. Disa gypa të gjatë qepë në beze shifeshin të mbështetun pingul për rafta. Hjedhun në një kand afër dritorje venitej të kuqtë e një flamuri me shtizë veshë në kadife. Përbante mija flamujsh ajo odë e errtë. Vjerrshatari i ri, mësue qyshë prej rinisë ma të parë me shndrrue ndjesitë e pacaktueme në parafytyrime të gjalla, mendoj: "Mija agimesh epopeje të kuqe fjetë në burgun e një kohe të mugët".

Humbi në një fluturim të vrikshëm lyrike. I pau ata flamuj të shtjelluam në një dritë të gjalle fitoresh kumbore, në krye të një kombi të lirë mbi udhë plot brohorina t'ardhëmenisë kur era e larit tymonte e pastër drejt qiellit. I pau ato shqipe të zeza tue lirue nga burgu i errët i një kohë te zezueme e tue rrahë flatrat nëpër ajri të kuqe si ëngjij drejtësie kah skajet ma të fshefuna të maleve e të fushave t'atdheut.

- A shef si kam ra mbrendë? Tue mbajtë uzdaë se nuk do të rrinte shtëpi pa e marrë ka një, i porosita me turra. Por s'blen kurrkush. Me kanë mbetë pa u shitë. Mjaft, pra, ia kam ulë çmimet.

Zani me tinguj metalikë theu shortin e vegimit të largët ajruer. Një zemërim i hovshëm iu gjinikue djaloshit përbrenda. Kërkoj me mend një të shame që t'i përshtatet.

- Gjynah me mbetë pa u shitë ky farë malli!

Ndërsa me dorën e rrëmakët mbante shtizën, rroku me atë të djathtë një kind të pëlhurës së kuqe e ju afrue djaloshit tue e ndukë.

- Shih sa cohë e mirë!

Po të vronte dy duer të ndyta tërbue n'epsh shtazarak tue u shtri kah trupi i një krijatyre të njomë e të dashur, përqethje ma e rreptë s'ia kish tronditë mishin e shtatit. Befas e me rrëmbim vërvitës vërviti duert përpara e ia hoq pëlhurën tregtarit. Ky zgërdhuci syt. Hilush Vilza tha me za t'ultë, por të ndezun:

- Mos e prek me ato duer .

Me za që i dridhej prej pezmit, tjetri ia kthei:

- Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeto me prralla, bieru mbas andrrave. Me vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe, me shka shof un. Hajt, hajt, qit bejta e dueje Shqipnin: bejta e Shqipnija kan me të qitë në dritë...

U afrue edhe ma tepër e pëshpëriti si në një fishkullimë

- U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht? E tash, jashtë...

- Kadalë... ia priti djaloshi me t'egër e sytë i vetuen: - dal vetë, s'ashtë nevoja me më qitë jashtë ti. Por edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire ne vesh si at këshillë qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrehesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallëve qyshse je ndry në këtë dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri i yt. E sa për Shqipni po të siguroj un se ka me qindruë. Prandej mos ban merak se edhe flamujt kanë me t'u shitë krejt. Por rueje shpirtin t'and mos t'ia shtish dreqit. E Hilush Vilza doli, lehtësue në zemër nga ai shkrim, me thithë ajr të kulluet n'udhë sepse era e asaj dugaje i mirrte frymën.

**1- "Tregtarë flamujsh" është:** 1 pikë

- a) roman;
- b) tregim;
- c) skicë;
- d) dramë.

**2- Personazhet janë në kundërvënje me njëri-tjetrin, sepse i ndan:** 1 pikë

- a) besimi fetar;
- b) brezat;
- c) mjedisi;
- d) mentaliteti.

3- Përshkruaj personazhin e tregtarit me cilësitë më tipikë të tij. 2 pikë

---

---

---

4- Përshkruaj personazhin e Hilush Vilzës. Ku ndryshon ai nga tregtari? Gjen në tekst një ndryshim midis tyre. 4 pikë

---

---

---

5- A është flamuri për tregtarin një mall për t'u shitur e fituar, si gjithë mallrat e tjerë? Gjej në tekst një moment ku duket kjo. 2 Pikë

---

---

---

6- Si i kuptoni fjalët e tregtarit. Jep mendimin tënd se çfarë ka dashur të thotë Hilush Vilza me këto fjalë: “Ti thue se jeton, por rrehash. Ti je shlye prej numrit të të gjallëve qyshse je ndry në këtë dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri i yt. E sa për Shqipni po të siguroj un se ka me qindruë. Prandej mos ban merak se edhe flamujt kanë me t'u shitë krejt. Por rueje shpirtin t'and mos t'ia shtish dreqit. E Hilush Vilza doli, lehtësue në zemër nga ai shfrim” 2 Pikë

7- Mendoni për një moment, sikur Hilush Vilza është bërë palë me mendimin e tregtarit, se flamujt janë mjete për të bërë tregti. Si do të rridhnin ngjarjet më pas? Shkruani një përfundim të skicë sipas këtij supozimi. 2 pikë

*Pjesa: Njohuri gjuhësore*

1- Bashko fjalitë e dhëna në një fjali të përbërë. Analizoni mjetet e lidhjes. 2 pikë

*Mua më pëlqen teatri. Ai parapëlqen kinemanë.*

---

---

2- Ndërto dy fjali ku që të përdoret si përemër lidhor dhe një herë lidhëz. 2 pikë

---

---

3- Ndërto dy fjali ku folja jam të përdoret si folje ndihmëse dhe me kuptimin e saj të plotë. 2 pikë

---

---

4- Fjalët pranë dhe drejt përdori në fjali si ndajfolje dhe si parafjalë. 4 pikë

---

---

---

5- Gjej dy emra që përdoren vetëm në numrin shumës. 2 pikë

---

---

---

6- Gjej mbiemrat në fragmentin më poshtë dhe në dy prej tyre përcakto kategoritë gramatikore. 4 pikë

Humbi në një fluturim të vrikshëm lyrike. I pau ata flamuj të shtjelluam në një dritë të gjalle fitoresh kumbore, në krye të një kombi të lirë mbi udhë plot brohorina t'ardhëmenisë kur era e larit tymonte e pastër drejt qiellit. I pau ato shqipe të zeza tue lirue nga burgu i errët i një kohë te zezueme e tue rrahë flatrat nëpër ajri të kuqe si ëngjuj drejtësie kah skajet ma të fshefuna të maleve e të fushave t'atdheut.

---

---

## 7- Ndërto dy fjali me pjesëza përcaktuese-saktësuese dhe dyshuese. 2 pikë

## 8- Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. 2 pikë

Duhet përcaktuar pikë për pikë zgjatja dhe natyra e këtij ndryshimi.

Frynte ere dhe gjethet binin.

## 9- Ndërto 4 fjali me fjalën “gjyshi” të dalë si kryefjalë, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë, përcaktor. 4 pikë

## 10- Dallo kallëzuesin foljor nga ai emëror: 2 pikë

*Ecte duke fishkëllyer,*

*Nata ishte e qetë dhe e ftohtë.*

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-10	11-15	16-21	22-25	26-30	31-35	36-40

## ZGJIDHJA E TESTIT

1- B

2- D

3- Tregtari në skicë paraqitet si një njeri **pa parime dhe materialist**.

Malli, që kishte menduar të fitonte sa më shumë kishte qenë flamuri, duke menduar se shqiptarët janë patriotë dhe do ta blinin me vrap, sa ai ta fuste në dyqan. Paratë për të kishin më shumë rëndësi se çdo gjë tjetër.

*A shef si kam ra mbrendë? Tue mbajtë uzdajë se nuk do të rrinte shtëpi pa e marrë ka një, i porosita me turra. Por s'blen kurrkush. Me kanë mbetë pa u shitë. Mjaft, pra, ia kam ulë çmimet.*

Është figura tipike e një tregtari.

4- Hilush Vilza është ëndërrimtar, pra idealist, poet, njeri me parime. Atdheu për të ishte gjithçka. Ndryshimi:

Tregtari - materialist *m'u shitën, a s'u shitën flamujt, qëndroi apo jo Shqipëria, unë kam mjaft me jetue.*

Hilushi - idealist

*Po të vronte dy duer të ndyta tërbue nëpsh shtazarak tue u shtri kah trupi i një krijatyre të njomë e të dashur, përqethje ma e rreptë s'ia kish tronditë mishin e shtatit. Befas e me rrëmbim vërvitës vërviti duert përpara e ia hoq pëlhurën tregtarit. Ky zgërdhuci syt. Hilush Vilza tha me za t'ultë, por të ndezun:*

*- Mos e prek me ato duer.*

Mendimi që kanë të dy për atdheun është i ndryshëm.

5- Po ai mendon për flamurin që është shenjë e kombit, simbol i identitetit kombëtar, po të njëjtën gjë që mendon për mallrat e tjerë.

*- Gjynah me mbetë pa u shitë ky farë malli!*

*Shiko ca cohë e mirë.*

6- Për poetin ishte e paimagjinueshme që të mos kishte parime, që atdheu dhe simbolet e tij të ishin të ktheheshin në mall. Megjithatë si idealist ai kishte bindjen se pavarësisht qëndrimit të tregtarit ndaj vendit të tij, Shqipëria nuk do të vdiste, sepse ekzistonin ende njerëz që mendonin për ardhmërinë e saj.

**Njohuri gjuhësore**

1- Bashkoni fjalitë e dhëna në një fjali të përbërë. Analizoni mjetet e lidhjes.

*Mua më pëlqen teatri. Ai parapëlqen kinemanë*

*Mua më pëlqen teatri, kurse ai parapëlqen kinemanë.*

*kurse - lidhës e përngjitur*

2-

a) Nxënësit që lexojnë vazhdimisht, kanë më shumë pyetje se të tjerët. **përemër lidhor**

b) I porosita nxënësit, që të përgatiteshin më mirë. **lidhës**

3- Unë jam 14 vjeç. **kuptim i plotë**

Qenke veshur e stolisur si rrallë herë. **ndihmës**

4- Pranë

Ai erdhi drejt meje me hap të lehtë. **paraafjalë**

Rri drejt! **ndajfolje**

Më qëndro pranë dhe mos u largo! **ndajfolje**

Pranë meje qëndronte një burrë i moshuar. **paraafjalë**

5- Pantallona, syze

6- Humbi në një fluturim **të vrikshëm** lyrike. I pau ata flamuj të shtjelluam në një dritë **të gjalle** fitoresh **kumbore**, në krye të një kombi **të lirë** mbi udhë plot brohorina t'ardhëmenisë kur era e larit tymonte **e pastër** drejt qiellit. I pau ato shqipe **të zeza** tue lirue nga burgu i **errët** i një kohë **te zezueme** e tue rrahë flatrat nëpër ajri **të kuqe** si ëngjuj drejtësie kah skajet **ma të fshefuna** të maleve e të fushave t'atdheut.

Burgu i errët -

I errët – gj. mashkullore, numri njëjës, rasa emërore, shkalla pohore

Fluturim të vrikshëm

Të frikshëm – gj. mashk. Nr. njëjës, rasa kallëzore, shkalla pohore

7- Pse pikërisht sot duhet të shkojmë?!

Kushedi sa po heq ai njeri!

8- Duhet përcaktuar pikë për pikë zgjatja dhe natyra e këtij ndryshimi. - **E thjeshtë**

Frynte erë dhe gjethet binin. - **E përbërë**

9- Gjyshi

Gjyshi im është gjyshi më i mirë në botë.

Gjyshin tim e kanë idhull fëmijët e tij.

Me gjyshin tim unë krenohem.

Ditari i gjyshit rrëfen shumë histori.

10- Ecte duke fishkëllyer. **kallëzues foljor**

Nata ishte e qetë dhe e ftohtë. **kallëzues emëror**

# TREMUJORI I TRETË

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Të lexuarit Tema mësimore: Së shpejti, kompjuterët emocionalë		Situata e të nxënit: Diskutojmë për robotët Robotët dhe jeta jonë A mund të mendojë një robot? A mund një robot të ketë sjellje inteligjente? A mund një robot të ketë ndërgjegje? A mund një robot të ketë emocione? Asimo një robot human i krijuar nga Honda. I gjatë 130 cm Pesha 54 kg Lëviz me shpejtësi 6 km/orë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton për robotët e përdorimin e tyre në të përditshmen;</li><li>- diskuton për veçoritë e tekstit shpjegues;</li><li>- analizon dukurinë e inteligjencës artificiale;</li><li>- analizon tiparet e kompjuterit emocional;</li><li>- shpjegon ngjashmërinë e trurit të njeriut me atë të kompjuterit emocional.</li></ul>		Fjalët kyçe: Tekst joletrar Shpjegues Robotë emocionalë Inteligjencë artificiale Tru	
Burimet: Libri i nxënësit, <a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca_artificiale">https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca_artificiale</a> <a href="http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/07/11/a-do-te-kene-se-shpejti-kompjuteret-emocione/">http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/07/11/a-do-te-kene-se-shpejti-kompjuteret-emocione/</a>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve: Parashikim me anë të titullit, Diskutim, Pyetje-përgjigje			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Parashikim me anë të titullit			
“Së shpejti kompjuterat emocionalë” ky është titulli i tekstit që do të lexoni tani.			
Parashikoni se çfarë do të lexoni. Për ç`lloj teksti do të flasim?			
Diskutojmë së bashku me nxënësit.			
Informacion shtesë për mësuesin			
<ul style="list-style-type: none"><li>○ Degë e shkencave kompjuterike që merret me sjelljet inteligjente, të mësuarit dhe përshtatjen në makina.</li><li>○ Përfshin një numër të madh aplikacionesh si simulatorë software-ik dhe robotike.</li></ul>			
Inteligjenca artificiale është aftësia e kompjuterit për të vepruar si qenie njerëzore. Po përdoret shumë në kohët e fundit te video-lojërat, ku lojtari vepron si një njeri i vërtetë.			
John McCarthy ishte i pari që përdori termin “Inteligjencë artificiale” në vitin 1956 dhe e definojë atë si shkencën dhe inxhinierinë e krijimit të makinave inteligjente.			
Në jetën e përditshme ne posedojmë disa makina që janë të programuar të kryejnë disa punë si marrja e të dhënave, regjistrimi i të dhënave, përshtatin klimën në mënyrë automatike, transferojnë të dhënat, modifikojnë informacionet për një shpejtësi marramendëse me precizitet të lartë të cilat makina ne i njohim si sisteme kompjuterike, apo ndryshe siç njihen në gjuhën e psikologëve kognitiv si produkte të inteligjencës artificiale. Inteligjenca artificiale përdoret më së shumti në video lojëra ku kompjuteri vepron si të ishte një lojtar. Pothuajse të gjitha videolojërat përmbajnë një nivel të caktuar të inteligjencës artificiale, llojet kryesore të A I (artificial intelligence) prodhojnë karaktere që lëvizin në platforma standarde dhe kryejnë veprime të paracaktuara. Përdorimi i inteligjencës artificial në fushat si:			

### **Meteorologji**

Së shpejti, shkencëtarët mund të jenë në gjendje të parashikojnë motin më mirë duke përdorur softuer të inteligjencës artificiale, të cilat mund të shohin përmes të dhënave komplekse. Kur ky softuer shih një stuhi të madhe që vjen, kjo automatikisht do të lëshojë alarm në mënyrë që t'i paralajmëroj banorët dhe mediat, dhe kjo mund të ndihmojë në shpëtimin e jetës.

### **Bujqësi**

Me anë të inteligjencës artificiale, shkencëtarët mund së shpejti të jenë në gjendje të përdorin robotët ose pajisje të tjera për të pastruar mjedisin dhe për të zvogëluar efektet e ajrit dhe ndotjes së ujit. Programe të avancuara softuerë do të lejojnë këto makina për të dalluar mes organizmave biologjike dhe ndotësve potencial si vaji ose mbeturinave të rrezikshme.

### **Transporti**

Me anë të inteligjencës artificiale makinat do të na paralajmërojnë për pengesat e mundshme në mënyrë që t'i të shmangemi aksidenteve, apo edhe do na lejojnë të rrimë duarkryq dhe makina të lëviz vetë. Inteligjenca artificiale shpejti mund të bëjë gjithë këtë të mundshme, duke përdorur kamera, sensorë dhe softuerë të posaçëm ndërtuar në automjet. Prodhuesit tashmë mbështeten në këtë teknologji për të bërë mbështetjen dhe parking të sigurt.

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca\\_artificiale](https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca_artificiale)

### **Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim**

Lexohet teksti nga nxënës të ndryshëm e më pas shpjgojmë veçoritë e tekstit shpjgues informues dhe merremi me shpjegimin e fjalëve të reja.

Teksti shpjgues prezanton, sqaron, tregon dhe informon objektivisht, duke thelluar idetë në një fushë të caktuar. Për të arritur këtë qëllim shpjegimi ndërthuret me forma të tjera të ligjërimit: tregimin dhe përshkrimin.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe**



### **Kuptojmë tekstin**

Lexoni tekstin dhe përgjiguni pyetjeve të mëposhtme.

#### **Cila është dukuria e shpjguar në këtë tekst?**

Dukuria e inteligjencës artificiale

#### **Çfarë thonë kërkuesit shkencorë për shpikjen e tyre?**

Kompjuteri që ata do të shpiknin do të jetë i aftë për të ndjerë brenda një viti i gjysmë.

#### **Cilat do të jenë aftësitë e kompjuterit emocional?**

Aftësitë e tij: a) ai do të jetë në gjendje të kuptojë kontekstin e asaj që po ndodh, b) si dhe të kuptojë ngjarjet që do të vazhdojnë të rrjedhin c) të mendojë si një njeri.

Makineria ka nevojë për aftësinë për të studiuar, jo përmes programimit apo mësimi përmes përsëritjes, por përmes mendimit si një person i caktuar, thanë kërkuesit shkencorë. Makineria në vetvete do të mund të vendosë synime të mësimi, të formulojë pyetje për të arritur këto synime dhe të kërkojë vazhdimisht për përgjigje.

#### **Ku u mbështetën kërkuesit shkencorë për të përsosur punën e tyre?**

Në funksionin e trurit njerëzor

#### **Cili është shpjegimi shkencor i procesit të funksionimit të kompjuterave emocionalë?**

#### **Si do të jetë pamja e jashtme e tyre?**

Pamja e tyre nuk do të ndryshojë nga ajo e njerëzve.

**Cila do të jetë përparësia e inteligjencës artificiale?**

Unë besoj se do të jetë një forcë madhore për të ecur përpara, një event i madh për racën njerëzore”.

**Pse ajo nuk ka pasojë negative për njerëzimin?**

Tani, mes zhvillimit të armëve biologjike dhe gjenetike, inteligjenca artificiale është ndër zbulimet më pak të dëmshme.

**A ka pasur më parë përpjekje për një shpikje të tillë?** Ky nuk është i pari plan për të ndërtuar një robot me emocione.

Kompania *Sony* ka lajmëruar më herët se këtë vit misionin për ta bërë të aftë një robot që të krijojë lidhje emocionale, pra të ketë inteligjencën artificiale duke menduar si njerëzit

Diskutojmë së bashku rreth të kuptuarit e tekstit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin hulumtimin për kompjuterët emocionalë, për diskutimin rreth inteligjencës artificiale etj.

**Detyrë shtëpie:** Kërkoni në internet për zbulime të kohëve të fundit. Shpjegoni veçoritë e tyre.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore: Së shpejti kompjuterat emocionalë</b>		Robotët dhe jeta jonë	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Tekst joletrar	
<div>- hulumton për robotët e përdorimin e tyre në të përditshmen;</div>		Shpjegues	
<div>- diskuton për veçoritë e tekstit shpjegues;</div>		Robotë emocionalë	
<div>- analizon dukurinë e inteligjencës artificiale AI;</div>		Inteligjencë artificiale	
<div>- analizon tiparet e kompjuterit emocional;</div>		Tru	
<div>- shpjegon ngjashmërinë e trurit të njeriut me atë të kompjuterit emocional.</div>			
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, <a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/intelegjenca_artificiale">https://sq.wikipedia.org/wiki/intelegjenca_artificiale</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> tik	
<a href="http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/07/11/a-do-te-kene-se-shpejti-kompjuteret-emocione/">http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/07/11/a-do-te-kene-se-shpejti-kompjuteret-emocione/</a>			
<i><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> Diskutim, Të nxënit në bashkëpunim, Vijë e vlerës</i>			
<i><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim</i>			
Diskutohet detyra e shtëpisë për zbulimet e shkencës kohët e fundit.			
<i><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënit në bashkëpunim</i>			
<i><b>Klasa ndahet në grupe të cilët analizojnë tekstin dhe diskutojnë rreth gjuhës së tekstit</b></i>			
<b>Grupi 1.</b> Shkruani pesë tipare të kompjuterit emocional që pritet të vihet në funksion.			
1) i aftë për të ndjerë;			
2) të mendojë si një person;			
3) të krijojë besim;			
4) të kuptojë kontekstin e asaj që po ndodh;			
5) të kuptojë ngjarjet si do të vazhdojnë të rrjedhin.			
<b>Grupi 2.</b> Gjeni në tekst fjalitë në të cilat autori: jep informacione rreth kompjuterit emocional; jep detaje të vendit ku po bëhet kërkimi dhe të personave të përfshirë në të; shpjegon ngjashmërinë që do të ketë truri i njeriut me kompjuterin emocional; paraqet qëndrimin e tij optimist.			
<b>Grupi 3.</b> Gjuha e tekstit			
Shënoni me tiparet gjuhësore që ka ky tekst.			

**Gjuha e tekstit të mësipërm është:**

- e thjeshtë dhe e qartë;
- pa nënkuptime;
- gjuhë teknike;
- e mbushur me citime;
- e pasur me informacione;
- me përshkrime të detajuara.

Argumentoni zgjedhjen tuaj për secilin rast.

PO

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Vija e vlerës**

A mendoni se shpikja e kompjuterave emocionalë do të jetë e dobishme?

JO

Nxënësit diskutojnë rreth pyetjes së ngritur, ndahet klasa në dy grupe. Secili do të mbrojnë PO/JO mendimin e tyre me argumente.

Në qoftë se dikush do të ndërrojë mendim kalon dhe pozicionohet në krahun ku ndryshon.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha e komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të dëgjuar</b> <b>Tema mësimore: Mbjatja e shënimeve</b>		<b>Situata e të nxënit: Po ti si mban shënime?</b> A keni bllok shënimesh në lëndë të ndryshme? Shikoni mënyrën e organizimit të shënimeve Diskutoni së bashku.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon skemat e organizimit të shënimeve;</li><li>- hulumton për gjetjen e mënyrave e këshillave për të mbajtur shënime në klasë;</li><li>- analizon rolin e shënimeve në të mësuarit.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Shënime Bllok shënimesh Detyra	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, video-projektor, bllok shënimesh		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<i><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Pyetja sjell pyetjen, Punë individuale, Shkrim i lirë</i>			
<i><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> Pyetja sjell pyetjen</i>			
<ul style="list-style-type: none"><li>• Si i mbani shënimet?</li><li>• Si i organizoni ato?</li><li>• A ju shërbejnë ato në të mësuarit ?</li><li>• A ju shërbejnë për të rikujtuar informacionin dhe riprodhuar atë?</li></ul>			
Nxënësit japin mendimet e tyre.			
<i><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë individuale</i>			
<u>Këshilla për mbajtjen e shënimeve në klasë</u>			
1. Siguroheni që keni me vete të gjitha materialet për të mbajtur shënime.			
2. Bëhu dëgjues aktiv gjatë të shpjeguarit të mësimi.			
3. Mbani shënime gjatë kohës së shpjegimit.			
4. Kujdes fjalët dhe konceptet kyçe.			
5. Shënimet i bëni sa më të lexueshme.			
6. Mbajtja e shënimeve të kthehet nga një punë e tmerrshme në një strategji për sukses!			

- Ruani shënimet tuaja në një vend. Nëse jeni duke ruajtur shënimet tuaja në vende të ndryshme, do ta bëjë shumë të vështirë t'i organizoni ato për provime dhe ese kur të vijë koha.
- Në kompjuterin tuaj, sigurohuni që të keni një dosje të veçantë për të diferencuar shënimet. Nëse i vendosni të gjitha së bashku do të jetë e vështirë për t'i gjetur përsëri.
- Është zakonisht më e lehtë për të ruajtur ndonjë shënim të shkruar me dorë, sepse ju mund të shtoni dhe zbrisni faqet sipas nevojës pa pasur nevojë t'i grisni ato.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Shkrim i lirë*

Mësuesi/ja lexon pjesën "Një program për shkëmbim nxënësish" në fq. 132.

Nxënësit në bllokun e tyre të shënimeve organizojnë atë që dëgjojnë duke marrë parasysh këshillat që u dhanë për mbajtjen e shënimeve

**Vlerësimi:** Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna, për mbajtjen e shënimeve gjatë procesit të të dëgjuarit kritik etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur shkakore, qëllimore (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Sot në orën e parë Ana shkoi me vonesë në shkollë. Ndërto një tekst ku të tregoni shkaqet e kësaj vonesë.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon pjesët e nënrenditura në fjalitë e përbëra shkakore dhe qëllimore;</li><li>- dallon mjetet lidhëse, lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore që lidhin pjesën kryesore dhe të nënrenditur;</li><li>- analizon pozicionet e pjesëve të nënrenditura në raport me pjesën kryesore;</li><li>- argumenton përdorimin e presjes që lidh pjesët në fjalitë e përbëra me n/r.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përbërë Pjesë e nënrenditur Shkakore Qëllimore Lidhëza nënrenditëse	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Bisedë, Tabela Insert, Shkrim i lirë</i>			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Bisedë</i>			
<b>Cili prej jush thotë se cila është marrëdhënia që vendoset midis pjesëve në fjalitë dhe vargjet e mëposhtme</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Toka punohej mirë, se ishte gjithë vlagë dhe e qëruar nga gurët.</li><li>• Dilnin çdo mbrëmje për shëtitje, që të merrnin ajër të pastër.</li><li>• Ne mes tuaj kam qëndruar e jam duke përvëlur, që t’u ap pakëzë dritë, natënë t’ua bënj ditë. Do të tretim, të kullohem, të digjem, të përvëlohem, që t’u ndrinj mir’ e të shihni, njëri-tjatërin të njihni.</li></ul>			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> <i>Tabela INSERT</i>			

**Tabela Insert**

<b>+(inf që shtohet)</b>	<b>V(inf që di më parë)</b>	<b>__ (inf që dihet gabim)</b>	<b>?(inf që nuk kuptohet dhe duhet ndihma e mësueses)</b>
<p>Pjesa e nënrenditur qëllimore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren.</p> <p>1) Vendoset pas pjesës kryesore: Toka duhet mirëmbajtur, në mënyrë që të mos i kundërvihet njeriut.</p> <p>2) Vendoset para pjesës kryesore: Me qëllim që të mos i kundërvihet njeriut, toka duhet mirëmbajtur.</p> <p>3) Vendoset në mes të pjesës kryesore: Toka, që të mos i kundërvihet njeriut, duhet mirëmbajtur.</p>	<p>Mes pjesëve të fjalive me nënrenditje shkakore vendoset marrëdhënia shkak-pasojë. Pjesa e varur shpreh shkakun apo arsyen e asaj që thuhet në pjesën kryesore.</p>		
<p>Si mjet lidhës për pjesët e fjalive qëllimore, zakonisht shërben lidhëza që, e cila shpeshherë mund të mos jetë e pranishme, kur pjesa e varur fillon me folje në mënyrën lidhore.</p>			
<p>Pjesa e nënrenditur shkakore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren.</p> <p>1) Vendoset pas pjesës kryesore: Fluturimet kishin vonesë, ngaqë ishte ngrice e madhe.</p> <p>2) Vendoset para pjesës kryesore: Ngaqë ishte ngrice e madhe, fluturimet kishin vonesë.</p> <p>3) Vendoset në mes të pjesës kryesore: Fluturimet, ngaqë ishte ngrice e madhe, kishin vonesë.</p>			

**Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të plotësojnë tabelën e dhënë.**

*Nëse ka ndonjë paqartësi shpjegohet nga mësuesilja.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë e pavarur, Shkrim i lirë

**Zëvendësoni rrethanorët e shkakut me pjesë të varura shkakore.**

Gjethet binin nga era.

*Gjethet binin për shkak se frynte erë.*

Të shkurajuar nga vështirësitë, hoqën dorë nga ky mision.

*Ata hoqën dorë nga ky mision, ngaqë ishin të shkurajuar nga vështirësitë.*

Ata e humbën lojën nga një pakujdesi e vogël.

*Ata e humbën lojën, sepse u treguan të pakujdesshëm.*

Nuk dilet në rrugë për shkak të trafikut të rënduar.

*Nuk dilet në rrugë, sepse është rënduar trafiku.*

#### **Nxënësit punojnë me ushtrimin:**

Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të trajtoni çështje që mbartin situatë shkak/pasojë dhe tregojnë rrethana qëllimore. Vëreni si reflektohen ato në fjalitë që keni përdorur. Përdorni lidhëza, si: *se, sepse, ngaqë, meqë, duke qenë se, për shkak se, nga frika se; që, me qëllim që, në mënyrë që* etj.

*\*Kujdes! Duhet t'i udhëzoni nxënësit që përcaktimi i lidhëzës nuk është kryesore për të caktuar llojin e fjalisë, por duhet të shikojnë rolin e tyre në fjali!*

Mund të ndodh që lidhëza *QË* të përdoret për të lidhur fjali qëllimore, fjali përcaktore, filluese!!!

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për zëvendësimin e rrethanorëve të shkakut me pjesë të n/r shkakore, për analizën e pjesëve të fjalisë së përbërë me n/r shkakore dhe qëllimore etj.

**Detyrë shtëpie:** Ndërto fjali ku lidhëza se të përdoret si lidhëz n/r shkakore dhe filluese.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur shkakore, qëllimore</b> <b>Ushtrime</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon pjesët e nënrenditura në fjalitë e përbëra shkakore dhe qëllimore;</li><li>- dallon mjetet lidhëse, lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore që lidhin pjesën kryesore dhe të nënrenditur;</li><li>- analizon pozicionet e pjesëve të nënrenditura në raport me pjesën kryesore;</li><li>- argumenton përdorimin e presjes që lidh pjesët në fjalitë e përbëra me n/r.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përbërë Pjesë e nënrenditur Shkakore Qëllimore Lidhëza nënrenditëse	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Punë në dyshe, Diagram Veni <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim Diskutohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Në qoftë se ka paqartësi ndërhyjnë mësuesi/ja. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë në dyshe <b>Rishikruani tekstin në gjuhë standarde dhe analizoni mënyrën e shprehjes së marrëdhënieve shkakore e qëllimore në të dy variantet.</b> <i>Ngase ecte ne karroce, e ndiente veten si te ndryme ne nje kosh hekuri. Shikonte perjashta tue mprehe syte me diktue tym zjarmi permby curra apo bandite tue nga ne kuaj neper cuba e gur per me i dale karrocës perpara. Mbasi kaloi disa gryka te vetmueme, u qetesue edhe ngase dita e asaj vjeshte ishte e kthjellët.</i> Ngaqë ecte në karrocë, e ndiente veten si të ndrydhur në një kosh hekuri. Shikonte përjashta duke mprehur sytë për të dalluar (diktuar) tym zjarmi përmbi curra apo bandite duke ngarë kuaj nëpër cuba e gur për t'i dalë karrocës përpara. Mbasi kaloi disa gryka të vetmuara, u qetësua edhe ngaqë dita e asaj vjeshte ishte e kthjellët.			

Rrethanor shkaku	Rrethanorë qëllimi	Fjalë qëllimore
<i>Kapiteni mend fluturonte nga gazi</i>	<i>Hyri në pijetore për të hedhur një gotë vodka.</i>	<i>Në mbrëmje shkoi të shihte teatër.</i>
<i>Nga gazi, merrni vesh, zuri të kërcejë nëpër trotuar.</i>		
<i>...nga frika se mos ndonjë nga fqinjët fuste aty gishtërinjtë...</i>		

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Diagram Venn

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për zëvendësimin e rrethanorëve të shkakut me pjesë të n/r shkakore, për analizën e pjesëve të fjalëve të përbërë me n/r shkakore dhe qëllimore etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha:</b> Gjuha dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Shkalla:</b> IV	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Rubrika:</b> Të lexuar <b>Tema mësimore:</b> Një program për shkëmbim nxënësish (ora 1)		<b>Situata e të nxënës:</b> Pse na pëlqen të studiojmë jashtë shtetit? Kushte më të mira arsimimi Arsim më cilësor Mësues më cilësorë Situata praktike për të vënë në zbatim dijet  Ose “Në shkollën binjake”	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth programit të studimit për nxënësit;</li><li>- diskuton rreth tekstit informues;</li><li>- informohet rreth kushteve që kërkon për t`u plotësuar ky program;</li><li>- analizon strukturën e tekstit të dhënë;</li><li>- argumenton rolin e komunikimit gjatë shkëmbimit të eksperiencave;</li><li>- analizon gjuhën e tekstit të dhënë.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Nxënës Shkëmbim përvojash Informim Shpjegim Hyrje Zhvillim, Mbyllje	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukatë shoqërore, histori	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, Lexim zinxhir/diskutim, Pemë mendimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim

- A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë program për shkëmbim nxënësish?

- A dini raste kur nxënës të moshës 14-17 vjeç kanë shkuar për të studiuar në vende të huaja për të ndjekur shkollën dhe për të jetuar në një familje vendase në mënyrë që të njohë gjuhën, kulturën, zakonet e atij vendi?

**Diskutojmë së bashku, pasi nxënësit për 5-7 min kanë menduar për rastet që kanë dëgjuar ose kanë jetuar familjarët e tyre.**

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Lexim zinxhir, Diskutim

Nxënësit fillojnë lexojnë zinxhir pjesën e dhënë duke u përqendruar tek informacioni që na jep çdo paragraf dhe shpjegimi që jepet për çdo informacion bazë.

Pas leximit të tekstit nxënësit punojnë rreth të kuptuarit e tekstit.

**Kuptojmë tekstin**

Ky tekst ka natyrë informuese dhe shpjeguese. Plotësoni tabelën e mëposhtme, duke mbajtur parasysh këtë veçori të tekstit.


Çfarë informacioni na sjell secili paragraf?	Çfarë shpjegimesh jepen për secilin informacion bazë?
Kufijtë e moshës	14-17 vjeç
Niveli i klasës	Klasat që i korrespondojnë kësaj moshe.
Niveli i rezultateve shkollore	Rezultate shkollore mesatare
Aftësia gjuhësore	Zotërim i rrjedhshëm i gjuhës së huaj
Shëndeti i mirë	Të mos ketë probleme të rënda shëndetësore.
Karakteristika personale	Aftësia për t'u përshtatur, për të bashkëpunuar, singleriteti, besueshmëria etj.

**Diskutojmë së bashku**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Pemë mendimi

Teksti i dhënë është një tekst informues-shpjegues

Cilat janë veçoritë e këtij teksti? Le t'i vendosim në pemën e mendimit.



\*Plotësohet pema e mendimit me informacione të tjera nëse kanë.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi.

**Detyrë shtëpie:** Vendoseni veten në pozitën e një kandidati. Nëse ju do të ishit sot kandidat për të marrë pjesë në një program shkëmbimi për nxënësit dhe do t'ju kërkonin të shkruanit karakteristikat personale, cilat do të ishin ato?

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuar</b> <b>Tema mësimore: Një program për shkëmbim nxënësish (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Në shkollën binjake	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth programit të studimit për nxënësit;</li><li>- diskuton rreth tekstit informues;</li><li>- informohet rreth kushteve që kërkon për t`u plotësuar ky program;</li><li>- analizon strukturën e tekstit të dhënë;</li><li>- argumenton rolin e komunikimit gjatë shkëmbimit të eksperiencave;</li><li>- analizon gjuhën e tekstit të dhënë.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Nxënës Shkëmbim përvojash Informim Shpjegim Hyrje Zhvillim Mbyllje	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> edukatë shoqërore	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bisedë, Të nxënit në bashkëpunim/punë me fisha, Rrjet diskutimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bisedë

**Detyrë shtëpie nxënësve iu dha tema:** “Vendoseni veten në pozitën e një kandidati. Nëse ju do të ishit sot kandidat për të marrë pjesë në një program shkëmbimi për nxënësit dhe do t’ju kërkonin të shkruanit karakteristikat personale, cilat do të ishin ato?”

**Diskutohet detyra e shtëpisë e dhënë në orën e mëparshme. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.**

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënit në bashkëpunim/punë me fisha.

**Ndabet klasa në grupe dhe u shpërndahen fishtat me ushtrimet që do të punojnë me to.**

**Grupi 1.** Ky grup punon duke grumbulluar informacion për karakteristikat që duhet të kenë kandidatët e programit të shkëmbimit të nxënësve.

Nxënësit e këtij grupi rendisin disa kushte që duhen plotësuar.

Kushtet e programit janë:

*Kufijtë e moshës; niveli i klasës; niveli i rezultateve; aftësia gjuhësore; shëndeti i mirë; karakteristikat personale të nxënësit.*

**Grupi 2.** Tregoni si bëhet verifikimi i plotë i nxënësit që dëshiron të marrë pjesë në një program për shkëmbim nxënësish?

**P:** Verifikimi i plotë bëhet me anë të dokumentacionit që plotëson, pra dosjes personale të tij, testimeve, intervistës dhe më pas me anë të rekomandimeve të mësuesve dhe shkollave.

**KUJDES! Këto përgjigje janë sugjeruese, gjithsecili jep përgjigjen e tij mbështetur në argumente!**

**Grupi 3.** Si është shkruar ky tekst? Është e qartë struktura e tij? Çfarë dalloni lehtësisht në këtë strukturë? Shpjegoni lidhjen e qartë kuptimore midis paragrafëve.

Struktura e tekstit është e qartë.

➤ Struktura e tekstit informues:

- **Hyrja:** Një paragraf i shkurtër ku prezantohet thelbi informacionit, që do paraqitet apo shpjegohet.
- **Zhvillimi:** Transmetimi i informacionit sipas shkallës së rëndësisë. Jepen ngjarjet sipas kohës, vendit dhe personave që janë protagonistë në ngjarje.
- **Mbyllja:** Një paragraf i shkurtër ku përmbledhet apo formulohet i gjithë informacioni pa bërë komente apo vlerësime për informacionin e dhënë.

Pse për një program të tillë rezultatet shkollore kalojnë në plan të dytë? Ç’tregon kjo?

U shpjegua dhe në punën e grupit tjetër që ka element më të rëndësishëm se rezultatet, ndaj nuk janë këto parësore.

**Grupi 4.** Gjeneroni detajet, fjalët kyçe dhe shprehjet që tregojnë qartësinë e shpjegimeve të informacionit.

Detaje: 14-17, zotërim i rrjedhshëm i gjuhës

Fjalë kyçe: kufijtë e moshës, aftësitë gjuhësore

Shprehje: të realizojë komunikimin jozyrtar

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Rrjet diskutimi

PO

A përpiqet autori të tërheqë kandidatë për program? Pse?

JO

Nxënësit diskutojnë duke dhënë argumentet e tyre.

Ata vlerësojnë njëri-tjetrin në përgjigje.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për argumentet e dhëna gjatë diskutimit, për analizën e strukturës së tekstit etj.

**Detyrë shtëpie:** Shpjegoni rolin e komunikimit në shkëmbime të tilla eksperiencash.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha e komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Flasim</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b>	
<b>Tema mësimore: Mbledhja e informacionit</b>		Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca qytetare</div>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Mbledhje e informacionit	
<div>- hulumton për mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme;</div> <div>- analizon mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit;</div> <div>- vlerëson përshtatjen e informacionit të mbledhur me temën e dhënë.</div>		Burime të ndryshme	
		Vjelje e informacionit	
<b>Burimet:</b> Teksti mësimor, videoprojektor		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
		biologji, gjeografi, histori	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Pyetja sjell pyetjen, Punë në dyshe, Punë individuale</i>			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:</b> <i>Pyetja sjell pyetjen</i>			
Një rol të rëndësishëm në hulumtim zë dhe mbledhja e informacionit/Po çfarë sigurojmë nga mbledhja e informacionit?			
1- Marrim njohuri shtesë për një çështje të caktuar.			
2- Ndikohemi dhe ndryshojmë mendim për një çështje të caktuar.			
3- Krijojmë besueshmëri. Kur arrini të flisni në një bisedë të rastit në lidhje me një çështje në të cilën përfshihen dhe jepni informacion që të tjerët nuk e dinë, por ju e mbështesni në fakte, kjo tregon se jeni i përgatitur për problemin që diskutohet.			
4- Informacioni juaj ju shërben si juve, edhe të tjerëve.			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> <i>punë në dyshe</i>			
Mbledhja e informacionit realizohet në mënyra të ndryshme. Më poshtë janë renditur disa prej tyre.			
<div>Konsultimi me enciklopedi të ndryshme dhe të besueshme, duke nxjerrë të dhëna për çështjen që na intereson.</div>		<div>Mënyrat e mbledhjes së informacionit</div>	
		<div>Ndjekja e aktualitetit na përditëson me ngjarjet kryesore që ndodhin.</div>	
<div>Forumet publike dhe seancat dëgjimore për çështje të ndryshme janë mënyra të mira për të gjetur informacion cilësor.</div>		<div>Sondazhet përbëjnë një nga mënyrat më të mira për të gjetur informacionin sasior. Ato mund të realizohen në formën e sondazheve me shkrim, ballë për ballë, ose me anë të telefonit.</div>	
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> <i>Punë individuale</i>			
Mbledhni informacion rreth temës “Prurjet më të reja të teknologjisë”, duke ndjekur hapat e mëposhtëm.			
Kërkoni informacion në internet për temën.			
Mbani shënime.			
Klasifikoni dhe gruponi burimet sipas besueshmërisë.			
Pyesni njerëz që kanë njohuri në këtë fushë.			
Renditni të gjitha burimet që keni përdorur.			
Vlerësoni nëse është i përshtatshëm ose i mjaftueshëm informacioni që keni mbledhur.			
Nxënësit punojnë në dyshe për të mbledhur informacionin, sistemin e tij dhe më pas diskutimin me shokët e shoqet.			
<b>Vlerësimi:</b> Bëhet vlerësimi për përgjigjet e dhëna.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b> <b>Tema mësimore: Si të shkruajmë një raport (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- klasifikon burimet e informacionit në parësore dhe dytësore;</li><li>- liston burimet e informacionit;</li><li>- respekton strukturën e punës me shkrim hyrje, zhvillim, përfundime;</li><li>- analizon veçoritë gjuhësore të këtij teksti;</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Raport Hyrje Zhvillim Përfundime Tekst informues	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit , “Të shkruajmë, procesi dhe shkrimet funksionale” CDE		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte, tik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Tabela Insert, Shkrim i lirë <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim <i>Raporto mësuesit për ecurinë tënde të një ditë më parë.</i> Nxënësit diskutojnë më njëri-tjetrin dhe ndajnë informacionin për ditën e kaluar duke u përpjekur të qëndrojnë brenda strukturës së raportit (për aq njohuri sa ata mund të kenë mbi raportin). <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Insert <b>Nxënësit udhëzohen të hapin tekstet dhe të plotësojnë tabelën Insert.</b>			
<b>+(inf që shtohet)</b>	<b>V(inf që di më parë)</b>	<b>__(inf që dihet gabim)</b>	<b>?(inf që nuk kuptohet dhe duhet ndihma e mësuesit/es)</b>
Organizohet sipas një strukture të përcaktuar: hyrje, zhvillim, mbyllje; Pasqyron mbledhjen dhe përzgjedhjen e të dhënave nga burimet referuese dhe nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë i fakteve.	Raporti është një tekst që informon për një situatë apo veprimtari në mënyrë të hollësishme, me të dhëna dhe fakte që lidhen me temën.		
Është i qartë, lehtësisht i kuptueshëm dhe shoqërohet me diagrame dhe fotografi përfundimi. Përmban një interpretim të gjithë temës.	ka gjuhë të qartë dhe objektive;		

**Kujdes! Vini re këshillat e mëposhtme:**

- Krijoni lidhje logjike mes paragrafëve të raportit në tërësi.
- Redaktoni raportin. Kontrolloni drejtshkrimin, gramatikën dhe pikësimin.
- Lexoni variantin përfundimtar të raportit, bëni ndryshimet e duhura.
- Kujdesuni që të mos reflektoni ndjenjat dhe opinionet tuaja në të.
- Kërkojini dikujt tjetër që t'ju lexojë raportin. Një palë sy të tjerë mund t'ju sigurojnë se shkrimi është i qartë dhe i kuptueshëm.
- Vendoseni për disa ditë mënjatë raportin e shkruar. Kjo gjë do t'ju ndihmojë për të vlerësuar qartësinë e tij kur ta lexoni me qetësi.
- Mirëprisni pyetje nga ata që e lexojnë para se ta dorëzoni.

**Hapat për të shkruar një raport:**

- 1) Përcaktoni temën e raportit. Përzgjidhet një temë, pasi janë shqyrtuar disa të tilla.
- 2) Kuptoni dhe vlerësoni, duke lexuar sa më shumë modele raportesh.
- 3) Mbani shënime dhe bëni pyetje për të sqaruar mendimet.
- 4) Kërkoni informacion rreth temës. Sigurohuni që keni gjetur materialet e duhura.
- 5) Bëni kujdes me burimet *online*. Jo gjithnjë janë të besueshme.
- 6) Mbani shënim burimet të cilave do t'ju referoheni. Vendosini referencat në raport.
- 7) Shkruani hyrjen e raportit. Paraqitni çështjet që do të trajtohen në raport dhe parashtroni konceptet kryesore të temës së raportit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë**

Ndahuni në grupe dhe caktoni detyrat për të shkruar një raport me temën: “*Aftësitë shkruese të nxënësve të klasës së tetë*”.

Ndiqui hapat e mësipërm.

Duke qenë se shkrimi i raportit kërkon kohë mendoj se nxënësit nuk do të kenë kohë mjaftueshëm për të shkruar raportin, ndaj u lihet detyrë shtëpie përfundimi i tij.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b>		<b>Situata e të nxënës:</b>	
<b>Tema mësimore: Si të shkruajmë një raport (ora 2)</b>		Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</div>			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Raport	
<div>- klasifikon burimet e informacionit në parësore dhe dytësore;</div>		Hyrje	
<div>- liston burimet e informacionit;</div>		Zhvillim	
<div>- respekton strukturën e punës me shkrim hyrje, zhvillim, përfundime;</div>		Përfundime	
<div>- analizon veçoritë gjuhësore të këtij teksti.</div>		Tekst informues	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, <a href="https://www.unicef.org/albania/Kukes_Drop-out_study-2008AL.pdf">https://www.unicef.org/albania/Kukes_Drop-out_study-2008AL.pdf</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
		arte, tik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bisedë, Të nxënës në bashkëpunim, Turi i galerisë			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bisedë			
Diskutojmë së bashku dhe rikujtojmë hapat hartimin e një raportit.			

**Struktura e raportit**

Raportet nuk kanë strukturë të ngurtë, megjithatë mund të ndërtohet mbi bazën e elementeve të mëposhtëm:

- Pasqyra e lëndës jo më shumë se 4-5 faqe.
- Përmbledhje e shkurtër - parashtron idetë dhe përfundimet kryesore të raportit.
- Hyrja - parashtrimi i qëllimeve të raportit.
- Zhvillimi i raportit - faktet e mbledhura, analiza/diskutimi i tyre.
- Përfundime dhe rekomandime - dalin në fund të raportit.
- Shtojcat dhe bibliografia - statistika dhe tabela, burimet ku është marrë informacioni.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënit në bashkëpunim

**Ndahet klasa në grupe dhe hartojnë një raport për braktisjen në shkollën e tyre.**

Nxënësit duke u ndarë në grupe zgjedhin temat për të cilat do të hartojnë raportin.

*Duke u bazuar në raportimet e mësuesve për fëmijët që braktisin shkollën, grindjet me shokët e shkollës nuk ishin një faktor mbizotërues; ato raportohen në pak më shumë se një të katërtën e rasteve. Nuk ka ndonjë ndryshim në numër midis fëmijëve që raportuan grindje me shokët dhe atyre që nuk raportuan. Ndryshimi nuk është i ndjeshëm krahasuar edhe me fëmijët që vazhdojnë shkollën. Megjithatë fëmijët në rrezik për ta braktisur shkollën, raportuan më shumë grindje se fëmijët braktisës, ndoshta sepse e kishin më të freskët sjelljen e tyre me shokët e shkollës. Kjo mund të na çojë ta mendojmë mosmarrëveshjen me shokët si një faktor përcaktues.*

*Shkelja e rregullave të shkollës duket se përbën një faktor paraprijës për braktisjen; ajo raportohet nga gjysma e fëmijëve braktisës, sidomos te djemtë. Shkeljet janë 1,5 herë më të shpeshta te fëmijët braktisës se te fëmijët që vazhdojnë shkollën, por 1,5 herë më të rralla se te fëmijët në rrezik për ta braktisur atë. Megjithatë, në studim nuk matet shkelja e rregullave në vetvete, por perceptimi i fëmijës në lidhje me shkeljen. Mbase fëmija nënkupton me 'shkelje' më pak ose më shumë nga ajo që është shkelje në të vërtetë, sipas rregullave të shkollës.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Turi i galerisë

Nxënësit punët e tyre i vendosin në klasë, i vëzhgojnë dhe i vlerësojnë. Mësuesi/ja bën korrigjimin dhe vlerësimin përfundimtar të punëve.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për shkrimin saktë të një raporti.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha:</b> Gjuha dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Shkalla:</b> IV	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuritë gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur mënyrore		<b>Situata e të nxënit:</b> Në supermarketin e ri Pranë pallatit ku unë banoj më kanë thënë se është hapur një supermarket i ri. Ju lutem, më tregoni mënyrën se si mund të shkoj deri atje.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon pjesën e n/r mënyrore në një fjalë të përbërë;</li><li>- analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë;</li><li>- argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r mënyrore në fjalë e si ndahet me presje ajo.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjalë e përbërë Pjesë kryesore Pjesë e nënrenditur mënyrore Mjet lidhës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, Tabela e koncepteve, Punë në dyshe

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim

**Dalloni llojin e fjalive të përbëra me n/r, gjeni mjetin lidhës dhe pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r.**

*Shtri këmbët sa ke jorganin.*

*Ecte, si të ishte e dehur.*

*Shkoi në Gjermani, që të jetonte më mirë se paraardhësit e tij.*

*Shkoi në Gjermani, se ishte në hasmëri me familjen e Franit.*

**Nxënësit diskutojnë së bashku. Ata vlerësojnë mendimet e njëri-tjetrit.**

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Tabela e koncepteve

<b>Fjalitë me pjesë të nënrenditur mënyrore</b>			
<b>Roli që luan pjesa e nënrenditur</b>	<b>Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës</b>	<b>Pozicioni i pjesës së n/r</b>	<b>Përdorimi i presjes</b>
Në fjalitë me pjesë të nënrenditur mënyrore, pjesa e varur tregon mënyrën se si kryhet veprimi apo si paraqiten faktet në pjesën kryesore.	<i>si/siç Bëj si të duash. ashtu si/siç Ashtu si erdhi, ashtu u largua, sa hap e mbyll sytë. kështu si/siç Nuk flet njeriu, kështu si flet ti. sikur Bënte naze, sikur të ishte fëmijë i vogël. sikurse Veproni, sikurse u kanë porositur. sikundër Ajo nuk fitoi, sikundër besonte shumica</i>	Pjesa e varur mënyrore mund të qëndrojë para pjesës kryesore, pas saj dhe rrallëherë edhe në mes të saj, si në fjalinë: Disa njerëz i trajtojnë kafshët shtëpiake <i>si të ishin anëtarë të familjes.</i> <i>Si të ishin anëtarë të familjes,</i> i trajtojnë disa njerëz kafshët shtëpiake. Disa njerëz, <i>si të ishin anëtarë të familjes,</i> i trajtojnë kafshët shtëpiake.	Pjesa e varur nuk ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore, kur kjo e fundit është para te parës. Ajo ndahet gjithnjë me presje kur pjesa e varur qëndron para ose futet në mes të pjesës kryesore.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Plotësoni shembujt e mëposhtëm me nga një pjesë të varur mënyrore.

*Si të jetë fara, ashtu do të jetë dhe fryti.*

*Është mirë që njeriu të sillet, si një qenie e vërtetë humane.*

*Këtu, kafshët trajtohen, sikur të jenë njerëz.*

*Era frynte, si të ishte e marrë.*

**Dalloni rrethanorët nga fjalitë me pjesë të nënrenditur rrethanore. Plotësoni tabelën.**

*Rrinte me orë të tëra mbështetur e rehatuar në divanin kundruall dritares pa bërë as gek as mek. Rrinte si të ishte i zënë në faj. Duhej të ishim stërvitur më mirë. Vraponin si t'i ndiqte kush nga pas. E shikonte duke përplasur qerpikët shpesh e më shpesh. Ashtu si thamë, u bë. Shpesh, njeriu, si bën, gjen.*

<b>Rrethanorë mënyre</b>	<b>Fjali e varur mënyrore</b>	<b>Mjeti lidhës</b>
<i>pa bërë as gek as mek.</i>	<i>Rrinte si të ishte i zënë në faj.</i>	<i>Si</i>
<i>Duhej të ishim stërvitur më mirë</i>	<i>Vraponin si t'i ndiqte kush nga pas.</i>	<i>Si</i>
<i>E shikonte duke përplasur qerpikët shpesh e më shpesh.</i>	<i>Ashtu si thamë, u bë  Shpesh, njeriu, si bën, gjen</i>	<i>Si</i>

- Ndërtoni pesë fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura mënyrore duke përdorur lidhëza të ndryshme.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për analizën që u bëjnë fjalive me pjesë të nënrenditur mënyrore.

**Detyrë shtëpie:** Ndërto një tekst me temë “Buzë detit” ku të përdorësh fjali të përbëra mënyrore dhe rrethorë mënyre.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuritë gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur rrjedhimore</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon pjesën e n/r rrjedhimore në një fjali të përbërë;</li><li>- analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë;</li><li>- argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r rrjedhimore në fjali e si ndahet me presje ajo.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> E përbërë E nënrenditur E bashkërenditur	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Tabela e koncepteve, Bashkëbisedim, Punë në dyshe</i> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Bashkëbisedim</i> Diskutohet detyra e shtëpisë e dhënë një orë më parë. <i>Nxënësit diskutojnë së bashku.</i> Ata vlerësojnë mendimet e njëri-tjetrit. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> <i>Tabela e koncepteve</i>			
<b>Fjalitë me pjesë të nënrenditur mënyrore</b>			
<b>Roli që luan pjesa e nënrenditur.</b>	<b>Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës</b>	<b>Pozicioni i pjesës së n/r</b>	<b>Përdorimi i presjes</b>
Në fjalitë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore, shprehet marrëdhënia mes faktit a ngjarjes së shprehur në fjalinë kryesore dhe përfundimit logjik të saj, të shprehur në fjalinë e varur.	lidhëza nënrenditëse rrjedhimore <i>ndaj</i> . krahas saj, si mjete lidhëse mund të shërbejnë edhe lidhëzat: <i>sa, sa që, aq sa, që, kështu që</i> etj.	Pjesa e varur RRJEDHIMORE mund të qëndrojë pas pjesës kryesore, gjithmonë.	Pjesa e varur ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore.
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> <i>Punë në dyshe</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimin 4 dhe 5.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për analizën që u bënë fjalive me pjesë të nënrenditur rrjedhimore.			
<b>Detyrë shtëpie:</b> Hartoni një tekst të shkurtër ku fjalitë të shprehin marrëdhënie mënyrore dhe rrjedhimore. Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse si dhe mjetet e lidhjes.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha:</b> Gjuha dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Shkalla:</b> IV	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Rubrika:</b> Të lexuarit <b>Tema mësimore:</b> Dhjetë rregulla për të ngrënë mirë (ora 1)		<b>Situata e të nxënësve:</b> Të ushqyerit e shëndetshëm dhe ndikimi në organizëm. - Për shëndetin dhe mënyrën e të ushqyerit jemi të gjithë të ndjeshëm. Ajo që duhet të kemi gjithnjë parasysh për të qenë të shëndetshëm e jo të shëndoshë është t'i japim më shumë përparësi cilësisë sesa sasisë së ushqimit për këtë arsye dieta jonë e përditshme duhet të jetë sa më e larmishme, të hamë në mënyrë të rregullt dhe të ekuilibruar duke i dhënë organizmit të gjitha substancat që ai ka nevojë. Një faktor i rëndësishëm për të pasur shëndet të mirë është të hash gjërat e duhura në masën e duhur. Prandaj është e rëndësishme të jetosh dhe të ushqehesh shëndetshëm. Zakoni i të ushqyerit të shëndetshëm i formuar herët në fëmijëri ka më shumë gjasa të mbahet gjatë gjithë jetës. Ushqimi duhet të jetë i rregullt dhe të sigurojë energjitë e nevojshme për kryerjen e punëve mendore dhe fizike. Ushqimi i shëndoshë është një ndër faktorët që ndikon në rritjen normale. Për këtë, ushqimi duhet të jetë i shumëllojshëm dhe i përbërë nga artikuj të ndryshëm. <a href="http://zeri.info/femrat/112540/keto-jane-ushqimet-me-te-shendetshme-per-trupin-tuaj-foto/">http://zeri.info/femrat/112540/keto-jane-ushqimet-me-te-shendetshme-per-trupin-tuaj-foto/</a>	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - diskuton për ndikimin e të ngrënit në shëndetin tonë; - formulon receta të shëndetshme për vaktet e të ngrënit; - shkruan këshilla duke u vendosur në rolin e dietologut; - analizon veçoritë e tekstit udhëzues.		<b>Fjalët kyçe:</b> Ushqime Të ngrënë Shëndetshëm Këshilla Pesticide Tekst udhëzues	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, teksti i biologjisë, <a href="http://zeri.info/femrat/112540/keto-jane-ushqimet-me-te-shendetshme-per-trupin-tuaj-foto/">http://zeri.info/femrat/112540/keto-jane-ushqimet-me-te-shendetshme-per-trupin-tuaj-foto/</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> biologji	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bashkëbisedim, Lexim në heshtje, Punë e drejtuar, Punë në dyshe. <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bashkëbisedim			
<div><ul style="list-style-type: none"><li>➤ Keni të drejtë të ndjeheni i sigurt dhe të jeni i sigurt në internet.</li><li>➤ Keni të drejtë të hulumtoni, mësoni dhe kënaqeni në internet.</li><li>➤ Keni të drejtë të mbani të fshehta informatat e juaja personale.</li><li>➤ Keni të drejtë që të tjerët të mos ju shqetësojnë ose ngacmojnë.</li><li>➤ Keni të drejtë t'i injoroni e-mailat dhe mesazhet nga njerëzit të cilët nuk i njihni ose nuk ju besoni.</li><li>➤ Keni të drejtë që të mos plotësoni formularët ose të mos përgjigjeni në pyetjet e parashtruara në internet.</li></ul></div>			

- Për çfarë bëhet fjalë në tekstin e mësipërm?
- Informoheni, argumentohet apo udhëzoheni në këtë tekst?
- Çfarë e bashkon dhe çfarë e ndan këtë tekst me një tekst ku udhëzohesh me mënyrën e përdorimit të një telefoni?
- Në ç'kohë e mënyrë janë foljet në këtë tekst?
- Ç'mund të thoni për gjuhën e përdorur? Po për llojet e fjalive?

### ***Bëhet një bisedë me nxënësit për tekstin udhëzues***

Struktura e tekstit udhëzues është zakonisht në tri pjesë:

- 1) Përshkrimi: përmban listën e mjeteve dhe materialit të dhënë në mënyrë që të veprojnë.
- 2) Procedura: tregon sekuencën e plotë dhe në rend të përsosur e hapat që duhet të marrë.
- 3) Shënimet: vendosen zakonisht në fund të tekstit, të tërheqin vëmendjen për kundërveprimet dhe të sugjerojnë masa.
- 4) Folje në urdhërore ose në të tashmen joveprore.
- 5) Nuk janë pjesë e këtij teksti pjesëzat emocionale, pasthirrmat, pjesëzat dyshuese, dëshirorja, habitorja e foljeve.
- 6) Kanë njëkuptimshmëri, pra mungesë të shmangieve konotative.
- 7) Fjalitë zakonisht nuk janë shumë të gjata.

Janë karakteristike për një pjesë tekstesh grupet paraformale të stilit formal: në bazë të, në lidhje me etj. (teksti juridiko-administrativ)

### ***Llojet e tekstit udhëzues***

Shenjat rrugore, stendat, fletëpalosjet, ligjet, një etiketa të ndryshme, dieta, recetat e mjekut, një recetat e gatimit, listat e shpenzimeve etj.

Rregullat e lojërave, udhëzimet për përdorim, manualët, rregullat e mirësjelljes, ligjet, tekstet ligjore, nenet dhe rregulloret.

### ***Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim në heshtje, Punë e drejtuar***

#### ***Lexohet në heshtje pjesa dhe më pas diskutohen këshillat e dhëna për një të ushqyer sa më të mirë***

Nëse është e mundur bëni pazar çdo ditë (e urrej frigoriferin, në të vërtetë imi është gjithmonë bosh).

Një supë e ruajtur në frigorifer për disa ditë, humbet shumë vitamina dhe elemente ushqyese. Konsumoni ushqime të freskëta e të sapogatuara.

Ziejini sa më pak të jetë e mundur ushqimet (zarzavatet, mishin, peshkun).

Zgjidhni ushqime integrale e biologjike nga vende ku nuk janë përdorur plehra kimikë e pesticide.

Konsumoni pak mish dhe kujdesuni që ai të jetë nga ferma, të cilat nuk i ushqejnë kafshët me antibiotikë apo hormone.

Konsumoni shumë peshk, mundësisht peshk deti dhe jo rezervati; peshku i detit është ndër të paktët që nuk mund të rritet në rezervat.

Përdorni sa më shumë fruta e zarzavate të stinës e jo të serës.

Konsumoni sa më pak ëmbëlsira dhe tregoni kujdes me kripën.

Nevojitet të paktën gjysmë ore lëvizje në ditë.

Respektoni oraret e ngrënies së vakteve.

*Më pas mësuesilja udhëzon nxënësit të merren me sqarimin e fjalëve të reja.*

### ***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe***

#### ***Nxënësit punojnë me rubrikën "Të kuptojmë tekstin"***

**Vendosni V kur pohimi është i vërtetë dhe G kur është i gabuar.**

Në hyrje të pjesës autori na njeh me temën. V

Në paragrafin e parë të zhvillimit autori jep këshilla. V

Autori na këshillon se mjafton gjysmë ore lëvizje fizike në ditë. V

Sipas autorit, gratë janë më të rrezikuara nga sëmundjet e zemrës. G

Në tekst përcaktohet qartësisht ndikimi pozitiv që ka lëvizja fizike për organizmin. V

Autori përcakton saktësisht oraret e vakteve të të ngrënies. G



Në mbyllje të tekstit, autori shpjegon një nga sugjerimet e tij. V

### ***Diskutojmë së bashku***

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen dhe cilësinë e diskutimeve, për hartimin e recetave të vendlindjes, por jo vetëm etj.

**Detyrë shtëpie:** Receta e vendlindjes sime. Tregoj për të.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Dhjetë rregulla për të ngrënë mirë (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Si të ushqehemi shëndetshëm. Receta dhe këshilla <b>1. Fillojeni ditën tuaj me drithëra integrale</b> Mesatarisht, ne marrim më shumë se gjysmën e asaj që kemi nevojë nga ky lloj ushqimi që mundet të ulë kolesterolin, parandalojë kapsllëkun dhe të përmirësojë tretjen. Shumica e drithërave integrale janë një burim i madh për fibrat. Filloni në mëngjes me drithëra integrale ose me miell tërshërë me 3 a më shumë gram fibër për çdo pjatë. Shtoni fruta dhe ju do të jeni drejt objektivit ditor prej 38 gram për meshkujt dhe 25 gram për femrat. <b>2. Buka me miell integral dhe biskotat</b> Merrni drithëra edhe në drekë. Hani një sandviç me bukë me miell integral. Apo zhytini biskotat me miell integral në kremin tuaj të preferuar. Drithërat integrale i përmbajnë të gjitha, krundet, embrionet, enzimën, duke iu dhënë juve të gjithë ushqimet e drithërave. Studimet tregojnë që shtimi i drithërave integrale dhe ushqimeve të tjera të pasura me fibra në dietën tuaj mund të reduktojë edhe riskun e sëmundjes së zëmrës dhe diabetit të llojit 2. <a href="http://www.tiranaobserver.al/11-ushqimet-me-me-shume-fibra-perfitimet-per-zemren-peshen-dhe-energjin/">http://www.tiranaobserver.al/11-ushqimet-me-me-shume-fibra-perfitimet-per-zemren-peshen-dhe-energjin/</a>	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - diskuton për ndikimin e të ngrënit në shëndetin tonë; - formulon receta të shëndetshme për vaktet e të ngrënit; - shkruan këshilla duke u vendosur në rolin e dietologut; - analizon veçoritë e tekstit udhëzues.		<b>Fjalët kyçe:</b> Ushqime Të ngrënë Shëndetshëm Këshilla Pesticide Tekst udhëzues	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, teksti i biologjisë <a href="http://grupii6.weebly.com/ushqimet-e-shendetshme.html">http://grupii6.weebly.com/ushqimet-e-shendetshme.html</a> <a href="http://www.tiranaobserver.al/11-ushqimet-me-me-shume-fibra-perfitimet-per-zemren-peshen-dhe-energjin/">http://www.tiranaobserver.al/11-ushqimet-me-me-shume-fibra-perfitimet-per-zemren-peshen-dhe-energjin/</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> biologji	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Imagjinatë e drejtuar, Të nxënësve në bashkëpunim, Rrjet diskutimi <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Imagjinatë e drejtuar			
			
<b>Përbërësit për krepë të ëmbël:</b> 250 gr miell 1/2 litër qumësht 40 gr gjalpë 3 vezë 60 gr sheqer 1 bustinë vanilje pak kripë pak kanelle (sipas dëshirës) pak rum ose konjak (sipas dëshirës)		<b>Përbërësit për krepë të kripur</b> 250gr miell 1/2 litër qumësht 40gr gjalpë 3 vezë pak kripë	

Vendosim në një tas të madh dhe të thellë miellin e situr, (shtojmë sheqerin dhe vaniljen nëse po përgatisim krepë të ëmbël), pak kripë dhe gjysmë litër qumësht. E rrahim përbërjen me pirun (apo me një rrahës elektrik) derisa të formohet një masë e njëtrajtshme dhe pa kokrriza.

Në një enë tjetër rrahim fort vezët, të cilat ia shtojmë masës më sipër, duke vazhduar përzierjen, derisa të dy përbërësit të bashkohen me njëri -tjetrin. E mbulojmë brumin me një letër transparente dhe e lëmë të pushojë për të paktën gjysmë ore.

Pasi kjo kohë të ketë kaluar, shkrijmë gjalpën në një tigan të vogël dhe ia shtojmë brumit, duke e përzier mirë (shtojmë edhe një gotë të vogël rum apo konjak nëse po përgatisim krepë të ëmbël).

Vendosim në zjarr një tigan të madh që nuk ngjitet (apo tiganët e posacëm të krepave) dhe kur të jetë nxehur, hedhim pak nga brumi duke vepruar në këtë mënyrë: me ndihmën e një garuzhdeje, e hedhim brumin në qendër të tiganit dhe më pas e rrotullojmë shpejt nga të gjitha anët, derisa të hapet dhe të formohet një "petë" e hollë. E lëmë në këtë mënyrë të gatuhet për rreth 1 minutë, duke e rrotulluar here pas here (në mënyrë që të mos ngjitet), dhe kur të ketë marrë një ngjyrë të artë, e kthejmë nga ana tjetër edhe për 1 minutë. Sapo krepë të jetë gati, e vendosim në një pjatë të madhe, duke e "rëshqitur" ngatigani, dhe vazhdojmë të njëjtën procedurë edhe për krepat e tjerë me brumin që ka mbetur.

Shënim: Nëse krepat e posapërgatitur nuk shërbehen menjëherë, vendosini ato në një vend të ngrohtë dhe shtojni reçel, marmalatë, nutela, pana, proshutë, djathë etj, vetëm në momentin e servirjes.

(<http://www.kuzhinaime.blogspot.com/>)

*Imagjinoni ti je në rolin e një shefi kuzhine dhe po jep udhëzime për të gatuar një krepë të ëmbël e një të kripur.*

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Të nxënit në bashkëpunim

**Ndaj klasën në grupe**

**Grupi 1.** Nënvizoni në tekst fjalitë në të cilat autori:

**jep informacion;** Rekomandimi i fundit është ndoshta më i vështirë për t'u ndjekur:

dembelizmi është i madh dhe koha në dispozicion është e pakët.

**shpjegon;** Por kujdes: kardiologjia moderne e përcakton lëvizjen si profilaksinë më të mirë ndaj sëmundjeve kardiovaskulare. Duke qenë se sot infarkti godet njësoj si burrat edhe gratë, impenjimi duhet të jetë i madh.

**sugjeron;** Mendoj se për këtë nuk ka një rregull fikse, secili prej nesh duhet "të lexojë" organizmin e vet e të përpiqet të hajë shëndetshëm, duke respektuar oraret e vakte. Mendoj, gjithsesi se për të rriturit janë të mjaftueshme tri vakte, për fëmijët një më shumë. Sasia e lëvizjes së këshilluar duhet të jetë gjysmë ore në ditë: gjatë ditëve të punës zgjidhja është biçikleta në mëngjes.

**referon një citim.** Një shprehje thotë: "Duhet ngrënë mëngjesi si mbret, dreka si princ dhe darka si varfanjak"

Çfarë nënkupton autori nëpërmjet frazave të mëposhtme?

... secili prej nesh duhet "të lexojë" organizmin e vet.

... e urrej frigoriferin, në të vërtetë i imi është gjithmonë bosh...

Nëpërmjet frazave të mëposhtme, autori në frazën e parë do të thotë se njeriu është mjek i vetes së tij.

Në të dytën do të thotë se blerjet duhet gjithmonë të jenë të kujdesshme, të shëndetshme dhe me masë.

**Grupi 2.** Cila është koha dhe mënyra foljore e përdorur nga autori për të dhënë këshilla?

*Mënyra urdhërore, koha e tashme*

Zëvendësoni fjalët me shkronja të zeza, duke mos ndryshuar kuptimin e fjalive të mëposhtme.

*Zgjidhni ushqime integrale (të shëndetshme e pa yndyrë) e biologjike.*

*Konsumoni pak mish. (Përdorni)*

*Muskujt tonifikohen (formëzohen), qarkullimi dhe thithja e oksigjenit përmirësohen.*

*...impenjimi (Angazhim, Përfshirje) duhet të jetë i madh.*

**Integrale futen drithërat, buka e zezë**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Rrjet diskutimi

PO

A mendoni se është e rëndësishme mënyra e gatimit të ushqimeve?

JO

Nxënësit diskutojnë së bashku duke qenë fleksibël në diskutim.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të marrit pjesë gjatë orës së mësimi dhe dhënies së mendimeve në funksion të temës.

**Detyrë shtëpie:**

Formuloni një recetë shëndetshme për tri vaktet e të ngrënit.

Mëngjesi: \_\_\_\_\_

Dreka: \_\_\_\_\_


Darka: \_\_\_\_\_

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: të shkruarit</b> <b>Tema mësimore: Si të shkruajmë një fletëpalosje (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale -Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth fletëpalosjes;</li><li>- dallon elementet e strukturës së fletëpalosjes;</li><li>- mëson hapat e shkrimit të fletëpalosjes;</li><li>- përgatit një fletëpalosje duke respektuar gjithë hapat për shkrimin e saj;</li><li>- ideon paraqitjen grafike të saj;</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fletëpalosje Informacion i përmblodhur Imazhe Strukturë Shpërndarje	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> tik	


**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bisedë, Pyetja sjell pyetjen, Shkrim i lirë  
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bisedë

**C'është barazia gjinore?**  
 Barazia gjinore nënkupton një pjesëmarrje të dukshme, të fuqishme dhe të barabartë të të dy seksve në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Barazia gjinore është e kundërta e pabarazisë gjinore, jo për nga ndryshimi gjinor dhe synon të nxisë pjesëmarrjen e plotë të grave dhe burrave në shoqëri.




**C'është integrimi gjinor?**  
 Integrimi gjinor është ri/organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve politike, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të trupëzohet në të gjitha politikat në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët që përfshihen normalisht në bërjen e politikave. Integrimi gjinor do të thotë që barazia gjinore të bëhet një pjesë e plotë e politikave të zakonshme. Ajo nënkupton një përkufizim më të gjerë dhe më përfshirës të barazisë gjinore, duke i dhënë vlerë ndryshimeve dhe larmisë.




**Stereotipet gjinore**  
 Stereotipat janë përgjithësime të forta për njëzëritë në një kategori të përcaktuar sociale. Çdo kulturë krijon kuptimet e veta për termat femer dhe mashkull. Keto kuptime përfshijnë një varg parashikimesh në lidhje me mënyrën sesi çdo gjini duhet të sillet. Kur ekzagjerohen keto parashikime kthehen në stereotipa gjinore. Kur ne flasim për stereotipat e rolit gjinor, ose stereotipat e rolit të seksit, ne flasim për ato grupe të strukturuar bindjesh rreth cilësive personale të grave dhe burrave.



**NE JEMI TE BARABARTE!!**



**Ndryshimi midis Seksit dhe Gjinisë (Gender)**  
 Seksi është term biologjik. Njerëzve u vihen terma mashkull ose femer në varësi të organeve të tyre seksuale dhe geneve. U referohet ndryshimeve biologjike midis femrave dhe meshkujve. Ato janë në përgjithësi të qëndrueshme dhe universale. Në të kundërt, **Gjinia** është term psikologjik dhe kulturor, duke ju referuar ndjenjave subjektive të femrave dhe meshkujve. Gjinia mund të referohet gjithashtu, vlerësimit të sjelljes nga shoqëria, si mashkullore ose femerore (roli gjinor).

Fletëpalosja është një fletë e madhe e shtypur dhe e palosur, ku jepen njoftime të ndryshme të ditës, botohen materiale me figura a me fotografi për ngjarje të ndryshme.

Ajo jep një informacion të përmblendhur dhe të shoqëruar me imazhe për çështjen në fjalë. Fletëpalosja shpërndahet në mënyra të ndryshme përmes medias, gazetave, me postë etj.

Një fletëpalosje shkruhet për të bërë publicitet, për të reklamuar një produkt, për të tërhequr vëmendje për një informacion të rëndësishëm apo për një ngjarje që do të organizohet së shpejti.

**Diskutojmë për fletëpalosje të ndryshme.**

**Kujdes! Fletëpalosjet që ju janë dhënë në Librin e mësuesit janë orientuese!**

EcoAlbania		Ditët e rëndësishme mjedisore		continental trout	
	<b>22 mars</b> kjo ditë e bukur e pranverës, ku nata dhe dita janë të gjata njësoj është <b>Dita Botërore e Ujit</b> . Çdo vit në gjithë botën organizohen aktivitete ndërgjegjëse për mbrojtjen e ujit. Në këtë ditë ne shkojmë pranë burimeve të ujit dhe bisedojmë për të mbrojtur pastërtinë e tij dhe për ta kursyer atë.		<b>10 maj</b> është dita <b>Botërore e shpendëve shtegtarë</b> . Mijëra shpendë shtegtojnë nga vendet e ftohta drejt atyre më të ngrohta për të kaluar dimrin. Gjatë rrugës ato hasin vështirësi të shumta. Prandaj në këtë ditë ne mblidhemi dhe organizojmë aktivitete për të bërë të njohur këto probleme dhe vëzhgojmë nga larg me ndihmën e dylbive shpend të ndryshëm që dimërojnë në lagunat e vendit tonë.		
	<b>15 maj</b> <b>Dita e llojeve të kërcënuara</b> . Në pyjet tona jetojnë shumë lloje kafshësh të egra ku disa prej tyre janë më të rralla si: rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli, etj. Këto kafshë kanë nevojë për ruajtje të veçantë, pasi në vitet e fundit numri i tyre është ulur dhe rrezikojnë të zhduken. Në këtë ditë ne trajtojmë tema të cilat na mësojnë si ti ruajmë këto kafshë në mënyrë që ato të mos zhduken.		<b>21 maj</b> <b>Dita e peshqve shtegtar</b> . Shumë peshq kanë nevojë të shtegtojnë për t'u ushqyer dhe riprodhuar. Këta peshq kanë një rol shumë të rëndësishëm në zinxhirin ushqimor. Gjithashtu përbejnë ushqim edhe për njerëzit që banojmë pranë lumenjve. Në këtë ditë ne shkojmë pranë lumenjve dhe bisedojmë me prindërit dhe shokët se si mund ti mbrojmë peshqit nga mënyrat e gabuara të peshkimit.		
	<b>5 qershori</b> është <b>Dita Botërore e Mjedisit</b> . Atë ditë së bashku me mësuesit dhe shokët ne flasim për rëndësinë që ka mjedisi i pastër. Ne pastrojmë më mirë se çdo ditë tjetër klasën, oborrin dhe mjedisin ku jetojmë. Në i bashkohemi aktiviteteve të shoqatave që punojnë për mbrojtjen e mjedisit.		<b>4 tetori</b> është <b>Dita Botërore e Kafshëve</b> . Ne i duam shumë kafshët dhe kujdesemi çdo ditë për to. Në këtë ditë ne organizojmë konkurse të ndryshme vizatimi, shfaqje teatri etj. Bisedojmë me prindërit dhe shokët për të kujtuar sa të dobishme janë kafshët në jetën tonë dhe si duhet t'i trajtojmë ato.		

**Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetja sjell pyetjen**

*Çfarë gjejmë brenda në fletëpalosje?*

Brenda një fletëpalosjeje gjejmë titullin, nëntitujt, sloganin, qëllimin, objektivat, ilustrimet e fotografitë, si dhe informacion për kontaktet e organizatorëve.

*A ka strukturë të organizuar fletëpalosja?*

Vendet ku ndodhen këto elemente përcaktojnë strukturën e fletëpalosjes.

*A keni shkruar fletëpalosje? Jepni shembuj.*

Po në projekte të lëndëve të ndryshme apo dhe në aktivitete të ndryshme, madje dhe i kemi shpërndarë në komunitet.

*A keni ditur se cilat janë pjesët përbërëse të një fletëpalosjeje?*

Jo dhe aq saktë!

*Le të mësojmë hapat se si shkruhet një fletëpalosje*

**Mendoni.** Duhet ta keni të qartë strategjinë, qëllimet dhe objektivat në lidhje me atë që doni të arrini. Për këtë duhet të mendoni, të mblidhni dhe të kërkonit ide edhe nga të tjerët.

**Bëni një plan.** Plani jua lehtëson shkrimin e fletëpalosjes. Në këtë plan, duhet të shkruani se çfarë përmbajtjeje do të ketë fletëpalosja para se të filloni ta shkruani atë. Gjatë bërjes së këtij plani, duhet të përcaktoni çështjet ose idetë që do të shpalosni në fletëpalosje. Shprehini sa më thjeshtë idetë tuaja.

**Shkruani.** Kur të jeni gati për ta hedhur në letër planin, përqendrohuni dhe shkruani në një skedë pikat e planit tuaj që lidhen me strategjinë, qëllimet, objektivat.

Mos mendoni se varianti i parë i kësaj fletëpalosjeje do të jetë i përsosur. Mos u shqetësoni, ai do të rishikohet disa herë. Shkruajeni variantin e parë sipas strukturës që keni krijuar.

Bëhuni kritik i vetes, kërkoni dhe konsultohuni me miq e kolegë. Shkruani variantin final pas konsultimeve. **Kontrolloni** faktet që keni paraqitur, fjalët kyçe që keni përdorur, qartësinë dhe saktësinë e tyre. Konsultohuni me një profesionist të fushës për të cilën po përgatisni fletëpalosjen.

**Ideoni paraqitjen grafike.** Përdorni imazhe, skica, fotografi etj., për ta bërë më të lexueshme dhe më tërheqëse **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë**

Tani është radha juaj!

Zgjidhni njërën nga temat e mëposhtme dhe përgatitni një fletëpalosje ku të respektoni të gjithë hapat për shkrimin e saj.

1) Libri i vitit      2) Pranvera e fëmijëve      3) Zërat e dijes

Nxënësit punojnë për të hartuar fletëpalosjen. Në qoftë se nxënësit nuk e përfundojnë brenda orës së mësimit u lihet detyrë shtëpie.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të shkruarit</b> <b>Tema mësimore: Si të shkruajmë një fletëpalosje (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskuton rreth fletëpalosjes;</li><li>- dallon elementet e strukturës së fletëpalosjes;</li><li>- mëson hapat e shkrimit të fletëpalosjes;</li><li>- përgatit një fletëpalosje duke respektuar gjithë hapat për shkrimin e saj;</li><li>- ideon paraqitjen grafike të saj;</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fletëpalosje Informacion i përmblodhur Imazhe Strukturë Shpërndarje	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<i><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bisedë, Punë individuale, Turi i galerisë</i> <i><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bisedë</i> Diskutojmë detyrën e shtëpisë për mënyrën se si është zhvilluar. Nxënësit japin mendimet e tyre dhe vlerësojnë punët e njëri-tjetrit. <i><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë individuale</i> <b>Tema e shkrimit të sotëm është:</b> <i>Krijo një fletëpalosje me temë “Dhuro për bamirësi”</i> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pse duhet dhuruar për bamirësi?</li><li>• Etapat e procesit të dhurimit</li><li>• Ku shkojnë bamirësitë?</li><li>• Adresat e kontaktit</li></ul> <i><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Turi i galerisë</i> <i>Në 10 min e fundit nxënësit dhe mësuesi/ja vlerësojnë punët e njëri-tjetrit, pas vëzhgimit të tyre në Turin e galerisë.</i> <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përfshirjen e tyre gjatë orës së mësimit.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Projekt</b> <b>Tema: Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj te moshuarve (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Në shtëpinë e të moshuarve Gjyshi i Noldit jeton në shtëpinë e të moshuarve. Atë e merr shumë malli për nipin e tij. Noldi shkon shumë shpesh për ta takuar, sepse e merr malli. Një ditë ai shkoi me shokët në shtëpinë e të moshuarve për t`i shërbyer atij dhe shokëve të tij...	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - flet për vullnetarizmin si vlerë që e ka karakterizuar popullin tonë; - tregon format e vullnetarizmit në ditët e sotme; - identifikon shtresat dhe personat, që kanë nevojë për shërbim vullnetar; - përgatit materiale sensibilizuese në ndihmë të moshuarve; - organizon veprimtari vullnetare në ndihme të të moshuarve; - merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të; - përzgjedh materialet e duhura për produktet finale; - bën sistemin e materialeve të përgatitura për prezantim; - drejton punën në grup; - prezanton produktet e projektit.		<b>Fjalët kyçe:</b> Vullnetarizëm Të moshuar Materiale sensibilizuese Veprimtari vullnetare Vullnetar	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, vizitë në shtëpinë e të moshuarve, vizitë në familjet me nevoja ekonomike në komunitet, bashkëpunim me emisionin “Fundjavë ndryshe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Të nxënit në bashkëpunim <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <b>Ndabet klasa në grupe</b> <b>U bëhet me dije nxënësve se gjatë projektit faza e parë e tij është:</b> <b>Faza 1 Aktivitetet parapërgatitore të projektit</b> Njohja me temën e projektit. Pavarësisht se është ora e parë, nxënësve për projektin u është folur që në fillim të vitit që ata të marrin masë për hulumtim dhe mos ta lënë punën vetëm në ditët që kanë projektin. <b>Formimi i grupeve të nxënësve dhe ndarja e detyrave brenda grupit</b> Grupet brenda klasës formohen heterogjene me nxënës me përparim të mirë, mesatar apo të dobët. Nxënësit duhet të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, pasi gjatë orës së projekteve, duhet të mësojnë duke u argëtuar. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënit në bashkëpunim			

<b>Titulli</b>	<b>Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj të moshuarve</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	Tri orë mësimore
<b>Qëllimi</b>	Të nxitim dhe promovojmë te nxënësit ndjenjën e vullnetarizmit dhe të kujdesit ndaj të moshuarve.
<b>Lëndët</b>	Gjuhë shqipe histori, qytetari
<b>Pjesëmarrësit</b>	Nxënësit e shkollës, komuniteti, prindërit, shoqëria
<b>Përshkrimi</b>	Projekti realizohet me nx. e klasave të 8 gjatë 3 orëve mësimore. Nxënësit njihen me temën, synimin dhe objektivat e projektit. Organizohen në grupe me tema të specifikuar në funksion të temës së projektit. Nxënësit përgatitin fletëpalosje, postera, materiale, sensibilzuese, intervista me të moshuar. Organizojnë vizita ne Shtëpinë e të Moshuarve. Organizojnë veprimtari me kontribute vullnetare në familje me të moshuar në nevojë. Përgatitin dosjet dhe këndin e projektit...
<b>Veprimtaritë sipas linjave kohore</b>	<p>Përshkrim i asaj që nxënësit do të kryejnë sipas afateve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjidhje problemesh</li> <li>- Grumbullim informacioni</li> <li>- Shkëmbime ndërpersonale</li> <li>- Vëzhgime</li> <li>- Diskutime</li> <li>- Vlerësime</li> </ul> <p>Për ditën e parë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja me temën e projektit, synimin dhe objektivat e tij.</li> <li>- Organizimi i grupeve me tema specifike në funksion të temës së projektit.</li> <li>- Përcaktimi i burimeve të informacionit</li> <li>- Përcaktimi i mënyrës së prezantimit dhe afati kohor</li> <li>- Përcaktimi i mënyrës së vlerësimit</li> </ul>
<b>Burime të kërkua</b>	Biblioteka e shkollës, prindërit, të moshuarit etj.
<b>Rezultatet</b>	Materialet e përgatitura nga nxënësit, foto dhe video te ndryshme do të ruhen në arkivin e shkollës dhe do të përdoren për ilustrimin e orëve mësimore në vazhdim...
<b>Përfitimet</b>	Të rritim te nxënësit ndjeshmërinë ndaj shtresave në nevojë, të zhvillojnë vullnetarizmin përtej fazës së projektit, të organizojnë veprimtari vullnetare herë pas here.
<b>Vlerësimi</b>	<p>Nxënësit do të vlerësohet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përgatitjen e materialeve në funksion të temës së grupit;</li> <li>- vlefshmërinë e materialeve;</li> <li>- respektimin e afatit kohor;</li> <li>- mënyrën e prezantimit;</li> <li>- shkallën e gabimeve;</li> <li>- përdorimin e teknologjisë;</li> <li>- mesazhet që jep.</li> </ul>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Të nxënët në bashkëpunim

**Nxënësit pasi kanë ndarë grupet dhe kanë caktuar nëntemat, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të caktuar mënyrën e përgatitjes së produktet që do të prezantojnë në orën e fundit.**

Ai mund të jetë:

- prezantim në PowerPoint;
- fletëpalosje ;
- postera;
- revistë apo gazetë;
- faqe web-i;

etj.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për marrjen e përgjegjësiwe personale, për bashkëpunimin në grup etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Projekt</b> <b>Tema: “Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj të moshuarve.” (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Vizita në terren	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - flet për vullnetarizmin si vlerë që e ka karakterizuar popullin tonë; - tregon format e vullnetarizmit në ditët e sotme; - identifikon shtresat dhe personat, që kanë nevojë për shërbim vullnetar; - përgatit materiale sensibilizuese në ndihmë të moshuarve; - organizon veprimtari vullnetare në ndihmë të të moshuarve; - merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të; - përzgjedh materialet e duhura për produktet finale; - bën sistemin e materialeve të përgatitura për prezantim; - drejton punën në grup; - prezanton produktet e projektit.		<b>Fjalët kyçe:</b> Vullnetarizëm Të moshuar Materiale sensibilizuese Veprimtari vullnetare Vullnetar	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, vizitë në shtëpinë e të moshuarve, vizitë në familjet me nevoja ekonomike në komunitet, bashkëpunim me emisionin “Fundjavë ndryshe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtari e nxënësit: Të nxënësve në bashkëpunim</b> <i>Faza 2:</i> Përpunimi i materialeve. Krijimi i posterave Krijimi i punimit në PowerPoint Krijimi i videos me mendime të nxënësit Nxënësit punojnë sipas punës së caktuar. Koordinatori i grupit është i vëmendshëm për punën që kryen secili nga anëtarët e grupit dhe bën vlerësimin e anëtarëve. <b>Vini re!</b> <i>Në këtë fazë, nxënësit duhet të mbledhin materialin në “burim”, pranë institucioneve.</i> Do të shkohet të vizitohet Shtëpia e të moshuarve, një grup tjetër do të shkojë në komunitetin e zonës ku ndodhet shkolla për të dhuruar ndihmë në të holla ose ushqime a veshmbathje. <b>Gjatë kësaj faze realizohen këto veprimtari:</b> - Diskutimi brenda grupit dhe në mes grupeve për materialet e sjella nga nxënësit, vlefshmërinë Sugjerime dhe ide për përmirësim - Përgatitja e materialeve për sensibilizim - Përgatitja e një koncerti të vogël për të moshuarit - Mbledhja e kontributeve për të moshuarit - Të selektoj dhe përzgjedh materialet më të vlefshme. - Të mbledh kontribute për të moshuar. - Të vizitojë të moshuarit dhe të dërgojë ndihmë në familje në nevojë. - Përzgjidhen materialet më të mira - Mbledhen ndihma vullnetare si ushqime e veshmbathje për të moshuar - Organizohet vizitë në Shtëpinë e të Moshuarve - Shpërndahen ndihma vullnetare në familje në nevojë			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për marrjen e përgjegjësi personale, për bashkëpunimin në grup etj.			

## PLANIFIKIMI ORËS SË MËSIMIT

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Projekt</b> <b>TEMA: “Vullnetarizmi dhe kujdesi ndaj te moshuarve.”</b> <b>(ora 3)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - flet për vullnetarizmin si vlerë që e ka karakterizuar popullin tonë; - tregon format e vullnetarizmit në ditët e sotme; - identifikon shtresat dhe personat, që kanë nevojë për shërbim vullnetar; - Përgatit materiale sensibilizuese në ndihmë të moshuarve; - organizon veprimtari vullnetare në ndihmë të të moshuarve; - merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të; - përzgjedh materialet e duhura për produktet finale; - bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim; - drejton punën në grup; - prezanton produktet e projektit.		<b>Fjalët kyçe:</b> Vullnetarizëm Të moshuar Materiale sensibilizuese Veprimtari vullnetare Vullnetar	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, vizitë në shtëpinë e të moshuarve, vizitë në familjet me nevoja ekonomike në komunitet, bashkëpunim me emisionin “Fundjavë ndryshe”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori, gjeografi, matematikë, edukim muzikor dhe fizik	
<b>Faza 3:</b> Aktivitetet në të cilin nxënësit prezantojnë rezultatet e punës së tyre si prezantime, tabela dhe albume. - Të prezantojnë në mënyrën më të mirë materialet e përgatitura. - Të japë mesazhe sensibilizuese. - Të shpërndajë material sensibilizuese në shkollë dhe komunitet.			
<b>Gjatë kësaj dite realizohen këto veprimtari:</b> - Prezantimi i materialeve me fletëpalosje, postera, projektor, poezi, dramatizime etj. - Përdorimi i teknologjisë - Dhënia e mesazheve mbi vullnetarizmin, nëpërmjet kartolinave... - Konkurrimi dhe vlerësimi i punës së nxënësve. - Afishimi në ambientet e shkollës i materialeve më të mira. - Konkluzione rreth projektit.			
Në këtë fazë do të vlerësohen nxënësit. Mësuesi/ja duhet të jetë transparente në vlerësim, po kështu dhe pjesëtarët e grupit me njëri-tjetrin. Më poshtë do t`ju sugjerojmë mbajtjen e disa evidencave në secilën prej orëve të projektit, evidenca që do t`jua lehtësojnë vlerësimin e nxënësve dhe ata do të jenë më të qartë me veten.			

Tabelat përmbajnë kriteret për vlerësim, të cilat u bëhen me dije nxënësve me fillimin e projektit.

Plotësimi i kriterëve për vlerësim

Monitorimi i zbatimit të detyrave

### Grupi I

**Vini re!** Kjo tabelë plotësohet për secilin grup pjesëmarrës në projekt!

	Detyrat	Personat përgjegjës	Afati	Komente
<b>Planifikuar</b>	Diskutimi i ideve dhe mendimeve për përgatitjen e prezantimit vullnetarizmi dhe shtresat që kanë më shumë nevojë për të.		24.11.2014	Nxënësit dhanë ide interesante dhe bashkëpunuan për realizimin e tyre.
<b>Realizuar</b>	+		24.11.2014	
<b>Planifikuar</b>	Vizitë në komunitet, familje me vështirësi ekonomike		25.11.2014	Paraqitja e albumit me foto nga jeta e komunitetit me nevoja ekonomike.
<b>Realizuar</b>	+		25.11.2014	Seleksionimi i tyre sipas temave të grupeve
<b>Planifikuar</b>	Vizitë në Shtëpinë e të moshuarve		25.11.2014	Vizita u realizua në formën e intervistës, materialet e së cilës u përdorën në hartimin e posterave.
<b>Realizuar</b>	+		25.11.2014	
<b>Planifikuar</b>	Përgatitja dhe hedhja e të dhënave në një tabela dhe ndërtimi i posterave dhe albumeve apo dosjeve të punës.		26.11.2014	U hartuan postera, fletë palosje dhe një hartë e Shqipërisë së Veriut me veshjet popullore të zonës.
<b>Realizuar</b>	+		26.11.2014	
<b>Planifikuar</b>	Prezantimi i produktit		27.11.2014	Prezantim i suksesshëm i punimeve duke shfaqur në mënyrë të qartë e koncize të gjitha llojet e përgatitjeve të bëra.
<b>Realizuar</b>	+		27.11.2014	

Fletëvlerësimi për menaxhimin individual të kohës. (Vlerësimi në pikë)

### Dita 1

**Vini re!** Fletëvlerësim plotësohet për secilën ditë të projektit!

Nr	Emri Mbiemri	Bashkë punimi me shokët	Shfrytë zimi i kohës	Shfrytë zimi i mjeteve	Dhënia e ideve	Mesazhet	Nota në Fund të ditës
1	Marsi X	10	10	10	10	10	10
2	Mateo Y	8	8	7	7	8	8
3	Magi Z	10	10	10	10	10	10

Fletëvlerësimi për bashkëpunimin brenda grupit. (Vlerësimi në pikë)

Dita 1					
NR	Kriteret Nxënësit	Anëtarët e grupit e ndihmojnë njëri- tjetrin	Të gjithë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në realizimin e projektit.	Vlerësimi	
25	Marsi X	10	10	10	
26	Mateo Y	9	10	10	

**TABELA E VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR TË NXËNËSVE**

Nr	Emri Mbiemri	Klasa	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Nota e projektit
1	Marsi X		10	10	10	10
2	Mateo Y		7	8	8	8
3	Magi Z		9	10	10	10

*U komunikohet dhe argumentohet vlerësimi nxënësve, pas prezantimit.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara, për prezantimin e produktit të projektit etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Fjalimi i Gjergj Kastriotit (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Diskutojmë: <i>Sulltan Mehmeti II: “Kurrë s’ka për të dalë më mbi tokë një luan i tillë si Skënderbeu”.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</li><li>- Kompetenca e të menduarit</li><li>- Kompetenca personale</li><li>- Kompetenca digjitale</li></ul>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton rreth figurës së Skënderbeut;</li><li>- dallon elementet e tekstit argumentues në fjalimin e Skënderbeut;</li><li>- analizon veçoritë gjuhësore të fjalimit të Skënderbeut;</li><li>- vlerëson figurën e Skënderbeut duke u nisur nga këndvështrimi i tij;</li><li>- zëvendëson fjalët dialektore me fjalët në normë letrare.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Skënderbeu Fjalim politik Emocione Ndjenja Funksion nxitës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, <a href="http://telegrafi.com/skenderbeu-hero-kombetar-i-shqiptareve/">http://telegrafi.com/skenderbeu-hero-kombetar-i-shqiptareve/</a> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=rdNCCKUspU">https://www.youtube.com/watch?v=rdNCCKUspU</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, Lexim me kodim i pjesës, Diskutim</i> <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim</i> <i>Disa orë më parë mësuesi/ja ka udhëzuar nxënësit të hulumtojnë rreth jetës dhe veprës heroike të Skënderbeut/ Diskutojmë rreth informacioneve të marra.</i> Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (1405- 1468) personifikon një epokë të tërë të historisë kombëtare të shqiptarëve për luftën më se njëshekullore të tyre kundër vërshimit osman për mbrojtjen e tokës, të pasurisë e të lirisë. Nën udhëheqjen e tij, lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë të lartë e të organizuar, shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të vendit dhe në forcimin e vetëdijes kombëtare të tyre. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptare, që udhëhoqi me vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë. Ai e kuptoi, më qartë se kushdo tjetër,			

detyrën që shtronte çasti historik: nevojën e bashkimit politik, si kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e interesave të të gjitha shtresave shoqërore, të pasura e të varfra, të kërcënuara tashmë prej pushtuesve osmanë në çështjet jetike. Procesin e bashkimit të shqiptarëve e favorizoi shumë edhe toleranca e lartë fetare e Skënderbeut. Si i krishterë dhe i rritur në ambientin mysliman, ai qëndroi mbi dallimet fetare. Ai bashkëpunoi ngushtë dhe pa asnjë paragjykim me klerin e rriteve të ndryshme dhe dërgoi si ambasadorë të tij në vendet e huaja priftërinj katolikë dhe ortodoksë. Respektimi i besimeve, e rriteve fetare, ndikoi pozitivisht në procesin e bashkimit të shqiptarëve. Bashkimi shpirtëror i të gjithë popullit shqiptar dhe forcimi i vetëdijes kombëtare të tij, shënonin fitoren më të madhe të epopesë së lavdishme të shek. XV-të dhe të tërë veprës së Skënderbeut.

Gjenerali anglez Xhejms Wolfe (heroi i Kuebekut ) kishte deklaruar se “Skënderbeu ua kalon gjithë oficerëve, të lashtë e të sotëm, për drejtimin e një ushtrie të vogël mbrojtëse”.

Skënderbeu gëzonte dashurinë nga bashkëkombësit e vet, jo vetëm sa që gjallë, por edhe pas vdekjes. Figura e tij mbeti e gjallë në ndërgjegjen e popullit shqiptar si kujtim i asaj lufte që habiti botën me fitoret e saj legjendare dhe u bë krenaria për një të kaluar, të cilën donin ta përsërisnin. Këngët që shqiptarët i thurën Skënderbeut, të cilat i këndonin me krenari edhe përpara pushtuesve, gojëdhënat e lidhura me vendet ku veprroi e luftoi ai dhe me vise të tjera të banuara prej tyre, i dhanë atij tiparet e një luftëtari me forca vigane, të pajisur me trimëri të pashoqe, i cili i kalonte caqet e realitetit dhe merrte cilësitë e një figure që mishëronte aspiratat e një populli të tërë për liri e pavarësi. Kujtimi i Skënderbeut jetoi, jo vetëm në zemrën e popullit që e lindi. Ai pati një shtrirje që kalonte kufijtë e Gadishullit të Ballkanit. Skënderbeu i detyroi të gjitha kohërat të flisnin për të. <http://telegrafi.com/skenderbeu-hero-kombetar-i-shqiptareve/>

**Fjalimi është një ligjëratë që mbahet në një mbledhje të gjerë.**

**Fjalimi mund të ketë tematika të ndryshme dhe mund të jetë i organizuar në formë të gjatë apo të shkurtër.**

*Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me kodim i pjesës*

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin brenda një kohe të caktuar dhe të kërkojnë në të informacionet e mëposhtme duke e pajisur tekstin me simbole gjatë leximit.

**Pjesa lexohet nga nxënës të ndryshëm, punohen fjalët e reja dhe më pas punohet rreth kuptimit të tekstit.**

**Kuptojmë tekstin**

**Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.**

**Cili është qëllimi i mbajtjes së këtij fjalimi?**

Prezantimi para popullit, pas rritjes dhe qëndrimit për një kohë në oborrin e sulltanit dhe ardhjes në atdhe për t'i ndihmuar shqiptarët nga zgjedha e huaj.

**Cilat kanë qenë arsyet e pritjes së Skënderbeut?**

Jua fsheha planet e mia dhe nuk jua çfaqa dëshirën që jua dinja shpirtin, posa ju ishit të parët që e hodhët zjarrin edhe e nisët këtë valle, po se puna duhej mejtuar thellë, se duheshin gjetur mjetet, se duhej zgjedhur mirë koha. Ndryshe, do të derdhej gjak më kot, edhe përfundimi do të ishte një robëri më e keqe se e para; edhe atëherë çdo shpresë për të nesërmen.

**Si i përshkruan ai shqiptarët në fjalimin e tij?**

Krenarë, kryelartë, pasardhës të një race të vjetër dhe bujare, trima dhe bujarë.

**Cila është thirrja që prijësi i bën popullit të vet?**

Shpërmëni tani, me ndihmën e Perëndisë, që ta çlirojmë tërë Shqipërinë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim**

**Në video-projektor shikojnë “Gjurmë shqiptare” – Historia e panjohur e Skënderbeut <https://www.youtube.com/watch?v=rdNCKUsphU>**

**Diskutojmë së bashku**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për diskutimin që i bëjnë figurës së Skënderbeut, mesazhit që zbulon në fjalimin e tij etj.

**Detyrë shtëpie:** Mësoni përmendësh fragmente nga fjalimi i Skënderbeut.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Fjalimi i Gjergj Kastriotit (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - hulumton rreth figurës së Skënderbeut; - dallon elementet e tekstit argumentues në fjalimin e Skënderbeut; - analizon veçoritë gjuhësore të fjalimit të Skënderbeut; - vlerëson figurën e Skënderbeut duke u nisur nga këndvështrimi i tij; - zëvendëson fjalët dialektore me fjalët në normë letrare; - ndërton hartën e personazhit të Skënderbeut.		<b>Fjalët kyçe:</b> Skënderbeu Fjalim politik Emocione Ndjenja Funksion nxitës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit <a href="http://telegrafi.com/skenderbeu-hero-kombetar-i-shqiptareve/">http://telegrafi.com/skenderbeu-hero-kombetar-i-shqiptareve/</a> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=rdNCCkUsphU">https://www.youtube.com/watch?v=rdNCCkUsphU</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Konkurs, Punë e pavarur në dyshe, Ruaje fjalën e fundit për mua

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Konkurs

Nxënësit recitojnë fragmente nga fjalimi i Skënderbeut. Në fund diskutohet për nxënësin që recitoi më bukur.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë e pavarur në dyshe

**Klasa ndahet në dyshe dhe punohet me fisha:**

1) Në fjalën e tij, Skënderbeu përdor disa emërtime për shqiptarët. Shkruajini ato dhe tregoni efektin që krijon kjo zgjedhje leksikore:

Emërtimet për shqiptarët	Efektin që krijohet

2) Nënvizoni fjalitë në të cilat merrni informacion historik.

3) Shkruani argumentet e përdorura nga Skënderbeu në fjalimin e tij:

për të arsyetuar shkaqet e pritjes së tij;

*Po unë sillesha me atë mënyrë, se ashtu e deshte shpëtimi juaj edhe imi, se puna ishte e atillë që duhej bërë dhe jo thënë, se shikonja që kishit më tepër nevojë për fre se sa për shtyrje.*

*Jua fsheha planet e mia dhe nuk jua çfaqta dëshirën që jua dinja shpirtin, posa ju ishit të parët që e hodhët zjarrin edhe e nisët këtë valle, po se puna duhej mejtuar thellë, se duheshin gjetur mjetet, se duhej zgjedhur mirë koha.*

*Ndryshe, do të derdhej gjak më kot, edhe përfundimi do të ishte një robëri më e keqe se e para; edhe atëherë çdo shpresë për të nesërmen do fluturonte; se një punë si kjo nisët një herë e mirë dhe në mos vafitë mbarë, rasti dhe mjetet për ta nisur përsëri ikin dhe nuk kthehen prapë për të bindur dhe motivuar shqiptarët për luftë.*

Nënvizoni fjalët e përdorura në dialekt. Shkruani përbri formën e tyre sipas normës letrare.

Tok-bashkë

Kujtonja - kujtoja


Sualltë - më sollët

Fre - pengesë

Ushhtë - heshtë

Etj.

4) Ndërto hartën e personazhit të Skënderbeut.



Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përpiqen të zbulojnë karakteristika të veçanta të Skënderbeut.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Ruaje fjalën e fundit për mua

Pasi mbarohet leximi dhe është komentuar përmbajtja tematike dhe ideore e fragmentit kalohet në vlerësimin dhe interpretimin e tekstit duke përdorur metodën “Ruaje fjalën e fundit për mua”.

U kërkohet nxënësve të gjejnë në tekst dhe t'i shkruajnë në një fletë, pjesë që u bëjnë përshtypje, i çudisin, i entuziazmojnë, i gëzojnë etj. Në anën tjetër të letres nxënësit duhet të shkruajnë komentin e tyre, d.m.th. çfarë u bëri përshtypje.

Ftohen nxënësit të lexojnë citimet që kanë zgjedhur. Nxënësi që do të lexojë citimin e tij, fton nxënësit e tjerë të bëjnë komentet e tyre. Edhe mësuesja mund të bëjë komente, por vetëm mbasi të kenë folur disa nxënës. Pasi nxënësve u është dhënë mundësia të komentojnë, ai që kishte zgjedhur citimin kthen fletën nga ana tjetër dhe lexon komentin.

Kjo është fjala e fundit.

Si i kuptoni fjalët e Skënderbeut: “Lirinë nuk jua solla unë, po e gjeta këtu në mes tuaj.”

Nxënësit japin mendimet e tyre. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe punën e arkivojnë në dosje.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani tri veçori gjuhësore të këtij fjalimi (ushtrimi 5 fq. 140).

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur kushtore dhe lejore (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Ti ke një ëndërr në sirtar Thuaj kushtin që duhet të plotësohet që ëndrra të mos ngelet ëndërr, po të realizohet.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon pjesën e n/r kushtore, lejore në një fjali të përbërë. - analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë; - argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r kushtore dhe lejore në fjali e si ndahet me presje ajo; - argumenton lidhjen kusht-pasojë në tekstet e krijuara.		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përbërë Pjesë e n/r kushtore, lejore Marrëdhënie kusht-pasojë Mjet lidhës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, <a href="https://www.youtube.com/watch?v=IG6Mm4g0ASQ">https://www.youtube.com/watch?v=IG6Mm4g0ASQ</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi, gjuhësi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, Tabela Insert, Punë në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim për njohuritë paraprake <a href="https://www.youtube.com/watch?v=IG6Mm4g0ASQ">https://www.youtube.com/watch?v=IG6Mm4g0ASQ</a> Dëgjohet kënga e kënduar nga Gëzim Nika, “Shqipëri o nëna ime”. Te refreni i saj: “Shqipëri o nëna ime, ndonëse jam i mërguar, dashurinë tënde kurrë zemra s’e ka harruar” dallojmë pjesën e nënrenditur lejore.			
<b>Ndërtojmë fjali më pjesë të n/r lejore dhe kushtore</b> U fut të lahej në det, edhe pse deti ishte i tërbuar. Iku nga shtëpia, megjithëse nëna i lutej me ngashërim. Po qe se del nga kjo derë, mos bëj gafë të futesh më brenda Nëse një ditë do trokasësh në portën time, unë nuk do ta hap atë.			
<b>Diskutojmë së bashku</b> <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Tabela INSERT <b>Tabela Insert</b> Udhëzohen nxënësit që të hapen tekstet dhe të plotësojnë tabelën me informacionin që jepet në tekst.			
<b>+(inf që shtohet)</b>	<b>V(inf që di më parë)</b>	<b>__(inf që dihet gabim)</b>	<b>?(inf që nuk kuptohet dhe duhet ndihma e mësueses)</b>
Në fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore, shprehet marrëdhënia kusht-pasojë. Veprimet apo gjendjet që shprehen në dy pjesët e fjalisë janë të ndërvarura. Veprimi apo mosveprimi te njëra, kushtëzon kryerjen apo moskryerjen e veprimit të tjetra.	Pjesët e fjalisë së përbëra kushtore mund të lidhen me lidhëza dhe shprehje lidhëzore, si: në, nëse, në qoftë se, po qe se, me kusht që, kur etj.		

Rendi i pjesëve të fjalive kushtore është i lire dhe në tri pozicionet ndahet me presje.	Pjesët e fjalisë së përbërë lejore mund të lidhen me lidhëza dhe shprehje lidhëzore, si: sado që, sido që, megjithëse, kudo, kushdo etj.		
Në këto fjali, veprimi apo gjendja që shprehet në pjesën e varur pritët të bëhet pengesë për atë të pjesës kryesore, por, në të vërtetë, veprimi kryhet.	Rendi i pjesëve të fjalive lejore është i lirë dhe në tri pozicionet ndahet me presje.		

Nxënësit përfshihen të gjithë në plotësimin e tabelës. Në qoftë se ka paqartësi, mësuesi/ja ndërhyr për të qartësuar dhe shpjeguar.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Dalloni fjalitë kushtore, pjesët përbërëse të tyre dhe llojin e mjeteve lidhëse.

**Në paste këtu në këtë mbledhje ndonjë mik me zemër të Cezarit, atij i thoni që Bruti e desh Cezarin jo me pak se ai. Dhe, në më pyetë ai mik përse Bruti u ngrit kundër Cezarit, përgjigjja ime është kjo: jo se e desha Cezarin më pak, po se e desha Romën më tepër. Në më quani të ndershëm, besomëni dhe quamëni mjaft të ndershëm sa të më besoni.**

**Shënim! Pjesët e n/r kushtore do shënohen me bold**

Mjeti lidhës është lidhëza NË

**Plotësoni pjesët kryesore me pjesë të varura kushtore dhe vendos në kllapa mjetin lidhës.**

Po të kisha shkopin magjik do të të plotësoja të gjitha dëshirat e parealizuar. (Po)

Në qoftë se nuk do të kishte internet, bota do të ishte shumë e zymtë. (Në qoftë se)

Sikur njerëzit të jetonin më gjatë, do të shihnin më shumë tmerre e dhimbje. (Sikur)

Nëse kafshët do të flisnin, do të na tregonin si ishte bota e tyre. (Nëse)

Nxënësit përfshin të gjithë në punimin e ushtrimeve.

Ata vlerësojnë njeri-tjetrin në përgjigjet e dhëna.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përfshirjen e tyre gjatë orës së mësimi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore dhe lejore (ora 2) Ushtrime</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <div><div>- dallon pjesën e n/r kushtore, lejore në një fjali të përbërë;</div><div>- analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë;</div><div>- argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r kushtore dhe lejore në fjali e si ndahet me presje ajo;</div><div>- argumenton lidhjen kusht-pasojë në tekstet e krijuara.</div></div>		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përbërë Pjesë e n/r kushtore, lejore Marrëdhënie kusht-pasojë Mjet lidhës	

Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Tabela e konceptit, të nxënit në bashkëpunim, Shkrim i lirë			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Tabela e konceptit			
Rikujto njohuritë për fjalitë e përbëra me n/r. Plotëso tabelën e koncepteve më to.			
Fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore			
Roli që luan pjesa e nënrenditur	Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës	Pozicioni i pjesës së n/r	Përdorimi i presjes
Në fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore, shprehet marrëdhënia kusht-pasojë. Veprimet apo gjendjet që shprehen në dy pjesët e fjalisë janë të ndërvuarura. Veprimi apo mosveprimi të njëra, kushtëzon kryerjen apo moskryerjen e veprimit të tjetra.	në, nëse, në qoftë se, sikur, po qe se	Rendi i pjesëve të fjalisë është i lirë	Pjesa e varur ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore
Fjalitë me pjesë të nënrenditur lejore			
Roli që luan pjesa e nënrenditur	Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës	Pozicioni i pjesës së n/r	Përdorimi i presjes
			Pjesa e varur ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore
Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit në bashkëpunim			
Nxënësit bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në zgjidhjen e ushtrimeve.			
Vijoni arsyetimin e shprehur me pjesë kushtore sipas modelit të dhënë.			
Ky ushtrim punohet dhe si lojë në çift.			
Po të isha i pasur, do të bëja një udhëtim rreth botës. Po të udhëtoja rreth botës, do të bëhesha më i ditur. Po të isha më i ditur do të ndihmoja njerëzimin duke gjetur kurën e shërimit të kancerit. Po të gjeja kurën kundër kancerit, do të shpëtoja shumë njerëz. Po të shpëtoja shumë njerëz, jeta ime do të ishte më e bukur...			
Po të kisha një shkop magjik ... vazhdo arsyetimin			
Po të isha dhe një herë e vogël...			
Plotësoni pjesët e mëposhtme me nga një fjalë të varur lejore.			
Ndonëse ia kam premtuar vetes disa herë, nuk e kam mbajtur fjalën.			
Kushdo të jetë kundërshtari le të vijë e të përballë me mua.			
Sido që të vijnë punët, do të jem në anën tënde.			
Megjithëse nuk e kam ende të drejtën e votës, unë kam bindjet e mia politike.			

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë**

Hartoni një tekst të shkurtër ku të shprehni marrëdhëniet kusht-pasojë, si dhe ato lejore. Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse dhe mjetet e lidhjes.

Nxënësit punojnë individualisht për të hartuar tekstin. Nëse ushtrimi nuk mbaron në klasë u jepet detyrë shtëpie.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dallimin e fjalive me pjesë të n/r kushtore dhe lejore në një tekst, për bashkëveprimin e tyre brenda grupit etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të flasim</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b>	
<b>Tema mësimore: Prezantimi me gojë</b>		Nxënësit prezantohen para klasës	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Prezantim	
- diskuton rreth prezantimit me gojë;		Kontroll i emocioneve	
- argumenton strukturën e prezantimit me gojë;		Slide	
- prezanton me hollësi një temë të caktuar.		Ppt	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, ppt të ndryshme		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
		tik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bisedë, Punë e drejtuar, Diskutim-Vlerësim			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bisedë			
Pas përgatitjes së produktit përfundimtar për një projekt na duhet të bëjmë një prezantim me gojë.			
<b>Po ç'është prezantimi?</b>			
Prezantimi është një veprimtari paraqitëse të foluri, që realizohet përmes një takimi ose një ceremonie, në të cilën dikush tregon, përshkruan ose shpjegon diçka për një grup tjetër njerëzish.			
Për të bërë një prezantim të mirë, duhet:			
<i>Për çfarë duhet për të bërë një prezantim të mirë?</i> t'u kuptuar nga dëgjuesit e prezantimit, duhet:			
të njihni mirë temën për të cilën do të flisni;			
të kontrolloni emocionet;			
të jeni i qartë për fushën për të cilën do të flisni;			
të përqendroheni mendërisht, para se të flisni.			
<i>Për çfarë duhet për t'u kuptuar nga dëgjuesit prezantimi:</i>			
të shqiptoni qartë dhe me një ritëm të caktuar fjalët;			
të shprehni qartë konceptet (ide, fakte, argumente);			
të përdorni terma të saktë dhe të përshtatshëm;			
t'i organizoni fjalitë në mënyrë të kuptueshme, korrekte dhe të thjeshtë.			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë e drejtuar			
<b>Mësuesilja orienton nxënësit të kenë kujdes etapat e hartimit të një prezantimi.</b>			
<b>HARTIMI I PREZANTIMIT</b>			
Filloni me përgatitjen e një strukture të prezantimit, ashtu si bëni kur tregoni një histori. Prezantimi ka:			
<i>një hyrje;</i>			
<i>një problematikë</i> (zhvillim ku renditen çështjet që do të prezantohen sipas një rendi logjik);			
<i>një mbyllje</i> (të shoqëruar me përfundime që u referohen pikave më të rëndësishme të prezantimit).			
Organizimi i materialit të shkruar për prezantim, mund të bëhet në programin <i>PowerPoint</i> .			
Kur krijoni <i>slide</i> -t e prezantimit, mbani parasysh rregullat e mëposhtme.			

Mos përdorni fjali të gjata.

Fjalitë mund të fillojnë me folje.

Mos vendosni shumë tekst në një *slide*.

Përdorni tabela, fotografi, grafikë, diagrame.

Titujt duhen shkruar të mëdhenj dhe me ngjyra.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Diskutim-Vlerësim

Zgjidhni njërën nga temat e mëposhtme për të hartuar një prezantim.

*Shpenzimi i kohës*

*Vështirësitë në të lexuar*


*Botimet e reja*

Organizojeni materialin e prezantimit në *PowerPoint* dhe paraqiteni përpara klasës.

**Vlerësoni prezantimet e njëri-tjetrit me pikë nga 1-10.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për prezantimet e tyre.

## PLANIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore: Gjiri i Meksikës (ora 1)</b>		Ushqimet pikante të Meksikës	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<b>Nxënësi/ja:</b>		Bota nënujore	
<div>- hulumton për Gjirin e Meksikës;</div> <div>- diskuton rreth studimit të Universitetit të Luizianës;</div> <div>- analizon veçoritë e tekstit argumentues;</div> <div>- diskuton për mbrojtjes e botës nënujore.</div>		Peshk	
		Peshkaqen	
		Tekst argumentues	
		Argumente	
		Hipotezë	
		Konstatime	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit <a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjiri_i_Meksik%C3%ABs">https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjiri_i_Meksik%C3%ABs</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> gjeografi	
<a href="https://www.evropaelire.org/a/2022359.html">https://www.evropaelire.org/a/2022359.html</a>			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Imagjinatë e drejtuar, Punë e orientuar, Punë në dyshe</i>			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i>			
<div>Imagjino sikur jeni në Gjirin e Meksikës. Përshkruajeni atë.</div> <div></div>			
<p>Gjiri i Meksikës (anglisht: Gulf of Mexico, spanjollisht: Golfo de México) është një det marginal i oqeanit <u>Atlantik</u> dhe si pjesë e detit mesdhetar amerikane është përafërsisht komplet i rrethuar nga Amerika Veriore. Në bregdetin verior dhe veriorë-perëndimorë shtrihen <u>Shtetet e Bashkuara të Amerikës</u> (të cilat janë Florida, Alabama, Mississippi, Louisiana und Texas), kurse në pjesën jugore-perëndimore dhe jugore shtrihet <u>Meksika</u> (shtetet meksikane janë Tamaulipas, Veracruz, Tabasco, Campeche, Yucatán und Quintana Roo). Në jug-lindje gjiri kufizohet me <u>Kubën</u>. Ai lidhet me rrugën detare të Floridës, që ndodhet mes <u>ShBA-ve</u> dhe <u>Kubës</u>, me oqeanin Atlantik dhe me rrugën detare të Yucatán, mes <u>Meksikës</u> dhe <u>Kubës</u>, me detin Karibikë. Temperatura e ujitë gjatë verës arrin deri në 30 °C, kurse gjatë dimrit deri në 25 °C. Kjo shpjegohet me faktin se Gjiri gati tërësisht ndodhet në zonën tropike.</p>			

Sipërfaqja e gjirit është gjithsej 1.550.000 km<sup>2</sup>. Në gjirin çdo vit krijohen rryma tropikale (hurrican) të cilët marrin shumë jetë njerëzish. [https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjiri\\_i\\_Meksik%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjiri_i_Meksik%C3%ABs)

Gjiri i Meksikës rrezikohet nga katastrofa ekologjike

Platforma e naftës “Deepwater Horizon” në Gjirin e Meksikës, e cila u dogj pas shpërthimit, mund të lëshojë 1.528 milionë litra naftë të papërpunuar në ditë dhe të shkaktojë një katastrofë ekologjike.

Rreziku i vërtetë për mjedisin do të paraqitet nëse nafta do të vinte deri në brigjet e Luizianës, e cila ndodhet 80 km më larg.

Ekipe të shpëtimit i kanë vazhduar kërkimet për 11 punëtorët e zhdukur, kurse kanë gjetur vetëm dy barka shpëtimi.

Më shumë se 100 njerëz u larguan pas shpërthimit dhe zjarrit, ndërsa katër janë plagosur seriozisht, transmeton AP.

<https://www.evropaelire.org/a/2022359.html>

Uji ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe sigurimi i tij është kthyer në një nga sfidat më të mëdha botërore. Ai nënkupton pastërti, energji, por mbi të gjitha, diçka të sigurt për të pirë. Sipas shifrave, është vlerësuar se rreth 2.6 miliardë njerëz në botë nuk kanë ujë higjienik dhe rreth 900 milionë të tjerë nuk konsumojnë ujë të sigurt. Sipas OBSH-së, 88% e sëmundjeve të diarresë shkaktohen nga konsumimi i këtij lloji uji. Gjithmonë uji ka qenë faktor vendimtar në zhvendosjen e popullsisë nga një vend në një tjetër, sepse ai është kushti themelor për një jetë të sigurt e të shëndetshme.

Shkaqet e ndotjes së ujit.

Ndotja e ujit dhe përdorimi i tij ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut dhe lë pasojë për kohë të gjatë. Sot në botë njihen më se dyqind sëmundje që paraqiten si pasojë e përdorimit të ujit të ndotur. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (ËHO) nga uji i ndotur, sot në botë sëmurën mbi pesëqind milion njerëz. Nga uji i papastër pasojnë një sërë sëmundjesh, ku, ndër më të rëndësishmet janë kolera, tifoja e zorrëve, hepatiti, tularemia etj. Këto sëmundje shpesh kanë marrë viktima njerëzore. Në ditët e sotme me zhvillimet e avancuara që po ecën bota, është vështirë të mendohet për një jetë në Tokë me ujë të pastër.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë e orientuar

Orientohen nxënësit të lexojnë pjesën dhe shpjegohen karakteristikat e tekstit argumentues.

Teksti argumentues ka për qëllim të shpjegojë, të paraqesë një arsyetim ose një kritikë; të diskutojë, **të bindë** për vlefshmërinë e argumenteve të veta.

Quhet argumentues, sepse autori nxjerr në pah një tezë, duke përdorur një seri argumentesh që mbështesin ose kundërshtojnë këtë tezë. Teza prezantohet në hyrje të tekstit dhe shoqërohet me argumentet përkatëse p.sh.

#### ❖ Çdo tekst argumentues ka këto elemente strukturore:

- Teza
- Argumente pro tezës
- Teza ose tezat e kundërta
- Argumente kundër tezave të kundërta
- Përfundimi

**Kujdes:** Çdo argument duhet pasqyruar me shembuj konkretë për ilustrim.

Jo çdo tekst argumentues, detyrimisht, është i ndërtuar mbi bazën e një skeme fikse, por të gjitha këto tekste kanë një tezë dhe argumentet, që duhet të parashtojnë për të pranuar a kundërshtuar këtë tezë, p.sh.:

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

#### **Çfarë tregon studimi i Universitetit të Luizianës?**

Gjiri i Meksikës është një vend i rëndësishëm për riprodhimin e një numri të madh specimesh peshkaqeni.

#### **Cili është zbulimi i papritur dhe ç'mekanizma vuri në lëvizje ai?**

#### **Ç'lloj peshku rritet në ujërat e kripura të këtij gjiri?**

Një peshk i vogël që ngjan si harengë, 30 cm dhe 250 gramë.

#### **Çfarë i befaso i studiuesit?**

Studiuesit i befaso i kapja e 145 peshkaqenëve të vegjël.

#### **Kur mendohet se janë shfaqur në Tokë peshkaqenët?**

Peshkaqenët e kanë populluar Tokën për më shumë se 400 milionë vjet; ata janë shfaqur rreth 100 milionë vjet përpara se të shfaqej dinozauri i parë.

<p><b>Ku u bazua hipoteza që u ngrit?</b></p> <p>Studiuesit ngritën hipotezën se peshkaqenët i përdorin këto brigje si çerdhe për të kaluar vitet e para të jetës. Gjiri i Meksikës ishte një vend i shkëlqyer për peshkaqenët e vegjël, pasi në të ushqimi ishte i bollshëm.</p> <p><b>Cili është përfundimi në të cilin arriti njëri nga studiuesit?</b></p> <p>Peshkaqenët janë grabitqarë, që ndodhen në krye të zinxhirit ushqimor detar. Nuk di nëse do të mund të parashikoni me saktësi se ç'do të ndodhte nëse ata do të zhdukeshin. Kjo do të sillte pasoja shkatërruese për ekosistemin detar.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre në mësim, mesazhin dhe analizën e fragmentit etj.</p> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Kërkoni në internet materiale shtesë për Gjirin e Meksikës dhe kuriozitete që lidhen me të.</p>
--

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Gjiri i Meksikës (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Plazhet e Meksikës – Kankun	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - hulumton për Gjirin e Meksikës; - diskuton rreth studimit të Universitetit të Luizianës; - analizon veçoritë e tekstit argumentues; - diskuton për mbrojtjes e botës nënujore.		<b>Fjalët kyçe:</b> Bota nënujore Peshk Peshkaqen Tekst argumentues Argumente Hipotezë Konstatime	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, <a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjiri_i_Meksik%C3%ABs">https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjiri_i_Meksik%C3%ABs</a> <a href="https://www.evropaelire.org/a/2022359.html">https://www.evropaelire.org/a/2022359.html</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> gjeografi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Të nxënës në bashkëpunim dhe punë me fishe, Tabela M <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim Diskutohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Nxënësit vlerësojnë njeri-tjetrin dhe vetëvlerësojnë gjithashtu. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënës në bashkëpunim, Punë me fishe Ndaj klasën në grupe dhe shpërndaj fishtat. <b>Grupi 1.</b> Jepni argumentet për tri konstatimet që shtrohen në tekst: - Gjiri i Meksikës është vend i përshtatshëm për rritjen e peshkaqenëve të vegjël. - Peshqit e Gjirit të Meksikës dëmtohen nga arsye të ndryshme. - Peshkaqenët janë mjaft të rëndësishëm për jetën në Tokë. <b>Grupi 2.</b> Konkluzioni i paragrafit të fundit është mjaft i rëndësishëm. Parafrazojeni mesazhin që ai jep me një fjali. Për shembull: <i>Peshkaqenët janë në krye të zinxhirit ushqimor detar, ndaj zhdukja e tyre do të kishte pasoja për ekosistemin.</i> <b>Grupi 3.</b> Nxënësit diskutojnë rreth temës: Çfarë mendoni se duhet bërë për mbrojtjen e botës ujore? <b>Grupi 4.</b> Vini re mbiemrat e përdorur në këtë tekst. A ndryshojnë ato nga ata që përdoren në tekstet përshkruese? <b>Grupi 5.</b> Togfjalëshi <i>krijesa të mahnitshme</i> krijon efektin: e madhështisë. <b>Grupi 6.</b> Gjeni disa fjalë a shprehje që përdoren zakonisht në fillimet e paragrafëve të tekstit argumentues.			
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Tabela M			
Çfarë dinit më parë rreth Gjirit të Meksikës ?		Çfarë mësuar këtu?	Çfarë do të donit të mësonit më tej?
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mesazhin dhe analizën e fragmentit, për dallimin e veçorive të tekstit argumentues			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Letra e parë (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Komentojmë thëniet e Senekës: <i>Një prej cilësive më të bukura të miqësisë së vërtetë është të kuptosh dhe të të kuptojnë.</i> <i>Është rrugë e vështirë ajo që të shpie në lartësitë e madhësisë.</i> <i>Lumturia e vërtetë është... të shijosh të tashmen, pa varësinë plot ankth prej të nesërmes.</i> <i>Asnjë njeri nuk ka qenë ndonjëherë rastësisht i mençur.</i> <i>Është cilësia, jo sasia, ajo që ka rëndësi.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca digjitale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- hulumton për jetën e filozofit të lashtësisë;</li><li>- dallon elementet e tekstit argumentues;</li><li>- analizon argumentet e dhëna në letër;</li><li>- zbulon mesazhin që përcjell pjesa;</li><li>- zbulon veçoritë gjuhësore të tekstit argumentues.</li></ul>		<b>Fjalët kyçe:</b> Filozof i lashtësisë Letër Këshilla Vlera e kohës Teza Argumente	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit <a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Lucius_Annaeus_Seneca">https://sq.wikipedia.org/wiki/Lucius_Annaeus_Seneca</a> <a href="http://www.gazetatema.net/2016/04/05/seneka-filozof-i-madh-i-lashtesis/">http://www.gazetatema.net/2016/04/05/seneka-filozof-i-madh-i-lashtesis/</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Bisedë, Lexim zinxhir, Punë në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Bisedë <b>Diskuton për jetën e Senekës</b> Lucius Annaeus Seneca lindi në Kordobë të Spanjës por pjesën dërmuese të jetës e kaloi në Romë. Fëmijërinë e kaloi nën Augustin dhe ndoqi një shkollim të mirë në retorikë ku e dërgoi babai i tij me qëllim që ta përgatisë për karrierë publike. Senekën e tërhiqte filozofia që në atë kohë me të madhe pati kapluar shkollat e retorikës : Këtu ai ndoqi mësimet e pitagoristit Sotion i cili mes tjerash këshillonte mosngrënien e mishit, stoikun Atal, i njohur për predikimet e tij nga morali dhe cinikun Demetrius. I pasionuar nga kjo mënyrë asketike e jetës u sëmure dhe qe i detyruar të tërhiqet nga kjo formë e të jetuarit. Pas kësaj kaloi një kohë të shkurtër në Egjipt e me t`u kthyer nën ndikimin e këshillave të prindit dhe filloi karrierën e avokatit. Arriti shpejt të shkëlqejë, por u zbeh nga Perandori Klaud i cili nën ndikimin e gruas së vet e dërgoi syrgjyn në Korzikë për gjatë tetë vitesh. U kthye vetëm kur gruaja e re e Klaudit e thirri në Romë. Tani iu besua edukimi Neronit të ri. Me rritjen e nxënësit, Seneka tërhiqet dhe jepet pas studimit, mund të thuhet, kultivimit shpirtëror. Fundit është pak sa i ngjashëm me atë të Sokratit... I përzier në përgatitjen e një komploti (fakte të pasigurta) u dënua nga Neroni me prerjen e venave, por vdekja vonohej kështu iu dha helmi e vdiq duke diktuar mendimet e veta. Në vdekje e përcolli edhe bashkëshortja e vet e cila nuk deshi të jetoj pa të. <a href="https://sq.Wikipedia.org/wiki/Lucius_Annaeus_Seneca">https://sq.Wikipedia.org/wiki/Lucius_Annaeus_Seneca</a> <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> lexim zinxhir <b>Lexohet pjesa nga nxënës të ndryshëm</b> <b>Më pas nxënësit punojnë në dyshe për karakteristikat e tekstit argumentues.</b> Jo çdo tekst argumentues, detyrimisht, është i ndërtuar mbi bazën e një skeme fikse, por të gjitha këto, teksti argumentues ka për qëllim të shpjegojë, të paraqesë një arsyetim ose një kritikë; të diskutojë, të bindë për vlefshmërinë e argumenteve të veta.			

Quhet argumentues, sepse autori nxjerr në pah një tezë, duke përdorur një seri argumentesh që mbështesin ose kundërshtojnë këtë tezë. Teza prezantohet në hyrje të tekstit dhe shoqërohet me argumentet përkatëse p.sh., tekste kanë një tezë dhe argumentet që duhen pranuar ose kundërshtuar,

❖ **Çdo tekst argument ka këto elemente strukturore:**

- Teza
- Argumente pro tezës
- Teza ose tezat e kundërta
- Argumente kundër tezave të kundërta
- Përfundimi

Foljet mund të jenë në veprorë, por dhe joveprorë. Veta e tretë e joveprores së tashme i jep karakter objektiv dhe formal tekstit (mendohet, vërtetohet, duket, bazohet etj.).

**Qëllimi i tekstit argumentues: Të bindë nëpërmjet arsytimit dhe argumentimit**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

**Kuptojmë tekstin**

**Shënimi me PO nëse pohimi është i vërtetë dhe JO nëse është e gabuar.**

Çështja kyçe e trajtuar në këtë tekst është: *dobishmëria e kohës.* PO

Autori e kritikon mikun e tij Lucil, për shpenzimin e kohës në mënyrë të pakujdesshme. JO

Sipas autorit, pjesa më e madhe e jetës na ikën duke mos bërë asgjë. PO

Ekzistojnë edhe nga ata të cilët dinë ta shfrytëzojnë si duhet kohën e tyre. JO

Sipas autorit, është e zakonshme në jetë që gjërat të lihen për më vonë. PO

Autori e cilëson veten si një njeri të përpiktë. JO

Në mbyllje të letres, ai përmbledh edhe një herë argumentet e dhëna. PO

*Nxënësit japin mendimet e tyre.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për hulumtimin për jetën e Senekës, për të kuptuarit e tekstit etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore: Letra e parë (ora 2)</b>		Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Aftësia për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Filozof i lashtësisë	
- hulumton për jetën e filozofit të lashtësisë;		Letër	
- dallon elementet e tekstit argumentues;		Këshilla	
- analizon argumentet e dhëna në letër;		Vlera e kohës	
- zbulon mesazhin që përcjell pjesa;		Teza	
- zbulon veçoritë gjuhësore të tekstit argumentues.		Argumente	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, <a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Lucius_Annæus_Seneca">https://sq.wikipedia.org/wiki/Lucius_Annæus_Seneca</a> <a href="http://www.gazetatema.net/2016/04/05/seneka-filozof-i-madh-i-lashtesis/">http://www.gazetatema.net/2016/04/05/seneka-filozof-i-madh-i-lashtesis/</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> histori	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë, Punë në dyshe, Shkrim i shpejtë</i>			
<i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bisedë</i>			
<i>Diskutoj me nxënësin për vlerën e kohës përcjellë nëpërmjet thënieve nga njerëzit e ditur.</i>			
<i>“Koha është monedha e jetës suaj. Kjo është e vetmja monedhë që ju keni, dhe vetëm ju mund ta përcaktoni se si do ta shpenzoni. Kini kujdes që të mos i leni njerëzit e tjerë ta shpenzojnë atë për ju”. Carl Sandburg</i>			

*“Koha është gjëja më e vlefshme që një njeri mund ta shpenzojë”.* Theophrastus  
*Koha është një mësues i madh, por për fat të keq i vret të gjithë nxënësit e saj.* Hector Berlioz  
*Ne duhet të përdorim kohën si mjet e jo si një mbështetje.* John F. Kennedy  
*E vetmja arsye për kohën është që çdo gjë nuk ndodh në të njëjtën kohë.* Albert Einstein  
*Dy luftëtarët më të fuqishëm janë durimi dhe koha.* Leon Tolstoy  
*Koha është këshilltari më i urtë i të gjithëve.* Pericles  
*Mos shpenzoni kohë duke goditur në mur, me shpresën që do të transformohet në një derë.* Coco Chanel  
**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe  
**Analizojmë tekstin**

### Shkruani tezën e këtij teksti argumentues

Po t'i bëjmë një analizë të kujdesshme problemit kohë, del se pjesa më e madhe e jetës na ikën duke mos bërë asgjë, dhe e gjithë jeta na shkon duke bërë tjetër gjë nga ajo që duhej të bënim.

### Shkruani 4 argumentet që autori jep në letrën drejtuar mikut të tij.

- 1- Koha është krejtësisht e jona, vetëm atë natyra na e dha neve në zotërim.\_
- 2- Koha nuk blihet me dhurata.
- 3- Shfrytëzo çdo orë e çdo minutë. Kështu, ti do të mund të pushtosh të tashmen e, rrjedhimisht, do të varesh më pak nga e nesërmja.
- 4- Punën e sotme, mos e lër për nesër.

### Vendosni + për ato pohime të cilat tregojnë veçoritë gjuhësore të këtij teksti.

Letra ka formën e një bashkëbisedimi dypalësh. +  
 Paragrafi i tretë fillon me një fjali pyetëse. +  
 Në tekst mbizotëron përdorimi i foljeve në mënyrën lidhore. +  
 Në tekst mbizotëron përdorimi i foljeve në mënyrën kushtore. jo  
 Argumentet e autorit jepen në formë këshillash. +  
 Argumentet janë fakte shkencore. jo  
 Formuloni mesazhin gjithëkohor që autori i përcjell secilit prej nesh.  
*Koha është flori!*

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i shpejtë

Argumentoni më shkrim këtë pohim të autorit: *“Koha është dhurata më e çmuar që ne mund t'i japim dikujt”.*

Nxënësit punojnë të qetë dhe më pas vlerësojnë punët e njëri-tjetrit dhe i arkivojnë ato në dosje.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi, bashkëpunimin e treguar, krahasimin e mesazheve etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një tekst argumentues me temë: “Pse është i rëndësishëm mësimi i gjuhëve të huaja?”

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore, sasiore (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Festat. Bëj krahasimin midis festave Zgjedhja është në dorën tënd se kë festë do të zgjedhësh për krahasim.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			

<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon pjesën e n/r krahasore në fjalitë e përbëra;</li> <li>- analizon mjetin lidhës në to;</li> <li>- argumenton përdorimin e presjes para pjesës së n/r krahasore;</li> <li>- ndërton tekste ku përdor fjali me pjesë të nr krahasore.</li> </ul>	<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përberë nr. krahasore Pjesë kryesore Pjesë e nënrenditur Mjet lidhës
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** *Lojë në çift, Tabela e konceptit, Punë në dyshe*

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** *Lojë në çift*

- Krahaso vetën me shoqen/shokun e bankës.
- Krahaso klasën tënde me një klasë të paralelit tënd.
- Krahaso futbollin shqiptar me atë anglez.
- Krahasimin bëje me fjali të nënrenditura krahasore.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** *Tabela e konceptit*

Roli i pjesës së n/r	Mjeti lidhës	Pozicioni në fjali i pjesës së n/r	Përdorimi i presjes
Në këto fjali, veprimi apo gjendja për të cilën bëhet fjalë në pjesën kryesore jepet me anë të një krahasimi në pjesën e varur.	Sa, aq sa, nga, nga sa	Në rastet më tipike qëndron para pjesës kryesore.	Ndahet gjithmonë me presje.
Krahasimi nuk bazohet gjithnjë te kallëzuesit e fjalive, siç ndodh në shembujt e mësipërm, por mund t'i referohet një gjymtyre tjetër, kryesisht në shkallën krahasore:			

Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfutuara.

Sa ç'është e bukur natyra, aq e bukur është dhe ajo.

Ai me shume flet, sesa dëgjon.

Duaji të tjerët, aq sa veten

Mesa flet muri, flet burri

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Punë në dyshe*

**Rishkruani fjalitë duke këmbyer ku është e mundur, rolin e pjesëve të tyre. Diskutoni rreth formës dhe kuptimit të të dy varianteve.**

*Sa ç'ishte i papërballueshëm i ftohti, aq ishte e padurueshme vapa.*

*Sa më shumë afrohej dhelpër, aq më shumë dridhej lepuri.*

*Sa më shpejt të mbyllet kjo punë, aq më mirë është.*

*Më mirë të rrih vetëm sesa të shoqërohesh me të këqijtë.*

*Më mirë të jesh se të kesh.*

*Nxënësit punojnë në dyshe. Më pas diskutojnë për ushtrimin e dhënë dhe vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalive n.r krahasore në tekste të ndryshme etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore sasiore - Ushtrime</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon pjesën e n/r krahasore dhe sasiore në fjalitë e përbëra; - analizon mjetin lidhës në to; - argumenton përdorimin e presjes para pjesës së n/r krahasore dhe sasiore; - ndërton tekste ku përdor fjali me pjesë të nr krahasore dhe sasiore.		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përberë n.r krahasore/sasiore Pjesë kryesore Pjesë e n/renditur Mjet lidhës	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Tabela e konceptit, Punë e pavarur individuale <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Diskutim Diskutohet detyra e shtëpisë së dhënë. Nxënësit sqarojnë me mësuesin/en paqartësitë e tyre.			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Tabela e konceptit <b>Fjalja me pjesë të n/r sasiore</b>			
<b>Roli i pjesës së n/r</b>	<b>Mjeti lidhës</b>	<b>Pozicioni në fjali i pjesës së n/r</b>	<b>Përdorimi i presjes</b>
Në këto fjali shprehet rrethana e sasisë së veprimit të një sendi ose të një tipari që përmbahet te fjalja drejtuese. Per shembull	Sa, aq sa, që	Qëndron para pjesës kryesore gjithmonë.	Ndahet gjithmonë me presje.
Sa më shumë afroheshim, aq më trima bëheshim. Rezultatet e vlerësimit të shokut e mërzhiten sa s’thuhet. Sa libra ka lexuar ai, ju s’keni ngrënë patate.			
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Punë e pavarur individuale Gjeni dhe shkruani dhjetë fjalë të urta ku të shprehen marrëdhënie krahasore. Me ndihmën e të rriturve dhe fjalorit do të puthet ushtrimi në fjalë. Nxënësit krahasojnë zgjidhjet me njëri-tjetrin.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për dallimin e pjesës së n/r krahasore nga ajo sasiore, për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimet etj.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të dëgjuarit</b> <b>Tema mësimore: Reklama</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Reklama të ndryshme shihen në <i>youtube</i> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=IË60EkVGd0U">https://www.youtube.com/watch?v=IË60EkVGd0U</a> <i>ose</i> nxënësit improvizojnë reklama për tematika të ndryshme.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - diskuton për reklamat, pasi i dëgjon ato në <i>youtube</i> ; - analizon ndërtimin e reklamës; - analizon veçoritë gjuhësore të reklamës; - prezanton reklama të krijuara nga ai.		<b>Fjalët kyçe:</b> Reklamë Reklamim Produkt	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, fjalor i gjuhës së sotme shqipe, <a href="https://www.youtube.com/watch?v=IË60EkVGd0U">https://www.youtube.com/watch?v=IË60EkVGd0U</a> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=LhgyuHTj9Bk">https://www.youtube.com/watch?v=LhgyuHTj9Bk</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bisedë, Punë në dyshe, Rrjet diskutimi

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bisedë

Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, reklama është tërësia e masave dhe e veprimeve që ndërmerren në vendet me tregti kapitaliste për të bërë sa më të njohur një mall, një shfaqje etj., me qëllim që të tërhiqen blerës ose shikues, zakonisht duke i paraqitur të zmadhuara e të zbukuruara cilësitë e vlerat e vërteta dhe duke bërë bujë

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

**Nxënësit dëgjojnë dhe diskutojnë më pas.**

Dëgjoni materialin me titull: “Çfarë është reklama dhe mediat e përdorura për reklamim?” Përgjigjuni pyetjeve.

Plotësoni me emrin e kompanisë që dëshironi reklamën e mëposhtme.

*Të gjitha që ju duhen në kuzhinë*

*Zgjidh tenxheret, tiganët, ekspresin, kompletet dhe aksesoret e tjerë të kuzhinës nga*

*Delimano, dhe do të kënaqeni e gatuani në të njëjtën kohë, kurse ushqimi juaj do të jetë*

*gjithnjë natyral dhe i shëndetshëm. Këtu ju do të gjeni gjithçka që ju nevojitet për kuzhinën tuaj.*

**Diskutojmë për funksionin e reklamës**

Reklama ka për funksion:

- të tërheqë vëmendjen e marrësit (blerësit);
- të krijojë interes për produktin;
- të krijojë dëshirën për ta blerë atë;
- të provokojë reagimin e blerësit.

Kërkon të japë sa më shumë nga mesazhi, por me pak fjalë.



- NIKE një nga kompanitë me të mëdha të produkteve sportive mbare boten.
- Ai është furnizuesi kryesor në botë i këpucë atletike dhe veshje dhe një prodhues i madh i pajisjeve sportive, me të ardhura më të madhe se US \$ 18.600.000.000 në vitin e tij fiskal 2008.
- Në vitin 2008, kishte të punësuar më shumë se 30.000 njerëz në mbarë botën.

Reklama përdor fjalitë e paplota, përdor shkallën krahasore të sipërisë relative, absolute dhe sipërore të mbiemrave, përdor shpesh vetën e dytë, për ta bërë më të besueshëm dhe më të drejtpërdrejtë mesazhin.

Lexojini reklamën shokut të bankës. Kërkojini që të mbajë shënime gjatë dëgjimit.

Drejtojini pyetje që kontrollojnë aftësitë e tij të të dëgjuarit.

*Përmirësoni fuqinë dhe stabilitetin tuaj me lehtësi*

Orbit trek Elite ofron një stërvitje të përkryer për të rinjtë, si dhe për të moshuarit, të cilët janë të shqetësuar për humbjen e lëvizshmërisë dhe të pavarësisë.

Rritni aktivitetin e muskujve deri në 400% brenda 60 sekondave.

Dhe gjithçka që duhet të bëni janë vetëm disa minuta me Orbit trek dhe ju mund të rrisni aktivitetin e muskujve deri në 400% brenda vetëm 60 sekondave! Vetëm disa lëvizje sa herë që keni kohë, është gjithçka që ju duhet për të rritur fuqinë e muskujve tuaj dhe për të përmirësuar lëvizshmërinë. Kryeni stërvitjen tuaj të përditshme në komoditetin e shtëpisë suaj.

Nuk ka rëndësi nëse bie shi apo borë, ju mund të kryeni fare lehtë ushtrimet tuaja të përditshme në komoditetin e shtëpisë suaj. Orbit trek është i sigurt, efektiv dhe i lehtë për t'u përdorur. Orbit trek përshtatet në çdo hapësirë, kështu ju por nuk mund ta bartni atë jashtë shtëpisë për t'u stërvitur.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjet diskutimi**

**PO**

A ndikojnë reklamat te ju për të blerë një mall të caktuar?

**JO**

**DISKUTOJMË SË BASHKU.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për dëgjimin aktiv, përfshirjen e tyre gjatë orës së mësimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha:</b> Gjuha dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Shkalla:</b> IV	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Rubrika:</b> Njohuri gjuhësore <b>Tema mësimore:</b> Eseja argumentuese (ora 1)		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim A duhet mbajtur uniforma në shkollë? Jepni argumentet pro dhe kundër problemit në fjalë.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale - Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon esenë argumentuese nga llojet e tjera të eseve; - diskuton për argumentet pro dhe kundër; - analizon strukturë e esesë; - shfrytëzon ide dhe fraza lidhëse për të shkruar një ese të tillë; - kontrollon para dorëzimit kriterin e organizimit dhe gjuhës para se ta lexojë esenë.		<b>Fjalët kyçe:</b> Ese Argument Kundërargument Fraza lidhëse Organizimi	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari, histori	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Imagjinatë e drejtuar, Lexim zinxhir, Punë individuale

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Imagjinatë e drejtuar

Imagjino sikur je në një vend mistik.

A do doje të rrije a të largoheshe prej tij?

Jep argumente për zgjedhjen tënde.

Secili nga nxënësit vret mendjen për të dhënë argumente dhe kundërargumente që mbështesin mendimin e tij.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Leximi zinxhir

Lexohet pjesa nga nxënës të ndryshëm.

Lexoni esenë argumentuese të mëposhtme dhe plotësoni tabelën me argumentet e

dhëna nga autori.

Argumente pro	Argumente kundër
Ka përparësitë e saj të zhvillimit të disa aftësive të njeriut	Rrjetet sociale dhe lojërat kompjuterike
Te fëmijët nxit memorizimin dhe përqendrimin, në rastin kur ka funksion pozitiv, për të shërbyer në mësimdhënie	Krijon varësi, izolim social dhe individualë, u merr kohën fëmijëve
Nxit kureshtjen	Jeta e fëmijëve drejtohet nga gjigantë virtualë
I bën të pavarur	Dëmtohen sytë
I bën të përgjegjshëm për detyrat që u ngarkohen	Fëmijët bëhen agresivë
Njihet me ndryshime që kanë ndodhur në rrafshin global	Imitojnë sjelljet e fituara nga lojërat
Qëndrojnë në kontakt me zhvillim e teknologjisë	Mungesë përqendrimi // u marrin kohën fëmijëve
	Humbje oreksi
	I ekspozon para rreziqeve të pedofilëve, por jo vetëm

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë individuale

Shfrytëzoni idetë e mëposhtme (duke shtuar edhe të tjera), si dhe frazat lidhëse për të shkruar një ese argumentuese me temë: *“Të studiosh jashtë vendit.”*

Nuk ekziston mënyrë më e mirë për të mësuar ose përvetësuar një gjuhë e huaj...

Përmirësohen aftësitë komunikuese.

Njeh kultura të ndryshme, sepse duke jetuar jashtë vendit dhe në një mjedis studentor ke mundësi të njihesh me studentë nga vende të ndryshme të botës.

Nxënësit fillojnë punë dhe nëse nuk u del koha ta përfundojnë në klasë u lihet detyrë shtëpie dhe kontrollohet orën tjetër.

**Më poshtë po ju sugjerojmë një ese argumentuese! Kujdes! Është vetëm sugjerim!**

Reklamat televizive dhe efekti mbi konsumatorin

Në jetën e përditshme, në mjediset publike, në radio, televizion, revista e gazeta, madje kohët e fundit dhe në internet shfaqen reklama nga më të zakonshmet e deri ato më të çuditshmet. Si një pjesë e rëndësishme e procesit të marketingut, reklama konsiderohet si një armë e fuqishme për t'u përballur me konkurrencën. Nga njëra anë reklamat sigurojnë një komunikim shumë të shpejtë me blerësin, duke spikatur efektin e tyre pozitiv. Nga ana tjetër kosto e lartë e tyre përbën problem serioz e shqetësues. Së fundmi manipulimi psikologjik me publikun është një problem që thekson efektin negativ të tyre mbi konsumatorin.

Reklamat sigurojnë një komunikim shumë të shpejtë me blerësin duke përdorur teknika të tilla si: me anë të përsëritjes së emrit të produktit, me formula si “Vodafone - Power to you” apo “AMC - E sjellim botën më afër”; trysni me ulje çmimi “Blini tani para se të mbarohet malli me ulje çmimi!”. Konsumatori tërhiqet shumë herë më shpejt ndaj këtyre produkteve, sesa ndaj produkteve që nuk u bëhet reklamë televizive.

Kosto e lartë e reklamave televizive është një problem serioz e shqetësues. Të gjithë duan të reklamojnë produktet e tyre në mediat më prestigjioze, por kjo nuk është kaq e thjeshtë, pasi kostoja është shumë e lartë. Në ShBA, në vitin 2006, kostoja mesatare e një reklame të një produkti vetëm prej 30` reklamimim gjatë finales së kampionatit të futbollit arriti në 2,5 milion USD. “Reklamimi i një produkti që do të bëhet në ndërprerjen e katërt të show-ut “Dancing with the stars” kushton 1670 euro” pohon Ana Kekezi, drejtoreshë marketingu pranë “Vizion Plus”, duke shtuar se shfaqjet nga realiteti po tërheqin interesin më të lartë për momentin, ndërsa vëmendja për emisionet politike ka rënë.[1]. Reklamimi i një produkti në ndërprerjet publicitare, kur zhvillohej “Big brother 4” kushtoi 1607 euro[2]. E si rrjedhim ky treg reklamash mbledh një shumë 55 milion eurosh në vit në Shqipëri ku 65% e “hanë” reklamat televizive , 20-23% reklamat outdoor, 5-7% radiot dhe media e shkruar dhe 1% interneti.[3]

Së fundmi një problem shqetësues është dhe manipulimi psikologjik me publikun i cili konsiston te synimi i kompanive për të krijuar një modë që konsumatorët duhet ta ndjekin. Në këtë mënyrë konsumatori bëhet i lumtur duke blerë produkte të tilla si: kremra për heqjen e rrudhave apo celulitit që i ka përdorur X modele. Modelet që i reklamojnë këto produkte duken shumë herë më të reja, jo falë produkteve, por falë photoshop-it; trupi perfekt i tyre është arritur me shumë ushtrime gjimnastikore, por duke i parë, publiku manipulohet e menjëherë e kap dëshira për t`i blerë këto produkte.

Unë mendoj se efektet pozitive apo negative të reklamave nuk do të ndikojnë në të ardhmen e tyre. Tregu i reklamave premton të jetë i zhvilluar ashtu si dhe sot. Reklamat janë e do të jenë pjesë e së përditshmes sonë ndaj do të jenë të pranishme kudo e kurdoherë.

<http://www.peshkupauje.com/2011/03/milionat-e-publicitetit>

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin në dhënien e ideve, për argumentet e qarta qofshin pro a kundër etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Eseja argumentuese (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Sot nuk dua të ha drekë! Argumentoji mamasë pse nuk dëshiron të ushqehesh.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon esenë argumentuese nga llojet e tjera të eseve; - diskuton për argumentet pro dhe kundër; - analizon strukturë e esesë; - shfrytëzon ide dhe fraza lidhëse për të shkruar një ese të tillë; - kontrollon para dorëzimit kriterin e organizimit dhe gjuhës para se ta lexojë esenë.		<b>Fjalët kyçe:</b> Ese Argument Kundërargument Fraza lidhëse Organizimi	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit “Si të shkruajmë ese CDE”		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari, histori	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim, Të nxënit në bashkëpunim, Reflekto/Reflekto/Reflekto</i> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Diskutim</i> <b>Diskutohet me nxënësit për detyrën e lënë me temë:</b> <i>“Të studiosh jashtë vendit.”</i> <b>Shihet:</b> ndërtimi strukturor i paragrafëve të esesë; lidhja logjike midis paragrafëve; trajtimi i temës së dhënë; fjalori i pasur; respektimi i drejtshkrimit në fjali dhe gramatikës etj. <i>Nxënësit japin mendimet e tyre.</i> <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> <i>Të nxënit në bashkëpunim</i> Shkruani një ese argumentuese në të cilën të shprehni mendimin tuaj (me rreth 100-120 fjalë) për njërën nga temat.			

**Grupi 1: Rruga drejt suksesit****Grupi 2: Miqësia e vërtetë****Grupi 3: Dënimi me vdekje**

Nxënësit fillojnë me brainstorming për të përthithur idetë e më pas japin argumentet pro dhe kundër. Shkruajnë kopjen e parë me qëllim të rishikohet disa herë para se ta lexojmë para auditorit.

Më poshtë po ju japim një shembull të formësimit të esesë argumentuese!

Dëmin me vdekje

Në jetojmë në një kohë kur vrasjet, grabitjet, plaçkitjet, dhunimet, e shumë lloje të krimeve të rënda janë bërë pjesë normale e jetës sonë. Bota sot po ballafaqohet me një eksplozion të krimeve të rënda. Mediat si elektronike po ashtu edhe ato të shkruara janë mbushura me lajme të trishtueshme, kështu që njeriu bashkëkohor në një mënyrë, me dashje apo pa të, është stërngarkuar me të dhëna, lajme e madje edhe imazhe ku të gjithë jemi dëshmitarë se jeta e njeriut, si qenie më e përsosur është bërë objekt permanent i sulmeve të vazhdueshme dhe më barbare. Duke qenë kështu, njeriu shpesh pyet veten si dhe pse po ndodhin kaq shumë krime? Pse numri i tyre vazhdimisht është në rritje edhe pse njeriu gjithnjë e më shumë është më i pasigurt se asnjëherë më parë? Për të gjitha këto krime mbi fajtorët duhet të ekzekutohet dënimi me vdekje apo ndonjë lloj tjetër dënimi mjaft që të mos jetë kapital?

Në të kaluarën dënimi kapital shqiptohej në çdo pjesë të globit, mirëpo dekadat e fundit shumë shtete e kanë kundërshtuar atë.

Së pari në karrigen e ekzekutimit mund të çohen njerëz të pafajshëm. Ka pasur raste që të dënuarit me vdekje të lirohen, kur provat e reja i kanë nxjerrë ata të pafajshëm. Një rast i tillë është ai i Ren Keine në ShBA ne Nju-Meksiko, i cili doli i pafajshëm 9 ditë para ekzekutimit të Marence Brandley në Teksas. Brandley thotë se ka prova dhe dëshmi që tregojnë se shteti i Teksasit ka ekzekutuar njerëz të pafajshëm dhe se shumë zezakë të varfër janë dërguar në qelitë e të dënuarve me vdekje afër Livingston-it në Teksas, sepse ata nuk kishin para për të paguar avokatët mbrojtës”[1].

Së dyti, dënimi me vdekje as nuk e pengon krimin e as nuk ndihmon viktimat. Një studim i OKB i përsëritur në vitin 1996 arrin në përfundimin se nuk ekziston asnjë provë që ekzekutimet kanë një efekt më të madh parandalues për krimet, sesa burgimi i përgjeshëm. Sipas Bashkimit Amerikan të Lirive Qytetare, shtetet amerikane ku dënimi me vdekje është ende i lejuar me ligj nuk kanë një tregues më të ulët të krimeve ose vrasjeve, sesa shtetet, të cilat nuk kanë ligje të tilla.

Një argument tjetër kundër ekzekutimit është mungesa e efektshmërisë së dënimit me vdekje, thotë Dorothy McClellan, e cila jep mësim në Universitetin A & M të Texasit.

“Dënimi me vdekje nuk e arrin qëllimin e tij. Ai kërkon hakmarrje, por nuk është i efektshëm, dhe nuk e përmbush rolin e parandaluesit të vrasjeve”. [2]

Së fundmi ekzekutimi i dënimit me vdekje shkel të drejtën themelore të njeriut, që sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut “jeta e gjithkujt duhet të mbrohet me ligj dhe se askush nuk duhet të privohet nga jeta”.

Megjithëse BE po bën një punë shumë të madhe për të zvogëluar vendet që zbatojnë dënimin me vdekje, këtë e tregon dhe fakti se në ShBA nga anketimi i Insitutit Galup vetëm 65% ë të anketuarve ishin pro dënimit me vdekje. Një ndër ta ishte dhe profesori i drejtësisë Robert Bleker i cili thotë: “Pas ndonjë vrasje mizore rritet dukshëm numri i atyre njerëzve që janë pro dënimit me vdekje.”

Duke e parë problemin nga aspekti ekonomik, shpenzimet që bëhen në burgje janë të shumta. Këto shpenzime paguhen nga taksat e popullit. Nëse do të zbatohet dënimi me vdekje e do të rritet numri i tyre, këto para do të shkonin në një destinacion më të dobishëm.

Duke e parë problemin nga aspekti shoqëror nëse dikush kryen një krim të rëndë ai duhet ta paguaj me të njëjtin çmim, me çmimin e lartë të jetës. Ndoshta ky dënim mund të jetë mjeti i vetëm në këtë botë të egër, që mund të frikësojë kriminelët.

Si përfundim pavarësisht mendimeve kundër apo pro këtij lloji dënimi, dënimi me vdekje është një shkëlqje e të drejtave themelore të njeriut: e të drejtës për jetën dhe e të drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues. Ai shkatërron marrëdhëniet qytetare në një shoqëri dhe dinjitetin e njerëzve që jetojnë në të.

1) <https://www.zeriamerikes.com/a/death-penalty/2562654.html>

2) <http://www.mapo.al/index.php?z=lexo&category=1&cid=20787&titulli=fushata-e-te-pafajshmeve-denimi-me-vdekje-humb-pike-n>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Reflekto/Reflekto/Reflekto

**Para se të dorëzoni esenë tuaj, kontrolloni pikat e mëposhtme.**

<p><b>Organizmi</b>  A keni ndjekur një vijueshmëri logjike?  A e paraqet hyrja juaj qartësisht temën?  A keni përdorur paragrafë të ndryshëm për secilën nga çështjet që keni trajtuar?  A fillon secili nga paragrafët me një fjali hyrëse?  A vijon secili prej tyre me shtjellime që e mbështesin këtë fjali?  A i përmbledh mbyllja e esesë suaj të gjitha argumentet?</p> <p><b>Gjuha</b>  A keni përdorur stilin e duhur?  A keni përdorur fjalor të pasur?  A keni përdorur fjalët dhe frazat lidhëse të duhura për të lidhur idetë?  A e keni organizuar esenë tuaj në paragrafë?  A keni përdorur citime?  A e keni verifikuar esenë për gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore?  Mbi bazën e këtyre kriterëve bëhet rishikimi i esesë para leximit në auditor.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mënyrën e përdorimit të argumenteve në një ese argumentuese, bashkëpunimin e tyre etj.</p>
---

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Portreti i Lasgush Poradecit (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Përshkruaj shoqen, shokun e bankës <i>Ose</i> Përshkruaj një prej pjesëtarëve të familjes <i>Ose</i> Përshkruaj një pikturë <i>Ose</i> Përshkruaj një stinë	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - hulumton për jetën e Lasgush Poradecit; - analizon veçoritë e tekstit përshkrues; - analizon përshkrimin objektiv dhe atë subjektiv; - shfaq ndjesitë e tij ndaj poetit të njohur nisur nga këndvështrimi i Ismail Kadaresë; - përshkruan një njeri, vend a send të dashur për të; - reflekton për vlerësimet që Kadare i bën Lasgushit.		<b>Fjalët kyçe:</b> Poet lirik Ismail Kadare Takime të rralla Përshkrim objektiv Përshkrim subjektiv Vel misteri	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bisedë, Lexim zinxhir e punë me fisht, Shkrim i shpejtë

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bisedë

Dy fjalë për autorin.

Llazar Sotir Gushter i njohur nën pseudonimin Lasgush Poradeci, lindi më 27 dhjetor të vitit 1899 në Pogradec, Shqipëri dhe vdiq më 12 nëntor të vitit 1987, poet dhe shkrimtar shqiptar. Lasgush Poradeci e jetoi Rilindjen në periudhën e shpërthimit të kryengritjeve të mëdha për liri. Në veprën e këtij romantiku të fundit të letërsisë sonë jetoi shqetësimi atdhetar i mbrojtjes së kombit dhe të traditës së Rilindjes, ashtu sikurse edhe dëshira për triumfin e pikëpamjeve demokratike, shqetësimi për një emancipim të përgjithshëm kulturor e shpirtëror të shoqërisë shqiptare. Ai është nga lirikët tanë më të mëdhenj, i cili u shqua për sensibilitetin dhe ëmbëlsinë poetike me të cilën i këndoi Shqipërisë dhe dashurisë. Në vitin 1933, u botua vëllimi i tij i parë “Vallja e yjeve”, dhe më 1937, u botua vëllimi i dytë “Ylli i zemrës”.

Pas Luftës së Dytë Botërore Lasgush Poradeci e vazhdoi veprimtarinë krijuese, por u mor edhe me përkthime. Ai shkroi, veç të tjerash, poemat “Eskursioni teologjik i Sokratit”, “Mbi ta”, “Kamadeva”, baladat për Muharrem e Reshit Çollakun. Gjithashtu, përktheu disa nga kryeveprat e letërsisë botërore si “Eugjen Onjegin” të Pushkin, lirikat e Lermontovit, të Bllokut, Poemat e Hajnes, të Majakovskit e Miçkieviçit, lirikat e Gëtes dhe Hajnes, poezi të Lanaut, Brehtit, Hygoit, Mysës, Bajronit, Shellit, Bërnit, të Eminesgut, etj. Vetëm në vitin 1989 mundi të botohet vepra e tij e plotë.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Lexim zinxhir e punë me fisht

Diskutojmë për përshkrimin objektiv e subjektiv.

**Përshkrimi objektiv** përdoret në tekstet shkencore, në enciklopeditë, në dokumentet zyrtare, në manualët shkencore dhe teknike etj. Karakteristikat e formës së tij janë: përdorimi i një gjuhe formale, të saktë dhe teknike; detaje të hollësishme për informacionet e dhëna; fjalori i përdorur është i saktë, i qartë dhe i thjeshtë.

**Përshkrimi subjektiv** përdoret në ditarët, letrat personale, në tekstet letrare dhe poetike. Karakteristikat e formës së tij janë: foljet e përdorura janë në kohë të tashme dhe të pakryer; përdorimi i ndajfoljeve, parafrazave, frazave që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet. përdorim i shumtë i mbiemrave. përdorimi i një gjuhe figurative, të pasur me metafora, krahasime, similituda etj.

**Titulli i pjesës është “Portreti i Lasgush Poradecit”. Çfarë lloj teksti mendoni se do të lexoni? Teksti përshkruar.**

Lexohet pjesa nga nxënës të ndryshëm. Punohet me fjalët e reja.

**Kuptojmë tekstin**

Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

**Çfarë i bënte përshtypje autorit sa herë takonte Lasgush Poradecin?**

Sapo trokisje në portën e Lasgushit gjithçka tjetërsohej.

**Nga informacioni i marrë nëpërmjet tekstit, a kuptojmë se takimet mes autorit dhe Poradecit kanë qenë të shpeshta?**

Jo Lasgushi ishte aty, disa qindra hapa larg e, megjithatë, përse nuk nisesha me ngut, me panik, për të mos humbur kohë?

Përse nuk kam shkruar më shpesh, thosha me vete. Dhe prapë shkroja rrallë.

**Si e përshkruan autori pamjen e jashtme të Lasgushit?**

I gjallë dhe i vdekur njëkohësisht. Pamja e tij e jepte shpeshherë në mënyrë të saktë këtë dyzim, sidomos kur vishte kostumin e zi dhe vinte borsalinë të zezë. Në një rast të tillë të dukej e natyrshme ta pyesje nëse dilte apo shkonte drejt arkivolit.

**Cilat janë detajet që i bëjnë përshtypje autorit në personalitetin e Poradecit?**

*Mekanizmi i kohës së tij ecte herë përpara, here mbrapsht e herë mbetej në vend. Edhe oraret ashtu i kishte: çohet nga gjumi në orën 11. Hante mëngjes. Flinte përsëri në 12. Hante drekën në 5 mbasdite. Flinte në 6. Çohet në 8 dhe punonte gjer më 3 pas mesnate.*

**Si e vlerëson Kadareja figurën e Poradecit?**

*Të shkoje tek ai, ishte më shumë se të dilje jashtë shtetit. Të dukej se dilje jashtë kohës, jashtë sistemit të zakonshëm të të menduarit.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Shkrim i shpejtë

Jepni mendimin tuaj:

**Në cilat shqisa bazohet autori për të portretizuar figurën e personazhit të vet? Sillni shembuj për secilin rast.**

Mbështetet në shqisën e të parit e të dëgjuarit

Jepni mendimin tuaj duke e pasuruar me shembuj nga teksti.

Nxënësit punojnë të qetë e më pas dëgjojnë dhe vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përshkrimin e bërë shokut, shoqes.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruani portretin e një figure të njohur e të dashur për ju. Shoqërojeni përshkrimin tuaj me një fotografi, në të cilën pasqyrohen detajet që ju keni përzgjedhur të përshkruani.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Portreti i Lasgush Poradecit (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Nxënësit recitojnë vargje të Lasgush Poradecit.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: <div><div>- hulumton për jetën e Lasgush Poradecit;</div><div>- analizon veçoritë e tekstit përshkrues;</div><div>- analizon përshkrimin objektiv dhe atë subjektiv;</div><div>- shfaq ndjesitë e tij ndaj poetit të njohur nisur nga këndvështrimi i Ismail Kadaresë;</div><div>- përshkruan një njeri, vend a send të dashur për të;</div><div>- reflekton për vlerësimet që Kadare i bën Lasgushit.</div></div>		<b>Fjalët kyçe:</b> <div>Poet lirik</div> <div>Ismail Kadare</div> <div>Takime të rralla</div> <div>Përshkrim objektiv</div> <div>Përshkrim subjektiv</div> <div>Vel misteri</div>	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit vargje nga poezitë e Lasgush Poradecit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b> <i>Shkrimi i shpejtë, Pauza treminutëshe, Të nxënës në bashkëpunim, Shkrim i lirë, Punë individuale</i>			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> <i>Shkrimi i shpejtë</i> Përshkruani portretin e një figure të njohur e të dashur për ju. Shoqërojeni përshkrimin tuaj me një fotografi, në të cilën pasqyrohen detajet që ju keni përzgjedhur të përshkruani.			
<b>Diskutojmë rreth detyrës së shtëpisë të dhënë orën e parë. Nxënësit japin mendimet e tyre.</b>			

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Pauza treminutëshe, Të nxënit në bashkëpunim

Informacioni i dhënë në tekst për personazhin	Tipare të karakterit	Tipare fizike	Vlerësime rreth figurës së tij	Krahasime me figurat e tjera
Porsa hyje tek ai, madje porsa trokisje në portë, aty për aty gjithçka tjetërsohej. Tjetër logjikë në të biseduar, tjetër kod, të tjera fjalë, të mbështjella me kuptim tjetër. Diçka mungonte përherë, e diçka qe e tepërt.	I paparashikueshëm Zemërimin e ftohtë I ashpër, Përbuzës, E folura e tij pa stërhollime	I gjatë Shumë i dobët, ngjante me një të vdekur sidomos kur vishte kostumin e zi me borsalinën e tij të zezë	Lasgush Poradeci ka mbetur për mua njeriu më i jashtëzakonshëm, më i ndërlikuar e më i pakuptueshëm që kam njohur.	Ai herë të kujtonte aktorin gjermano-shqiptar të viteve '30, Aleksandër Moisiun, herë grekët e lashtë të mbështjellë me zhgun jashtëkohor, e herë Papën Gjon Pali II.

### Gjuha e tekstit

#### Zgjidhni një nga përcaktimet subjektive të autorit për Poradecin dhe komentojeni atë.

Ndjenja e keqardhjes, e mëshirës së mundshme, e pikëllimit që ai qe harruar pa të drejtë, thërrmohej si një enë kristali sapo ndeshej me të. Kur ai hynte në kafenetë e Pogradecit, shkrimtarët që vinin për verim kishin ndjesinë se po strukeshin nga një stuhi e padukshme.

Ai ishte i paparashikueshëm, gërryes si acid, i rrezikshëm, i beftë.

Nxënësit komentojnë shprehjet e dhëna ose dhe të tjera dhe diskutojnë rreth tyre.

#### Gjuha përshkruese e Kadaresë herë formësohet në fjali të gjata, me disa mbiemra që renditen njëri pas tjetrit e herë nga fjali të shkurtra e koncize. Ç'të veçantë krijon ky stil përshkrimi.

##### Funksion shprehës. Lexuesi përfshihet emocionalisht.

Kemi përshkrim shprehës i cili përdoret dendur në tekste letrare për ta bërë sa më të gjallë përshkrimin dhe për ta bërë lexuesin sa më të ndjeshëm për atë që autori shkruan.

#### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë, Punë individuale

Shkruani vlerësimin e dhënë nga autori me fjalë të tjera, duke ruajtur idenë e dhënë: "Duke e parë, dhe sidomos duke e dëgjuar, gjithmonë mendoja se si ishte e mundur që njeriu ballkanas, njeriu shqiptar, të arrinte një ndërlikim të tillë, përkryerje, mëvetësi dhe mister

Një nga formulimet mund të jetë:

Trekëndëshi përkryerje, mëvetësi dhe mister karakterizonte këtë shqiptar.

Nxënësit japin mendimet e tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë orës së mësimi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b> <b>Tema mësimore: Mjeshtëri i kukullave (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Kukullat kokeshi – mister dhe bukuri Diskutojmë	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - hulumton rreth historisë së krijimit të kukullave “Kokeshi”; - zbulon lidhjen e brezave babai-gjyshi-mjeshtëri në dashurinë për gdhendjen e kukullave; - analizon veprimet e mjeshtërit të gdhendjes së kukullave; - përshkruan portretin e mjeshtërit; - argumenton lidhjen gjysh – nip dhe vazhdimësinë e punës në breza.		<b>Fjalët kyçe:</b> Kukullat kokeshi Pasion Mjeshtëri Gdhend Plaku – nipi Medalje	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit, <a href="https://www.youtube.com/watch?v=7RZLswtTTc0">https://www.youtube.com/watch?v=7RZLswtTTc0</a>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte, tik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Parashikim me anë të titullit, VLMD, Punë në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Parashikim me anë të titullit Arti i gdhendjes së kukullave, kukeshi është i lashtë 400 vjeçar. Janë krijuar për herë të parë si suvenirë, për turistët që vizitojnë pjesët veriore të Italisë. <b>Shiko</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=7RZLswtTTc0">https://www.youtube.com/watch?v=7RZLswtTTc0</a> Janë bërë pjesë e lojërave në internet Si mendoni për titullin “Mjeshtëri i kukullave” Si do të zhvillohen ngjarjet në të? <b>Diskutojmë së bashku.</b> Nxënësit bëjnë parashikimet e tyre. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> VLMD Mësuesi/ja lexon pjesën e ndarë në paragrafë. Nxënësit dëgjojnë paragrafët dhe u përgjigjen pyetjeve rreth tyre. <b>Pjesa 1. Një mjeshtër ... kukullave të tij</b> <b>Sa vjeç</b> është mjeshteri dhe nga është ai? Si kujdeset ai për profesionin dhe mjeshtërinë e tij? Çfarë mendoni se do të lexoni në paragrafët që do të vijnë? <b>Pjesa 2. Mjeshtëri e adhuror... për një ditë pune të mbarë.</b> Mjeshteri e ka trashëgim këtë mjeshteri apo është i vetmi nga familja? Cili është detaji për të cilin kujdesen këta mjeshtër? A janë të famshme këto kukulla? Pse janë të tilla? <b>Pjesa 3. Kukullat “kokeshi”... mjeshtër i kukullave “kokoshi”.</b> Si ishin kukullat e gdhendura nga mjeshteri plak? Përshkruajini ato. <b>Pjesa 4. Një ditë ai mori një porosi... kukullat e familjes së tij.</b> A i ka humbur refleksat mjeshteri megjithëse është i moshuar? Pse plaku dyshon për sasinë e kukullave që gdhendte në mbrëmje? Kush i gdhendte kukullat “kukeshi”? Çfarë mendoni se do të lexoni më pas ? <b>Pjesa 5. Ndoshta dikush... ato që i duheshin plakut për ekspozitë.</b> Kush e ndihmonte mjeshterin? A u çudit plaku, kur pa nipin e tij?			

**Pjesa 6. Mjeshtri zgjedh kukullat... të vyer për zemrën e tij.**

Ku e vendosi mjeshtëri medaljen e marrë? Pse veproi kështu?

Pas veprimtarisë me lexim dhe dëgjim të drejtuar nxënësit punojnë rubrikat e dhëna në tekst.

*Diskutohen dhe fjalët e reja.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë në dyshe

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

**Sa vjeç është mjeshtri i kukullave dhe cilës kombësie i përket ai?**

*80 vjeç dhe është nga Japonia*

**Cili është detaji i rëndësishëm për të tre trashëgimtarët e familjes?**

*Të tre trashëgimtarët e familjes e kanë të rëndësishëm detajin e dashurisë*

**Kur rrezikon kukulla ta humbë famën e saj? Ku gjenden kukullat “kokeshi”?**

**Ku e kërkon bekimin plaku? Pse ky vend është i veçantë?**

*Për këtë plaku ulet çdo mëngjes në altarin pranë vendit të punishtes së tij, në një nga mjediset e shtëpisë, dhe kërkon bekimin e paraardhësve për një ditë pune të mbarë.*

**Gjeni dy veçoritë kryesore të kukullave “kokeshi”. Mjaft të bukura, nga sytë e tyre del një lëng si kristal, i kanë flokë të gjata me ngjyrë të ndezur.**

*Kukullat janë:*

*të famshme;*

*shumë të famshme;*

*të panjohura;*

*pak të njohura.*

**Gjeni detajet e natës kur plaku dëgjon zhurma në punishte.**

*Një mbrëmje, nuk reziston dot nga kureshtja. Plaku ngrihet dhe, në majë të gishtave, ecën ngadalë, pa ndezur asnjë dritë, i afrohet punishtes. Ajo është e ndriçuar, si të ishte ditë. Hap derën dhe hyn brenda. Për çudinë e tij të madhe, ai gjen të nipin që po gdhend një kukull “kokoshi”.*

**Veçoni zgjedhjen që bën plaku në fund të përshkrimit**

*Kur kthehet në shtëpi, mjeshtri, pa bërë zhurmë, hyn në dhomën e nipit. Djali është në gjumë të thellë. Me ngadalë, plaku e vendos medaljen në një anë të krevatit. Kështu, ajo nuk do t'i shtohet koleksionit të çmimeve të mjeshtrit.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për të dëgjuarit kritik, për të kuptuarit e tekstit etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Të lexuarit</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore: Mjeshtëri i kukullave (ora 2)</b>		Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Kukullat kokeshi	
- hulumton rreth historisë së krijimit të kukullave “Kokeshi”;		Pasion	
- zbulon lidhjen e brezave babai-gjyshi-mjeshtëri në dashurinë për gdhendjen e kukullave;		Mjeshtëri	
- analizon veprimet e mjeshtërit të gdhendjes së kukullave;		Gdhend	
- përshkruan portretin e mjeshtërit;		Plaku – nipi	
- argumenton lidhjen gjysh – nip dhe vazhdimësinë e punës në breza.		Medalje	

<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> arte, tjk
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stuhi mendimi, Të nxënët në bashkëpunim-Grupet e ekspertëve, Rrjet diskutimi</p> <p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Stuhi mendimi</p> <div data-bbox="137 331 1441 918"> <pre> graph TD     A([Ngjyra të ndezura]) --- B([Sytë si të njeriut që])     C([Kukullat e plakut]) --- D([Veshje karakteristike të zonës])     E([Flokë të gjata/në dorë rrethore me rruaza]) --- F([Druri i njomë])     G([Veshja me stilt të panjohur]) --- H([Kukullat e nipit])     I([Më të plota]) --- J([Më të qeshura])             </pre> </div> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënët në bashkëpunim-Grupet e ekspertëve</p> <p><b>Ndabet klasa në grupe</b></p> <p><b>Grupi 1.</b> Mendoni se plaku e vuante idenë që do të ishte mjeshtri i fundit i kukullave “kokeshi”? Plaku ka një dëshirë të jashtme dhe një të brendshme. Plaku dëshiron që ta mbyllë. Brenda vetes ai dëshiron që të vazhdojë. _____ Cila prej dëshirave verifikohet në fund?</p> <p><b>Grupi 2.</b> Në këtë tekst përshkruhen: muri i plakut; puna plakut; kukullat “kokeshi” të bëra nga plaku; kukullat “kokeshi” të bëra nga nipi i tij; gëzimi i plakut.</p> <p><b>Përmbledhni përshkrimet e murit, punës dhe gëzimit të mjeshtrit në fund. Nga dallojnë dhe ku ngjajnë ato.</b></p> <p><b>Grupi 3.</b> Gjeni fjalë që tregojnë adhurimin e plakut për zanatin e tij. Renditni disa mbiemra që luajnë rol në përshkrimet e kësaj pjese Të gjata, të ndezura, të bukura, delikate, i kujdesshëm</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Rrjet diskutimi</p> <p>Diskutoni rreth mesazheve që përcillen në fjalitë e mëposhtme.</p> <p><i>Është i vjetër në moshë, e megjithatë nuk i ka humbur refleksët e punës.</i></p> <p><i>Kanë sy shumë të ngjashme me të njeriut. Pikërisht prej këtej buron dashuria që ato dhurojnë.</i></p> <p><i>Në vend të medaljes, mjeshtri ka fituar diçka shumë më të shtrenjtë dhe më të vyer për zemrën e tij.</i></p> <p><b>Nxënësit diskutojnë dhe japin mendimin e tyre. Ata vlerësojnë gjykimet e njëri-tjetrit.</b></p> <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre në grup, për angazhimin e tyre gjatë diskutimeve etj.</p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore: Fjalitë e varura përcaktore (ora 1)</b>		Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi/ja:		Fjali e përbërë	
<div>- dallon pjesën e n/r përcaktore në një fjali të përbërë;</div>		Pjesë e nënrenditur	
<div>- dallon paraprijësin në pjesën kryesore;</div>		Mjet lidhës	
<div>- analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë;</div>		Fjalë lidhëse	
<div>- argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r përcaktore në fjali e si ndahet me presje ajo.</div>		Paraprijës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> DDM, Punë në dyshe			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> DDM			
<b>Di</b>	<b>Dua të di</b>	<b>Mësova</b>	
Në fjalitë përcaktore, pjesa e varur hyn në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj. Më pëlqeu libri <i>që lexova dhe</i> .			
<b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> DDM			
<b>DI</b>	<b>DUA TË DUA</b>	<b>MËSOVA</b>	
Në fjalitë përcaktore, pjesa e varur hyn në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj. Më pëlqeu libri <i>që lexova dhe</i> .	Cilët shërbejnë si mjete lidhëse për fjalinë me pjesë të n/r përcaktore?	Si mjete lidhëse për fjalitë përcaktore mund të shërbejë përemri lidhor <i>që</i> ose <i>i cili/e cila</i> .	
	Në cilin pozicion qëndron pjesa e n/r përcaktore në raport me pjesën kryesore?	Pjesa e varur përcaktore mund të qëndrojë pas pjesës kryesore dhe në mes të saj:	
	Si ndahet me presje me pjesën kryesore, pjesa e n/r?	Pjesët e varura përcaktore, që lidhen me përemrat lidhore <i>i cili, e cila</i> , ndahen me presje. Kur paraprihen nga përemri lidhor <i>që</i> , zakonisht nuk ndahen me presje.	
Në fjalitë përcaktore, pjesa e varur hyn në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj. Më pëlqeu libri <i>që lexova dhe</i> . Cilët shërbejnë si mjete lidhëse për fjalinë me pjesë të n/r përcaktore? Si mjete lidhëse për fjalitë përcaktore mund të shërbejë përemri lidhor <i>që</i> ose <i>i cili/e cila</i> .			

Në cilin pozicion qëndron pjesa e n/r përcaktore në raport me pjesën kryesore?  
Pjesa e varur përcaktore mund të qëndrojë pas pjesës kryesore dhe në mes të saj:

Si ndahet me presje me pjesën kryesore, pjesa e n/r?  
Pjesët e varura përcaktore, që lidhen me përemrat lidhore *i cili, e cila*, ndahen me presje. Kur paraprihen nga përemri lidhor *që*, zakonisht nuk ndahen me presje.

Plotësohet tabela nga nxënësit. Në rast se nxënësit kanë paqartësi, shpjegohen nga mësuesi/ja.

*Sugjerim! Punoni me këtë metodë, pasi kjo i bën nxënësit më aktivë në dhënien e mendimeve në fazën e parë dhe “detyron” nxënësin në fazën tjetër të mësimit të bëjë pyetje se çfarë duan të dinë rreth fjalisë së përbërë me n/r përcaktore dhe të punojë me tekstin deri në detaje. Në rastet më të shumta, nxënësit dëgjojnë shpjegimin e mësuesit/les për temën e re, dhe nuk i hapin tekstet në shtëpi a më pas.*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Punë në dyshe*

**Plotësoni pjesët kryesore me nga një pjesë të varur përcaktore.**

*Më kujtohen ende fjalët, të cilat m’i thoshe përditë.*

*Përgjithësisht, më pëlqejnë filmat, që kanë subjekt miqësinë.*

*Ai ka një zakon, që ta shpif.*

*Ka disa ngjarje në historinë e vendit, që ngelen të pashlyeshme.*

*Ai është i vetmi vend, që të ngelet në kujtesë shumë gjatë.*

Nxënësit punojnë me ushtrimet e më pas diskutojnë rreth tyre.

Ata vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit, për dallimin e fjalive me pjesë të n/r përcaktore etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani një tekst të shkurtër me temë “Ndërrimi i stinëve” ose “Intervistë me veten” ku të përdorni sa më shumë fjali përcaktore.

Si mjete lidhëse përdorni përemrat lidhorë *që, i cili/e cila*, duke i shoqëruar këta të fundit edhe me parafjalë.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Fjalitë e varura përcaktore (ora 2)</b> <b>Ushtrime</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Punë me tekstin	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon pjesën e n/r përcaktore në një fjali të përbërë; - dallon paraprijësin në pjesën kryesore; - analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë; - argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e n/r përcaktore në fjali e si ndahet me presje ajo.		<b>Fjalët kyçe:</b> Fjali e përbërë Pjesë e nënrenditur Mjet lidhës Fjalë lidhëse Paraprijës	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> letërsi	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Diskutim, Punë në dyshe, Pauza treminutëshe

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Diskutim

**Diskutohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm.**

*Nxënësit vlerësojnë punët e njëri-tjetrit dhe sqarojnë paqartësitë.*

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

**Dalloni përcaktorët nga pjesët e varura përcaktore. Plotësoni tabelën.**

*Vajza, e lodhur nga leximi i tepërt, u largua nga biblioteka. Një i moshuar që po lexonte gazetën në park, e flaku papritur atë në një kosh pranë tij. Trikon e punuar me dorë nga gjyshja, nuk e heq nga dollapi. Punëtorët të cilët bëjnë pastrimin e qytetit, janë banorët e tij të natës. E ndërtuar me gurë të bardhë, shtëpia dukej si në përralla. Shtëpia në të cilën mblidheshim të gjithë së bashku, ruan ende kujtimet e të shkuarës.*

Përcaktor	Fjali përcaktore	Mjeti lidhës
E ndërtuar me gurë të bardhë, shtëpia dukej si në përralla.	Një i moshuar që po lexonte gazetën në park, e flaku papritur atë në një kosh pranë tij.	Që
	Punëtorët të cilët bëjnë pastrimin e qytetit, janë banorët e tij të natës.	Të cilët

**Nxënësit plotësojnë tabelën.**

**Formoni pesë fjali ku lidhëza “që” të lidhë pjesët e një fjalie:**

Qëllimore: Emigroi në Gjermani, që të jetonte një jetë më të mirë.

Përcaktore:

Kryefjalore:

Kundrinore:

Kushtore:

Zëvendësoni përcaktorët me pjesë të varura përcaktore dhe anasjellas.

Hanxhiu kishte një grua zemërdhembshur, që i vinte keq për mjerimet e tjetrit. E bija e saj, një vajze e re me pamje të bukur, e ndihmonte për të porepsur mysafirin. Në këtë han, punonte një shërbëtoreshë asuriane me gojë të gjerë, kokë të madhe, hundë plloçke, me njërin sy të shtrembër e me tjetrin jo fare të shëndoshë, por që të gjitha kusuret ia mbulonte bukuria e shtatit.

Hanxhiu kishte një grua që ishte zemërdhembshur dhe që i vinte keq për mjerimet e tjetrit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Pauza treminutëshe

Ndërto një fjali ku pjesa e nënrenditur të lidhet me kryesoren me mjetin lidhës që dhe të qëndrojë një herë pas pjesës kryesore dhe një herë në mes të saj.

*Nxënësit punojnë të qetë dhe më pas shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin për të kontrolluar saktësinë e kryerjes së ushtrimit.*

*Puna arkivohet në dosje.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin saktë të mjeteve lidhëse në fjalinë me pjesë të n/r përcaktore etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Eseja përshkruese (ora 1)</b>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Përshkruaj vendlindjen tënde.	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon esenë përshkruese nga llojet e tjera të eseve; - diskuton për mbiemrat që përdoren në ese; - analizon strukturën e esesë; - shfrytëzon ide dhe fraza lidhëse për të shkruar një ese të tillë; - kontrollon para dorëzimit kriterin e organizimit dhe gjuhës para se ta lexojë esenë.		<b>Fjalët kyçe:</b> Përshkrim Vend Person Mjedis Send Mbiemra	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari, arte, gjeografi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Imagjinatë e drejtuar, Mbajtja e strukturuar e shënimeve, Rishikim në dyshe <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</b> Imagjinatë e drejtuar Eseja përshkruese është një lloj eseje në të cilën përshkruhet: një objekt, person, vend, përvojë, emocion, situatë etj. <b>Imagjino sikur</b> me një llambë magjike u ktheve në fëmijëri. Përshkruaj shtëpinë ku u rrite. Nxënësit rikujtojnë fëmijërinë dhe përshkruajnë vendin ku u rritën.			
Ja disa udhëzime për të shkruar një ese përshkruese: Mendoni për disa minuta rreth asaj që do të shkruani. Nëse duhet të përshkruani pyllin në një stinë të caktuar, shkruani në fletore disa fjalë kyçe: <i>drurë të gjelbëruar, lëndina, lule, bar, qiell, stinë etj.</i> Pasi të keni përcaktuar objektet tuaja, filloni të shkruani mbiemra që cilësojnë secilin prej tyre dhe realizojnë përshkrimin. Përdorni gjuhë të qartë dhe të saktë. Kjo do të thotë se fjalët duhet të zgjidhen me kujdes, në përputhje me atë që doni të përshkruani. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Mbajtja e strukturuar e shënimeve <b>Lexohet pjesa “Pranvera në Alpet shqiptare” me radhë.</b> Lexoni përshkrimin e mëposhtëm. Nënvizoni informacionin që merrni nëpërmjet përshkrimit në një organizues grafik. Informacioni që merret është për Luginën e Valbonës, të Cemit, të Shalës, të Currajt, të Gashit, me bukuritë e tyre natyrore, vlerat shkencore dhe kurative.			
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</b> Rishikim në dyshe Gjatë leximit të përshkrimit të mëposhtëm, nënvizoni mbiemrat dhe përcaktoni kohën foljore që ka përdorur autori. Thethi, i pari në dhjetë fshatrat turistike më të mira të Shqipërisë. Shqipëria e vogël në sipërfaqe, por e bekuar me bukuri të pafundme. Ndër mjediset natyrore malore, përzgjedhja e parë për të vizituar është Parku Kombëtar i Thethit në zemër të Alpeve. Thethi është një ndër zonat më të veçanta të turizmit malor. Në Theth mund të gjeni një natyrë praktikisht të virgjër, mund të vizitoni kishat, kullat, shtëpitë tradicionale dhe mjaft monumente të natyrës. Aty ju presin njerëz mikpritës dhe të dashur. Thethi renditet i pari në dhjetë fshatrat turistike më të mira të Shqipërisë, i ndjekur nga Voskopoja në Korçë dhe Bënja në Përmet. Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë elemente, të tilla si: natyra dhe ekosistemi, tradita e kulinaria, infrastruktura dhe mundësitë akomoduese. E tashme dhe e shkruar.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësim.			

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Eseja përshkruese (ora 2)</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Përshkruaj aromën e parfumit tënd të preferuar.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - dallon esenë përshkruese nga llojet e tjera të eseve; - diskuton për mbiemrat që përdoren në ese; - analizon strukturën e esesë; - shfrytëzon ide dhe fraza lidhëse për të shkruar një ese të tillë; - kontrollon para dorëzimit kriterin e organizimit dhe gjuhës para se ta lexojë esenë.		<b>Fjalët kyçe:</b> Përshkrim Vend Person Mjedis Send Mbiemra	
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit, “Si të shkruajmë ese” CDE		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> qytetari, arte, gjeografi	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutim, Të nxënit në bashkëpunim-Punë në grupe. Rishikim në dyshe Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit. Diskutojmë rreth kërkesave për shkrimin e esesë përshkruese. Kujdes përshkrimin objektiv dhe atë subjektiv. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Të nxënit në bashkëpunim-Punë në grupe Shkruani një ese përshkruese subjektive për njërin prej temave të mëposhtme. <b>Grupi 1.</b> Një natë me stuhi <b>Grupi 2.</b> Personi që admiroj <b>Grupi 3.</b> Kopshti i fëmijërisë <b>Grupi 4.</b> Përmes errësirës <b>Grupi 5.</b> Një shtëpi përrallore, Gjyshja <b>Më poshtë po ju sjellim një shembull të një eseje përshkruese</b> Përshkrimi i një objekti “Si të shkruajmë ese” CDE. Udhëzues praktik për nxënësit dhe mësuesit. E thjeshtë Ajo ishte një orë e thjeshtë dhe e mbajtur mirë. Kur e nxora me kujdes nga mbajtësja e saj në formë drejtkëndëshi ku kish qëndruar prej shumë kohësh, vura re se sa shumë rëndoi në pëllëmbën e dorës sime. Por ajo ishte punuar me shumë delikatesë. Mbi të nuk kishte zbukurime të tepruara, pasi ajo ish menduar të ishte funksionale dhe për shumë vite e kish kryer detyrën e saj. Nëse prekje pjesën e prapme të orës, në pëllëmbën e dorës do të shkactohej një ndjenjë butësie, si të ishte punuar me shumë dashuri, njësoj siç po e ndjeja dhe unë në atë çast. Për të treguar kohën, fusha e orës së xhepit kishte shifra të gjata e të drejta romake. Ato nuk ishin shumë të mëdha dhe meqenëse midis çdo numri kishte hapësirë, shifrat nuk e mbingarkonin fushën e orës. Thjeshtësinë orës ia shtonte ekuilibri i ruajtur dhe simetria e arritur. Aty ku lexoheshin shifrat një dhe dy, gjendeshin zgjatime metalike në vazhdim të të cilave ishin dy butona të vijëzuar. Ato dukeshin si dy rojtarë që bënin roje. Njeri buton përdorej për të rregulluar orën dhe tjetri për të vendosur zilen e alarmit. Sa e sa herë janë rrotulluar këto butona, herë para e herë prapa për të rregulluar orën, dhe ende ishin të paprishur. Vijëzimet mbi butona ende dukeshin qartë, sikur të ishin vijat e një fytyre të plakur, që është krenare të shfaqë karakterin e saj luftarak ndaj kalimit të kohës. Gishtërinjtë më rrëshqitën ngadalë në rripin e zi prej lëkure që lidhte orën nga njëra anë, me zinxhirin nga ana tjetër. Gjendja në të cilën ndodhej lëkura më habiti, sepse ajo ishte ende e butë dhe elastike, pavarësisht nga mosha e saj. Kur zbrërtheva zinxhirin dhe përzgjeta rripin, vrima në të cilën ajo mbërthehej ishte hapur fare pak, sa për të lejuar që të mbërthehej lehtë. Dhe kur e mbylla, ajo u puthit fare mirë. Dy rrudha të thella e të dukshme, pikërisht aty ku bashkoheshin ora dhe rripi tregonin tërheqjen e peshës që ajo kishte mbajtur, por ato ishin veç rrudha, nuk kishte shenja që rripi ishte grisur. Ai rrip lëkure ishte lidhja dhe forca që nevojitej për t’i mbajtur të gjitha pjesët bashkë dhe për ta bërë atë të funksiononte si një e vetme.			

I vetmi zbulim i këtij elementi funksional ishte zinxhiri që varej në njërën anë të rripit prej lëkure. Një copëz e rrumbullakët metali të rëndë mbante portretin e disa burrave. Ata qëndronin në këmbë me veglat në duar, me kapelet në kokë, dhe në krye të kësaj cope metali shkruheshin tri fjalë: 30 vjet shërbim. Në fund të saj shkruhej një emër që i përkiste punëtorit të cilit i jepej ora, në mirënjohje për këtë kohë të gjatë në shërbim. Dy prej këtyre shpërblimeve qëndronin bashkë. Këto bukuri të paçmuara i shtonin dhe më shumë dinjitet orës.

Vazhdonte të ishte e thjeshtë, apo jo? Cilësitë e prekshme dhe ato të padukshme ishin pjesët që e krijuan atë orë, siç krijuan dhe njeriun të cilit ajo i përkiste, babain tim. ("Si të shkruajmë esë" fq. 146-147)

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Rishikim në dyshe*

**Nxënësit punojnë të qetë dhe më pas shkëmbejnë me njëri-tjetrin esetë e tyre. Kujdes kriteret e vlerësimit!**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Ligjëratë e drejtë		Situata e të nxënës: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon ligjëratën e drejtë nga e zhdrejta; - dallon pjesën lajmëruese dhe pjesën përmendëse në të.		Fjalët kyçe: Ligjërata e drejtë Ligjëratë e zhdrejtë Pjesa lajmëruese Pjesa përmendëse	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim për njohuritë paraprake, Tabela e konceptit, Punë në dyshe			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim për njohuritë paraprake			
Dalloni pjesët përbërëse në ligjëratën e drejtë.			
Nëna tha: “Nesër nisemi për pushime në Sarandë”			
Cila është pjesa përmendëse dhe cila është pjesa lajmëruese?			
Nxënësit vënë në kontroll dijet e tyre.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e konceptit			
Ligjërata e drejtë	Pjesa lajmëruese Ose fjalët e autorit	Pjesa përmendëse Fjalët e riprodhuara të folësit	Pozicioni ku ndodhet PL dhe PP
Ligjërata e drejtë riprodhon në formë të pandryshuar ç’është thënë apo shkruar nga një i tretë apo nga vetë folësi a shkruesi. Pra, në ligjërimin e mëparshëm nuk bëhet asnjë ndërhyrje.	Pjesa lajmëruese është produkt i riprodhuesit të ligjëratës, në rastin konkret si e tillë Shërben. Nëna tha	Pjesa përmendëse është ligjërata e folësit a e shkruarit të parë, e cila mund të riprodhohet tërësisht e pandryshuar, ose me ndryshime në formë. Në rastin konkret, ajo vjen në formën e ligjëratës së drejtë, pra risillet pa asnjë ndryshim, duke ruajtur formën dhe përmbajtjen e prodhuar nga ligjëruesi i parë: Nesër nisemi për pushime në Sarandë.	Rendi i pjesës lajmëruese dhe asaj përmendëse, është i lirë. Kështu, pjesa lajmëruese mund të qëndrojë përpara pjesës përmendëse, mund ta ndjekë atë, ose të hyjë në mes të saj.
		PP mund të jetë fjali dëftore, pyetëse dhe thirrmore	

**Kujdes!****Kujtojmë!**

Gjatë kalimit nga ligjëratat e drejtë në të zhdrejtë vihen re disa ndryshime, ndër të cilët përmendim:

*Shmanget përdorimi i dypikëshit dhe i thonjëzave dhe futet në përdorim lidhëza:*

Ai tha: “Nuk di ç’të bëj”. Ai tha se nuk dinte ç’të bënte.

*Foljet dhe përemrat e vetës së parë apo të dytë kthehen në vetë të tretë:*

Genti tha: “Vetëm unë paskam detyrime?” Genti tha se vetëm ai paskësh detyrime.

*Ndryshon koha e foljeve.*

Ai thoshte shpesh: “Po t’i kishte njerëzit e dashur pranë, *do të ishte* më e lehtë”.

Ai thoshte shpesh se po t’i kishte pasur njerëzit e dashur pranë, *do të kishte qenë* më e lehtë”.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** *Punë në dyshe*

**Dalloni ligjëratën e drejtë dhe analizoni pjesën lajmëruese (PL) dhe atë përmendëse. (PP)**

– Hë, – tha, – më trego. Gjithë dëshira që kisha për të treguar m’u zhduk papritur.

– Ç’të të tregoj? S’ka asgjë për të treguar, – ia ktheva.

– S’ka asgjë për të treguar?! – ia bëri ajo me habi, sikur dëgjoi gjënë më të pabesueshme në botë.

**Plotësoni fjalitë me ligjëratë të drejtë.**

*Mami më tha: “Të dua shumë biri im!”*

*Populli thotë: “Besa e shqiptarit si purtekë e arit”*

*I thashë motrës: “Duhet të mësosh më shumë, në do të bëhesh dikushi!”*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përdorimin e ligjëratës së drejtë në komunikim, për dallimin e pjesës lajmëruese dhe pjesës përmendëse etj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruani në ligjëratë të drejtë një bisedë imagjinare me vetveten. Bëni kujdes që pjesa përmendëse të përdoret në pozicione të ndryshme në raport me pjesën lajmëruese.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Ligjërata e zhdrejtë</b>		<b>Situata e të nxënës:</b> Kthe ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë.	
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - të dallojë ligjëratën e zhdrejtë nga ajo e drejtë; - të analizojë ndryshimet që ndodhin gjatë kthimit të ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas.		<b>Fjalët kyçe:</b> Ligjëratë e zhdrejtë	
<b>Burimet:</b> libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve: Diskutim i njohurive të mëparshme, Ditar dypjesësh, Praktikë e udhëhequr</i> <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim i njohurive të mëparshme</i> <b>Kthe ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë</b> A mund të luajmë bashkë Bora? - e pyeti Bora. <i>Ndërtimi i njohurive të reja: Ditar dypjesësh</i> Ligjëratat e zhdrejtë është riprodhim i fjalëve të një tjetri, ose i fjalëve të vetë folësit, në formë të ndryshuar, por duke e ruajtur të paprekur kuptimin e tyre.			

Ndryshimet në formë mund të vihen re gjatë kthimit të një ligjërate të drejtë në të zhdrejtë.

Ligjëratë e drejtë	Ligjërata e zhdrejtë
Ai thoshte shpesh: “Njerëzit duhet të bëjnë më shumë kujdes për planetin e tyre”.	Ai thoshte shpesh se njerëzit duhej të bënin më shumë kujdes për planetin e tyre.

**Ligjëratat e zhdrejta kthejini në ligjërata të drejta. Shkruajini dhe përdorni shenjat e pikësimit që duhen.**

*Ivesti na tha se edhe një mijë pengesa sikur t'i dilnin përpara, ai do t'i kapërcente me guxim.*

*Ivesti tha: “Një mijë pengesa të më dalin përpara, do t'i kapërcej.”*

*Klesti tha se ishte i kënaqur nga bashkëpunimi ynë.*

*Klesti tha: “Jam i kënaqur nga bashkëpunimi ynë.”*

*Jehona premtoi se do të stërvitej çdo ditë rregullisht.*

*Jehona premtoi: “Do të stërvitem çdo ditë rregullisht!”*

*Ai tha se nuk mund ta priste autobusin. Ai tha: “Nuk e pres autobusin!”*

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Praktikë e udhëhequr**

**Rishkruani tekstin duke vënë shenjat e pikësimit.**

ai me pyeti a mund të thuhet se atë ditë i kishe mposhtur ndjenjat e natyrshme njerëzore i thashë jo do të gënjeja po ta thosha këtë më tha ty të përshkruajnë si një njeri të heshtur dhe të mbyllur ai donte të dinte nëse ishte apo jo e vërtetë u përgjigja kjo ndodhë ngaqë asnjëherë nuk kam ndonjë gjë të madhe për të thënë dhe meqë është kështu nuk flas ai qeshi dhe shtoi sidoqoftë kjo nuk ka fare rëndësi

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Rubrika: Njohuri gjuhësore</b> <b>Tema mësimore: Shkruaj një ese argumentuese</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Punë me një tekst argumentues	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca personale			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: - shkruan ese argumentuese duke respektuar strukturën e saj.			
<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, Punë në dyshe, Reflekt/Reflekt/Reflekt

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:** Bashkëbisedim

Skema e renditjes formale në një ese.

Reklamat televizive – efektet e tyre mbi konsumatorin

## **I Efektet pozitive**

1. Komunikim i shpejtë me blerësin
2. Tërheqje e konsumatorit ndaj produktit

## **II Efektet negative**

1. Kosto e lartë prezantimi
2. Manipulim psikologjik i konsumatorit

**Ndërtimi i njohurive të reja:** Punë në dyshe

**Më poshtë po ju sugjerojmë një ese argumentuese! Kujdes! Është vetëm sugjerim!**

*Reklamat televizive dhe efekti mbi konsumatorin*

Në jetën e përditshme, në mjediset publike, në radio, televizion, revista e gazeta, madje kohët e fundit dhe në internet shfaqen reklama nga më të zakonshmet e deri ato më të çuditshmet. Si një pjesë e rëndësishme e procesit të marketingut, reklama konsiderohet si një armë e fuqishme për t'u përballur me konkurrencën. Nga njëra anë reklamat sigurojnë një komunikim shumë të shpejtë me blerësin, duke spikatur efektin e tyre pozitiv. Nga ana tjetër kosto e lartë e tyre përbën problem serioz e shqetësues. Së fundmi, manipulimi psikologjik me publikun është një problem që thekson efektin negative të tyre mbi konsumatorin.

Reklamat sigurojnë një komunikim shumë të shpejtë me blerësin duke përdorur teknika të tilla si: me anë të përsëritjes së emrit të produktit, me formula si "Vodafone - Power to you" apo "AMC - E sjellim botën më afër"; trysni me ulje çmimi "Blini tani para se të mbarohet malli me ulje çmimi!". Konsumatori tërhiqet shumë herë më shpejt ndaj këtyre produkteve, sesa ndaj produkteve që nuk u bëhet reklamë televizive.

Kosto e lartë e reklamave televizive është një problem serioz e shqetësues. Të gjithë duan të reklamojnë produktet e tyre në mediat më prestigjioze, por kjo nuk është kaq e thjeshtë pasi kostoja është shumë e lartë. Në ShBA, në vitin 2006, kostoja mesatare e një reklame të një produkti vetëm prej 30' reklamimim gjatë finales së kampionatit të futbollit arriti në 2,5 milion USD. "Reklamimi i një produkti që do të bëhet në ndërprerjen e katërt të show-ut "Dancing with the stars" kushton 1670 euro", pohon Ana Kekezi, drejtoreshë marketingu pranë "Vizion Plus", duke shtuar se shfaqjet nga realiteti po tërheqin interesin më të lartë për momentin, ndërsa vëmendja për emisionet politike ka rënë. [1] Reklamimi i një produkti në ndërprerjet publicitare, kur zhvillohej "Big brother 4 kushtoi 1607 euro [2]. E si rrjedhim ky treg reklamash mbledh një shumë 55 milion eurosh në vit në Shqipëri ku 65% e "hanë" reklamat televizive, 20-23% reklamat outdoor, 5-7% radiot dhe media e shkruar dhe 1% interneti.[3]

Së fundmi një problem shqetësues është dhe manipulimi psikologjik me publikun i cili konsiston te synimi i kompanive për të krijuar një modë që konsumatorët duhet ta ndjekin. Në këtë mënyrë konsumatori bëhet i lumtur duke blerë produkte të tilla si: kremra për heqjen e rrudhave apo celulitit që i ka përdorur X modele. Modelet që i reklamojnë këto produkte duken shumë herë më të reja, jo falë produkteve, por falë photoshop-it; trupi perfekt i tyre është arritur me shumë ushtrime gjimnastike, por duke i parë publiku manipulohet e menjëherë e kap dëshira për t'i blerë këto produkte.

Unë mendoj se efektet pozitive apo negative të reklamave nuk do të ndikojnë në të ardhmen e tyre. Tregu i reklamave premton të jetë i zhvilluar ashtu si dhe sot. Reklamat janë e do të jenë pjesë e së përditshmes sonë ndaj do të jenë të pranishme kudo e kurdoherë.

<http://www.peshkupauje.com/2011/03/milionat-e-publicitetit>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Reflekt/Reflekt/Reflekt

**Pas mbarimit të esesë, diskutohen punët me njëri-tjetrin dhe më pas arkivohen në dosje.**

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për punën e bërë gjatë orës së mësimi etj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<b>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla: IV</b>	<b>Klasa: VIII</b>																																																																																																																																															
<b>Rubrika: Të shkruajmë</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>																																																																																																																																																
<b>Tema mësimore: Vlerësime rreth një teme të shkruar</b>		Punë me tekstin																																																																																																																																																
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>																																																																																																																																																		
<div>- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</div> <div>- Kompetenca e të menduarit</div> <div>- Kompetenca personale</div> <div>- Kompetenca digjitale</div>																																																																																																																																																		
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>																																																																																																																																																
Nxënësi/ja:		Vlerësim																																																																																																																																																
<div>- vlerëson esenë e tij dhe të shokëve;</div> <div>- analizon gabimet e vetes dhe të tyre;</div> <div>- argumenton vlerësimin e bërë.</div>		Vetëvlerësim																																																																																																																																																
		Tabelë vlerësimi																																																																																																																																																
		Kritere																																																																																																																																																
<b>Burimet: libri i nxënësit</b>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>																																																																																																																																																
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë, Lojë në çift, Pauza treminutëshe</i>																																																																																																																																																		
<i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bisedë</i>																																																																																																																																																		
Gjatë gjithë vitit kemi zhvilluar tema me shkrim, kemi marrë vlerësime me notë për to dhe nuk jemi ndalur për kriteret që kemi ndjekur kur është bërë vlerësimi i tyre.																																																																																																																																																		
<i>Le të listojmë disa njohuri që ne duhet të dimë gjatë kohës kur vlerësojmë një temë:</i>																																																																																																																																																		
<b>Merrni një ese që keni shkruar dhe verifikoni nëse janë zbatuar udhëzimet e mëposhtme. Shënoni me + udhëzimet që keni zbatuar.</b>																																																																																																																																																		
<div>1. Çdo ese ka një titull. Shkruani një titull të qartë, titulli në formë pyetjeje është problematik.</div> <div>2. Fjalitë hyrëse në çdo paragraf duhet të jenë të qarta dhe të mbulojnë idenë.</div> <div>3. Hyrja duhet të jetë e qartë dhe koncize.</div> <div>4. Gjatë gjithë shkrimit, përpikuni t’i jepni përgjigje çështjes që keni ngritur (temës).</div> <div>5. Tregoni kujdes në ndjekjen e logjikës së shkrimit.</div> <div>6. Përdorni sa më shumë argumente dhe bëni lidhje shkak-pasojë.</div> <div>7. Paragrafët duhet të lidhen me njëri-tjetrin. Në përgjithësi, çdo paragraf lind nga i mëparshmi.</div> <div>8. Shmangni përdorimin e fjalëve të mëdha, pompoze.</div> <div>9. Shmangni idetë e dyshimta.</div> <div>10. Tregoni kujdes që të mos i devijoni së vërtetës.</div> <div>11. Mos e filloni shkrimin me data.</div> <div>12. Zgjidhni fjalët me kujdes që të mos lini vend për keqinterpretime apo deformime të idesë suaj.</div> <div>13. Paragrafët duhet të dallohen nga njëri-tjetri nëpërmjet hapësirës së paragrafit.</div>																																																																																																																																																		
<b>Ndërtimi i njohurive të reja: Lojë në çift</b>																																																																																																																																																		
Vlerësoni esenë tuaj duke vendosur nga 1-10 pikë për zbatimin e secilit udhëzim.																																																																																																																																																		
Plotësoni diagramin e mëposhtëm, duke ngjyrosur një katror për çdo pikë. Në fund përcaktoni pikën tuaj më të dobët dhe pikën më të fortë.																																																																																																																																																		
<table><tr><td>10</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>9</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>8</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>7</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>6</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>5</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>2</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td>10</td><td>11</td><td>12</td><td>13</td></tr></table>				10													9													8													7													6													5													4													3													2													1													1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
10																																																																																																																																																		
9																																																																																																																																																		
8																																																																																																																																																		
7																																																																																																																																																		
6																																																																																																																																																		
5																																																																																																																																																		
4																																																																																																																																																		
3																																																																																																																																																		
2																																																																																																																																																		
1																																																																																																																																																		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13																																																																																																																																						

*Nxënësit vlerësojnë sipas udhëzimeve dhe më pas evidentojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre.*

### **Kujdes!**

Merrni një ese që e ka shkruar një shoku ose shoqja juaj dhe verifikoni nëse janë zbatuar udhëzimet e mëposhtme. Shënoni udhëzimet që ka zbatuar.

1. Në përgjithësi, fjalitë duhet të kenë kryefjalë dhe kallëzues.
2. Mos përdorni fjalitë e paplota me tepri.
3. Mos e përdorni shpesh fjalëzën “etj.”, pasi ajo e mbyll mendimin.
4. Kur shkruani një fjalë të gjatë, bëni kujdes: shihni problemet, idetë, lidhjet logjike.
5. Në shkrimet e tipit ese zakonisht nuk përdoren përemrat “kjo/ky”.
6. Mos e copëtoni fjalinë me ndajshime.
7. Rekomandohet përdorimi i vetës së parë: “Unë mendoj...”, “Sipas mendimit tim...”.
8. Respektoni hapësirat mes fjalëve.
9. Mos harroni të mbyllni thonjëzat.
10. Mos shkruani me shkronja të mëdha.
11. Kontrolloni drejtshkrimin e fjalëve.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pauza treminutëshe**

Vlerësoni esenë e shokut ose të shoqes suaj, duke vendosur nga 1-10 pikë për zbatimin e secilit udhëzim. Plotësoni diagramin e mëposhtëm duke ngjyrosur një katror për çdo pikë. Në fund, përcaktoni pikën më të dobët dhe pikën më të fortë të shokut ose shoqes suaj.

<b>10</b>										
<b>9</b>										
<b>8</b>										
<b>7</b>										
<b>6</b>										
<b>5</b>										
<b>4</b>										
<b>3</b>										
<b>2</b>										
<b>1</b>										

*Nxënësit mësojnë të vlerësojnë punët e tyre dhe të të tjerëve. Pra e kalojnë me sukses procesin e vlerësimit dhe vetëvlerësimit. Udhëzohen të jenë të vëmendshëm, të paanshëm dhe jo emocionalë gjatë vlerësimit dhe vetëvlerësimit.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për respektimin e udhëzimeve për vlerësim dhe vetëvlerësim të një teme.

## TESTI I TREMUJORIT TË TRETË

### HAJDUT?!

Çdo muaj Aleksandri vë një pjesë të pagës së tij në llogarinë e tij në një bankë lokale. Nuk është shumë, por është e vetmja mënyrë që ai mund të kursejë, aq sa i duhen për pushime me fëmijët.

Çdo muaj banka i dërgon atij një njoftim ku i bën të ditur se sa të holla ka ai në llogarinë e tij. Këtë muaj Aleksandri shikon se ai ka shumë më tepër të holla se sa mendonte. Duhet të ketë pasur një gabim. Ai i shkruan bankës, ku i bën të ditur se i kanë vënë atij 2000 \$ më shumë.

“Nuk ka pasur gabim, - u përgjigj banka. Të hollat janë tuajat!

Aleksandri i shkruan përsëri. - Kemi kontrolluar dy herë , - i përgjigjet banka, - nuk kemi bërë ndonjë gabim.”

Aleksandri nuk është i kënaqur. Ai shkruan për herë të tretë dhe banka i kthen përgjigje se të hollat janë të tijat.

Mbas kësaj Aleksandri nuk mendon se ka ndonjë gjë për të humbur. Ai filloi të shpenzojë të hollat për gjëra, që i duheshin atij dhe familjes së tij. Ai blen mobilie të reja, rizbukuron apartamentin e tij dhe niset një javë me pushime me familjen.

Pak më vonë, njerëzit në bankë kuptojnë se ata kanë bërë një gabim. Të 2000\$ që i ishin dhënë Aleksandrit ishin të një klienti tjetër, i cili kishte të njëjtin emër. Banka i kërkon Aleksandrit të kthejë të hollat. Ai u jep atyre ato që kishin mbetur, por kishte harxhuar më shumë se 1000\$. Aleksandri akuzohet për vjedhje.

Mbas një gjykimi prej tri ditësh, juria vendosi të shpallë Aleksandrin të pafajshëm. Jurive nuk u duhet të japin shpjegime për vendimin e tyre, por ne mund të mendojmë se përpjekjet e Aleksandrit për t'i tërhequr vëmendjen bankës për gabimin, e bindën jurinë se ai nuk ka vepruar me synim të keq.

Megjithëse Aleksandri nuk u gjend fajtor për vjedhje, përsëri mbeti pyetja nëse ai duhet të kthejë të hollat që i kishte shpenzuar. Nuk ishte brenda kompetencave të gjykatës të trajtonte këtë fakt dhe bankës iu desh të ngrinte një padi në një gjykatë tjetër për të marrë të hollat.

#### 1. Aleksandri kishte depozituar në bankë të hollat për: 1 pikë

- a) pushime
- b) mobilim të shtëpisë
- c) për arsimimin e fëmijëve
- d) për t'i bërë dhuratë gruas

#### 2. Sasia e të hollave të vendosura tepër ishte: 1 pikë

- a) 5000 \$
- b) 2000 \$
- c) 8000 \$
- d) 100000 \$

#### 3. Kush ishte përgjegjës për të korrigjuar gabimin e bankës, Aleksandri apo banka? Pse? 2 pikë

---

---

#### 4. A i mori padrejtësisht Aleksandri të hollat padrejtësisht? Jepni mendimin tuaj! 2 pikë

---

---

5. Imagjinoni sikur ju të ishit një mik i Aleksandrit. A do ta kishit paditur atë në polici? 2 pikë

6. Si do të kishit vepruar, po të ishit Aleksandri? 2 pikë

7. Krijë një ese me temë “Fajtor, pa faj” 4 pikë

*Pjesa gjuhësore*

1. Gjej në tekstin e dhënë 1 fjali të thjeshtë dhe 1 fjali të përbërë. 2 pikë

---



---



---



---

2. Gjej në tekstin e dhënë 2 fjali të përbëra; një me nënrenditje dhe një me bashkërenditje, nënvizo mjetin lidhës. 4 pikë

---



---

3. Gjej një fjali me pjesë të n/renditur përcaktore. Dallo pjesën kryesore dhe atë të nënrenditur. 2 pikë

PK \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ Pn/r \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

4. Përcakto llojin e pjesës së nënrenditur të nënvizuar në fjalinë e dhënë: 1 pikë

Megjithëse Aleksandri nuk u gjend fajtor për vjedhje, përsëri mbeti pyetja nëse ai duhet të kthejë të hollat që i kishte shpenzuar.

5. Pjesën e nënrenditur në ushtrimin 4 vendose dhe në 2 pozicione të tjera në raport me pjesën kryesore. 2 pikë

---



---

6. Ndërto fjali me pjesë të nënrenditur. 5 pikë

- a) kushtore dhe shkakore
- b) krahasore
- c) mënyrore
- d) rrjedhimore

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

## Përgjigjet e testit

1. A
2. B
3. Përgjegjës për të korrigjuar gabimin e Aleksandrit ishte banka. Aleksandri e kishte bërë detyrën e tij si qytetar i përgjegjshëm, duke i shkruar bankës tri herë nëse kishte gabim në llogari.
4. Jo, për mendimin tim nuk kishte asnjë gabim në veprimin e Aleksandrit.  
E kishte sensibilizuar tri herë bankën për të parë nëse kishte ndonjë gabim në llogarinë e tij.
5. Jo! Ai nuk mund të quhej hajdut, pasi dhe gjykata i dha të drejtë atij për tërheqjen e vëmendjes ndaj bankës.

### Pjesa e gjuhësore

- **Fjali të thjeshta:**
  - a) Çdo muaj Aleksandri vë një pjesë të pagës së tij në llogarinë e tij në një bankë lokale.
  - b) Aleksandri i shkruan përsëri. Ose Aleksandri nuk është i kënaqur.
- **Fjali të përbëra:**

Nuk ishte brenda kompetencave të gjykatës të trajtonte këtë fakt dhe bankës iu desh të ngrinte një padi në një gjykatë tjetër për të marrë të hollat.

Megjithëse Aleksandri nuk u gjend fajtor për vjedhje, përsëri mbeti pyetja nëse ai duhet të kthejë të hollat që i kishte shpenzuar.

- 1) Ai filloi të shpenzojë të hollat për gjëra, që i duheshin atij dhe familjes së tij. *fjali n/renditëse përcaktore*  
Ai blen mobilie të reja, rizbukuron apartamentin e tij dhe niset një javë me pushime me familjen. *fjali b.renditëse shtuese*
- 2) Ai filloi të shpenzojë të hollat për gjëra, PK + që i duheshin atij dhe familjes. *Pjesë n/renditur përcaktore.*  
*Paraprijësi gjëra. Mjeti lidhës që*
- 3) Megjithëse Aleksandri nuk u gjend fajtor për vjedhje *Pjesë e nënrenditur lejore*

6. **a) kushtore dhe shkakore:** Nëse do shkosh në Pogradec në verë, merr trikon me mëngë të gjata me vete, sepse është shumë freskët.

**b) krahasore:** Biseda e tij ishte më miqësore nga sa mendohej.

**c) mënyrore:** Babai e puthi të birin me mall, ashtu siç e puthte në fëmijëri.

**d) rrjedhimore:** Ajo e kishte zënë ngushtë me argumente, kështu që ai nuk fliste fare më mirë.



